



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

Raport përfundimtar përmbledhës “Për auditimin e zbatimit të rekomandimeve në 6 subjekte “Agjencia e Menaxhimit të Garancive dhe Kredive të Pakthjera, Bankën e Shqipërisë, Degën Doganore Tiranë, Degën Doganore Kakavijë, Drejtorinë Rajonale Tatimore Fier, Drejtorinë Rajonale Tatimore Vlorë”, të audituara gjatë vitit 2024”.

RAPORTI I KONSOLIDUAR I AUDITIMIT

**“MBI AUDITIMIN PËR VERIFIKIMIN E ZBATIMIT TË
REKOMANDIMEVE TË LËNA NË AUDITIMET E VITIT 2024”**

Janar 2026

Nr.	Përmbajtja	Faqja
1	Përmbledhje ekzekutive	3-4
1.1	Hyrje	4-4
1.2	Objektivat e auditimit	4-5
1.3	Qëllimi i auditimit	5-5
1.4	Metodologjia	5-5
1.5	Konkluzione	5-5
2	Opinioni i përgjithshëm mbi zbatimin e rekomandimeve	5-5
3	Përshkrimi i auditimit	6-6
3.1	Agjencia e Menaxhimit të Garancive dhe Kredive të Pakthyera	6-22
3.2	Banka e Shqipërisë	22-27
3.3	Dega Doganore Tiranë	27-113
3.4	Dega Doganore Kakavijë	113-134
3.5	Drejtoria Rajonale Tatimore Fier	134-195
3.6	Drejtoria Rajonale Tatimore Vlorë	195-219

1. PËRMBLEDHJE EKZEKUTIVE

Mbështetur në ligjin nr. 154/2014, datë 27.11.2014 “Mbi organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit”, si dhe bazuar në Programin e Auditimit nr.857/6, prot, datë 12.09.2025, me objekt “Për verifikimin e zbatimit të rekomandimeve të lëna nga KLSH, në auditimet e vitit 2024”, Kontrolli i Lartë i Shtetit auditoi zbatimin e rekomandimeve të lëna në 6 subjekte auditime të ushtruara gjatë vitit 2024, Në përfundim të auditimit, janë hartuar projektraportet e auditimit për secilin subjekt, bazuar në Letrat e punës, Akt konstatimet, vërejtjet e bëra nga subjektet. Projekt raportet e auditimit janë dërguar në 6 subjekteve përkatëse:

- Agjencia e Menaxhimit të Garancive dhe Kredive të Pakthyera, dërguar Raportin Përfundimtar të Auditimit me shkresë nr. 185/14 prot., datë 01.08.2024;
- Banka e Shqipërisë, dërguar Raportin Përfundimtar të Auditimit me shkresë nr. 655/12, datë 31.12.2024;
- Dega Doganore Tiranë, dërguar me Raportin Përfundimtar të Auditimit me shkresën nr. 1113/23 prot., datë 31.12.2024;
- Dega Doganore Kakavijë, dërguar Raportin Përfundimtar të Auditimit me shkresë nr. 858/20 prot., datë 05.03.2024;
- Drejtorja Rajonale Tatimore Fier, dërguar Raportin Përfundimtar të Auditimit me shkresë Nr.1112/33 Prot., datë 15.07.2024;
- Drejtorja Rajonale Tatimore Vlorë , dërguar Raportin Përfundimtar të Auditimit me shkresë nr. 1111/40 prot., datë 03.10.2024.

Mbi këtë bazë është hartuar Raporti Përfundimtar i Auditimit.

Nga auditimi i zbatimit të rekomandimeve të evaduar gjatë vitit 2024, për 6 auditime të zhvilluara në 6 institucione, në lidhje me respektimin e afateve për informimin e KLSH-së, rezulton se:

5 subjekte (Banka e Shqipërisë, Drejtorja Rajonale Tatimore Vlorë, Drejtorja Rajonale Tatimore Fier, Dega Doganore Tiranë, Dega Doganore Kakavijë) kanë respektuar afatin 20 ditor për kthimin e përgjigjes për zbatimin e rekomandimeve, në përputhje me nenin 15, shkronja (j) të ligjit nr. 154/2014, datë 27.11.2014 “Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollin të Lartë të Shtetit”.

- 1 subjekte (Agjencia e Menaxhimit të Garancive dhe Kredive të Pakthyera) nuk ka respektuar afatin prej 20 ditë për kthimin e përgjigjes për zbatimin e rekomandimeve, në përputhje me nenin 15, shkronja (j) të ligjit nr. 154/2014, datë 27.11.2014 “Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollin të Lartë të Shtetit”.

- 4 subjekte (Drejtorja Rajonale Taimore Vlorë, Dega Doganore Tiranë, Drejtorja Rajonale Tatimore Fier, Dega Doganore Kakavijë) kanë kthyer përgjigje në KLSH mbi ecurinë e zbatimit të rekomandimeve brenda afatit 6 mujor në zbatim të pikës 2, të nenit 30, të Ligjit nr. 154/2014 datë 27.11.2014 “Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit”;

- 2 subjekte (Agjencia e Menaxhimit të Garancive dhe Kredive të Pakthyera, Banka e Shqipërisë) kanë kthyer përgjigje jashtë afateve të përcaktuara në pikën 2, të nenit 30, të Ligjit nr. 154/2014 datë 27.11.2014 “Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit”;

Niveli i realizimit të masave sipas llojit të tyre, paraqitet si më poshtë:

Nga auditimi “Për verifikimin e zbatimit të rekomandimeve të lëna nga KLSH, në auditimet e vitit 2024”, mbështetur në ligjin nr. 154/2014, datë 27.11.2014 “Për organizimin dhe funksionimin e
--

Kontrollit të Lartë të Shtetit”, standardet e INTOSAI-t, Manualët e Auditimit të KLSH-së, u konstatua se, niveli i zbatimit të rekomandimeve në 6 (gjashtë) institucionet: Agjencia e Menaxhimit të Garancive dhe Kredive të Pakthyera, Bankën e Shqipërisë, Degën Doganore Tiranë, Degën Doganore Kakavijë, Drejtorinë Rajonale Tatimore Fier dhe Drejtorinë Rajonale Tatimore Vlorë, paraqitet si vijon:

Lidhur me detyrimin ligjor të subjekteve të audituara për të raportuar në KLSH rreth hartimit të programit të tyre për të zbatuar rekomandimet e lëna, brenda afatit 20 ditor ka rezultuar se:

- 5 subjekte (Banka e Shqipërisë, Drejtoria Rajonale Tatimore Vlorë, Drejtoria Rajonale Tatimore Fier, Dega Doganore Tiranë, Dega Doganore Kakavijë) kanë respektuar afatin 20 ditor për kthimin e përgjigjes për zbatimin e rekomandimeve, në përputhje me nenin 15 shkronja (j) të Ligjit nr. 154/2014, datë 27.11.2014 “*Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit*”.

-1 subjekt (Agjencia e Menaxhimit të Garancive dhe Kredive të Pakthyera) nuk ka respektuar afatin 20 ditor për kthimin e përgjigjes për zbatimin e rekomandimeve, në përputhje me nenin 15 shkronja (j) të Ligjit nr. 154/2014, datë 27.11.2014 “*Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit*”.

Lidhur me detyrimin ligjor të subjekteve të audituara për të raportuar në KLSH mbi ecurinë e zbatimit të rekomandimeve të dhëna brenda afatit 6 mujor ka rezultuar se:

- 4 subjekte: (Drejtoria Rajonale Taimore Vlorë, Dega Doganore Tiranë, Drejtoria Rajonale Tatimore Fier, Dega Doganore Kakavijë) kanë kthyer përgjigje në KLSH mbi ecurinë e zbatimit të rekomandimeve brenda afatit 6 mujor, në kundërshtim me përcaktimet e pikës 2, të nenit 30, të Ligjit nr. 154/2014 datë 27.11.2014 “*Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit*”.

- 2 subjekte (Agjencia e Menaxhimit të Garancive dhe Kredive të Pakthyera, Banka e Shqipërisë), nuk kanë kthyer përgjigje në KLSH mbi ecurinë e zbatimit të rekomandimeve brenda afatit 6 mujor, në kundërshtim me përcaktimet e pikës 2, të nenit 30, të Ligjit nr. 154/2014 datë 27.11.2014 “*Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit*”.

Në 6 subjektet e audituara janë rekomanduar gjithsej **177 masa**, janë pranuar **171 masa** ose **97%**, si dhe nuk janë pranuar **6 masa** ose **3%** e tyre.

Nga **171** masat të lëna gjithsej dhe të pranuar, janë zbatuar plotësisht **95** masa ose **55 %**, zbatuar pjesërisht **25** masa ose **15 %**, në proces zbatimi **30** masa ose **18 %** dhe pazbatuar **21** masa ose **12%** e tyre.

Analizuar sipas llojit të masave të rekomanduara konstatohet se:

- **Masa për përmirësime/ndryshime legjislativi:** Nga **2** masa të rekomanduara janë pranuar plotësisht **2** rekomandime ose **100%**, të cilat rezultuan të pazbatuara.

- **Masa organizative:** Nga **93** masa të rekomanduara, janë pranuar plotësisht **88** rekomandime ose **95%**, **5** nuk janë pranuar ose **5%**. Nga masat e pranuar, janë zbatuar plotësisht **45** rekomandime ose **51%**, janë zbatuar pjesërisht **9** rekomandime ose **10%**, janë në proces zbatimi **27** rekomandime ose **31%**, si dhe **7** rekomandime rezultojnë të pazbatuara ose **8%**.

- **Masa me efekt negativ financiar (3E) “Të ardhura të munguara”:** Nga **52** masa të rekomanduara, janë pranuar plotësisht **51** rekomandime ose **98%**. Nga masat e pranuar janë zbatuar plotësisht **29** rekomandime ose **57%**, **14** rekomandime janë zbatuar pjesërisht ose **28%**, në proces zbatimi janë **2** rekomandime ose **4%**, si dhe **7** rekomandime ose **14%** nuk janë zbatuar.

- **Masa shpërblim dëmi:** Nga **8** masa të rekomanduara në vlerën **417,679 mijë lekë**, janë pranuar plotësisht **8** rekomandime ose **100%** e tyre, nga të cilat rezultojnë të zbatuara pjesërisht **1** masë, **1** masë në proces zbatimi dhe **6** të pa zbatuara, në vlerë **31,400 mijë lekë**.

- **Masa disiplinore:** Nga **22** masa të rekomanduara, janë pranuar plotësisht **22** rekomandime ose **100%** dhe janë zbatuar plotësisht **21** dhe **1** rekomandim zbatuar pjesërisht ose **9**- **Masa disiplinore:** Nga **22** masa të rekomanduara, janë pranuar plotësisht **22** rekomandime ose **100%** dhe janë zbatuar plotësisht **21** dhe **1** rekomandim zbatuar pjesërisht ose **99%**.

1.1. Hyrje

Kontrolli i Lartë i Shtetit auditoi zbatimin e rekomandimeve të lëna në auditimet e evaduara gjatë vitit 2023, të subjekteve të cilësuar më poshtë, mbështetur në programin e auditimit të miratuar nga Kryetari i Kontrollit të Lartë të Shtetit nr. 857/6 prot., datë 12.09.2025, të miratuar nga Kryetari i Kontrollit të Lartë të Shtetit, në zbatim të Rregullores së Procedurave të Auditimit dhe të Manualit për ndjekjen e zbatimit të rekomandimeve të auditimeve të Kontrollit të Lartë të Shtetit dhe Regjistrin elektronik institucional, miratuar me Vendimin e Kryetarit të KLSH nr. 67, datë 13.06.2020, nga data 11.11.2024 deri më datë 13.12.2024. Auditimi “Mbi zbatimin e rekomandimeve të lëna nga KLSH në auditimet e kryera në vitin 2024” u realizuar nga grupi i auditimit me përbërje:

- V.B, përgjegjës i grupit të auditimit
- R.G.
- R.Xh.
- E.B.
- I.F.
- F.D.
- A.D.
- E.H.

Auditimi filloi më 15.09.2025 dhe përfundoi më 24.10.2025.

Subjektet e audituara:

- Agjencia e Menaxhimit të Garancive dhe Kredive të Pakthyera;
- Banka e Shqipërisë;
- Drejtoria Doganore Kakavijë;
- Drejtoria Doganore Tiranë ;
- Drejtoria Rajonale Tatimeve Fier ;
- Drejtoria Rajonale Tatimeve Vlorë.

1.2. Objektivat e auditimit

- Hartimi i programit (Planit të Veprimit). Respektimi i afateve ligjore për njoftimin e KLSH për ecurinë e zbatimit të rekomandimeve brenda afateve të përcaktuara në ligjin nr. 154/2014 “Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit”.
- Zbatimi i rekomandimeve për përmirësime në legjislacionin në fuqi.
- Zbatimi i rekomandimeve për masat me karakter organizativ.
- Zbatimi i rekomandimeve për shpërblimin e dëmit ekonomik.
- Zbatimi i rekomandimeve për përdorim me efektivitet, eficientë dhe ekonomicitet të fondeve.
- Zbatimi i rekomandimeve për masa disiplinore dhe administrative.
- Të tjera që rezultojnë gjatë auditimit.

1.3. Qëllimi i auditimit

Dhënia e konkluzionit, mbi zbatimin e rekomandimeve të KLSH, të lëna nga auditimi i mëparshëm, në lidhje me respektimin e afateve të raportimit në KLSH mbi, Plan veprimin dhe ecurinë e zbatimit të rekomandimeve; statusin e zbatimit të rekomandimeve; koherencën e tyre si dhe përgjegjshmërinë menaxheriale, duke ju referuar Kornizës së Deklaratave Profesionale të INTOSAI (IFPP) të cilat përcaktojnë qartë rolet e përgjegjësitë e subjekteve të audituara dhe Institucioneve Supreme të Auditimit (SAI), sipas të cilave: “ përgjegjësia për implementimin e rekomandimeve në kohë dhe në mënyrë efektive është e subjekteve të audituara dhe përgjegjësi e SAI-ve ndjekja e zbatimit të rekomandimeve pra të verifikojë veprimet e ndërmarra dhe nëse janë arritur rezultatet e pritshme”.

1.4. Metodologjia

Duke patur në fokus përmbushjen e qëllimit të procedurës së auditimit dhe dhënien e një vlerësimi sa më objektiv, profesional dhe të pavarur, të saktë, të plotë e të qartë në lidhje me zbatimin e rekomandimeve, u auditua niveli i zbatimit të secilit rekomandim në subjektet e përzgjedhura, vlerësuar sipas dokumentacionit të vënë në dispozicion gjatë fazës së kryerjes së auditimit në terren.

1.5. Konkluzione

Për çështjet e shqyrtuara janë zhvilluar ballafaqime gjatë fazës së auditimit në terren dhe në përfundim të tij janë mbajtur Akt Verifikime për çdo subjekt të audituar, mbi rezultatet e të cilave është përgatitur ky Raport Auditimi.

2. KONKLUZIONI

Në përfundim të auditimit të ushtruar në 6 subjekte, bazuar në ISSAI/IFPP 100 “Parimet themelore të auditimit në sektorin publik” dhe Manualin për ndjekjen e zbatimit të rekomandimeve, miratuar nga Kryetari i KLSH me Vendimin nr. 67, datë 13.06.2020, për rekomandimet e lëna nga KLSH në auditimin e kryer gjatë vitit 2024, bazuar në Programin e Auditimit nr. 857/6 prot., datë 12.09.2025, me objekt “Për verifikimin e zbatimit të rekomandimeve të lëna nga KLSH, në auditimet e vitit 2024”, KLSH ka arritur në konkluzionin se, nga ana e subjekteve të audituara përgjithësisht është treguar përgjegjshmëri menaxheriale në shqyrtimin, pranimin dhe zbatimin e rekomandimeve të lëna nga KLSH, në auditimet e kryera gjatë vitit 2024. Nga auditimi i zbatimit të rekomandimeve konstatohet se shkalla e pranueshmërisë së rekomandimeve kundrejt atyre të papranuara rezulton në nivel të konsiderueshëm, konkretisht nga 177 masa të rekomanduara gjithsej, janë pranuar 171 masa ose 97%, si dhe nuk janë pranuar 6 masa ose 3% e tyre.

Niveli i zbatimit të rekomandimeve të pranuar për këto subjekte, rezulton sipas kësaj strukture: zbatuar plotësisht 95 masa ose 55%, zbatuar pjesërisht 25 masa ose 15%, në proces zbatimi 30 masa ose 18%, si dhe rezultojnë 21 masa të pazbatuara ose 12%.

3. PËRSHKRIMI I AUDITIMIT

Në zbatim të Programit të Auditimit nr. 857/6 prot., datë 12.09.2025 “Për verifikimin e zbatimit të rekomandimeve të lëna në auditimet e vitit 2024”, Grupi i auditimit ka ushtruar auditim, sipas njoftimeve për fillim auditimi:

1. Agjencinë e Menaxhimit të Garancive dhe Kredive të Pakthyera, sipas Njoftimit për fillim auditimi nr. 857/1, datë 10.09.2025;
2. Banka e Shqipërisë, sipas Njoftimit për fillim auditimi nr. 857/2, datë 10.09.2025;
3. Drejtoria Doganore Tiranë, sipas Njoftimit për fillim auditimi nr. 857/6, datë 10.09.2025
4. Drejtoria Doganore Kakavijë, sipas Njoftimit për fillim auditimi nr. 857/5, datë 10.09.2025;

- 5.Drejtoria Rajonale Tatimeve Fier, sipas Njoftimit për fillim auditimi nr. 857/3, datë 10.09.2025;
6.Drejtoria Rajonale Tatimeve Vlorë, sipas Njoftimit për fillim auditimi nr.857/4, datë 10.09.2025.

Nga verifikimi i dokumentacionit lidhur me hapat e ndërmarra për realizimin e rekomandimeve të lëna, ka rezultuar si në vijim:

3.1. AGJENCINË E MENAXHIMIT TË GARANCIVE DHE KREDIVE TË PAKTHYERA

I. PËRMBLEDHJE

Kontrolli i Lartë i Shtetit, ushtroi auditimin tematik në Agjencinë e Menaxhimit të Garancive dhe Kredive të Pakthyera me objekt “Për zbatimin e rekomandimeve të lëna në auditimet e evaduara në vitin 2024”, më shkresë përcjellëse nr. 185/14 prot.,datë 01.08.2024, në Agjencinë e Menaxhimit të Garancive dhe Kredive të Pakthyera në çështjeve, që lidhen me:

- Vlerësimin e rekomandimeve të KLSH-së të lëna nga auditimi i kryer në vitin 2024, hartimi programeve (plan veprimeve) nga subjekti i audituar, duke ngarkuar me detyra personat përgjegjës dhe përcaktuar afatet konkrete për zbatimin e rekomandimeve për çdo njësi vartëse; - Nxjerrjen nga titullari i njësisë publike të akteve administrative të nevojshme, si:

Vendimeve (urdhrave) për zbatimin e masave organizative;

Vendimet ekzekutive për shpërblimin e dëmit;

Vendimet ekzekutive për përdorimin me efektivitet, efikasitet dhe ekonomicitet të fondeve;

Vendimet e nëpunësit autorizues, komisioneve disiplinore për dhënien e masave disiplinore e të tjera masa e rekomandime që i përcillen subjektit të audituar nëpërmjet Vendimit të Kryetarit të Kontrollit të Lartë të Shtetit.

II. HYRJA

Auditimi është kryer në përputhje me ligjin nr. 154, datë 27.11.2014 “Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit”, si dhe manualit “Për ndjekjen e zbatimit të rekomandimeve të Kontrollit të Lartë të Shtetit” dhe Regjistrin elektronik institucional të zbatimit të rekomandimeve.

Auditimi i zbatimit të rekomandimeve të lëna në auditimin e mëparshëm, sipas drejtimeve të Programit të Auditimit nr. 857/6 prot., datë 12.09.2025 të miratuar nga Kryetari i Kontrollit të Lartë të Shtetit, është kryer nga grupi i audituesve i përbërë nga:

- V.B. përgjegjës i grupit të auditimit

- I.F. auditues

Auditimi filloi më 15.09.2025 dhe përfundoi më 24.10.2025.

II/1. OBJEKTI I AUDITIMIT

Zbatimi i masave të rekomanduara në auditimin e mëparshëm të dërguara me shkresën nr. 185/14 prot., datë 01.08.2024 në Agjencinë e Menaxhimit të Garancive dhe Kredive të Pakthyera sëbashku me Raportin Përfundimtar të Auditimit, nga Grupi i Audituesve Shtetërorë të KLSH-së.

II/2. QËLLIMI I AUDITIMIT

Auditimi i zbatimit të rekomandimeve kryhet në funksion të hartimit të Raportit Vjetor të aktivitetit të Kontrollit të Lartë të Shtetit, që paraqitet në Kuvendin e Shqipërisë brenda tremujorit të parë të vitit pasardhës, bazuar në pikën 3 të nenit 31 të ligjit nr. 154/2014 “Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit”.

II/3. METODOLOGJIA E AUDITIMIT

Auditimi i plotë i të gjithë dokumentacionit të paraqitur nga subjekti dhe që ka lidhje me zbatimin e masave të rekomanduara nga KLSH për përmirësimin e gjendjes së subjekteve në të ardhmen.

III. PËRSHKRIMI I AUDITIMIT

III/1. INFORMACION I PËRGJITHSHËM

Nga auditimi në terren i dokumentacionit të paraqitur nga subjekti Agjencia e Menaxhimit të Garancive dhe Kredive të Pakthyer në lidhje me zbatimin e rekomandimeve të lëna nga KLSH me shkresën nr. 185/14 prot., datë 01.08.2024, rezulton se, niveli i pranimeve dhe zbatimit të rekomandimeve është si më poshtë:

-Për përmirësimin e gjendjes janë lënë 20 rekomandime si ‘*Masa organizative*’, të cilat janë pranuar plotësisht, të cilat kanë statusin e ecurisë së zbatimit si vijon: 9 zbatuar plotësisht, 1 zbatuar pjesërisht, 10 në proces zbatimi dhe 0 masa të pazbatuar;

- Për fillimin e procedurës për dhënien e masës disiplinore në lidhje me mangësitë dhe shkeljet e konstatuara, të trajtuara në Raportin Përfundimtar të Auditimit është lënë 1 Masë Disiplinore e cila është pranuar dhe zbatuar plotësisht.

Konkluzion i përgjithshëm mbi zbatimin e rekomandimeve

Nga auditimi i zbatimit të rekomandimeve konstatohet se shkalla e pranueshmërisë së rekomandimeve rezulton në nivel 100% .

Niveli i zbatimit të rekomandimeve të zbatuara plotësisht rezultoi në masën 48%, niveli i rekomandimeve të zbatuara pjesërisht rezultoi 4%, niveli i zbatimit të rekomandimeve në proces zbatimi rezultoi 48%, niveli i rekomandimeve të pa zbatuara rezultoi 0%.

III/2. REZULTATET E AUDITIMIT SIPAS DREJTIMEVE TË AUDITIMIT

Nga auditimi i ushtruar në Agjencinë e Menaxhimit të Garancive dhe Kredive të Pakthyer, për zbatimin e rekomandimeve të KLSH-së, “*Mbi auditimin e përputhshmërisë* ” për periudhën 01.01.2021-31.12.2023, trajtuar në Raportin Përfundimtar të Auditimit me Vendimin e Kryetarit të KLSH-së përcjellë me shkresën nr. 185/14 prot., datë 01.08.2024, rezultoi si më poshtë vijon:

A. Mbi hartimin e programit (Planit të veprimit) dhe respektimin e afateve ligjore për njoftimin e KLSH për ecurinë e zbatimit të rekomandimeve brenda afateve të përcaktuara në Ligjin nr. 154/2014, datë 27.11.2014 “Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit”.

Nga auditimi ka rezultuar:

Me shkresën e KLSH nr.185/14 prot., datë 01.08.2024, protokolluar Agjencinë e Menaxhimit të Garancive dhe Kredive të Pakthyer është dërguar Raporti Përfundimtar dhe Rekomandimet për Auditimin e Përputhshmërisë, sipas Programit të Auditimit me 17/1 prot., datë 31.10.2022.

-Agjencinë e Menaxhimit të Garancive dhe Kredive të Pakthyer ka kthyer përgjigje më shkresën nr.4111/1 prot., datë 15.10.2024, pranë KLSH-së .në tejkallim të afatit ligjor 20 ditor.në kundërshtim me neni 15 gërma (j), ligjit nr. 154, datë 27.11.2014 “Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit”.

Agjencia e Menaxhimit të Garancive dhe Kredive të Pakthyer , AMGKP ka kthyer përgjigje me shkresën nr. 2224 prot., datë 22.07.2025, “Mbi progresin e zbatimit rekomandimeve jashtë **afatit 6 muhor,në kundërshtim me** pikën nr. 2, neni 30, të ligjit nr. 154, datë 27.11.2014 “Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit”.

B. Zbatimi i rekomandimeve për masat me karakter organizativ. Ecuria e zbatimit dhe analizimi i rekomandimeve: rekomandime të pranuar dhe nga këto, sa janë zbatuar plotësisht; zbatuar pjesërisht, në proces zbatimi dhe rekomandimet e pa zbatuara.

1.1. Rekomandimi: Nga Drejtori i Përgjithshëm i Agjencisë, në kuadër të ndryshimeve ligjore që ka pësuar Agjencia, të vlerësohen problematikat e evidentuara dhe të merren masa me qëllim shmangien e këtyre mangësive, në funksion të përmirësimit të punës në vijimësi.

Pretendimi i subjektit: Drejtoria ka ndërmarrë masa për hartimin e akteve nënligjore, të cilat do të sigurojnë funksionimin efektiv dhe shmangien e problematikave të evidentuara në zbatim të ligjit në fuqi.

Për hartimin e këtyre akteve nënligjore aktualisht agjencia ka vijuar me zhvillimin e takimeve me Ministrinë e Financave dhe me Ministrinë e Drejtësisë. Aktualisht relacioni i projektvendimit pasi u rivlerësua nga Ministria e Drejtësisë na është rikthyer për rishikim dhe jemi në proces të zhvillimit të një takimi ndërmjet MF, MD dhe AMGKP.

Qëndrimi i grupit të auditimit: Grupi i auditimit, pasi shqyrtoi dokumentat që ju vendosën në dispozicion nga institucioni, e konsideron rekomandimin të ***pranuar*** dhe ***në proces zbatimi***.

2.1. Rekomandimi: Agjencia e Menaxhimit të Garancive dhe Kredive të Pakthyera të marrë masa për ngritjen e një grupi pune i cili të analizojë mospërputhjet e evidentuara në Sistemin e Kreditit, si dhe të saktësojë këto të dhëna, duke bashkëpunuar me autoritetet përkatëse si ASHK/Gjendja Civile dhe kryqëzuar me dosjet fizike, me qëllim pasqyrimin e të dhënave të plota dhe të sakta, në funksion të përmirësimit të punës në vjeljen e kredive.

Pretendimi i subjektit:

Agjencia ka vetëm të drejtën e përdorimit të sistemit të Kreditit por nuk gëzon të drejtën e ndryshimeve të kodit të kredisë dhe kodit të klientit. Për të siguruar ndryshimet e nevojshme ka vijuar bashkëpunimi me AKSH-in si strukturë mbikëqyrëse e sistemit (fazë e cila është në proces zhvillimi). Gjithashtu ka vijuar të bashkëpunohet me Gjendjen Civile/ASHK për sa i përket pa saktësive të të dhënave të debitorëve të çelur me qëllim pasqyrimin e të dhënave të sakta në Sistemin e Kreditit.

Konkretisht sipas shkresave bashkëlidhur gjeni korrespondencën:

Shkresë Nr.107 prot., datë 16.01.2025 "Kërkesë për Bashkëpunim" drejtuar Gjendjes Civile,

Për sa i përket SISTEMIT KREDIT agjencia është në proces dorëzimi të sistemit pranë AKSH-it, shkresat si më poshtë:

Shkresë nr. 1420 prot., datë 20.05.2024 "Kërkesë për kalimin e sistemit të KREDITIT pranë AKSHI-t".

Shkresë nr. 2512/1 prot., datë 26.06.2024 "Kthim përgjigje AKSH-it".

Shkresë nr. 1420/2 prot., datë 08.07.2024 "Kthim Përgjigje AMGKP"

Urdhër i Brendshëm nr. 141 prot., 20.01.2025 " Për kalimin e Sistemit të Kreditit pranë AKSH-it"

Shkresë nr. 168 prot., datë 21.01.2025 "Informacion drejtuar AKSH-it"

Informacion nr. 141/1 Prot., datë 20.05.2025 mbi takimin e zhvilluar e përfaqësues të AKSHI-t me objekt "Kalimi i Sistemit të Kreditit në menaxhim të tyre".

Shkresë Nr.2358/1 prot., datë 13.08.2025 "Kërkesë e përsëritur për Bashkëpunim" drejtuar Gjendjes Civile,

Email datë 03.09.2025 me zyrën e Gjendjes Civile në Ministrinë e Brendshme,

Emaille korrespondencë me AKSHI-n , mbi kalimin e Kreditit.

Qëndrimi i grupit të auditimit: Grupi i auditimit, pasi shqyrtoi dokumentat që ju vendosën në

dispozicion nga institucioni, e konsideron rekomandimin të **pranuar** dhe **në proces zbatimi**.

3.1. Rekomandimi: Agjencia e Menaxhimit të Garancive dhe Kredive të Pakthyera të marrë masa për ngritjen e një grupi pune, i cili të konfirmojë dhe plotësojë të dhënat e munguara në Sistemin e Kreditit, përfshirë dhe ato që mbahen jashtë sistemit, duke bashkëpunuar me autoritetet përkatëse si ASHK/Gjendja Civile/Banka e Shqipërisë etj., me qëllim pasqyrimin e të dhënave të plota dhe të sakta, në funksion të rritjes së efektivitetit të saj në vjeljen e detyrimeve debitore.

Pretendimi i subjektit:

Kjo detyrë është zbatuar në vijmësi për cdo dosje, por për shkak të ngarkesës dhe volumit të madh të dosjeve që merren në shqyrtim, është vlerësuar e pamundur të kryhet brenda 2024 por grupi i punës ka raportuar përiodikisht tek titullari i institucionit.

Konkretisht sipas urdhërit bashkëlidhur:

Urdhër i brendshëm Nr. 4111 prot., datë 09.10.2024 "Për zbatimin e planit të masave, mbi planin e masave për rekomandimin nr.3 të lëna nga KLSH.

Për zbatimin e këtij urdhëri në sistemin e kreditit janë përditësuar të gjithë të dhënat në qelizën "shënime" për sa i përket gjeneraliteteve, ID-ve, kolateralit apo cdo informacion i ardhur nga ASHK, BSH, zyrat përmbarimore shtetërore apo private (fazat përmbarimore).

Qëndrimi i grupit të auditimit: Grupi i auditimit, pasi shqyrtoi dokumentat që ju vendosën në dispozicion nga institucioni, e konsideron rekomandimin të **pranuar** dhe **në proces zbatimi**.

4.1. Rekomandimi: Drejtori i Agjencisë së Menaxhimit të Garancive dhe Kredive të Pakthyera të marrë masa për ngritjen e një grupi pune me qëllim (i) evidentimin e pasurive të lëna si kolateral përmes informacionit që disponon Agjencia ndër vite dhe bashkëpunimit institucional me Agjencinë Shtetërore të Kadastrës, si dhe (ii) zhvillimin e një analize kosto-përfitim për vlerësimin e këtyre kolateraleve, me qëllim rritjen e nivelit të rikupërimit të kredive.

Pretendimi i subjektit:

Nga ana e Drejtorisë së AMGKP-së është vendosur që të verifikohen dosjet rast pas rasti, nga Sektori i Ndjekjes së Procedurave Juridike dhe Operacionale. Vlerësimi i të gjitha këtyre kolateraleve nga ana e Agjencisë do të kishte një kosto të konsiderueshme. Për këtë arsye është kryer vlerësimi i pasurive të kërkuara nga përmbarimi si më poshtë vijon:

Vendim Nr. 367 Prot., datë 31.01.2025 (debitor A.M.)

Vendim Nr. 2102 Prot., datë 08.07.2025 (debitor V.M.).

Qëndrimi i grupit të auditimit: Grupi i auditimit, pasi shqyrtoi dokumentat që ju vendosën në dispozicion nga institucioni, e konsideron rekomandimin të **pranuar** dhe **të zbatuar pjesërisht**.

5.1. Rekomandimi: Agjencia e Menaxhimit të Garancive dhe Kredive të Pakthyera të marrë masa për ngritjen e një grupi pune i cili të (i) vlerësojë ekzistencën fizike të pasurive të luajtshme të sekuestruara ndër vite, (ii) të inventarizojë këto pasuri dhe (iii) të përcaktojë vlerën e saktë të tyre, me qëllim pasqyrimin e saktë të këtyre pasurive në llogaritë e pasqyrave financiare dhe më pas mbledhjen e huave të pakthyera.

Pretendimi i subjektit:

Për sa i përket vlerësimit të ekzistencës fizike të pasurive të luajtshme të sekuestruara ndër vite janë ngritur urdhërat e mëposhtëm:

Urdhër i Brendshëm Nr. 4333 Prot., datë 29.10.2024 "Ngritje e grupit të punës për inventarizimin dhe gjendjen fizike të pronave të luajtshme në pronësi të AMGKP-së ", ku janë mbajtur procesverbalet si më poshtë:

Procesverbal me Nr. 4333/1 prot., datë 13.12.2024.

Procesverbal me Nr. 114 prot., datë 17.01.2025.

Procesverbal me Nr. 115 prot., datë 17.01.2025.

Urdhër i Brendshëm nr. 4334 prot., datë 29.10.2024 "Ngritje e grupit të punës për inspektimin dhe gjendjen fizike të pasurive të paluajtshme", ku janë mbajtur procesverbalet si më poshtë:

1. Procesverbal Nr. 4334/1 prot., datë 20.11.2024.
2. Procesverbal Nr. 4334/2 prot., datë 20.11.2024.
3. Procesverbal Nr. 4334/3 prot., datë 20.11.2024.
4. Procesverbal Nr. 4334/4 prot., datë 20.11.2024.
5. Procesverbal Nr. 4334/5 prot., datë 20.11.2024.
6. Procesverbal Nr. 4334/6 prot., datë 13.12.2024.
7. Procesverbal Nr. 4334/7 prot., datë 13.12.2024.

Për sa i përket inventarizimit të këtyre pasurive dhe përcaktimit të vlerës së saktë të tyre, me qëllim pasqyrimin e saktë të këtyre pasurive në llogaritë e pasqyrave financiare dhe më pas mbledhjen e huave të pakthyera është një proces i cili do të kryhet pas miratimit të akteve nënligjore do të bëhet rast pas rasti rivlerësimi i këtyre pasurive.

Qëndrimi i grupit të auditimit: Grupi i auditimit, pasi shqyrtoi dokumentat që ju vendosën në dispozicion nga institucioni, e konsideron rekomandimin të *pranuar* dhe *në proces zbatimi*.

6.1. Rekomandimi: Agjencia e Menaxhimit të Garancive dhe Kredive të Pakthyera të marrë masa për nxjerrjen e certifikatave të pronësisë në ASHK dhe të urdhrave të kontabilizimit për 12 pasuritë e paluajtshme të cituara në këtë auditim, me qëllim pasqyrimin e tyre në llogaritë e pasqyrave financiare të Agjencisë dhe më pas ndjekjen e procedurave të mundshme të ankandit.

Pretendimi i subjektit:

Nga ana e institucionit janë marrë masat e nevojshme për aplikim në ASHK për nxjerrjen e certifikatave për debitorët si më poshtë vijon:

1. B.R.,

Shkresë nr. 1315 prot., datë 16.04.2025.

Shkresë nr. 1279/2 prot., datë 16.07.2025.

Kthim përgjigje ASHK-së.

shkresë nr. 1279/4 prot., datë 19.08.2025 Kërkesë për paisje dokumentacioni.

2. S.K.,

Shkresë nr. 1913/1 prot., datë 16.06.2025.

Shkresë nr. 1913/3 prot., datë 25.06.2025.

Kthim-Përgjigje, shkresë n r. 1913/4 prot., datë 16.07.2025.

Kërkesë e ripërsëritur, shkresë nr. 1913/7 prot., datë 31.07.2025, Kthim përgjigje ASHK-së.

A.K., Shkresë nr. 532/1 prot., datë 20.02.2025.

3. C.C.,

Shkresë nr. 1024/1 prot., më datë 13.05.2025 është dërguar shkresë për tejkalim afatesh

Më datë 27.06.2025 jemi paisur me certifikatë pronësie në emër të AMGKP-së, e cila është kontrabilizuar me urdhërin e brendshëm nr. 2151/2 prot., datë 17.07.2025.

1. V.L.,

Shkresë nr. 1316 prot., datë 16.04.2025,

Shkresë nr. 1316/1 prot., datë 21.07.2025 "Kërkesë e ripërsëritur"

2. B.B., 2 prona.

Për njërën nga pronat jemi paisur me certifikatë pronësie me datë 18.02.2020.

Shkresë nr. 2619 prot., datë 15.09.2025 "Kërkesë për pajisje me dokumentacion".

3. T.T., 3 prona

Autorizim nr. 5477 prot., datë 26.12.2024

Shkresë me nr. 1758/1 datë 17.07.2025

Kthim-Përgjigje, Topografi Emiljan Gjura, nr. 2293/4 prot., datë 29.08.2025

Urdhër i Brendshëm nr. 2293/2 Prot., datë 27.08.2025 “ Për fillimin e procedurave të kryerjes së plan rivlimeve për pasurite e marra në pronësi nga debitorët”

Plan rivlimi datë 01.09.2025.

4. J.R.

Shkresa nr. 5399 prot., datë 19.12.2024 kërkesë për plotësim dokumentacioni nga ASHK.

Vendimi nr.256/2011, nr. 8462 prot., datë 23.11.2012 mbi kalimin e pronësisë së sendit të paluajtshëm në pronosi të kreditorit.

Shkresa kthim përgjigje aplikimit nr.2012 datë 24.10.2024, me nr. 5399/1 prot., datë 20.12.2024

5. F.D.

Shkresa nr. 2759 prot., datë 22.09.2025, kërkesë për paisje me dokumentacion drejtuar Agjencia Shtetërore e Kadastrës Drejtoria Vendore Gjirokastrë.

Qëndrimi i grupit të auditimit: Grupi i auditimit, pasi shqyrtoi dokumentat që ju vendosën në dispozicion nga institucioni, e konsideron rekomandimin të *pranuar* dhe *i zbatuar*.

7.1. Rekomandimi: Nga ana e Sektorit të Financës në AMGKP në bashkëpunim me strukturat përkatëse, të merren masa për verifikimin e gjendjes reale dhe statusin e pronave dhe asetëve të mbajtura për shitje, të kryejë inventarizimin si edhe regjistrimin e të gjitha pronave në ASHK, duke përgatitur të gjithë dokumentacionin tekniko-ligjor, më pas vlerësimin e tyre, kontabilizimin në vlerë të plotë dhe pasqyrimin në aktivet e pasqyrave financiare.

Pretendimi i subjektit:

Agjencia pas daljes së akteve nënligjore të cilat do të përcaktojnë dhe saktësojnë procedurat e vlerësimit do të ketë angazhimin maksimal për realizimin e rekomandimit, duke marrë masa për zbatimin e tyre. Pasi të bëhet rivlerësimi i pronave, Sektori i Financës në bazë të urdhërit të kontabilizimit do të bëjë ndryshimin e vlerës në kontabilitet në përputhje me kuadrin ligjor në fuqi. Rrjedhimisht, për shkak të mos daljes së akteve nënligjore për procedurat e vlerësimit të pronës, ende nuk ka marrë një urdhër për kontabilizimin dhe pasqyrimin në aktivet e pasqyrave financiare.

Qëndrimi i grupit të auditimit: Grupi i auditimit, pasi shqyrtoi dokumentat që ju vendosën në dispozicion nga institucioni, e konsideron rekomandimin të *pranuar* dhe *në proces zbatimi*.

8.1. Rekomandimi: Drejtoria i Përgjithshëm i Agjencisë së Menaxhimit të Garancive dhe Kredive të Pakthyera të marrë masa për ngritjen e një grupi pune me qëllim vlerësimin e të gjithë problematikave, të rezultuara nga auditimi për të siguruar garantimin e saktësisë dhe plotësisë në dokumentimin e dosjeve të kredive, duke bërë inventarizimin, numerizimin dhe arkivimin për çdo dosje.

Pretendimi i subjektit:

Duke konsideruar që është detyrë e cila kërkon angazhim dhe kohë të konsiderueshme të disa sektorëve në vijimësi janë marrë masat si më poshtë:

Dosjet po plotësohen me fletën shoqëruese sipas normave tekniko-ligjore të miratuara nga Arkiva.

Urdhëri i Brendshëm Nr. 4111 prot., datë 09.10.2024 "Për zbatimin e planit të masave, mbi

planin e masave për rekomandimin nr. 3 të lëna nga KLSH

Nga sektori i Informacionit dhe Administrimit të Dokumentacionit është mbyllur procesi i inventarizimit të GS 1.

Duke qenë se është miratuar Marrëveshja e Garancisë me nr. 10959/3 prot., datë 01.08.2025 ndërmjet Ministrisë së Financave dhe 11 Bankave të nivelit të dytë” Për miratimin e skemës së veçantë të garancisë shtetërore të huasë për garantimin e huamarrjes së subjekteve në sektorin e bujqësisë” (GS 5) aktualisht janë hapur dosjet dhe po vijohet me plotësimin e saj për cdo aplikim të raportuar nga bankat.

I gjithë dokumentacioni dalës i institucionit raportohet në server sipas sektorëve përkatës për të mundësuar gjurmimin e dokumentacionit.

Email datë 18.12.2024, drejtuar sektorëve mbi kalimin në server të çdo informacioni shtesë.

Qëndrimi i grupit të auditimit: Grupi i auditimit, pasi shqyrtoi dokumentat që ju vendosën në dispozicion nga institucioni, e konsideron rekomandimin të *pranuar* dhe *të zbatuar*.

9.1. Rekomandimi: Drejtoria e Menaxhimit të Garancive Shtetërore, huave dhe nënhuave dhe trajtimit të kredive të marrë masa për përditësimin e të dhënave mbi SHPK që rezultojnë debitore, për personat që kanë ndërruar jetë dhe vlerësimin rast pas rasti mbi mundësitë e arkëtimit nga shpallja e falimentit dhe çelja e trashëgimisë.

Pretendimi i subjektit:

Agjencia ka marrë masa për analizimin e të gjitha shpk-ve ka vijuar me ndjekjen e të gjitha hapave ligjorë sipas rasteve, në përputhje me parashikimet ligjore.

Konkretisht:

Urdhër i Brendshëm nr. 357 Prot., datë 31.01.2025 referuar Gjetjes nr. 9 të raportit të Auditimit të KLSH-së mbi analizën e SHPK-ve

1. Informacion Nr. 662 Prot., datë 21.02.2025, mbi dosjen "E" shpk
2. Informacion Nr. 559 Prot., datë 11.02.2025, mbi dosjen shoqëria "K"(2 dosje)
3. Informacion Nr. 588 Prot., datë 14.02.2025, mbi dosjen "P" shpk
4. Informacion Nr. 1392 Prot., datë 18.04.2025, mbi dosjen "S" shpk(2 dosje)
5. Informacion Nr. 231 Prot., datë 24.01.2025, mbi dosjen "S" shpk
6. Informacion Nr. 2179 Prot., datë 17.07.2025, mbi dosjen "T" Shpk
7. Informacion Nr. 558 Prot., datë 11.02.2025, mbi dosjen "G" shpk
8. Informacion Nr. 591 Prot., datë 14.02.2025, mbi dosjen "E" shpk V.P.N.
9. Informacion Nr. 728 Prot., datë 25.02.2025, mbi dosjen "D" shpk L.H.D.(2 dosje).
10. Informacion Nr. 581 prot., datë 13.02.2025, mbi dosjen "T" shpk.
11. Informacion Nr. 650 Prot., datë 19.02.2025, mbi dosjen "B" shpk.(2 doje)
12. Informacion Nr. 2187 Prot., datë 18.07.2025, mbi dosjen "A" shpk
13. Informacion Nr. 2221 Prot., datë.22.07.2025, mbi dosjen "A" shpk
14. Informacion Nr. 2238 Prot., datë 24.07.2025, mbi dosjen "E" shpk
15. Informacion Nr. 2241 Prot., datë.25.07.2025, mbi dosjen "B" shpk.
16. Informacion Nr .2246 Prot., datë.25.07.2025, mbi dosjen "A" shpk
17. Informacion Nr. 2256 Prot., datë.28.07.2025, mbi dosjen "D" shpk (2 dosje)
18. Informacion Nr. 2267 Prot., datë 29.07.2025, mbi dosjen "E" shpk
19. Informacion Nr. 2285 Prot., datë 01.08.2025, mbi dosjen "M" shpk
20. Informacion Nr. 2333 Prot., datë.06.08.2025, mbi dosjen "K" shpk
21. Informacion Nr. 2336 Prot., datë.07.08.2025, mbi dosjen "Sh" shpk
22. Informacion Nr. 2410 Prot., datë.18.08.2025, mbi dosjen "U" shpk

23. Informacion Nr. 2416 Prot., datë.22.08.2025, mbi dosjen "K" shpk
24. Informacion Nr. 2435 Prot., datë 26.08.2025, mbi dosjen "B" shpk
25. Informacion Nr. 2434 Prot., datë 26.08.2025, mbi dosjen "T" shpk
26. Informacion Nr. 2451 Prot., datë 28.08.2025, mbi dosjen "E" shpk.
27. Informacion Nr. 2452 Prot., datë 28.08.2025, mbi dosjen "A" shpk
28. Informacion Nr. 2467 Prot., datë 01.09.2025, mbi dosjen "R" shpk
29. Informacion Nr. 2466 Prot., datë 01.09.2025, mbi dosjen "E" shpk
30. Informacion Nr. 2465 Prot., datë 01.09.2025, mbi dosjen "D" shpk
31. Informacion Nr. 2473 Prot., datë 02.09.2025, mbi dosjen "H" shpk
32. Informacion Nr. 2474 Prot., datë 02.09.2025, mbi dosjen "M" shpk
33. Informacion Nr. 2468 Prot., datë 02.09.2025, mbi dosjen "K" shpk
34. Informacion Nr. 2469 Prot., datë 02.09.2025, mbi dosjen "N" shpk
35. Informacion Nr. 2484 Prot., datë 03.09.2025, mbi dosjen "P" shpk
36. Informacion Nr. 2483 Prot., datë 03.09.2025, mbi dosjen "K" shpk
37. Informacion Nr. 2482 Prot., datë 03.09.2025, mbi dosjen "V" shpk
38. Informacion Nr. 2479 Prot., datë 03.09.2025, mbi dosjen "P" shpk
39. Informacion Nr. 2475 Prot., datë 03.09.2025, mbi dosjen "K" shpk
40. Informacion Nr. 2476 Prot., datë 03.09.2025, mbi dosjen "K" shpk
41. Informacion Nr. 2477 Prot., datë 03.09.2025, mbi dosjen "S" shpk
42. Informacion Nr. 2490 Prot., datë 08.09.2025, mbi dosjen "E" shpk
43. Informacion Nr. 2491 Prot., datë 08.09.2025, mbi dosjen "E" shpk
44. Informacion Nr. 2492 Prot., datë 08.09.2025, mbi dosjen "A" shpk
45. Informacion Nr. 2493 Prot., datë 08.09.2025, mbi dosjen "A" shpk
46. Informacion Nr. 2499 Prot., datë 08.09.2025, mbi dosjen "I" shpk. (2 dosje)Informacion Nr. 2494 Prot., datë 08.09.2025, mbi dosjen "G" shpk
47. Informacion Nr. 2495 Prot., datë 08.09.2025, mbi dosjen "I" shpk
48. Informacion Nr. 2503 Prot., datë 09.09.2025, mbi dosjen "I" shpk
49. Informacion Nr. 2505 Prot., datë 09.09.2025, mbi dosjen "P" shpk
50. Informacion Nr. 2513 Prot., datë 10.09.2025, mbi dosjen "B" shpk
51. Informacion Nr. 2509 Prot., datë 10.09.2025, mbi dosjen "A" shpk
52. Informacion Nr. 2512 Prot., datë 10.09.2025, mbi dosjen "L" shpk
53. Informacion Nr. 2541 Prot., datë 11.09.2025, mbi dosjen "L" shpk
54. Informacion Nr. 2542 Prot., datë 11.09.2025, mbi dosjen "T" shpk
55. Informacion Nr. 2544 Prot., datë 11.09.2025, mbi dosjen "S" shpk
56. Informacion Nr. 2545 Prot., datë 11.09.2025, mbi dosjen "G" shpk
57. Informacion Nr. 2554 Prot., datë 11.09.2025, mbi dosjen "E" shpk
58. Informacion Nr. 2555 Prot., datë 11.09.2025, mbi dosjen "M" shpk

Informacion Nr. 357/1 Prot, datë 03.02.2025 me objekt “Kërkesë për shtyerje afati të Urdhërit të Brendshëm Nr. 357 Prot, datë 31.01.2025 për Analizën e SHPK-ve”.

Nga ana e specialistëve të sektorit të Ndjekjes së Procedurave Juridike dhe Operacionale është përgatitur exceli ku janë hedhur të dhënat kryesore të dosjeve i cili do jetë në përditësim pas cdo kërkesë apo cdo kthim-përgjigje si dhe do të dërgohen shkresat për të gjitha rastet (Gjendje Civile, ZP, QKB).

Qëndrimi i grupit të auditimit: Grupi i auditimit, pasi shqyrtoi dokumentat që ju vendosën në dispozicion nga institucioni, e konsideron rekomandimin të *pranuar* dhe *në proces zbatimi*.

10.1. Rekomandimi: Drejtori i Përgjithshëm i Agjencisë së Menaxhimit të Garancive dhe Kredive të Pakthyerë të marr masa për rishikimin dhe nënshkrimin e marrëveshjeve ekzistuese si dhe me të gjitha institucionet e tjera që lehtësojnë marrjen e informacionit, me qëllim rritjen e bashkëpunimit në menaxhimin e garancive dhe rritjen e arkëtimit nga kreditë e pakthyerë.

Pretendimi i subjektit:

Rekomandimi ka filluar të zbatohet dhe nga ana e Drejtorisë së AMGKP-së ka nisur procesi i nënshkrimit të marrëveshjes së bashkëpunimit me DPSHTRR. Në vijim i është dërguar shkresë për marrëveshje Drejtorisë së Tatimeve, ASHK-së, Drejtorisë së Aksioneve, Fondi Besa, NOA, Agrokredit etj,

1. Shkresë Nr. 2582 prot., datë 25.06.2024 "Kërkesë për bashkëpunim" drejtuar Agjencisë Shtetërore të Kadastrës,

2. Shkresë Nr.107 prot., datë 16.01.2025 " Kërkesë për Bashkëpunim" drejtuar Gjendjes Civile. 3. Korespondencë me sektorin juridik të DPSHTRR": email-i datë 16.06.2024 dërguar në AMGKP në lidhje me draft-marrëveshjen.

- Shkresë Nr. 2358/1 prot., datë 13.08.2025 " Kërkesë e përsëritur për Bashkëpunim" drejtuar Gjendjes Civile

- Email datë 03.09.2025, Takim me përfaqësues të Gjendjes Civile pranë Ministrisë së Brendshme.

Qëndrimi i grupit të auditimit: Grupi i auditimit, pasi shqyrtoi dokumentat që ju vendosën në dispozicion nga institucioni, e konsideron rekomandimin të *pranuar* dhe *në proces zbatimi*.

11.1. Rekomandimi: Nga ana e Sektorit të Financës, të merren masa për evidentimin dhe pasqyrimin e plotë dhe regjistrimin kontabël të të gjithë debitorëve mbi të cilët ka lindur detyrimi ndaj AMGKP-së, ku të përshkruhen në mënyrë të detajuar, principali i detyrimit, interesat e akumuluar përgjatë viteve si edhe çdo shpenzim tjetër, në mënyrë të tillë që të plotësohen parimet e saktësisë, plotësisë, klasifikimit dhe identifikimit.

Pretendimi i subjektit:

Lista e debitorëve është çelur në sistemin e kreditit në datën 01.01.2004 sipas proces-verbaleve të transferimit nga ish bankat shtetërore BTA, BK, BKT dhe Insig me detyrimin gjendje në momentin e çeljes duke zbritur nga principali, interesi ose shpenzimet e pafalshme, pra detyrimin në total, arkëtimet dhe duke shtuar shpenzime të pafalshme dhe interesat e përlllogaritura.

Sistemi i kreditit nuk ofron një pasqyrim të saktë të kredive të trajtuara për shkak të trajtimeve të ndryshme ligjore ndër vite. Ku deri në daljen e vkm nr. 450 datë 16.06.2010 arkëtimet fillimisht zbriteshin nga interesat dhe pasi shlyheshin interesat, zbriteshin për principal. Pas datës 01.01.2004 arkëtimet janë pasqyruar në kartelën e debitorëve, pavarësisht se ku janë kontabilizuar ato për principal, shpenzime të pafalshme apo interesa.

Si një institucion i ri me ndryshimet ligjore ku pritet dalja e VKM-ve për të parë trajtimin e debitorëve dhe në vazhdim do të shikohen masat që mund të merren për sistemin e kreditit, i cili do të mbikqyret nga AKSHI. Ndërkohë në sistem në vijimësi çdo veprim i kryer është regjistruar në mënyrë analitike, në lidhje me shpenzimet që i ngarkohen debitorëve. Pas auditimit të KLSH-së, për cdo praktikë mbyllje është bashkëlidhur statement bankare ose mandatë arkëtimi për cdo arkëtim të kryer nga debitori. Sektori i Financës dhe Buxhetit nuk ka akses të ndërhyjë në periudha të kaluara.

Qëndrimi i grupit të auditimit: Grupi i auditimit, pasi shqyrtoi dokumentat që ju vendosën në dispozicion nga institucioni, e konsideron rekomandimin të *pranuar* dhe *në proces zbatimi*.

12.1. Rekomandimi: Nga ana e Sektorit të Financës në AMGKP, të merren masa për

riklasifikimin e detyrimit që ka Agjencia ndaj KFË si detyrim afatgjatë në Pasqyrat Financiare si dhe të merren masa që shuma e plotë e detyrimit ndaj KFË të regjistrohet në Klasën e Pasiveve Afatgjata llogaria “*Huatë Afatgjata*”.

-Nga ana e Sektorit të Financës dhe Strukturave Drejtuese në AMGKP, të merren masat e nevojshme për shlyerjen e detyrimit ndaj MFE-së sipas kushteve dhe afateve të marrëveshjeve me KFË-në, duke paguar principalin dhe interesat në kohën e maturimit të tyre me qëllim shmangien e fenomenit të pagesave pjesore të detyrimit.

Pretendimi i subjektit:

Në zbatim të ligjit nr. 55/2023, si një institucion buxhetor në varësi të Ministrisë të Financave, Kreut II, Neni 3 të gjitha të ardhurat e përfituara do të derdhen në buxhetin e shtetit duke shlyer detyrimin ndaj MFE-së për KFË-në. Në fund të çdo muaji Sektori i Financës dhe Buxhetit, të gjitha arkëtimet e debitorëve i derdh në Depozitën e Qeverisë për detyrimin ndaj KFË-së. Në llogari lihen shuma vetëm për komisionet e mirëmbajtjes të llogarive bankare.

Kontretisht për zbatim:

Urdhër i brendshëm nr. 4715 prot., datë 18.11.2024 “Për zbatimin e rekomandimeve të projekt raportit të auditimit të Kontrollit të Lartë të Shtetit mbi Autoritetit Kontraktor”

Pika 1, në zbatim të ligjit nr.55/2023, si një institucion buxhetor në varësi të Ministrisë të Financave, Kreut II, Neni 3 të gjitha të ardhurat e përfituara do të derdhen në buxhetin e shtetit duke shlyer detyrimin ndaj Ministrisë të Financave për KFË-në.

Qëndrimi i grupit të auditimit: Grupi i auditimit, pasi shqyrtoi dokumentat që ju vendosën në dispozicion nga institucioni, e konsideron rekomandimin të ***pranuar*** dhe ***zbatuar***.

13.1. Rekomandimi: Nga ana e Sektorit të Financës në AMGKP, të merren masat për të kryer sistemimet e nevojshme dhe regjistrimet në kontabilitet në bazë të klasifikimit ekonomik kontabël, për një pasqyrim më të drejtë dhe të saktë të Kapitalit, me qëllim që të parandalohen gabimet apo parregullsitë e mundshme në interpretimin e llogarive të pasqyrave financiare.

Pretendimi i subjektit:

Deri në vitin 2022 Agjencia nuk ka patur të pasqyruar lëvizjen e kapitalit.

Referuar ligjit nr.25/2018 “Për kontabilitetin dhe Pasqyrat Financiare” si dhe “Udhëzimin e Ministrisë të Financave nr. 8 datë 09.03.2018, “Për procedurat e Përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes të përgjithshme”, është paraqitur Pasqyra e ndryshimeve në Aktivet Neto/Fondet Neto për vitin 2024 në mënyrë analitike.

Në zbatim të Urdhërit të Brendshëm nr. 4715 prot., datë 18.11.2024 “Për zbatimin e rekomandimeve të projekt raportit të auditimit të Kontrollit të Lartë të Shtetit mbi Autoritetit Kontraktor”, pika 3, në vazhdim pasqyra e kapitalit të paraqitet në mënyrë analitike, sipas ligjit në fuqi.

Sipas rekomandimit të lënë për vitin 2024 është paraqitur analitikisht pasqyra e kapitalit në pasqyrat financiare të vitit 2024.

Qëndrimi i grupit të auditimit: Grupi i auditimit, pasi shqyrtoi dokumentat që ju vendosën në dispozicion nga institucioni, e konsideron rekomandimin të ***pranuar*** dhe ***të zbatuar***.

14.1. Rekomandimi: Agjencia e Menaxhimit të Garancive dhe Kredive të Pakthyera në bashkëpunim me Ministrinë e Financave dhe nëpërmjet saj t’i kërkojnë Këshillit të Ministrave miratimin e një sistemi për bazat e të dhënave shtetërore dhe të procedurave të detajuara për kthimin e garancive, huave, nënhuave dhe procedurat e marrjes në pronësi të pasurive të lëna si garanci ose jo nga huamarrësit e shitjes së këtyre pasurive, me qëllim përmirësimin e efektivitetit

të veprimtarisë së saj në mbledhjen e huave të pakthyera.

Pretendimi i subjektit:

Për zbatimin e Vendimit Nr. 662 datë 23.10.2024 "Për krijimin e regjistrit për kthimin e garancive shtetërore", nga ana e Drejtorisë së AMGKP-së janë bërë përpjekje maksimale, duke zhvilluar takime me MF dhe AKSHI-n si dhe ka patur një komunikim mes institucioneve në mënyrë elektronike dhe shkresoresi më poshtë vijon:

E-mail datë 21.01.2025 drejtuar MF,

E-mail nga përfaqësues të AKSH-it datë 22.01.2025,

Shkresa nr. 230 prot., datë 23.01.2025 " Kërkesë për bashkëpunim për zbatimin e Vendimit Nr. 662 datë 23.10.2024"

E-mail datë 09.05.2025 drejtuar AKSH-it,

E-mail datë 13.05.2025 drejtuar AKSH-it,

Shkresa nr. 230/1 prot., datë 17.03.2025.

Shkresa nr. 230/3 prot., datë 13.08.2025 "Kërkesë e përseritur për të disatën herë për bashkëpunim për zbatimin e Vendimit nr. 662 datë 23.10.2024" drejtuar AKSHIT.

Qëndrimi i grupit të auditimit: Grupi i auditimit, pasi shqyrtoi dokumentat që ju vendosën në dispozicion nga institucioni, e konsideron rekomandimin të *pranuar* dhe *në proces zbatimi*

15.1. Rekomandim: Ministria e Financave, të marrë masa për vlerësimin e problematikave të konstatuara në lidhje me VKM nr. 349, datë 26.05.2022 dhe kalimin e kompetencave Agjencisë, me qëllim shmangien e riskut për detyrime të mundshme në të ardhmen.

-Agjencia e Menaxhimit të Garancive dhe Kredive të Pakthyera në bashkëpunim me Ministrinë e Financave, të marrin masa për ngritjen e një grupi pune me qëllim identifikimin dhe raportimin e përfituesve të garancisë që rezultojnë jo të rregullt në likuidimin e detyrimeve.

Pretendimi i subjektit:

Agjencia e Menaxhimit të Garancive dhe Kredive të Pakthyera është person juridik publik, buxhetor, në varësi të Ministrit përgjegjës për financat, i krijuar sipas Ligjit nr. 55/2023, "Për Agjencinë e Menaxhimit të Garancive dhe Kredive të Pakthyera", e cila ka objekt trajtimin, ndjekjen dhe kthimin e garancive, huave, nën-huave dhe huave buxhetore. Me hyrjen në fuqi të këtij ligji agjencia ka ndryshuar funksionin, strukturën dhe qëllimin e saj. Bazuar në vendimin Nr. 723, datë 13.12.2023 për " Organizimin dhe funksionimin e Agjencisë së Menaxhimit të Garancive dhe Kredive të Pakthyera" si dhe Urdhërin e Kryeministrit nr. 17 datë 25.01.2024 "Për Miratimin e Strukturës dhe të Organikës të Agjencisë të Garancisë dhe Kredive të Pakthyera" në strukturën e AMGKP janë krijuar 2 sektorë që merren specifikisht me garancitë, kontrollin dhe verifikimin e tyre, konkretisht:

Spektori i Monitorimit dhe Mbikëqyrjes së Skemave të Veçanta të Garancisë

Spektori i Verifikimit të Kërkesave të Garancisë dhe Konfirmimit të Kontratave

Ligji nr. 8894 datë 14.05. 2002, "Për Agjencinë e Trajtimit të Kredive" i cili ishte në fuqi për periudhën objektit auditimi, në strukturë nuk kishte sektorë që verifikonin kushtet dhe vijueshmërinë e garancive sovrane. Për këtë arsye nuk është parë e arsyeshme ngritja e një grupi pune nga MF dhe Agjenci, pasi me strukturën e re, ky grup pune nuk është me i nevojshëm të ngrihet pasi ka 2 sektorë që verifikojnë garancitë.

Konkretisht:

BKT, 2 subjekte total të cilët kanë përfituar kredinë për GS3. Një subjekt e ka mbyllur kredinë me parapagim në 15.03.2023, ndërsa subjekti tjetër ka 3 linja kredie të cilat i ka paguar rregullisht edhe i maturohen në dhjetor 2025.

OTP, ka 1 subjekt i cili ka përfituar kredinë në GS3 të cilën e ka ndarë në 2 linja OD. Maturohet në dhjetor 2025.

RZB, ka 4 subjekte në total nga të cilët 3 e kanë mbyllur kredinë dhe 1 subjekt ka ngelur vetëm për 7.48 ALL.

Qëndrimi i grupit të auditimit: Grupi i auditimit, pasi shqyrtoi dokumentat që ju vendosën në dispozicion nga institucioni, e konsideron rekomandimin të *pranuar* dhe të *zbatuar*.

16.1. Rekomandimi: Nga Sektori i Arkivës të merren masa, për të reflektuar në fletën shoqëruese të dosjeve të gjitha dokumentacionet, pjesë e saj dhe çdo shkresë hyrëse dhe dalëse në lidhje me një dosje t'i bashkëngjitet dosjes, për të mundësuar një historik të plotë të saj.

Nga personat e autorizuar me akses në përdorimin e sistemit të kreditit, të merren masa, për saktësimin e të dhënave në të gjitha rekordet që lidhen me të dhënat e kredisë, si valuta, data e plotësimit/bllokimit të interesave, kolateralet etj.

Pretendimi i subjektit:

Agjencia pas daljes së akteve nënligjore do të hartojë Rregulloren e Brendshme si dhe procedurat e Sektorit të Arkivës ku do të merren masa për reflektimin e rekomandimit Nr.16, bazuar në kuadrin ligjor në fuqi me qëllim përmirësimin e performancës së Agjencisë. Në vijim strukturat e ngarkuara do të bashkëpunojnë sipas fushës së përgjegjësisë për të ndërmarrë veprimet të cilat mundësojnë historikun e cdo dosje nga personat e autorizuar me akses në përdorimin e sistemit të kreditit.

Nga ana e Sektorit të Ndjekjes së Procedurave të Ekzekutimit nga krijimi i tij në Vitin 2024 azhurnohet cdo shkresë hyrëse për debitorët nga zyrat përbarimore private dhe shtetërore si dhe cdo e dhënë e gjetur në dosjet fizike, hidhet në sistemin kredit sipas urdhërit nr.4111 prot datë 09.10.2024. Nga sektori i Arkivës dosjet po plotësohen sipas këtij urdhëri me fletën shoqëruese sipas normave tekniko-ligjore të miratuara nga Arkiva.

Qëndrimi i grupit të auditimit: Grupi i auditimit, pasi shqyrtoi dokumentat që ju vendosën në dispozicion nga institucioni, e konsideron rekomandimin të *pranuar* dhe të *zbatuar*.

17.1. Rekomandimi: Nga Agjencia e Menaxhimit të Garancive dhe Kredive të Pakthyerat të analizohen dhe të nxirren përgjegjësitë për mos realizimin e të ardhurave përgjatë tre viteve si dhe mos derdhjen e tyre në Buxhetin e Shtetit në masën e përcaktuar në ligj.

Pretendimi i subjektit:

Plani nuk është realizuar 100% por është realizuar në përputhje me objektivat e Agjencisë. Realizimi i të ardhurave gjatë vitit 2021 ka qenë 86.3% , viti 2022 ka qenë 69%, viti 2023 ka qenë 90%. Shkaqet e mosrealizimit e të ardhurave gjatë viteve të fundit përfshijnë : 1) mungesa e të dhënave për adresat e debitorëve, 2) mungesë të dhënash në dokumentacionin e kredisë, 3) mosha e debitorëve, një pjesë e madhe janë në pension ose kanë vdekur, 4) dosje të djegur nga ngjarjet e vitit '97 ku mungojnë aktmarrëveshja. 5) Pezullimi i veprimeve përbarimore pasi ka debitorë të larguar jashtë vendit, 6) vlera e kolateralit të lënë si garaci është më e ulët se shpenzimet e ankandit ose shpenzimet përbarimore, 7) kredi mbi 30 vjet.

Qëndrimi i grupit të auditimit: Grupi i auditimit, pasi shqyrtoi dokumentat që ju vendosën në dispozicion nga institucioni, e konsideron rekomandimin të *pranuar* dhe të *zbatuar*.

18.1. Rekomandimi: Drejtori i Përgjithshëm i Agjencisë së Menaxhimit të Garancive dhe Kredive

të Pakthyesa, në kuadër të mospërputhjes së përcaktimeve të Rregullores së funksionimit të brendshëm, ndryshimeve ligjore dhe ristrukturimit, të marrë masa për hartimin dhe miratimin e rregullores së brendshme të harmonizuar me kuadrin ligjor në fuqi dhe strukturën aktuale të Agjencisë, me qëllim përmirësimin e performancës së veprimtarisë së kësaj Agjencie.

Pretendimi i subjektit:

Agjencia pas daljes së akteve nënligjore do të hartojë Rregulloren e Brendshme, bazuar në kuadrin ligjor në fuqi me qëllim përmirësimin e performancës së Agjencisë. Agjencia ka vijuar me zhvillimin e takimeve me Ministrinë e Financave dhe me Ministrinë e Drejtësisë për diskutimin e relacionit të projektvendimit të akteve nënligjore. Aktualisht ky relacion pasi u rivlerësua nga Ministria e Drejtësisë na është rikthyer për rishikim dhe jemi në proces të zhvillimit të një takimi ndërmjet MF, MD dhe AMGKP.

Ndërkohë një draft-rregullore është hartuar bazuar në ligjin 55/2023 "Për Menaxhimin e Garancive dhe Kredive të Pakthyesa", Vendimin Nr. 723, datë 13.12.2023 për " Organizimin dhe funksionimin e Agjencisë së Menaxhimit të Garancive dhe Kredive të Pakthyesa", Urdhërin e Kryeministrit nr. 17 datë 25.01.2024 "Për Miratimin e Strukturës dhe të Organikës të Agjencisë të Garancisë dhe Kredive të Pakthyesa".

- Shkresa nr. 236 prot., datë 05.02.2024 "Mbi propozimin e Rregullores së funksionimit të brendshëm të AMGKP-së" drejtuar Ministrit të Financave.

Qëndrimi i grupit të auditimit: Grupi i auditimit, pasi shqyrtoi dokumentat që ju vendosën në dispozicion nga institucioni, e konsideron rekomandimin të *pranuar* dhe *në proces zbatimi*.

19.1. Rekomandimi: Drejtori i Përgjithshëm i Agjencisë së Menaxhimit të Garancive dhe Kredive të Pakthyesa në bashkëpunim me strukturat e veta përkatëse, të marrin masa për analizimin e problematikave të konstatuara me qëllim uljen e nivelit të ekspozimit ndaj rrisqeve potenciale, duke konkluduar rast pas rasti për masat që duhen marrë në vijim me qëllim arkëtimin e detyrimeve, duke ezauruar plotësisht procedurat ligjore për secilin prej kredi marrësve që nuk kanë shlyer detyrimet e huasë së marrë.

Pretendimi i subjektit:

Drejtorja ka monitoruar dhe mbikëqyrur zbatimin e veprimtarisë së agjencisë nëpërmjet kontrollit të punëve dhe raportimeve periodike vjetore të sektorëve të agjencisë për realizimin e objektivave të përcaktuara nga ligji, duke ngritur urdhrat si më poshtë vijon:

1. Urdhër i Brendshëm nr.4333 prot., datë 29.10.2024 " Ngritje e grupit të punës për inventarizimin dhe gjendjen fizike të pronave të paluajtshme në pronësi të AMGKP-së,
2. Urdhër i Brendshëm nr. 4715 prot., datë 18.11.2024 " Për zbatimin e rekomandimeve të projekt raportit të auditimit të Kontrollit të Lartë të Shtetit mbi Autoritetit Kontraktor ”,
3. Urdhëri i Brendshëm Nr. 4111 prot., datë 09.10.2024 "Për zbatimin e planit të masave, mbi planin e masave për rekomandimin nr. 3 të lëna nga KLSH,
4. Urdhër i Brendshëm nr. 141 prot., 20.01.2025 " Për kalimin e Sistemit të Kreditit pranë AKSH-it"
5. Urdhër i brendshëm nr. 358 Prot., datë 31.01.2025 "Për analizën e dosjeve në ekzekutim pranë zyrave përmbare private dhe shtetërore për vitin 2024".
6. Urdhër i Brendshëm nr. 357 Prot., datë 31.01.2025 për "Analizën e SHPK-ve" etj
7. Përgatitja e kërkesave buxhetore të PBA 2026-2028, nr. 2266/1 prot., 05.08.2025.
8. Raportim monitorimi 4 mujor, nr. 1694 prot., datë 21.05.2025.
9. Raportim monitorimi 8 mujor, nr. 2496/1 prot., datë 10.09.2025.

10. Raportim 3 mujor për GS1,GS2, GS3 dhe GS4 nr. 1435 prot., 22.04.2025.

Gjithashtu në mënyrë periodike në varësi të funksionit që ka secili nga sektorët raporton pranë strukturave drejtuese, konkretisht:

Sektori i Monitorimit dhe Mbikëqyrjes së Skemave të Veçanta të Garancisë, kryen raportime mujore për Ministrinë e Financave sa i përket garancive

Sektori i Ndjekjes së Procedurave të Ekzekutimit Përmbartimor, kryen raporte mujore mbi ecurinë dhe zbatimin e fazave përmbartimore

Sektori i Ndjekjes së Procedurave Juridike dhe Operacionale, kryen raportime javore mbi ecurinë e punës, si dhe mujore mbi ecurinë dhe mbi planifikimin e punëve në vijim

Sektori i Verifikimit të Kërkesave të Garancisë dhe Konfirmimit të Kontratave, raporton në MF mbi gjendjen e detyrimeve të pashlyera çdo muaj për garancitë e huaja, huatë dhe nënhuatë.

Sektori i Informacionit dhe Administrimit të Dokumentacionit, brenda datës 10 të çdo muaji, pas dërgimit nga sektori i Financës dhe Buxhetit për debitorët e mbyllur, raporton në Bankën e Shqipërisë debitorët e mbyllur.

Sektori i Financës dhe Buxhetit, kryen raporte javore, mujore mbi Evidencën e Arkëttimeve.

Qëndrimi i grupit të auditimit: Grupi i auditimit, pasi shqyrtoi dokumentat që ju vendosën në dispozicion nga institucioni, e konsideron rekomandimin të *pranuar* dhe *të zbatuar*.

20.1. Rekomandimi: Titullari i Autoritetit Kontraktor së bashku me strukturat përgjegjëse të prokurimit publik të marrin masa për përcaktimin e fondit limit, hartimin e specifikimeve teknike, përcaktimin e kapacitetit financiar dhe teknik në përputhje me kuadrin ligjor dhe objektin e madhësinë e prokurimit për të siguruar përdorimin me efektivitet të fondeve publike.

Gjithashtu, të merren masa për inventarizimin e dosjeve në përputhje me normat tekniko-profesionale dhe metodologjike të shërbimit arkivor .

Pretendimi i subjektit:

Titullari i Autoritetit Kontraktor së bashku me strukturën përgjegjëse të Prokurimit Publik ka marrë masat e nevojshme duke marrë pjesë në trajnime të ndryshme, për të njohur sa më mirë legjislacionin e prokurimeve si dhe për ta vënë në zbatim atë duke siguruar kështu përdorimin me efektivitet të fondeve publike duke marrë pjesë në trajnim në ASPA dhe çertifikuar me anë të çertifikimit me nr.215/11/2025/5, datë 28.07.2025.

Për sa i përket inventarizimit të dosjeve në përputhje me normat tekniko profesionale është nxjerrë urdhëri me nr.593 prot., datë 14.02.2025.

Qëndrimi i grupit të auditimit: Grupi i auditimit, pasi shqyrtoi dokumentet që ju vendosën në dispozicion nga institucioni, e konsideron rekomandimin të *pranuar* dhe *të zbatuar*.

2. Mbi zbatimin e rekomandimeve për masat disiplinore. Fillimi i procedurave për dhënien e masave disiplinore dhe administrative. Sa rekomandime janë pranuar dhe ecuria e tyre për masat e dhëna.

Në auditimin e mëparshëm KLSH, ka rekomanduar 1 masë disiplinore, në kompetencë të titullarit të Agjencisë së Menaxhimit të Garancive dhe Kredive të Pakthyera, realizimi i së cilës paraqitet si më poshtë.

Në fazë Projekt –Raport, Raporteri nga subjekti nuk janë paraqitur nuk janë observacione.

MASA DISIPLINORE

Mbështetur në nenin 3, të ligjit nr. 55/2023 “Për Menaxhimin e Garancive dhe Kredive Shtetërore të Pakthyera”, pika 1, i rekomandojmë Ministrin të Financave analizimin në mënyrë të thelluar të problematikave të evidentuara në këtë Raport Përfundimtar Auditimi, nxjerrjen e përgjegjëse dhe marrjen e masave të nevojshme me qëllim mbarëvajtjen dhe mirëfunksionimin e Agjencisë së Menaxhimit të Garancive dhe Kredive të Pakthyera.

C.2 Mbështetur në nenin 5, të ligjit nr. 55/2023 “Për Menaxhimin e Garancive dhe Kredive Shtetërore të Pakthyera”, si dhe VKM nr. 723, datë 13.12.2023 “Për organizimin dhe funksionimin e Agjencisë së Menaxhimit të Garancive dhe Kredive të Pakthyera”, pikat 3 dhe 5 të kreut të tretë i rekomandojmë Drejtorit të Përgjithshëm të Agjencisë vlerësimin e shkeljeve dhe gjykimin përfundimtar në lidhje me masat disiplinore sipas problematikave të konstatuara në Raportin Përfundimtar të Auditimit, në referencë të Kodit të Punës, miratuar me ligjin nr. 7961, datë 12.7.1995, i ndryshuar, neni 21, pika 3, germa “h”.

Pretendimi i subjektit: Për shkak të ndryshimeve ligjore të fundit, problematikave të evidentuara dhe origjinës së tyre, përgjegjëse të mbartura ndër vite dhe numrit të lartë të punonjësve që kanë shkëputur marrëdhëniet e punës me këtë institucion, Kontrolli i Lartë i Shtetit e ka të pamundur adresimin institucional të rekomandimeve për masa disiplinore. Konkretisht:

1. Për periudhën objekt auditimi kjo Agjenci ka vepruar si person juridik publik, në varësi të Ministrin të Financave, në zbatim të ligjit nr. 8894, datë 14.05.2002 “Për Agjencinë e Trajtimin të Kredive”, i ndryshuar, periudhë gjatë së cilës organet drejtuese të Agjencisë kanë qenë Këshilli Mbikëqyrjes dhe Drejtoria. Aktualisht Agjencia e Menaxhimit të Garancive dhe Kredive të Pakthyera është person juridik publik, buxhetor, në varësi të Ministrin Përgjegjës për Financat dhe ushtron kompetencat bazuar në ligjin nr. 55/2023, datë 13.07.2023. Këto ndryshime ligjore janë shoqëruar me ndryshime në funksione, kompetenca dhe mënyrën e organizimit të kësaj Agjencie. Përpos ndryshimit të organizimit të Agjencisë, gjatë periudhës objekt auditimi ka patur një numër të konsiderueshëm shkëputje të marrëdhënieve të punës, ku konkretisht për vitin 2021 rezultojnë 15 shkëputje të marrëdhënieve të punës nga 27 punonjës sipas strukturës së miratuar, për vitin 2022 rezultojnë 9 nga 28 punonjës dhe për vitin 2023 rezultojnë 8 nga 30 punonjës.

2. Pavarësisht periudhës objekt auditimi 2021-2023, problematikave dhe shkeljet e konstatuara në të gjitha drejtimet e auditimit kanë rezultuar të shtrira në kohë dhe të trashëguara ndër vite, si rrjedhojë edhe përgjegjësitë për to, trajtuar më hollësisht në këtë Raport Auditimi.

Bazuar në rekomandimet e lëna nga Raporti përfundimtar i auditimit struktura drejtuese bie dakort me to dhe ka marrë të gjitha masat e domosdoshme për ti zbatuar dhe për ti ndjekur në vijim.

Në gjykimin përfundimtar deri më tani nuk janë marrë masa disiplinore për asnjë nga punonjësit e strukturës së AMGKP-së. Gjatë kësaj periudhe nga Drejtoria janë hartuar një sërë urdhrash mbi zbatimin dhe ndjekjen e rekomandimeve.

Nga sa më sipër në rast moszbatimit të tyre deri në përfundim të afateve do të vijohet me marrjen e masave.

Qëndrimi i grupit të auditimit: Grupi i auditimit, pasi shqyrtoi dokumentet që ju vendosën në dispozicion nga institucioni, e konsideron rekomandimin të *pranuar* dhe *të zbatuar*.

KONKLUZIONI I AUDITIMIT:

Sa më sipër, konstatohet se nga ana e Agjencisë së Menaxhimit të Garancive dhe Kredive të

Pakthyerat, janë përcjellë në KLSH dy raportimet, por jashtë afateve të kërkesave të Ligjit nr. 154/2014 “Për organizimin dhe funksionimin e KLSH”, neni 15, 30. Nga 21 rekomandime të lëna për zbatim, janë pranuar 21 ose 100 % e tyre., nga të cilat 20 me krakter “Masa organizativ” 9 masa organizative rezultojnë të zbatuara plotësisht, 1 masë organizative rezultuan e zbatuar pjesërisht dhe 9 masa në proces zbatimi.

Masat me karakter Disiplinor janë zbatuar 100% .

IV. GJETJE DHE REKOMANDIME.

Për sa më sipër ri kërkojmë që, Agjencisë së Menaxhimit të Garancive dhe Kredive të Pakthyerat të marrë të gjitha masat e nevojshme me qëllim zbatimin e të gjitha rekomandimeve që rezultojnë të pazbatuar dhe pjesërisht zbatuar, si dhe përshpejtimin e zbatimit të rekomandimeve, të cilat rezultojnë në proces zbatimi, brenda 6-mujorit të parë të vitit 2026.

MASA ORGANIZATIVE

1. Rekomandimi: Nga Drejtori i Përgjithshëm i Agjencisë, në kuadër të ndryshimeve ligjore që ka pësuar Agjencia, të vlerësohen problematikat e evidentuara dhe të merren masa me qëllim shmangien e këtyre mangësive, në funksion të përmirësimit të punës në vijimësi.

2.1. Rekomandimi: Agjencia e Menaxhimit të Garancive dhe Kredive të Pakthyerat të marrë masa për ngritjen e një grupi pune i cili të analizojë mospërputhjet e evidentuara në Sistemin e Kreditit, si dhe të saktësojë këto të dhëna, duke bashkëpunuar me autoritetet përkatëse si ASHK/Gjendja Civile dhe kryqëzuar me dosjet fizike, me qëllim pasqyrimin e të dhënave të plota dhe të sakta, në funksion të përmirësimit të punës në vjeljen e kredive.

3.1. Rekomandimi: Agjencia e Menaxhimit të Garancive dhe Kredive të Pakthyerat të marrë masa për ngritjen e një grupi pune, i cili të konfirmojë dhe plotësojë të dhënat e munguara në Sistemin e Kreditit, përfshirë dhe ato që mbahen jashtë sistemit, duke bashkëpunuar me autoritetet përkatëse si ASHK/Gjendja Civile/Banka e Shqipërisë etj., me qëllim pasqyrimin e të dhënave të plota dhe të sakta, në funksion të rritjes së efektivitetit të saj në vjeljen e detyrimeve debitore.

5.1. Rekomandimi: Agjencia e Menaxhimit të Garancive dhe Kredive të Pakthyerat të marrë masa për ngritjen e një grupi pune i cili të (i) vlerësojë ekzistencën fizike të pasurive të luajtshme të sekuestruara ndër vite, (ii) të inventarizojë këto pasuri dhe (iii) të përcaktojë vlerën e saktë të tyre, me qëllim pasqyrimin e saktë të këtyre pasurive në llogaritë e pasqyrave financiare dhe më pas mbledhjen e huave të pakthyerat.

7.1. Rekomandimi: Nga ana e Sektorit të Financës në AMGKP në bashkëpunim me strukturat përkatëse, të merren masa për verifikimin e gjendjes reale dhe statusin e pronave dhe asetëve të mbajtura për shitje, të kryejë inventarizimin si edhe regjistrimin e të gjitha pronave në ASHK, duke përgatitur të gjithë dokumentacionin tekniko-ligjor, më pas vlerësimin e tyre, kontabilizimin në vlerë të plotë dhe pasqyrimin në aktivet e pasqyrave financiare

9.1. Rekomandimi: Drejtorja e Menaxhimit të Garancive Shtetërore, huave dhe nën-huave dhe trajtimit të kredive të marrë masa për përditësimin e të dhënave mbi SHPK që rezultojnë debitore, për personat që kanë ndërruar jetë dhe vlerësimin rast pas rasti mbi mundësitë e arkëtimit nga shpallja e falimentit dhe çelja e trashëgimisë.

10.1. Rekomandimi: Drejtori i Përgjithshëm i Agjencisë së Menaxhimit të Garancive dhe Kredive të Pakthyerat të marrë masa për rishikimin dhe nënshkrimin e marrëveshjeve ekzistuese si dhe me

të gjitha institucionet e tjera që lehtësojnë marrjen e informacionit, me qëllim rritjen e bashkëpunimit në menaxhimin e garancive dhe rritjen e arkëtimit nga kreditë e pakthyera.

11.1. Rekomandimi: Nga ana e Sektorit të Financës, të merren masa për evidentimin dhe pasqyrimin e plotë dhe regjistrimin kontabël të të gjithë debitorëve mbi të cilët ka lindur detyrimi ndaj AMGKP-së, ku të përshkruhen në mënyrë të detajuar, principli i detyrimit, interesat e akumuluar përgjatë viteve si edhe çdo shpenzim tjetër, në mënyrë të tillë që të plotësohen parimet e saktësisë, plotësisë, klasifikimit dhe identifikimit.

14.1. Rekomandimi: Agjencia e Menaxhimit të Garancive dhe Kredive të Pakthyera në bashkëpunim me Ministrinë e Financave dhe nëpërmjet saj t'i kërkojnë Këshillit të Ministrave miratimin e një sistemi për bazat e të dhënave shtetërore dhe të procedurave të detajuara për kthimin e garancive, huave, nënhuave dhe procedurat e marrjes në pronësi të pasurive të lëna si garanci ose jo nga huamarrësit e shitjes së këtyre pasurive, me qëllim përmirësimin e efektivitetit të veprimtarisë së saj në mbledhjen e huave të pakthyera.

18.1. Rekomandimi: Drejtori i Përgjithshëm i Agjencisë së Menaxhimit të Garancive dhe Kredive të Pakthyera, në kuadër të mospërputhjes së përcaktimeve të Rregullores së funksionimit të brendshëm, ndryshimeve ligjore dhe ristrukturimit, të marrë masa për hartimin dhe miratimin e rregullores së brendshme të harmonizuar me kuadrin ligjor në fuqi dhe strukturën aktuale të Agjencisë, me qëllim përmirësimin e performancës së veprimtarisë së kësaj Agjencie.

3.2 BANKA E SHQIPËRISË

Kontrolli i Lartë i Shtetit ushtroi auditimin tematik në Bankën e Shqipërisë me objekt “Për zbatimin e rekomandimeve të lëna në auditimet e evaduarra në vitin 2024”, për auditimin e përputhshmërisë, përcjellë me shkresën 655/12, datë 31.12.2024, kushtuar vëmendjen e posaçme çështjeve, që lidhen me:

- Vlerësimin e rekomandimeve të KLSH-së të lëna nga auditimi i kryer në vitin 2024, hartimi i programeve (plan veprimeve) nga subjekti i audituar, duke ngarkuar me detyra personat përgjegjës dhe përcaktuar afatet konkrete për zbatimin e rekomandimeve për çdo njësi vartëse; - Nxjerrjen nga titullari i njësisë publike të akteve administrative të nevojshme, si:

Vendimeve (urdhrave) për zbatimin e masave organizative;

Vendimet ekzekutive për përdorimin me efektivitet, eficiency dhe ekonomicitet të fondeve;

e të tjera masa e rekomandime që i përcillen subjektit të audituar nëpërmjet Vendimit të Kryetarit të Kontrollit të Lartë të Shtetit.

II. HYRJA

Auditimi është kryer në përputhje me ligjin nr. 154, datë 27.11.2014 “Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit”, si dhe manualit “Për ndjekjen e zbatimit të rekomandimeve të Kontrollit të Lartë të Shtetit” dhe Regjistrit elektronik institucional të zbatimit të rekomandimeve.

zbatimit të rekomandimeve.

Auditimi i zbatimit të rekomandimeve të lëna në auditimin e mëparshëm, sipas drejtimeve të Programit të Auditimit nr. 857/6 prot., datë 12.09.2025., të miratuar nga Kryetari i Kontrollit të Lartë të Shtetit, është kryer nga grupi i audituesve i përbërë nga:

-V.B., përgjegjës i grupit të auditimit

- R.G., auditues
- E.H., auditues.

Auditimi ka filluar më datë 15.09.2025 ka përfunduar më datë 14.10.2025

II/1. OBJEKTI I AUDITIMIT

Zbatimi i masave të rekomanduara në auditimin e mëparshëm të dërguara me shkresën nr. 655/12, datë 31.12.2024, mbi veprimtarinë e Banka e Shqipërisë së bashku me Raportin Përfundimtar të Auditimit, nga Grupi i Audituesve Shtetërorë të KLSH-së.

II/2. QËLLIMI I AUDITIMIT

Auditimi i zbatimit të rekomandimeve kryhet në funksion të hartimit të Raportit Vjetor të aktivitetit të Kontrollit të Lartë të Shtetit, që paraqitet në Kuvendin e Shqipërisë brenda tremujorit të parë të vitit pasardhës, bazuar në pikën 3 të nenit 31 të ligjit nr. 154/2014 “Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit”.

II/3. METODOLOGJIA E AUDITIMIT

Auditimi i plotë i të gjithë dokumentacionit të paraqitur nga subjekti dhe që ka lidhje me zbatimin e masave të rekomanduara nga KLSH për përmirësimin e gjendjes së subjekteve në të ardhmen.

III. PËRSHKRIMI I AUDITIMIT

III/1. INFORMACION I PËRGJITHSHËM.

Nga auditimi në terren i dokumentacionit të paraqitur nga subjekti **Banka e Shqipërisë** në lidhje me zbatimin e rekomandimeve të lëna nga KLSH me shkresën nr. 655/12, datë 31.12.2024, rezulton se, niveli i pranimeve dhe zbatimit të rekomandimeve është si më poshtë:

Për përmirësimin e gjendjes janë lënë 6 rekomandime “Masa Organizative” të lëna për zbatim, janë pranuar 2 rekomandime. Nga 6 rekomandime 4 rekomandime të pa pranuar dhe të pa zbatuara, 1 masë rezulton e zbatuar pjesërisht, 1 masë në proces zbatimi.

Opinion i përgjithshëm mbi zbatimin e rekomandimeve

Nga auditimi i zbatimit të rekomandimeve konstatohet se shkalla e pranueshmërisë së rekomandimeve kundrejt atyre të pa pranuar rezulton në nivelin 33%, konkretisht nga 6 rekomandime gjithsej, janë pranuar 2 rekomandime.

Niveli i rekomandimeve të zbatuara plotësisht rezultoi në masën 0%, niveli i zbatimit të rekomandimeve në proces zbatimi rezultoi 0%, niveli i rekomandimeve të zbatuara pjesërisht rezultoi 50%, si dhe niveli i rekomandimeve të pazbatuara rezultoi 50%.

III/2. REZULTATET E AUDITIMIT SIPAS DREJTIMEVE TË AUDITIMIT

Nga auditimi i ushtruar në **Banka e Shqipërisë** për zbatimin e rekomandimeve të KLSH-së, “*Mbi auditimin e përputhshmërisë*” trajtuar në Raportin Përfundimtar të Auditimit me Vendimin e Kryetarit të KLSH-së, përcjellë me shkresën nr. 655/12, datë 31.12.2024, rezultoi si më poshtë vijon:

A. Mbi hartimin e programit (Planit të veprimit) dhe respektimin e afateve ligjore për njoftimin e KLSH për ecurinë e zbatimit të rekomandimeve brenda afateve të përcaktuara në Ligjin nr. 154, datë 27.11.2014 “Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit”.

Nga auditimi ka rezultuar:

Në lidhje me hartimin e “Plan veprimit për zbatimin e rekomandimeve të lëna nga KLSH” dhe dërgimin e tij në KLSH, ka rezultuar se;

-Banka e Shqipërisë me shkresën nr. 2093/55 prot., 20.01.2025 për “Dërgimi i planit të masave mbi auditimin e përputhshmërisë për vitin 2023 Banka e Shqipërisë, ka informuar Kontrollin e Lartë të Shtetit mbi ecurinë e zbatimit të rekomandimeve, **brenda afatit kohor prej 20 ditë.**

-Banka e Shqipërisë nuk ka dërguar informacion mbi nivelin e zbatueshmërisë së rekomandimeve për periudhën 6-mujore, në kundërshtim me pikën 2, neni 30 të ligjit nr. 154/2014, datë 27.11.2014 “Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit”.

B. Zbatimi i rekomandimeve për masat organizative. Ecuria e zbatimit dhe analizimi i rekomandimeve: rekomandime të pranuar dhe nga këto, sa janë zbatuar plotësisht; zbatuar pjesërisht, në proces zbatimi dhe rekomandimet e pa zbatuara.

Në mënyrë më të detajuar, auditimi i verifikimit të zbatimit të rekomandimeve për secilin rekomandim të përcjellë në Bankën e Shqipërisë paraqitet:

1. Rekomandimi: Banka e Shqipërisë në bashkëpunim me Ministrinë e Financave të marrë masa për krijimin e hapësirave me qëllim nxitjen e mundësive mbi investimin e likuiditeteve në monedhë vendase dhe valuta të huaja në vlerë dhe në kohëzgjatje, jo vetëm përmes investimeve në depozitë, por edhe përmes instrumenteve të tjerë për menaxhimin e likuiditetit.

Pretendimi i subjektit: Parimet e ofrimit të instrumenteve të menaxhimit të likuiditetit nga BSh për MF janë:

a. Ruajtja e normave të tregjeve në përputhje me orientimin e politikës monetare të Bankës së Shqipërisë. Shumat dhe afatet që janë përcaktuar në marrëveshje krijojnë kushtet dhe inventivet për një administrim sa më efektiv të zbatimit të politikës monetare dhe asaj fiskale në vend.

Instrumentet e ofruara janë instrumente për menaxhimin afatshkurtër të likuiditetit dhe që të sigurojnë kushtet për një menaxhim aktiv të borxhit të shtetit. Shprehemi së instrumentet e depozitës në lekë dhe valutë, si dhe SĚAP-e valutë/lekë dhe lekë/valutë, i shërbejnë më së miri këtij qëllimi. Në këtë kuadër nuk jemi në dijeni të instrumenteve të tjera potenciale që t’i shërbejnë qëllimit të lartpërmendur. Në qoftë se ka propozime konkrete për instrumente shtesë jemi të hapur t’i diskutojmë.

b. Parimi i pavarësisë së bankës qendrore nga shteti.

Për sa i përket marrëdhënies financiare BSH me MOF duhet të kihet parasysh që çdo shpenzim i rritur i BSH përkehet në ulje të derdhjes së fitimit që banka bën te MF e si rrjedhim në terma të përfitimit neto MOF mbetet në të njëjtin pozicion financiar.

Për sa i përket shfrytëzimit të mundësisë që i ofrohet MF për përdorimin e instrumenteve që BSH vë në dispozicion, mbetemi në qëndrimin e mbajtur në përgjigjen ndaj akt konstatimit nr 2 (nr.4118/1, datë 09.10.24) që mirë-administrimi i likuiditetit të qeverisë është detyrë e Ministrisë së Financave dhe sa më shpejt ky likuiditet të kalojë në ekonomi aq më mirë është për GDP-në e vendit.

Për sa më sipër rekomandimi 1.1 duke marrë në konsideratë setin aktual të instrumenteve të ofruar, e konsiderojmë të plotësuar nga Banka. Në qoftë se ka propozime konkrete për instrument të tjera jemi të hapur t’i diskutojmë. Në të kundërt, këtë rekomandim e konsiderojmë të realizuar.

Qëndrimi i grupit të auditimit: Ky rekomandim konsiderohet i papranuar dhe i pazbatuar.

2.1. Rekomandimi: Banka e Shqipërisë të marrë masa për të bashkëpunuar me Ministrinë e Financave, në drejtim të koordinimit të veprimeve, për emetimin brenda afatit ligjor të përcaktuar, të letrave me vlerë, me qëllim shmangien e riskut për mos mbulimin në kohë të rezervave negative. *Pretendimi i subjektit: Për gjetjen dhe rekomandimin e pikës 2, Banka e Shqipërisë, si në të gjitha përgjigjet e saj ndër vite, vijon të jetë e opinionit që Banka e Shqipërisë i ka përmbushur me*

përpikmëri detyrimet e saj. Në zbatim të nenit 64, pika "b" e ligjit nr. 8269, datë 23.12.1997 "Për Bankën e Shqipërisë", i ndryshuar, si dhe nenit 6, pika 3 e marrëveshjes "Mbi transferimin e fitimit neto të Bankës së Shqipërisë pranë Ministrisë së Financave dhe mbulimin e humbjeve të Bankës së Shqipërisë", në kushtet kur në mbyllje të vitit 2023 dhe auditimit të pasqyrave financiare "Rezerva e rivlerësimit të valutave" rezultoi me gjendje negative në vlerën 56,737,912,520.53 lekë, me anë të shkresës nr. 1679 prot., datë 15.4.2024 dërguar nga Banka e Shqipërisë, Ministria e Financave është njoftuar për tepricën e llogarisë "Rezerva e rivlerësimit të valutave" si dhe i është kërkuar konfirmimi për angazhimin e përbushjes së detyrimeve të mundshme për emetimin e letrave me vlerë nga Ministria e Financave për mbulimin e vlerës negative të llogarisë "Rezerva e Rivlerësimit të Valutave" në vlerën e mësipërme. Me anë të shkresës nr. 5061/1 prot., datë 17.05.2024, Ministria e Financave konfirmoi marrjen e informacionit si dhe përbushjen e detyrimeve sipas përcaktimeve në marrëveshjen e rishikuar midis palëve. Për sa më lart, rekomandimi nuk qëndron për Bankën e Shqipërisë, për rrjedhojë rekomandimi nuk pranohet.

Qëndrimi i grupit të auditimit: Ky rekomandim konsiderohet i papranuar dhe i pazbatuar.

3.1. Rekomandimi: Banka e Shqipërisë të marrë masa për të hartuar një manual/udhëzim të detajuar, ku të përcaktojnë procedurat për menaxhimin dhe përdorimin e rezervës "Rezerva" si rezultat i zbatimit për herë të parë të SNRF-ve, hapat për implementimin e Standardeve Ndërkombëtare të Raportimit Financiar si dhe rregulla për monitorimin dhe raportimin e përdorimit të kësaj rezerve.

Pretendimi i subjektit: Banka e Shqipërisë, duke filluar nga viti financiar 2015, zbaton pa përjashtime Standardet Ndërkombëtare të Raportimit Financiar (SNRF), duke përbushur kërkesat e Ligjit për Bankën e Shqipërisë si dhe ligjit "Për Kontabilitetin dhe Pasqyrat Financiare". Në këtë kuadër, Banka ka miratuar politikën kontabël në përputhje me SNRF (vendim nr. 37, datë 23.03.2016 të Këshillit Mbikëqyrës) si dhe me mbështetjen e FMN, ka përgatitur dhe miratuar më tej, Manualin e Parimeve Kontabël (urdhër nr. 6030, datë 31.12.2020 të Zëvendës Guvernatorit të Parë). Manualin e Parimeve Kontabël përbejnë kuadrin rregullator kontabël, të cilat udhëheqin zbatimin e Standardeve Ndërkombëtare të Raportimit Financiar në Bankën e Shqipërisë. Manualin paraqesin parime procedurale të nevojshme të zbatimit të politikave kontabël të cilat janë në përputhje me SNRF, brenda kontekstit të operacioneve/transaksioneve të Bankës. Referuar gjetjes nga auditimi mbi "Rezerva si rezultat i zbatimit për herë të parë të SNRF-ve", sqarojmë se pjesë e manualeve të Parimeve Kontabël (si më lart), është edhe "Manuali i Parimeve Kontabël: Kapitali dhe Rezervat", i cili më konkretisht, në seksionin 6.2.4 "Rezerva", pika 6.2.4.3 paraqet natyrën e zërit "Rezerva si rezultat i zbatimit për herë të parë të SNRF-ve", krijuar me Vendimin e Këshillit Mbikëqyrës, Nr. 19, datë 15.03.2018 "Për rialokimin dhe alokimin e disa prej rezervave të Bankës së Shqipërisë;". Në këtë seksion përshkruhen rregullat e njohjes fillestare, matjes së tyre në vijim si dhe përdorimin e tyre të mundshëm në të ardhmen bazuar në Vendimin Nr. 19 dhe SNRF. Për sa më lart, rekomandimi nuk pranohet.

Qëndrimi i grupit të auditimit: Ky rekomandim konsiderohet i papranuar dhe i pazbatuar.

4.1. Rekomandimi: Komisionet e ankandeve të marrin masa për mos pranimin nga i njëjti subjekt të më shumë se 5 kërkesave konkurruese për ankandet e bonove të thesarit dhe më shumë se 3 kërkesave konkurruese për ankandet e obligacioneve si dhe të analizojë këto kërkesa dhe të pranojë ato kërkesa të cilat kanë të paktën 0.01% ndryshimin në nivelin e yield-it.

Pretendimi i subjektit: Shprehemi se i përmbahemi shpjegimeve të dhëna në Akt-konstatimin nr. 3, datë 09.10.2024 (nr.prot.4119/1), për kërkesa të mbërritura nga ASD për menaxhimin e dy

fondeve të ndryshme. Nuk ka asnjë kufizim rregullativ që pengon një subjekt të paraqesë shuma të ndryshme me të njëjtin yield. Për analogji, sqarojmë se bankat mund të paraqesin në ankand nëpërmjet llogarisë së individëve, respektivisht sipas llogjit të ankandit më shumë se tre ose pesë shuma të ndryshme me të njëjtin yield, që teorikisht mund të jenë një individ ose shumë individë. Këto konsiderohen shuma të ndryshme jo kërkesa të ndryshme. Kjo paraqitje është më se e pranueshme pasi varet nga llogari me të cilën bëhen shlyerjet e veprimeve dhe nuk përbën asnjë shkelje për barazinë e subjekteve në ankand. Gjithashtu, përsërisim qëndrimin e mbajtur në lidhje me të njëjtin rekomandim në raportin e KLSH për vitin 2020-2021, dhe vitin 2022 ku është sqaruar se përcaktimi në Nenin 8, pika 3 i Udhëzimit të Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë nr. 31, datë 26.12.2013 “Për emetimin nga qeveria e Republikës së Shqipërisë të obligacioneve në formë regjistri”, dhe Nenit 9, pika 3 e Udhëzimit Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë nr. 30, datë 26.12.2013 “Për emetimin nga qeveria e Republikës së Shqipërisë të bonove të thesarit në formë regjistri”, kërkesë konkurruese unike nga një subjekt konsiderohet kërkesa (pavarësisht në sa shuma të ndryshme është ndarë) që ndryshon në yieldin e përcaktuar me 0.01% nga kërkesa tjetër. Qëllimi i përcaktimit të numrit të kërkesave në ankand në raport me përcaktimin e yieldit ka qenë shmangia e vendosjes së kërkesave të pakufizuara të subjekteve me shuma të ulta dhe çmime të ndryshme në eksplorim të përcaktimit të çmimit ekuilibër në ankand (price discover). Për sa më sipër sqaruar, kërkesat e ASD në të dy ankandet e cituara kanë qenë në përputhje me numrin maksimal të lejuar për pjesëmarrjen nga një subjekt. Për sa më sipër rekomandimi 4.1 nuk qëndron.

Qëndrimi i grupit të auditimit: Ky rekomandim konsiderohet i papranuar dhe i pazbatuar.

5.1. Rekomandimi: Banka e Shqipërisë të vlerësojë dhe analizojë kosto/përfitimet e mbajtjes hapur së sporteleve të bonove të thesarit, me qëllim rritjen e eficiencës dhe efektivitetit të përdorimit të fondeve dhe burimeve të Bankës së Shqipërisë.

Pretendimi i subjektit: Ky rekomandim pranohet. Banka e Shqipërisë e pranon këtë rekomandim dhe ka vlerësuar eficiencën e sportelit të Bonove për popullsinë. Ky vlerësim është dërguar për diskutim në nivel teknik të Ministria e Financave.

Qëndrimi i grupit të auditimit: Ky rekomandim konsiderohet i pranuar dhe në proces zbatimi.

6.1. Rekomandimi: Banka e Shqipërisë të marrë masa për zbatimin e të gjitha rekomandimeve që kanë rezultuar të zbatuara pjesërisht, si dhe të përshpejtojë realizimin e rekomandimit në proces.

Pretendimi i subjektit: Ky rekomandim pranohet. Banka e Shqipërisë duke vlerësuar zbatueshmërinë e rekomandimeve të adresuara nga Kontrolli i Lartë i Shtetit ka përgatitur gjithmonë planin e masave për rekomandimet e pranuar dhe arsyetimet mbështetëse për rekomandimet e papranuara apo të pranuar pjesërisht. Ky plan masash i është dërguar gjithmonë KLSH-së në mbyllje të çdo raporti Auditimi. Në këtë kuadër Banka ka zbatuar të gjitha rekomandimet që janë pranuar apo pranuar pjesërisht. Sqarojmë që rekomandimet që janë zbatuar nga ana Jonë, janë mbështetur me evidencat përkatëse për grupet e auditimit. Ne i mbetemi qëndrimit që rekomandimet e pranuar apo të pranuar pjesërisht në raportet e mëparshme të Auditimit janë zbatuar nga ana e Bankës. (SHTOJCA 1).

Qëndrimi i grupit të auditimit: Ky rekomandim konsiderohet i pranuar dhe pjesërisht i zbatuar.

KONKLUZIONI I AUDITIMIT

Nga verifikimi i dokumentacionit konstatohet se niveli i pranimeve dhe zbatimit të rekomandimeve të lëna nga KLSH me shkresën nr. 655/12, datë 31.12.2024, është si më poshtë:

Për përmirësimin e gjendjes janë lënë 6 rekomandime “Masa Organizative” të lëna për zbatim, janë pranuar 2 rekomandime. Nga 6 rekomandime 4 rekomandime të pa pranuar dhe të pa zbatuara, 1 masë rezultoi pjesërisht 1 masë në proces

IV. GJETJE DHE REKOMANDIME

Për sa më sipër, rikërkojmë që Banka e Shqipërisë të marrin të gjitha masat e nevojshme me qëllim zbatimin e të gjitha rekomandimeve që rezultojnë të pazbatuar dhe pjesërisht zbatuar, si dhe përshpejtimin e zbatimit të rekomandimeve, të cilat rezultojnë në proces zbatimi, brenda 6-mujorit të parë të vitit 2026.

MASA ORGANIZATIVE

1.1. Rekomandimi: Banka e Shqipërisë në bashkëpunim me Ministrinë e Financave të marrë masa për krijimin e hapësirave me qëllim nxitjen e mundësive mbi investimin e likuiditeteve në monedhë vendase dhe valuta të huaja në vlerë dhe në kohëzgjatje, jo vetëm përmes investimeve në depozitë, por edhe përmes instrumenteve të tjerë për menaxhimin e likuiditetit.

2.1. Rekomandimi: Banka e Shqipërisë të marrë masa për të bashkëpunuar me Ministrinë e Financave, në drejtim të koordinimit të veprimeve, për emetimin brenda afatit ligjor të përcaktuar, të letrave me vlerë, me qëllim shmangien e riskut për mos mbulimin në kohë të rezervave negative.

3.1. Rekomandimi: Banka e Shqipërisë të marrë masa për të hartuar një manual/udhëzim të detajuar, ku të përcaktojnë procedurat për menaxhimin dhe përdorimin e rezervës “Rezerva” si rezultat i zbatimit për herë të parë të SNRF-ve, hapat për implementimin e Standardeve Ndërkombëtare të Raportimit Financiar si dhe rregulla për monitorimin dhe raportimin e përdorimit të kësaj rezerve.

5.1. Rekomandimi: Banka e Shqipërisë të vlerësojë dhe analizojë kosto/përfitimet e mbajtjes hapur së sporteve të bonove të thesarit, me qëllim rritjen e eficiencës dhe efektivitetit të përdorimit të fondeve dhe burimeve të Bankës së Shqipërisë.

3.3. DEGA DOGANORE TIRANË

I. PËRMBLEDHJE

Kontrolli i Lartë i Shtetit ushtroi auditimin tematik në Dega Doganore Tiranë “Për zbatimin e rekomandimeve të lëna në auditimet e evaduar në vitin 2023”, mbi auditimin e përputhshmërisë përcjellë me shkresën nr. 1113/23 prot., datë 31.12.2024, duke i kushtuar vëmendjen e posaçme çështjeve, që lidhen me:

- Vlerësimin e rekomandimeve të KLSH-së të lëna nga auditimi i kryer në vitin 2024, hartimi i programeve (plan veprimeve) nga subjekti i audituar, duke ngarkuar me detyra personat përgjegjës dhe përcaktuar afatet konkrete për zbatimin e rekomandimeve për çdo njësi vartëse;

- Nxjerrjen nga titullari i njësisë publike të akteve administrative të nevojshme, si:

Vendimeve (urdhrave) për zbatimin e masave organizative;

Vendimet ekzekutive për shpërblimin e dëmit;

Vendimet ekzekutive për përdorimin me efektivitet, eficiencë dhe ekonomikitet të fondeve;

Vendimet e nëpunësit autorizues, komisioneve disiplinore për dhënien e masave disiplinore e të tjera masa e rekomandime që i përcillen subjektit të audituar nëpërmjet Vendimit të Kryetarit të Kontrollit të Lartë të Shtetit.

II. HYRJA

Auditimi është kryer në përputhje me ligjin nr. 154, datë 27.11.2014 “Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit”, si dhe manualit “Për ndjekjen e zbatimit të rekomandimeve të Kontrollit të Lartë të Shtetit” dhe Regjistrin elektronik institucional të zbatimit të rekomandimeve.

Auditimi i zbatimit të rekomandimeve të lëna në auditimin e mëparshëm, sipas drejtimeve të Programit të Auditimit nr. 857/6 prot., datë 12.09.2025, të miratuar nga Kryetari i Kontrollit të Lartë të Shtetit, është kryer nga grupi i audituesve i përbërë nga:

-V.B., përgjegjëse e grupit të auditimit

-A.D., auditues

-E.B., audituese

-F.D., auditues

Auditimi ka filluar më datë 15.09.2025 dhe ka përfunduar më datë 24.10.2025.

II/1. OBJEKTI I AUDITIMIT

Zbatimi i masave të rekomanduara në auditimin e mëparshëm të dërguara me shkresën nr. 1113/23 prot., datë 31.12.2024, mbi veprimtarinë e Drejtorine Doganore Tiranë, së bashku me Raportin Përfundimtar të Auditimit, nga Grupi i Audituesve Shtetërorë të KLSH-së.

II/2. QËLLIMI I AUDITIMIT

Auditimi i zbatimit të rekomandimeve kryhet në funksion të hartimit të Raportit Vjetor të aktivitetit të Kontrollit të Lartë të Shtetit, që paraqitet në Kuvendin e Shqipërisë brenda tremujorit të parë të vitit pasardhës, bazuar në pikën 3 të nenit 31 të ligjit nr. 154/2014 “Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit”.

II/3. METODOLOGJIA E AUDITIMIT

Auditimi i plotë i të gjithë dokumentacionit të paraqitur nga subjekti dhe që ka lidhje me zbatimin e masave të rekomanduara nga KLSH për përmirësimin e gjendjes së subjekteve në të ardhmen.

III. PËRSHKRIMI I AUDITIMIT

III/1. INFORMACION I PËRGJITHSHËM.

Nga auditimi në terren i dokumentacionit të paraqitur nga subjekti **Drejtorinë Doganore Tiranë** në lidhje me zbatimin e rekomandimeve të lëna nga KLSH me shkresën nr. 1113/23 prot., datë 31.12.2024, rezulton se, niveli i pranimeve dhe zbatimit të rekomandimeve është si më poshtë:

- Për përmirësimin e gjendjes janë lënë 2 rekomandime si masa “*Propozime për përmirësim në legjislacionin*” në fuqi, të cilat janë pranuar, por rezultojnë të pazbatuara;

Janë lënë 16 rekomandime si masa organizative, nga të cilat 15 janë pranuar dhe 1 nuk është pranuar. Të pranuarat kanë statusin e ecurisë së zbatimit si vijon: 2 zbatuar plotësisht, 1 zbatuar pjesërisht, 6 në proces zbatimi dhe 6 të pazbatuar;

Janë lënë 8 rekomandime si masa të ardhura të munguara në buxhetin e shtetit, të cilat janë pranuar plotësisht, të cilat kanë statusin e ecurisë së zbatimit si vijon: 1 zbatuar pjesërisht, 2 në proces zbatimi dhe 5 masa të pazbatuar;

Janë lënë 2 rekomandime si masa për eliminimin e efekteve negative, nga të cilat 1 është pranuar dhe zbatuar plotësisht dhe 1 është pranuar pjesërisht;

Janë lënë 3 rekomandime si masa të tjera, të cilat janë pranuar plotësisht. Statusi i ecurisë së zbatimit është si vijon: 1 zbatuar plotësisht; 2 zbatuar pjesërisht;

- Për fillimin e procedurës për dhënien e masës disiplinore në lidhje me mangësitë dhe shkeljet e konstatuara, të trajtuara në Raportin Përfundimtar të Auditimit është lënë 1 Masë Disiplinore e cila është pranuar dhe zbatuar pjesërisht.

Opinion i përgjithshëm mbi zbatimin e rekomandimeve

Nga auditimi i zbatimit të rekomandimeve konstatohet se shkalla e pranueshmërisë së rekomandimeve kundrejt atyre të pa pranuar rezulton në nivel 94%, konkretisht nga 32 rekomandime gjithsej, janë pranuar 30 rekomandime.

Niveli i zbatimit të rekomandimeve të zbatuara plotësisht rezultoi në masën 12%, niveli i rekomandimeve zbatuara pjesërisht rezultoi 16%, niveli i rekomandimeve në proces zbatimi rezultoi 26%, si dhe niveli i rekomandimeve të pa zbatuara rezultoi 46%.

III/2. REZULTATET E AUDITIMIT SIPAS DREJTIMEVE TË AUDITIMIT

Nga auditimi i ushtruar në **Drejtorinë Doganore Tiranë** për zbatimin e rekomandimeve të KLSH-së, “*Mbi auditimin e përputhshmërisë*” për periudhën 01.01.2022-31.12.2023, trajtuar në Raportin Përfundimtar të Auditimit me Vendimin e Kryetarit të KLSH-së, përcjellë me shkresën nr. 1113/23 prot., datë 31.12.2024., rezultoi si më poshtë vijon:

A. Mbi hartimin e programit (Planit të veprimit) dhe respektimin e afateve ligjore për njoftimin e KLSH për ecurinë e zbatimit të rekomandimeve brenda afateve të përcaktuara në Ligjin nr. 154/2014, datë 27.11.2014 “Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit”.

-Nga **Drejtorinë Doganore Tiranë** me shkresën nr. 1024/2 prot., datë, 03.02.2025 është përcjellë “Plani i masave për zbatimin e rekomandimeve sipas raportit të KLSH-së, për auditimi brenda afatit kohor prej 20 ditë. siç është përcaktuar në nenin 15 shkronja (j) të ligjit nr. 154/2014, datë 27.11.2014 “Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollin të Lartë të Shtetit”.

-Drejtoria e Përgjithshme e Doganave me shkresën nr. 13449 prot., datë 03.07.2025, ka dërguar informacion mbi nivelin e zbatueshmërisë së rekomandimeve për periudhën 6-mujore, sipas përcaktimeve të pikës 2, të nenit 30, të ligjit nr. 154/2014, datë 27.11.2014 “Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit.

B. Zbatimi i rekomandimeve për masat për ndryshime apo përmirësime në legjislacionin në fuqi. Ecuria e zbatimit dhe analizimi i rekomandimeve: rekomandime të pranuar dhe nga këto, sa janë zbatuar plotësisht; zbatuar pjesërisht, në proces zbatimi dhe rekomandimet e pa zbatuara.

Në mënyrë më të detajuar, auditimi i verifikimit të zbatimit të rekomandimeve për secilin rekomandim të përcjellë në Degen Doganore Tiranë paraqitet.

.1 .1. Rekomandimi: Drejtoria e Përgjithshme e Doganave nëpërmjet Sektorit të Drejtorisë së Kontrollit të Akcizës dhe Pas Zhdoganimit në Departamentin e Analizave të Riskut dhe Aposteriorit, në vijim të ndërtojë Programe Kontrolli Specifike Verifikuese për deklaratimet e praktikave doganore që janë përpunuar sipas tabelës trajtuar për këtë çështje bashkëlidhur anekseve të Raportit Përfundimtar të Auditimit së mësipërme, si dhe të tjera praktika me qëllim verifikimin e vërtetësisë së pagesës detyrimeve doganore për mallrat e trajtuar sa më sipër, në funksion të verifikimit të mallit “Tub Plastik një përdorim” dhe “Shiringa plastike një përdorim”, me destinacion përfundimtar Mbetje në Njësi Spitalore apo Shitje në Farmaci Publike ose Depo Farmaceutike.

Pretendimi i subjektit:

Me shkresën nr. 1024/3 prot., datë 11.04.2025, DD Tiranë e ka përcjell rekomandimin e KLSH-së për kompetencë, Drejtorisë së Kontrollit Pas Zhdoganimit në DPD.

Me shkresën nr. 11594 prot., datë 05.06.2025, Drejtoria e Kontrollit Pas Zhdoganimit në DPD ka argumentuar se, në bazë të ligjit nr. 9975, datë 28.07.2008 “Për Taksat Kombëtare”, neni 3, pika 8, si dhe në udhëzimin nr. 26, datë 04.09.2008, i ndryshuar, në pikën 2.8 citohet se: “*Taksa e materialeve/artikujve plastikë, lëndëve të para të importuara për prodhimin e tyre dhe e ambalazheve prej qelqi*”, si dhe 2.8.1: “*Taksa e materialeve/artikujve plastikë dhe e ambalazheve plastike që importohen dhe bëjnë pjesë në kapitullin 39 të NKM-së, është 35 lekë/kg. Nuk e paguajnë këtë taksë 35 lekë/kg, lëndët e para në formë primare që importohen sipas krerëve 3901 deri në 3914, të NKM-së*”.

Përveç materialeve/artikujve të importuar në Kapitullin 39 të NKM-së, kjo taksë zbatohet edhe kur materiali plastik zë të paktën, 51% të masës së përgjithshme të ambalazhit që ambalazhon produkte të tjera të importuara, të klasifikuara në kapitujt, krerët, nënkrerët dhe kodet e tjera tarifore të NKM-së.

Duke qenë se artikujt “shiringa dhe tuba plastik venoz” nuk përfshihen në Kapitullin 39 të NKM-së, por në kreun 9018 të kësaj nomenklature, atëherë taksa e ambalazhit siç përcaktohet në pikën 2.8.1, nuk paguhet. Në kuptim të këtij ligji, janë materialet prej plastike të klasifikuara në Kapitullin 39 të NKM-së, të cilat paguajnë taksën TAM (duke hequr rastet përjashtimore) dhe jo çdo lloj artikulli me përbërje plastike apo që mund të përmbajë plastikë në të.

Komenti i grupit të auditimit:

Për sa ka argumentuar Drejtoria e Kontrollit Pas Zhdoganimit me shkresën nr. 11594 prot, datë 05.06.2025 se, duke qenë se artikujt “shiringa dhe tuba plastik venoz” nuk përfshihen në Kapitullin 39, të NKM-së, por në kreun 9018 të kësaj nomenklature, atëherë taksa e ambalazhit siç përcaktohet në pikën 2.8.1, nuk paguhet. Ky rekomandim nuk gjen zbatim dhe nuk është pranuar nga Drejtoria e Përgjithshme e Doganave. Grupi i auditimit në përfundim të analizës së fakteve arrin në konkluzionin që argumentimi ligjor i paraqitur nga Drejtoria e Kontrollit Pas Zhdoganimit në DPD, nuk ka bazë ligjore pasi bie në kundërshtim me përcaktimet ligjore të ligjit nr. 9975, datë 28.07.2008 “Për Taksat Kombëtare”, neni 3, pika 8, si dhe në udhëzimin nr. 26, datë 04.09.2008, i ndryshuar.

Ky rekomandim konsiderohet i pranuar dhe i pa zbatuar.

1.2 Rekomandimi: Drejtoria e Përgjithshme e Doganave në përfundim të procedurave të kontrollit të gjykojë problematikën e trajtuar sa më sipër duke bashkërenduar menjëherë me Ministrinë e Financave me qëllim kryerjen e ndryshimeve ligjore për përfshirjen e artikujve “Tub Plastik një përdorim për përdorim venoz” dhe “Shiringa plastike një përdorim në trajte përdorimi përfundimtar ambalazh” me destinacion përfundimtar ambalazhimin e solucioneve që shiten në Farmaci Publike ose Depo Farmaceutike në listën e artikujve plastike ambalazhues një përdorimshëm që paguajnë taksë kombëtare TAM në nivelin 35 lek/kg dhe përfshirjen e këtyre mallrave për pagesë të taksës së ambalazhit në anekset e ligjit nr. 9975, datë 28.07.2008 “Për Taksat Kombëtare” Në përfundim të procedurës nga Drejtoria e Përgjithshme e Doganave të informohet Institucioni i Kontrollit të Lartë të Shtetit mbi rezultatet e kontrollit dhe mbi vërtetësinë e veprimeve të kryera për propozim për pagesë takse të ambalazhit plastik për praktika të gjeneruar të trajtuara në anekset bashkëlidhur këtij Raportit Përfundimtar të Auditimit.

Përgjigja e subjektit:

Me shkresën nr. 11594 prot., datë 05.06.2025, Drejtoria e Kontrollit Pas Zhdoganimit në DPD ka

argumentuar qëndrimin e mbajtur nga ana e tyre duke u bazuar në ligjin nr. 9975, datë 28.07.2008 “Për Taksat Kombëtare”, neni 3, pika 8, si dhe në udhëzimin nr. 26, datë 04.09.2008, i ndryshuar, në pikën 2.8. Duke qenë se artikujt “shiringa dhe tuba plastik venoz” nuk përfshihen në Kapitullin 39 të NKM-së, por në kreun 9018 të kësaj nomenklature, atëherë taksa e ambalazhit siç përcaktohet në pikën 2.8.1, nuk paguhet.

Komenti i grupit të auditimit:

Për sa ka argumentuar nga Drejtoria e Kontrollit Pas Zhdoganimit me shkresën nr. 11594 prot, datë 05.06.2025 se, duke qenë se artikujt “shiringa dhe tuba plastik venoz” nuk përfshihen në Kapitullin 39 të NKM-së, por në kreun 9018 të kësaj nomenklature, atëherë taksa e ambalazhit siç përcaktohet në pikën 2.8.1, nuk paguhet. Ky rekomandim nuk gjen zbatim dhe nuk është pranuar nga Drejtoria e Përgjithshme e Doganave. Grupi auditimit në përfundim të analizës së fakteve arrin në konkluzionin që argumentimi ligjor i paraqitur nuk ka bazë ligjore pasi bie në kundërshtim me përcaktimet ligjore të ligjit nr. 9975, datë 28.07.2008 “Për Taksat Kombëtare”, neni 3, pika 8, si dhe në udhëzimin nr. 26, datë 04.09.2008, i ndryshuar.

Ky rekomandim konsiderohet i pranuar dhe i pa zbatuar.

3. Zbatimi i rekomandimeve për masat me karakter organizativ. Ecuria e zbatimit dhe analizimi i rekomandimeve: rekomandime të pranuar dhe nga këto, sa janë zbatuar plotësisht; zbatuar pjesërisht, në proces zbatimi dhe rekomandimet e pa zbatuara.

1.1 Rekomandimi: Nga Drejtoria për Mbrojtjen e Pronësisë Intelektuale, pranë Drejtorisë së Përgjithshme të Doganave të merren masa që të ketë vendimmarrje për të gjitha rastet e mallrave të sekuestruara pas kryerjes së verifikimeve për cenueshmerinë e pronësisë intelektuale.

Përgjigja e subjektit:

Me shkresën nr. 1024/12 prot., datë 28.04.2025, DD Tiranë e ka përcjellë rekomandimin e KLSH-së për kompetencë, në DPD.

Komenti i grupit të auditimit:

Grupit të auditimit të KLSH-së, nuk i'u vendos asnjë dokument nga Drejtoria për Mbrojtjen e Pronësisë Intelektuale mbi procedurën e ndjekur nga ana e tyre, në zbatim të këtij rekomandimi.

Ky rekomandim konsiderohet i pranuar dhe i pa zbatuar.

1.2 Rekomandimi: Nga strukturat përkatëse verifikuese (*Spektori i Verifikimit Fizik, Antikontrabanda etj.*) të merren masa që krahas procesverbalit të bllokimit, të mbahet dhe procesverbal sekuestrimi për mallrat, në mënyrë që Spektori Juridik të vijojë me vendimmarrjet sipas rastit.

Përgjigja e subjektit:

Me shkresën nr. 12019/1 prot., datë 12.06.2025, Drejtoria e Antikontrabandës informon se ka nxjerrë urdhrin e brendshëm nr. 12019 prot., datë 12.06.2025, drejtuar strukturave të kontrollit të kësaj drejtorie dhe në dijeni degëve doganore, për marrjen e masave dhe zbatimin menjëherë të këtij urdhri, (bashkëlidhur urdhri i brendshëm).

Komenti i grupit të auditimit:

Për sa më sipër, si dhe nga dokumentet e vëna në dispozicion grupit të auditimit, rekomandimi konsiderohet i pranuar dhe në proces zbatimi.

Ky rekomandim konsiderohet i pranuar dhe në proces zbatimi.

1.3 Rekomandimi: Nga Drejtori i Drejtorisë së Përgjithshme të Doganave të merren masa për ngritjen e grupeve të shkatërrimit për mallrat e akcizës të destinuara për shkatërrim që ndodhen në

magazinat e Degës së Doganës Tiranë.

Përgjigja e subjektit:

Me shkresën nr. 10/4 prot., datë 10.02.2025, Departamenti i Akcizës i ka kërkuar Degëve Doganore në zbatim të udhëzimit nr. 07, datë 17.12.2020, si dhe urdhrin nr. 1, datë 06.01.2021 të Drejtorit të Përgjithshëm të DPD, të marrin masa për produktet e akcizës që gjenden në magazinat e këtyre degëve dhe që duhen shkatërruar.

Me shkresën nr. 1024/9 prot., datë 25.04.2025, Kryetari i DD Tiranë ka nxjerrë urdhrin nr. 6, me të cilin ka kërkuar: -marrjen e masave për çdo rast nga ana e magazinës së DD Tiranë, fletë hyrja e mallrave sekuestro dhe magazinimi i tyre, duhet të ketë bashkëngjitur krahas procesverbal bllokimit dhe procesverbal verifikimi, sekuestrimi, si dhe të kontrollit fizik të protokolluar pranë DD Tiranë; -marrjen e masave në ndjekje të procedurave ligjore nga ana e magazinierit dhe specialistit të financës kateg. IV2, për kontabilizimin, dokumentimin në bashkëpunim me sektorët e tjerë të DPD, për mallrat sekuestro deri në konfiskim, shkatërrim apo dërgim në rezervat e shtetit.

Komenti i grupit të auditimit:

Për sa më sipër, në zbatimin e këtij rekomandimi janë marrë masa nga Departamenti i Akcizës, në zbatim të udhëzimit nr. 07, datë 17.12.2020 dhe urdhrin nr. 1, datë 06.01.2021 të Drejtorit të Përgjithshëm të DPD, si dhe nga Kryetari i DD Tiranë me urdhrin nr. 6, datë 25.04.2025.

Ky rekomandim konsiderohet i pranuar dhe zbatuar plotësisht.

2.1 Rekomandimi: Nga ana e përgjegjësit të Zyrës së Magazinimit të Përkohshëm të përcillet problematika e sistemit në strukturat përkatëse në mënyrë që të dhënat e këtij sistemi të jenë të sakta dhe koherente. Nga strukturat përkatëse lidhur me sistemin të merren masa për reflektim dhe zgjidhje të problematikave të hasura.

Përgjigja e subjektit:

Me shkresën nr. 1024/14 prot., datë 28.04.2025, DD Tiranë e ka përcjell rekomandimin e KLSH-së për kompetencë, në DPD.

Për sa i përket formës së shfaqjes në sistem të Dokumentit Elektronik të Përkohshëm (DEMP), për ato raste që rezultojnë të pa mbyllura apo të mbyllura pjesërisht, por ishin çliruar me një deklaratë doganore për vendosjen në një regjim të posaçëm doganor, për të gjitha rastet e rezultuara, u përcoll informacioni i detajuar me deklaratat përkatëse të mbylljes. Në zbatim të rekomandimit, për përiudhën në vazhdimësi pas verifikimit të dokumentit sipas të cilit mallrat janë vendosur në regjim, kryhet procedura e “shkarkimit manual” dhe në sistem shfaqen vetëm rastet kur mallrat janë gjendje në kushtet e magazinimit të përkohshëm.

Komenti i grupit të auditimit:

Nga informacioni i DD Tiranë, përcjellë me email-in e datës 21.10.2025 është sqaruar se, Zyra e Magazinimit të Përkohshëm ka përcjellë problematikën e konstatuar në auditim nga KLSH dhe në zbatim të rekomandimit, për përiudhën në vazhdimësi pas verifikimit të dokumentit sipas të cilit mallrat janë vendosur në regjim, kryhet procedura e “shkarkimit manual” dhe në sistem shfaqen vetëm rastet kur mallrat janë gjendje në kushtet e magazinimit të përkohshëm.

Ky rekomandim konsiderohet i pranuar dhe zbatuar plotësisht.

3.1 Rekomandimi: Nga Zyra e Magazinimit të Përkohshëm për mallrat e vendosura në magazinim të përkohshëm të evidentuara se u ka kaluar afati i qëndrimit prej 90 ditë, të merren të gjitha masat e nevojshme për rregullim situatë konform parashikimeve të legjislacionit doganor. Gjithashtu të merren masa që kontrollet e ushtruara ndaj subjekteve të autorizuara të shoqërohen me dokumentacionin e plotë dhe të nevojshëm duke identifikuar dhe verifikuar saktë artikujt, vlerën,

sasinë, cilësinë e tyre si dhe kohëzgjatjen e qëndrimit të tyre në këto ambiente.

Përgjigja e subjektit:

Nga ana e DD Tiranë janë marrë të gjitha masat në bashkëpunim dhe me DPD duke rregulluar situatën në lidhje me mallrat e vendosura në magazinim të përkohshëm.

Nga informacioni i DD Tiranë, përcjellë me email-in e datës 21.10.2025 është sqaruar nga Zyra e Magazinimit të Përkohshëm, në lidhje me plotësimin me dokumentacion dhe informacion të detajuar të rasteve kur ka kaluar afati 90 ditore i mallrave të vendosura në regjimin e magazinimit të përkohshëm në informacionet, në zbatim të rekomandimit në informacionet e hartuara, në përfundim të kontrolleve periodike plotësohen të dhëna të detajuara për subjektet, numrin e referencës, artikuj, sasi, vlerat dhe kohëzgjatja e qëndrimit në regjim. Vazhdojnë procedurat e mbikqyrjes së rasteve të evidentuara, nga të cilat pjesa më e madhe kanë kryer procedurat e vendosjes në një regjim të posaçëm.

Komenti i grupit të auditimit:

Për sa më sipër, nga Zyra e Magazinimit të Përkohshëm, janë marrë masat dhe po vijojnë në procedurat e mbikqyrjes së rasteve të evidentuara, nga të cilat pjesa më e madhe kanë kryer procedurat e vendosjes në një regjim të posaçëm.

Ky rekomandim konsiderohet i pranuar dhe në proces zbatimi.

4.1 Rekomandimi: Kryetari i Degës Doganore Tiranë, Sektori i Mbikqyrjes së regjimeve ekonomike doganore, të marrin masa të menjëhershme për verifikimin e koeficientëve të shfrytëzimit për të gjithë operatorët ekonomikë që kanë përfituar autorizime të tipit RPA, të cilët rezultojnë me mbyllje të regjimit të RPA me procedurë IM9 “*Asgjësim i produkteve të dala nga proceset e përpunimit të mallrave nën regjim dhe humbje dhe firo të dala gjatë procesit të përpunimit të mallrave të vendosura nën regjim*” me qëllim eliminimin e pasojave dhe efekteve negative që mund të lindin në të ardhurat doganore që raportohen në Buxhetin e Shtetit.

Përgjigja e subjektit:

Me shkresën nr. 1024/6 prot., datë 25.04.2025, Kryetari i DD Tiranë ka nxjerrë urdhrin nr. 3, drejtuar Sektorit të Mbikqyrjes së Regjimeve Ekonomike Doganore, për zbatimin e këtij rekomandimi.

Nga Sektori i Mbikqyrjes së Regjimeve Ekonomike Doganore janë paraqitur proceverbale të kontrollit (me dokumente bashkëngjitur), për regjimin e përpunimit aktiv me nr. 2288/1 prot., datë 25.03.2024; nr. 6712/1 prot., datë 23.08.2024; nr. 7573/1 prot., datë 27.09.2024; nr. 9710/1 prot., datë 31.10.2024; nr. 3016/1 prot., datë 24.04.2025; nr. 3345/1 prot., datë 08.05.2025; nr. 3320/1 prot., datë 08.05.2025; nr. 6718/1 prot., datë 28.07.2025.

Komenti i grupit të auditimit:

Për sa më sipër, Sektori i Mbikqyrjes së Regjimeve Ekonomike Doganore ka vënë në dispozicion të grupit të auditimit të KLSH-së, proces verbale të dokumentet bashkëngjitur, mbajtur në kontrollet e kryera.

Ky rekomandim konsiderohet i pranuar dhe në proces zbatimi.

5.1 Rekomandimi: Drejtoria/Sektori Juridik në Degën e Doganës Tiranë të marrë masa për hartimin dhe miratimin brenda afateve procedurale të parashikuara të vendimeve të Degës Doganore dhe dokumentimin e gjurmëve të auditimit për pengesat dhe arsyet e vonësve nga momenti i mbajtjes së procesverbaleve të konstatimit të shkeljeve administrative.

Përgjigja e subjektit:

Me shkresën nr. 1024/10 prot., datë 25.04.2025, Kryetari i DD Tiranë ka nxjerrë urdhrin nr. 7,

drejtuar Sektorit Juridik, për zbatimin e këtij rekomandimi.

Me relacionin përcjellë në KLSH, me shkresën nr. 1024/23 prot., datë 12.09.2025 DD Tiranë argumenton se, për Vendimet nr. 695 dhe 696 datë 20.07.2023, si dhe vendimin nr. 698 dhe 699 datë 21.07.2023 që i përkasin operatorit "I" me NIPT M., nga ana e Zyrës së Rregjimeve Doganore pranë DD Tiranë në zbatim të Plan Kontrollit nr.813 prot., DDT datë 01.02.2023, është mbajtur dhe procesverbali i konstatimit të kundërvajtjes administrative ndaj Operatorit Ekonomik "I" me NIPT M. Në varësi të autorizimeve dhe rregjimeve që kishte subjekti dhe konstatimeve faktike të Zyrës së Rregjimeve Doganore, procesverbaleve të kundërvajtjeve administrative është proceduar dhe me vendimet përkatëse. Vonesa në daljen me aktin administrativ ka ardhur për shkak të mbingarkesës me vendimmarrje që DD Tiranë ka pasur në atë periudhë, një lapsus njerëzor në administrimin e procedimit të vendimmarrjes por që nuk sjellin pasojë financiare por dhe procedurale për operatorin ekonomik dhe mirëfunksionimin e institucionit. Subjektit i është njoftuar procesverbali i kundërvajtjes administrative, i është dhënë mundësia e ezaurimit të rrugës administrative në zbatim të parashikimeve ligjore dhe nënligjore që kuadri ligjor mirëpërcakton për shkeljet doganore. Vonesa në zbardhjen e një vendimi nuk çënon fuqinë vendimarrëse të tij, si dhe nuk i mohon subjektit mundësinë për t'u ankuar administrativisht apo edhe gjyqësisht nga momenti i marrjes dijeni.

Në lidhje me pikën "Mbi afatet procedurale", Vendimi nr. 863, datë 06.10.2023 për agjencinë doganore "S" për caktimin e gjobës në masën 50,000 lekë është marrë mbi bazën e procesverbalit nr. 00015339, si dhe dokumentacionin bashkëlidhur tij "Informacion për marrje vendimi" për shkeljen e kryer nga agjencia doganore "S" me nr. J., të Departamentit Operativo Hetimor. Vonesa ka ardhur për shkak të një gabimi njerëzor ku nga ana e Zyrës Jurike në momentin e marrjes së materialit është mbajtur vendimi për konstatimin e kundërvajtjes në lidhje me deklaratën doganore R71463 me importues "A" shpk me NIPT L., kurse për agjencinë është "harruar". Në vëmendjen tuaj, agjencia doganore ka kryer pagesën dhe nuk ka paraqitur ankim.

Komenti i grupit të auditimit:

Për sa më sipër, sipas argumentimeve të paraqitura në relacion dhe dokumentacionit të vënë në dispozicion nga Drejtoria Juridike,

Ky rekomandim konsiderohet i pranuar dhe në proces zbatimi.

6.1 Rekomandimi: Dega Doganore të marrë masa për zbatimin e parashikimeve të Kodit Doganor mbi klasifikimin e shkeljes, aplikimin e penaltetëve dhe saktësimin e parregullsive të evidentuara në vlerën 40,000 lekë.

Përgjigja e subjektit:

Me shkresën nr. 1024/10 prot., datë 25.04.2025, Kryetari i DD Tiranë ka nxjerrë urdhrin nr. 7, drejtuar Sektorit Juridik, për zbatimin e këtij rekomandimi.

Për 2 vendimet, nr. 852 datë 29.09.2023 dhe nr. 880 datë 20.10.2023 për operatorin "U", në të cilët pretendohet se: gjoba e aplikuar tejkalon limitin e parashikimit ligjor mbi të cilin është klasifikuar shkelja me 20,000 lekë, neni 256/1/b i Kodit Doganor në të cilin përcaktohet se 'b) kur kundërvajtja nuk ka të beje me mallrat, sipas përcaktimeve të shkronjës "a", zbatohet sanksion në masën 20 000 lekë deri në 50 000 lekë', si dhe vlerën e propozuar në proces verbale prej 50,000 lekësh. sqarojme si me poshte vijon:

Në lidhje me pikën "Mbi masën e penaltetit të aplikuar mbi parashikimin", subjekti "U." shpk me NIPT K. për vendimet nr. 852 datë 29.09.2023 dhe 880 datë 20.10.2023, është penalizuar për parregullsi në deklaram gjatë përpilimit të deklaratës nga kjo agjenci, por pa efektet financiar. Kundërvajtjet kanë qenë të një shkelje jo të rënda që kanë ardh si rrjedhojë e një gabimi më shumë

njerëzor sesa me dashje gjatë përpilimit të deklaratës doganore. Gjithashtu në përcaktimin e masës së penaltetit në lidhje me këto subjekte autoriteti vendimarrës ka pasur përcaktimet e dispozitave ligjore se ky subjekt ka qënë përsëritës dhe për këtë arsye është aplikuar penaltete shtesë në shumën 70,000 lekë, por duke ruajtur parimin e proporcionalitetit.

Në vëmendjen tuajën, subjekti “U” shpk me NIPT K. është penalizuar dhe me vendimin nr. 63 datë 31.01.2023, vendimin nr. 851 datë 29.09.2023, vendim nr. 853 datë 29.09.2023. Bashkëngjitur në këtë subjekt keni listën për të cilën ky subjekt është penalizuar disa herë nga autoriteti doganor gjatë periudhës së auditimit. DD Tiranë ka aplikuar një penaltet më të lartë sesa ai i propozuar në procesverbalin e kundravajtjes administrative referuar Ligjit nr. 102/2014 datë 31.07.2014 “Kodi Doganor i Republikës së Shqipërisë” i ndryshuar; VKM nr. 651, datë 10.11.2017 “Për miratimin e dispozitave zbatuese të Ligjit nr. 102/2014, datë 31.07.2014”.

Komenti i grupit të auditimit:

Për sa më sipër, subjekti sqaron qëndrimin e tij në lidhje me konstatimin, por grupit të auditimit të KLSH-së, nuk i’u vendos në dispozicion asnjë dokument mbi procedurën e ndjekur nga DD Tiranë për zbatim e tij.

Ky rekomandim konsiderohet i pranuar dhe i pa zbatuar.

7.1 Rekomandimi: Drejtoria e Burimeve Njerëzore në bashkëpunim me Drejtorinë e Përgjithshme të Doganave të marrin masat për plotësimin e pozicioneve vakante me doganier akcize sipas kërkesave specifike të pozicionit.

Përgjigjja e subjektit:

Me shkresën nr. 1024/11 prot., datë 28.04.2025, DD Tiranë e ka përcjell rekomandimin e KLSH-së për kompetencë, në DPD.

Komenti i grupit të auditimit:

Grupit të auditimit të KLSH-së, nuk i’u vendos asnjë dokument mbi procedurën e ndjekur nga Drejtoria e Burimeve Njerëzore në DPD në zbatim të këtij rekomandimi.

Ky rekomandim konsiderohet i pranuar dhe i pa zbatuar.

8.1 Rekomandimi: Dega Doganore Tiranë të analizojë dhe të nxjerrë përgjegjësitë për mangësitë e konstatuara në çështjen e autorizimeve të magazinave fiskale të cilat rezultojnë të pa mbuluara me garanci sipas legjislacionit doganor e për të cilat nuk kanë nisur ende procedurat e revokimit të autorizimit të magazinës fiskale, si dhe të marrë masa për monitorim të vazhdueshëm të veprimtarisë së operatorëve lidhur me vlefshmërinë në kohë të kushteve ligjore të autorizimeve.

Përgjigjja e subjektit:

Me shkresën nr. 1024/7 prot., datë 25.04.2025, Kryetari i DD Tiranë ka nxjerrë urdhrin nr. 4, drejtuar Zyrës së Akcizës në DD Tiranë për zbatimin e këtij rekomandimi.

Me shkresën nr. 1024/33 prot., datë 12.09.2025, DD Tiranë ndër të tjera, informon se lidhur me vlefshmërinë e garancive të autorizimeve të magazinave fiskale, nuk ka patur magazina fiskale të pa mbuluara me garanci.

Qëndrimi i grupit të auditimit: Ky rekomandim konsiderohet i pa pranuar.

9.1 Rekomandimi: Dega Doganore dhe Zyra e Akcizës të marrë masa për përgatitjen brenda afateve ligjore të dokumentacionit përkatës në zbatim të procedurës së rimbursimit të akcizës për të gjithë kërkesat e operatorëve, si dhe të dalë me vendim për kërkesat e pa trajtuara ende 2 vjet me vonesë të operatorit “T.” SHPK.

Përgjigjja e subjektit:

Me shkresën nr. 1024/7 prot., datë 25.04.2025, Kryetari i DD Tiranë ka nxjerrë urdhrin nr. 4, drejtuar Zyrës së Akcizës në DD Tiranë, për zbatimin e këtij rekomandimi.

Me shkresën nr. 1024/33 prot., datë 12.09.2025, DD Tiranë ndër të tjera, informon se lidhur me konstatimin për rimbursimin e operatorit T. janë bashkëngjitur shkresat, të cilat janë dërguar tek operatori, për arsye të rimbursimit të akcizës:

Me shkresën nr. 3856/1 prot., datë 21.05.2024, me lëndë: Kthim pa veprim, DD Tiranë i ka kthyer përgjigje subjektit “T.” SHPK, ku citohet: *kërkesa juaj nuk do të merret në shqyrtim, pasi mallrat e prodhuara nga ana juaj dhe të shitur me faturë TVSH, janë në tejkalim të afateve ligjore, të përcaktuara në Ligjin nr. 61/2012, i ndryshuar; shkresën nr. 11380 prot., datë 05.12.2022, si dhe 8178 prot., datë 10.10.2024.*

Komenti i grupit të auditimit:

Për sa më sipër, Grupit të auditimit të KLSH-së, ju vendosën në dispozicion vetëm vendimet e nxjerra për operatorin “T.” SHPK. Pë rrjedhojë rekomandimi konsiderohet i pranuar dhe i zbatuar pjesërisht.

Ky rekomandim konsiderohet i pranuar dhe zbatuar pjesërisht.

10.1 Rekomandimi: Zyra e Akcizës të marrë masa për intensifikimin e kontroleve fizike me qëllim rritjen e përqindjes së mbulimit me kontroll për të minimizuar riskun e mos mbikëqyrjes dhe monitorimit. Gjithashtu të realizojë përzgjedhjen e operatorëve për kontroll bazuar në një analizë risku periodike të dokumentuar, si dhe dokumentojë kontrollin dhe rezultatet e tij, dhe më tej të hartojë raportet e kontrollit, në përputhje me përcaktimet e manualit të metodologjisë së kontrollit të akcizës.

Përgjigja e subjektit:

Me shkresën nr. 1024/7 prot., datë 25.04.2025, Kryetari i DD Tiranë ka nxjerrë urdhrin nr. 4, drejtuar Zyrës së Akcizës në DD Tiranë, për zbatimin e këtij rekomandimi.

Komenti i grupit të auditimit:

Grupit të auditimit të KLSH-së, nuk ju vendos asnjë dokument mbi procedurën e ndjekur nga Zyra e Akcizës në DD Tiranë në zbatim të këtij rekomandimi.

Ky rekomandim konsiderohet i pranuar dhe i pa zbatuar.

11.1 Rekomandimi: Drejtoria e Burimeve Njerëzore dhe Drejtori i Përgjithshëm i Doganave të marrin masat për plotësimin e pozicionit vakant me specialist borxhi sipas kërkesave specifike të pozicionit.

Përgjigja e subjektit:

Me shkresën nr. 1024/11 prot., datë 28.04.2025, DD Tiranë e ka përcjell rekomandimin e KLSH-së për kompetencë, në DPD.

Komenti i grupit të auditimit:

Grupit të auditimit të KLSH-së, nuk ju vendos asnjë dokument mbi procedurën e ndjekur nga Drejtoria e Burimeve Njerëzore në DPD në zbatim të këtij rekomandimi.

Ky rekomandim konsiderohet i pranuar dhe i pa zbatuar.

12.1 Rekomandimi: Dega Doganore Tiranë (Zyra e Borxhit dhe Sektori Juridik), të marrë masa për zbatimin me rigorozitet të të gjitha fazave për rikupërimin e borxhit doganor të përcaktuara në Udhëzimin nr. 15, datë 03.12.2018, për të gjithë operatorët e evidentuar në anekse dhe ndjekjen e procedurave në afat me qëllim uljen e nivelit të borxhit doganor me vlerë 18,620 milionë lekë.

Përgjigja e subjektit:

Me shkresën nr. 1024/8 prot., datë 25.04.2025, Kryetari i DD Tiranë ka nxjerrë urdhrin nr. 5, drejtuar Zyrës së Borxhit Doganor, për zbatimin e këtij rekomandimi.

Zyra e borxhit në DD Tiranë ka marrë masa për rikupërimin me forcë të detyrimeve doganore të papaguara që u takon viteve 2022 dhe 2023. Janë kryer gjithsej 172 pagesa me vlerë prej 14,410,527 lekë, ku evidentohen 147 pagesa totale me vlerë 10,216,841 lekë dhe pagesa të pjesshme rezultojnë 25, me vlerë 4,193,686 lekë.

149 raste janë realizuar nga masat me marra nga Zyrës së Borxhit Doganor në DD Tiranë, në bashkëpunim me DPD, ndërsa 23 raste janë realizuar nga masat e marra nga përmbarues, në zbatim të vendimeve të gjykatës, në vijim të kontratave të lidhura mes dy palësh.

Komenti i grupit të auditimit:

Për sa më sipër, subjekti ka paraqitur dokument justifikues me email-in e datës 21.10.2025, nënshkruar nga specialist i borxhit doganor, në lidhje me marrjen e masave për rikupërimin e borxhit doganor.

Ky rekomandim konsiderohet i pranuar dhe në proces zbatimi.

12.2 Rekomandimi: Zyra e Borxhit të marrë masa për realizimin në afat të procedurave të evidentimit dhe rikupërimin të detyrimeve të papaguara doganore dhe të akcizës, si dhe të njoftojë strukturën përkatëse tatimore DPT/DRT sipas “Marrëveshjes së Bashkëpunimit midis DPD dhe DPT” nr. 14355, datë 19.06.2018, mbi detyrimet shtesë tatimore të lindura si pasojë e detyrimeve shtesë të akcizës për operatorin “B.” sha.

Përgjigjja e subjektit:

Me shkresën nr. 1024/8 prot., datë 25.04.2025, Kryetari i DD Tiranë ka nxjerrë urdhrin nr. 5, drejtuar Zyrës së Borxhit Doganor, për zbatimin e këtij rekomandimi.

DD Tiranë i ka kërkuar përmes email-it të datës 06.07.2024, Drejtorisë së Përgjithshme të Tatimeve, pezullimin e aktivitetit deri në shlyerjen e detyrimeve doganore të papaguara ndaj DD Tiranë, për debitorët (duke i bashkëngjitur tabelën) për të cilët Gjykata ka lëshuar urdhër ekzekutimi.

Komenti i grupit të auditimit:

Për sa më sipër, Zyra e Borxhit në DD Tiranë, ka paraqitur dokumente justifikues në marrjen e masave për rikupërimin e borxhit doganor, si dhe ka dërguar në DPD kërkesën për pezullimin e aktivitetit të operatorit “B.” SHA, i cili përfshihet në listën e debitorëve me urdhër ekzekutim në DD Tiranë.

Ky rekomandim konsiderohet i pranuar dhe në proces zbatimi.

13.1 Rekomandimi: Zyra e Mbikqyrjes Doganore për mbikqyrjen e Regjimit të Lejimit të Përkohshëm (RLP) të mbajë regjistra për regjistrimin e të gjithë operatorëve dhe operacioneve për të gjitha llojet e mjeteve dhe mallrave që lëvizin në këtë regjim doganor dhe të kryejë kontrolle fizike gjatë kësaj periudhe për të bërë identifikimin e mallrave të vendosura nën atë regjim, statusin e tyre doganor dhe lëvizjet e mallrave brenda afateve autorizuese.

Përgjigjja e subjektit:

Me shkresën nr. 1024/5 prot., datë 25.04.2025, Kryetari i DD Tiranë ka nxjerrë urdhrin nr. 2, drejtuar Sektorit të Mbikqyrjes së Regjimeve Ekonomike Doganore, për zbatimin e këtij rekomandimi.

Komenti i grupit të auditimit:

Grupit të auditimit të KLSH-së, nuk i’u vendos në dispozicion asnjë dokument mbi procedurën e ndjekur nga Sektori i Mbikqyrjes së Regjimeve Ekonomike Doganore për zbatimin e këtij

rekomandimi.

Ky rekomandim konsiderohet i pranuar dhe i pa zbatuar.

C. MASA TË ARDHURA TË MUNGUARA NË BUXHETIN E SHTETIT

1.1 Rekomandimi: Dega Doganore Tiranë në bashkëpunim me Drejtorinë e Përgjithshme të Doganave të marrë masa të menjëhershme me qëllim fillimin e procedurave ligjore sipas legjisllacionit në fuqi për zbatimin ligjor të konstatimeve të trajtuara në këtë Raport Përfundimtar të Auditimit duke përfshirë shqyrtimin, vendimmarrjen, kontabilizimin dhe më pas arkëtimin e detyrimeve doganore të munguara të rilogaritura në **shumën 417,679,279 lekë**.

Përgjigja e subjektit:

Me shkresën nr. 1024/15 prot., datë 02.05.2025, DD Tiranë e ka përcjell rekomandimin e KLSH-së për kompetencë, Drejtorisë së Kontrollit pas Zhdoganimit në DPD.

Me Relacionin e përcjellë në KLSH, me shkresën nr. 1024/23 prot., datë 12.09.2025 DD Tiranë sqaron se:

Aneksi nr. 4.1, 4.2, 4.3 dhe 4.4 Për deklaratat që i përkasin importit të artikujve mish/pa kocka; mish gjedhi tremiks; mish pule; fileto pule; kofshe derri; kofshe derri/me kocke; mish koke pa kocke/derri; mish/gjedhi/musku; paste MDM; shpatull derri” të klasifikuar në Kapitullin 02, DD Tiranë nuk ka dalë me vendimmarrje.

Me shkresën nr. 1024/31 prot., datë 12.09.2025 DD Tiranë i ka dërguar kërkesën për verifikim DOH dhe DIARM në DPD, për importet e kryera nga subjekti “Z” SHPK, për artikujt të ndryshëm ushqimor.

Me shkresën nr. 1024/32 prot., datë 12.09.2025 DD Tiranë i ka dërguar kërkesën për verifikim DOH dhe DIARM në DPD, për importet e kryera nga subjekti “A” SHPK, për artikujt të ndryshëm ushqimor.

Aneksi nr. 4.5 Për deklaratat që i përkasin importit të artikullit “stomak pule” të klasifikuar në Kapitullin 05, DD Tiranë nuk ka dalë me vendimmarrje.

Me shkresën nr. 1024/30 prot., datë 12.09.2025 DD Tiranë i ka dërguar kërkesën për verifikim DOH dhe DIARM në DPD, për importet e kryera nga subjekti “E” SHPK, për artikujt të ndryshëm ushqimor.

Aneksi nr. 4.6 Për deklaratat që i përkasin importit të artikujve “Cigare Compact 4” të klasifikuar në Kapitullin 24, për subjektin ”P” me NIPT K., DD Tiranë ka dalë me vendimmarrje për rikupërim detyrimi doganor në shumën 3,591,382 lekë.

Aneksi nr 4.7 Për deklaratat që i përkasin importit të artikujve “*fruta të thata: arra; hurma arabie*” të klasifikuar në Kapitullin 08, DD Tiranë nuk ka dalë me vendimmarrje.

Aneksi nr. 4.8 dhe 4.9 Për deklaratat që i përkasin importit të artikujve “cokokrem”; “kakao” dhe “cokollatë” të klasifikuar në Kapitullin 18, DD Tiranë nuk ka dalë me vendimmarrje.

Me shkresën nr. 3163 prot., datë 23.04.2025 DD Tiranë i ka dërguar kërkesën për verifikim DOH dhe DIARM në DPD, për importet e kryera nga subjekti “P” SHPK, për artikujt të ndryshëm ushqimor, bashkëlidhur edhe shkresa nr. 3164 prot., datë 23.04.2025 DD Tiranë për artikullin “cokocrem”.

Me shkresën nr. 1024/26 prot., datë 12.09.2025 DD Tiranë i ka dërguar kërkesën për verifikim DOH dhe DIARM në DPD, për importet e kryera nga subjekti “L”, për artikujt “kek dhe çokollatë”.

Aneksi nr. 4.10 Për deklaratat që i përkasin importit të artikujve “pije/leng/fruta” të klasifikuar në Kapitullin 20, për subjektin “J” me NIPT L., DD Tiranë ka dalë me Vendimin nr. 424, datë

11.08.2025 për rikupërim detyrimi doganor në shumën 114,370 lekë.

Aneksi nr. 4.15 Për deklaratat që i përkasin importit të artikujve “pije/leng/fruta” të klasifikuar në Kapitullin 20, për subjektin “B” me NIPT L., DD Tiranë ka dalë me vendimmarrje për rikupërim detyrimi doganor në shumën 114,370 lekë.

Aneksi nr. 4.12 Për deklaratat që i përkasin importit të artikullit “*kikirika te pjekur*” të klasifikuar në Kapitullin 2008, nuk lindin detyrime doganore shtesë.

Me shkresën nr. 2125 prot., datë 13.03.2025 DD Tiranë i ka dërguar kërkesën për verifikim DOH dhe DIARM në DPD, për importet e kryera nga subjekti “F” PF, për artikujt “arra”.

Aneksi nr. 4.11, 4.13, 4.14 dhe 4.16 Për deklaratat që i përkasin importit të artikujve “*kerpudha te konsevuara – ne tretesire ujore*” të klasifikuar në Kapitullin 2003, “*domate e konservuar*” të klasifikuar në Kapitullin 2002 dhe “*ketchup*” të klasifikuar në Kapitullin 2005 dhe 20, DD Tiranë nuk ka dalë me vendimmarrje.

Aneksi nr. 4.17 Për deklaratat që i përkasin importit të artikujve “pije energjike në ambalazh 0.25 lt” të klasifikuar në kreun 2202, janë mbajtur 14 vendime për deklaratat e subjektit “J” me NIPT L., në vlerën totale prej 598,477 lekë.

Ndërsa për 11 praktika në vlerën 297,852 lekë të po këtij subjekti, është ndërhyrë nga personeli i SVQ sipas vlerës 0.83 euro/lt në momentin e pranimit të deklaratës doganore.

Për deklaratat që i përkasin importit të artikujve “pije energjike” të klasifikuar në kreun 2202, DD Tiranë nuk ka dalë me vendimmarrje. Nga analiza e indikatorëve rezulton se përzgjedhja e metodës për vlerësimin doganor është në përputhje me kërkesat e legjislacionit doganor në fuqi.

Me shkresën nr. 1024/29 prot., datë 12.09.2025 DD Tiranë i ka dërguar kërkesën për verifikim DOH dhe DIARM në DPD, për importet e kryera nga subjekti “T”, për artikujt të ndryshëm ushqimor.

Aneksi nr. 4.18, 4.19 dhe 4.20 Për deklaratat që i përkasin importit të artikujve “birrë Përoni”, “Birre/Carlsberg 0.33 liter” dhe “Birre/Tuborg 0.33 liter” të klasifikuar në Kapitullin 22, DD Tiranë nuk ka dalë me vendimmarrje.

Aneksi nr. 4.21 Për deklaratat që i përkasin importit të artikujve “Frut molle i thare/copa” të klasifikuar në Kapitullin 23. Nga analiza e indikatorëve rezulton se përzgjedhja e metodës për vlerësimin doganor është në përputhje me kërkesat e legjislacionit doganor në fuqi.

Me shkresën nr. 1024/28 prot., datë 12.09.2025 DD Tiranë i ka dërguar kërkesën për verifikim DOH dhe DIARM në DPD, për importet e kryera nga subjekti “C” SHPK, për artikujt të ndryshëm ushqimor.

Aneksi nr. 4.23 Në lidhje me importet e artikullit “ushqim për qen dhe mace” të klasifikuar në Kapitullin 23, në vlerën 424,721 lekë sipas RPA, DD Tiranë nuk ka dalë me vendimmarrje.

Aneksi nr. 4.22, 4.24 dhe 4.25 Në lidhje me importet e artikullit “Boje Hidromat”, “mastice/ngjitës; pigment”, “pigment” të klasifikuar në Kapitullin 32, DD Tiranë nuk ka dalë me vendimmarrje.

Aneksi nr. 4.26 Për deklaratat që i përkasin importit të artikujve Letra të lagura dhe sapun i lëngshëm, Detergjent leng; DD Tiranë nuk ka dalë me vendimmarrje.

Me shkresën nr. 1024/24 prot., datë 12.09.2025, DD Tiranë ka dërguar kërkesën për verifikim DOH dhe DIARM, në lidhje me importet e kryera nga subjekti “E”, “H”, për artikullin “letër e lagur”.

Me shkresën nr. 1024/25 prot., datë 12.09.2025, DD Tiranë ka dërguar kërkesën për verifikim DOH dhe DIARM, në lidhje me importet e kryera nga subjekti “E” SHPK për artikullin “letër e lagur”.

Aneksi nr. 4.26 dhe 4.27 Për deklaratat që i përkasin importit të artikujve Letra të lagura dhe

sapun i lëngshëm, Detergjent leng; Sapun/leng; Zbutesh/ Rrobash; Solucion Enesh; Zbutesh/ Rrobash të klasifikuar në Kapitullin 34, DD Tiranë nuk ka dalë me vendimmarrje.

Aneksi nr. 4.29 Për deklaratat që i përkasin importit të artikujve “aditiv betoni” të klasifikuar në Kapitullin 38, DD Tiranë nuk ka dalë me vendimmarrje.

Aneksi nr. 4.30 Për deklaratat që i përkasin importit të artikujve “Lekure e njome” të klasifikuar në Kapitullin 41, DD Tiranë ka dalë me vendimmarrje në shumën 11,726,000 lekë.

Aneksi nr. 4.31 Për deklaratat e artikujve “betoforma druri të përdorura për ndërtim” të klasifikuar në Kapitullin 44, DD Tiranë ka marrë vendime për subjektin “A” M. me vendimin nr. 414, datë 06.08.2025, në shumën 25,084 lekë; A.M. me vendimin nr. 397, datë 05.08.2025, në shumën nr. 9,389 lekë; F.L. me vendimin nr. 396, datë 05.08.2025, në shumën 13,138 lekë; E.NIPT J. me vendimin nr. 393, datë 04.08.2025, në shumën 150,000 lekë, pasi nga verifikimi rezultoi se subjekti ka deklaruar “panelet druri për dyer të brendshme”; S. NIPT L., për DAV R52311 me vendimin nr. 395, datë 05.08.2025 në shumën 18,356 lekë; për “A” L.; A.M.; A.K.; G.SHPK K.; I.K.; N.K.; S.K.; S.K. për rikupërim detyrimi doganor në shumën totale 365,694 lekë vetëm për ato raste në të cilat vlera e deklaruar është nën vlerën 140 euro/m³. Në të gjitha rastet e rivlerësimit të artikullit “betoforma druri për ndërtim të përdorura” nga DVQ dhe nga DD Tiranë është aplikuar vlera 140 euro/m³.

Për të gjitha rastet e tjera të artikullit “betoforma druri të përdorura për ndërtim” të klasifikuar në Kapitullin 44, si dhe duke marrë në konsideratë që pesha specifike e 1m³ betoforma druri është 650 kg, vlera e deklaruar nga subjektet ka qënë me e lartë se 140 euro/m³, DD Tiranë nuk ka dalë me vendimmarrje.

Aneksi nr. 4.32 Për deklaratat që i përkasin importit të artikujve “MDF e Veshur” të klasifikuar në Kapitullin 44, DD Tiranë nuk ka dalë me vendimmarrje.

Për deklaratat që i përkasin importit të artikullit “fije për prodhim litari” deklaruar në kreun *5407* të kryera nga subjekti “F” me NIPT K. Nga ana e subjektit është depozituar Vendimi nr 101 dt. 04.09.2021 I Deges se Doganes Kapshtice sipas se ciles për praktika te meparshme për importe te ketij subjekti te njihet transaksioni.

Nga ana e operatorit janë depozituar dokumentat shtesë, justifikues për vlerën e transaktuar si: Transfertat Bankare të likuidimeve dhe Deklaratat e Eksportit të cilat ndodhen bashkëlidhur praktikave doganore. Për këtë artikull nuk mund të aplikohet vlera sipas Urdhërit nr 779 Prot DPD dt. 16.01.2013 të Drejtorit të Përgjithshëm të Doganave ”Mbi rishikimin e disa indikatorëve kontrolli shtesë në vlerësimin doganor të mallrave me origjinë nga vendet jashtë BE/NEU”, pasi indikatorët e vlerësimit egzistojnë për pelhurat si produkt i përfunduar. nga verifikimi i dokumentacionit bashkëngjitur rezulton se vendi i origjines, vendi i eksportit dhe vendi i transaksionit është Turqia, gjithashtu për këto artikuj nuk egzistojnë vlera në dosjen e të dhënave të disponueshme, faturat shoqëruese të mallit përmbajnë informacion të plotë e të detajuar për çmimet e mallit, në zbatim të kërkesave të pikes 161 të VKM nr 651 dt. 10.11.2017 Dispozitat Zbatuese të Kodit Doganor të RSH i është kërkuar importuesve dokumentacion shtesë për të vërtetuar vlerën e transaksionit, janë depozituar, transfertat bankare e pagesave të kryera, te cilat ndodhen bashkëlidhur deklaratave doganore, nga verifikimi i informacionit që përmbajnë këta dokumenta justifikohet rregullsia e vlerave të pasqyruara në faturat shoqëruese të mallit. Nga analiza e indikatorëve e fakteve të mësipërme rezulton se përzgjedhja e metodës për vlerësimin doganor është në përputhje me kërkesat e legjislacionit doganor në fuqi.

Për deklaratat që i përkasin importit të artikullit “fije për prodhim thasë” deklaruar në kreun *5407* të kryera nga subjekti “G”, të përmendura në aneksin 4.33, vlerësimi është kryer bazuar në nenin 66 të Ligjit 102/2014 "Kodi Doganor i Republikës së Shqipërisë", datë 31.07.2014 si dhe

pikës 4.1 të Udhëzimit të Ministrit të Financave dhe Ekonomisë Nr. 3, dt. 23.01.2018 “Për vlerësimin e mallrave për qëllime doganore” është pranuar transaksioni si vlerë doganore.

Në këtë rast artikulli i deklaruar nuk është pëlhurë për veshmbathje por pëlhurë e thurur me fije polipropileni për thasë.

Për këtë artikull nuk mund të aplikohet vlera sipas Urdhërit nr 779 Prot DPD dt. 16.01.2013 të Drejtorit të Përgjithshëm të Doganave “Mbi rishikimin e disa indikatorëve kontrolli shtesë në vlerësimin doganor të mallrave me origjinë nga vendet jashtë BE/NEU”, pasi indikatorët e vlerës egzistojnë për përlyhurat si produkt i përfunduar.

Nga ana e operatorit janë depozituar dokumentat shtesë, justifikues për vlerën e transaktuara si: Transfertat Bankare të likuidimeve dhe Deklaratat e Eksportit të cilat ndodhen bashkëlidhur praktikave doganore.

Aneksi nr. 4.34 Për deklaratat që i përkasin importit të artikullit “pëlhurë” deklaruar në kreun *54 dhe 60*, DD Tiranë ka dalë me vendimet nr. 290/2024; 281/2024 dhe 291/2024 për praktikatat doganore të subjektit “D” me NIPT M. në shumën 197,213 lekë.

Për praktikatat doganore të subjektit F.” me NIPT L., DD Tiranë ka marrë vendimin nr. 399, datë 05.08.2025, në shumën 24,505 lekë; për N. me NIPT L. ka marrë vendimin nr. 415, datë 06.08.2025, në shumën 13,592 lekë. Për praktikën doganore R61782 të subjektit “D” me NIPT K. është vjelë detyrimi doganor sipas rekomandimit të KLSH, në shumën 15,400 lekë me anë të ndërhyrjes aposteriori.

Ndërsa në lidhje me praktikën 90525 të subjektit “M” me NIPT L., nga verifikimi rezultoi se ka mbetje nga procesi i prodhimit pas përpunimit nën RPA. Për deklaratat doganore R 115042 dhe 120548 të subjektit “N.” me NIPT J., DD Tiranë nuk ka dalë me vendimmarrje.

Aneksi nr. 4.35 DD Tiranë ka dalë me vendimmarrje për rivlerësim për 78 deklarata doganore me vlerën 4,618,957 lekë. Për rastet e tjera nuk ka vendimmarrje.

Me shkresën nr. 3860 prot., datë 19.05.2025 DD Tiranë i ka dërguar kërkesën për verifikim DOH dhe DIARM në DPD, për importet e kryera nga subjekti “E” PF, për artikujt të ndryshëm ushqimor.

Aneksi nr. 4.36 Për deklaratat që i përkasin importit të artikullit “mbulose krevati/jorgan” deklaruar në kreun *94*, duhet të aplikohet vlera 660 lekë/kg CIF, sipas Urdhrit nr. 779 prot., datë 16.01.2013, të Drejtorit të Përgjithshëm të Doganave “Mbi rishikimin e disa indikatorëve kontrolli shtesë në vlerësimin doganor të mallrave me origjinë nga vendet jashtë BE/NEU”, nuk ekziston asnjë indikator vlere për artikullin “jorgan”, por specifikohet se vlera prej 660 lekë/kg CIF duhet të aplikohet për artikujt të kreut 6302 (batanije) dhe jo për kapitullin *94. Për sa më sipër DD Tiranë nuk ka dalë me vendimmarrje.

Aneksi nr. 4.37 Për deklaratat që i përkasin importit të artikullit “shtupa” deklaruar në kreun *9603 për subjektin “M” me NIPT K., duhet të aplikohet vlera 5.5 USD/kg sipas vlerave që gjenden në Dosjen e të Dhënave të Disponueshme. Në Dosjen e të Dhënave të Disponueshme nuk ekziston asnjë vlerë referuese për artikullin “shtupa me mikrofiber” deklaruar në kreun *9603, por egziston vlera 5.5 USD/kg për artikullin peceta mikrofibër në kapitullin 63, deklaruar në kreun *9603. Për sa më sipër DD Tiranë nuk ka dalë me vendimmarrje.

Aneksi nr. 4.38 për deklaratat që i përkasin importit të artikullit “flokë/thonj fallco” deklaruar në kreun *6704 për subjektin “P” me NIPT L., duhet të aplikohet vlera 7 USD/kg. Në Dosjen e të Dhënave të Disponueshme nuk ekziston asnjë vlerë referuese për artikullin “flokë/thonj fallco”, por në Database Kombëtar të Vlerësimit rezulton se vlerat e deklaruara nga subjekti, përkojnë me vlerat e deklaruara nga operatorët e tjerë nga i njëjti vend origjine. DD Tiranë nuk ka dalë me vendimmarrje.

Për deklaratat doganore R5836 dhe 6620 të subjektit “G” me NIPT K. Ndërsa për praktikatat e

tabelës së mëposhtme është ndërhyrë nga personeli i SVQ sipas vlerës 4.1 USD/kg në momentin e pranimit të deklaratës doganore.

Për deklaratat doganore R134795 dhe R64065 të subjektit “I” me NIPT M. Ndërsa për praktikatat e tabelës së mëposhtme është ndërhyrë nga personeli i SVQ sipas vlerës 4.1 USD/kg në momentin e pranimit të deklaratës doganore.

Për deklaratat doganore R1567 dhe R5578 të subjektit “K” me NIPT K. nga verifikimi rezulton se vlera e deklaruar është më e lartë se vlera referuese 4.1 USD/kg.

Me shkresën nr. 6644/1 prot., datë 13.05.2025, DTO në DPD i ka kthyer përgjigje shkresës nr. 2426, datë 28.03.2025 të DD Tiranë, mbi klasifikimin tarifor për artikullin “thonj plastik fallco dhe maja plastike për thonj”, klasifikimi i të cilit në këtë rast, përcaktohet nga Regulli i Përgjithshëm Interpretues 1 dhe 6 i NKM-së, si dhe në përshkrimin e kodit tarifor 39264000.

Aneksi nr. 4.38 DD Tiranë ka dalë me vendimmarrje për rivlerësim për 6 deklarata doganore me vlerën 193,118 lekë.

Aneksi nr. 4.39 Për deklaratat që i përkasin importit të artikujve “membrane” të klasifikuar në Kapitullin 69, për subjektin “E” dhe “I” u verifikua dokumentacioni bashkëlidhur praktikave doganore. Në zbatim të rekomandimeve të lëna, janë dërguar për verifikim pranë autoriteteve doganore homologe:

- me shkresën Nr.10136 Prot., datë 28.10.2022, pranë Departamentit Operativ Hetimor praktikatat doganore R 60588, datë 29.06.2021, R 104529, datë 26.10.2021 dhe R 118882, datë 03.12.2021, me importues Subjektin “E”, sipas shkresës Nr.22037/1 Prot., datë 30.12.2022, nga DOH është konfirmuar rregullsia e transaksioneve të deklaruara në dokumentacionin shoqërues të këtyre deklaratave,

- me shkresën Nr.10135 Prot., datë 28.10.2022, janë dërguar për verifikim pranë Departamentit Operativ Hetimor praktikatat doganore R 104273, datë 26.10.2021, R 106539, datë 01.11.2021 dhe R 112528, datë 13.12.2021, me importues Subjektin “I”, sipas shkresës Nr.22119/2 Prot., datë 11.01.2023, nga DOH është konfirmuar rregullsia e transaksioneve të deklaruara në dokumentacionin shoqërues të këtyre deklaratave,

- me shkresën Nr.10137 Prot., datë 28.10.2022, janë dërguar për verifikim pranë Departamentit Operativ Hetimor praktikatat doganore R 100880, datë 18.10.2021, R 107732, datë 04.11.2021 dhe R 84886, datë 04.09.2021, me importues Subjektin “M”. Për sa më sipër, në varësi të konfirmimeve nga autoritetet doganore homologe të transaksioneve të kryera për praktikatat e tjera të dërguara për verifikim, do të rishikohen edhe detyrimet e rillogaritura në Tabelën 41 për artikullin “membrane bituminoze”. Nga verifikimi i dokumentacionit bashkëngjitur rezulton se çmimet e deklaruara janë në të njëjtin nivel me të dhënat e bursës. DD Tiranë nuk ka dalë me vendimmarrje.

Aneksi nr. 4.40 Për deklaratat që i përkasin importit të artikujve “llamarinë” të klasifikuar në Kapitullin 72, për subjektin “N” me NIPT K., faturat shoqëruese përmbajnë informacion të plotë e të detajuar për çmimet e mallit, nga ana e importuesit është depozituar dokumentacion shtesë për të vërtetuar vlerën e transaksionit. Vlerat e deklaruar janë në përputhje me vlerat e buletinit të bursës për periudhën në fjalë. DD Tiranë nuk ka dalë me vendimmarrje.

Aneksi nr. 4.41 -Për deklaratat që i përkasin importit të artikullit “artikuj metalik”, R107165 të vitit 2022 e cila i përket subjektit “G” me NIPT L. rivlerësimi nuk qëndron pasi nga verifikimi i dokumentacionit bashkëngjitur rezulton se artikulli i deklaruar është profil metalik për mbajtjen e pllakave të gipsit. Vlera e deklaruar është mbi vlerën e të dhënave të bursës për periudhën në fjalë. Me shkresën nr. 1024/27 prot., datë 12.09.2025 DD Tiranë i ka dërguar kërkesën për verifikim DOH dhe DIARM në DPD, për importet e kryera nga subjekti “G”, për artikujt “bojra dhe

materiale ndërtimi”.

-Për deklaratën doganore R98566 të vitit 2022 e cila i përket subjektit “A” me NIPT L. rivlerësimi nuk qëndron pasi lloji i monedhës së deklaruar është GBP dhe si rrjedhojë e diferencave në kursin e këmbimit ndërmjet monedhës Euro dhe GBP nuk ka vend për rivlerësim.

Për deklaratën doganore R94630; R64607 dhe R20575 të vitit 2022, e cila i përket subjektit “M” me NIPT K.; Për deklaratat doganore R117377; R29803 dhe R92588 të vitit 2022, e cila i përket subjektit “D” me NIPT K.; Për deklaratën doganore R20173 të vitit 2023, e cila i përket subjektit “P” me NIPT J., rivlerësimi nuk qëndron pasi nga verifikimi i dokumentacionit bashkëngjitur, rezulton se artikulli i deklaruar është tel për susta dhe jo susta të gatshme. Vlera e deklaruar është mbi vlerën e të dhënave të bursës për periudhën në fjalë.

Për deklaratat doganore R55143 dhe R110000 të vitit 2023 e cila i përket subjektit “E” me NIPT K. rivlerësimi nuk qëndron pasi nga verifikimi i dokumentacionit bashkëngjitur rezulton se artikulli i deklaruar është shina për vagonat e minierave. Vlera e deklaruar është mbi vlerën e të dhënave të bursës për periudhën në fjalë.

Për deklaratat e mësipërme DD Tiranë nuk ka dalë me vendimmarrje.

Për deklaratën doganore R54207 të vitit 2022 e cila i përket subjektit “A” me NIPT L. është vjelë detyrimi nga ndërhyrja e aposteriorit sipas rekomandimit të KLSH.

Për deklaratën doganore R74466 të vitit 2022 e cila i përket subjektit “T” me NIPT L. është vjelë detyrimi nga ndërhyrja e aposteriorit sipas rekomandimit të KLSH.

Aneksi nr. 4.42 -Për deklaratat që i përkasin importit të artikullit “artikuj metalik, mbajtëse metalike, punto të përdorurua”, të subjektit “E” me NIPT L. është vjelë detyrimi nga ndërhyrja e aposteriorit sipas rekomandimit të KLSH;

-Për deklaratat doganore të subjektit “E” me NIPT K. dhe “I” me NIPT L. është vjelë detyrimi nga ndërhyrja e aposteriorit sipas rekomandimit të KLSH;

Për deklaratat doganore të subjektit “S” me NIPT K. është vjelë detyrimi nga ndërhyrja e aposteriorit sipas rekomandimit të KLSH;

-Për deklaratën doganore R1687 dt. 13.01.2022 të cilat i përket subjektit “Q” me NIPT K. me të cilën ka deklaruar artikullin “lopata”, nga verifikimi rezulton se vlera e deklaruar nga subjekti është sipas vlerave që gjenden në Dosjen e të Dhënave të Disponueshme për artikullin “lopata” deklaruar në kreun 8201.

-Për deklaratat doganore që i përkasin subjektit “I” me NIPT L. janë trajtuar në Aneksin 4.71 për të cilat janë mbajtur proceverbale për rivlerësim dhe për keqklasifikim tarifor të artikullit “mbajtëse metalike”, për 20 deklarata doganore në vlerën 143,203 lekë.

-Për deklaratat që i përkasin importit të artikullit “punto të përdorurua” të cilat i përkasin subjekti “F” me NIPT M., u krye verifikimi nga Grupi i Punës dhe rezultoi se llogaritjet e kryera nga KLSH kanë gabime në llogaritje, nga rillgoritja rezultuan detyrime shtesë në shumat: R 109630 DT.21.10.2022 – 28,916 lekë; R 110017 DT.22.10.2022 – 13,525 leke; R 109141 DT.20.10.2022 – 132,177 leke. Sipas vlerave të rillogaritura u mbajtën aktet përkatëse për vjeljen e detyrimit doganor.

-Për deklaratat që i përkasin importit të artikullit “punto të përdorurua” të cilat i përkasin subjekti “S” me NIPT K., u krye verifikimi nga Grupi i Punës dhe rezultoi se llogaritjet e kryera nga KLSH kanë gabime në llogaritje, nga rillgoritja rezultuan detyrime shtesë në shumën: R 64988 DT.27.06.2023 – 11,627 lekë;. Sipas vlerave të rillogaritura u mbajtën aktet përkatëse për vjeljen e detyrimit doganor.

Aneksi nr. 4.43 Për deklaratat doganore R86787; R86215 dhe 86786 të subjektit “M” me NIPT K., DD Tiranë doli me vendimmarrje në vlerën totale 56,380 lekë;

Për deklaratat që i përkasin importit të artikullit “vida; gozhdë; etj”, deklaruar nga subjekti “K” me NIPT L. është vjelë detyrimi nga ndërhyrja e aposteriorit;

Ndërsa, për deklaratat doganore të subjekteve “M” me NIPT K.; “K” me NIPT L.; “A” me NIPT M.; “C” me NIPT M.; “A” me NIPT L.; “K” me NIPT K.; “N” me NIPT L.; “R” me NIPT K.; “A”SHPK me NIPT L.; “L” me NIPT L., rivleresimi nuk qendron, vlera e deklaruar është ne përputhje me te dhenat e burses;

Për deklaratat doganore të “E” me NIPT M.; “L” me NIPT K.; “D”SHPK me NIPT L.; “M” me NIPT K.; u krye verifikimi nga Grupi i Punës dhe rezultoi se vlerat e deklaruara jane sipas publikimeve të buletinit “Metal Bulletini” të miratuara nga DPD.

Aneksi nr. 4.44 Për deklaratat të artikullit “artikuj bakri”, R73238 e subjektit “F” me NIPT L. është vjelë detyrimi nga ndërhyrja e aposteriorit.

Ndërsa, për deklaratat e subjektit “E” me NIPT L.; “P” NIPT K., u krye verifikimi nga Grupi i Punës dhe rezultoi se artikulli i deklaruar nuk është “artiikuj bakri” por janë artikuj bronzi, DD Tiranë nuk ka dalë me vendimmarrje.

Aneksi nr. 4.45 Për deklaratat që i përkasin importit të artikullit “artikuj alumini”, deklaruar në kapitullin 76 ju sqarojmë se: Për deklaratat e subjekti “S” me NIPT J., DD Tiranë ka dalë me vendimmarrje për vlerën totale 144,755 lekë;

Ndërsa, për deklaratat e artikullit “alukobond dhe vasketa alumini” të subjekteve “A” me NIPT J.; “R” me NIPT K.; “E” me NIPT K., vlerësimi është kryer bazuar në nenin 66 të Ligjit 102/2014 “KD”, është pranuar transaksioni si vlerë doganore. Në Dosjen e të Dhënave të Disponueshme nuk egzistojnë vlera referuese për artikullin “alukobond”, si rrjedhim nuk mund të përdoret vlera prej 2.7 euro/kg edhe për faktin që ky artikull vlerësohet sipas sipërfaqes në m2, sipas vlerave referuese për m/2 që gjenden në Dosjen e të Dhënave të Disponueshme (panelet alumini).

Për deklaratën doganore R7526 e të subjektit “2” me NIPT L. nga verifikimi rezulton se vlera totale e artikujve te deklaruar është më e lartë nga vlera e të Dhënave të Disponueshme. Për artikullin “shkallë alumini” deklaruar me R81984 e subjektit “P” me NIPT K. nga verifikimi rezulton se vlera totale e artikujve te deklaruar është më e lartë nga vlera e të Dhënave të Disponueshme.

Aneksi nr. 4.46 Për deklaratat që i përkasin importit të artikullit “artikuj metalik”, deklaruar në kapitullin 73, R60589 të subjektit “A” me NIPT L. dhe R1048 A., me NIPT L. nga verifikimi rezulton se artikujt e deklaruar janë të përdorur.

Për deklaratat doganore R107966; R29636; R78466; R37619; R101360 e cila i përket subjektit E K. dhe R96324 e subjektit F. L. nga verifikimi rezulton se totali i vlerës së deklaruar është më e lartë se të dhënat e disponueshme.

Për deklaratat doganore R128127 dhe 12504 te subjektit I.K. nga verifikimi rezulton se artikulli i deklaruar është “Varese rrobash, prift”, observacion nga subjekti, artikulli me bazament mermeri, rivleresimi nuk qendron.

Ndërsa, për deklaratën doganore R112504 e subjektit P. L. nga verifikimi rezulton se rivleresimi i kryer nga SVQ, është aplikuar vleresimi 0.7 euro/kg. DD Tiranë ka dalë me vendimmarrje për vlerën totale 153,232 lekë.

Me shkresën nr. 4218/1 prot., datë 20.03.2025 DTO në DPD, i ka kthyer përgjigje shkresës nr. 1611 prot., datë 03.03.2025 të DD Tiranë, mbi klasifikimin tarifor për artikullin “varëse rrobash plastike”, sipas të cilës

Aneksi nr. 4.47 Për deklaratat që i përkasin importit të artikullit “*makineri, etj*”, DD Tiranë ka dalë me 108 vendime për vlerën totale 2,784,784 lekë.

Për deklaratën doganore R50106 të vitit 2022 e subjektit “B” me NIPT L. është vjelë detyrimi nga

ndërhyrja e aposteriorit sipas rekomandimit të KLSH.

Për deklaratat doganore R133820; R132419 dhe 111707 të vitit 2022 e subjekteve “R” dhe “R” është vjelë detyrimi nga ndërhyrja e aposteriorit sipas rekomandimit të KLSH. Ndërsa për rastet e mëposhtme nuk dalë me vendimmarrje:

Për deklaratën doganore R86423 të vitit 2023 e subjektit “6” me NIPT K., nga verifikimi rezulton artikulli “rrul i përdorur” që përdoret në ngjeshje e rrugëve dhe nga personeli i SVQ është përdorur metoda 3 e rivlerësimit sipas artikujve të ngjashëm.

Për deklaratën doganore R89202 të vitit 2023 e subjektit “D” me NIPT M., rivlerësimi nuk qëndron pasi lloji i monedhës së deklaruar është GBP dhe si rrjedhojë e diferencave në kursin e këmbimit ndërmjet monedhes euro dhe GBP nuk ka vend për rivlerësim.

Për deklaratat doganore R135227 dhe R91873 të vitit 2022 e t subjektit “L” me NIPT L., nga verifikimi rezulton se për artikullin “elektroshtëpiake të përdoruara” e nga personeli i SVQ është përdorur metoda e rivlerësimit, duke i rivlerësuar artikujt me 40% të vlerës së artikujve të rinj.

Për deklaratën doganore R107617 të vitit 2023 e subjektit “R” me NIPT L., rivlerësimi nuk qëndron pasi lloji i monedhës së deklaruar është GBP.

Për deklaratën doganore R15457 të vitit 2022 e subjektit “S” me NIPT L., rivlerësimi nuk qëndron pasi vlera e deklaruar është më e lartë se vlera 0.7 euro/kg.

Për deklaratat doganore R90190; R93483 dhe R90188 të vitit 2023 e subjektit “V” me NIPT J., rivlerësimi nuk qëndron pasi lloji i monedhës së deklaruar është GBP.

Aneksi nr. 4.48 Për deklaratat që i përkasin importit të artikullit “*pjesë kembimi për automjete*” të klasifikuar në Kapitullin 8708, DD Tiranë ka dalë me 19 vendime për vlerën totale 1,172,704 lekë.

Nuk janë mbajtur vendime vetëm në 2 raste:

Për DAV R85842 e subjektit “K” me NIPT J. nga verifikimi i deklaratës rezulton se kemi të bëjmë me gabim në deklarim nga ana e përfaqësuesit të subjektit, nga ana jonë u krye amendimi aposteriori i kësaj deklarate, mbas amendimit nuk ka vend për rivlerësim.

Për DAV R12666 e subjektit “V” p.f. me NIPT L. rezulton se nga ana e personeli doganor në momentin e deklarimit është kryer rivlerësimi i artikullit të deklaruar me vlerën 1.8 euro/kg. Nga ana e subjektit ky rivlerësim është ankimuar dhe si rrjedhim në vijim të vendimit të gjykatës në favor të subjektit është kryer rimbursimi i shumës së paguar shtesë.

Sipas shkresës nr. 20980/3 prot., datë 30.12.2022, Drejtoria e Buxhetit dhe e Financës në DPD, urdhëruar DD Tiranë, që të marrë masa për amendimin e deklaratës doganore R12666 datë 14.02.2022, në shumën 372,396 lekë, si dhe zbatimin e Vendimit nr. 2851, datë 31.10.2022 të GjASHP Tiranë, konfirmuar nga Drejtoria Juridike.

Për DAV R28619; R5699 dhe R5698 të vitit 2022 të subjektit “I” me NIPT L. rezulton se nga e personeli doganor në momentin ne deklarimi është kryer rivlerësimi i artikullit të deklaruar me vlerën 1.8 euro/kg. Lloji i monedhës së deklaruar është GBP dhe si rrjedhojë e diferencave në kursin e këmbimit ndërmjet monedhes euro dhe GBP nuk ka vend për rivlerësim.

Aneksi nr. 4.49-4.50 Në lidhje me gjetjet dhe konstatimet për subjektin “M” me NIPT J. për artikullin “pelena rifuxho” deklaruar në kapitullin *96*, nga ana e DVQ duke u nisur nga lloji i produktit është përdorur si bazë vlerësimi vlera 1 euro/kg. Në raste të mëparshme kur janë përdorur metoda alternative vlerësimi, DD Tiranë është detyruar nëpërmjet vendimeve të gjykatës të rimbursojë subjektin si psh për R 64904 dt. 27.08.2020; R 66651 dt. 02.09.2020; etj. Bashkëgjitur ju dërgohen urdhërat e rimbursimit 1833/3 Prot DPD dt. 02.04.2021 dhe 13344/1 Prot DPD dt. 30.07.2021 të Drejtorit të Përgjithshëm.

Aneksi nr. 4.52 Në lidhje me importet e artikullit “jastëk” për praktikat doganore R73223 të

subjektit H me NIPTK. dhe R82964 të subjektit I me NIPT L. është vjelë detyrimi doganor nga ndërhyrja e aposteriori pas dakordësimit të deklaruesit. Për rastet e tjera, DD Tiranë ka dalë me vendime në shumën 252,180 lekë.

Aneksi nr. 4.53 Në lidhje me importet e artikullit “lodra” nga ana e DD Tiranë janë mbajtur vendime për rikupërim të detyrimit doganor në vlerën 160,385 lekë.

Ndërsa për importet e subjektit “E” me NIPT K., nga verifikimi rezulton se artikulli është lodër plastike e mbushur me ujë që përdoret për të krijuar flluska sapuni për argëtim.

Aneksi nr. 4.55 Në lidhje me gjetjet dhe konstatimet për subjektin “D” me NIPT L. për artikullin “vaj ushqimor” DD Tiranë ka dalë me 80 vendime, për detyrimet doganore në shumën 1,969,253 lekë dhe gjobë në shumën 3,938,556 lekë të praktikave doganore të periudhës deri më dt. 28.04.2023, kohë në të cilën ka dalë Udhëzimi nr. 12, datë 28.04.2023 i Ministrisë së Financave.

Për praktikat doganore të kryera mbas datës 28.04.2023, pasi sipas të dhënave të dokumentacionit shoqërues (specifikimeve në listë ngarkesat shoqëruese të mallit), si dhe verifikimeve fizike (kontrollit fizik të kreyer nga doganierët e kontrollit fizik) pesha që zë ambalazhi plastik nuk e kalon kufirin 50% të masës së përgjithshme të ambalazhit që ambalazhon produktin, DD Tiranë nuk doli me vendimmarrje.

Aneksi nr. 4.56 Në lidhje me gjetjet dhe konstatimet për artikullin “paste dhembesh” ku operatori ekonomik nuk rezulton të keta paguar taksën e ambalazhit për pjesën plastike “*të tubetit dhe tapës*” për subjektin R me NIPT K. ka marrë vendime për detyrime doganore në shumën 7,503 lekë dhe gjobë në shumën 15,006 lekë; për E me NIPT L. ka marrë vendime për detyrime doganore në shumën 8,542 lekë dhe gjobë në shumën 17,084 lekë; për S me NIPT K. ka marrë vendime për detyrime doganore në shumën 6,684 lekë dhe gjobë në shumën 13,368 lekë; për I me NIPT L. ka marrë vendim për detyrime doganore në shumën 1,890 lekë dhe gjobë në shumën 3,780 lekë; për K. me NIPT K.V ka marrë vendim për detyrime doganore në shumën 7,359 lekë dhe gjobë në shumën 14,717 lekë; për M me NIPT K. ka marrë vendim për detyrime doganore në shumën 23,479 lekë dhe gjobë në shumën 46,958 lekë; për B me NIPT K. ka marrë 1 vendim për detyrime doganore në shumën 1,680 lekë dhe gjobë në shumën 3,360 lekë; për F me NIPT K. ka marrë vendime për detyrime doganore në shumën 40,723 lekë dhe gjobë në shumën 81,446 lekë; për D me NIPT M. ka marrë vendim për detyrime doganore në shumën 15,337 lekë dhe gjobë në shumën 30,675 lekë; për N. me NIPT K. ka marrë vendime për detyrime doganore në shumën 479,308 lekë dhe gjobë në shumën 958,616 lekë; në total detyrime doganore dhe gjobë në shumën 1,203,376 lekë.

Aneksi nr. 4.57 Në lidhje me gjetjet dhe konstatimet për subjektin “I” me NIPT J. për artikullin “pastë dhëmbësh” DD Tirane nuk ka dale me vendimmarrje pasi, pesha e ambalazhit total për paketim 12 copë është diferenca ndërmjet peshës bruto dhe peshës neto, e cila në rastin konkret rezulton 387 gr. Pesha që zë materiali plastik në këtë ambalazh është 95.40 gr dhe në përqindje rezulton 24.7%. Si konkluzion, ambalazhet e produkteve “Pastë Dhëmbësh” kanë material plastik por pesha e materialit plastik në çdo rast në raport me peshën e ambalazhit total të produkteve është ndjeshëm nën 51%. Pra, për asnjë nga produktet “Pastë Dhëmbësh” që importohen nga subjekti “I” sh.p.k. nuk biem nën zbatimin e taksës së ambalazhit plastik sipas përcaktimeve të Ligjit dhe Udhëzimit për Taksat Kombëtare.

Aneksi nr. 4.58 Në lidhje me importet e artikullit “kafe në kapsula”, DD Tiranë pas verifikimit të praktikave doganore ka dalë me vendime për subjektet: B. SHPK, A., N, E për detyrime TAM në shumën 498,456 dhe gjobë në shumën 498,56 lekë, total 996,912 lekë.

Aneksi nr. 4.59 Në lidhje me importet e artikullit “membrane bituminoze” ku konstatohet se kemi të bëjmë me deklarim të gabuar të llojit të ambalazhit plastik, DD Tiranë ka dalë me vendimmarrje.

Ndërsa për rastet e mëposhtme: DD Tiranë nuk ka dalë me vendimmarrje në rastet e importeve të subjektit “F” me NIPT L. pasi nga verifikimi i dokumentacionit bashkëngjitur deklaratës doganore artikulli i deklaruar është “*Laminat plastic PVC*” i cili klasifikohet tek: *përshatjet për mobilieritë dhe kodin 3926 90 97 -- të tjera.*

DD Tiranë nuk ka dalë me vendimmarrje në rastet e importeve të subjektit “I” me NIPT L. pasi nga verifikimi i dokumentacionit bashkëngjitur deklaratës doganore të cilat citohen në Raportin Përfundimtar të Kontrollit të Lartë të Shtetit nr. 10738/27 Prot. DD Tirane datë 13.01.2025 vërehet se nga ana e Drejtorisë Rajonale Tatimore Elbasan për subjektin “I” SHPK me NIPT L. janë lëshuar autorizimet nr 6792/1 Prot dt. 17.09.2021; nr 6792/1 Prot. Dt. 17.09.2021; nr 1690/3 Prot dt. 06.03.2025 dhe 1690/2 Prot dt. 05.03.2025 për përjashtimin e taksës 35 lekë/kg për artikuj “membrana PVC” në kodin tarifor 39204390; “shkarkues PVC” në kodin tarifor 39219090; “shirit PVC ëaterstop” në kodin tarifor 39259010; “membrana PVC” në kodin tarifor 39204390 dhe “shkarkues rakorderi PVC” në kodin tarifor 39219060.

Për sa më sipër duke qënë se Drejtoria Rajonale Tatimore Elbasan është autoriteti që ka lëshuar autorizimet e mësipërme për përjashtimin e taksës 35 lekë/kg në import, me anë të shkresës nr. 3983 prot., datë 23.05.2025, DD Tiranë ka kërkuar për ndjekje të mëtejshme DRT Elbasan, për verifikim artikujt e importuar nga subjekti “I” SHPK me NIPT L. me deklaratat doganore.

Aneksi nr. 4.60 Në lidhje me importet e artikullit “Tubplastik/njepërdorim/veno/ambalazh” të Aneksit 4.60 të subjektit “E” me NIPT L. ku konstatohet se kemi të bëjmë me deklaram të gabuar të llojit të ambalazhit plastik, sqarojmë se janë artikuj me karakter spitalor dhe klasifikohen në kreun 9018 dhe jo në kapitullin 39, si rrjedhim nuk paguajnë taksë plastike.

Aneksi nr. 4.62 Në lidhje me importet e artikullit “qumësht i kondensuar” trajtuar në faqet 451 - 452 të Aneksit 4.62 të subjektit “I” sh.p.k me NIPT K. ku konstatohet se kemi të bëjmë me keqklasifikim tarifor me pasojë shmangien e pagesës së taksës së qumështit pluhur QPL. Sqarojmë se, klasifikimi i produktit “Qumësht i kondensuar” në kodin tarifor 04049083 të NKM-së, i importuar nga subjekti “I” sh.p.k mendojmë se është i saktë referuar përbërësve dhe përmbajtjes së tij.

Produkti “Qumësht i kondensuar” që importohet nga subjekti “I” sh.p.k. nën kodin tarifor 04049083 të NKM-së ka qënë dhe vijon të mbetet i pandryshuar, pavarësisht ndryshimit të ligjit. Si konkluzion, për produktin “Qumësht i kondensuar” në kodin tarifor 04049083 të NKM-së, i importuar nga subjekti “I” sh.p.k.:

1. klasifikimi i këtij produkti në kodin tarifor 04049083 të NKM-së mendojmë se është i saktë, referuar përbërësve dhe përmbajtjes së produktit, si dhe dokumenteve Certifikatë Origjine dhe Deklaratë Eksporti dërguar nga furnitori/eksportuesi;
2. klasifikimi i këtij produkti në kodin tarifor 04049083 të NKM-së është bërë shumë vite përpara ndryshimit të ligjit për taksat kombëtare, ligj i cili ka hyrë në fuqi nga data 05.01.2022 dhe ky klasifikim vijon të jetë i pandryshuar edhe sot;
3. kodi tarifor 04049083 i NKM-së nuk përfshihet në asnjë nga kategoritë e përcaktuara në ligj për të cilat aplikohet taksë kombëtare.

Aneksi nr. 4.63 Në lidhje me importet e artikullit “hirrë dhe protein hirre” trajtuar në faqen 452 të Aneksit 4.63 ku konstatohet se kemi të bëjmë me keqklasifikim tarifor me pasojë shmangien e pagesës së taksës së qumështit pluhur QPL, Ju sqarojmë se: Referuar përberjes dhe bazuar në standartet nderkombetare të vendosura, produkti i mesipërm nuk është qumesht pluhur, por përzierje në trajte pluhuri e nenprodukteve të qumeshtit.

Keto produkte janë përzierje mekanike të përfutuara nga procesi i bashkimit mekanik në blender (miksera) i nenprodukteve të ndryshme me baze hire, qumeshti pluhur, yndyre qumeshti apo shtesa

te tjera ushqimore dhe për rrjedhojë nuk klasifikohen qumesht pluhur.

Bazuar në standartet ndërkombëtare produkti konsiderohet “qumesht pluhur” vetëm kur përftohet nga procesi i tharjes së qumeshtit të freskët të pastëruar, i papërziera dhe pa asnjë lloj shtese apo ndërhyrje me nënprodukte të tjera ushqimore, qofshin keto me baze shtazore apo bimore para, gjatë apo mbas procesit të tharjes.

Aneksi nr. 4.64 Në lidhje me importet e artikullit “Diafragme Derri” i klasifikuar në kodin tarifor “02064900” dhe në kreun “0206” është deklaruar si të brendshme duke mos paguar tarifën baze prej 10%, si rezultat i klasifikimit tarifor jo të sakte, ju sqarojmë se:

Nga ana jonë me anë të shkresës nr. 1652 prot., DD Tiranë datë 28.02.2025 i është kërkuar Drejtorisë së Tarifës dhe Origjinës kërkesë për interpretim dhe saktësim të klasifikimit tarifor të artikullit “diafragmë derri”.

Drejtoria e Tarifës dhe Origjinës ka kthyer përgjigje me shkresën nr. 4213/1 prot., DPD datë 25.03.2025 sipas së cilës diafragma e dërrit klasifikohet në kreun 0206.

- Në kodin tarifor 0206 30 00 nëse është e freskët apo e ftohtë.
- Në kodin tarifor 0206 49 00 nëse është në gjendje të ngrirë.

Gjithashtu nga ana jonë me anë të shkresës nr 10738/24 prot., DD Tirane datë 08.07.2024 i është propozuar DOH, profili i riskut për marrje mostrash për analizim laboratorik me qëllim saktësimin e klasifikimit tarifor për këtë artikull. Bashkëngjitur ju dërgohet shkresa nr. 4213/1 prot DPD datë 25.03.2025 e Drejtorisë së Tarifës dhe Origjinës dhe shkresa e DD Tiranë me nr. 10738/24 Prot DD Tiranë datë 08.07.2024 për propozim për profil risku për artikullin “diafragmë derri”.

Aneksi nr. 4.65 Në lidhje me importet e artikullit “ushqim për qen dhe mace” ju sqarojmë se, DD Tiranë pas verifikimit të praktikave doganore ka dalë me vendime në shumën 2,754,099 lekë detyrime doganore dhe 2,754,099 lekë gjobë, në shumë totale 5,508,198 lekë.

Aneksi nr. 4.66 Në lidhje me importet e artikullit “ushqim për qen dhe mace” ju sqarojmë se, DD Tiranë pas verifikimit të praktikave doganore ka dalë me vendime në shumën 136,208 lekë detyrime doganore dhe 136,208 lekë gjobë, në total 272,416 lekë.

Aneksi nr. 4.67 Në lidhje me importet e artikullit “aksesore mobilje dhe shezlon”, sqarojmë se keqklasifikimi nuk qëndron.

Aneksi nr. 4.69 Për deklaratat R112179; R129654 dhe që i përkasin importit të artikullit “*kuti matesa uji*” të klasifikuar në kodin tarifor 39269097, ju sqarojmë se: këto deklarata importe janë kryer nga BE dhe kodi tarifor i deklaruar në deklaratën e importit përputhet me kodin tarifor në deklaratën e eksportit dhe në faturën tregtare.

Gjithashtu klasifikimi për këtë artikull është përcaktuar në përputhje me Rregullat e përgjithshme të interpretuara (GIR) dhe Shënimi i Përgjithshëm i për Seksionin XVI.

Për R51565 që i përkasin importit të artikullit “*qese urine*” të klasifikuar në kodin tarifor 39269097, nuk kemi të bëjmë me keqklasifikim kemi të bëjmë me artikuj spitalor dhe ky artikull shërben si çantë mbledhëse prej PVC me shënime për matjen e vëllimit.

Për R37514; 123 dhe 33504 që i përkasin importit të artikullit “*artikuj laboratorik për analiza*” të klasifikuar në kodin tarifor 39269097, sqarojmë se është përcaktuar në përputhje me Rregullat e përgjithshme të interpretuara (GIR) dhe Shënimi i Përgjithshëm i për Seksionin XVI.

Për 110640; 128480 që i përkasin importit të artikullit “*artikuj laboratorik për analiza*” të klasifikuar në kodin tarifor 39269097, sqarojmë se është përcaktuar në përputhje me Rregullat e përgjithshme të interpretuara (GIR) dhe Shënimi i Përgjithshëm i për Seksionin XVI.

Për R35293 që i përkasin importit të artikullit “*kellef telefonash*” të klasifikuar në kodin tarifor 39269097, sqarojmë se është përcaktuar në përputhje me Rregullat e përgjithshme të interpretuara (GIR) dhe Shënimi i Përgjithshëm i për Seksionin XVI.

Për 110640; 128480 dhe R10397; R3001 që i përkasin importit të artikullit “*artikuj laboratorik për analiza*” të klasifikuar në kodin tarifor 39269097, sqarojme se është përcaktuar në përputhje me Rregullat e përgjithshme të interpretuara (GIR) dhe Shënimi i Përgjithshëm i për Seksionin XVI.

Për R 74663 datë 20.07.2023 dhe R59834 që i përkasin importit të artikullit “*vazo lulesh*”, si dhe për R46249 dt. 13.05.2022 dhe R74663 dt. 20.07.2023 që i përkasin importit të artikullit “*kosha plastike*” të klasifikuar në kodin tarifor 39269097 sqarojmë se,

Me shkresën nr. 2581 prot., DD Tiranë datë 03.04.2025 i është kërkuar Drejtorisë së Tarifës dhe Origjinës kërkesë për interpretim në lidhje me klasifikimin në artikullit “*vazo plastike për lule*”. Drejtoria e Tarifës dhe Origjinës ka kthyer përgjigje me shkresën nr. 7286/1 prot DPD, datë 02.05.2025, vazo lulesh për ambjente të jashtme (për fidanë, etj) klasifikohet në kreun 3926. Nga verifikimi i deklaratave doganore rezulton se kemi të bëjmë me vazo lulesh për ambjente të jashtme, gjithashtu nga verifikimi i deklaratave doganore rezulton se kemi të bëjmë me kosha plastike për ambjente të jashtme.

Aneksi nr. 4.70 Për deklaratat doganore që i përkasin importit të artikullit “*sutura kirurgjikale/ngjitëse kirurgjikale*” të klasifikuar në kodin tarifor 30061010 dhe 30061090, ju sqarojmë se:

Për praktikat R111920 dhe R39621 të subjektit “E” me NIPT K. ka rezultuar se importet e këtij artikulli janë deklaruar në kodin tarifor 30061010 janë me vend eksporti dhe vend origjine nga India, kodi tarifor është i specifikuar në faturën tregtare. Praktika R111920 është profilizuar nga sistemi në kanal të kuq dhe kontrolli fizik konfirmon se artikulli është sipas deklaramit.

Për praktikat R100246 dhe R48234 të subjektit “M” me NIPT J.; R55618 dhe R82526 të subjektit “O” me NIPT K., nga verifikimi ka rezultuar se artikulli i importuar është “*pako ankografie sterile / penj kirurgjikal*” të deklaruar në kodin tarifor 30061090 dhe 30061010.

Aneksi nr. 4.71 Në lidhje me keqklasifikimin e artikujve të kapitullit “73”, të aneksit 4.71 të RPA, DD Tiranë ka dalë me vendimmarrje për detyrime doganore në shumën 435,950 lekë dhe gjobë në shumën 435,950 lekë, në total 871, 900 lekë, për artikujt “*kosha metalik*” dhe “*mbajtëse hekuri*”. Ndërsa në lidhje me klasifikimin e artikullit “*brryla/rakorderi dhe fllanxha*” ju sqarojmë se, Në përgjigje të konstatuar nga auditimi i KLSH-së dhe përkufizimit të përdorur nga autoriteti doganor mbi klasifikimin tarifor të artikullit “*bërila dhe mënga të pafiletuara*”, konsiderojmë se është bërë një interpretim i pasaktë dhe jo i përputhshëm me kriteret e Nomenklaturës së Kombinuar të Mallrave. Klasifikimi tarifor në kodin 7307 22 10 është i pasaktë dhe nuk merr parasysh natyrën teknike të artikullit, funksionin e tij të kufizuar si gjysmë-produkt, dhe kriteret e qarta të Nomenklaturës së Kombinuar.

Për artikullin “*gardh metalik*” klasifikohet në nënkreun 731420, si rrjedhim rekomandimi për keqklasifikim të artikullit “*gardh metalik*” nuk qëndron.

Në lidhje me klasifikimin e artikullit “*kafaze për zogj*”, rezulton se klasifikimi është në përputhje me klasifikimin në dokumentacionin shoqërues dhe NKM, praktikat janë përzgjedhur nga sistemi në kanalin “*e verdhë*” dhe “*kuq*” – për verifikim fizik, sipas shënimeve në “*aktin e kontrollit*” të deklaratave nga verifikimi fizik nuk janë konstatuar parregullsi me deklaramin.

Në lidhje me klasifikimin e artikullit shina”, të deklaruar në kreun 7302, rezulton se klasifikimi është në përputhje me klasifikimin në dokumentacionin shoqërues dhe NKM.

Aneksi nr. 4.72 Në lidhje me keqklasifikimin e artikujve “*ekrane me module dhe monitor me module interaktiv*” të aneksit 4.72 të RPA, DD Tiranë ka dalë me vendimmarrje.

Për R80597 të subjektit Q.; R 114468 të subjektit “B.” dhe R28641 të subjektit “T.” pas verifikimit artikulli i deklaruar rezulton i shoqëruar nga Certifikata e Lëvizjes së Lirë EUR 1 dhe si rrjedhim

përfiton trajtim tarifor preferencial me tarifë 0%.

Ndërsa në lidhje me klasifikimin tarifor të artikujve të deklaruar me deklaratat doganore të cituara në Aneksin 4.72 për të cilat DD Tiranë nuk ka dalë me vendimmarrje pasi nga verifikimi i dokumentacionit shoqërues rezulton se klasifikimi është në përputhje me klasifikimin në dokumentacionin shoqërues dhe NKM.

Aneksi nr. 4.75 Për deklaratat doganore që i përkasin importit të artikullit “vazeline” të klasifikuar kreun 2712, për subjektin ”E” me NIPT J. në lidhje me klasifikimin e këtij artikulli, DD Tiranë ka dalë me vendimmarrje për të gjitha rastet në shumën 112,320 lekë detyrime doganore dhe 112,320 lekë gjoba, në total 224,640 lekë.

Aneksi nr. 4.76 Në lidhje me keqklasifikimin e artikujve “graso dhe solucion korroziv” ju sqarojmë se DD Tiranë ka dalë me 15 vendime në vlerën totale 575,852 lekë për artikujt “spraj për vida”, “spraj /graso” dhe “vaj emulsion”.

Ndërsa në lidhje me klasifikimin tarifor të artikujve “solucion korrozi” të deklaruar me deklarata doganore të cituara në Aneksin 4.76 për të cilat DD Tiranë nuk ka dalë me vendimmarrje pasi nga verifikimi i dokumentacionit shoqërues rezulton se klasifikimi është në përputhje me klasifikimin në dokumentacionin shoqërues dhe NKM. Artikulli shërben për ftohje e makinerive metal preresë dhe jo për motorrat me djegje të brendshme si rrjedhim keqklasifikimi nuk qëndron.

Aneksi nr. 4.77 – 4.78 Në lidhje me keqklasifikimin e artikujve “aditiv” të trajtuar në faqen 461 - 462 të aneksit 4.76 të RPA, ju sqarojmë se:

Nga analizimi i kostatimit të Grupit të Auditimit të KLSH-së, shqyrtimit të dokumentacionit bashkangjitur praktikës doganore rezulton se është importuar nga Italia artikulli “Aditiv blu” klasifikuar në kodin tarifor 3811 me tarifë doganore 0%.

Referuar shënimeve shpjeguese të NKM-së, kodi tarifor 3811, 271019, si dhe referuar dokumentacionit shoqërues të mallit dhe shënimeve shpjeguese të NKM-ve artikulli “Aditiv blu” klasifikohet në kodin tarifor 38119000 pasi përdoren për pastrim nga ndryshku dhe nuk është produkt energjistik pasi nuk përdoret si karburante për motorët, lëndë djegëse.

Referuar ligji 61/2012 Neni 51, kompania disponon gjithë dokumentacionin e plote ligjor dhe që provon vertetesinë e deklaramit dhe klasifikimit tarifor.

Për sa më sipër, duke ju referuar dokumentacionit shoqërues të mallit ku kodi tarifor është vendosur në fature dhe deklarate eksporti si dhe shënimeve shpjeguese të NKM-ve .

Klasifikimi tarifor është konformë notave shpjeguese të NKM-ve dhe aktve ligjore në fuqi, dhe ky produkt “Aditiv blu” nuk përdoret si lubrifikant, nuk përdoret si lende djegës, për motorra apo si shtese në to, ndaj nuk lindin detyrime doganore shtesë.

Aneksi nr. 4.78 Në lidhje me keqklasifikimin e artikujve “spray/vajra të lehtë” të trajtuar në faqen 460 - 461 të aneksit 4.76 të RPA, ju sqarojmë se:

Dega Doganore Tiranë ka dalë me vendimmarrje (tabela e paraqitur) në lidhje me keqklasifikimin e artikujve “spray/vajra të lehtë” të Aneksit 4.76 të RPA DD Tiranë ka dalë me 5 vendimmarrje për detyrim doganore në shumën 471,799 lekë dhe gjobë në shumën 471,799 lekë, në total 943,598 lekë.

Ndërsa në lidhje me klasifikimin tarifor të artikujve “solucion korrozi” të deklaruar me deklarata doganore të cituara në Aneksin 4.78 për të cilat DD Tiranë nuk ka dalë me vendimmarrje pasi nga verifikimi i dokumentacionit shoqërues rezulton se klasifikimi është në përputhje me klasifikimin në dokumentacionin shoqërues dhe NKM.

Artikulli është deklaruar duke ju referuar dokumentacionit shoqërues të mallit ku kodi tarifor është vendosur në fature dhe deklarate eksporti si dhe shënimeve shpjeguese të NKM-ve .

Klasifikimi tarifor është konformë notave shpjeguese të NKM-ve dhe aktve ligjore në fuqi, ndaj

nuk linden detyrime doganore shitesë.

Aneksi nr. 4.79 Në lidhje me keqklasifikimin e artikujve “spray/vajra të lehtë” të trajtuar në faqen 462 - 463 të aneksit 4.79 të RPA, DD Tiranë ka dalë me vendimmarrje për detyrime doganore në shumën 1,163,178 lekë dhe gjoba në shumën 1,163,178 lekë, në total 2,326,356 lekë.

Ndërsa në lidhje me klasifikimin tarifor të artikujve “vaj” të deklaruar me deklaratat doganore të cituara në Aneksin 4.79 për të cilat DD Tiranë nuk ka dalë me vendimmarrje, pasi nga verifikimi i dokumentacionit shoqërues rezulton se klasifikimi është në përputhje me klasifikimin në dokumentacionin shoqërues dhe NKM. Artikulli është deklaruar duke ju referuar dokumentacionit shoqërues të mallit ku kodi tarifor është vendosur në fature dhe deklarate eksporti si dhe shënimeve shpjeguese të NKM-ve. Klasifikimi tarifor është konformë notave shpjeguese të NKM-ve dhe aktve ligjore në fuqi, ndaj nuk linden detyrime doganore shitesë.

Aneksi nr. 4.82 Në lidhje me vlerësimin e artikullit “pëlhurë polipropileni për thasë” deklaruar në kreun *5407* të kryera nga subjekti “G” shpk me NIPT K. të trajtuar në faqen 465 të RPA, Ju sqarojmë se:

Për deklaratat që i përkasin importit të artikullit “pëlhurë polipropileni për thasë” deklaruar në kreun *5407* të kryera nga subjekti “G”, të përmendura në faqen 4651 dhe Aneksin 7.82 të RPA, vlerësimi është kryer bazuar në nenin 66 të Ligjit 102/2014 “Kodi Doganor i Republikës së Shqipërisë”, datë 31.07.2014 si dhe pikës 4.1 të Udhëzimit të Ministrisë të Financave dhe Ekonomisë Nr. 3, dt. 23.01.2018 “Për vlerësimin e mallrave për qëllime doganore” është pranuar transaksioni si vlerë doganore.

Në këtë rast artikulli i deklaruar nuk është pëlhurë për veshmbathje por pëlhurë e thurur me fije polipropileni për thasë.

Nga ana e operatorit janë depozituar dokumentat shitesë, justifikues për vlerën e transaktuar si: Transfertat Bankare të likuidimeve dhe Deklaratat e Eksportit të cilat ndodhen bashkëlidhur praktikave doganore.

Me shkresën nr. 3459/1 prot., datë 05.05.2025, DD Tiranë i ka kërkuar DTO në DPD kërkesë për interpretim klasifikimi, për artikullin “shkallë plastike”.

Me shkresën nr. 4218/1 prot., datë 20.03.2025 DTO kthen i përgjigje DD Tiranë në vijim të shkresës nr. 1611, datë 27.02.2025, mbi klasifikimin tarifor të artikullit varëse rrobash.

Me shkresën nr. 11483/1 prot., datë 09.06.2025, DTO në DPD, informon mbi rezultatin e pas verifikimit të certifikatës EUR 1 A 3500562 datë 11.12.2023, DD Tiranë.

Komenti i grupit të auditimit:

Për sa argumentuar nga Dega Doganore Tiranë, në relacionin dhe dokumentacionin e vënë në dispozicion grupit të auditimit të KLSH-së, nga verifikimi i tyre, rezultoi se:

Për gjetjet dhe konstatimet e trajtuara në Raportin Përfundimtar të Auditimit që lidhen me kapitullin 20, në vlerën 381,440 lekë, në të cilën janë konstatuar mangësi në mungesë të certifikatës së origjinës, nuk ka përgjigje nga subjekti DD Tiranë.

Për gjetjet dhe konstatimet e trajtuara në Raportin Përfundimtar të Auditimit që lidhen me kapitullin 21, në vlerën 1,497,884 lekë, në të cilën janë konstatuar mangësi, nuk ka përgjigje nga DD Tiranë.

Për gjetjet dhe konstatimet e trajtuara në Raportin Përfundimtar të Auditimit që lidhen me Aneksin nr. 4.41 dhe 4.72, DD Tiranë ka dalë me vendimmarrje, por nuk ka përgjigje të detajuara.

Për gjetjet dhe konstatimet që lidhen me raste të trajtuara në anekset respektive për deklaratat që i përkasin importit të artikujve dhe subjekteve të ndryshme, për të cilat është vjelë detyrimi nga ndërhyrja e aposteriorit sipas rekomandimit të KLSH-së, mungojnë vlerat në lekë të shprehura në materialin informues.

Në përfundim, për gjetjet dhe konstatimet e trajtuara në Raportin Përfundimtar të Auditimit që lidhen me raste të trajtura në anekset respektive për deklaratat që i përkasin importit të artikujve konstatohet se, nga analiza e materialit të vendosur në dispozicion nga DD Tiranë, vlerat e kontabilizuara nga kjo degë rezultojnë në shumën 39,314,466 lekë, për të cilat janë vënë në dispozicion të grupit të auditimit dhe rezultojnë në proces vendimmarrje për hartime vendimesh dhe 15 vendime me vlerë 15,561,234 lekë, duke trajtuar në total me procedurë vendimmarrjeje një vlerë prej 54,875,700 lekë (*detyrim dhe penalitet dhe taksa kombëtare*). Për rastet, për të cilat nga DD Tiranë është kërkuar procesi i verifikimit të transaksioneve pranë Departamentit Operativ Hetimor, rastet për të cilat është kërkuar interpretim teknik nga Drejtoria e Tarifës dhe Origjinës dhe rastet për të cilat është dhënë detyrë rekomanduese për zbatim që të ndiqen nga Drejtoria e Kontrollit pas Zhdoganimit pranë Drejtorisë së Përgjithshme të Doganave sipas rekomandimeve respektive që lidhen me anekset respektive të bashkëlidhura në Raportin Përfundimtar të Auditimit, nuk u vendosën në dispozicion nga grupi i punës, për zbatimin e rekomandimeve të dhëna të sakta për vlerën e zbatueshmërisë të secilit rekomandim të dhënë që lidhet me çdo deklaram doganor sipas numrit të praktikës doganore dhe vitit korrespondues dhe detyrimit doganor të rekomanduar.

Ky rekomandim konsiderohet i pranuar dhe zbatuar pjesërisht.

2.1 Rekomandimi: Dega Doganore Tiranë në bashkëpunim me Drejtorinë e Përgjithshme të Doganave të marrë masa të menjëhershme me qëllim fillimin e procedurave doganore sipas legjislacionit në fuqi për subjektet që kanë rezultuar se kanë deklaruar vlera të ulta të mallrave dhe shpenzimeve të transportit të deklaruara sipas nevojave ekonomike hedhje malli në qarkullim të lirë me procedurë 4051 për mallra të hyra më parë në regjime doganore të tipit RPA të natyrës “*Tallash druri*” dhe “*copa mbetje druri*” në kapitullin *44* “*mbetje letre*” dhe “*mbetje kartoni*” të kapitullin 48 dhe “*mbetje plastike*” në kapitullin 39 të NM në RSH, dhe për mallra të konstatuar në mangësi të pajustificuara në bilancin material të autorizimit të përpunimit RPA të natyrës alkool puro me efekte në të ardhurat doganore në Buxhetin e Shtetit në shumën totale **31,400,097 lekë**.

Përgjigja e subjektit:

a) Aneksi nr. 3.1. Për deklaratat që i përkasin importit të artikujve “mbetje druri, tallash” të klasifikuar në Kapitullin 44, sqarojmë se, për mbetjet teknologjike nga procesi i përpunimit aktiv të mallrave dhe materialeve bashkëngjitur DAV, janë depozituar gjithë dokumentacioni i nevojshëm si autofaturat.

Ky produkt është mbetje e përftuar nga procesi teknologjik i përpunimit të mallrave jo shqiptare të destinuara për t’u riekportuar në formën e produkteve kompensuese, pa pagesën e detyrimeve doganore ose me rimbursimin e tyre pas ri-eksportimit. Sipas observacionit të paraqitur nga subjektet, ky produkt është pjesë e procesit teknologjik për prodhimin e produktit final dhe shërben si lëndë djegëse në furrat e tharjes. Arsyeja e hedhjes për qarkullim të lirë e këtij produkti është për shkak të rakordimit të peshës me artikujt e importuar nën regjim.

Nga subjektet e tjera janë paraqitur dokumentacion shtesë si: fatura tatimore shitje, me të cilët vërtetohet vlera e shitjes së këtyre produkteve (mbetjet e letrës) në tregun vendas. Në Dosjen e Të Dhënave të Disponueshme nuk gjenden vlera referuese për këto artikuj. Në përgjigje të konstatimeve dhe rekomandimeve të paraqitura nga KLSH në Raportin Përfundimtar të Auditimit, lidhur me rivlerësimin e mallrave të natyrës “mbetje” të deklaruara në procedurën 4051 për qarkullim të lirë (“mbetje druri”), konsiderojmë të domosdoshme të parashtrojmë sa vijon:

-Sipas nenit 70 të ligjit nr. 102/2014 “Kodi Doganor i Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar, dhe

akteve nënligjore në zbatim të tij, vlera doganore e mallrave përcaktohet sipas metodave të përcaktuara në seksionin 2 të këtij ligji dhe akteve përkatëse zbatuese. Në rastin konkret, për mallrat e natyrës “mbetje”, zbatimi i metodës së parë (transaksioni real) nuk është i mundur për shkak të mungesës së një çmimi të përcaktuar të shitblerjes ndërmjet palëve. Në vijim, kalimi në metodat alternative duhet të jetë i mbështetur në dokumentacion të qartë, të verifikueshëm dhe të justifikuar.

-Audituesit kanë përdorur si bazë për rivlerësim “çmime orientuese për produkte të ngjashme në shitje”, të cilat nuk përfaqësojnë çmime të referencës të miratuara nga autoritetet doganore, por tregues të përgjithshëm tregtarë, që nuk kanë fuqi detyruese dhe nuk mund të zëvendësojnë asnjë nga metodat e ligjshme të përcaktuara në Kodin Doganor. Më tej, mungojnë burimet e referencës dhe dokumentacioni mbështetës për këto çmime, duke e bërë të pamundur verifikimin e saktësisë së tyre.

-Vetë natyra e mallrave të deklaruara si “mbetje” e përjashton mundësinë e krahasimit me produkte të gatshme në shitje. Mbetjet industriale apo mbetjet e papërpunuara (siç janë “copë druri”, “mbetje kartoni” etj), të cilat janë deklaruar në procedurën 4051 për hedhje në qarkullim të lirë, nuk përbëjnë produkt tregtar të përfunduar dhe, për rrjedhojë, nuk mund të vlerësohen sipas çmimeve të produkteve përfundimtare apo të përpunuara. Ky parim është i sanksionuar edhe në nenin 74 të Kodit Doganor që parashikon se vlera doganore duhet të përfaqësojë vlerën reale të mallit në momentin e importit.

-Praktika e mëparshme doganore dhe mungesa e vendimeve administrative për çmime të referencës, për mallrat në fjalë nuk ekzistojnë vendime të miratuara nga Drejtoria e Përgjithshme e Doganave për çmime të referencës apo baza të dhënash me vlera të detyrueshme. Në mungesë të kësaj, vlerësimi është kryer në përputhje me praktikat doganore të konsoliduara ndër vite, të dokumentuara në sistemin ASYCUDA dhe është reflektuar në vlerësimet paraprake të aplikuara nga vetë organet doganore, pa kundërshtime të mëparshme.

-Efekti financiar i parashikuar nga audituesit është spekulativ dhe i pambështetur në prova. Përlllogaritja e një efekti financiar të supozuar në mungesë të dokumentacionit të plotë dhe pa një analizë të metodologjisë ligjore të vlerësimit përbën tejkalim të kompetencës dhe përfshirje në aspekte tekniko-doganore që janë kompetencë e strukturave të autorizuara.

Duke marrë parasysh sa më sipër, rekomandimi i audituesve për rivlerësimin e mallrave të natyrës “mbetje” mbi bazën e çmimeve orientuese për produkte të ngjashme në shitje nuk mund të zbatohet. Për rrjedhojë, ai nuk duhet të merret si bazë për ndryshim vlerash apo përlllogaritje detyrimesh doganore shtesë. Për sa më sipër Grupi i Punës gjykoj për të mos dalë me vendimmarrje për këtë artikull.

Nga DD Tiranë të njëjtët argumente si më lart, janë paraqitur dhe për artikujt e mëposhtëm, me këto specifikime të veçanta:

b) Aneksi nr. 3.2. Për deklaratat që i përkasin importit të artikujve “mbetje letrë” të klasifikuar në Kapitullin 48, sqarojmë se: nga subjektet janë paraqitur dokumentacion shtesë si: kontrata me subjektin G., kontrata me subjektin S. me objekt grumbullim, eksporti, riciklim të produkteve të letrës dhe kartonit, fatura tatimore shitje, me të cilët vërtetohet vlera e shitjes së këtyre produkteve (mbetjet e letrës) në tregun vendas. Nga subjektet e tjera janë paraqitur dokumentacion shtesë si: fatura tatimore shitje, me të cilët vërtetohet vlera e shitjes së këtyre produkteve (mbetjet e letrës) në tregun vendas.

Duke marrë parasysh sa më sipër, rekomandimi i audituesve për rivlerësimin e mallrave të natyrës “mbetje” mbi bazën e çmimeve orientuese për produkte të ngjashme në shitje nuk mund të zbatohet. Për rrjedhojë, ai nuk duhet të merret si bazë për ndryshim vlerash apo përlllogaritje

detyrimesh doganore shtesë. Për sa më sipër Grupi i Punës gjykoj për të mos dalë me vendimmarrje për këtë artikull.

c) Aneksi nr. 3.3. Për deklaratat që i përkasin importit të artikujve “mbetje plastike” të klasifikuar në Kapitullin 39,

kanë arritur në përfundim se, rekomandimi i audituesve për rivlerësimin e mallrave të natyrës “mbetje” mbi bazën e çmimeve orientuese për produkte të ngjashme në shitje nuk mund të zbatohet. Për rrjedhojë, ai nuk duhet të merret si bazë për ndryshim vlerash apo përlllogaritje detyrimesh doganore shtesë. Për sa më sipër, Grupi i Punës gjykoj për të mos dalë me vendimmarrje për këtë artikull.

d) Aneksi nr. 3.3. Për deklaratat që i përkasin importit të artikujve “mbetje alumini” të klasifikuar në Kapitullin 76, kanë arritur në përfundim se, rekomandimi i audituesve për rivlerësimin e mallrave të natyrës “mbetje” mbi bazën e çmimeve orientuese për produkte të ngjashme në shitje nuk mund të zbatohet. Për rrjedhojë, ai nuk duhet të merret si bazë për ndryshim vlerash apo përlllogaritje detyrimesh doganore shtesë. Për sa më sipër, Grupi i Punës gjykoj për të mos dalë me vendimmarrje për këtë artikull.

e) Aneksi nr. 3.4. Për rivlerësimin e mbetjeve doganore të deklaruara sipas procedurës 4051, mbi bazën e çmimeve orientuese për produktet përkatëse në shitje, lidhur me rivlerësimin e mallrave të natyrës “mbetje” të deklaruara në procedurën 4051 për qarkullim të lirë (“mbetje druri”, “mbetje kartoni”, “mbetje plastike”, “mbetje letre”, “mbetje tekstile” etj.), Grupi i punës ka paraqitur përveç argumente si më sipër, edhe këto pretendime: Për rivlerësimin e mallrave të natyrës “mbetje” mbi bazën e çmimeve orientuese për produkte të ngjashme në shitje nuk është i mbështetur në asnjë dispozitë të ligjit 102/2014 dhe akteve në zbatim. Për rrjedhojë, ai nuk duhet të merret si bazë për ndryshim vlerash apo përlllogaritje detyrimesh doganore shtesë.

f) Aneksi nr. 3.5. Për deklaratat që i përkasin importit të artikujve “Skrap” të klasifikuar në Kapitullin 08, për subjektin ” M” me NIPT K., sqarojme se: DD Tiranë nuk ka dalë me Vendim marrje pasi nga verifikimi i dokumentacionit bashkëngjitur dhe vlerës së deklaruar nga subjekti rezulton se, çmimet e deklaruara janë në të njëjtin nivel me të dhënat e buletinit të bursës sipas publikimeve të “Metal Buletin”. Nga analiza e indikatorëve e fakteve të mësipërme rezulton se përzgjedhja e metodës për vlerësimin doganor është në përputhje me kërkesat e legjislacionit doganor në fuqi.

Komenti i grupit të auditimit:

Për sa është argumentuar nga grupet e punës së DD Tiranë, nga DD Tiranë dhe nga DPD nuk janë marrë masa për fillimin e procedurave doganore sipas legjislacionit në fuqi për subjektet që kanë rezultuar se kanë deklaruar vlera të ulta të mallrave dhe shpenzimeve të transportit të deklaruara sipas nevojave ekonomike hedhje malli në qarkullim të lirë me procedurë 4051 për mallra të hyra më parë në regjime doganore të tipit RPA të natyrës “*Tallash druri*” dhe “*copa mbetje druri*” në kapitullin *44* “*mbetje letre*” dhe “*mbetje kartoni*” të në kapitullin 48 dhe “*mbetje plastike*” në kapitullin 39 të NM në RSH, dhe për mallra të konstatuar në mangësi të pajustificuara në bilancin material të autorizimit të përpunimit RPA të natyrës alkool puro me efekte në të ardhurat doganore në Buxhetin e Shtetit në shumën totale 31,400,097 lekë.

Ky rekomandim konsiderohet i pranuar dhe i pa zbatuar.

3.1 Rekomandimi: Dega Doganore Tiranë në bashkëpunim me Drejtorinë e Përgjithshme të Doganave, të marrë masa të menjëhershme me qëllim shqyrtimin, vendimmarrjen, kontabilizimin dhe më pas arkëtimin e detyrimeve doganore të munguara të rillogaritur në shumën 1,420,575 lekë, si dhe të kërkojë procedurë eksporti të detyrueshëm ose dhënie destinacioni malli për përfitim

statusi shqiptar në një rast vendimi administrativ që lidhen me konstatimet e trajtuara për shkeljen e afatit të regjimit RLP për mallra të natyrës autovetura të nxjerra për vitin 2022.

Përgjigja e subjektit:

Për vendimin nr.1018 datë 07.09.2022 të marrë sipas Proces – verbalit për verifikimin e shkeljes doganore me nr. Serial 0023044 (nr. 8022 Prot., datë 26.08.2022) të mbajtur nga ana e strukturave te Deges se Doganes Tirane, konkretisht nga ana e Sektorit te Opëracioneve Doganore për shkeljen e kryer nga ana e subjektit/përson fizik “J” me NIPT L.. Në datën 25.08.2022 është paraqitur ne Degen e Doganes Tirane, subjekti/përson fizik “J” me NIPT L. e cila përmes përfaqesuesit te tij doganor, Agjensise Doganore “E” ka bere deklarimin me DAV R-87492 datë.25.08.2022.

Në bazë të nenit, 178-181, 250, 251, 256, , 273 e vijues, 276 të Ligjin nr. 102/ 2014, datë 31.07.2014 “*Kodi Doganor i RSH*”, të VKM –së nr. 651, datë 10.11.2017 “*Për miratimin e dispozitave zbatuese të Ligjit nr. 102/2014, datë 31.07.2014*”; si dhe çdo Urdhëresë e DPD-së që nuk bie në kundërshtim me Ligjin nr. 102/2014, datë 31.07.2014 “*Kodi Doganor i RSH*”; për subjekti/Përson Fizik “J” me NIPT L. ka lindur detyrimin doganor i shmangur si me lart trajtuar në shumën 6,540 leke, si dhe sanksioni ne masen e 1-fishit të detyrimit doganor te munguar.

Në referencë te interpretimit ligjor te sipërcituar për caktimin e mases se penalitetit dhe kriteret gjate dhenies se penalizimit, vete ligji e mirpërcakton ekzistencen e kushteve kumulative te cilat duhen marre ne konsiderate ne cdo rast te trajtimit te shkeljes.

-Autoriteti vendimarrës DD Tiranë vendimin nr. 1104 datë 25.10.2022 e ka marrë bazuar në procesverbalin për verifikimin e kundërvajtjes doganore të mbajtur nga ana e grupit të Antikontrabandës dhe Sektorit Opëracional në DD Tiranë, ku janë përcaktuar pagesat e detyrimit në shumën 216,000 lekë dhe penalitetet sa njëfishi i detyrimit të munguar pasi ka parë tërësinë e rrethanave të shkeljes dhe mbështetur në gjithë dokumentacionin ligjor.

Konstatimi i KLSH-së për aplikimin e nenit 252 germa d në lidhje me nenin 257 nuk qëndron, kjo parë jo vetem në vështrim të hetimit të rrethanave të kryerjes së shkeljes ku merret në konsideratë edhe ana subjektive e subjektit kompetencë kjo e strukturave konstatuese dhe që vjen shkak pasojë pasi juristi nuk mund të kryejë hetimin e rrethanave pasi kjo hyn në kompetencen e konstatueseve që në rastin konkret kanë qenë struktura kompetente të Antikontrabandës të specilizuara në fushën e shkeljeve dhe me tagra e kompetenca edhe si OPGJ, por gjithashtu parë edhe në interpretim të Kodit Doganor për pjesën e shkeljeve ku kjo lloj shkelje me një sasi të vogël malli të padeklaruar. Pra si forme shkeljeje është parashikuar ne disa germa te nenit 251 dhe për me tepër qe ana subjektive rezulton nga hetimi i rrethanave te shkeljes e qendrimit te subjektit nga ana e strukturave konstatuese dhe nga juristi nuk mund te behen ndryshime.

-Autoriteti vendimarrës DD Tirane vendimin nr. 1020 datë 14.09.2023 e ka marre bazuar ne Proces verbalin për verifikimin e kundervajtjes doganore “të mbajtur nga ana e grupit te Antikontrabandes dhe Sektorit Opëracional prane DD Tirane, ku jane përcaktuar pagesa e detyrimit ne shumen 216,000 leke dhe penalitetet në shumën 44,954 leke, pasi ka pare teresine e gjithë dokumentacionit ligjor. Konstatimi i KLSH-se për aplikimin e nenit 252 germa d ne lidhje me nenin 257 nuk qendron.

Pra si forme shkleje përfshire edhe problematika e deklarates përbledhese është parashikuar ne disa germa te nenit 251 dhe për me tepër qe ana subjektive rezulton nga hetimi i rrethanave te shkeljes e qendrimit te subjektit nga ana e strukturave konstatuese dhe nga juristi nuk mund te behen ndryshime.

-Autoriteti vendimarrës DD Tirane vendimin nr. 1105 datë 26.10.2022 e ka marre bazuar ne Proces verbalin për verifikimin e kundervajtjes doganore “të mbajtur nga ana e grupit te Antikontrabandes dhe Sektorit Opëracional prane DD Tirane, ku jane përcaktuar pagesa e detyrimit ne shumen

33,000 leke dhe penaltet në shumën 33,000 leke pasi ka pare teresine e gjithë dokumentacionit ligjor. Konstatimi i KLSH-se për aplikimin e nenit 252 germa d ne lidhje me nenin 257 nuk qendron.

-Për vendimet nr. 584, 585, 586, 587, 588, 589 si dhe 590 datë 01.04.2022, kur nga ana e grupit të auditimit është konstatuar se procedura e marrjes së vendimit nuk është bërë në zbatim korrekt të kuadrit ligjor dhe mundësine që i jepet operatorit ekonomik të kundërshtojë gjatë procedurës administrative detyrimin dhe sanksionin që lindin nga ky akt administrativ, më lejoni që të kundërshtoj këtë konstatim tuajin, pasi vendimarrjet që ju konstatoni janë marrë mbi bazën e rekomandimeve te Raportit Përfundimtar të Auditimit (Nr.1006/18 Prot., DDT datë 04.10.2021) Duke marrë në konsideratë faktin se ka një afat të caktuar për zbatimin e rekomandimeve, dhe faktin se procesverbalet e konstatimit të kundërvajtjeve janë depozituar në limitet kohore, vlerësoj se duhet të rishikohet ngarkimi me përgjegjësi për juristin lidhur me procedurën e komunikimit të aktit administrative. Sjell në vëmendjen tuaj se këto për këto vendimarrje detyrimi doganor i lindur gjithashtu dhe sanksioni janë kontabilizuar me shumat përkatëse për llogari të autoritetit doganor.

-Lidhur me vendimin nr. 676 datë 19.05.2022 me subjekt “A” konstatimi nuk qendron pasi si forme shkelje futet tek rastet e paparashikuara shprehimisht dhe për pasoje është bazuar ne nenin 259 te KD. Vendimi është bazuar ne procesverbalin e struktrave konstatuese.

-Referuar konstatimeve për vendimet për klasifikim te gabuar te shkeljes se kryer dhe sanksionit te vendosur për rastet e marra ne shkelje te RLP-së për automjete, si me poshte referoj për keto vendimarrje. Vendimet nr. 598, datë 04.04.2022, nr. 599, datë 05.04.2022, nr. 602 datë 07.04.2022, nr. 604 datë 11.04.2022, nr. 607 datë 19.04.2022, nr. 619 datë 22.04.2022, nr. 624 datë 27.04.2022, nr. 625 datë 27.04.2022 dhe nr. 626 datë 29.04.2022 ; vendimet nr. 629 datë 04.05.2022, 647 datë 09.05.2022, 656 datë 11.05.2022, 658 datë 12.05.2022, 665 datë 14.05.2022, nr. 670 datë 17.05.2022, nr. 700 datë 26.05.2022, nr. 702 datë 27.05.2022, nr. 759 datë 09.06.2022, nr. 760 datë 09.06.2022, 761 datë 10.06.2022 dhe 761 datë 10.06.2022. Gjithashtu për të njëjtën natyre të kundërvajtjes administartive përmend dhe vendimet nr. 48 datë 12.01.2023 dhe nr. 89 datë 10.01.2023.

Të gjitha aktet administrative sa më lartë trajtuar në këtë auditim kanë dalë në mbështetje të legjislacionit doganor shqiptar si dhe Udhëzimit të Përbashkët të Ministrit të Financave dhe Ministrit të Brendshëm me nr. 4, datë 04.02.2010 « *Për zbatimin e procedurave të miratimit, mbikëqyrjes dhe përmbjlljes së rregjimit të lejimit të përkohshëm të automjeteve të huaja për përdorim privat* » lidhur me parashikimin e nenit 3 të nenit 650 Vendi për paraqitjen e aplikimit të VKM-së nr. 651, datë 10.11.2017 « *Për Dispozitat Zbatuese të Kodit Doganor* » të DPD-së nga ana e doganierit dhe përgjegjësit të Sektorit të Vlerësimit në Qendër në DPD. Akti i konstatimit përpilohet në përputhje me nenin 262, 274 dhe 276 të KD.

Gjatë marrjes së Vendimeve Administrative nga autoriteti Vendimarrës Kompetent është mbajtur në konsideratë që sanksionet e vendosura për kundërvajtjet e përcaktuara sipas Kodit Doganor duhet të jenë efektive, proporcionale e dekurajuese dhe të vendosen brenda kufijve ligjore. Vendimarrja është mbështetur në nenin 11 dhe 12 të Ligjit nr. 44/ 2015 të “*Kodit të Procedurave Administrative*”, i ndryshuar.

Në këto kushte mendoj se vendimarrja administrative e DD Tiranë është e mbështetur në ligj dhe në akte dhe si e tillë nuk mund të procedohet me rishikim të tyre apo me saktësim të bazës ligjore. Nëse i referohemi praktikës gjyqësore tashmë të konsoliduar ashpërsia e penaltetit nuk mund të jetë në disproporcion me natyrën e kundërvajtjes administrative doganore, duke marrë në konsideratë edhe faktin që shtetasit janë paraqitur vullnetarisht pranë autoritetit doganor për ti

dhënë destinacion automjetit si dhe kanë paguar shumën e detyrimeve që rrjedhin si rezultat i zhdoganimit të automjeteve për përdorim privat.

-Konstatohen 6 vendime me parregullsi në klasifikimin e shkeljes për RLP të ndryshme nga makinat.

Në rastin e RLP qëndron i njëjti interpretim si për rastin e RLP-se të makinave.

Vendimet e Degës së Doganës Tirane janë marrë mbi bazën e provave dhe të situatës ligjore dhe faktike që ekzistonte në kohën e kryerjes së shkeljes doganore, kërkesë e domosdoshme e nenit 250, 276 e vijues të ligjit nr.102/2014, datë 31.07.2014 “Kodi Doganor” i ndryshuar.

Përsa më lart vendimmarrja është e argumentuar dhe e mbështetur në ligj, është në diskrecionin e autoritetit vendimarrës të përcaktojë llojin e masës së sanksioneve lidhur me kundërvajtjen administrative të konstatuar. Në përfundim, rezulton se vendimet e DD Tiranë janë nxjerrë mbi bazën e procesverbaleve të shkeljeve doganore, si rrjedhojë e aplikimit të saktë të dispozitave ligjore që i përgjigjen shkeljes doganore të kryer të konstatuara nga struktura doganore respektive, pra referenca ligjore është e saktë dhe për pasojë sanksionet e vendosura janë korrekte.

-Për vendimin nr. 763 datë 13.06.2022, nga ana e Zyres Aposteriori është mbajtur procesverbali me nr. serial 0022850 (nr. 3547 prot., datë 11.04.2022) “Për verifikimin e kundërvajtjes administrative”, përmes të cilit pasqyrohet vlera e detyrimit të munguar për praktikën doganore IM4 R 33004 datë 20.05.2020, i cili rezulton të jetë në masën 179,751 lekë.

Në vijimësi, pas konstatimit të fakteve reale dhe atyre të paraqitura në menyre dokumentare nga strukturat doganore por dhe nga operatori ekonomik, vleresoj se, Ligji nr. 44/ 2015 “Kodi i Procedurave Administrative në Republikën e Shqipërisë” në teresinë e frymes ligjore që ndjek, përcakton sundimin e ligjit si parimin bazë më të rëndësishëm për kryerjen e procedurave administrative.

Duke mbajtur parasysh parimet e përgjithshme nga e cila duhet të udhëhiqet administrata në kryerjen e funksioneve të saj si “Parimi i ligjshmërisë; parimi i mbrojtjes së interesit publik por pa cënuar të drejtat e personave privat; parimi i drejtësisë dhe paanësisë; parimi i përgjegjshmërisë; parimi i kontrollit gjyqësor etj”, parime këto të sanksionuara në Ligjin nr.44/2015 “Kodi i Procedurave Administrative në Republikën e Shqipërisë”, shprehemi se nga ana jonë është vepruar në përputhje të plotë me ligjin.

Komenti i grupit të auditimit:

Për sa rekomanduar më sipër, me qëllim shqyrtimin, kontabilizimin dhe më pas arkëtimin e detyrimeve doganore të munguara të rillojatur në shumën 1,420,575 lekë, për vendimet nr. 1018, 1104, 1020 dhe 1105 që lidhen me diferencat sasiore të konstatuara në sasi malli më tepër dhe të padeklaruara dhe që nuk është deklaruar gjobë doganore sa 2-fishi i detyrimeve doganore të papaguara me shumën 300,824 lekë, DD Tiranë nuk kanë ndryshuar vendimmarrje.

Për vendimet nr. 584, 585, 586, 587, 588, 589 si dhe 590 datë 01.04.2022, për të cilat nga ana e grupit të auditimit është konstatuar se procedura e marrjes së vendimit nuk është bërë në zbatim korrekt të kuadrit ligjor dhe mundësinë që i jepet operatorit ekonomik të kundërshtojë gjatë procedurës administrative detyrimin dhe sanksionin që lindin nga ky akt administrativ. Subjekti sqaron se për këto vendimmarrje detyrimi doganor i lindur gjithashtu dhe sanksioni janë kontabilizuar me shumat përkatëse për llogari të autoritetit doganor dhe nuk ka ndryshuar qëndrim. Për vendimet e tjera, të cilat kanë detyrim doganor të munguar dhe penalitet, në shumën 1,109,751 lekë, DD Tiranë nuk ka ndryshuar vendimmarrje.

Ky rekomandim konsiderohet i pranuar dhe i pa zbatuar.

4.1 Rekomandimi: Dega Doganore Tiranë, të marrë masa për shqyrtimin e rasteve të evidentuara

dhe ndjekjen e të gjitha procedurave të nevojshme administrative me qëllim arkëtimin e detyrimeve doganore në vlerën 1,710,952 lekë.

Përgjigja e subjektit:

DD Tiranë sqaron në mënyrë shterruese pse autoriteti doganor nuk ndryshoi qëndrim (marrje vendimesh) në lidhje me subjektet dhe rastet e përmendura në këtë rekomandim:

a) Në lidhje me pikën “Mbi regjimin e lejimit të përkohshëm”, Vendimi nr. 567, datë 29.05.2023 është marrë në bazë të procesverbalit të doganierëve të regjimeve të DD Tiranë. Kundravajtja ka qenë e një shkelje jo të rëndë që ka ardh si rrjedhojë e një gabimi njerëzor sesa me dashje. Gjithashtu në përcaktimin e masës së penalitetit në lidhje me këtë subjekt autoriteti vendimarrës ka pasur përcaktimet e dispozitave ligjore si më poshte vijon: neni 262 i Kodit Doganor, nenin 11 dhe neni 12 të Ligjit nr. 44/ 2015 të “*Kodit të Procedurave Administrative*”, i ndryshuar.

Pra, organi doganor (juristi) ka vlerësuar nëse është e mundur që qëllimi i kërkuar të realizohet me masa sa më pak represive, pa kompromentuar efektivitetin e tyre nisur nga detyrimi doganor i lindur për t’u paguar. Referuar praktikës së konsoliduar të Gjykatës ashpërsia e penaliteteve nuk mund të jetë në disproporcion me natyrën e kundërvajtjes administrative doganore, duke patur në konsideratë faktin që subjekti ka bërë kërkesë për shtyrje të afatit të RLP-së që është aprovuar nga DPD.

b) Në lidhje me pikën “Euro 1 trajtim preferencial”, Vendimi nr. 882 datë 20.10.2023 për subjektin “L” ku ky subjekt është ngarkuar me pagimin e detyrimit në shumën 99,706 lekë dhe agjencia doganore “S”, i’u bëjmë me dije se ky vendim është mbajtur në bazë të procesverbalit nr. 6209/2 prot., datë 17.07.2023 të mbajtur nga zyra e aposteriorit pranë DD Tiranë lidhur me R105189 datë 10.10.2022, të subjektit “L” përsos fizik me NIPT L., ku është përcaktuar vetëm pagesa e detyrimit dhe nuk është vendosur masë penaliteti. Zyra juridike pasi ka marrë në shqyrtim tërë praktikën doganore si dhe dokumentacionin ligjor bashkëngjitur si dhe bazuar në nenin 262 i Kodit Doganor, nenin 11 dhe neni 12 të Ligjit nr. 44/ 2015 të “*Kodit të Procedurave Administrative*”, i ndryshuar.

Organi doganor (juristi) ka vlerësuar nëse është e mundur që qëllimi i kërkuar të realizohet me masa sa më pak represive, pa kompromentuar efektivitetin e tyre nisur nga detyrimi doganor i lindur për t’u paguar.

c) Në lidhje me pikën “Mbi kontrollin e rezultuar sasi tepër”, Autoriteti vendimarrës DD Tiranë vendimin nr. 808, datë 11.09.2023 e ka marrë bazuar në procesverbalin për verifikimin e kundërvajtjes doganore me nr. 7789 prot., datë 08.09.2023, të mbajtur nga ana e Grupit të Antikontrabandës dhe Sektorit Operacional pranë DD Tiranë, për shkeljen e kryer nga ana e subjektit “D” PF NIPT L. lidhur me deklaratën doganore IM4 nr. R.92587 datë 06.09.2023, ku janë përcaktuar pagesa e detyrimit në shumën 69,205 lekë dhe penalitet sa njëfishi i detyrimit të munguar, pasi ka parë tërësinë e gjithë dokumentacionit ligjor.

- Vendimin nr. 812, datë 13.09.2023 e ka marrë bazuar në procesverbalin për verifikimin e kundërvajtjes doganore të mbajtur nga ana e Grupit të Antikontrabandës dhe Sektorit Operacional pranë DD Tiranë, për shkeljen e kryer nga ana e subjektit “D” lidhur me deklaratën doganore IM4 nr. R.94550 datë 11.09.2023, ku janë përcaktuar pagesa e detyrimit në shumën 18,829 lekë dhe penalitet sa njëfishi i detyrimit të munguar. DD Tiranë sqaron se, autoriteti doganor ka parë tërësinë e gjithë dokumentacionit ligjor të praktikës doganore, është kryer kontrolli i plotë fizik dhënë nga Sektori i Koordinimit, bazuar në analizën e riskut me numër 2 (dy), ku u kryen numërimi/peshimi/kontrolli për natyrë malli/kontrolli për klasifikim i kryer nga Grupi i Antikontrabandës nr. 08-12 është konstatuar diferencë në sasinë e mallit të deklaruar (*pesha sipas deklaramit*), për sasinë si numër, pasqyruar në evidencën e kontrollit fizik nr. 0000072. Si pasojë

e diferencave të konstatuara në numër (*artikujt këmisha;pantallona*) kanë rezultuar detyrime doganore të shmangura. Ka rezultuar se strukturat konstatuese të degës doganore në bashkëpunim me strukturat e Antikontrabandës mbështetur në tagrin që ligji i'u jep strukturave konstatuese për verifikimin e shkeljeve, kanë konkluduar se Operatorit Ekonomik "D" SHPK me NIPT. L. duhet të penalizohet me 1 fish të detyrimit doganor të shmangur në shumën 18.829 lekë mbi të cilin është marrë dhe vendimarrja. Gjithashtu autoriteti doganor është bazuar në nenin 262 i Kodit Doganor, nenin 11 dhe neni 12 të Ligjit nr. 44/ 2015 të "*Kodit të Procedurave Administrative*", i ndryshuar.

d) Lidhur me konstatimin Shkelje procedurale dhe materiale për vendimarrje të cilat janë në kundërshtim me legjislacionin doganor, konkretisht vendimi nr. 51, datë 17.01.2023, ku citojmë : Shoqëria "M" shpk me Nipt L., është pajisur nga DPD me Autorizim të Rregjimit të Lejimit të Përkohshëm (përfashtim i pjesshëm) përkatësisht me nr.17089/1 datë 08.07.2016, 15425/1 datë 30.06.2017, nr. 16518/1 datë 14.07.2017. Nga ana e DPD si struktura e cila ka lëshuar keto autorizime është bërë me dije mosrespektimi i afatit të përcaktuar për secilin prej tyre. Nga Zyra e Mbikëqyrjes Doganore, lidhur me rezultatet e kontrollit është konstatuar se shoqëria ka shkelur kushtet e autorizimit. Duke parë që këto parregullsi i korrespondojnë të njëjtit subjekt dhe nga e njëjta strukturë konstatimi që ka dhënë dhe vetë autorizimet për operatorin ekonomik, por edhe duke patur parasysh rrethanat e kryerjes së tyre, është vlerësuar që të aplikohet një penaltet i përgjithshëm për këto lloj parregullsie në formën e gabimeve, pasi mungon elementi subjektiv i fajit përderisa nuk ka as shmangie nga pagesa e detyrimit doganor dhe gjithashtu edhe për faktin se shkeljet vijnë më shumë në formën e një kundërvajtje të zgjatur në kohë pra vazhduese në raport me mosrespektimin e autorizimit të lëshuar për regjimin e RLP-së. Vlen për t'u sqaruar se duke mos e nënvlerësuar aspak vlerën e ligjit material siç është Kodi Doganor, si ligji specifik që bën rregullimin e marrëdhënieve në fushën doganore, nuk mund të mos mbahen parasysh edhe parimet e përgjithshme të sanksionuara në nenin 4, Ligji nr. 10 279, datë 20.5.2010 "*Për kundërvajtjet administrative*". Në vendimin nr. 51 datë 17.01.2023 masa e penaltetit të dhënë për rastin është në përputhje me parimet administrative të vendimarrjes, në nenin 262 i Kodit Doganor, nenin 11 dhe neni 12 të Ligjit nr. 44/ 2015 të "*Kodit të Procedurave Administrative*", i ndryshuar.

e) Për vendimin nr. 53, datë 24.01.2023, Shoqëria "B" shpk me Nipt L., është pajisur nga DPD me Autorizim të Rregjimit të Lejimit të Përkohshëm me nr.11100/1 datë 27.04.2019, për një periudhë kohore 24 muaj. Mbështetur në Procesverbalin për verifikimit e kundërvajtjes doganore të Zyrës së Mbikëqyrjes Doganore me nr. serial 0022272, nr. 602 prot., datë 23.01.2023 rezulton se, subjekti nuk ka respektuar afatin e përcaktuar/rieksportit në këtë autorizim, pra shkeljen e afatit të Rregjimit të Lejimit të Përkohshëm për autorizimin me nr.11100/1 datë 27.04.2019.

Referuar konstatimit tuaj për faktin se subjekti zotëron 2 regjime lejimi të përkohshëm dhe është penalizuar për 1, ju lutem më lejoni t'ju citoj se vendimarrja është marrë për procesverbalin për të cilin Zyra e Rregjimeve Doganore ka paraqitur për vendimarrje, pra Juristi i Degës Doganore nuk ka qenë në dijeni për regjimin e dytë dhe nuk mundet të mbajë përgjegjësi për moskontabilizimin e shumës, si dhe mos sanksionimin e operatorit ekonomik, për të cilin dhe ju vetë keni shprehur se nuk është mbajtur procesverbal i kundërvajtjes administrative.

f) Vendimi nr. 156, datë 03.03.2023 me subjekt "E" është mbajtur në bazë të procesverbalit nga Drejtoria e Hetimit nga ana e të cilëve si struktura kompetente për hetimin e shkeljes, pas hetimit të kryer kanë konkluduar se ka kundërvajtje në formë parregullsie duke aplikuar penaltet 20,000 lekë. Zyra Juridike pasi ka marrë në shqyrtim praktikën doganore, si dhe dokumentacionin ligjor bashkëngjitur, bazuar në nenin 262 i Kodit Doganor, nenin 11 dhe neni 12 të Ligjit nr. 44/ 2015 të "*Kodit të Procedurave Administrative*", i ndryshuar.

Duke patur parasysh se konfirmimi i autoriteteve doganore homologe konfirmon vërtetësinë e

dokumentit Eur 1 por, megjithatë pas verifikimeve të kryera nga ana e tyre thuhet se malli nuk përfiton origjinë preferenciale, atëherë jemi përpara një kundërvajtje në formë parregullsie, pasi subjekti nuk ka paraqitur dokumenta fallco. Dokumenti i origjinës është autentik pra original dhe për rrjedhojë subjekti nuk ka faj për gabimin e bërë nga furnitori apo strukturat që e kanë lëshuar Eur 1 në Greqi.

Por, për të mos e lënë pa penalizim fare Drejtoria e Hetimit, pas verifikimit të të gjitha rrethanave të shkeljes ka vendosur aplikimin e nje penalteti në formë parregullsie. Autoriteti vendimmarrës DD Tiranë bazuar në procesverbalin e Drejtorisë së Hetimit ka vlerësuar nëse është e mundur që qëllimi i kërkuar të realizohet me masa sa më pak represive, pa kompromentuar efektivitetin e tyre nisur nga detyrimi doganor i lindur për t'u paguar.

g) Lidhur me procesverbalet e shkeljeve për Vendimet nr. 50, 48, 98, 89, procesverbalet plotësohen nga SVQ, dhe juristi nuk mund të bëjë ndërhyrje në procesverbal, por mangësitë e konstatuara në procesverbal i rregullon duke vendosur bazën ligjore që duhet dhe shumën përkatëse në vendim.

gj) Për vendimin nr. 158 datë 03.03.2023, i cili është marrë sipas procesverbalit për verifikimin e shkeljes doganore me nr. serial 0005582 (nr. 1469 prot., datë 20.02.2023) të mbajtur nga ana e Departamentit Operativ Hetimor, Strukturave të Antikontrabandës, për shkeljen e kryer nga ana e subjektit/përson fizik "S." me NIPT K.. Gjatë marrjes së Vendimit Administrativ nga autoriteti Vendimmarrës Kompetent është mbajtur në konsideratë që sanksionet e vendosura për kundërvajtjet e përcaktuara sipas Kodit Doganor duhet të jenë efektive, proporcionale e dekurajuese dhe të vendosen brenda kufijve ligjore. Vendim është mbështetur në nenin 262 i Kodit Doganor, nenin 11 dhe neni 12 të Ligjit nr. 44/ 2015 të "*Kodit të Procedurave Administrative*", i ndryshuar, si dhe neni 18 i Ligjit nr. 10279, datë 20.05.2010 "*Përkundërvajtjet administrative*".

h) Për vendimin nr. 100, datë 16.02.2023, Sipas procesverbalit për verifikimin e shkeljes doganore me nr. serial 0022201 (nr. 632 prot., datë 24.01.2022) të mbajtur nga ana e Sektorit të Operacioneve Doganore për shkeljen e kryer nga subjektit PF "X" me NIPT M..

Sikurse neni 262 përcakton se Autoritetet doganore kompetente në caktimin e llojit dhe masës së sanksioneve për kundërvajtjet e përcaktuara në nenet 251 deri në 254 duhet të marrin parasysh të gjitha rrethanat, duke përfshirë plotësimin e te gjitha kushteve ne përcaktimin e mases se penaltetit, dhe jo vetem por marrjen ne konsiderate nder te tjera dhe te efekteve financiare qe shkelja ka shkaktuar ne rastin konkret.

Komenti i grupit të auditimit:

Për sa më sipër, DD Tiranë lidhur me marrjen e masave për shqyrtimin e rasteve të evidentuara dhe ndjekjen e të gjitha procedurave të nevojshme administrative me qëllim arkëtimin e detyrimeve doganore në shumën 1,710,952 lekë, nuk ka ndryshuar vendimmarrje.

Ky rekomandim konsiderohet i pranuar dhe i pa zbatuar.

5.1 Rekomandimi: Dega Doganore Tiranë në bashkëpunim me Drejtorinë e Përgjithshme të Doganave, të marrë masa që për të gjitha rastet e transiteve të evidentuara me diferencë në peshë në aktin e inspektimit nga zyra doganore nisëse, të kryhen verifikimet përkatëse, të ndiqen procedurat e parashikuara në manual, të mbahen procesverbale apo dokumentacion për të faktuar nëse diferencat sjellin ose jo pasoja financiare.

Përgjigjja e subjektit:

-Në lidhje me procedurat e ndjekura nga Zyra Operacionale për trajtimin e rasteve të diferencave të peshës së mjeteve grupazh, të rezultuara nga krahasimi i peshës së deklaruar në deklaratën e tranzitit, me peshën e rezultuar nga peshimi i mjetit, bazuar në informacionin e dërguar nga ZMP janë evidentuar mjetet, pas depozitimit të të gjitha deklarimeve për mallrat që transportoheshin në

një mjet, është përzgjedhur punonjësi që do të kryejë procedurat e verifikimit fizik, më pas kanë vazhduar procedurat e verifikimeve dhe në rubrikën "akt inspektimi" të deklaratave janë plotësuar shënimet mbi rezultatet e verifikimeve, përgjithësisht si shkak i diferencave në peshë kanë qënë pasaktësisë së peshës së mjetit bosh që jepet në lejën e qarkullimit, mjetet për të cilët është konstatuar kjo parregullsi kanë qënë të huaja dhe të paregjstruara në Shqipëri, fakt që nuk mundëson aplikimin e penaliteteve. Në disa raste diferencat kanë rezultuar në mallra, pagesa e detyrimit të të cilave përlllogaritet për copë dhe jo për kg dhe diferenca nuk ndikonte në pagesën e detyrimit. Diferenca në peshë është vlerësuar si një indikator për mënyrën se si të kryhen kontrollet dhe verifikimet fizike të mallrave dhe jo si një arsye për të aplikuar penalitet, në rastet kur nga verifikimet e kryera është vërtetuar se diferenca ndikon në pagesën e detyrimit doganor, janë mbajtur aktet përkatëse dhe për shkeljen e konstatuar janë aplikuar penalitete sipas legjislacionit doganor.

Komenti i grupit të auditimit:

Nga grupi i auditimit të KLSH-së u konstatua se, DD Tiranë rezulton në proces pune mbi masat e marra për rastet e transiteve të evidentuara me diferencë në peshë në aktin e inspektimit nga zyra doganore nisëse.

Ky rekomandim konsiderohet i pranuar dhe në proces zbatimi.

5.2 Rekomandimi: Zyra Operacionale dhe Dega Doganore Tiranë, në cilësinë e strukturës kompetente të ndërmarrë të gjitha masat e nevojshme dhe vendimet përkatëse në përputhje me kërkesat ligjore dhe procedurale, më qëllim arkëtimin e të ardhurave të munguara në buxhetin e shtetit të evidentuara në vlerën 440,000 lekë ne formën e gjobës.

Përgjigja e subjektit:

-Në lidhje me procedurat e ndjekura nga Zyra Operacionale për trajtimin e rasteve të diferencave të peshës së mjeteve grupazh, të rezultuara nga krahasimi i peshës së deklaruar në deklaratën e tranzitit, me peshën e rezultuar nga peshimi i mjetit, bazuar në informacionin e dërguar nga ZMP janë evidentuar mjetet, pas depozitimit të të gjitha deklarimeve për mallrat që transportoheshin në një mjet, është përzgjedhur punonjësi që do të kryejë procedurat e verifikimit fizik, më pas kanë vazhduar procedurat e verifikimeve dhe në rubrikën "akt inspektimi" të deklaratave janë plotësuar shënimet mbi rezultatet e verifikimeve, përgjithësisht si shkak i diferencave në peshë kanë qënë pasaktësisë së peshës së mjetit bosh që jepet në lejën e qarkullimit, mjetet për të cilët është konstatuar kjo parregullsi kanë qënë të huaja dhe të paregjstruara në Shqipëri, fakt që nuk mundëson aplikimin e penaliteteve. Në disa raste diferencat kanë rezultuar në mallra, pagesa e detyrimit të të cilave përlllogaritet për copë dhe jo për kg dhe diferenca nuk ndikonte në pagesën e detyrimit. Diferenca në peshë është vlerësuar si një indikator për mënyrën se si të kryhen kontrollet dhe verifikimet fizike të mallrave dhe jo si një arsye për të aplikuar penalitet, në rastet kur nga verifikimet e kryera është vërtetuar se diferenca ndikon në pagesën e detyrimit doganor, janë mbajtur aktet përkatëse dhe për shkeljen e konstatuar janë aplikuar penalitete sipas legjislacionit doganor.

Grupi i punës i DD Tiranë nuk ka dalë me vendimmarrje në lidhje me këto raste.

Komenti i grupit të auditimit:

Nga grupi i auditimit të KLSH-së u konstatua se nga DD Tiranë nuk janë marrë masa që për rastet e transiteve të evidentuara me diferencë në peshë në aktin e inspektimit nga zyra doganore nisëse, të kryhen verifikimet përkatëse, si dhe nuk kanë dalë me vendimmarrje për arkëtimin e të ardhurave të munguara në buxhetin e shtetit në vlerën 440,000 lekë.

Ky rekomandim konsiderohet i pranuar dhe i pa zbatuar.

6.1 Rekomandimi: Zyra e mbikëqyrjes doganore të regjimit të magazinimit doganor në zbatim të procedurave funksionale të kryejë inventarizimin e dosjeve, në dosje të jepen të dhëna të qarta të gjurmës së kontrolleve të ushtruara, administrimin në to, jo vetëm të dokumentacionit të sjellë nga subjektet, por edhe dokumentacionin vërtetues të të gjithë punës së kryer nga doganierët mbikëqyrës të regjimit të magazinimit doganor, si dhe të kryejnë kontrolle të paktën një herë në tre muaj. Të kryejë mbikëqyrjen e Autorizimeve për përdorimin e Regjimit të Magazinimit Doganor për të parë nëse përmbushen detyrimet që rrjedhin nga ky autorizim.

Përgjigja e subjektit:

Me shkresën nr. 1024/6 prot., datë 25.04.2025, Kryetari i DD Tiranë ka nxjerrë urdhrin nr. 3/1, drejtuar Sektorit të Mbikëqyrjes së Regjimeve Ekonomike Doganore, për zbatimin e këtij rekomandimi.

DD Tiranë informon se, doganierët e Zyrës së Mbikëqyrjes Doganore kanë marrë masa për plotësimin e dosjeve të subjekteve. Kanë kryer verifikimet e koeficienteve të shfrytëzimit në ambjentet e operatorit ekonomik. Çdo tre muaj kanë kryer rakordimet me subjektet e Përpunimit Aktiv si dhe verifikimin dhe rakordimin me Magazinat Doganore.

Komenti i grupit të auditimit:

Spektori i Mbikëqyrjes së Regjimeve Ekonomike Doganore ka marrë masa në inventarizimin e dosjeve dhe dokumentimin e të gjitha praktikave.

Ky rekomandim konsiderohet i pranuar dhe në proces zbatimi.

6.2 Rekomandimi: Dega Doganore Tiranë në bashkëpunim me Drejtorinë e Përgjithshme të Doganave, të ndërmarrë të gjitha masat e nevojshme më qëllim arkëtimin e të ardhurave të munguara në buxhetin e shtetit në shumën 100,000 lekë.

Komenti i grupit të auditimit:

Grupit të auditimit të KLSH-së, nuk ju vendos asnjë dokument në dispozicion mbi procedurën e ndjekur nga Spektori i Mbikëqyrjes së Regjimeve Ekonomike Doganore në zbatim të këtij rekomandimi.

Ky rekomandim rezulton i pranuar dhe i pa zbatuar.

A. Zbatimi i rekomandimeve për masat për të ardhura të munguara. Ecuria e zbatimit dhe analizimi i rekomandimeve: rekomandime të pranuar dhe nga këto, sa janë zbatuar plotësisht; zbatuar pjesërisht, në proces zbatimi dhe rekomandimet e pa zbatuara.

1.1 Rekomandimi: Dega Doganore Tiranë të përcjellë pranë Drejtorisë së Përgjithshme të Doganave për ndjekje problematikën e konstatimeve të mësipërme në **shumën 173,484,666 lekë** (detyrim) për shqyrtime të thelluara dhe të detajuara dhe kontrolle të mëtejshme për periudha të mëparshme përfshirë edhe periudhën 3 vjeçare (2021 deri 2024), që lidhen me:

- Rillogaritjen e detyrimeve për klasifikimin tarifor përfundimtar të artikujve “qumësht UHT me 3.6 yndyre dhe qumësht për kafe”, “Doreza Kirurgjikale” dhe “Hudhër e ftohte” dhe “Qumësht UHT me 3.6% yndyre dhe Qumësht për kafe”
- Rillogaritjen e detyrimeve doganore për mallin “qumësht i kondensuar i mbushur me ëmbëlsire” për pagesën e taksës QPL;
- Rillogaritjen e detyrimeve doganore për mallin “Spraj (vajra të lehte), Practioner, dhe Solvent” dhe “Vaj Lubrifikant”;
- Pagesën e detyrimeve doganore dhe detyrimeve të akcizës dhe ndjekje të procedurave

të mëtejshme doganore nga struktura të specializuara kontrolluese dhe konstatuese pranë DPD-së (si Drejtoria e Kontrollit Pas Zhdoganimit, Drejtoria së Riskut, dhe Monitorimit dhe Drejtoria e Tarifës dhe Origjinës), duke marrë në konsideratë metodat dhe radhën e procesit ligjor të verifikimit doganor dhe përputhshmërinë me përcaktimet e legjislacionit doganor në fuqi. Në përfundim Dega Doganore Tiranë të informojë Institucionin e Kontrollit të Lartë të Shtetit për veprimet e kryera për këtë rekomandim.

Përgjigjja e subjektit:

Me shkresën nr. 1024 prot., datë 03.02.2025, Kryetari i DD Tiranë ka nxjerrë urdhrin nr. 01, datë 31.01.2025, i ndryshuar me urdhrin nr. 1/1, me shkresën nr. 1024/20 prot., datë 26.06.2025 për “Shqyrtimin/analizimin e Raportit Përfundimtar të Auditimit të Kontrollit të Lartë të Shtetit” dhe ngritjen e grupeve të punës me përfaqësues: Kryetar, S. R. dhe anëtarë të Zyrës Operacionale Doganore: J. Ç., U. M., B.C., J.P., A.K., G.I., J. H, E. T dhe E. G; nga Zyra e Regjimeve Doganore me anëtarë: V.I., T. L., S. P., S. C., A. M., S. S., E. N., A.M., R. R.; nga Zyra e Akcizës Doganore me anëtarë G.Y., O. Z., E. J., E.T., J. A., A. B., S.S.; nga Zyra e Pikës së hyrje-daljes me anëtarë A.N., E. H., G.P., E. D., G. H., E. B., E. M., K. B.; nga Zyra e Kontrollit Aposteriori me anëtar E.L.; nga Sektori i Magazinimit të përkohshëm me anëtarë A.Q., G.U., B.N.; nga Zyra Juridike me anëtarë A.G. dhe R.I.; nga Zyra e Borxhit me J.M.; nga Zyra e Financës me anëtarë M.D, A.Z. dhe A.B.

Me shkresën nr. 1024/4 prot., datë 18.04.2025, DD Tiranë ka përcjellë rekomandimin e KLSH-së për kompetencë, në DPD.

Me shkresën nr. 10/2 prot., datë 24.01.2025, Drejtori i Përgjithshëm i DPD ka nxjerrë urdhër për analizimin, vlerësimin dhe zbatimin e rekomandimeve të Raportit Përfundimtar të Auditimit të Kontrollit të Lartë të Shtetit.

Me shkresën nr. 1024/23 prot., datë 12.09.2025, DD Tiranë ka përcjellë në KLSH, relacionin e grupit të punës, mbi Raportin Përfundimtar të Auditimit për periudhën 01.01.2022-31.12.2023.

Komenti i grupit të auditimit:

Për sa më sipër, nga Drejtori i Përgjithshëm i Doganave dhe Kryetari i Degës Doganore Tiranë janë marrë masa në ngritjen e grupeve të punës, me qëllim analizimin dhe vlerësimin e problematikave të konstatuara në Raportin Përfundimtar të Auditimit, të KLSH-së.

Ky rekomandim konsiderohet i pranuar dhe i zbatuar plotësisht.

1.2 Rekomandimi: Drejtoria e Përgjithshme të Doganave nëpërmjet strukturave të specializuara kontrolluese dhe konstatuese pranë DPD-së (Drejtoria e Kontrollit Pas Zhdoganimit, Drejtoria e Riskut dhe Monitorimit, Drejtoria e Tarifës dhe Origjinës, si dhe Drejtoria e Laboratorit Kimik), të ndërtojë menjëherë Programe Kontrolli për artikujt “qumësht UHT me 3.6 yndyrë dhe qumësht për kafe” “Doreza Kirurgjikale” dhe “Hudhër e ftohte”, për rillogaritje detyrime doganore për mallin “qumësht i kondensuar i mbushur me ëmbëlsire” për pagesën e taksës QPL dhe për rillogaritje detyrime doganore për mallin “Spraj (vajra te lehte), Praimer, dhe Solvent” dhe “Vaj Lubrifikant”, për pagesën e detyrimeve doganore dhe të akcizës dhe të kryejë menjëherë veprime konkrete verifikuese doganore pranë selive të ushtrimit të aktivitetit të kompanive dhe të regjistrave të kontabilitetit financiar të subjekteve me qëllim ndjekjen e kontabilizimit të të ardhurave doganore të munguara të llogaritura në **shumën 173,484,666 lekë** (nga të cilat shuma prej 83,272,639 lekë për vitin 2023 dhe shuma prej 90,212,026 për vitin 2022), si dhe llogaritjen e gjobave si pasojë e keq deklarimit dhe shmangies së pagesës së detyrimeve doganore nga deklaruesit e drejtpërdrejtë apo të tërthortë agjencitë doganore respektive bazuar në kërkesat e nenit 250.1/a; 250.4; 256.1/a dhe 256.1/b të KD.

Përgjigja e subjektit:

Me shkresën nr. 1024/4 prot., datë 18.04.2025, DD Tiranë e ka përcjell rekomandimin e KLSH-së për kompetencë, në DPD.

a) Me shkresën nr. 2294 prot., datë 21.03.2025, DD Tiranë i dërgon DOH dhe DARM propozim për profil risku për artikullin “qumësht për kafe”, klasifikuar në kodin tarifor 19019099.

Me shkresën nr. 11594 prot., datë 05.06.2025, Drejtoria e Kontrollit Paszhdoganimit në DPD, njofton se: me shkresën nr. 10952 prot., datë 27.05.2025 i është drejtuar Drejtorisë së Analizës së Riskut dhe Monitorimit ku ka kërkuar që, bazuar në Manualin nr. 02, datë 31.03.2016, të shqyrtojë mundësinë e implementimit të profilit të riskut me qëllim saktësimin e klasifikimit tarifor të artikujve “qumësht i kondensuar” dhe “qumësht UHT 3.6% yndyrë dhe qumësht për kafe”.

Konkluzioni mbi klasifikimin tarifor pas analizave laboratorike dhe konfirmimit nga Sektori i Tarifës do të ndihmojë Drejtorinë e Kontrollit Paszhdoganimit në kryerjen e kontrollit mbi importet e këtyre artikujve.

Me shkresën nr. 12135 prot., datë 13.06.2025, Drejtoria e Analizës së Riskut dhe Monitorimit informon se ka marrë në analizë të gjithë artikujt e cituar në gjetjen e KLSH-së, sipas problematikave të ngritura dhe do të paraqesë në Komisionin e Menaxhimit të Riskut, propozimet përkatëse me qëllim përmbushjen e rekomandimeve dhe përmirësimin e punës.

Aneksi nr. 4.62 Subjekti “I” sh.p.k. me numër NIPT K. kryen aktivitet tregtar prej vitit 2009 pranë DD Tiranë. Produkti “Qumësht i kondensuar” në kodin tarifor 04049083 të NKM-së, klasifikimi në kodin tarifor 04049083 të NKM-së mendojmë se është i saktë;

b) Me shkresën nr. 11594 prot., datë 05.06.2025, Drejtoria e Kontrollit Paszhdoganimit në DPD, njofton se, Departamenti Teknik ka dërguar në DD Kapshticë shkresën nr. 4030/1 prot., datë 08.03.2011, si dhe me shkresën nr. 6724 prot., datë 09.03.2016 të Drejtorisë së Tarifës dhe Origjinës kanë dhënë udhëzim/interpretim shterues mbi klasifikimin tarifor të “hudhrës së ftohtë apo të freskët” dhe “hudhrës së tharë”. Qëllimi i udhëzimit ka qenë unifikimi dhe zbatimi korrekt i klasifikimit të hudhrës.

Aneksi nr. 4.68 Për praktikën që i përkasin importit të artikullit “*hudhër*” me deklarues subjektin “J”, dhe “O” produkti “*hudhër e thatë*” është klasifikuar në kodin tarifor 07032000, në përputhje me klasifikimin e kryer në certifikatën e origjinës.

c) Aneksi 4.73/Aneksi 4.74 Në lidhje me keqklasifikimin e artikullit “*qumësht për kafe dhe përgatitje me bazë qumështi*” deklaruar në kreun 1901, të kryera nga subjekti “K” me NIPT K. dhe “K” me NIPT L. janë marrë mostra për analizim nga Laboratori Doganor dhe klasifikimi i këtij artikulli ka rezultuar sipas deklaramit të subjektit.

d) Me shkresën nr. 11594 prot., datë 05.06.2025, Drejtoria e Kontrollit Paszhdoganimit në DPD bën me dije se referuar pikave 2 dhe 3, neni 2 të ligjit nr. 61/2012 “Për Akcizat në RSH”, ky ligj nuk ka përcaktuar produktet “Spraj (vajra të lehtë), Pramer dhe Solvent” si produkte që duhet të paguajnë detyrim akcize.

e) Në lidhje me keqklasifikimin e artikujve “doreza kirurgjikale me një përdorim” të trajtuar në Anekset 4.80 - 4.81 të RPA, për praktikën doganore që i përkasin importeve për artikullin “*doreza ekzaminimi*” është llogaritur detyrim doganor shtesë në vlerën 31,531,527 lekë dhe 4,673,342 lekë, në total 36,207,869 lekë dhe propozohet penalitet sa një fish i diferencës së pretenduar për shkak të keqklasifikimit.

Pasi u kryen verifikimet në dokumentacionin bashkëlidhur deklaratave doganore, si edhe sqarimeve e dokumentacionit të depozituar nga importuesi me shkresën të protokolluar në DD Tiranë me numër 12070/1, datë 31.01.2023, rezulton se:

Sipas deklaratave të cituara në RPA, është importuar artikulli “*doreza ekzaminimi të masave të*

ndryshme”, me origjinë nga Malaysia, produkti është klasifikuar në kodin tarifor 40151100, në dokumentacionin shoqërues dhe përshkrimin në kutinë 31 të deklaratave të importit, produkti emërtohet “doreza ekzaminimi Latex”, duke specifikuar standartin EN 455-1, EN 455-2, si edhe përmasat, përbërjen dhe karakteristikat e secilit produkt (një përdorimshe), në disa prej dokumentave shoqërues produkti është klasifikuar në Nënkreun tarifor 401511, në etiketën e paketimit shoqërues artikulli përmban markimin CE.

Sipas emërimit e përshkrimit në Nomenklaturën e Kombimuar të Mallrave artikulli “doreza prej gome” klasifikohet në: Dorezat, dorezat e boksit dhe ato pa gishta: 40151100 – Kirurgjikale dhe 40151911 – Të tjera.

Referuar Notave Shpjeguese të Nomenklaturës së Kombinuar të Mallrave, interpretimeve të dhëna nga Departamenti Teknik në DPD, me shkresën nr. 29352 Prot., datë 15.12.2016 “Tërheqje vëmendje në lidhje me klasifikimin tarifor të dorezave ekzaminuese njëpërdorimëshe”, për kodin 4015 11 00 specifikohet se: “Ky kod kuptohet vetëm në dorezat kirurgjikale në paketime sterile. Gjithashtu përfshin dhe dorezat të cilat kanë standartin EN 455-1, EN 455-2, të përputhshëm apo ekuivalente”;

Në pikën 2, të shkresës së Departamentit Teknik me Nr. 29352 Prot, datë 15.12.2016, specifikohet se: “Në rastet kur, nga ana e operatorëve ekonomikë, deklarohet se dorezat e ekzaminimit që përmbajnë markimin CE dhe njëkohësisht, përmbushin standartin EN 455-1 dhe EN 455-2, ky standart mund të jetë ose jo i stampuar në etiketën e paketimit, por duhet të jetë i konfirmuar nga dokumentacioni shoqërues i mallrave të lëshuar nga prodhuesi (si certifikata e analizash, certifikatë konformiteti, etj.) që vërtetojnë plotësimin e këtyre standardeve. Në këto raste artikulli “doreza ekzaminimi njëpërdorimëshe” do të klasifikohet në kodin tarifor 4015 11 00 të NKM”.

Mbështetur në sqarimet, faktet dhe interpretimet e përmendura më lart, rezulton se produkti “doreza ekzaminimi të masave të ndryshme”, plotëson kushtet e specifikuar në NKM, Notat Shpjeguese të NK, si edhe interpretimet e dhëna nga Departamenti Teknik në shkresën nr. 29352 Prot, datë 15.12.2016, për t’u klasifikua në kodin tarifor 4015 11 00. kodi tarifor është i specifikuar në faturën tregtare. Shumica e praktikave doganore janë profilizuar nga sistemi në kanal të kuq dhe kontrolli fizik konfirmon se artikulli është sipas deklaramit, ndaj nuk lindin detyrime doganore shtesë.

Komenti i grupit të auditimit:

Nga rekomandimi mbi ndjekjen e kontabilizimit të të ardhurave doganore të munguara të llogaritura në shumën 173,484,666 lekë nga të cilat shuma prej 83,272,639 lekë për vitin 2023 dhe shuma prej 90,212,026 për vitin 2022), sqarojmë se:

-shuma 81,962,208 lekë i përkasin artikullit “qumësht i kondësuar” dhe “qumësht UHT 3.6% yndyrë dhe qumësht për kafe” në Aneksin nr. 4.62;

-shuma 714,111 lekë, i përkasin artikujve “hudhrës së ftohtë apo të freskët” dhe “hudhrës së tharë” në Aneksin nr. 4.68;

-shuma 44,895,184 lekë i përket artikullit “qumësht për kafe dhe përgatitje me bazë qumështi” deklaruar në kreun 1901, Aneksi 4.73/Aneksi 7.74;

-shuma 9,705,294 lekë i përket artikujve “Spraj (vajra te lehte), Practioner, dhe Solvent” “Vaj Lubrifikant”, të mallrave që klasifikohen në kreun “2710” dhe *34*;

-shuma 36,207,869 lekë i përket artikullit “Doreza kirurgjikale” të deklaruara në kodin tarifor “40151200”, për të cilat DD Tiranë ka argumentuar se nuk lindin detyrime shtesë.

Nga ana e Drejtorisë së Tarifës dhe Origjinës dhe Drejtoria e Laboratorit Kimik nuk u paraqitën dokumente justifikuese mbi zbatimin e këtij rekomandimi.

Nuk janë marrë në shqyrtim, sipas shkresës nr. 11594 prot, datë 05.06.2025, Drejtoria e Kontrollit

Paszhdoganimit në DPD, njofton se, Departamenti Teknik ka dërguar në DD Kapshticë shkresën nr. 4030/1 prot, datë 08.03.2011, si dhe me shkresën nr. 6724 prot, datë 09.03.2016 të Drejtorisë së Tarifës dhe Origjinës kanë dhënë udhëzim/interpretim shterues mbi klasifikimin tarifor të “hudhrës së ftohtë apo të freskët” dhe “hudhrës së tharë”. Qëllimi i udhëzimit ka qenë unifikimi dhe zbatimi korrekt i klasifikimit të hudhrës.

Ky rekomandim konsiderohet i pranuar pjesërisht dhe i pa i zbatuar

C. Zbatimi i rekomandimeve për të ardhura të munguara Ecuria e zbatimit dhe analizimi i rekomandimeve: rekomandime të pranuar dhe nga këto, sa janë zbatuar plotësisht; zbatuar pjesërisht, në proces zbatimi dhe rekomandimet e pa zbatuara.

1.1 Rekomandimi: Dega Doganore Tiranë në bashkëpunim me Drejtorinë e Përgjithshme të Doganave të marrë masa të menjëhershme me qëllim fillimin e procedurave ligjore sipas legjislacionit në fuqi për zbatimin ligjor të konstatimeve të trajtuara në këtë Raport Përfundimtar të Auditimit duke përfshirë shqyrtimin, vendimmarrjen, kontabilizimin dhe më pas arkëtimin e detyrimeve doganore të munguara të rilogaritura në **shumën 417,679,279 lekë.**

Përgjigja e subjektit:

Me shkresën nr. 1024/15 prot., datë 02.05.2025, DD Tiranë e ka përcjell rekomandimin e KLSH-së për kompetencë, Drejtorisë së Kontrollit pas Zhdoganimit në DPD.

Me Relacionin e përcjellë në KLSH, me shkresën nr. 1024/23 prot., datë 12.09.2025 DD Tiranë sqaron se:

Aneksi nr. 4.1, 4.2, 4.3 dhe 4.4 Për deklaratat që i përkasin importit të artikujve mish/pa kocka; mish gjedhi tremiks; mish pule; fileto pule; kofshe derri; kofshe derri/me kocke; mish koke pa kocke/derri; mish/gjedhi/musku; paste MDM; shpatull derri” të klasifikuar në Kapitullin 02, DD Tiranë nuk ka dalë me vendimmarrje.

Me shkresën nr. 1024/31 prot., datë 12.09.2025 DD Tiranë i ka dërguar kërkesën për verifikim DOH dhe DIARM në DPD, për importet e kryera nga subjekti “Z” SHPK, për artikujt të ndryshëm ushqimor.

Me shkresën nr. 1024/32 prot., datë 12.09.2025 DD Tiranë i ka dërguar kërkesën për verifikim DOH dhe DIARM në DPD, për importet e kryera nga subjekti “A” SHPK, për artikujt të ndryshëm ushqimor.

Aneksi nr. 4.5 Për deklaratat që i përkasin importit të artikullit “stomak pule” të klasifikuar në Kapitullin 05, DD Tiranë nuk ka dalë me vendimmarrje.

Me shkresën nr. 1024/30 prot., datë 12.09.2025 DD Tiranë i ka dërguar kërkesën për verifikim DOH dhe DIARM në DPD, për importet e kryera nga subjekti “E” SHPK, për artikujt të ndryshëm ushqimor.

Aneksi nr. 4.6 Për deklaratat që i përkasin importit të artikujve “Cigare Compact 4” të klasifikuar në Kapitullin 24, për subjektin ”P” me NIPT K., DD Tiranë ka dalë me vendimmarrje për rikupërim detyrimi doganor në shumën 3,591,382 lekë.

Aneksi nr 4.7 Për deklaratat që i përkasin importit të artikujve “*fruta të thata: arra; hurma arabie*” të klasifikuar në Kapitullin 08, DD Tiranë nuk ka dalë me vendimmarrje.

Aneksi nr. 4.8 dhe 4.9 Për deklaratat që i përkasin importit të artikujve “cokokrem”; “kakao” dhe “cokollatë” të klasifikuar në Kapitullin 18, DD Tiranë nuk ka dalë me vendimmarrje.

Me shkresën nr. 3163 prot., datë 23.04.2025 DD Tiranë i ka dërguar kërkesën për verifikim DOH dhe DIARM në DPD, për importet e kryera nga subjekti “P” SHPK, për artikujt të ndryshëm ushqimor, bashkëlidhur edhe shkresa nr. 3164 prot., datë 23.04.2025 DD Tiranë për artikullin

“cokocrem”.

Me shkresën nr. 1024/26 prot., datë 12.09.2025 DD Tiranë i ka dërguar kërkesën për verifikim DOH dhe DIARM në DPD, për importet e kryera nga subjekti “L”, për artikujt “kek dhe çokollatë”.

Aneksi nr. 4.10 Për deklaratat që i përkasin importit të artikujve “pije/leng/fruta” të klasifikuar në Kapitullin 20, për subjektin “J” me NIPT L., DD Tiranë ka dalë me Vendimin nr. 424, datë 11.08.2025 për rikupërim detyrimi doganor në shumën 114,370 lekë.

Aneksi nr. 4.15 Për deklaratat që i përkasin importit të artikujve “pije/leng/fruta” të klasifikuar në Kapitullin 20, për subjektin “B” me NIPT L., DD Tiranë ka dalë me vendimmarrje për rikupërim detyrimi doganor në shumën 114,370 lekë.

Aneksi nr. 4.12 Për deklaratat që i përkasin importit të artikullit “*kikirika te pjekur*” të klasifikuar në Kapitullin 2008, nuk lindin detyrime doganore shtesë.

Me shkresën nr. 2125 prot., datë 13.03.2025 DD Tiranë i ka dërguar kërkesën për verifikim DOH dhe DIARM në DPD, për importet e kryera nga subjekti “F” PF, për artikujt “arra”.

Aneksi nr. 4.11, 4.13, 4.14 dhe 4.16 Për deklaratat që i përkasin importit të artikujve “*kerpudha te konsevuar – ne tretesire ujore*” të klasifikuar në Kapitullin 2003, “*domate e konservuar*” të klasifikuar në Kapitullin 2002 dhe “*ketchup*” të klasifikuar në Kapitullin 2005 dhe 20, DD Tiranë nuk ka dalë me vendimmarrje.

Aneksi nr. 4.17 Për deklaratat që i përkasin importit të artikujve “pije energjike në ambalazh 0.25 lt” të klasifikuar në kreun 2202, janë mbajtur 14 vendime për deklaratat e subjektit “J” me NIPT L., në vlerën totale prej 598,477 lekë.

Ndërsa për 11 praktika në vlerën 297,852 lekë të po këtij subjekti, është ndërhyrë nga personeli i SVQ sipas vlerës 0.83 euro/lt në momentin e pranimit të deklaratës doganore.

Për deklaratat që i përkasin importit të artikujve “pije energjike” të klasifikuar në kreun 2202, DD Tiranë nuk ka dalë me vendimmarrje. Nga analiza e indikatorëve rezulton se përzgjedhja e metodës për vlerësimin doganor është në përputhje me kërkesat e legjislacionit doganor në fuqi.

Me shkresën nr. 1024/29 prot., datë 12.09.2025 DD Tiranë i ka dërguar kërkesën për verifikim DOH dhe DIARM në DPD, për importet e kryera nga subjekti “T”, për artikujt të ndryshëm ushqimor.

Aneksi nr. 4.18, 4.19 dhe 4.20 Për deklaratat që i përkasin importit të artikujve “birrë Përoni”, “Birre/Carlsberg 0.33 liter” dhe “Birre/Tuborg 0.33 liter” të klasifikuar në Kapitullin 22, DD Tiranë nuk ka dalë me vendimmarrje.

Aneksi nr. 4.21 Për deklaratat që i përkasin importit të artikujve “Frut molle i thare/copa” të klasifikuar në Kapitullin 23. Nga analiza e indikatorëve rezulton se përzgjedhja e metodës për vlerësimin doganor është në përputhje me kërkesat e legjislacionit doganor në fuqi.

Me shkresën nr. 1024/28 prot., datë 12.09.2025 DD Tiranë i ka dërguar kërkesën për verifikim DOH dhe DIARM në DPD, për importet e kryera nga subjekti “C” SHPK për artikujt të ndryshëm ushqimor.

Aneksi nr. 4.23 Në lidhje me importet e artikullit “ushqim për qen dhe mace” të klasifikuar në Kapitullin 23, në vlerën 424,721 lekë sipas RPA, DD Tiranë nuk ka dalë me vendimmarrje.

Aneksi nr. 4.22, 4.24 dhe 4.25 Në lidhje me importet e artikullit “Boje Hidromat”, “mastice/ngjitës; pigment”, “pigment” të klasifikuar në Kapitullin 32, DD Tiranë nuk ka dalë me vendimmarrje.

Aneksi nr. 4.26 Për deklaratat që i përkasin importit të artikujve Letra të lagura dhe sapun i lëngshëm, Detergjent leng; DD Tiranë nuk ka dalë me vendimmarrje.

Me shkresën nr. 1024/24 prot., datë 12.09.2025, DD Tiranë ka dërguar kërkesën për verifikim

DOH dhe DIARM, në lidhje me improtet e kryera nga subjekti “E”, “H”, për artikullin “letër e lagur”.

Me shkresën nr. 1024/25 prot., datë 12.09.2025, DD Tiranë ka dërguar kërkesën për verifikim DOH dhe DIARM, në lidhje me improtet e kryera nga subjekti “E” SHPK për artikullin “letër e lagur”.

Aneksi nr. 4.26 dhe 4.27 Për deklaratat që i përkasin importit të artikujve Letra të lagura dhe sapun i lëngshëm, Detergjent leng; Sapun/leng; Zbutesh/ Rrobash; Solucion Enesh; Zbutesh/ Rrobash të klasifikuar në Kapitullin 34, DD Tiranë nuk ka dalë me vendimmarrje.

Aneksi nr. 4.29 Për deklaratat që i përkasin importit të artikujve “aditiv betoni” të klasifikuar në Kapitullin 38, DD Tiranë nuk ka dalë me vendimmarrje.

Aneksi nr. 4.30 Për deklaratat që i përkasin importit të artikujve “Lekure e njome” të klasifikuar në Kapitullin 41, DD Tiranë ka dalë me vendimmarrje në shumën 11,726,000 lekë.

Aneksi nr. 4.31 Për deklaratat e artikujve “betoforma druri të përdorura për ndërtim” të klasifikuar në Kapitullin 44, DD Tiranë ka marrë vendime për subjektin A. M. me vendimin nr. 414, datë 06.08.2025, në shumën 25,084 lekë; A. M. me vendimin nr. 397, datë 05.08.2025, në shumën nr. 9,389 lekë; F. L. L. me vendimin nr. 396, datë 05.08.2025, në shumën 13,138 lekë; E. NIPT J. me vendimin nr. 393, datë 04.08.2025, në shumën 150,000 lekë, pasi nga verifikimi rezultoi se subjekti ka deklaruar “panelet druri për dyer të brendshme”; S. NIPT L., për DAV R52311 me vendimin nr. 395, datë 05.08.2025 në shumën 18,356 lekë; për “A” L.; “A” M.; “A” K.; “G” SHPK K.; “I” K.; “N” K.; “S” K.; “S” K. për rikupërim detyrimi doganor në shumën totale 365,694 lekë vetëm për ato raste në të cilat vlera e deklaruar është nën vlerën 140 euro/m³. Në të gjitha rastet e rivlerësimit të artikullit “betoforma druri të përdorura” nga DVQ dhe nga DD Tiranë është aplikuar vlera 140 euro/m³.

Për të gjitha rastet e tjera të artikullit “betoforma druri të përdorura për ndërtim” të klasifikuar në Kapitullin 44, si dhe duke marrë në konsideratë që pesha specifike e 1m³ betoforma druri është 650 kg, vlera e deklaruar nga subjektet ka qënë me e lartë se 140 euro/m³, DD Tiranë nuk ka dalë me vendimmarrje.

Aneksi nr. 4.32 Për deklaratat që i përkasin importit të artikujve “MDF e Veshur” të klasifikuar në Kapitullin 44, DD Tiranë nuk ka dalë me vendimmarrje.

Për deklaratat që i përkasin importit të artikullit “fije për prodhim litari” deklaruar në kreun *5407* të kryera nga subjekti “F” me NIPT K.. Nga ana e subjektit është depozituar Vendimi nr 101 dt. 04.09.2021 I Deges se Doganes Kapshtice sipas se ciles për praktika te meparshme për importe te ketij subjekti te njihet transaksioni.

Nga ana e operatorit janë depozituar dokumentat shtesë, justifikues për vlerën e transaktuara si: Transfertat Bankare të likuidimeve dhe Deklaratat e Eksportit të cilat ndodhen bashkëlidhur praktikave doganore. Për këtë artikull nuk mund të aplikohet vlera sipas Urdhërit nr 779 Prot DPD dt. 16.01.2013 të Drejtorit të Përgjithshëm të Doganave ”Mbi rishikimin e disa indikatorëve kontrolli shtesë në vlerësimin doganor të mallrave me origjinë nga vendet jashtë BE/NEU”, pasi indikatorët e vlerësimit egzistojne për pelhurat si produkt i përfunduar. nga verifikimi i dokumentacionit bashkëngjitur rezulton se vendi i origjines, vendi i eksportit dhe vendi i transaksionit është Turqia, gjithashtu për këto artikuj nuk egzistojnë vlera në dosjen e të dhënave të disponueshme, faturat shoqëruese të mallit përmbajnë informacion të plotë e të detajuar për çmimet e mallit, në zbatim të kërkesave të pikes 161 të VKM nr 651 dt. 10.11.2017 Dispozitat Zbatuese të Kodit Doganor të RSH i është kërkuar importuesve dokumentacion shtesë për të vërtetuar vlerën e transaksionit, janë depozituar, transfertat bankare e pagesave të kryera, te cilat ndodhen bashkëlidhur deklaratave doganore, nga verifikimi i informacionit që përmbajnë këta

dokumenta justifikohet rregullsisia e vlerave të pasqyruara në faturat shoqëruese të mallit. Nga analiza e indikatorëve e fakteve të mësipërme rezulton se përzgjedhja e metodës për vlerësimin doganor është në përputhje me kërkesat e legjislacionit doganor në fuqi.

Për deklaratat që i përkasin importit të artikullit “fije për prodhim thasë” deklaruar në kreun *5407* të kryera nga subjekti “G”, të përmendura në aneksin 4.33, vlerësimi është kryer bazuar në nenin 66 të Ligjit 102/2014 "Kodi Doganor i Republikës së Shqipërisë", datë 31.07.2014 si dhe pikës 4.1 të Udhëzimit të Ministrit të Financave dhe Ekonomisë Nr. 3, dt. 23.01.2018 “Për vlerësimin e mallrave për qëllime doganore” është pranuar transaksioni si vlerë doganore.

Në këtë rast artikulli i deklaruar nuk është pëlhurë për veshmbathje por pëlhurë e thurur me fije polipropileni për thasë.

Për këtë artikull nuk mund të aplikohet vlera sipas Urdhërit nr 779 Prot DPD dt. 16.01.2013 të Drejtorit të Përgjithshëm të Doganave “Mbi rishikimin e disa indikatorëve kontrolli shtesë në vlerësimin doganor të mallrave me origjinë nga vendet jashtë BE/NEU”, pasi indikatorët e vlerës egzistojnë për përlhurat si produkt i përfunduar.

Nga ana e operatorit janë depozituar dokumentat shtesë, justifikues për vlerën e transaktuara si: Transfertat Bankare të likuidimeve dhe Deklaratat e Eksportit të cilat ndodhen bashkëlidhur praktikave doganore.

Aneksi nr. 4.34 Për deklaratat që i përkasin importit të artikullit “pëlure” deklaruar në kreun *54 dhe 60*, DD Tiranë ka dalë me vendimet nr. 290/2024; 281/2024 dhe 291/2024 për praktikatat doganore të subjektit “D” me NIPT M. në shumën 197,213 lekë.

Për praktikatat doganore të subjektit F” me NIPT L., DD Tiranë ka marrë vendimin nr. 399, datë 05.08.2025, në shumën 24,505 lekë; për N. me NIPT L. ka marrë vendimin nr. 415, datë 06.08.2025, në shumën 13,592 lekë. Për praktikën doganore R61782 të subjektit “D” me NIPT K. është vjelë detyrimi doganor sipas rekomandimit të KLSH, në shumën 15,400 lekë me anë të ndërhyrjes aposteriori.

Ndërsa në lidhje me praktikën 90525 të subjektit “M” me NIPT L., nga verifikimi rezultoi se ka mbetje nga procesi i prodhimit pas përpunimit nën RPA. Për deklaratat doganore R 115042 dhe 120548 të subjektit “N” me NIPT J., DD Tiranë nuk ka dalë me vendimmarrje.

Aneksi nr. 4.35 DD Tiranë ka dalë me vendimmarrje për rivlerësim për 78 deklarata doganore me vlerën 4,618,957 lekë. Për rastet e tjera nuk ka vendimmarrje.

Me shkresën nr. 3860 prot., datë 19.05.2025 DD Tiranë i ka dërguar kërkesën për verifikim DOH dhe DIARM në DPD, për importet e kryera nga subjekti “E” PF, për artikujt të ndryshëm ushqimor.

Aneksi nr. 4.36 Për deklaratat që i përkasin importit të artikullit “mbulese krevati/jorgan” deklaruar në kreun *94*, duhet të aplikohet vlera 660 lekë/kg CIF, sipas Urdhrit nr. 779 prot., datë 16.01.2013, të Drejtorit të Përgjithshëm të Doganave “Mbi rishikimin e disa indikatorëve kontrolli shtesë në vlerësimin doganor të mallrave me origjinë nga vendet jashtë BE/NEU”, nuk ekziston asnjë indikator vlere për artikullin “jorgan”, por specifikohet se vlera prej 660 lekë/kg CIF duhet të aplikohet për artikujt të kreut 6302 (batanije) dhe jo për kapitullin *94. Për sa më sipër DD Tiranë nuk ka dalë me vendimmarrje.

Aneksi nr. 4.37 Për deklaratat që i përkasin importit të artikullit “shtupa” deklaruar në kreun *9603 për subjektin “M” me NIPT K., duhet të aplikohet vlera 5.5 USD/kg sipas vlerave që gjenden në Dosjen e të Dhënave të Disponueshme. Në Dosjen e të Dhënave të Disponueshme nuk ekziston asnjë vlerë referuese për artikullin “shtupa me mikrofiber” deklaruar në kreun *9603, por ekziston vlera 5.5 USD/kg për artikullin peceta mikrofibër në kapitullin 63, deklaruar në kreun *9603. Për sa më sipër DD Tiranë nuk ka dalë me vendimmarrje.

Aneksi nr. 4.38 për deklaratat që i përkasin importit të artikullit “flokë/thonj fallco” deklaruar në

kreun *6704 për subjektin “P” me NIPT L., duhet të aplikohet vlera 7 USD/kg. Në Dosjen e të Dhënave të Disponueshme nuk ekziston asnjë vlerë referuese për artikullin “flokë/thonj fallco”, por në Database Kombëtar të Vlerësimit rezulton se vlerat e deklaruara nga subjekti, përkojnë me vlerat e deklaruara nga operatorët e tjerë nga i njëjti vend origjine. DD Tiranë nuk ka dalë me vendimmarrje.

Për deklaratat doganore R5836 dhe 6620 të subjektit “G” me NIPT K. Ndërsa për praktikën e tabelës së mëposhtme është ndërhyrë nga personeli i SVQ sipas vlerës 4.1 USD/kg në momentin e pranimit të deklaratës doganore.

Për deklaratat doganore R134795 dhe R64065 të subjektit “I” me NIPT M. Ndërsa për praktikën e tabelës së mëposhtme është ndërhyrë nga personeli i SVQ sipas vlerës 4.1 USD/kg në momentin e pranimit të deklaratës doganore.

Për deklaratat doganore R1567 dhe R5578 të subjektit “K” me NIPT K. nga verifikimi rezulton se vlera e deklaruar është më e lartë se vlera referuese 4.1 USD/kg.

Me shkresën nr. 6644/1 prot., datë 13.05.2025, DTO në DPD i ka kthyer përgjigje shkresës nr. 2426, datë 28.03.2025 të DD Tiranë, mbi klasifikimin tarifor për artikullin “thonj plastik fallco dhe maja plastike për thonj”, klasifikimi i të cilit në këtë rast, përcaktohet nga Regulli i Përgjithshëm Interpretues 1 dhe 6 i NKM-së, si dhe në përshkrimin e kodit tarifor 39264000.

Aneksi nr. 4.38 DD Tiranë ka dalë me vendimmarrje për rivlerësim për 6 deklarata doganore me vlerën 193,118 lekë.

Aneksi nr. 4.39 Për deklaratat që i përkasin importit të artikujve “membrane” të klasifikuar në Kapitullin 69, për subjektin “E” dhe “I” u verifikua dokumentacioni bashkalidhur praktikave doganore. Në zbatim të rekomandimeve të lëna, janë dërguar për verifikim pranë autoriteteve doganore homologe:

- me shkresën Nr.10136 Prot., datë 28.10.2022, pranë Departamentit Operativ Hetimor praktikat doganore R 60588, datë 29.06.2021, R 104529, datë 26.10.2021 dhe R 118882, datë 03.12.2021, me importues Subjektin “E”, sipas shkresës Nr.22037/1 Prot., datë 30.12.2022, nga DOH është konfirmuar rregullsia e transaksioneve të deklaruara në dokumentacionin shoqërues të këtyre deklaratave,

- me shkresën Nr.10135 Prot., datë 28.10.2022, janë dërguar për verifikim pranë Departamentit Operativ Hetimor praktikat doganore R 104273, datë 26.10.2021, R 106539, datë 01.11.2021 dhe R 112528, datë 13.12.2021, me importues Subjektin “I”, sipas shkresës Nr.22119/2 Prot., datë 11.01.2023, nga DOH është konfirmuar rregullsia e transaksioneve të deklaruara në dokumentacionin shoqërues të këtyre deklaratave,

- me shkresën Nr.10137 Prot., datë 28.10.2022, janë dërguar për verifikim pranë Departamentit Operativ Hetimor praktikat doganore R 100880, datë 18.10.2021, R 107732, datë 04.11.2021 dhe R 84886, datë 04.09.2021, me importues Subjektin “M”. Për sa më sipër, në varësi të konfirmimeve nga autoritetet doganore homologe të transaksioneve të kryera për praktikën e tjera të dërguara për verifikim, do të rishikohen edhe detyrimet e rillogaritura në Tabelën 41 për artikullin “membrane bituminoze”. Nga verifikimi i dokumentacionit bashkëngjitur rezulton se çmimet e deklaruara janë në të njëjtin nivel me të dhënat e bursës. DD Tiranë nuk ka dalë me vendimmarrje.

Aneksi nr. 4.40 Për deklaratat që i përkasin importit të artikujve “llamarinë” të klasifikuar në Kapitullin 72, për subjektin “N” me NIPT K., faturat shoqëruese përmbajnë informacion të plotë e të detajuar për çmimet e mallit, nga ana e importuesit është depozituar dokumentacion shtesë për të vërtetuar vlerën e transaksionit. Vlerat e deklaruar janë në përputhje me vlerat e buletinit të bursës për periudhën në fjalë. DD Tiranë nuk ka dalë me vendimmarrje.

Aneksi nr. 4.41 -Për deklaratat që i përkasin importit të artikullit “artikuj metalik”, R107165 të vitit 2022 e cila i përket subjektit “G” me NIPT L. rivleresimi nuk qëndron pasi nga verifikimi i dokumentacionit bashkëngjitur rezulton se artikulli i deklaruar është profil metalik për mbajtjen e pllakave të gipsit. Vlera e deklaruar është mbi vlerën e të dhënave të bursës për periudhën në fjalë. Me shkresën nr. 1024/27 prot., datë 12.09.2025 DD Tiranë i ka dërguar kërkesën për verifikim DOH dhe DIARM në DPD, për importet e kryera nga subjekti “G”, për artikujt “bojra dhe materiale ndërtimi”.

-Për deklaratën doganore R98566 të vitit 2022 e cila i përket subjektit “A” me NIPT L. rivleresimi nuk qëndron pasi lloji i monedhës së deklaruar është GBP dhe si rrjedhojë e diferencave në kursin e këmbimit ndërmjet monedhës Euro dhe GBP nuk ka vend për rivlerësim.

Për deklaratën doganore R94630; R64607 dhe R20575 të vitit 2022, e cila i përket subjektit “M” me NIPT K.; Për deklaratat doganore R117377; R29803 dhe R92588 të vitit 2022, e cila i përket subjektit “D” me NIPT K.; Për deklaratën doganore R20173 të vitit 2023, e cila i përket subjektit “P” me NIPT J., rivleresimi nuk qëndron pasi nga verifikimi i dokumentacionit bashkëngjitur, rezulton se artikulli i deklaruar është tel për susta dhe jo susta të gatshme. Vlera e deklaruar është mbi vlerën e të dhënave të bursës për periudhën në fjalë.

Për deklaratat doganore R55143 dhe R110000 të vitit 2023 e cila i përket subjektit “E” me NIPT K. rivleresimi nuk qëndron pasi nga verifikimi i dokumentacionit bashkëngjitur rezulton se artikulli i deklaruar është shina për vagonat e minierave. Vlera e deklaruar është mbi vlerën e të dhënave të bursës për periudhën në fjalë.

Për deklaratat e mësipërme DD Tiranë nuk ka dalë me vendimmarrje.

Për deklaratën doganore R54207 të vitit 2022 e cila i përket subjektit “A” me NIPT L. është vjelë detyrimi nga ndërhyrja e aposteriorit sipas rekomandimit të KLSH.

Për deklaratën doganore R74466 të vitit 2022 e cila i përket subjektit “T” me NIPT L. është vjelë detyrimi nga ndërhyrja e aposteriorit sipas rekomandimit të KLSH.

Aneksi nr. 4.42 -Për deklaratat që i përkasin importit të artikullit “artikuj metalik, mbajtëse metalike, punto të përdorurua”, të subjektit “E” me NIPT L. është vjelë detyrimi nga ndërhyrja e aposteriorit sipas rekomandimit të KLSH;

-Për deklaratat doganore të subjektit “E” me NIPT K. dhe “I” me NIPT L. është vjelë detyrimi nga ndërhyrja e aposteriorit sipas rekomandimit të KLSH;

Për deklaratat doganore të subjektit “S” me NIPT K. është vjelë detyrimi nga ndërhyrja e aposteriorit sipas rekomandimit të KLSH;

-Për deklaratën doganore R1687 dt. 13.01.2022 të cilat i përket subjektit “Q” me NIPT K. me të cilën ka deklaruar artikullin “lopata”, nga verifikimi rezulton se vlera e deklaruar nga subjekti është sipas vlerave që gjenden në Dosjen e të Dhënave të Disponueshme për artikullin “lopata” deklaruar në kreun 8201.

-Për deklaratat doganore që i përkasin subjektit “I” me NIPT L. janë trajtuar në Aneksin 4.71 për të cilat janë mbajtur proceverbale për rivlerësim dhe për keqklasifikim tarifor të artikullit “mbajtëse metalike”, për 20 deklarata doganore në vlerën 143,203 lekë.

-Për deklaratat që i përkasin importit të artikullit “punto të përdorurua” të cilat i përkasin subjekti “F” me NIPT M., u krye verifikimi nga Grupi i Punës dhe rezultoi se llogaritjet e kryera nga KLSH kanë gabime në llogaritje, nga rillgoritja rezultuan detyrime shtesë në shumat: R 109630 DT.21.10.2022 – 28,916 lekë; R 110017 DT.22.10.2022 – 13,525 leke; R 109141 DT.20.10.2022 – 132,177 leke. Sipas vlerave të rilllogaritura u mbajtën aktet përkatëse për vjeljen e detyrimit doganor.

-Për deklaratat që i përkasin importit të artikullit “punto të përdorurua” të cilat i përkasin subjekti

“S” me NIPT K., u krye verifikimi nga Grupi i Punës dhe rezultoi se llogaritjet e kryera nga KLSH kanë gabime në llogaritje, nga rillgoritja rezultuan detyrime shtesë në shumën: R 64988 DT.27.06.2023 – 11,627 lekë;. Sipas vlerave të rillogaritura u mbajtën aktet përkatëse për vjeljen e detyrimit doganor.

Aneksi nr. 4.43 Për deklaratat doganore R86787; R86215 dhe 86786 të subjektit “M” me NIPT K., DD Tiranë doli me vendimmarrje në vlerën totale 56,380 lekë;

Për deklaratat që i përkasin importit të artikullit “vida; gozhdë; etj”, deklaruar nga subjekti “K” me NIPT L. është vjelë detyrimi nga ndërhyrja e aposteriorit;

Ndërsa, për deklaratat doganore të subjekteve “M” me NIPT K.; “K” me NIPT L.; “A” me NIPT M.; “C” me NIPT M.; “A” me NIPT L.; “K” me NIPT K.; “N” me NIPT L.; “R” me NIPT K.; “A”SHPK” me NIPT L.; “L” me NIPT L., rivleresimi nuk qendron, vlera e deklaruar është në përputhje me të dhenat e burses;

Për deklaratat doganore të “E” me NIPT M.; “L” me NIPT K.; “D”SHPK” me NIPT L.; “M” me NIPT K.; u krye verifikimi nga Grupi i Punës dhe rezultoi se vlerat e deklaruara janë sipas publikimeve të buletinit “Metal Bulletini” të miratuara nga DPD.

Aneksi nr. 4.44 Për deklaratat të artikullit “artikuj bakri”, R73238 e subjektit “F” me NIPT L. është vjelë detyrimi nga ndërhyrja e aposteriorit.

Ndërsa, për deklaratat e subjektit “E” me NIPT L.; “P” NIPT K., u krye verifikimi nga Grupi i Punës dhe rezultoi se artikulli i deklaruar nuk është “artiikuj bakri” por janë artikuj bronzi, DD Tiranë nuk ka dalë me vendimmarrje.

Aneksi nr. 4.45 Për deklaratat që i përkasin importit të artikullit “artikuj alumini”, deklaruar në kapitullin 76 ju sqarohet se: Për deklaratat e subjektit “S.” me NIPT J., DD Tiranë ka dalë me vendimmarrje për vlerën totale 144,755 lekë;

Ndërsa, për deklaratat e artikullit “alukobond dhe vasketa alumini” të subjekteve “A” me NIPT J.; “R” me NIPT K.; “E” me NIPT K., vlerësimi është kryer bazuar në nenin 66 të Ligjit 102/2014 “KD”, është pranuar transaksioni si vlerë doganore. Në Dosjen e të Dhënave të Disponueshme nuk egzistojnë vlera referuese për artikullin “alukobond”, si rrjedhim nuk mund të përdoret vlera prej 2.7 euro/kg edhe për faktin që ky artikull vlerësohet sipas sipërfaqes në m², sipas vlerave referuese për m² që gjenden në Dosjen e të Dhënave të Disponueshme (panele alumini).

Për deklaratën doganore R7526 e të subjektit “2” me NIPT L. nga verifikimi rezulton se vlera totale e artikujve të deklaruar është më e lartë nga vlera e të Dhënave të Disponueshme. Për artikullin “shkallë alumini” deklaruar me R81984 e subjektit “P” me NIPT K. nga verifikimi rezulton se vlera totale e artikujve të deklaruar është më e lartë nga vlera e të Dhënave të Disponueshme.

Aneksi nr. 4.46 Për deklaratat që i përkasin importit të artikullit “artikuj metalik”, deklaruar në kapitullin 73, R60589 të subjektit A me NIPT L. dhe R1048 A, me NIPT L. nga verifikimi rezulton se artikujt e deklaruar janë të përdorur.

Për deklaratat doganore R107966; R29636; R78466; R37619; R101360 e cila i përket subjektit E. K. dhe R96324 e subjektit F. L. nga verifikimi rezulton se totali i vlerës së deklaruar është më e lartë se të dhënat e disponueshme.

Për deklaratat doganore R128127 dhe 12504 të subjektit I. K. nga verifikimi rezulton se artikulli i deklaruar është “Varese rrobash, prift”, observacion nga subjekti, artikulli me bazament mermeri, rivleresimi nuk qendron.

Ndërsa, për deklaratën doganore R112504 e subjektit P. L. nga verifikimi rezulton se rivleresimi i kryer nga SVQ, është aplikuar vleresimi 0.7 euro/kg. DD Tiranë ka dalë me vendimmarrje për vlerën totale 153,232 lekë.

Me shkresën nr. 4218/1 prot., datë 20.03.2025 DTO në DPD, i ka kthyer përgjigje shkresës nr. 1611 prot., datë 03.03.2025 të DD Tiranë, mbi klasifikimin tarifor për artikullin “varëse rrobash plastike”, sipas të cilës

Aneksi nr. 4.47 Për deklaratat që i përkasin importit të artikullit “*makineri, etj*”, DD Tiranë ka dalë me 108 vendime për vlerën totale 2,784,784 lekë.

Për deklaratën doganore R50106 të vitit 2022 e subjektit “B” me NIPT L. është vjelë detyrimi nga ndërhyrja e aposteriorit sipas rekomandimit të KLSH.

Për deklaratat doganore R133820; R132419 dhe 111707 të vitit 2022 e subjekteve “R” dhe “R” është vjelë detyrimi nga ndërhyrja e aposteriorit sipas rekomandimit të KLSH. Ndërsa për rastet e mëposhtme nuk dalë me vendimmarrje:

Për deklaratën doganore R86423 të vitit 2023 e subjektit “6” me NIPT K., nga verifikimi rezulton artikulli “rrul i përdorur” që përdoret në ngjeshje e rrugëve dhe nga personeli i SVQ është përdorur metoda 3 e rivlerësimit sipas artikujve të ngjashëm.

Për deklaratën doganore R89202 të vitit 2023 e subjektit “D” me NIPT M., rivlerësimi nuk qëndron pasi lloji i monedhës së deklaruar është GBP dhe si rrjedhojë e diferencave në kursin e këmbimit ndërmjet monedhes euro dhe GBP nuk ka vend për rivlerësim.

Për deklaratat doganore R135227 dhe R91873 të vitit 2022 e t subjektit “L” me NIPT L., nga verifikimi rezulton se për artikullin “elektroshtëpiake të përdoruara” e nga personeli i SVQ është përdorur metoda e rivlerësimit, duke i rivlerësuar artikujt me 40% të vlerës së artikujve të rinj.

Për deklaratën doganore R107617 të vitit 2023 e subjektit “R” me NIPT L., rivlerësimi nuk qëndron pasi lloji i monedhës së deklaruar është GBP.

Për deklaratën doganore R15457 të vitit 2022 e subjektit “S” me NIPT L., rivlerësimi nuk qëndron pasi vlera e deklaruar është më e lartë se vlera 0.7 euro/kg.

Për deklaratat doganore R90190; R93483 dhe R90188 të vitit 2023 e subjektit “V” me NIPT J., rivlerësimi nuk qëndron pasi lloji i monedhës së deklaruar është GBP.

Aneksi nr. 4.48 Për deklaratat që i përkasin importit të artikullit “*pjesë kembimi për automjete*” të klasifikuar në Kapitullin 8708, DD Tiranë ka dalë me 19 vendime për vlerën totale 1,172,704 lekë.

Nuk janë mbajtur vendime vetëm në 2 raste:

Për DAV R85842 e subjektit “K” me NIPT J. nga verifikimi i deklaratës rezulton se kemi të bëjmë me gabim në deklarim nga ana e përfaqësuesit të subjektit, nga ana jonë u krye amendimi aposteriori i kësaj deklarate, mbas amendimit nuk ka vend për rivlerësim.

Për DAV R12666 e subjektit “V” p.f. me NIPT L. rezulton se nga ana e personeli doganor në momentin e deklarimit është kryer rivlerësimi i artikullit të deklaruar me vlerën 1.8 euro/kg. Nga ana e subjektit ky rivlerësim është ankimuar dhe si rrjedhim në vijim të vendimit të gjykatës në favor të subjektit është kryer rimbursimi i shumës së paguar shtesë.

Sipas shkresës nr. 20980/3 prot., datë 30.12.2022, Drejtoria e Buxhetit dhe e Financës në DPD, urdhëruar DD Tiranë, që të marrë masa për amendimin e deklaratës doganore R12666 datë 14.02.2022, në shumën 372,396 lekë, si dhe zbatimin e Vendimit nr. 2851, datë 31.10.2022 të GjASHP Tiranë, konfirmuar nga Drejtoria Juridike.

Për DAV R28619; R5699 dhe R5698 të vitit 2022 të subjektit “I” me NIPT L. rezulton se nga e personeli doganor në momentin ne deklarimi është kryer rivlerësimi i artikullit të deklaruar me vlerën 1.8 euro/kg. Lloji i monedhës së deklaruar është GBP dhe si rrjedhojë e diferencave në kursin e këmbimit ndërmjet monedhes euro dhe GBP nuk ka vend për rivlerësim.

Aneksi nr. 4.49-4.50 Në lidhje me gjetjet dhe konstatimet për subjektin “M” me NIPT J. për artikullin “pelena rifuxho” deklaruar në kapitullin *96*, nga ana e DVQ duke u nisur nga lloji i

produktit është përdorur si bazë vlerësimi vlera 1 euro/kg. Në raste të mëparshme kur janë përdorur metoda alternative vlerësimi, DD Tiranë është detyruar nëpërmjet vendimeve të gjykatës të rimbursojë subjektin si psh për R 64904 dt. 27.08.2020; R 66651 dt. 02.09.2020; etj. Bashkëgjitur ju dërgohen urdhërat e rimbursimit 1833/3 Prot DPD dt. 02.04.2021 dhe 13344/1 Prot DPD dt. 30.07.2021 të Drejtorit të Përgjithshëm.

Aneksi nr. 4.52 Në lidhje me importet e artikullit “jastëk” për praktikat doganore R73223 të subjektit H. me NIPTK. dhe R82964 të subjektit I me NIPT L. është vjelë detyrimi doganor nga ndërhyrja e aposteriori pas dakordësimit të deklaruesit. Për rastet e tjera, DD Tiranë ka dalë me vendime në shumën 252,180 lekë.

Aneksi nr. 4.53 Në lidhje me importet e artikullit “lodra” nga ana e DD Tiranë janë mbajtur vendime për rikupërim të detyrimit doganor në vlerën 160,385 lekë.

Ndërsa për importet e subjektit “E ” me NIPT K., nga verifikimi rezulton se artikulli është lodër plastike e mbushur me ujë që përdoret për të krijuar flluska sapuni për argëtim.

Aneksi nr. 4.55 Në lidhje me gjetjet dhe konstatimet për subjektin “D” me NIPT L. për artikullin “vaj ushqimor” DD Tiranë ka dalë me 80 vendime, për detyrimet doganore në shumën 1,969,253 lekë dhe gjobë në shumën 3,938,556 lekë të praktikave doganore të periudhës deri më dt. 28.04.2023, kohë në të cilën ka dalë Udhëzimi nr. 12, datë 28.04.2023 i Ministrisë së Financave. Për praktikat doganore të kryera mbas datës 28.04.2023, pasi sipas të dhënave të dokumentacionit shoqërues (specifikimeve në listë ngarkesat shoqëruese të mallit), si dhe verifikimeve fizike (kontrollit fizik të kreyer nga doganierët e kontrollit fizik) pesha që zë ambalazhi plastik nuk e kalon kufirin 50% të masës së përgjithshme të ambalazhit që ambalazhon produktin, DD Tiranë nuk doli me vendimmarrje.

Aneksi nr. 4.56 Në lidhje me gjetjet dhe konstatimet për artikullin “paste dhembesh” ku operatori ekonomik nuk rezulton te keta paguar taksen e ambalazhit për pjesën plastike “*të tubetit dhe tapës*” për subjektin R me NIPT K. ka marrë vendime për detyrime doganore në shumën 7,503 lekë dhe gjobë në shumën 15,006 lekë; për E me NIPT L. ka marrë vendime për detyrime doganore në shumën 8,542 lekë dhe gjobë në shumën 17,084 lekë; për S me NIPT K. ka marrë vendime për detyrime doganore në shumën 6,684 lekë dhe gjobë në shumën 13,368 lekë; për I me NIPT L. ka marrë vendim për detyrime doganore në shumën 1,890 lekë dhe gjobë në shumën 3,780 lekë; për K me NIPT K. ka marrë vendim për detyrime doganore në shumën 7,359 lekë dhe gjobë në shumën 14,717 lekë; për M me NIPT K. ka marrë vendim për detyrime doganore në shumën 23,479 lekë dhe gjobë në shumën 46,958 lekë; për B me NIPT K. ka marrë 1 vendim për detyrime doganore në shumën 1,680 lekë dhe gjobë në shumën 3,360 lekë; për F me NIPT K. ka marrë vendime për detyrime doganore në shumën 40,723 lekë dhe gjobë në shumën 81,446 lekë; për D. me NIPT M. ka marrë vendim për detyrime doganore në shumën 15,337 lekë dhe gjobë në shumën 30,675 lekë; për N me NIPT K. ka marrë vendime për detyrime doganore në shumën 479,308 lekë dhe gjobë në shumën 958,616 lekë; në total detyrime doganore dhe gjobë në shumën 1,203,376 lekë.

Aneksi nr. 4.57 Në lidhje me gjetjet dhe konstatimet për subjektin “I” me NIPT J.F për artikullin “pastë dhëmbësh” DD Tirane nuk ka dale me vendimmarrje pasi, pesha e ambalazhit total për paketim 12 copë është diferenca ndërmjet peshës bruto dhe peshës neto, e cila në rastin konkret rezulton 387 gr. Pesha që zë materiali plastik në këtë ambalazh është 95.40 gr dhe në përqindje rezulton 24.7%. Si konkluzion, ambalazhet e produkteve “Pastë Dhëmbësh” kanë material plastik por pesha e materialit plastik në çdo rast në raport me peshën e ambalazhit total të produkteve është ndjeshëm nën 51%. Pra, për asnjë nga produktet “Pastë Dhëmbësh” që importohen nga subjekti “I” sh.p.k. nuk biem nën zbatimin e taksës së ambalazhit plastik sipas përcaktimeve të Ligjit dhe Udhëzimit për Taksat Kombëtare.

Aneksi nr. 4.58 Në lidhje me importet e artikullit “kafë në kapsula”, DD Tiranë pas verifikimit të praktikave doganore ka dalë me vendime për subjektet: B SHPK, A, N, E për detyrime TAM në shumën 498,456 dhe gjobë në shumën 498,56 lekë, total 996,912 lekë.

Aneksi nr. 4.59 Në lidhje me importet e artikullit “membrane bituminoze” ku konstatohet se kemi të bëjmë me deklarim të gabuar të llojit të ambalazhit plastik, DD Tiranë ka dalë me vendimmarrje. Ndërsa për rastet e mëposhtme: DD Tiranë nuk ka dalë me vendimmarrje në rastet e importeve të subjektit “F” me NIPT L. pasi nga verifikimi i dokumentacionit bashkëngjitur deklaratës doganore artikulli i deklaruar është “*Laminat plastic PVC*” i cili klasifikohet tek: *përshstatjet për mobilieritë dhe kodin 3926 90 97 -- të tjera*.

DD Tiranë nuk ka dalë me vendimmarrje në rastet e importeve të subjektit “I” me NIPT L. pasi nga verifikimi i dokumentacionit bashkëngjitur deklaratës doganore të cilat citohen në Raportin Përfundimtar të Kontrollit të Lartë të Shtetit nr. 10738/27 Prot. DD Tirane datë 13.01.2025 vërehet se nga ana e Drejtorisë Rajonale Tatimore Elbasan për subjektin “I” SHPK me NIPT L. janë lëshuar autorizimet nr 6792/1 Prot dt. 17.09.2021; nr 6792/1 Prot. Dt. 17.09.2021; nr 1690/3 Prot dt. 06.03.2025 dhe 1690/2 Prot dt. 05.03.2025 për përjashtimin e taksës 35 lekë/kg për artikuj “membrana PVC” në kodin tarifor 39204390; “shkarkues PVC” në kodin tarifor 39219090; “shirit PVC ëaterstop” në kodin tarifor 39259010; “membrana PVC” në kodin tarifor 39204390 dhe “shkarkues rakorderi PVC” në kodin tarifor 39219060.

Për sa më sipër duke qënë se Drejtoria Rajonale Tatimore Elbasan është autoriteti që ka lëshuar autorizimet e mësipërme për përjashtimin e taksës 35 lekë/kg në import, me anë të shkresës nr. 3983 prot., datë 23.05.2025, DD Tiranë ka kërkuar për ndjekje të mëtejshme DRT Elbasan, për verifikim artikujt e importuar nga subjekti “I” SHPK me NIPT L. me deklaratat doganore.

Aneksi nr. 4.60 Në lidhje me importet e artikullit “Tubplastik/njepërdorim/veno/ambalazh” të Aneksit 4.60 të subjektit “E” me NIPT L. ku konstatohet se kemi të bëjmë me deklarim të gabuar të llojit të ambalazhit plastik, sqarojmë se janë artikuj me karakter spitalor dhe klasifikohen në kreun 9018 dhe jo në kapitullin 39, si rrjedhim nuk paguajnë taksë plastike.

Aneksi nr. 4.62 Në lidhje me importet e artikullit “qumësht i kondensuar” trajtuar në faqet 451 - 452 të Aneksit 4.62 të subjektit “I” sh.p.k me NIPT K. ku konstatohet se kemi të bëjmë me keqklasifikim tarifor me pasojë shmangien e pagesës së taksës së qumështit pluhur QPL. Sqarojmë se, klasifikimi i produktit “Qumësht i kondensuar” në kodin tarifor 04049083 të NKM-së, i importuar nga subjekti “I” sh.p.k mendojmë se është i saktë referuar përbërësve dhe përmbajtjes së tij.

Produkti “Qumësht i kondensuar” që importohet nga subjekti “I” sh.p.k. nën kodin tarifor 04049083 të NKM-së ka qënë dhe vijon të mbetet i pandryshuar, pavarësisht ndryshimit të ligjit. Si konkluzion, për produktin “Qumësht i kondensuar” në kodin tarifor 04049083 të NKM-së, i importuar nga subjekti “I” sh.p.k.:

1. klasifikimi i këtij produkti në kodin tarifor 04049083 të NKM-së mendojmë se është i saktë, referuar përbërësve dhe përmbajtjes së produktit, si dhe dokumenteve Certifikatë Origjine dhe Deklaratë Eksporti dërguar nga furnitori/eksportuesi;
2. klasifikimi i këtij produkti në kodin tarifor 04049083 të NKM-së është bërë shumë vite përpara ndryshimit të ligjit për taksat kombëtare, ligj i cili ka hyrë në fuqi nga data 05.01.2022 dhe ky klasifikim vijon të jetë i pandryshuar edhe sot;
3. kodi tarifor 04049083 i NKM-së nuk përfshihet në asnjë nga kategoritë e përcaktuara në ligj për të cilat aplikohet taksë kombëtare.

Aneksi nr. 4.63 Në lidhje me importet e artikullit “hirrë dhe protein hirre” trajtuar në faqen 452 të Aneksit 4.63 ku konstatohet se kemi të bëjmë me keqklasifikim tarifor me pasojë shmangien e

pagesës së taksës së qumështit pluhur QPL, Ju sqarojmë se: Referuar përberjes dhe bazuar ne standartet nderkombetare te vendosura, produkti i mesipërm nuk është qumesht pluhur, por përzjerje ne trajte pluhuri e nenprodukteve te qumeshtit.

Keto produkte jane përzjerje mekanike te përfutuara nga procesi i bashkimit mekanik ne blender (miksera) i nenprodukteve te ndryshme me baze hire, qumeshti pluhur, yndyre qumeshti apo shtesa te tjera ushqimore dhe për rrjedhoje nuk klasifikohen qumesht pluhur.

Bazuar ne standartet nderkombetare produkti konsiderohet “qumesht pluhur” vetem kur përftohet nga procesi i tharjes se qumeshtit te fresket te pasterizuar, I papërzjere dhe pa asnje lloj shtese apo nderhyrje me nenprodukte te tjera ushqimore, qofshin keto me baze shtazore apo bimore para, gjatë apo mbas procesit të tharjes.

Aneksi nr. 4.64 Në lidhje me importet e artikullit “Diafragme Derri” i klasifikuar në kodin tarifor “02064900” dhe në kreun “0206” është deklaruar si të brendshme duke mos paguar tarifën baze prej 10%, si rezultat i klasifikimi tarifor jo te sakte, ju sqarojmë se:

Nga ana jonë me anë të shkresës nr. 1652 prot., DD Tiranë datë 28.02.2025 i është kërkuar Drejtorisë së Tarifës dhe Origjinës kërkesë për interpretim dhe saktësim të klasifikimit tarifor të artikullit “diafragmë derri”.

Drejtoria e Tarifës dhe Origjinës ka kthyer përgjigje me shkresën nr. 4213/1 prot., DPD datë 25.03.2025 sipas së cilës diafragma e derrit klasifikohet në kreun 0206.

- Në kodin tarifor 0206 30 00 nëse është e freskët apo e ftohtë.
- Në kodin tarifor 0206 49 00 nëse është në gjendje të ngrirë.

Gjithashtu nga ana jonë me anë të shkresës nr 10738/24 prot., DD Tirane datë 08.07.2024 i është propozuar DOH, profili i riskut për marrje mostrash për analizim laboratorik me qëllim saktësimin e klasifikimit tarifor për këtë artikull. Bashkëngjitur ju dërgohet shkresa nr. 4213/1 prot DPD datë 25.03.2025 e Drejtorisë së Tarifës dhe Origjinës dhe shkresa e DD Tiranë me nr. 10738/24 Prot DD Tiranë datë 08.07.2024 për propozim për profil risku për artikullin “diafragmë derri”.

Aneksi nr. 4.65 Në lidhje me importet e artikullit “ushqim për qen dhe mace” ju sqarojmë se, DD Tiranë pas verifikimit të praktikave doganore ka dalë me vendime në shumën 2,754,099 lekë detyrime doganore dhe 2,754,099 lekë gjobë, në shumë totale 5,508,198 lekë.

Aneksi nr. 4.66 Në lidhje me importet e artikullit “ushqim për qen dhe mace” ju sqarojmë se, DD Tiranë pas verifikimit të praktikave doganore ka dalë me vendime në shumën 136,208 lekë detyrime doganore dhe 136,208 lekë gjobë, në total 272,416 lekë.

Aneksi nr. 4.67 Në lidhje me importet e artikullit “aksesore mobilje dhe shezlon”, sqarojmë se keqklasifikimi nuk qëndron.

Aneksi nr. 4.69 Për deklaratat R112179; R129654 dhe që i përkasin importit të artikullit “*kuti matesa uji*” të klasifikuar në kodin tarifor 39269097, Ju sqarojmë se: këto deklarata importe janë kryer nga BE dhe kodi tarifor i deklaruar në deklaratën e importit përputhet me kodin tarifor në deklaratën e eksportit dhe në faturën tregtare.

Gjithashtu klasifikimi për këtë artikull është përcaktuar në përputhje me Rregullat e përgjithshme të interpretuara (GIR) dhe Shënimi i Përgjithshëm i për Seksionin XVI.

Për R51565 që i përkasin importit të artikullit “*qese urine*” të klasifikuar në kodin tarifor 39269097, nuk kemi të bëjmë me keqklasifikim kemi të bëjmë me artikuj spitalor dhe ky artikull shërben si çantë mbledhëse prej PVC me shënime për matjen e vëllimit.

Për R37514; 123 dhe 33504 që i përkasin importit të artikullit “*artikuj laboratorik për analiza*” të klasifikuar në kodin tarifor 39269097, sqarojme se është përcaktuar në përputhje me Rregullat e përgjithshme të interpretuara (GIR) dhe Shënimi i Përgjithshëm i për Seksionin XVI.

Për 110640; 128480 që i përkasin importit të artikullit “*artikuj laboratorik për analiza*” të

klasifikuar në kodin tarifor 39269097, sqarojme se është përcaktuar në përputhje me Rregullat e përgjithshme të interpretuara (GIR) dhe Shënimi i Përgjithshëm i për Seksionin XVI.

Për R35293 që i përkasin importit të artikullit “*kellef telefonash*” të klasifikuar në kodin tarifor 39269097, sqarojme se është përcaktuar në përputhje me Rregullat e përgjithshme të interpretuara (GIR) dhe Shënimi i Përgjithshëm i për Seksionin XVI.

Për 110640; 128480 dhe R10397; R3001 që i përkasin importit të artikullit “*artikuj laboratorik për analiza*” të klasifikuar në kodin tarifor 39269097, sqarojme se është përcaktuar në përputhje me Rregullat e përgjithshme të interpretuara (GIR) dhe Shënimi i Përgjithshëm i për Seksionin XVI.

Për R 74663 datë 20.07.2023 dhe R59834 që i përkasin importit të artikullit “*vazo lulesh*”, si dhe për R46249 dt. 13.05.2022 dhe R74663 dt. 20.07.2023 që i përkasin importit të artikullit “*kosha plastike*” të klasifikuar në kodin tarifor 39269097 sqarojmë se,

Me shkresën nr. 2581 prot., DD Tiranë datë 03.04.2025 i është kërkuar Drejtorisë së Tarifës dhe Origjinës kërkesë për interpretim në lidhje me klasifikimin në artikullit “vazo plastike për lule”. Drejtoria e Tarifës dhe Origjinës ka kthyer përgjigje me shkresën nr. 7286/1 prot DPD, datë 02.05.2025, vazo lulesh për ambjente të jashtme (për fidanë, etj) klasifikohet në kreun 3926. Nga verifikimi i deklaratave doganore rezulton se kemi të bëjmë me vazo lulesh për ambjente të jashtme, gjithashtu nga verifikimi i deklaratave doganore rezulton se kemi të bëjmë me kosha plastike për ambjente të jashtme.

Aneksi nr. 4.70 Për deklaratat doganore që i përkasin importit të artikullit “*sutura kirurgjikale/ngjitëse kirurgjikale*” të klasifikuar në kodin tarifor 30061010 dhe 30061090, ju sqarojmë se:

Për praktikat R111920 dhe R39621 të subjektit “E” me NIPT K. ka rezultuar se importet e këtij artikulli janë deklaruar në kodin tarifor 30061010 janë me vend eksporti dhe vend origjine nga India, kodi tarifor është i specifikuar në faturën tregtare. Praktika R111920 është profilizuar nga sistemi në kanal të kuq dhe kontrolli fizik konfirmon se artikulli është sipas deklaramit.

Për praktikat R100246 dhe R48234 të subjektit “M” me NIPT J.; R55618 dhe R82526 të subjektit “O” me NIPT K., nga verifikimi ka rezultuar se artikulli i importuar është “pako ankografie sterile / penj kirurgjikal” të deklaruar në kodin tarifor 30061090 dhe 30061010.

Aneksi nr. 4.71 Në lidhje me keqklasifikimin e artikujve të kapitullit “73”, të aneksit 4.71 të RPA, DD Tiranë ka dalë me vendimmarrje për detyrime doganore në shumën 435,950 lekë dhe gjobë në shumën 435,950 lekë, në total 871, 900 lekë, për artikujt “kosha metalik” dhe “mbajtëse hekuri”. Ndërsa në lidhje me klasifikimin e artikullit “*brryla/rakorderi dhe flanaxha*” ju sqarojmë se, Në përgjigje të konstatuar nga auditimi i KLSH-së dhe përkufizimit të përdorur nga autoriteti doganor mbi klasifikimin tarifor të artikullit “*bërila dhe mënga të pafiletuara*”, konsiderojmë se është bërë një interpretim i pasaktë dhe jo i përputhshëm me kriteret e Nomenklaturës së Kombinuar të Mallrave. Klasifikimi tarifor në kodin 7307 22 10 është i pasaktë dhe nuk merr parasysh natyrën teknike të artikullit, funksionin e tij të kufizuar si gjysmë-produkt, dhe kriteret e qarta të Nomenklaturës së Kombinuar.

Për artikullin “*gardh metalik*” klasifikohet në nënkreun 731420, si rrjedhim rekomandimi për keqklasifikim të artikullit “*gardh metalik*” nuk qëndron.

Në lidhje me klasifikimin e artikullit “*kafaze për zogj*”, rezulton se klasifikimi është në përputhje me klasifikimin në dokumentacionin shoqërues dhe NKM, praktikat janë përzgjedhur nga sistemi në kanal “e verdhë” dhe “kuq” – për verifikim fizik, sipas shënimeve në “aktin e kontrollit” të deklaratave nga verifikimi fizik nuk janë konstatuar parregullsi me deklarimin.

Në lidhje me klasifikimin e artikullit shina”, të deklaruar në kreun 7302, rezulton se klasifikimi

është në përputhje me klasifikimin në dokumentacionin shoqërues dhe NKM.

Aneksi nr. 4.72 Në lidhje me keqklasifikimin e artikujve “ekrane me module dhe monitor me module interaktiv” të aneksit 4.72 të RPA, DD Tiranë ka dalë me vendimmarrje.

Për R80597 të subjektit Q; R 114468 të subjektit “B” dhe R28641 të subjektit “T” pas verifikimit artikulli i deklaruar rezulton i shoqëruar nga Certifikata e Lëvizjës së Lirë EUR 1 dhe si rrjedhim përfiton trajtim tarifor preferencial me tarifë 0%.

Ndërsa në lidhje me klasifikimin tarifor të artikujve të deklaruar me deklaratat doganore të cituara në Aneksin 4.72 për të cilat DD Tiranë nuk ka dalë me vendimmarrje pasi nga verifikimi i dokumentacionit shoqërues rezulton se klasifikimi është në përputhje me klasifikimin në dokumentacionin shoqërues dhe NKM.

Aneksi nr. 4.75 Për deklaratat doganore që i përkasin importit të artikullit “vazeline” të klasifikuar kreun 2712, për subjektin ”E” me NIPT J. në lidhje me klasifikimin e këtij artikulli, DD Tiranë ka dalë me vendimmarrje për të gjitha rastet në shumën 112,320 lekë detyrime doganore dhe 112,320 lekë gjoba, në total 224,640 lekë.

Aneksi nr. 4.76 Në lidhje me keqklasifikimin e artikujve “graso dhe solucion korroziv” ju sqarohet se DD Tiranë ka dalë me 15 vendime në vlerën totale 575,852 lekë për artikujt “spraj për vida”, “spraj /graso” dhe “vaj emulsion”.

Ndërsa në lidhje me klasifikimin tarifor të artikujve “solucion korrozi” të deklaruar me deklarata doganore të cituara në Aneksin 4.76 për të cilat DD Tiranë nuk ka dalë me vendimmarrje pasi nga verifikimi i dokumentacionit shoqërues rezulton se klasifikimi është në përputhje me klasifikimin në dokumentacionin shoqërues dhe NKM. Artikulli shërben në përftohje e makinerive metal prerese dhe jo për motorrat me djegje të brendshme si rrjedhim keqklasifikimi nuk qëndron.

Aneksi nr. 4.77 – 4.78 Në lidhje me keqklasifikimin e artikujve “aditiv” të trajtuar në faqen 461 - 462 të aneksit 4.76 të RPA, ju sqarohet se:

Nga analizimi i kostatimit të Grupit të Auditimit të KLSH-së, shqyrtimit të dokumentacionit bashkangjitur praktikës doganore rezulton se është importuar nga Italia artikulli “Aditiv blu” klasifikuar në kodin tarifor 3811 me tarifë doganore 0%.

Referuar shënimeve shpjeguese të NKM-së, kodi tarifor 3811, 271019, si dhe referuar dokumentacionit shoqërues të mallit dhe shënimeve shpjeguese të NKM-ve artikulli “Aditiv blu” klasifikohet në kodin tarifor 38119000 pasi përdoren për pastrim nga ndryshku dhe nuk është produkt energjitik pasi nuk përdoret si karburante për motorët, lëndë djegëse.

Referuar ligji 61/2012 Neni 51, kompania disponon gjithë dokumentacionin e plote ligjor dhe qe provon vertetesine e deklarimit dhe klasifikimit tarifor.

Për sa më sipër, duke ju referuar dokumentacionit shoqërues të mallit ku kodi tarifor është vendosur në fature dhe deklarate eksporti si dhe shënimeve shpjeguese të NKM-ve .

Klasifikimi tarifor është konformë notave shpjeguese të NKM-ve dhe aktve ligjore në fuqi, dhe ky produkt “Aditiv blu” nuk përdoret si lubrifikant, nuk përdoret si lëndë djegëse, për motorra apo si shtese në to, ndaj nuk lindin detyrime doganore shtesë.

Aneksi nr. 4.78 Në lidhje me keqklasifikimin e artikujve “spray/vajra të lehtë” të trajtuar në faqen 460 - 461 të aneksit 4.76 të RPA, ju sqarohet se:

Dega Doganore Tiranë ka dalë me vendimmarrje (tabela e paraqitur) në lidhje me keqklasifikimin e artikujve “spray/vajra të lehtë” të Aneksit 4.76 të RPA DD Tiranë ka dalë me 5 vendimmarrje për detyrim doganore në shumën 471,799 lekë dhe gjobë në shumën 471,799 lekë, në total 943,598 lekë.

Ndërsa në lidhje me klasifikimin tarifor të artikujve “solucion korrozi” të deklaruar me deklarata doganore të cituara në Aneksin 4.78 për të cilat DD Tiranë nuk ka dalë me vendimmarrje pasi nga

verifikimi i dokumentacionit shoqërues rezulton se klasifikimi është në përputhje me klasifikimin në dokumentacionin shoqërues dhe NKM.

Artikulli është deklaruar duke ju referuar dokumentacionit shoqërues të mallit ku kodi tarifor është vendosur në fature dhe deklarate eksporti si dhe shënimeve shpjeguese të NKM-ve .

Klasifikimi tarifor është konformë notave shpjeguese të NKM-ve dhe aktve ligjore në fuqi, ndaj nuk lindin detyrime doganore shtesë.

Aneksi nr. 4.79 Në lidhje me keqklasifikimin e artikujve “spray/vajra të lehtë” të trajtuar në faqen 462 - 463 të aneksit 4.79 të RPA, DD Tiranë ka dalë me vendimmarrje për detyrime doganore në shumën 1,163,178 lekë dhe gjoba në shumën 1,163,178 lekë, në total 2,326,356 lekë.

Ndërsa në lidhje me klasifikimin tarifor të artikujve “vaj” të deklaruar me deklaratat doganore të cituara në Aneksin 4.79 për të cilat DD Tiranë nuk ka dalë me vendimmarrje, pasi nga verifikimi i dokumentacionit shoqërues rezulton se klasifikimi është në përputhje me klasifikimin në dokumentacionin shoqërues dhe NKM. Artikulli është deklaruar duke ju referuar dokumentacionit shoqërues të mallit ku kodi tarifor është vendosur në fature dhe deklarate eksporti si dhe shënimeve shpjeguese të NKM-ve. Klasifikimi tarifor është konformë notave shpjeguese të NKM-ve dhe aktve ligjore në fuqi, ndaj nuk lidin detyrime doganore shtesë.

Aneksi nr. 4.82 Në lidhje me vlerësimin e artikullit “pëlhurë polipropilene për thasë” deklaruar në kreun *5407* të kryera nga subjekti “G” shpk me NIPT K. të trajtuar në faqen 465 të RPA, Ju sqarojmë se:

Për deklaratat që i përkasin importit të artikullit “pëlhurë polipropilene për thasë” deklaruar në kreun *5407* të kryera nga subjekti “G”, të përmendura në faqen 4651 dhe Aneksin 7.82 të RPA, vlerësimi është kryer bazuar në nenin 66 të Ligjit 102/2014 "Kodi Doganor i Republikës së Shqipërisë", datë 31.07.2014 si dhe pikës 4.1 të Udhëzimit të Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë Nr. 3, dt. 23.01.2018 “Për vlerësimin e mallrave për qëllime doganore” është pranuar transaksioni si vlerë doganore.

Në këtë rast artikulli i deklaruar nuk është pëlhurë për veshmbathje por pëlhurë e thurur me fije polipropilene për thasë.

Nga ana e operatorit janë depozituar dokumentat shtesë, justifikues për vlerën e transaktuar si: Transferrat Bankare të likuidimeve dhe Deklaratat e Eksportit të cilat ndodhen bashkëlidhur praktikave doganore.

Me shkresën nr. 3459/1 prot., datë 05.05.2025, DD Tiranë i ka kërkuar DTO në DPD kërkesë për interpretim klasifikimi, për artikullin “shkallë plastike”.

Me shkresën nr. 4218/1 prot., datë 20.03.2025 DTO kthen i përgjigje DD Tiranë në vijim të shkresës nr. 1611, datë 27.02.2025, mbi klasifikimin tarifor të artikullit varëse rrobash.

Me shkresën nr. 11483/1 prot., datë 09.06.2025, DTO në DPD, informon mbi rezultatin e pas verifikimit të certifikatës EUR 1 A 3500562 datë 11.12.2023, DD Tiranë.

Komenti i grupit të auditimit:

Për sa argumentuar nga Dega Doganore Tiranë, në relacionin dhe dokumentacionin e vënë në dispozicion grupit të auditimit të KLSH-së, nga verifikimi i tyre, rezultoi se:

Për gjetjet dhe konstatimet e trajtuara në Raportin Përfundimtar të Auditimit që lidhen me kapitullin 20, në vlerën 381,440 lekë, në të cilën janë konstatuar mangësi në mungesë të certifikatës së origjinës, nuk ka përgjigje nga subjekti DD Tiranë.

Për gjetjet dhe konstatimet e trajtuara në Raportin Përfundimtar të Auditimit që lidhen me kapitullin 21, në vlerën 1,497,884 lekë, në të cilën janë konstatuar mangësi, nuk ka përgjigje nga DD Tiranë.

Për gjetjet dhe konstatimet e trajtuara në Raportin Përfundimtar të Auditimit që lidhen me Aneksin

nr. 4.41 dhe 4.72, DD Tiranë ka dalë me vendimmarrje, por nuk ka përgjigje të detajuara. Për gjetjet dhe konstatimet që lidhen me raste të trajtuara në anekset respektive për deklaratat që i përkasin importit të artikujve dhe subjekteve të ndryshme, për të cilat është vjelë detyrimi nga ndërhyrja e aposteriorit sipas rekomandimit të KLSH-së, mungojnë vlerat në lekë të shprehura në materialin informues.

Në përfundim, për gjetjet dhe konstatimet e trajtuara në Raportin Përfundimtar të Auditimit që lidhen me raste të trajtuara në anekset respektive për deklaratat që i përkasin importit të artikujve konstatohet se, nga analiza e materialit të vendosur në dispozicion nga DD Tiranë, vlerat e kontabilizuara nga kjo degë rezultojnë në shumën 39,314,466 lekë, për të cilat janë vënë në dispozicion të grupit të auditimit dhe rezultojnë në proces vendimmarrje për hartime vendimesh dhe 15 vendime me vlerë 15,561,234 lekë, duke trajtuar në total me procedurë vendimmarrjeje një vlerë prej 54,875,700 lekë (*detyrim dhe penalitet dhe taksa kombëtare*). Për rastet, për të cilat nga DD Tiranë është kërkuar procesi i verifikimit të transaksioneve pranë Departamentit Operativ Hetimor, rastet për të cilat është kërkuar interpretim teknik nga Drejtoria e Tarifës dhe Origjinës dhe rastet për të cilat është dhënë detyrë rekomanduese për zbatim që të ndiqen nga Drejtoria e Kontrollit pas Zhdoganimit pranë Drejtorisë së Përgjithshme të Doganave sipas rekomandimeve respektive që lidhen me anekset respektive të bashkëlidhura në Raportin Përfundimtar të Auditimit, nuk u vendosën në dispozicion nga grupi i punës, për zbatimin e rekomandimeve të dhëna të sakta për vlerën e zbatueshmërisë të secilit rekomandim të dhënë që lidhet me çdo deklaram doganor sipas numrit të praktikës doganore dhe vitit korrespondues dhe detyrimit doganor të rekomanduar.

Ky rekomandim konsiderohet i pranuar dhe zbatuar pjesërisht.

2.1 Rekomandimi: Dega Doganore Tiranë në bashkëpunim me Drejtorinë e Përgjithshme të Doganave të marrë masa të menjëhershme me qëllim fillimin e procedurave doganore sipas legjislacionit në fuqi për subjektet që kanë rezultuar se kanë deklaruar vlera të ulta të mallrave dhe shpenzimeve të transportit të deklaruara sipas nevojave ekonomike hedhje malli në qarkullim të lirë me procedurë 4051 për mallra të hyra më parë në regjime doganore të tipit RPA të natyrës “*Tallash druri*” dhe “*copa mbetje druri*” në kapitullin *44* “*mbetje letre*” dhe “*mbetje kartoni*” të në kapitullin 48 dhe “*mbetje plastike*” në kapitullin 39 të NM në RSH, dhe për mallra të konstatuar në mangësi të pajustificuara në bilancin material të autorizimit të përpunimit RPA të natyrës alkool puro me efekte në të ardhurat doganore në Buxhetin e Shtetit në shumën totale **31,400,097 lekë**.

Përgjigja e subjektit:

a) Aneksi nr. 3.1. Për deklaratat që i përkasin importit të artikujve “mbetje druri, tallash” të klasifikuar në Kapitullin 44, sqarojmë se, për mbetjet teknologjike nga procesi i përpunimit aktiv të mallrave dhe materialeve bashkëngjitur DAV, janë depozituar gjithë dokumentacioni i nevojshëm si autofaturat.

Ky produkt është mbetje e përfutur nga procesi teknologjik i përpunimit të mallrave jo shqiptare të destinuar për t’u riekportuar në formën e produkteve kompensuese, pa pagesën e detyrimeve doganore ose me rimbursimin e tyre pas ri-eksportimit. Sipas observacionit të paraqitur nga subjektet, ky produkt është pjesë e procesit teknologjik për prodhimin e produktit final dhe shërben si lëndë djegëse në furrat e tharjes. Arsyeja e hedhjes për qarkullim të lirë e këtij produkti është për shkak të rakordimit të peshës me artikujt e importuar nën regjim.

Nga subjektet e tjera janë paraqitur dokumentacion shtesë si: fatura tatimore shitje, me të cilët vërtetohet vlera e shitjes së këtyre produkteve (mbetjet e letrës) në tregun vendas. Në Dosjen e Të

Dhënave të Disponueshme nuk gjenden vlera referuese për këto artikuj. Në përgjigje të konstatimeve dhe rekomandimeve të paraqitura nga KLSH në Raportin Përfundimtar të Auditimit, lidhur me rivlerësimin e mallrave të natyrës “mbetje” të deklaruara në procedurën 4051 për qarkullim të lirë (“mbetje druri”), konsiderojmë të domosdoshme të parashtrijmë sa vijon:

-Sipas nenit 70 të ligjit nr. 102/2014 “Kodi Doganor i Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar, dhe akteve nënligjore në zbatim të tij, vlera doganore e mallrave përcaktohet sipas metodave të përcaktuara në seksionin 2 të këtij ligji dhe akteve përkatëse zbatuese. Në rastin konkret, për mallrat e natyrës “mbetje”, zbatimi i metodës së parë (transaksioni real) nuk është i mundur për shkak të mungesës së një çmimi të përcaktuar të shitblerjes ndërmjet palëve. Në vijim, kalimi në metodat alternative duhet të jetë i mbështetur në dokumentacion të qartë, të verifikueshëm dhe të justifikuar.

-Audituesit kanë përdorur si bazë për rivlerësim “çmime orientuese për produkte të ngjashme në shitje”, të cilat nuk përfaqësojnë çmime të referencës të miratuara nga autoritetet doganore, por tregues të përgjithshëm tregtarë, që nuk kanë fuqi detyruese dhe nuk mund të zëvendësojnë asnjë nga metodat e ligjshme të përcaktuara në Kodin Doganor. Më tej, mungojnë burimet e referencës dhe dokumentacioni mbështetës për këto çmime, duke e bërë të pamundur verifikimin e saktësisë së tyre.

-Vetë natyra e mallrave të deklaruara si “mbetje” e përjashton mundësinë e krahasimit me produkte të gatshme në shitje. Mbetjet industriale apo mbetjet e papërpunuara (siç janë “copë druri”, “mbetje kartoni” etj), të cilat janë deklaruar në procedurën 4051 për hedhje në qarkullim të lirë, nuk përbëjnë produkt tregtar të përfunduar dhe, për rrjedhojë, nuk mund të vlerësohen sipas çmimeve të produkteve përfundimtare apo të përpunuara. Ky parim është i sanksionuar edhe në nenin 74 të Kodit Doganor që parashikon se vlera doganore duhet të përfaqësojë vlerën reale të mallit në momentin e importit.

-Praktika e mëparshme doganore dhe mungesa e vendimeve administrative për çmime të referencës, për mallrat në fjalë nuk ekzistojnë vendime të miratuara nga Drejtoria e Përgjithshme e Doganave për çmime të referencës apo baza të dhënash me vlera të detyrueshme. Në mungesë të kësaj, vlerësimi është kryer në përputhje me praktikat doganore të konsoliduara ndër vite, të dokumentuara në sistemin ASYCUDA dhe është reflektuar në vlerësimet paraprake të aplikuara nga vetë organet doganore, pa kundërshtime të mëparshme.

-Efekti financiar i parashikuar nga audituesit është spekulativ dhe i pambështetur në prova. Përlllogaritja e një efekti financiar të supozuar në mungesë të dokumentacionit të plotë dhe pa një analizë të metodologjisë ligjore të vlerësimit përbën tejkalim të kompetencës dhe përfshirje në aspekte tekniko-doganore që janë kompetencë e strukturave të autorizuar.

Duke marrë parasysh sa më sipër, rekomandimi i audituesve për rivlerësimin e mallrave të natyrës “mbetje” mbi bazën e çmimeve orientuese për produkte të ngjashme në shitje nuk mund të zbatohet. Për rrjedhojë, ai nuk duhet të merret si bazë për ndryshim vlerash apo përlllogaritje detyrimesh doganore shtesë. Për sa më sipër Grupi i Punës gjykoi për të mos dalë me vendimmarrje për këtë artikull.

Nga DD Tiranë të njëjtët argumente si më lart, janë paraqitur dhe për artikujt e mëposhtëm, me këto specifikime të veçanta:

b) Aneksi nr. 3.2. Për deklaratat që i përkasin importit të artikujve “mbetje letre” të klasifikuar në Kapitullin 48, sqarojmë se: nga subjektet janë paraqitur dokumentacion shtesë si: kontrata me subjektin G, kontrata me subjektin S me objekt grumbullim, eksporti, riciklim të produkteve të letrës dhe kartonit, fatura tatimore shitje, me të cilët vërtetohet vlera e shitjes së këtyre produkteve (mbetjet e letrës) në tregun vendas. Nga subjektet e tjera janë paraqitur dokumentacion shtesë si:

fatura tatimore shitje, me të cilët vërtetohet vlera e shitjes së këtyre produkteve (mbetjet e letrës) në tregun vendas.

Duke marrë parasysh sa më sipër, rekomandimi i audituesve për rivlerësimin e mallrave të natyrës “mbetje” mbi bazën e çmimeve orientuese për produkte të ngjashme në shitje nuk mund të zbatohet. Për rrjedhojë, ai nuk duhet të merret si bazë për ndryshim vlerash apo përlllogaritje detyrimesh doganore shtesë. Për sa më sipër Grupi i Punës gjykoj për të mos dalë me vendimmarrje për këtë artikull.

c) Aneksi nr. 3.3. Për deklaratat që i përkasin importit të artikujve “mbetje plastike” të klasifikuar në Kapitullin 39,

kanë arritur në përfundim se, rekomandimi i audituesve për rivlerësimin e mallrave të natyrës “mbetje” mbi bazën e çmimeve orientuese për produkte të ngjashme në shitje nuk mund të zbatohet. Për rrjedhojë, ai nuk duhet të merret si bazë për ndryshim vlerash apo përlllogaritje detyrimesh doganore shtesë. Për sa më sipër, Grupi i Punës gjykoj për të mos dalë me vendimmarrje për këtë artikull.

d) Aneksi nr. 3.3. Për deklaratat që i përkasin importit të artikujve “mbetje aumini” të klasifikuar në Kapitullin 76, kanë arritur në përfundim se, rekomandimi i audituesve për rivlerësimin e mallrave të natyrës “mbetje” mbi bazën e çmimeve orientuese për produkte të ngjashme në shitje nuk mund të zbatohet. Për rrjedhojë, ai nuk duhet të merret si bazë për ndryshim vlerash apo përlllogaritje detyrimesh doganore shtesë. Për sa më sipër, Grupi i Punës gjykoj për të mos dal me vendimmarrje për këtë artikull.

e) Aneksi nr. 3.4. Për rivlerësimin e mbetjeve doganore të deklaruara sipas procedurës 4051, mbi bazën e çmimeve orientuese për produktet përkatëse në shitje, lidhur me rivlerësimin e mallrave të natyrës “mbetje” të deklaruara në procedurën 4051 për qarkullim të lirë (“mbetje druri”, “mbetje kartoni”, “mbetje plastike”, “mbetje letre”, “mbetje tekstile” etj.), Grupi i punës ka paraqitur përveç argumente si më sipër, edhe këto pretendime: Për rivlerësimin e mallrave të natyrës “mbetje” mbi bazën e çmimeve orientuese për produkte të ngjashme në shitje nuk është i mbështetur në asnjë dispozitë të ligjit 102/2014 dhe akteve në zbatim. Për rrjedhojë, ai nuk duhet të merret si bazë për ndryshim vlerash apo përlllogaritje detyrimesh doganore shtesë.

f) Aneksi nr. 3.5. Për deklaratat që i përkasin importit të artikujve “Skrap” të klasifikuar në Kapitullin 08, për subjektin ” M” me NIPT K., sqarojme se: DD Tiranë nuk ka dalë me Vendim marrje pasi nga verifikimi i dokumentacionit bashkëngjitur dhe vlerës së deklaruar nga subjekti rezulton se, çmimet e deklaruara janë në të njëjtin nivel me të dhënat e buletinit të bursës sipas publikimeve të “Metal Buletin”. Nga analiza e indikatorëve e fakteve të mësipërme rezulton se përzgjedhja e metodës për vlerësimin doganor është në përputhje me kërkesat e legjislacionit doganor në fuqi.

Komenti i grupit të auditimit:

Për sa është argumentuar nga grupet e punës së DD Tiranë, nga DD Tiranë dhe nga DPD nuk janë marrë masa për fillimin e procedurave doganore sipas legjislacionit në fuqi për subjektet që kanë rezultuar se kanë deklaruar vlera të ulta të mallrave dhe shpenzimeve të transportit të deklaruara sipas nevojave ekonomike hedhje malli në qarkullim të lirë me procedurë 4051 për mallra të hyra më parë në regjime doganore të tipit RPA të natyrës “*Tallash druri*” dhe “*copa mbetje druri*” në kapitullin *44* “*mbetje letre*” dhe “*mbetje kartoni*” te ne kapitullin 48 dhe “*mbetje plastike*” në kapitullin 39 të NM në RSH, dhe për mallra të konstatuar në mangësi të pajustificuara në bilancin material të autorizimit të përpunimit RPA të natyrës alkool puro me efekte në të ardhurat doganore në Buxhetin e Shtetit në shumën totale 31,400,097 lekë.

Ky rekomandim konsiderohet i pranuar dhe i pa zbatuar.

3.1 Rekomandimi: Dega Doganore Tiranë në bashkëpunim me Drejtorinë e Përgjithshme të Doganave, të marrë masa të menjëhershme me qëllim shqyrtimin, vendimmarrjen, kontabilizimin dhe më pas arkëtimin e detyrimeve doganore të munguara të rillogaritur në shumën 1,420,575 lekë, si dhe të kërkojë procedurë eksporti të detyrueshëm ose dhënie destinacioni malli për përfitim statusi shqiptar në një rast vendimi administrativ që lidhen me konstatimet e trajtuara për shkeljen e afatit të regjimit RLP për mallra të natyrës autovetura të nxjerra për vitin 2022.

Përgjigja e subjektit:

Për vendimin nr.1018 datë 07.09.2022 të marrë sipas Proces – verbalit për verifikimin e shkeljes doganore me nr. Serial 0023044 (nr. 8022 Prot., datë 26.08.2022) të mbajtur nga ana e strukturave te Deges se Doganes Tirane, konkretisht nga ana e Sektorit te Opëracioneve Doganore për shkeljen e kryer nga ana e subjektit/përson fizik “J” me NIPT L.. Në datën 25.08.2022 është paraqitur ne Degen e Doganes Tirane, subjekti/përson fizik “J” me NIPT L. e cila përmes përfaqesuesit te tij doganor, Agjensise Doganore “E” ka bere deklarimin me DAV R-87492 datë.25.08.2022.

Në bazë të nenit, 178-181, 250, 251, 256, , 273 e vijues, 276 të Ligjin nr. 102/ 2014, datë 31.07.2014 “Kodi Doganor i RSH”, të VKM –së nr. 651, datë 10.11.2017 “Për miratimin e dispozitave zbatuese të Ligjit nr. 102/2014, datë 31.07.2014”; si dhe çdo Urdhëresë e DPD-së që nuk bie në kundërshtim me Ligjin nr. 102/2014, datë 31.07.2014 “Kodi Doganor i RSH”; për subjekti/Përson Fizik “J” me NIPT L. ka lindur detyrimin doganor i shmangur si me lart trajtuar në shumën 6,540 leke, si dhe sanksioni ne masen e 1-fishit të detyrimit doganor te munguar.

Në referencë te interpretimit ligjor te sipërcituar për caktimin e mases se penalitetit dhe kriteret gjate dhenies se penalizimit, vete ligji e mirpërcakton ekzistencen e kushteve kumulative te cilat duhen marre ne konsiderate ne cdo rast te trajtimit te shkeljes.

-Autoriteti vendimarrës DD Tiranë vendimin nr. 1104 datë 25.10.2022 e ka marrë bazuar në procesverbalin për verifikimin e kundërvajtjes doganore të mbajtur nga ana e grupit të Antikontrabandës dhe Sektorit Opëracional në DD Tiranë, ku janë përcaktuar pagesat e detyrimit në shumën 216,000 lekë dhe penalitetet sa njëfishi i detyrimit të munguar pasi ka parë tërësinë e rrethanave të shkeljes dhe mbështetur në gjithë dokumentacionin ligjor.

Konstatimi i KLSH-së për aplikimin e nenit 252 germa d në lidhje me nenin 257 nuk qëndron, kjo parë jo vetem në vështrim të hetimit të rrethanave të kryerjes së shkeljes ku merret në konsideratë edhe ana subjektive e subjektit kompetencë kjo e strukturave konstatuese dhe që vjen shkak pasojë pasi juristi nuk mund të kryejë hetimin e rrethanave pasi kjo hyn në kompetencen e konstatueseve që në rastin konkret kanë qenë struktura kompetente të Antikontrabandës të specilizuara në fushën e shkeljeve dhe me tagra e kompetenca edhe si OPGJ, por gjithashtu parë edhe në interpretim të Kodit Doganor për pjesën e shkeljeve ku kjo lloj shkelje me një sasi të vogël malli të padeklaruar. Pra si forme shkeljeje është parashikuar ne disa germa te nenit 251 dhe për me tepër qe ana subjektive rezulton nga hetimi i rrethanave te shkeljes e qendrimit te subjektit nga ana e strukturave konstatuese dhe nga juristi nuk mund te behen ndryshime.

-Autoriteti vendimarrës DD Tirane vendimin nr. 1020 datë 14.09.2023 e ka marre bazuar ne Proces verbalin për verifikimin e kundervajtjes doganore “të mbajtur nga ana e grupit te Antikontrabandes dhe Sektorit Opëracional prane DD Tirane, ku jane përcaktuar pagesa e detyrimit ne shumen 216,000 leke dhe penalitet në shumën 44,954 leke, pasi ka pare teresine e gjithe dokumentacionit ligjor. Konstatimi i KLSH-se për aplikimin e nenit 252 germa d ne lidhje me nenin 257 nuk qendron.

Pra si forme shkleje përfshire edhe problematika e deklarates përbledhese është parashikuar ne disa germa te nenit 251 dhe për me tepër qe ana subjektive rezulton nga hetimi i rrethanave te shkeljes

e qendrimit te subjektit nga ana e strukturave konstatuese dhe nga juristi nuk mund te behen ndryshime.

-Autoriteti vendimarrës DD Tirane vendimin nr. 1105 datë 26.10.2022 e ka marrë bazuar ne Proces verbalin për verifikimin e kundervajtjes doganore “të mbajtur nga ana e grupit te Antikontrabandes dhe Sektorit Operacional prane DD Tirane, ku jane përcaktuar pagesa e detyrimit ne shumen 33,000 leke dhe penalitet në shumën 33,000 leke pasi ka pare teresine e gjithë dokumentacionit ligjor. Konstatimi i KLSH-se për aplikimin e nenit 252 germa d ne lidhje me nenin 257 nuk qendron.

-Për vendimet nr. 584, 585, 586, 587, 588, 589 si dhe 590 datë 01.04.2022, kur nga ana e grupit të auditimit është konstatuar se procedura e marrjes së vendimit nuk është bërë në zbatim korrekt të kuadrit ligjor dhe mundësine që i jepet operatorit ekonomik të kundërshtojë gjatë procedurës administrative detyrimin dhe sanksionin që lindin nga ky akt administrativ, më lejoni që të kundërshtoj këtë konstatim tuajin, pasi vendimarrjet që ju konstatoni janë marrë mbi bazën e rekomandimeve te Raportit Përfundimtar të Auditimit (Nr.1006/18 Prot., DDT datë 04.10.2021) Duke marrë në konsideratë faktin se ka një afat të caktuar për zbatimin e rekomandimeve, dhe faktin se procesverbalet e konstatimit të kundërvajtjeve janë depozituar në limitet kohore, vlerësoj se duhet të rishikohet ngarkimi me përgjegjësi për juristin lidhur me procedurën e komunikimit të aktit administrative. Sjell në vëmendjen tuaj se këto për këto vendimmarrje detyrimi doganor i lindur gjithashtu dhe sanksioni janë kontabilizuar me shumat përkatëse për llogari të autoritetit doganor.

-Lidhur me vendimin nr. 676 datë 19.05.2022 me subjekt “A” konstatimi nuk qendron pasi si forme shkelje futet tek rastet e paparashikuara shprehimisht dhe për pasoje është bazuar ne nenin 259 te KD. Vendimi është bazuar ne procesverbalin e strukturave konstatuese.

-Referuar konstatimeve për vendimet për klasifikim te gabuar te shkeljes se kryer dhe sanksionit te vendosur për rastet e marra ne shkelje te RLP-së për automjete, si me poshte referoj për keto vendimmarrje. Vendimet nr. 598, datë 04.04.2022, nr. 599, datë 05.04.2022, nr. 602 datë 07.04.2022, nr. 604 datë 11.04.2022, nr. 607 datë 19.04.2022, nr. 619 datë 22.04.2022, nr. 624 datë 27.04.2022, nr. 625 datë 27.04.2022 dhe nr. 626 datë 29.04.2022 ; vendimet nr. 629 datë 04.05.2022, 647 datë 09.05.2022, 656 datë 11.05.2022, 658 datë 12.05.2022, 665 datë 14.05.2022, nr. 670 datë 17.05.2022, nr. 700 datë 26.05.2022, nr. 702 datë 27.05.2022, nr. 759 datë 09.06.2022, nr. 760 datë 09.06.2022, 761 datë 10.06.2022 dhe 761 datë 10.06.2022. Gjithashtu për të njëjtën natyre të kundervajtjes administrativë përmend dhe vendimet nr. 48 datë 12.01.2023 dhe nr. 89 datë 10.01.2023.

Të gjitha aktet administrative sa më lartë trajtuar në këtë auditim kanë dalë në mbështetje të legjislacionit doganor shqiptar si dhe Udhëzimit të Përbashkët të Ministrisë të Financave dhe Ministrisë të Brendshëm me nr. 4, datë 04.02.2010 « *Për zbatimin e procedurave të miratimit, mbikëqyrjes dhe përmbylljes së rregjimit të lejimit të përkohshëm të automjeteve të huaja për përdorim privat* » lidhur me parashikimin e nenit 3 të nenit 650 Vendi për paraqitjen e aplikimit të VKM-së nr. 651, datë 10.11.2017 « *Për Dispozitat Zbatuese të Kodit Doganor* » të DPD-së nga ana e doganierit dhe përgjegjësit të Sektorit të Vlerësimit në Qendër në DPD. Akti i konstatimit përpilohet në përputhje me nenin 262, 274 dhe 276 të KD.

Gjatë marrjes së Vendimeve Administrative nga autoriteti Vendimmarrës Kompetent është mbajtur në konsideratë që sanksionet e vendosura për kundërvajtjet e përcaktuara sipas Kodit Doganor duhet të jenë efektive, proporcionale e dekurajuese dhe të vendosen brenda kufijve ligjore. Vendimmarrja është mbështetur në nenin 11 dhe 12 të Ligjit nr. 44/ 2015 të “*Kodit të Procedurave Administrative*”, i ndryshuar.

Në këto kushte mendoj se vendimmarrja administrative e DD Tiranë është e mbështetur në ligj dhe në akte dhe si e tillë nuk mund të procedohet me rishikim të tyre apo me saktësim të bazës ligjore. Nëse i referohemi praktikës gjyqësore tashmë të konsoliduar ashpërsia e penalitetit nuk mund të jetë në disproporcion me natyrën e kundërvajtjes administrative doganore, duke marrë në konsideratë edhe faktin që shtetasit janë paraqitur vullnetarisht pranë autoritetit doganor për të dhënë destinacion automjetit si dhe kanë paguar shumën e detyrimeve që rrjedhin si rezultat i zhdoganimit të automjeteve për përdorim privat.

-Konstatohen 6 vendime me parregullsi në klasifikimin e shkeljes për RLP të ndryshme nga makinat.

Në rastin e RLP qëndron i njëjti interpretim si për rastin e RLP-se të makinave.

Vendimet e Degës së Doganës Tirane janë marrë mbi bazën e provave dhe të situatës ligjore dhe faktike që ekzistonte në kohën e kryerjes së shkeljes doganore, kërkesë e domosdoshme e nenit 250, 276 e vijues të ligjit nr.102/2014, datë 31.07.2014 “Kodi Doganor” i ndryshuar.

Përsa më lart vendimmarrja është e argumentuar dhe e mbështetur në ligj, është në diskrecionin e autoritetit vendimarrës të përcaktojë llojin e masës së sanksioneve lidhur me kundërvajtjen administrative të konstatuar. Në përfundim, rezulton se vendimet e DD Tiranë janë nxjerrë mbi bazën e procesverbaleve të shkeljeve doganore, si rrjedhojë e aplikimit të saktë të dispozitave ligjore që i përgjigjen shkeljes doganore të kryer të konstatuara nga struktura doganore respektive, pra referenca ligjore është e saktë dhe për pasojë sanksionet e vendosura janë korrekte.

-Për vendimin nr. 763 datë 13.06.2022, nga ana e Zyres Aposteriori është mbajtur procesverbali me nr. serial 0022850 (nr. 3547 prot., datë 11.04.2022) “Për verifikimin e kundërvajtjes administrative”, përmes të cilit pasqyrohet vlera e detyrimit të munguar për praktikën doganore IM4 R 33004 datë 20.05.2020, i cili rezulton të jetë në masën 179,751 lekë.

Në vijimësi, pas konstatimit të fakteve reale dhe atyre të paraqitura në mënyrë dokumentare nga strukturat doganore por dhe nga operatori ekonomik, vlerësoj se, Ligji nr. 44/ 2015 “Kodi i Procedurave Administrative në Republikën e Shqipërisë” në teresinë e frymës ligjore që ndjek, përcakton sundimin e ligjit si parimin bazë më të rëndësishëm për kryerjen e procedurave administrative.

Duke mbajtur parasysh parimet e përgjithshme nga e cila duhet të udhëhiqet administrata në kryerjen e funksioneve të saj si “Parimi i ligjshmërisë; parimi i mbrojtjes së interesit publik por pa cënuar të drejtat e personave privat; parimi i drejtësisë dhe paanësisë; parimi i përgjegjshmërisë; parimi i kontrollit gjyqësor etj”, parime këto të sanksionuara në Ligjin nr.44/2015 “Kodi i Procedurave Administrative në Republikën e Shqipërisë”, shprehemi se nga ana jonë është vepruar në përputhje të plotë me ligjin.

Komenti i grupit të auditimit:

Për sa rekomanduar më sipër, me qëllim shqyrtimin, kontabilizimin dhe më pas arkëtimin e detyrimeve doganore të munguara të rillogarit në shumën 1,420,575 lekë, për vendimet nr. 1018, 1104, 1020 dhe 1105 që lidhen me diferencat sasiore të konstatuara në sasi malli më tepër dhe të padeklaruara dhe që nuk është deklaruar gjobë doganore sa 2-fishi i detyrimeve doganore të papaguara me shumën 300,824 lekë, DD Tiranë nuk kanë ndryshuar vendimmarrje.

Për vendimet nr. 584, 585, 586, 587, 588, 589 si dhe 590 datë 01.04.2022, për të cilat nga ana e grupit të auditimit është konstatuar se procedura e marrjes së vendimit nuk është bërë në zbatim korrekt të kuadrit ligjor dhe mundësinë që i jepet operatorit ekonomik të kundërshtojë gjatë procedurës administrative detyrimin dhe sanksionin që lindin nga ky akt administrativ. Subjekti sqaron se për këto vendimmarrje detyrimi doganor i lindur gjithashtu dhe sanksioni janë kontabilizuar me shumën përkatëse për llogarit të autoritetit doganor dhe nuk ka ndryshuar qëndrim.

Për vendimet e tjera, të cilat kanë detyrim doganor të munguar dhe penalitet, në shumën 1,109,751 lekë, DD Tiranë nuk ka ndryshuar vendimmarrje.

Ky rekomandim konsiderohet i pranuar dhe i pa zbatuar.

4.1 Rekomandimi: Dega Doganore Tiranë, të marrë masa për shqyrtimin e rasteve të evidentuara dhe ndjekjen e të gjitha procedurave të nevojshme administrative me qëllim arkëtimin e detyrimeve doganore në vlerën 1,710,952 lekë.

Përgjigjja e subjektit:

DD Tiranë sqaron në mënyrë shterruese pse autoriteti doganor nuk ndryshoi qëndrim (marrje vendimesh) në lidhje me subjektet dhe rastet e përmendura në këtë rekomandim:

a) Në lidhje me pikën “Mbi regjimin e lejimit të përkohshëm”, Vendimi nr. 567, datë 29.05.2023 është marrë në bazë të procesverbalit të doganiereve të regjimeve të DD Tiranë. Kundravajtja ka qenë e një shkelle jo të rëndë që ka ardh si rrjedhojë e një gabimi njerëzor sesa me dashje. Gjithashtu në përcaktimin e masës së penalitetit në lidhje me këtë subjekt autoriteti vendimarrës ka pasur përcaktimet e dispozitave ligjore si më poshte vijon: neni 262 i Kodit Doganor, nenin 11 dhe neni 12 të Ligjit nr. 44/ 2015 të “Kodit të Procedurave Administrative”, i ndryshuar.

Pra, organi doganor (juristi) ka vlerësuar nëse është e mundur që qëllimi i kërkuar të realizohet me masa sa më pak represive, pa kompromentuar efektivitetin e tyre nisur nga detyrimi doganor i lindur për t’u paguar. Referuar praktikës së konsoliduar të Gjykatës ashpërsia e penaliteteve nuk mund të jetë në disproporcion me natyrën e kundërvajtjes administrative doganore, duke patur në konsideratë faktin që subjekti ka bërë kërkesë për shtyrje të afatit të RLP-së që është aprovuar nga DPD.

b) Në lidhje me pikën “Euro 1 trajtim preferencial”, Vendimi nr. 882 datë 20.10.2023 për subjektin “L” ku ky subjekt është ngarkuar me pagimin e detyrimit në shumën 99,706 lekë dhe agjencia doganore “S”, i’u bëjmë me dije se ky vendim është mbajtur në bazë të procesverbalit nr. 6209/2 prot., datë 17.07.2023 të mbajtur nga zyra e aposteriorit pranë DD Tiranë lidhur me R105189 datë 10.10.2022, të subjektit “L” përson fizik me NIPT L., ku është përcaktuar vetëm pagesa e detyrimit dhe nuk është vendosur masë penaliteti. Zyra juridike pasi ka marrë në shqyrtim tërë praktikën doganore si dhe dokumentacionin ligjor bashkëngjitur si dhe bazuar në nenin 262 i Kodit Doganor, nenin 11 dhe neni 12 të Ligjit nr. 44/ 2015 të “Kodit të Procedurave Administrative”, i ndryshuar.

Organi doganor (juristi) ka vlerësuar nëse është e mundur që qëllimi i kërkuar të realizohet me masa sa më pak represive, pa kompromentuar efektivitetin e tyre nisur nga detyrimi doganor i lindur për t’u paguar.

c) Në lidhje me pikën “Mbi kontrollet e rezultuara sasi tepër”, Autoriteti vendimarrës DD Tiranë vendimin nr. 808, datë 11.09.2023 e ka marrë bazuar në procesverbalin për verifikimin e kundërvajtjes doganore me nr. 7789 prot., datë 08.09.2023, të mbajtur nga ana e Grupit të Antikontrabandës dhe Sektorit Operacional pranë DD Tiranë, për shkeljen e kryer nga ana e subjektit “D” PF NIPT L. lidhur me deklaratën doganore IM4 nr. R.92587 datë 06.09.2023, ku janë përcaktuar pagesa e detyrimit në shumën 69,205 lekë dhe penalitet sa njëfishi i detyrimit të munguar, pasi ka parë tërësinë e gjithë dokumentacionit ligjor.

- Vendimin nr. 812, datë 13.09.2023 e ka marrë bazuar në procesverbalin për verifikimin e kundërvajtjes doganore të mbajtur nga ana e Grupit të Antikontrabandës dhe Sektorit Operacional pranë DD Tiranë, për shkeljen e kryer nga ana e subjektit “D” lidhur me deklaratën doganore IM4 nr. R.94550 datë 11.09.2023, ku janë përcaktuar pagesa e detyrimit në shumën 18,829 lekë dhe penalitet sa njëfishi i detyrimit të munguar. DD Tiranë sqaron se, autoriteti doganor ka parë

tërësinë e gjithë dokumentacionit ligjor të praktikës doganore, është kryer kontrolli i plotë fizik dhënë nga Sektori i Koordinimit, bazuar në analizën e riskut me numër 2 (dy), ku u kryen numërimi/peshimi/kontrolli për natyrë malli/kontrolli për klasifikim i kryer nga Grupi i Antikontrabandës nr. 08-12 është konstatuar diferencë në sasinë e mallit të deklaruar (*pesha sipas deklarimit*), për sasinë si numër, pasqyruar në evidencën e kontrollit fizik nr. 0000072. Si pasojë e diferencave të konstatuara në numër (*artikujt këmisha;pantallona*) kanë rezultuar detyrime doganore të shmangura. Ka rezultuar se strukturat konstatuese të degës doganore në bashkëpunim me strukturat e Antikontrabandës mbështetur në tagrin që ligji i’u jep strukturave konstatuese për verifikimin e shkeljeve, kanë konkluduar se Operatorit Ekonomik “D” SHPK me NIPT. L. duhet të penalizohet me 1 fish të detyrimit doganor të shmangur në shumën 18.829 lekë mbi të cilin është marrë dhe vendimarrja. Gjithashtu autoriteti doganor është bazuar në nenin 262 i Kodit Doganor, nenin 11 dhe neni 12 të Ligjit nr. 44/ 2015 të “*Kodit të Procedurave Administrative*”, i ndryshuar.

d) Lidhur me konstatimin Shkelje procedurale dhe materiale për vendimarrje të cilat janë në kundërshtim me legjislacionin doganor, konkretisht vendimi nr. 51, datë 17.01.2023, ku citojmë : Shoqëria “M” shpk me Nipt L., është pajisur nga DPD me Autorizim të Rregjimit të Lejimit të Përkohshëm (përjashtim i pjesshëm) përkatësisht me nr.17089/1 datë 08.07.2016, 15425/1 datë 30.06.2017, nr. 16518/1 datë 14.07.2017. Nga ana e DPD si struktura e cila ka lëshuar keto autorizime është bërë me dije mosrespektimi i afatit të përcaktuar për secilin prej tyre. Nga Zyra e Mbikëqyrjes Doganore, lidhur me rezultatet e kontrollit është konstatuar se shoqëria ka shkelur kushtet e autorizimit. Duke parë që këto parregullsi i korrespondojnë të njëjtit subjekt dhe nga e njëjta strukturë konstatimi që ka dhënë dhe vetë autorizimet për operatorin ekonomik, por edhe duke patur parasysh rrethanat e kryerjes së tyre, është vlerësuar që të aplikohet një penaltet i përgjithshëm për këto lloj parregullsie në formën e gabimeve, pasi mungon elementi subjektiv i fajit përderisa nuk ka as shmangie nga pagesa e detyrimit doganor dhe gjithashtu edhe për faktin se shkeljet vijnë më shumë në formën e një kundërvajtje të zgjatur në kohë pra vazhduese në raport me mosrespekimin e autorizimit të lëshuar për regjimin e RLP-së. Vlen për t’u sqaruar se duke mos e nënvlerësuar aspak vlerën e ligjit material siç është Kodi Doganor, si ligji specifik që bën rregullimin e marrëdhënieve në fushën doganore, nuk mund të mos mbahen parasysh edhe parimet e përgjithshme të sanksionuara në nenin 4, Ligji nr. 10 279, datë 20.5.2010 “Për kundërvajtjet administrative”. Në vendimin nr. 51 datë 17.01.2023 masa e penaltetit të dhënë për rastin është në përputhje me parimet administrative të vendimarrjes, në nenin 262 i Kodit Doganor, nenin 11 dhe neni 12 të Ligjit nr. 44/ 2015 të “*Kodit të Procedurave Administrative*”, i ndryshuar.

e) Për vendimin nr. 53, datë 24.01.2023, Shoqëria “B” shpk me Nipt L., është pajisur nga DPD me Autorizim të Rregjimit të Lejimit të Përkohshëm me nr.11100/1 datë 27.04.2019, për një periudhë kohore 24 muaj. Mbështetur në Procesverbalin për verifikimit e kundërvajtjes doganore të Zyrës së Mbikëqyrjes Doganore me nr. serial 0022272, nr. 602 prot., datë 23.01.2023 rezulton se, subjekti nuk ka respektuar afatin e përcaktuar/rieksportit në këtë autorizim, pra shkeljen e afatit të Rregjimit të Lejimit të Përkohshëm për autorizimin me nr.11100/1 datë 27.04.2019.

Referuar konstatimit tuaj për faktin se subjekti zotëron 2 regjime lejimi të përkohshëm dhe është penalizuar për 1, ju lutem më lejoni t’u citoj se vendimarrja është marrë për procesverbalin për të cilin Zyra e Rregjimeve Doganore ka paraqitur për vendimarrje, pra Juristi i Degës Doganore nuk ka qenë në dijeni për regjimin e dytë dhe nuk mundet të mbajë përgjegjësi për moskontabilizimin e shumës, si dhe mos sanksionimin e operatorit ekonomik, për të cilin dhe ju vetë keni shprehur se nuk është mbajtur procesverbal i kundërvajtjes administrative.

f) Vendimi nr. 156, datë 03.03.2023 me subjekt “E” është mbajtur në bazë të procesverbalit nga Drejtoria e Hetimit nga ana e të cilëve si struktura kompetente për hetimin e shkeljes, pas hetimit

të kryer kanë konkluduar se ka kundërvajtje në formë parregullsie duke aplikuar penalitet 20,000 lekë. Zyra Juridike pasi ka marrë në shqyrtim praktikën doganore, si dhe dokumentacionin ligjor bashkëngjitur, bazuar në nenin 262 i Kodit Doganor, nenin 11 dhe neni 12 të Ligjit nr. 44/ 2015 të “Kodit të Procedurave Administrative”, i ndryshuar.

Duke patur parasysh se konfirmimi i autoriteteve doganore homologe konfirmon vërtetësinë e dokumentit Eur 1 por, megjithatë pas verifikimeve të kryera nga ana e tyre thuhet se malli nuk përfiton origjinë preferenciale, atëherë jemi përpara një kundërvajtje në formë parregullsie, pasi subjekti nuk ka paraqitur dokumenta fallco. Dokumenti i origjinës është autentik pra origjinal dhe për rrjedhojë subjekti nuk ka faj për gabimin e bërë nga furnitori apo strukturat që e kanë lëshuar Eur 1 në Greqi.

Por, për të mos e lënë pa penalizim fare Drejtoria e Hetimit, pas verifikimit të të gjitha rrethanave të shkeljes ka vendosur aplikimin e nje penaliteti në formë parregullsie. Autoriteti vendimmarrës DD Tiranë bazuar në procesverbalin e Drejtorisë së Hetimit ka vlerësuar nëse është e mundur që qëllimi i kërkuar të realizohet me masa sa më pak represive, pa kompromentuar efektivitetin e tyre nisur nga detyrimi doganor i lindur për t’u paguar.

g) Lidhur me procesverbalet e shkeljeve për Vendimet nr. 50, 48, 98, 89, procesverbalet plotësohen nga SVQ, dhe juristi nuk mund të bëjë ndërhyrje në procesverbal, por mangësitë e konstatuara në procesverbal i rregullon duke vendosur bazën ligjore që duhet dhe shumën përkatëse në vendim.

gj) Për vendimin nr. 158 datë 03.03.2023, i cili është marrë sipas procesverbalit për verifikimin e shkeljes doganore me nr. serial 0005582 (nr. 1469 prot., datë 20.02.2023) të mbajtur nga ana e Departamentit Operativ Hetimor, Strukturave të Antikontrabandës, për shkeljen e kryer nga ana e subjektit/përson fizik “S” me NIPT K.. Gjatë marrjes së Vendimit Administrativ nga autoriteti Vendimmarrës Kompetent është mbajtur në konsideratë që sanksionet e vendosura për kundërvajtjet e përcaktuara sipas Kodit Doganor duhet të jenë efektive, proporcionale e dekurajuese dhe të vendosen brenda kufijve ligjore. Vendim është mbështetur në nenin 262 i Kodit Doganor, nenin 11 dhe neni 12 të Ligjit nr. 44/ 2015 të “Kodit të Procedurave Administrative”, i ndryshuar, si dhe neni 18 i Ligjit nr. 10279, datë 20.05.2010 “Përkundërvajtjet administrative”.

h) Për vendimin nr. 100, datë 16.02.2023, Sipas procesverbalit për verifikimin e shkeljes doganore me nr. serial 0022201 (nr. 632 prot., datë 24.01.2022) të mbajtur nga ana e Sektorit të Operacioneve Doganore për shkeljen e kryer nga subjektit PF “X” me NIPT M..

Sikurse neni 262 përcakton se Autoritetet doganore kompetente në caktimin e llojit dhe masës së sanksioneve për kundërvajtjet e përcaktuara në nenet 251 deri në 254 duhet të marrin parasysh të gjitha rrethanat, duke përfshirë plotësimin e të gjitha kushteve në përcaktimin e masës së penalitetit, dhe jo vetëm por marrjen në konsideratë ndër të tjera dhe të efekteve financiare që shkelja ka shkaktuar në rastin konkret.

Komenti i grupit të auditimit:

Për sa më sipër, DD Tiranë lidhur me marrjen e masave për shqyrtimin e rasteve të evidentuara dhe ndjekjen e të gjitha procedurave të nevojshme administrative me qëllim arkëtimin e detyrimeve doganore në shumën 1,710,952 lekë, nuk ka ndryshuar vendimmarrje.

Ky rekomandim konsiderohet i pranuar dhe i pa zbatuar.

5.1 Rekomandimi: Dega Doganore Tiranë në bashkëpunim me Drejtorinë e Përgjithshme të Doganave, të marrë masa që për të gjitha rastet e transiteve të evidentuara me diferencë në peshë në aktin e inspektimit nga zyra doganore nisëse, të kryhen verifikimet përkatëse, të ndiqen procedurat e parashikuara në manual, të mbahen procesverbale apo dokumentacion për të faktuar nëse diferencat sjellin ose jo pasoja financiare.

Përgjigja e subjektit:

-Në lidhje me procedurat e ndjekura nga Zyra Operacionale për trajtimin e rasteve të diferencave të peshës së mjeteve grupazh, të rezultuara nga krahasimi i peshës së deklaruar në deklaratën e tranzitit, me peshën e rezultuar nga peshimi i mjetit, bazuar në informacionin e dërguar nga ZMP janë evidentuar mjetet, pas depozitimit të të gjitha deklarimeve për mallrat që transportoheshin në një mjet, është përzgjedhur punonjësi që do të kryejë procedurat e verifikimit fizik, më pas kanë vazhduar procedurat e verifikimeve dhe në rubrikën "akt inspektimi" të deklaratave janë plotësuar shënimet mbi rezultatet e verifikimeve, përgjithësisht si shkak i diferencave në peshë kanë qënë pasaktësisë së peshës së mjetit bosh që jepet në lejën e qarkullimit, mjetet për të cilët është konstatuar kjo parregullsi kanë qënë të huaja dhe të paregjstruara në Shqipëri, fakt që nuk mundëson aplikimin e penaliteteve. Në disa raste diferencat kanë rezultuar në mallra, pagesa e detyrimit të të cilave përlllogaritet për copë dhe jo për kg dhe diferenca nuk ndikonte në pagesën e detyrimit. Diferenca në peshë është vlerësuar si një indikator për mënyrën se si të kryhen kontrollet dhe verifikimet fizike të mallrave dhe jo si një arsye për të aplikuar penalitet, në rastet kur nga verifikimet e kryera është vërtetuar se diferenca ndikon në pagesën e detyrimit doganor, janë mbajtur aktet përkatëse dhe për shkeljen e konstatuar janë aplikuar penalitete sipas legjislacionit doganor.

Komenti i grupit të auditimit:

Nga grupi i auditimit të KLSH-së u konstatua se, DD Tiranë rezulton në proces pune mbi masat e marra për rastet e transiteve të evidentuara me diferencë në peshë në aktin e inspektimit nga zyra doganore nisëse.

Ky rekomandim konsiderohet i pranuar dhe në proces zbatimi.

5.2 Rekomandimi: Zyra Operacionale dhe Dega Doganore Tiranë, në cilësinë e strukturës kompetente të ndërmarrë të gjitha masat e nevojshme dhe vendimet përkatëse në përputhje me kërkesat ligjore dhe procedurale, më qëllim arkëtimitin e të ardhurave të munguara në buxhetin e shtetit të evidentuara në vlerën 440,000 lekë ne formën e gjobës.

Përgjigja e subjektit:

-Në lidhje me procedurat e ndjekura nga Zyra Operacionale për trajtimin e rasteve të diferencave të peshës së mjeteve grupazh, të rezultuara nga krahasimi i peshës së deklaruar në deklaratën e tranzitit, me peshën e rezultuar nga peshimi i mjetit, bazuar në informacionin e dërguar nga ZMP janë evidentuar mjetet, pas depozitimit të të gjitha deklarimeve për mallrat që transportoheshin në një mjet, është përzgjedhur punonjësi që do të kryejë procedurat e verifikimit fizik, më pas kanë vazhduar procedurat e verifikimeve dhe në rubrikën "akt inspektimi" të deklaratave janë plotësuar shënimet mbi rezultatet e verifikimeve, përgjithësisht si shkak i diferencave në peshë kanë qënë pasaktësisë së peshës së mjetit bosh që jepet në lejën e qarkullimit, mjetet për të cilët është konstatuar kjo parregullsi kanë qënë të huaja dhe të paregjstruara në Shqipëri, fakt që nuk mundëson aplikimin e penaliteteve. Në disa raste diferencat kanë rezultuar në mallra, pagesa e detyrimit të të cilave përlllogaritet për copë dhe jo për kg dhe diferenca nuk ndikonte në pagesën e detyrimit. Diferenca në peshë është vlerësuar si një indikator për mënyrën se si të kryhen kontrollet dhe verifikimet fizike të mallrave dhe jo si një arsye për të aplikuar penalitet, në rastet kur nga verifikimet e kryera është vërtetuar se diferenca ndikon në pagesën e detyrimit doganor, janë mbajtur aktet përkatëse dhe për shkeljen e konstatuar janë aplikuar penalitete sipas legjislacionit doganor.

Grupi i punës i DD Tiranë nuk ka dalë me vendimmarrje në lidhje me këto raste.

Komenti i grupit të auditimit:

Nga grupi i auditimit të KLSH-së u konstatua se nga DD Tiranë nuk janë marrë masa që për rastet e transiteve të evidentuara me diferencë në peshë në aktin e inspektimit nga zyra doganore nisëse, të kryhen verifikimet përkatëse, si dhe nuk kanë dalë me vendimmarrje për arkëtimin e të ardhurave të mungura në buxhetin e shtetit në vlerën 440,000 lekë.

Ky rekomandim konsiderohet i pranuar dhe i pa zbatuar.

6.1 Rekomandimi: Zyra e mbikëqyrjes doganore të regjimit të magazinimit doganor në zbatim të procedurave funksionale të kryejë inventarizimin e dosjeve, në dosje të jepen të dhëna të qarta të gjurmës së kontrolleve të ushtruara, administrimin në to, jo vetëm të dokumentacionit të sjellë nga subjektet, por edhe dokumentacionin vërtetues të të gjithë punës së kryer nga doganierët mbikëqyrës të regjimit të magazinimit doganor, si dhe të kryejnë kontrolle të paktën një herë në tre muaj. Të kryejë mbikëqyrjen e Autorizimeve për përdorimin e Regjimit të Magazinimit Doganor për të parë nëse përmbushen detyrimet që rrjedhin nga ky autorizim.

Përgjigjja e subjektit:

Me shkresën nr. 1024/6 prot., datë 25.04.2025, Kryetari i DD Tiranë ka nxjerrë urdhrin nr. 3/1, drejtuar Sektorit të Mbikëqyrjes së Regjimeve Ekonomike Doganore, për zbatimin e këtij rekomandimi.

DD Tiranë informon se, doganierët e Zyrës së Mbikëqyrjes Doganore kanë marrë masa për plotësimin e dosjeve të subjekteve. Kanë kryer verifikimet e koeficienteve të shfrytëzimit në ambientet e operatorit ekonomik. Çdo tre muaj kanë kryer rakordimet me subjektet e Përpunimit Aktiv si dhe verifikimin dhe rakordimin me Magazinat Doganore.

Komenti i grupit të auditimit:

Spektori i Mbikëqyrjes së Regjimeve Ekonomike Doganore ka marrë masa në inventarizimin e dosjeve dhe dokumentimin e të gjitha praktikave.

Ky rekomandim konsiderohet i pranuar dhe në proces zbatimi.

6.2 Rekomandimi: Dega Doganore Tiranë në bashkëpunim me Drejtorinë e Përgjithshme të Doganave, të ndërmarrë të gjitha masat e nevojshme më qëllim arkëtimin e të ardhurave të munguara në buxhetin e shtetit në shumën 100,000 lekë.

Komenti i grupit të auditimit:

Grupit të auditimit të KLSH-së, nuk ju vendos asnjë dokument në dispozicion mbi procedurën e ndjekur nga Spektori i Mbikëqyrjes së Regjimeve Ekonomike Doganore në zbatim të këtij rekomandimi.

Ky rekomandim rezulton i pranuar dhe i pa zbatuar.

E. MASA TË TJERA.

1.1 Rekomandimi: Dega Doganore Tiranë të marrë masa që për rastet e tranziteve të evidentuara si të mbërritur me vonesë, të reflektojë shënimet përkatëse në dokumentin e tranzitit, si dhe të procedojë me penalizimin e subjekteve për mosrespektim të afatit kohor të mbërritjes në doganën e destinacionit.

Përgjigjja e subjektit:

Me shkresën nr. 1024/22 prot., datë 15.09.2025, DD Tiranë e ka përcjell rekomandimin e KLSH-së në lidhje me afatin kohor dhe mbylljen e tranziteve, për kompetencë Drejtorisë së Procedurave në DPD.

Në lidhje me problematikën e ngritur për penalizimin e subjekteve për vonesa në transit arsytet pse

DD Tiranë nuk ka dalë me vendime është për shkak të disa faktorëve: struktura e paplotësuar në këtë sektor, detyrat funksionale dhe se puna në pikën e Hyrje-Daljeve është shumë intensive dhe me përgjegjësi, pasi kemi të bëjmë me mallrat e ardhura nga degët e tjera doganore, të cilat do të zhdoganohen apo do të shkojnë në eksport dhe për keto arsye, pika e Hyrje-Dalje në DD Tiranë nuk ka punë me zhdoganimin, pra jo me te ardhurat e doganës (fiskun). Disa tranzite të ardhura kanë pasur vonesë, pasi kanë ardhur nga disa faktorë të tjerë, që nuk varen nga dogana.

DD Tiranë ka marrë dhe do të marrë të gjitha masat në kryerjen e detyrave tona që ti mbyllim sa më shpejt tranzitet e ardhura dhe subjektet të mos vonohen në deklarimin e mallrave, që dhe te ardhurat e doganës nga sektoret e tjerë të mblidhen sa me shpejt.

Komenti i grupit të auditimit:

Për sa më sipër, DD Tiranë ka sqaruar se vonesat në tranzit nuk varen gjithmonë nga kjo degë doganore. Ata shprehin angazhimin se do të marrin masa në këtë drejtim, por nuk kanë dalë me vendimmarrje.

Ky rekomandim konsiderohet i pranuar dhe i zbatuar pjesërisht.

1.2 Rekomandimi: Dega Doganore Tiranë në bashkëpunim me Drejtorinë e Përgjithshme të Doganave të hartojnë udhëzim të ri për ndryshimin e tabelës së afateve të transitit të përcaktuar në udhëzimin nr. 04 datë 30.09.2011 “*Për caktimin e afatit brenda të cilit mallrat të vendosura në regjimin e transitit duhet të paraqiten në zyrën e destinacionit*”, duke marrë parasysh zhvillimet e reja infrastrukturore, trafikun apo arsye të tjera. Të ndërmarrë të gjitha masat e nevojshme dhe vendimet përkatëse në përputhje me kërkesat ligjore dhe procedurale, më qëllim arkëtimin e të ardhurave të munguara në Buxhetin e Shtetit të evidentuara në 13,045 raste transiti (shkelje afati) në **shumën 260,900,000 lekë** në formën e gjobës doganore.

Përgjigja e subjektit:

Me shkresën nr. 1024/22 prot., datë 15.09.2025, DD Tiranë e ka përcjell rekomandimin e KLSH-së për kompetencë, Drejtorisë së Procedurave në DPD.

Me shkresën nr. 1024/34 prot., datë 12.09.2025 DD Tiranë i është drejtuar Departamentit Teknik, Departamentit Administrativ dhe DOH në DPD, mbi problematikën e afatit kohor dhe mbylljes së tranziteve, ku kërkohet të merren masa për ngritjen e një grupi pune me pjesëmarrjen e të gjithë departamenteve dhe degëve doganore që të shqyrtohen dhe reflektohen problematika dhe mbylljen me vonesë e tranziteve në sistemin ASYCUDA, me qëllim unifikimin e procedurës së tranziteve duke bërë ndryshimet ligjore.

Në relacion DD Tiranë sqaron se, pika e Hyrje-Dalje në DD Tiranë nuk ka punë me zhdoganimin, pra Jo me te ardhurat e doganës (fiskun). Detyra kryesore e Pikes Hyrje-Dalje ne Doganen e Tiranës është qe te gjitha mallrat e tranziteve te ardhura dhe eksportet e kryera nga kjo dogane, te jene te pa cenura nga elementet e sigurise, si dhe ti sherbehet subjekteve sa me shpejt dhe te mos kete vonesa ne zhdoganimin apo eksportin e mallrave. Disa tranzite të ardhura kanë pasur vonesë, pasi kanë ardhur nga disa faktorë të tjerë, që nuk varen nga dogana.

DD Tiranë ka marrë dhe do të marrë të gjitha masat në kryerjen e detyrave tona që ti mbyllim sa më shpejt tranzitet e ardhura dhe subjektet të mos vonohen në deklarimin e mallrave, që dhe te ardhurat e doganës nga sektoret e tjerë të mblidhen sa me shpejt. Në lidhje me problematikën e ngritur për penalizimin e subjekteve për vonesa në transit arsytet pse DD Tiranë nuk ka dalë me vendime.

Komenti i grupit të auditimit:

DD Tiranë ka përcjellë problematikën në DPD, nëpërmjet shkresës nr. 1024/34 prot., datë

12.09.2025, por nuk kanë dalë me vendimmarrje në arkëtimin e të ardhurave të munguara në shumën 260,900,000 lekë. Rekomandimi konsiderohet i zbatuar pjesërisht

Ky rekomandim konsiderohet i pranuar dhe i zbatuar pjesërisht.

2.1 Rekomandimi: Dega Doganore Tiranë, për 125 raste të deklarimeve të mallrave ku janë konstatuar deklarime mallrash të natyrës “Produkte Shtazore” dhe “Mallra Ushqimore të Gatshëm” të cilat nuk kanë bashkëlidhur në sistemin Asycuda World dokumentacion ligjor të tipit “Certifikate Veterinare” për produktet shtazore të importuara dhe dokumenti shoqërues i tipit “Raport Analize”, “Certifikate Fito sanitare” “Certifikate Shëndeti”, “Certifikate Origjine” për produkte ushqimore të gatshme, të aplikojë gjobë ne masën 20,000 lekë për çdo rast kundërvajtje administrative doganore, për vlerën totale 2,500,000 lekë.

Përgjigja e subjektit:

Sipas verifikimeve të bëra nga grupi i punës në lidhje me Aneksin 4.83/Aneksin 4.84 ku citohet se, *“ka mungesë të certifikatave veterinare të vendit të origjinës”*, sqarohet se: Certifikata veterinare është një dokument që vërteton se mishi është prodhuar, përpunuar dhe pakëtuar sipas standardeve veterinare të kërkuara. Kërkohet që vendi eksportues dhe subjekti eksportues të jenë në përputhje me ligjet/shqyrtimet veterinare, *kjo certifikatë i dorëzohet inspektorit të AKU në pikën doganore hyrëse në momentin e hyrjes së mallit në territorin e Republikës së Shqipërisë. Nga verifikimi i deklaratave doganore rezultoi se një kopje e certifikatës së marrjes së mostrave nga inspektori i AKU-së u është bashkëngjitur deklaratave doganore.* Gjithashtu nga verifikimi i deklaratave të Aneksit 4.84 nuk rezultuan mangësi ne dokumentacion.

Komenti i grupit të auditimit:

Për sa më sipër, grupi i punës së ngritur nga DD Tiranë ka kryer verifikimet në lidhje me konstatimet e KLSH-së dhe sqaron se kjo certifikatë i dorëzohet inspektorit të AKU-së në pikën doganore hyrëse në momentin e hyrjes së mallit në territorin e Republikës së Shqipërisë dhe nuk kanë konstatuar mangësi në dokumentacion.

Ky rekomandim konsiderohet i pranuar dhe i zbatuar plotësisht.

D. Mbi zbatimin e rekomandimeve për masat disiplinore. Fillimi i procedurave për dhënien e masave disiplinore dhe administrative. Sa rekomandime janë pranuar dhe ecuria e tyre për masat e dhëna.

F I. Mbështetur në nenin 15, të Ligjit nr. 154/2014, datë 27.11.2014 “Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit” dhe në nenin 58 dhe 59, të ligjit nr. 152/2013 “Për nëpunësin civil” të ndryshuar, si dhe në VKM nr. 115, datë 05.03.2014 “Për përcaktimin e procedurës disiplinore dhe të rregullave për krijimin, përbërjen e vendimmarrjen në komisionin disiplinor në shërbimin civil”, i kërkojmë Drejtorit të Përgjithshëm të Doganave dhe Kryetarit të Degës Doganore përkatëse, të fillojnë procedurat për dhënien e masës disiplinore:

F. I (a) Niveli i masës “**Vërejtje**” për punonjësit e kategorisë **C2** (të emëruar ose komanduar) si më poshtë vijon:

1. Për **Znj. A. M.**, me detyrë doganiere zyra mbikëqyrjes doganore në D.D.Tiranë
2. Për **Znj. S. P.**, me detyrë doganiere zyra mbikëqyrjes doganore në D.D.Tiranë
3. Për **Znj. T. L.**, me detyrë doganiere zyra mbikëqyrjes doganore në D.D.Tiranë
4. Për **Znj. S. C.**, me detyrë doganiere zyra mbikëqyrjes doganore në D.D.Tiranë
5. Për **Znj. S. S.**, me detyrë doganiere zyra mbikëqyrjes doganore në D.D.Tiranë

-Për problematika te evidentuara gjatë procedurave doganore të mbikëqyrjes së regjimeve doganore ekonomike të përpunimit aktiv për të cilat nuk janë kryer kontrole periodike me iniciativë të drejtpërdrejte për verifikimin e koeficientit të shfrytëzimit sipas përcaktimeve ligjore të nenit 15 të

Udhëzimit nr. 4 datë 28.03.2019 “Mbi zbatimin Praktik te Regjimit te Përpunimit Aktiv”.

-Për problematika që lidhen veprime te cilat nuk janë kryer në përmbushje të Rregullores së Brendshme të Degëve Doganore “Mbi organizimin e funksionimit të Drejtorisë së Përgjithshme të Doganave” e dalë me Urdhrin nr. 146, datë 07.05.2018, të Ministrit të Financave neni 15 pika 4 ‘kompetencat e doganierit te mbikëqyrjes’

F. I (b). Niveli i masës “*Mbajtja në masën e 1/3 të pagës së plotë për një periudhë deri në 6 muaj*” për punonjësit kategorisë C1 dhe C2 (përgjegjës sektori ose doganier vlerësimi te emëruar ose komanduar) si më poshtë vijon:

1. Për **Znj. M. H.**, me detyrë doganier i klasifikim/vlerësim në sektorin SVQ
2. Për **Znj. T. Sh.**, me detyrë doganier i klasifikim/vlerësim në sektorin SKAO dhe SVQ
3. Për **Znj. E. Xh.**, me detyrë doganier i klasifikim/vlerësim në sektorin SKAO dhe SVQ
4. Për **Z. R. M.**, me detyrë doganier i klasifikim/vlerësim në sektorin SVQ
5. Për **Z. R. B.**, me detyrë doganier i klasifikim/vlerësim në sektorin SVQ.
6. Për **Znj. L. D.**, me detyrë doganier i klasifikim/vlerësim në sektorin SVQ
7. Për **Znj. K. Xh.**, me detyrë doganier i klasifikim/vlerësim në sektorin SVQ
8. Për **Z. E. M.**, me detyrë ish doganier i klasifikim/vlerësim në sektorin SVQ
9. Për **Znj. A. B.**, me detyrë doganiere i klasifikim/vlerësim në sektorin SVQ
10. Për **Z. E. H.**, me detyrë doganier i klasifikim/vlerësim në sektorin SVQ
11. Për **Z. P. R.**, me detyrë doganier i klasifikim/vlerësim në sektorin SKAO dhe SVQ
12. Për **Znj. G. G.**, me detyrë doganiere e klasifikim/vlerësim në sektorin SVQ
13. Për **Z. A. H.**, me detyrë doganiere i klasifikim/vlerësim në sektorin SVQ
14. Për **Z. E. N.**, me detyrë doganier i klasifikim/vlerësim në sektorin SKAO dhe SVQ
15. Për **Znj. B. K.**, me detyrë doganier i klasifikim/vlerësim në sektorin SKAO dhe SVQ
16. Për **Z. J. S.**, me detyrë doganier i klasifikim/vlerësim në sektorin SKAO dhe SVQ
17. Për **Z. I. R.**, me detyrë ish përgjegjës i sektorit të kontrollit dokumentar pranë SVQ
18. Për **Z. J. H.**, me detyrë ish përgjegjës i sektorit të kontrollit dokumentar pranë SVQ
19. Për **Z. B. D.**, me detyrë ish doganier i klasifikim/vlerësim në sektorin SKAO dhe SVQ
20. Për **Znj. E. G.**, me detyrë doganier i klasifikim/vlerësim në sektorin SVQ

- Për mospërmbushje të kërkesave të legjislacionit doganor gjatë ushtrimit të detyrave funksionale dhe kryerjes së veprimeve që cenojnë figurën e nëpunësit civil, institucionin apo shërbimin civil në tërësi të përcaktuara në Udhëzimin nr. 5 datë 26.01.2018 sipas shkresës nr 2194 Prot DPD datë 26.01.2018 “Mbi procedurat standarde të Vlerësimit në Qendror dhe Sektorit të Kontrollit Aposterior Operativ”, nxjerrë nga Drejtori i Përgjithshëm i Doganave të cilat bien në kundërshtim me përcaktimet dhe shpjegimet e këtij Udhëzimi sa më poshtë vijon:

“Pika I (nga pika I deri në pikën 5), Pika II (nga 2 deri 3), Pika III “Procedurat që ndiqen nga SVQ” nga I.1 deri në I.5, Pika (A) “Kontrolli i Klasifikimit tarifor të Mallrave” pika a.1 deri a.3, Pika (B) “Kontrolli mbi origjinën e mallrave” nga b.1 deri b.8, Pika (C), Pika (D) “Kontrolli dhe shqyrtimi i Vlerës Doganore” nga d.1 deri në d.12, Pika (E) “Konstatimi i Shkeljes Doganore” nga e.1 deri në e.7, Pika III.1 “Përzgjedhja në Kanal të Kuq” nga 2.1 deri 2.10, Pika III 2.A “Konstatimi i Shkeljes Doganore” nga a.1 deri a.7, Pika IV “Procedurat që ndiqen nga SKAO” nga 1.1 deri 1.9, Pika IV.a “Kontrolli mbi klasifikimin tarifor” nga a.1 deri a.3, Pika IV.b “Kontrolli mbi origjinën” nga b.1 deri b.9, Pika IV (D) “Kontrolli dhe shqyrtimi i Vlerës Doganore” nga d.1 deri në d.13, Pika IV.2 “Rastet e Përzgjedhura dhe kanale të tjera” nga 2.1 deri në 2.4, Pika IV 3. “Konstatimi i Shkeljes Doganore” nga 3.1 deri 3.6, Pika V “Bashkëpunimi ndërmjet strukturave”.

-Për problematika në lidhje me praktika doganore të cilat janë trajtuar me transaksion, ndërkohë që duhet të ishin trajtuar me ndërhyrje në vlerën e mallit dhe jo në përputhje me kërkesat e neneve

65 deri 70 të ligjit nr. 102/2014 datë 31.7.2014 “Kodi Doganor i Republikës së Shqipërisë” i ndryshuar, lidhur me vlerësimin doganor të mallrave , duke kryer vlerësime jo të bazuara sipas kriterëve të pikës 4.6 sipas metodës 6 bazuar në të Dhënat e Disponueshme në RSH, pikës 5 “Rregullimet”, pikës 6 “Dokumentacioni shoqërues që lidhet me vlerën doganore”, pikës 6/b/c/d, pikës 7 “Profilizimi i riskut në vlerësimin doganor” ,pikës 8 “Dokumentacioni Shtesë”, pikës 8/a/dh/ii/iii/vii/f , pikës 11 “Përdorimi i Data basit të Vlerësimit” bazuar në pikën 10/c që lidhen me rillogaritje të detyrimeve doganore në import si dhe jo në përmbushje të kërkesave të Udhëzimit nr. 3, datë 23.01.2018 “Për vlerësimin e mallrave për qëllime doganore”

-Për problematika që lidhen me procedurat e përpunimit të deklarave doganore me klasifikime tarifore të cilat nuk deklaruar janë në përputhje me rregullat e Nomenklaturës së Mallrave në RSH, mos rillogaritje të detyrimeve doganore të taksës kombëtare të ambalazhit plastik, mos pagesa të detyrimeve doganore të mallrave që duhet të paguajnë akcizë, për të cilat nuk është vepruar në përputhje me kërkesat e nenit 50 dhe Shtojcës 5 të Ligjit nr. 61/2012 “Për Akcizat në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, veprime jo në përputhje me përcaktimet e shkresës nr. 779 prot, të DPD datë 16.01.2013 “Mbi rishikimin e disa indikatorëve shtesë në vlerësimin doganor të mallrave me origjinë nga vendet jashtë BE”, për veprime të cilat nuk janë në përputhje me përcaktimet e ligjit nr. 9975, datë 28.07.2008 “Për Taksat Kombëtare”, i ndryshuar, me qëllim vjeljen dhe arkëtimin e taksës kombëtare TAM për artikujt që duhet të paguajnë këtë taksë kombëtare, përcaktimet e shpjegimeve të Udhëzimit nr. 2, datë 17.01.2014, pika 2.8.5 dhe ligjit nr. 92/2014 “Për Tatimin mbi Vlerën e Shtuar në Republikën e Shqipërisë”. përcaktimeve të ligjit nr. 112/2021 datë 25.11.2021 për disa shtesa ne ligjin nr. 9975 datë 28.07.2008 “Për taksat kombëtare”. i ndryshuar, nenin 14, 15, 16 17 dhe 18 te ligjit nr .9863 datë 28.01.2008 “Për Ushqimin” ndryshuar”

-Për problematika që lidhen veprime te cilat nuk janë kryer në përmbushje të Rregullores së Brendshme të Degëve Doganore “Mbi organizimin e funksionimit të Drejtorisë së Përgjithshme të Doganave” e dalë me Urdhrin nr. 146, datë 07.05.2018, të Ministrisë të Financave neni 12 pika 10 “kompetencat e doganierit” dhe nenit 12 pika 5 “kompetencat e përgjegjësit te zyrës operacion ale te kontrollit doganor” dhe Seksionit III, pika 1.5, shkronja “a”, si dhe seksionin IV, pika 1.9, shkronja “a”, të Udhëzimit nr. 5, datë 26.01.2018 të DPD “Mbi procedurat standarde të funksionimit të SVQ dhe SKAO”.

F. I (c). Niveli i masës “Mbajtja në masën e 1/3 të pagës së plotë për një periudhë deri në 6 muaj” për punonjësit kategorisë **C2** (te emëruar ose komanduar) si më poshtë vijon:

1. Për **Z.A. K.**, me detyrë doganier i sektorit të kontrollit operacional pranë D.D.Tiranë.
2. Për **Z. B. C.**, me detyrë doganier i sektorit të kontrollit operacional pranë D.D.Tiranë.
3. Për **Z. U. M.**, me detyrë doganier i sektorit të kontrollit operacional pranë D.D.Tiranë.

-Për mospërmbushje të kërkesave të legjislacionit doganor gjatë ushtrimit të detyrave funksionale dhe kryerjes së veprimeve që cenojnë figurën e nëpunësit civil, institucionin apo shërbimin civil në tërësi të përcaktuara në Udhëzimin nr. 5 datë 26.01.2018 sipas shkresës nr. 2194 Prot DPD datë 26.01.2018 “Mbi procedurat standarde të Vlerësimit në Qendror dhe Sektorit të Kontrollit Aposterior Operativ”, nxjerrë nga Drejtori i Përgjithshëm i Doganave të cilat bien në kundërshtim me përcaktimet dhe shpjegimet e këtij Udhëzimi sa më poshtë vijon:

“Pika I (nga pika I deri në piken 5), Pika II (nga 2 deri 3), Pika III “Procedurat që ndiqen nga SVQ” nga 1.1 deri në 1.5, Pika (A) “Kontrolli i Klasifikimit tarifor te Mallrave” pika a.1 deri a.3, Pika (B) “Kontrolli mbi origjinën e mallrave” nga b.1 deri b.8, Pika (C), Pika (E) “Konstatimi i Shkeljes Doganore” nga e.1 deri në e.7, Pika III.1 “ Përzgjedhja në Kanal të Kuq” nga 2.1 deri 2.10, Pika III 2.A “ Konstatimi i Shkeljes Doganore” nga a.1 deri a.7, Pika IV .a “Kontrolli mbi klasifikimin tarifor” nga a.1 deri a.3, Pika IV .b “Kontrolli mbi origjinën” nga b.1 deri b.9, Pika IV (D) “Kontrolli dhe shqyrtimi i Vlerës Doganore” nga d.1 deri në d.13, Pika IV.2 “Rastet e Përzgjedhura dhe kanale të tjera” nga 2.1 deri në 2.4, Pika IV 3. “

Konstatimi i Shkeljes Doganore” nga 1.1 deri 3.6, Pika V “Bashkëpunimi ndërmjet strukturave”.

-Për problematika që lidhen me mos kryerjen e plotë të procedurave të kontrollit doganor të përpunimit të deklarave doganore të kanalizuar në kanal te kuq (risk lartë) të cilat rezultojnë me klasifikime tarifore jo në përputhje me rregullat e Nomenklaturës së Mallrave në RSH, duke shkaktuar pasoja në mos rillogaritje të detyrimeve doganore të taksës kombëtare të ambalazhit plastik, mos pagesa të detyrimeve doganore të mallrave që duhet të paguajnë akcizë, për të cilat nuk është vepruar në përputhje me kërkesat e nenit 50 dhe Shtojcës 5 të Ligjit nr. 61/2012 “Për Akcizat në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, për veprime të cilat nuk janë në përputhje me përcaktimet e ligjit nr. 9975, datë 28.07.2008 “Për Taksat Kombëtare”, i ndryshuar, me qëllim vjeljen dhe arkëtimin e taksës kombëtare TAM për artikujt që duhet të paguajnë këtë taksë kombëtare, përcaktimet e shpjegimeve të Udhëzimit nr. 2, datë 17.01.2014, pika 2.8.5 dhe ligjit nr. 92/2014 “Për Tatimin mbi Vlerën e Shtuar në Republikën e Shqipërisë”. përcaktimeve të ligjit nr. 112/2021 datë 25.11.2021 për disa shtesa në ligjin nr. 9975 datë 28.07.2008 “për taksat kombëtare”. i ndryshuar, nenin 14, 15, 16 17 dhe 18 të ligjit nr. 9863 datë 28.01.2008 “Për Ushqimin” ndryshuar”.

-Për problematika që lidhen veprime të cilat nuk janë kryer në përmbushje të Rregullores së Brendshme të Degëve Doganore “Mbi organizimin e funksionimit të Drejtorisë së Përgjithshme të Doganave” e dalë me Urdhërin nr. 146, datë 07.05.2018, të Ministrit të Financave neni 12 pika 10 “kompetencat e doganierit” dhe Seksionit III, pika 1.5, shkronja “a”, si dhe seksionin IV, pika 1.9, shkronja “a”, të Udhëzimit nr. 5, datë 26.01.2018 të DPD “Mbi procedurat standarde të funksionimit të SVQ dhe SKAO”.

F. I (d). Niveli i masës “*Pezullim nga e drejta e ngritjes në detyrë, përfshirë rritjen në shkallën e pagës për një periudhë deri në dy vjet në shërbimin civil*” për punonjësit kategorisë C1 dhe C2 (te emëruar ose komanduar) si më poshtë vijon:

1. Për **Z. J. H.**, me detyrë doganier i sektorit të kontrollit operacional pranë D.D.Tirane.
2. Për **Z. G. I.**, me detyrë doganier i sektorit të kontrollit operacional pranë D.D.Tirane.
3. Për **Z. E. C.** me detyrë ish përgjegjës i sektorit të kontrollit operacional pranë D.D.Tirane.

-Për mos përmbushje të kërkesave të legjisllacionit doganor gjatë ushtrimit të detyrave funksionale dhe kryerjes së veprimeve që cenojnë figurën e nëpunësit civil, institucionin apo shërbimin civil në tërësi të përcaktuara në Udhëzimin nr. 5 datë 26.01.2018 sipas shkresës nr 2194 Prot DPD datë 26.01.2018 “Mbi procedurat standarde të Vlerësimit në Qendror dhe Sektorit të Kontrollit Aposterior Operativ”, nxjerrë nga Drejtori i Përgjithshëm i Doganave të cilat bien në kundërshtim me përcaktimet dhe shpjegimet e këtij Udhëzimi sa më poshtë vijon:

“Pika I (nga pika 1 deri në piken 5), Pika II (nga 2 deri 3), Pika III “Procedurat që ndiqen nga SVQ” nga 1.1 deri në 1.5, Pika (A) “Kontrolli i Klasifikimit tarifor të Mallrave” pika a.1 deri a.3, Pika (B) “Kontrolli mbi origjinën e mallrave” nga b.1 deri b.8, Pika (C), Pika (E) “Konstatimi i Shkeljes Doganore” nga e.1 deri në e.7, Pika III.1 “Përzgjedhja në Kanal te Kuq” nga 2.1 deri 2.10, Pika III 2.A “Konstatimi i Shkeljes Doganore” nga a.1 deri a.7, Pika IV .a “Kontrolli mbi klasifikimin tarifor” nga a.1 deri a.3, Pika IV .b “Kontrolli mbi origjinën” nga b.1 deri b.9, Pika IV (D) “Kontrolli dhe shqyrtimi i Vlerës Doganore” nga d.1 deri në d.13, Pika IV.2 “Rastet e Përzgjedhura dhe kanale te tjera” nga 2.1 deri në 2.4, Pika IV 3. “Konstatimi i Shkeljes Doganore” nga 3.1 deri 3.6, Pika V “Bashkëpunimi ndërmjet strukturave”.

-Për problematika të evidentuara në praktikën doganore ku u konstatua se pas kryerjes së procedurës së kontrollit fizik nga personeli përpunues doganor për praktikën doganore në detyrim dhe juridiksionin kontrolli në aktin e kontrollit është shënuar se deklarimi përputhet me gjendjen fizike të mallrave ndërkohe që pas procedurave të ri kontrollit është konstatuar mall i padeklaruar me diferenca në sasi, natyrë dhe vlerë për mjetet e çliruara nga zona doganore Tirane të rikthyera më pas për procedura ri kontrolli nga struktura e Drejtorisë së Antikontrabandes pranë

Departamentit Operativ Hetimor. Pasi janë kryer procedurat e ri kontrollit nga struktura e Drejtorisë së Antikontrabandes pranë Departamentit Operativ Hetimor kane rezultuar diferenca te mallrave te ndryshëm ne sasi me efekte dhe pasoja ne detyrime doganore për të cilat më pas Dega Doganore Tiranë ka nxjerrë vendime administrative me efekte negative ne Buxhetin e Shtetit të cilat janë kontabilizuar në formën e borxhit doganor. Ne përfundim se konstatohet se nga personeli përpunues doganor i kontrollit fizik pranë Degës Doganore Tirane nuk janë kryer procedura te rregullta kontrolli gjate kryerjes se detyrave funksionale me pasoje lindjen e efekteve negative ne te ardhurat e Buxhetit te Shtetit.

-Për problematika që lidhen me mos kryerjen e plotë të procedurave të kontrollit doganor të përpunimit të deklarave doganore të kanalizuar në kanal te kuq (risk lartë) të cilat rezultojnë me klasifikime tarifore jo në përputhje me rregullat e Nomenklaturës së Mallrave në RSH, duke shkaktuar pasoja në mos rillogaritje të detyrimeve doganore të taksës kombëtare të ambalazhit plastik, mos pagesa të detyrimeve doganore të mallrave që duhet të paguajnë akcizë, për të cilat nuk është vepruar në përputhje me kërkesat e nenit 50 dhe Shtojcës 5 të Ligjit nr. 61/2012 “Për Akcizat në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, për veprime të cilat nuk janë në përputhje me përcaktimet e ligjit nr. 9975, datë 28.07.2008 “Për Taksat Kombëtare”, i ndryshuar, me qëllim vjeljen dhe arkëtimin e taksës kombëtare TAM për artikujt që duhet të paguajnë këtë taksë kombëtare, përcaktimet e shpjegimeve të Udhëzimit nr. 2, datë 17.01.2014, pika 2.8.5 dhe ligjit nr. 92/2014 “Për Tatimin mbi Vlerën e Shtuar në Republikën e Shqipërisë”. përcaktimeve të ligjit nr. 112/2021 datë 25.11.2021 për disa shtesa ne ligjin nr. 9975 datë 28.07.2008 “Për taksat kombëtare”.i ndryshuar, nenin 14, 15, 16 17 dhe 18 te ligjit nr. 9863 datë 28.01.2008 “Për Ushqimin” ndryshuar”

-Për problematika që lidhen me veprime te cilat nuk janë kryer në përmbushje të Rregullores së Brendshme të Degëve Doganore “Mbi organizimin e funksionimit të Drejtorisë së Përgjithshme të Doganave “e dalë me Urdhërin nr. 146, datë 07.05.2018, të Ministrit të Financave neni 12 pika 10 ‘kompetencat e doganierit’ dhe nenit 12 pika 5 ‘kompetencat e përgjegjësit te zyrës operacionale te kontrollit doganor’ dhe Seksionit III, pika 1.5, shkronja “a”, si dhe seksionin IV, pika 1.9, shkronja “a”, të Udhëzimit nr. 5, datë 26.01.2018 të DPD “Mbi procedurat standarde të funksionimit të SVQ dhe SKAO”.

F. I (e). Niveli i masës “Vërejtje” për punonjësit e kategorisë **C2** (te emëruar ose komanduar) si më poshtë vijon:

1. Për **Znj. R. K.**, me detyrë doganiere i klasifikim/vlerësim në sektorin SVQ
2. Për **Znj. E. B.**, me detyrë doganiere i klasifikim/vlerësim në sektorin SVQ
3. Për **Z. L. Xh.** me detyrë doganier i klasifikim/vlerësim në sektorin SVQ
4. Për **Znj. A. C.**, me detyrë doganier i klasifikim/vlerësim në sektorin SVQ
5. Për **Z. A. B.**, me detyrë doganier i klasifikim/vlerësim në sektorin SVQ
6. Për **Z. K. B.**, me detyrë doganier i klasifikim/vlerësim në sektorin SKAO dhe SVQ
7. Për **Z. J. C.**, me detyrë doganier i klasifikim/vlerësim në sektorin SVQ

- Për mos përmbushje të kërkesave të legjislacionit doganor gjatë ushtrimit të detyrave funksionale dhe kryerjes së veprimeve që cenojnë figurën e nëpunësit civil, institucionin apo shërbimin civil në tërësi të përcaktuara në Udhëzimin nr. 5 datë 26.01.2018 sipas shkresës nr. 2194 Prot DPD datë 26.01.2018 “Mbi procedurat standarde të Vlerësimit në Qendror dhe Sektorit të Kontrollit Aposterior Operativ”, nxjerrë nga Drejtori i Përgjithshëm i Doganave të cilat bien në kundërshtim me përcaktimet dhe shpjegimet e këtij Udhëzimi sa më poshtë vijon:

“Pika I (nga pika I deri ne piken 5), Pika II (nga 2 deri 3), Pika III “Procedurat që ndiqen nga SVQ” nga I.1 deri ne I.5, Pika (A) “Kontrolli i Klasifikimit tarifor te Mallrave” pika a.1 deri a.3, Pika (B) “Kontrolli mbi origjinën e mallrave” nga b.1 deri b.8, Pika (C), Pika (D) “Kontrolli dhe shqyrtimi i Vlerës Doganore” nga d.1 deri në d.12, Pika (E) “Konstatimi i Shkeljes Doganore” nga e.1 deri ne e.7, Pika III.1 “

Përzgjedhja ne Kanal te Kuq” nga 2.1 deri 2.10, Pika III 2.A “ Konstatimi i Shkeljes Doganore” nga a.1 deri a.7, Pika IV “Procedurat që ndiqen nga Skao” nga 1.1 deri 1.9, Pika IV .a “Kontrolli mbi klasifikimin tarifor” nga a.1 deri a.3, Pika IV .b “Kontrolli mbi origjinën” nga b.1 deri b.9, Pika IV (D) “Kontrolli dhe shqyrtimi i Vlerës Doganore” nga d.1 deri në d.13, Pika IV.2 “Rastet e Përzgjedhura dhe kanale te tjera” nga 2.1 deri në 2.4, Pika IV 3. “ Konstatimi i Shkeljes Doganore” nga 3.1 deri 3.6, Pika V “Bashkëpunimi ndërmjet strukturave”.

-Për problematika në lidhje me praktika doganore të cilat janë trajtuar me transaksion, ndërkohë që duhet të ishin trajtuar me ndërhyrje në vlerën e mallit dhe jo në përputhje me kërkesat e neneve 65 deri 70 të ligjit nr. 102/2014 datë 31.7.2014 “Kodi Doganor i Republikës së Shqipërisë” i ndryshuar, lidhur me vlerësimin doganor të mallrave , duke kryer vlerësime jo të bazuara sipas kriterëve të pikës 4.6 sipas metodës 6 bazuar në të Dhënat e Disponueshme në RSH, pikës 5 “Rregullimet”, pikës 6 “Dokumentacioni shoqërues që lidhet me vlerën doganore”, pikës 6/b/c/d, pikës 7 “Profilizimi i riskut në vlerësimin doganor” ,pikës 8 “Dokumentacioni Shtesë”, pikës 8/a/dh/ii/iii/vii/f , pikës 11 “Përdorimi i Databasit të Vlerësimit” bazuar në pikën 10/c që lidhen me rillogaritje të detyrimeve doganore në import si dhe jo në përmbushje të kërkesave të Udhëzimit nr. 3, datë 23.01.2018 “Për vlerësimin e mallrave për qëllime doganore”.

-Për problematika që lidhen me procedurat e përpunimit të deklaratave doganore me klasifikime tarifore të cilat nuk deklaruar janë në përputhje me rregullat e Nomenklaturës së Mallrave në RSH, mos rillogaritje të detyrimeve doganore të taksës kombëtare të ambalazhit plastik, mos pagesa të detyrimeve doganore të mallrave që duhet të paguajnë akcizë, për të cilat nuk është vepruar në përputhje me kërkesat e nenit 50 dhe Shtojcës 5 të Ligjit nr. 61/2012 “Për Akcizat në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, veprime jo në përputhje me përcaktimet e shkresës nr. 779 prot, të DPD datë 16.01.2013 “Mbi rishikimin e disa indikatorëve shtesë në vlerësimin doganor të mallrave me origjinë nga vendet jashtë BE”, për veprime të cilat nuk janë në përputhje me përcaktimet e ligjit nr. 9975, datë 28.07.2008 “Për Taksat Kombëtare”, i ndryshuar, me qëllim vjeljen dhe arkëtimin e taksës kombëtare TAM për artikujt që duhet të paguajnë këtë taksë kombëtare, përcaktimet e shpjegimeve të Udhëzimit nr. 2, datë 17.01.2014, pika 2.8.5 dhe ligjit nr. 92/2014 “Për Tatimin mbi Vlerën e Shtuar në Republikën e Shqipërisë”. përcaktimeve të ligjit nr. 112/2021 datë 25.11.20121 për disa shtesa ne ligjin nr. 9975 datë 28.07.2008 “Për taksat kombëtare”. i ndryshuar, nenin 14, 15, 16 17 dhe 18 te ligjit nr .9863 datë 28.01.2008 “Për Ushqimin” ndryshuar”

-Për problematika që lidhen veprime te cilat nuk janë kryer në përmbushje të Rregullores së Brendshme të Degëve Doganore “Mbi organizimin e funksionimit të Drejtorisë së Përgjithshme të Doganave” e dalë me Urdhërin nr. 146, datë 07.05.2018, të Ministrit të Financave neni 12 pika 10 ‘‘ kompetencat e doganierit’’ dhe Seksionit III, pika 1.5, shkronja “a”, si dhe seksionin IV, pika 1.9, shkronja “a”, të Udhëzimit nr. 5, datë 26.01.2018 të DPD “Mbi procedurat standarde të funksionimit të SVQ dhe SKAO”.

F. I (f). Niveli i masës “*Pezullim nga e drejta e ngritjes në detyrë, përfshirë rritjen në shkallën e pagës për një periudhë deri në dy vjet në shërbimin civil*” për punonjësin e kategorisë **C1** si më poshtë vijon.

1. Për **Z. A. N.** me detyrë përgjegjës i sektorit të pikës së hyrjes pranë D.D.Tirane.

-Për problematikat e konstatuara lidhur me auditimin e transiteve me destinacionit Degën e Doganës Tiranë pranë zyrës së pikës së hyrje-daljes (*afati kohor dhe mbyllja e transiteve*) dhe konkretisht: Nga ana e doganierëve të pikës së hyrjes nuk është bërë evidentimi dhe dokumentimi i vonesave të justifikuara/incidenteve dhe masat e marra për mbikëqyrjen doganore në kundërshtim me nenin 126 dhe 128 të Kodit Doganor si dhe në referim tabelës së afateve të transitit nxjerrë sipas Udhëzimit nr. 04 datë 30.09.2011 “Për caktimin e afatit brenda të cilit mallrat të vendosura në regjimin e transitit duhet të paraqiten në zyrën e destinacionit”. si dhe referuar Rregullores së Brendshme të Degëve Doganore “Mbi organizimin e funksionimit të Drejtorisë së Përgjithshme të Doganave” e dalë me Urdhërin nr. 146, datë 07.05.2018, të Ministrit të Financave neni 13 pika 3 ‘‘ kompetencat e përgjegjësit te sektorit te peshore pike/kontrolli’’

-Nuk janë dokumentuar shënimet për vonesën po ashtu edhe incidentet që mund të kenë ndodhur gjatë transportit në shënimet në kutinë 56 të deklaratës transit në sistemin Asiçuda dhe masat e marra për të lejuar mbikëqyrjen doganore të mallrave.

-Nga verifikimet e kryera në total për vitet 2022-2023 rezultojnë 13045 raste me tejkalim të afatit limit të vendosur nga dogana nisëse për mbërritjen në destinacionit të cilat rezultojnë të pa sanksionuara nga zyra e pikës së hyrjes dhe Dega Doganore Tiranë për të cilat duhet të ishte mbajtur proces verbal për llojin e shkeljes kundërvajtje administrative sipas nenit 251 pika 2/e të KD dhe sipas nenit 256 pika 1/b në shumën 20,000 lekë (çdo rast).

F II. Mbështetur në nenin 15, të Ligjit nr. 154/2014, datë 27.11.2014 “Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit”, nenin 37 të Ligjit nr. 7961, datë 12.07.1995 “Kodi i Punës në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar dhe nenit 12 ‘Masat Disiplinore’ te kontratës individuale të punës, i rekomandojmë Drejtorit të Përgjithshëm të Drejtorisë së Përgjithshme të Doganave dhe Kryetarit të Degës Doganore Tiranë në cilësinë e organit epror, që bazuar në performancën e secilit punonjës dhe të shkeljeve të konstatuara në Raportin Përfundimtar të Auditimit të KLSH-së, të fillojnë procedurat për dhënien e masave disiplinore si më poshtë vijon:

F. II (a). Niveli i masës “Vërejtje me paralajmërim për pushim nga puna” sipas nenit 12 pika 2 (b) të kontratës së punës individuale për punonjësit e mëposhtëm të kategorisë C3.

1. Për **Z. Y. V.** me detyrë doganier i sektorit të pikës së hyrjes pranë D.D.Tirane
2. Për **Z. E. D.** me detyrë doganier i sektorit të pikës së hyrjes pranë D.D.Tirane
3. Për **Z. G. H.** me detyrë doganier i sektorit të pikës së hyrjes pranë D.D.Tirane
4. Për **Z. E. M.** me detyrë doganier i sektorit të pikës së hyrjes pranë D.D.Tirane
5. Për **Z. E. B.** me detyrë doganier i sektorit të pikës së hyrjes pranë D.D.Tirane
6. Për **Z. E. M.** me detyrë ishdoganier i sektorit të pikës së hyrjes pranë D.D.Tirane
7. Për **Z. K. B.** me detyrë doganier i sektorit të pikës së hyrjes pranë D.D.Tirane

-Për problematikat e konstatuara lidhur me auditimin e transiteve me destinacionit Degën e Doganës Tiranë pranë zyrës së pikës së hyrje-daljes (afati kohor dhe mbyllja e transiteve) ku nuk është bërë evidentimi dhe dokumentimi i vonesave të justifikuara/incidenteve dhe masat e marra për mbikëqyrjen doganore në kundërshtim me nenin 126 dhe 128 të Kodit Doganor si dhe në referim tabelës së afateve të transitit nxjerrë sipas Udhëzimit nr. 04 datë 30.09.2011 “Për caktimin e afatit brenda të cilit mallrat të vendosura në regjimin e transitit duhet të paraqiten në zyrën e destinacionit” si dhe referuar Rregullores së Brendshme të Degëve Doganore “Mbi organizimin e funksionimit të Drejtorisë së Përgjithshme të Doganave” e dalë me Urdhrin nr. 146, datë 07.05.2018, të Ministrit të Financave neni 12 pika 11 ‘kompetencat e doganierit te peshore pike/kontrolli’.

-Nuk janë dokumentuar shënimet për vonesën po ashtu edhe incidentet që mund të kenë ndodhur gjatë transportit në shënimet në kutinë 56 të deklaratës transit në sistemin Asicuda dhe masat e marra për të lejuar mbikëqyrjen doganore të mallrave.

-Nga verifikimet e kryera në total për vitet 2022-2023 rezultojnë 13045 raste me tejkalim të afatit limit të vendosur nga dogana nisëse për mbërritjen në destinacionit të cilat rezultojnë të pa sanksionuara nga zyra e pikës së hyrjes dhe Dega Doganore Tiranë për të cilat duhet të ishte mbajtur proces verbal për llojin e shkeljes kundërvajtje administrative sipas nenit 251 pika 2/e të KD dhe sipas nenit 256 pika 1/b në shumën 20,000 lekë (çdo rast).

Shënim: Për nënpunësit e përmendur në Raportin Përfundimtar të Auditimit znj. L. B., E.H., z. G.P., J. P., E. Th., A. V., L.A., A. Sh., E. N, A. D., H. M., E. D., E. K., O. H., O. V., J. T., R. M., K. H., M. K., V. Y., E. P., E. K., E. K., E. Gj., K. B., R. M., S. L., K. H., A. Gj., L. D., K. E., J. M., S. T., E. Sh., , N. H., G. Y., O. Z., E. J., S. S., E.T., J. M., grupi auditues ka vlerësuar që nisur nga materialiteti i gjetjeve për numrin e praktikave të kryera dhe të përpunuara, niveli dhe frekuenca e shkeljeve të konstatuara, përgjegjësia e drejtpërdrejte ose indirekte në veprimet e kryera në mos përmbushje të detyrave funksionale sipas legjislacionit në fuqi, të mos

rekomandohet masë disiplinore. Në vijim nga strukturat eprorë përfshirë Drejtorinë e Përgjithshme të Doganave dhe Degën Doganore Tiranë si eprorë direkte dhe te drejtpërdrejtë të gjykohet dhe vlerësohet nisja ose jo e procedurave disiplinore për çdo rast ku janë të përfshirë dhe të përmendur këta persona në materialin e Raportit Përfundimtar të Auditimit pavarësisht faktit se për këta nëpunës zyrtarë nuk është rekomanduar masë e drejtpërdrejtë disiplinore në këtë material.

Përgjigja e subjektit:

Me shkresën nr. 1024/13 prot., datë 28.04.2025, me lëndë: "Për kompetencë", Kryetari i DD Tiranë i është drejtuar DPD-së për konstatimet e grupit të auditimit të KLSH-së në lidhje me pikën G.I (b)-H, pika Masa Disiplinore (bashkëngjitur konstatimet grupit të auditimit të KLSH-së).

Me vendimin nr. 1024 prot., datë 06.06.2025, kryetari i DD Tiranë ka vendosur mosmarrjen e masës disiplinore ndaj punonjësve S. P. dhe S. S. me detyrë doganierë mbikqyrje, kategoria C2, në DD Tiranë;

Me vendimin nr. 1024 prot., datë 14.07.2025 kryetari i DD Tiranë ka vendosur mosmarrjen e masës disiplinore ndaj punonjësve T. L., A. M. dhe S. C. me detyrë doganierë mbikqyrje, kategoria C2, në DD Tiranë.

Komenti i grupit të auditimit:

Për sa më sipër, pas shqyrtimit të situatave dhe problematikave të trajtuara në Raportin Përfundimtar të Auditimit të KLSH-së, për të cilët janë rekomanduar masa disiplinore për 5 punonjës, kryetari i DD Tiranë ka dalë me vendime për mosmarrje mase disiplinore.

Ndërsa, nga DPD nuk është paraqitur asnjë dokument justifikues në lidhje me zbatimin e këtij rekomandimi. Rekomandimi konsiderohet i pranuar dhe i zbatuar pjesërisht.

Ky rekomandim konsiderohet i pranuar dhe i zbatuar pjesërisht.

G. NJOFTIM I DEPARTAMENTIT TË ADMINISTRATËS PUBLIKE

Për punonjësit për të cilët janë rekomanduar masa disiplinore, Dega Doganore Tiranë në bashkëpunim me Drejtorinë e Përgjithshme të Doganave, pasi të zbatohet procedurat e nevojshme ligjore dhe nënligjore për klasifikimin e shkeljeve dhe fillimin e ecurisë disiplinore dhe pas përfundimit të afateve ankimore, ***të ndërmarrë veprimet si më poshtë:***

a. Të njoftojë Departamentin e Administratës Publike, për regjistrimin e masës disiplinore në Regjistrin Qendror të Përsoneelit, në zbatim të neneve 7 dhe 17, të ligjit nr. 152/2013 "Për nëpunësin civil", i ndryshuar.

b. Të njoftojë Komisionerin për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil, për mbikëqyrjen e ligjshmërisë në administrimin e shërbimit civil, në zbatim të nenit 11, të ligjit nr. 152/2013 "Për nëpunësin civil", i ndryshuar.

Komenti i grupit të auditimit:

Nga Drejtoria e Përgjithshme e Doganave dhe Dega Doganore Tiranë, grupit të auditimit të KLSH-së nuk i'u paraqit asnjë dokument, me të cilin të jetë kryer njoftimi i Departamentit të Administratës Publike, mbi masat disiplinore, të rekomanduara nga KLSH në auditimin e "Përputhshmërisë" së veprimtarisë së DD Tiranë, për periudhën 01.01.2022-31.12.2023.

Ky rekomandim konsiderohet i pranuar dhe i pa zbatuar.

KONKLUZIONI I AUDITIMIT

Nga verifikimi i dokumentacionit konstatohet se niveli i pranimeve dhe zbatimit të rekomandimeve të lëna nga KLSH me shkresën nr. 1024/19 prot., datë 07.07.2025, është si më poshtë: Ndërsa nga Drejtoria e Përgjithshme e Doganave janë realizuar këto dy raportime. Nga 32 rekomandime të lëna për zbatim, janë pranuar 31 rekomandime ose 96.87% e tyre, nuk është pranuar vetëm 1 rekomandim.

Nga 31 rekomandimet e pranuar, janë zbatuar plotësisht 4 rekomandime ose 12.9% e tyre; janë në proces zbatimi 8 rekomandime ose 25.8% e tyre, janë zbatuar pjesërisht 5 rekomandime ose 16.13% e tyre, si dhe rezultojnë pa zbatuar 14 rekomandime ose 45.16 % e tyre.

IV. GJETJE DHE REKOMANDIME.

Për sa më sipër ri kërkojmë që, Drejtorisë Doganore Tiranë të marrë të gjitha masat e nevojshme me qëllim zbatimin e të gjitha rekomandimeve që rezultojnë të pazbatuar dhe pjesërisht zbatuar, si dhe përshejtimin e zbatimit të rekomandimeve, të cilat rezultojnë në proces zbatimi, brenda 6-mujorit të parë të vitit 2025.

PROPOZIME PËR NDRYSHIME APO PËRMIRËSIME NË LEGJISLACIONIN NË FUQI

1.1 Rekomandimi: Drejtoria e Përgjithshme e Doganave nëpërmjet Sektorit të Drejtorisë së Kontrollit të Akcizës dhe Pas Zhdoganimit në Departamentin e Analizave të Riskut dhe Aposteriorit, në vijim të ndërtojë Programe Kontrolli Specifike Verifikuese për deklarimet e praktikave doganore që janë përpunuar sipas tabelës trajtuar për këtë çështje bashkëlidhur anekseve të Raportit Përfundimtar të Auditimit të mesipërme, si dhe të tjera praktika me qëllim verifikimin e vërtetësisë së pagesës detyrimeve doganore për mallrat e trajtuar sa më sipër, në funksion të verifikimit të mallit “Tub Plastik një përdorim” dhe “Shiringa plastike një përdorim”, me destinacion përfundimtar Mbetje në Njësi Spitalore apo Shitje në Farmaci Publike ose Depo Farmaceutike.

1.2 Rekomandimi: Drejtoria e Përgjithshme e Doganave në përfundim të procedurave të kontrollit të gjykojë problematikën e trajtuar sa më sipër duke bashkërenduar menjëherë me Ministrinë e Financave me qëllim kryerjen e ndryshimeve ligjore për përfshirjen e artikujve “Tub Plastik një përdorim për përdorim venoz” dhe “Shiringa plastike një përdorim ne trajte përdorimi përfundimtar ambalazh” me destinacion përfundimtar ambalazhimit e solucioneve që shiten në Farmaci Publike ose Depo Farmaceutike në listën e artikujve plastike ambalazhues një përdorimshëm që paguajnë taksë kombëtare TAM në nivelin 35 lek/kg dhe përfshirjen e këtyre mallrave për pagesë të taksës së ambalazhit në anekset e ligjit nr. 9975, datë 28.07.2008 “Për Taksat Kombëtare” Në përfundim të procedurës nga Drejtoria e Përgjithshme e Doganave të informohet Institucioni i Kontrollit të Lartë të Shtetit mbi rezultatet e kontrollit dhe mbi vërtetësinë e veprimeve të kryera për propozim për pagesë takse të ambalazhit plastik për praktika të gjeneruar të trajtuara në anekset bashkëlidhur këtij Raportit Përfundimtar të Auditimit.

MASA ORGANIZATIVE

1.1 Rekomandimi: Nga Drejtoria për Mbrojtjen e Pronësisë Intelektuale, pranë Drejtorisë së Përgjithshme të Doganave të merren masa që të ketë vendimmarrje për të gjitha rastet e mallrave të sekuestruara pas kryerjes së verifikimeve për cenueshmerinë e pronësisë intelektuale.

1.2 Rekomandimi: Nga strukturat përkatëse verifikuese (*Spektori i Verifikimit Fizik, Antikontrabanda etj.*) të merren masa që krahas procesverbalit të bllokimit, të mbahet dhe procesverbal sekuestrimi për mallrat, në mënyrë që Spektori Juridik të vijojë me vendimmarrjet sipas rastit.

3.1 Rekomandimi: Nga Zyra e Magazinimit të Përkohshëm për mallrat e vendosura në magazinim të përkohshëm të evidentuara se u ka kaluar afati i qëndrimit prej 90 ditë, të merren të gjitha masat e nevojshme për rregullim situatë konform parashikimeve të legjislacionit doganor. Gjithashtu të merren masa që kontrollet e ushtruara ndaj subjekteve të autorizuara të shoqërohen me dokumentacionin e plotë dhe të nevojshëm duke identifikuar dhe verifikuar saktë artikujt, vlerën, sasinë, cilësinë e tyre si dhe kohëzgjatjen e qëndrimit të tyre në këto ambiente.

4.1 Rekomandimi: Kryetari i Degës Doganore Tiranë, Spektori i Mbikëqyrjes së regjimeve ekonomike doganore, të marrin masa të menjëhershme për verifikimin e koeficientëve të shfrytëzimit për të gjithë operatorët ekonomikë që kanë përfituar autorizime të tipit RPA, të cilët rezultojnë me mbyllje të regjimit të RPA me procedurë IM9 “*Asgjësim i produkteve të dala nga proceset e përpunimit të mallrave nën regjim dhe humbje dhe firo të dala gjatë procesit të përpunimit të mallrave të vendosura nën regjim*” me qëllim

eliminimin e pasojave dhe efekteve negative që mund të lindin në të ardhurat doganore që raportohen në Buxhetin e Shtetit.

5.1 Rekomandimi: Drejtoria/Spektori Juridik në Degën e Doganës Tiranë të marrë masa për hartimin dhe miratimin brenda afateve procedurale të parashikuara të vendimeve të Degës Doganore dhe dokumentimin e gjurmëve të auditimit për pengesat dhe arsyet e vonesave nga momenti i mbajtjes së procesverbaleve të konstatimit të shkeljeve administrative.

6.1 Rekomandimi: Dega Doganore të marrë masa për zbatimin e parashikimeve të Kodit Doganor mbi klasifikimin e shkeljes, aplikimin e penaltetëve dhe saktësimin e parregullsive të evidentuara në vlerën 40,000 lekë.

7.1 Rekomandimi: Drejtoria e Burimeve Njerëzore në bashkëpunim me Drejtorinë e Përgjithshme të Doganave të marrin masat për plotësimin e pozicioneve vakante me doganierë akcize sipas kërkesave specifike të pozicionit.

10.1 Rekomandimi: Zyra e Akcizës të marrë masa për intensifikimin e kontrolleve fizike me qëllim rritjen e përqindjes së mbulimit me kontroll për të minimizuar riskun e mos mbikëqyrjes dhe monitorimit. Gjithashtu të realizojë përzgjedhjen e operatorëve për kontroll bazuar në një analizë risku periodike të dokumentuar, si dhe dokumentojë kontrollet dhe rezultatet e tij, dhe më tej të hartojë raportet e kontrollit, në përputhje me përcaktimet e manualit të metodologjisë së kontrollit të akcizës.

11.1 Rekomandimi: Drejtoria e Burimeve Njerëzore dhe Drejtori i Përgjithshëm i Doganave të marrin masat për plotësimin e pozicionit vakant me specialist borxhi sipas kërkesave specifike të pozicionit.

12.1 Rekomandimi: Dega Doganore Tiranë (Zyra e Borxhit dhe Spektori Juridik), të marrë masa për zbatimin me rigorozitet të të gjitha fazave për rikupërimin e borxhit doganor të përcaktuara në Udhëzimin nr. 15, datë 03.12.2018, për të gjithë operatorët e evidentuar në anekse dhe ndjekjen e procedurave në afat me qëllim uljen e nivelit të borxhit doganor me vlerë 18,620 milionë lekë.

12.2 Rekomandimi: Zyra e Borxhit të marrë masa për realizimin në afat të procedurave të evidentimit dhe rikupërimin të detyrimeve të papaguara doganore dhe të akcizës, si dhe të njoftojë strukturën përkatëse tatimore DPT/DRT sipas “Marrëveshjes së Bashkëpunimit midis DPD dhe DPT” nr. 14355, datë 19.06.2018, mbi detyrimet shtesë tatimore të lindura si pasojë e detyrimeve shtesë të akcizës për operatorin “B” sha.

13.1 Rekomandimi: Zyra e Mbikëqyrjes Doganore për mbikëqyrjen e Regjimit të Lejimit të Përkohshëm (RLP) të mbajë regjistra për regjistrimin e të gjithë operatorëve dhe operacioneve për të gjitha llojet e mjeteve dhe mallrave që lëvizin në këtë regjim doganor dhe të kryejë kontrolle fizike gjatë kësaj periudhe për të bërë identifikimin e mallrave të vendosura nën atë regjim, statusin e tyre doganor dhe lëvizjet e mallrave brenda afateve autorizuese.

C. MASA TË ARDHURA TË MUNGUARA NË BUXHETIN E SHËTIT

2.1 Rekomandimi: Dega Doganore Tiranë në bashkëpunim me Drejtorinë e Përgjithshme të Doganave të marrë masa të menjëhershme me qëllim fillimin e procedurave doganore sipas legjislacionit në fuqi për subjektet që kanë rezultuar se kanë deklaruar vlera të ulta të mallrave dhe shpenzimeve të transportit të deklaruar sipas nevojave ekonomike hedhje malli në qarkullim të lirë me procedurë 4051 për mallra të hyra

më parë në regjime doganore të tipit RPA të natyrës “*Tallash druri*” dhe “*copa mbetje druri*” në kapitullin *44* “*mbetje letre*” dhe “*mbetje kartoni*” te ne kapitullin 48 dhe “*mbetje plastike*” në kapitullin 39 të NM në RSH, dhe për mallra të konstatuar në mangësi të pajustificuara në bilancin material të autorizimit të përpunimit RPA të natyrës alkool puro me efekte në të ardhurat doganore në Buxhetin e Shtetit në shumën totale **31,400,097 lekë**.

3.1 Rekomandimi: Dega Doganore Tiranë në bashkëpunim me Drejtorinë e Përgjithshme të Doganave, të marrë masa të menjëhershme me qëllim shqyrtimin, vendimmarrjen, kontabilizimin dhe më pas arkëtimin e detyrimeve doganore të munguara të rillojatur në shumën 1,420,575 lekë, si dhe të kërkojë procedurë eksporti të detyrueshëm ose dhënie destinacioni malli për përfitim statusi shqiptar në një rast vendimi administrativ që lidhen me konstatimet e trajtuara për shkeljen e afatit të regjimit RLP për mallra të natyrës autovetura të nxjerra për vitin 2022.

4.1 Rekomandimi: Dega Doganore Tiranë, të marrë masa për shqyrtimin e rasteve të evidentuara dhe ndjekjen e të gjitha procedurave të nevojshme administrative me qëllim arkëtimin e detyrimeve doganore në vlerën 1,710,952 lekë.

5.1 Rekomandimi: Dega Doganore Tiranë në bashkëpunim me Drejtorinë e Përgjithshme të Doganave, të marrë masa që për të gjitha rastet e transiteve të evidentuara me diferencë në peshë në aktin e inspektimit nga zyra doganore nisëse, të kryhen verifikimet përkatëse, të ndiqen procedurat e parashikuara në manual, të mbahen procesverbale apo dokumentacion për të faktuar nëse diferencat sjellin ose jo pasoja financiare.

5.2 Rekomandimi: Zyra Operacionale dhe Dega Doganore Tiranë, në cilësinë e strukturës kompetente të ndërmarrë të gjitha masat e nevojshme dhe vendimet përkatëse në përputhje me kërkesat ligjore dhe procedurale, më qëllim arkëtimin e të ardhurave të munguara në buxhetin e shtetit të evidentuara në vlerën 440,000 lekë në formën e gjobës.

6.1 Rekomandimi: Zyra e mbikëqyrjes doganore të regjimit të magazinimit doganor në zbatim të procedurave funksionale të kryejë inventarizimin e dosjeve, në dosje të jepen të dhëna të qarta të gjurmës së kontroleve të ushtruara, administrimin në to, jo vetëm të dokumentacionit të sjellë nga subjektet, por edhe dokumentacionin vërtetues të të gjithë punës së kryer nga doganierët mbikëqyrës të regjimit të magazinimit doganor, si dhe të kryejnë kontrole të paktën një herë në tre muaj. Të kryejë mbikëqyrjen e Autorizimeve për përdorimin e Regjimit të Magazinimit Doganor për të parë nëse përmbushen detyrimet që rrjedhin nga ky autorizim.

6.2 Rekomandim: Dega Doganore Tiranë në bashkëpunim me Drejtorinë e Përgjithshme të Doganave, të ndërmarrë të gjitha masat e nevojshme më qëllim arkëtimin e të ardhurave të munguara në buxhetin e shtetit në shumën 100,000 lekë.

D. MASA PËR ELEMIMIN E EFEKTEVE NEGATIVE TË KONSTATUARA NË ADMINISTRIMIN E TË ARDHURAVE DOGANORE

1.2 Rekomandimi: Drejtoria e Përgjithshme të Doganave nëpërmjet strukturave të specializuara kontrolluese dhe konstatuese pranë DPD-së (Drejtoria e Kontrollit Pas Zhdoganimit, Drejtoria e Riskut dhe Monitorimit, Drejtoria e Tarifës dhe Origjinës, si dhe Drejtoria e Laboratorit Kimik), të ndërtojë menjëherë Programe Kontrolli për artikujt “qumësht UHT me 3.6 yndyrë dhe qumësht për kafe” “Doreza Kirurgjikale” dhe “Hudhër e ftohte”, për rillojartje detyrime doganore për mallin “qumësht i kondensuar i mbushur me ëmbëlsirë” për pagesën e taksës QPL dhe për rillojartje detyrime doganore për mallin “Spraj (vajra te lehte), Pramer, dhe Solvent” dhe “Vaj

Lubrifikant”, për pagesën e detyrimeve doganore dhe të akcizës dhe të kryejë menjëherë veprime konkrete verifikuese doganore pranë selive të ushtrimit të aktivitetit të kompanive dhe të regjistrave të kontabilitetit financiar të subjekteve me qëllim ndjekjen e kontabilizimit të të ardhurave doganore të munguara të llogaritura në **shumën 173,484,666 lekë** (nga të cilat shuma prej 83,272,639 lekë për vitin 2023 dhe shuma prej 90,212,026 për vitin 2022), si dhe llogaritjen e gjobave si pasojë e keq deklarimit dhe shmangies së pagesës së detyrimeve doganore nga deklaruesit e drejtpërdrejtë apo të tërthortë agjencitë doganore respektive bazuar në kërkesat e nenit 250.1/a; 250.4; 256.1/a dhe 256.1/b të KD.

E. MASA DISIPLINORE

E I. Mbështetur në nenin 15, të Ligjit nr. 154/2014, datë 27.11.2014 “Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit” dhe në nenin 58 dhe 59, të ligjit nr. 152/2013 “Për nëpunësin civil” të ndryshuar, si dhe në VKM nr. 115, datë 05.03.2014 “Për përcaktimin e procedurës disiplinore dhe të rregullave për krijimin, përbërjen e vendimmarrjen në komisionin disiplinor në shërbimin civil”, i kërkojmë Drejtorit të Përgjithshëm të Doganave dhe Kryetarit të Degës Doganore përkatëse, të fillojnë procedurat për dhënien e masës disiplinore:

E. I (b). Niveli i masës “*Mbajtja në masën e 1/3 të pagës së plotë për një periudhë deri në 6 muaj*” për punonjësit kategorisë **C1** dhe **C2** (përgjegjës sektori ose doganier vlerësimi të emëruar ose komanduar) si më poshtë vijon:

1. Për **Znj. M. H.**, me detyrë doganier i klasifikim/vlerësim në sektorin SVQ
2. Për **Znj. T. Sh.**, me detyrë doganier i klasifikim/vlerësim në sektorin SKAO dhe SVQ
3. Për **Znj. E. Xh.**, me detyrë doganier i klasifikim/vlerësim në sektorin SKAO dhe SVQ
4. Për **Z. R. M.**, me detyrë doganier i klasifikim/vlerësim në sektorin SVQ.
5. Për **Z. R. B.**, me detyrë doganier i klasifikim/vlerësim në sektorin SVQ.
6. Për **Znj. L. D.**, me detyrë doganier i klasifikim/vlerësim në sektorin SVQ
7. Për **Znj. K. Xh.**, me detyrë doganier i klasifikim/vlerësim në sektorin SVQ
8. Për **Z. E. M.**, me detyrë ish doganier i klasifikim/vlerësim në sektorin SVQ
9. Për **Znj. A. B.**, me detyrë doganiere i klasifikim/vlerësim në sektorin SVQ
10. Për **Z. E. H.**, me detyrë doganier i klasifikim/vlerësim në sektorin SVQ.
11. Për **Z. P. R.**, me detyrë doganier i klasifikim/vlerësim në sektorin SKAO dhe SVQ
12. Për **Znj. G. G.**, me detyrë doganiere e klasifikim/vlerësim në sektorin SVQ
13. Për **Z. A. H.**, me detyrë doganiere i klasifikim/vlerësim në sektorin SVQ
14. Për **Z. E. N.**, me detyrë doganier i klasifikim/vlerësim në sektorin SKAO dhe SVQ
15. Për **Znj. B. K.**, me detyrë doganier i klasifikim/vlerësim në sektorin SKAO dhe SVQ
16. Për **Z. J. S.**, me detyrë doganier i klasifikim/vlerësim në sektorin SKAO dhe SVQ
17. Për **Z. I. R.**, me detyrë ish përgjegjës i sektorit të kontrollit dokumentar pranë SVQ
18. Për **Z. J. H.**, me detyrë ish përgjegjës i sektorit të kontrollit dokumentar pranë SVQ
19. Për **Z. B. D.**, me detyrë ish doganier i klasifikim/vlerësim në sektorin SKAO dhe SVQ
20. Për **Znj. E. G.**, me detyrë doganier i klasifikim/vlerësim në sektorin SVQ

- Për mospërbushje të kërkesave të legjisllacionit doganor gjatë ushtrimit të detyrave funksionale dhe kryerjes së veprimeve që cenojnë figurën e nëpunësit civil, institucionin apo shërbimin civil në tërësi të përcaktuara në Udhëzimin nr. 5 datë 26.01.2018 sipas shkresës nr 2194 Prot DPD datë 26.01.2018 “*Mbi procedurat standarde të Vlerësimit në Qendror dhe Sektorit të Kontrollit Aposterior Operativ*”, nxjerrë nga Drejtori i Përgjithshëm i Doganave të cilat bien në kundërshtim me përcaktimet dhe shpjegimet e këtij Udhëzimi sa më poshtë vijon:

“Pika I (nga pika 1 deri në pikën 5), Pika II (nga 2 deri 3), Pika III “Procedurat që ndiqen nga SVQ” nga 1.1 deri në 1.5, Pika (A) “Kontrolli i Klasifikimit tarifor të Mallrave” pika a.1 deri a.3, Pika (B) “Kontrolli mbi origjinën e mallrave” nga b.1 deri b.8, Pika (C), Pika (D) “Kontrolli dhe shqyrtimi i Vlerës Doganore” nga d.1 deri në d.12, Pika (E) “Konstatimi i Shkeljes Doganore” nga e.1 deri në e.7, Pika III.1 “ Përzgjedhja në Kanal të Kuq” nga 2.1 deri 2.10, Pika III 2.A “Konstatimi i Shkeljes Doganore” nga a.1 deri a.7, Pika IV “Procedurat që ndiqen nga SKAO” nga 1.1 deri 1.9, Pika IV.a “Kontrolli mbi klasifikimin tarifor” nga a.1 deri a.3, Pika IV .b “Kontrolli mbi origjinën” nga b.1 deri b.9, Pika IV (D) “Kontrolli dhe shqyrtimi i Vlerës Doganore” nga d.1 deri në d.13, Pika IV.2 “Rastet e Përzgjedhura dhe kanale të tjera” nga 2.1 deri në 2.4, Pika IV 3. “Konstatimi i Shkeljes Doganore” nga 3.1 deri 3.6, Pika V “Bashkëpunimi ndërmjet strukturave”.

-Për problematika në lidhje me praktika doganore të cilat janë trajtuar me transaksion, ndërkohë që duhet të ishin trajtuar me ndërhyrje në vlerën e mallit dhe jo në përputhje me kërkesat e neneve 65 deri 70 të ligjit nr. 102/2014 datë 31.7.2014 *“Kodi Doganor i Republikës së Shqipërisë”* i ndryshuar, lidhur me vlerësimin doganor të mallrave , duke kryer vlerësime jo të bazuara sipas kritereve të pikës 4.6 sipas metodës 6 bazuar në të Dhënat e Disponueshme në RSH, pikës 5 *“Rregullimet”*, pikës 6 *“Dokumentacioni shoqërues që lidhet me vlerën doganore”*, pikës 6/b/c/d, pikës 7 *“Profilizimi i riskut në vlerësimin doganor”* ,pikës 8 *“Dokumentacioni Shtesë”*, pikës 8/a/dh/ii/iii/vii/f , pikës 11 *“Përdorimi i Data basit të Vlerësimit”* bazuar në pikën 10/c që lidhen me rilogaritje të detyrimeve doganore në import si dhe jo në përmbushje të kërkesave të Udhëzimit nr. 3, datë 23.01.2018 *“Për vlerësimin e mallrave për qëllime doganore”*

-Për problematika që lidhen me procedurat e përpunimit të deklaratave doganore me klasifikime tarifore të cilat nuk deklaruar janë në përputhje me rregullat e Nomenklaturës së Mallrave në RSH, mos rilogaritje të detyrimeve doganore të taksës kombëtare të ambalazhit plastik, mos pagesa të detyrimeve doganore të mallrave që duhet të paguajnë akcizë, për të cilat nuk është vepruar në përputhje me kërkesat e nenit 50 dhe Shtojcës 5 të Ligjit nr. 61/2012 *“Për Akcizat në Republikën e Shqipërisë”*, i ndryshuar, veprime jo në përputhje me përcaktimet e shkresës nr. 779 prot, të DPD datë 16.01.2013 *“Mbi rishikimin e disa indikatorëve shtesë në vlerësimin doganor të mallrave me origjinë nga vendet jashtë BE”*, për veprime të cilat nuk janë në përputhje me përcaktimet e ligjit nr. 9975, datë 28.07.2008 *“Për Taksat Kombëtare”*, i ndryshuar, me qëllim vjeljen dhe arkëtimin e taksës kombëtare TAM për artikujt që duhet të paguajnë këtë taksë kombëtare, përcaktimet e shpjegimeve të Udhëzimit nr. 2, datë 17.01.2014, pika 2.8.5 dhe ligjit nr. 92/2014 *“Për Tatimin mbi Vlerën e Shtuar në Republikën e Shqipërisë”*. përcaktimeve të ligjit nr. 112/2021 datë 25.11.2021 për disa shtesa ne ligjin nr. 9975 datë 28.07.2008 *“Për taksat kombëtare”*. i ndryshuar, nenin 14, 15, 16 17 dhe 18 te ligjit nr .9863 datë 28.01.2008 *“Për Ushqimin”* ndryshuar

-Për problematika që lidhen veprime te cilat nuk janë kryer në përmbushje të Rregullores së Brendshme të Degëve Doganore *“Mbi organizimin e funksionimit të Drejtorisë së Përgjithshme të Doganave”* e dalë me Urdhrin nr. 146, datë 07.05.2018, të Ministrit të Financave neni 12 pika 10 *“kompetencat e doganierit”* dhe nenit 12 pika 5 *“kompetencat e përgjegjës të zyrës operacionale të kontrollit doganor”* dhe Seksionit III, pika 1.5, shkronja “a”, si dhe seksionin IV, pika 1.9, shkronja “a”, të Udhëzimit nr. 5, datë 26.01.2018 të DPD *“Mbi procedurat standarde të funksionimit të SVQ dhe SKAO”*.

E. I (c). Niveli i masës ***“Mbajtja në masën e 1/3 të pagës së plotë për një periudhë deri në 6 muaj”*** për punonjësit kategorisë **C2** (te emëruar ose komanduar) si më poshtë vijon:

1. Për **Z.A. K.**, me detyrë doganier i sektorit të kontrollit operacional pranë D.D.Tiranë.

2. Për **Z. B. C.**, me detyrë doganier i sektorit të kontrollit operacional pranë D.D.Tiranë.

3. Për **Z. U. M.**, me detyrë doganier i sektorit të kontrollit operacional pranë D.D.Tiranë.

-Për mospërbushje të kërkesave të legjislacionit doganor gjatë ushtrimit të detyrave funksionale dhe kryerjes së veprimeve që cenojnë figurën e nëpunësit civil, institucionin apo shërbimin civil në tërësi të përcaktuara në Udhëzimin nr. 5 datë 26.01.2018 sipas shkresës nr. 2194 Prot DPD datë 26.01.2018 “*Mbi procedurat standarde të Vlerësimit në Qendror dhe Sektorit të Kontrollit Aposterior Operativ*”, nxjerrë nga Drejtori i Përgjithshëm i Doganave të cilat bien në kundërshtim me përcaktimet dhe shpjegimet e këtij Udhëzimi sa më poshtë vijon:

“Pika I (nga pika 1 deri në piken 5), Pika II (nga 2 deri 3), Pika III “*Procedurat që ndiqen nga SVQ*” nga 1.1 deri në 1.5, Pika (A) “*Kontrolli i Klasifikimit tarifor te Mallrave*” pika a.1 deri a.3, Pika (B) “*Kontrolli mbi origjinën e mallrave*” nga b.1 deri b.8, Pika (C), Pika (E) “*Konstatimi i Shkeljes Doganore*” nga e.1 deri në e.7, Pika III.1 “*Përzgjedhja në Kanal të Kuq*” nga 2.1 deri 2.10, Pika III 2.A “*Konstatimi i Shkeljes Doganore*” nga a.1 deri a.7, Pika IV .a “*Kontrolli mbi klasifikimin tarifor*” nga a.1 deri a.3, Pika IV .b “*Kontrolli mbi origjinën*” nga b.1 deri b.9, Pika IV (D) “*Kontrolli dhe shqyrtimi i Vlerës Doganore*” nga d.1 deri në d.13, Pika IV.2 “*Rastet e Përzgjedhura dhe kanale të tjera*” nga 2.1 deri në 2.4, Pika IV 3. “*Konstatimi i Shkeljes Doganore*” nga 1.1 deri 3.6, Pika V “*Bashkëpunimi ndërmjet strukturave*”.

-Për problematika që lidhen me mos kryerjen e plotë të procedurave të kontrollit doganor të përpunimit të deklaratave doganore të kanalizuar në kanal te kuq (risk lartë) të cilat rezultojnë me klasifikime tarifore jo në përputhje me rregullat e Nomenklaturës së Mallrave në RSH, duke shkaktuar pasoja në mos rillogaritje të detyrimeve doganore të taksës kombëtare të ambalazhit plastik, mos pagesa të detyrimeve doganore të mallrave që duhet të paguajnë akcizë, për të cilat nuk është vepruar në përputhje me kërkesat e nenit 50 dhe Shtojcës 5 të Ligjit nr. 61/2012 “*Për Akcizat në Republikën e Shqipërisë*”, i ndryshuar, për veprime të cilat nuk janë në përputhje me përcaktimet e ligjit nr. 9975, datë 28.07.2008 “*Për Taksat Kombëtare*”, i ndryshuar, me qëllim vjeljen dhe arkëtimin e taksës kombëtare TAM për artikujt që duhet të paguajnë këtë taksë kombëtare, përcaktimet e shpjegimeve të Udhëzimit nr. 2, datë 17.01.2014, pika 2.8.5 dhe ligjit nr. 92/2014 “*Për Tatimin mbi Vlerën e Shtuar në Republikën e Shqipërisë*”. përcaktimeve të ligjit nr. 112/2021 datë 25.11.2021 për disa shtesa ne ligjin nr. 9975 datë 28.07.2008 “*për taksat kombëtare*”. i ndryshuar, nenin 14, 15, 16 17 dhe 18 te ligjit nr. 9863 datë 28.01.2008 “*Për Ushqimin*” ndryshuar”.

-Për problematika që lidhen veprime te cilat nuk janë kryer në përmbushje të Rregullores së Brendshme të Degëve Doganore “*Mbi organizimin e funksionimit të Drejtorisë së Përgjithshme të Doganave*” e dalë me Urdhërin nr. 146, datë 07.05.2018, të Ministrit të Financave neni 12 pika 10 “*kompetencat e doganierit*” dhe Seksionit III, pika 1.5, shkronja “a”, si dhe seksionin IV, pika 1.9, shkronja “a”, të Udhëzimit nr. 5, datë 26.01.2018 të DPD “*Mbi procedurat standarde të funksionimit të SVQ dhe SKAO*”.

E. I (d). Niveli i masës “*Pezullim nga e drejta e ngritjes në detyrë, përfshirë rritjen në shkallën e pagës për një periudhë deri në dy vjet në shërbimin civil*” për punonjësit kategorisë C1 dhe C2 (te emëruar ose komanduar) si më poshtë vijon:

1. Për **Z. J. H.**, me detyrë doganier i sektorit të kontrollit operacional pranë D.D.Tirane.

2. Për **Z. G. I.**, me detyrë doganier i sektorit të kontrollit operacional pranë D.D.Tirane.

3. Për **Z. E. C.** me detyrë ish përgjegjës i sektorit të kontrollit operacional pranë D.D.Tiranë.

-Për mos përmbushje të kërkesave të legjislacionit doganor gjatë ushtrimit të detyrave funksionale dhe kryerjes së veprimeve që cenojnë figurën e nëpunësit civil, institucionin apo shërbimin civil në tërësi të përcaktuara në Udhëzimin nr. 5 datë 26.01.2018 sipas shkresës nr 2194 Prot DPD datë

26.01.2018 “Mbi procedurat standarde të Vlerësimit në Qendror dhe Sektorit të Kontrollit Aposterior Operativ”, nxjerrë nga Drejtori i Përgjithshëm i Doganave të cilat bien në kundërshtim me përcaktimet dhe shpjegimet e këtij Udhëzimi sa më poshtë vijon:

“Pika I (nga pika 1 deri ne piken 5), Pika II (nga 2 deri 3), Pika III “Procedurat që ndiqen nga SVQ” nga 1.1 deri ne 1.5, Pika (A) “Kontrolli i Klasifikimit tarifor te Mallrave” pika a.1 deri a.3, Pika (B) “Kontrolli mbi origjinën e mallrave” nga b.1 deri b.8, Pika(C), Pika (E) “Konstatimi i Shkeljes Doganore” nga e.1 deri ne e.7, Pika III.1 “ Përzgjedhja ne Kanal te Kuq” nga 2.1 deri 2.10, Pika III 2.A “ Konstatimi i Shkeljes Doganore” nga a.1 deri a.7, Pika IV .a “Kontrolli mbi klasifikimin tarifor” nga a.1 deri a.3, Pika IV .b “Kontrolli mbi origjinën” nga b.1 deri b.9, Pika IV (D) “Kontrolli dhe shqyrtimi i Vlerës Doganore” nga d.1 deri në d.13, Pika IV.2 “Rastet e Përzgjedhura dhe kanale te tjera” nga 2.1 deri në 2.4, Pika IV 3. “ Konstatimi i Shkeljes Doganore” nga 3.1 deri 3.6, Pika V “Bashkëpunimi ndërmjet strukturave”.

-Për problematika të evidentuara në praktikat doganore ku u konstatua se pas kryerjes se procedurës se kontrollit fizik nga personeli përpunues doganor për praktikat doganore në detyrim dhe juridiksion kontrolli ne aktin e kontrollit është shënuar se deklarimi përputhej me gjendjen fizike te mallrave ndërkohe që pas procedurave të ri kontrollit është konstatuar mall i padeklaruar me diferenca ne sasi, natyre dhe vlere për mjetet e çliruara nga zona doganore Tirane të rikthyera më pas për procedura ri kontrolli nga struktura e Drejtorisë se Antikontrabandes pranë Departamentit Operativ Hetimor. Pasi janë kryer procedurat e ri kontrollit nga struktura e Drejtorisë se Antikontrabandes pranë Departamentit Operativ Hetimor kane rezultuar diferenca te mallrave te ndryshëm ne sasi me efekte dhe pasoja ne detyrime doganore për të cilat më pas Dega Doganore Tiranë ka nxjerrë vendime administrative me efekte negative ne Buxhetin e Shtetit të cilat janë kontabilizuar në formën e borxhit doganor. Ne përfundim se konstatohet se nga personeli përpunues doganor i kontrollit fizik pranë Degës Doganore Tirane nuk janë kryer procedura te rregullta kontrolli gjate kryerjes se detyrave funksionale me pasoje lindjen e efekteve negative ne te ardhurat e Buxhetit te Shtetit.

-Për problematika që lidhen me mos kryerjen e plotë të procedurave të kontrollit doganor të përpunimit të deklaratave doganore të kanalizuar në kanal te kuq (risk lartë) të cilat rezultojnë me klasifikime tarifore jo në përputhje me rregullat e Nomenklaturës së Mallrave në RSH, duke shkaktuar pasoja në mos rillogaritje të detyrimeve doganore të taksës kombëtare të ambalazhit plastik, mos pagesa të detyrimeve doganore të mallrave që duhet të paguajnë akcizë, për të cilat nuk është vepruar në përputhje me kërkesat e nenit 50 dhe Shtojcës 5 të Ligjit nr. 61/2012 “Për Akcizat në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, për veprime të cilat nuk janë në përputhje me përcaktimet e ligjit nr. 9975, datë 28.07.2008 “Për Taksat Kombëtare”, i ndryshuar, me qëllim vjeljen dhe arkëtimin e taksës kombëtare TAM për artikujt që duhet të paguajnë këtë taksë kombëtare, përcaktimet e shpjegimeve të Udhëzimit nr. 2, datë 17.01.2014, pika 2.8.5 dhe ligjit nr. 92/2014 “Për Tatimin mbi Vlerën e Shtuar në Republikën e Shqipërisë”. përcaktimeve të ligjit nr. 112/2021 datë 25.11.2021 për disa shtesa ne ligjin nr. 9975 datë 28.07.2008 “Për taksat kombëtare”.i ndryshuar, nenin 14, 15, 16 17 dhe 18 te ligjit nr. 9863 datë 28.01.2008 “Për Ushqimin” ndryshuar”

-Për problematika që lidhen me veprime te cilat nuk janë kryer në përmbushje të Rregullores së Brendshme të Degëve Doganore “Mbi organizimin e funksionimit të Drejtorisë së Përgjithshme të Doganave “e dalë me Urdhërin nr. 146, datë 07.05.2018, të Ministrit të Financave neni 12 pika 10 “kompetencat e doganierit’ dhe neni 12 pika 5 ‘kompetencat e përgjegjës të zyrës operacionale te kontrollit doganor’” dhe Seksionit III, pika 1.5, shkronja “a”, si dhe seksionin IV, pika 1.9, shkronja “a”, të Udhëzimit nr. 5, datë 26.01.2018 të DPD “Mbi procedurat standarde të funksionimit të SVQ dhe SKAO”.

E. I (e). Niveli i masës **“Vërejtje”** për punonjësit e kategorisë **C2** (te emëruar ose komanduar) si më poshtë vijon:

1. Për **Znj. R. K.**, me detyrë doganiere i klasifikim/vlerësim në sektorin SVQ
2. Për **Znj. E. B.**, me detyrë doganiere i klasifikim/vlerësim në sektorin SVQ
3. Për **Z. L. Xh.** me detyrë doganier i klasifikim/vlerësim në sektorin SVQ
4. Për **Znj. A. C.**, me detyrë doganier i klasifikim/vlerësim në sektorin SVQ
5. Për **Z. A. B.**, me detyrë doganier i klasifikim/vlerësim në sektorin SVQ
6. Për **Z. K. B.**, me detyrë doganier i klasifikim/vlerësim në sektorin SKAO dhe SVQ
7. Për **Z. J. C.**, me detyrë doganier i klasifikim/vlerësim në sektorin SVQ

- Për mos përmbushje të kërkesave të legjislacionit doganor gjatë ushtrimit të detyrave funksionale dhe kryerjes së veprimeve që cenojnë figurën e nëpunësit civil, institucionin apo shërbimin civil në tërësi të përcaktuara në Udhëzimin nr. 5 datë 26.01.2018 sipas shkresës nr. 2194 Prot DPD datë 26.01.2018 *“Mbi procedurat standarde të Vlerësimit në Qendror dhe Sektorit të Kontrollit Aposterior Operativ”*, nxjerrë nga Drejtori i Përgjithshëm i Doganave të cilat bien në kundërshtim me përcaktimet dhe shpjegimet e këtij Udhëzimi sa më poshtë vijon:

“Pika I (nga pika 1 deri ne piken 5), Pika II (nga 2 deri 3), Pika III “Procedurat që ndiqen nga SVQ” nga 1.1 deri ne 1.5, Pika (A) “Kontrolli i Klasifikimit tarifor te Mallrave” pika a.1 deri a.3, Pika (B) “Kontrolli mbi origjinën e mallrave” nga b.1 deri b.8, Pika(C), Pika (D) “Kontrolli dhe shqyrtimi i Vlerës Doganore” nga d.1 deri në d.12, Pika (E) “Konstatimi i Shkeljes Doganore” nga e.1 deri ne e.7, Pika III.1 “ Përzgjedhja ne Kanal te Kuq” nga 2.1 deri 2.10, Pika III 2.A “ Konstatimi i Shkeljes Doganore” nga a.1 deri a.7, Pika IV “Procedurat që ndiqen nga Skao” nga 1.1 deri 1.9, Pika IV .a “Kontrolli mbi klasifikimin tarifor” nga a.1 deri a.3, Pika IV .b “Kontrolli mbi origjinën” nga b.1 deri b.9, Pika IV (D) “Kontrolli dhe shqyrtimi i Vlerës Doganore” nga d.1 deri në d.13, Pika IV.2 “Rastet e Përzgjedhura dhe kanale te tjera” nga 2.1 deri në 2.4, Pika IV.3. “ Konstatimi i Shkeljes Doganore” nga 3.1 deri 3.6, Pika V “Bashkëpunimi ndërmjet strukturave”.

-Për problematika në lidhje me praktika doganore të cilat janë trajtuar me transaksion, ndërkohë që duhet të ishin trajtuar me ndërhyrje në vlerën e mallit dhe jo në përputhje me kërkesat e neneve 65 deri 70 të ligjit nr. 102/2014 datë 31.7.2014 *“Kodi Doganor i Republikës së Shqipërisë”* i ndryshuar, lidhur me vlerësimin doganor të mallrave , duke kryer vlerësime jo të bazuara sipas kritereve të pikës 4.6 sipas metodës 6 bazuar në të Dhënat e Disponueshme në RSH, pikës 5 *“Rregullimet”*, pikës 6 *“Dokumentacioni shoqërues që lidhet me vlerën doganore”*, pikës 6/b/c/d, pikës 7 *“Profilizimi i riskut në vlerësimin doganor”* ,pikës 8 *“Dokumentacioni Shtesë”*, pikës 8/a/dh/ii/iii/vii/f , pikës 11 *“Përdorimi i Databasit të Vlerësimit”* bazuar në pikën 10/c që lidhen me rilogaritje të detyrimeve doganore në import si dhe jo në përmbushje të kërkesave të Udhëzimit nr. 3, datë 23.01.2018 *“Për vlerësimin e mallrave për qëllime doganore”*.

-Për problematika që lidhen me procedurat e përpunimit të deklaratave doganore me klasifikime tarifore të cilat nuk deklaruar janë në përputhje me rregullat e Nomenklaturës së Mallrave në RSH, mos rilogaritje të detyrimeve doganore të taksës kombëtare të ambalazhit plastik, mos pagesa të detyrimeve doganore të mallrave që duhet të paguajnë akcizë, për të cilat nuk është vepruar në përputhje me kërkesat e nenit 50 dhe Shtojcës 5 të Ligjit nr. 61/2012 *“Për Akcizat në Republikën e Shqipërisë”*, i ndryshuar, veprime jo në përputhje me përcaktimet e shkresës nr. 779 prot, të DPD datë 16.01.2013 *“Mbi rishikimin e disa indikatorëve shtesë në vlerësimin doganor të mallrave me origjinë nga vendet jashtë BE”*, për veprime të cilat nuk janë në përputhje me përcaktimet e ligjit nr. 9975, datë 28.07.2008 *“Për Taksat Kombëtare”*, i ndryshuar, me qëllim vjeljen dhe arkëtimin e taksës kombëtare TAM për artikujt që duhet të paguajnë këtë taksë kombëtare, përcaktimet e

shpjegimeve të Udhëzimit nr. 2, datë 17.01.2014, pika 2.8.5 dhe ligjit nr. 92/2014 “Për Tatimin mbi Vlerën e Shtuar në Republikën e Shqipërisë”. përcaktimeve të ligjit nr. 112/2021 datë 25.11.2021 për disa shtesa në ligjin nr. 9975 datë 28.07.2008 “Për taksat kombëtare”. i ndryshuar, nenin 14, 15, 16 17 dhe 18 të ligjit nr. 9863 datë 28.01.2008 “Për Ushqimin” ndryshuar”

-Për problematika që lidhen veprime të cilat nuk janë kryer në përmbushje të Rregullores së Brendshme të Degëve Doganore “Mbi organizimin e funksionimit të Drejtorisë së Përgjithshme të Doganave” e dalë me Urdhërin nr. 146, datë 07.05.2018, të Ministrit të Financave neni 12 pika 10 “kompetencat e doganierit” dhe Seksionit III, pika 1.5, shkronja “a”, si dhe seksionin IV, pika 1.9, shkronja “a”, të Udhëzimit nr. 5, datë 26.01.2018 të DPD “Mbi procedurat standarde të funksionimit të SVQ dhe SKAO”.

E. I (f). Niveli i masës “**Pezullim nga e drejta e ngritjes në detyrë, përfshirë rritjen në shkallën e pagës për një periudhë deri në dy vjet në shërbimin civil**” për punonjësin e kategorisë C1 si më poshtë vijon.

1. Për **Z. A. N.** me detyrë përgjegjës i sektorit të pikës së hyrjes pranë D.D.Tirane.

-Për problematikat e konstatuara lidhur me auditimin e transiteve me destinacionit Degën e Doganës Tiranë pranë zyrës së pikës së hyrje-daljes (afati kohor dhe mbyllja e transiteve) dhe konkretisht: Nga ana e doganierëve të pikës së hyrjes nuk është bërë evidentimi dhe dokumentimi i vonesave të justifikuara/incidenteve dhe masat e marra për mbikëqyrjen doganore në kundërshtim me nenin 126 dhe 128 të Kodit Doganor si dhe në referim tabelës së afateve të transitit nxjerrë sipas Udhëzimit nr. 04 datë 30.09.2011 “Për caktimin e afatit brenda të cilit mallrat të vendosura në regjimin e transitit duhet të paraqiten në zyrën e destinacionit”. si dhe referuar Rregullores së Brendshme të Degëve Doganore “Mbi organizimin e funksionimit të Drejtorisë së Përgjithshme të Doganave” e dalë me Urdhërin nr. 146, datë 07.05.2018, të Ministrit të Financave neni 13 pika 3 “kompetencat e përgjegjës të sektorit të peshore pike/kontrolli”

-Nuk janë dokumentuar shënimet për vonesën po ashtu edhe incidentet që mund të kenë ndodhur gjatë transportit në shënimet në kutinë 56 të deklaratës transit në sistemin Asiçuda dhe masat e marra për të lejuar mbikëqyrjen doganore të mallrave.

-Nga verifikimet e kryera në total për vitet 2022-2023 rezultojnë 13045 raste me tejkalim të afatit limit të vendosur nga dogana nisëse për mbërritjen në destinacionit të cilat rezultojnë të pa sanksionuara nga zyra e pikës së hyrjes dhe Dega Doganore Tiranë për të cilat duhet të ishte mbajtur proces verbal për llojin e shkeljes kundërvajtje administrative sipas nenit 251 pika 2/e të KD dhe sipas nenit 256 pika 1/b në shumën 20,000 lekë (çdo rast).

E II. Mbështetur në nenin 15, të Ligjit nr. 154/2014, datë 27.11.2014 “Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit”, nenin 37 të Ligjit nr. 7961, datë 12.07.1995 “Kodi i Punës në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar dhe nenit 12 “Masat Disiplinore” të kontratës individuale të punës, i rekomandojmë Drejtorit të Përgjithshëm të Drejtorisë së Përgjithshme të Doganave dhe Kryetarit të Degës Doganore Tiranë në cilësinë e organit epror, që bazuar në performancën e secilit punonjës dhe të shkeljeve të konstatuara në Raportin Përfundimtar të Auditimit të KLSH-së, të fillojnë procedurat për dhënien e masave disiplinore si më poshtë vijon:

E. II (a). Niveli i masës “**Vërejtje me paralajmërim për pushim nga puna**” sipas nenit 12 pika 2 (b) të kontratës së punës individuale për punonjësit e mëposhtëm të kategorisë C3.

1. Për **Z. Y. V.** me detyrë doganier i sektorit të pikës së hyrjes pranë D.D.Tirane

2. Për **Z. E. D.** me detyrë doganier i sektorit të pikës së hyrjes pranë D.D.Tirane

3. Për **Z. G. H.** me detyrë doganier i sektorit të pikës së hyrjes pranë D.D.Tirane

4. Për **Z. E. M.** me detyrë doganier i sektorit të pikës së hyrjes pranë D.D.Tirane
5. Për **Z. E. B.** me detyrë doganier i sektorit të pikës së hyrjes pranë D.D.Tirane
6. Për **Z. E. M.** me detyrë ishdoganier i sektorit të pikës së hyrjes pranë D.D.Tirane
7. Për **Z. K. B.** me detyrë doganier i sektorit të pikës së hyrjes pranë D.D.Tirane

-Për problematikat e konstatuara lidhur me auditimin e transiteve me destinacionit Degën e Doganës Tiranë pranë zyrës së pikës së hyrje-daljes (*afati kohor dhe mbyllja e transiteve*) ku nuk është bërë evidentimi dhe dokumentimi i vonesave të justifikuar/incidenteve dhe masat e marra për mbikëqyrjen doganore në kundërshtim me nenin 126 dhe 128 të Kodit Doganor si dhe në referim tabelës së afateve të transitit nxjerrë sipas Udhëzimit nr. 04 datë 30.09.2011 “Për caktimin e afatit brenda të cilit mallrat të vendosura në regjimin e transitit duhet të paraqiten në zyrën e destinacionit” si dhe referuar Rregullores së Brendshme të Degëve Doganore “Mbi organizimin e funksionimit të Drejtorisë së Përgjithshme të Doganave”e dalë me Urdhrin nr. 146, datë 07.05.2018, të Ministrit të Financave neni 12 pika 11 ‘kompetencat e doganierit të peshores pikë/kontrolli’.

-Nuk janë dokumentuar shënimet për vonesën po ashtu edhe incidentet që mund të kenë ndodhur gjatë transportit në shënimet në kutinë 56 të deklaratës transit në sistemin Asicuda dhe masat e marra për të lejuar mbikëqyrjen doganore të mallrave.

-Nga verifikimet e kryera në total për vitet 2022-2023 rezultojnë 13045 raste me tejkalim të afatit limit të vendosur nga dogana nisëse për mbërritjen në destinacionit të cilat rezultojnë të pa sanksionuara nga zyra e pikës së hyrjes dhe Dega Doganore Tiranë për të cilat duhet të ishte mbajtur proces verbal për llojin e shkeljes kundërvajtje administrative sipas nenit 251 pika 2/e të KD dhe sipas nenit 256 pika 1/b në shumën 20,000 lekë (çdo rast).

F. NJOFTIM I DEPARTAMENTIT TË ADMINISTRATËS PUBLIKE

Për punonjësit për të cilët janë rekomanduar masa disiplinore, Dega Doganore Tiranë në bashkëpunim me Drejtorinë e Përgjithshme të Doganave, pasi të zbatojë procedurat e nevojshme ligjore dhe nënligjore për klasifikimin e shkeljeve dhe fillimin e ecurisë disiplinore dhe pas përfundimit të afateve ankimore, **të ndërmarrë veprimet si më poshtë:**

a. Të njoftojë Departamentin e Administratës Publike, për regjistrimin e masës disiplinore në Regjistrin Qendror të Përsoneelit, në zbatim të neneve 7 dhe 17, të ligjit nr. 152/2013 “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar.

b. Të njoftojë Komisionerin për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil, për mbikëqyrjen e ligjshmërisë në administrimin e shërbimit civil, në zbatim të nenit 11, të ligjit nr. 152/2013 “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar.

3.4. DEGËS DOGANORE KAKAVIJË

I. PËRMBLEDHJE

Kontrolli i Lartë i Shtetit Degës Doganore Kakavijë me objekt “Për zbatimin e rekomandimeve të lëna në auditimet e evaduara në vitin 2024”, për auditimin mbi licencimin dhe monitorimin e subjekteve me veprimtari në fushën minerare, përcjellë me shkresën nr. 858/20 prot., datë 05.03.2024, duke i kushtuar vëmendjen e posaçme çështjeve, që lidhen me:

- Vlerësimin e rekomandimeve të KLSH-së të lëna nga auditimi i kryer në vitin 2024, hartimi i programeve (plan veprimeve) nga subjekti i audituar, duke ngarkuar me detyra personat përgjegjës dhe përcaktuar afatet konkrete për zbatimin e rekomandimeve për çdo njësi vartëse; Nxjerrjen nga titullari i njësive publike të akteve administrative të nevojshme, si:

Vendimeve (urdhrave) për zbatimin e masave organizative;
Vendimet ekzekutive për shpërblimin e dëmit;
Vendimet ekzekutive për përdorimin me efektivitet, efikasitet dhe ekonomicitet të fondeve;
Vendimet e nëpunësit autorizues, komisioneve disiplinore për dhënien e masave disiplinore e të tjera masa e rekomandime që i përcillen subjektit të audituar nëpërmjet Vendimit të Kryetarit të Kontrollit të Lartë të Shtetit.

II. HYRJA

Auditimi është kryer në përputhje me ligjin nr. 154, datë 27.11.2014 “Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit”, si dhe manualit “Për ndjekjen e zbatimit të rekomandimeve të Kontrollit të Lartë të Shtetit” dhe Regjistrin elektronik institucional të zbatimit të rekomandimeve.

Auditimi i zbatimit të rekomandimeve të lëna në auditimin e mëparshëm, sipas drejtimeve të Programit të Auditimit nr. 857/6, datë 12.09.2025, të miratuar nga Kryetari i Kontrollit të Lartë të Shtetit, është kryer nga grupi i audituesve i përbërë nga:

-V.B. , përgjegjës i grupit të auditimit

-I.F. , auditues

-F.D. , auditues

Auditimi ka filluar më datë 15.09.2025 dhe ka përfunduar më datë 24.10.2025.

II/1. OBJEKTI I AUDITIMIT

Zbatimi i masave të rekomanduara në auditimin e mëparshëm të dërguara me shkresën nr. 858/20 prot., datë 05.03.2024, mbi veprimtarinë e Degës Doganore Kakavijë së bashku me Raportin Përfundimtar të Auditimit, nga Grupi i Audituesve Shtetërorë të KLSH-së.

II/2. QËLLIMI I AUDITIMIT

Auditimi i zbatimit të rekomandimeve kryhet në funksion të hartimit të Raportit Vjetor të aktivitetit të Kontrollit të Lartë të Shtetit, që paraqitet në Kuvendin e Shqipërisë brenda tremujorit të parë të vitit pasardhës, bazuar në pikën 3 të nenit 31 të ligjit nr. 154/2014 “Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit”.

II/3. METODOLOGJIA E AUDITIMIT

Auditimi i plotë i të gjithë dokumentacionit të paraqitur nga subjekti dhe që ka lidhje me zbatimin e masave të rekomanduara nga KLSH për përmirësimin e gjendjes së subjekteve në të ardhmen.

III. PËRSHKRIMI I AUDITIMIT

III/1. INFORMACION I PËRGJITHSHËM.

Nga auditimi në terren i dokumentacionit të paraqitur nga subjekti Degës Doganore Kakavijë në lidhje me zbatimin e rekomandimeve të lëna nga KLSH me shkresën nr. 858/20 prot., datë 05.03.2024, rezulton se, niveli i pranimeve dhe zbatimit të rekomandimeve është si më poshtë:

-Për përmirësimin e gjendjes janë lënë 15 rekomandime “Masa organizative”, të cilat janë pranuar dhe kanë statusin e ecurisë së zbatimit si vijon: 13 të zbatuara plotësisht dhe 2 zbatuar pjesërisht;

-Për përmirësimin e gjendjes janë lënë 4 rekomandime “Masa për eliminimin e efekteve financiare”, nga të cilat 3 janë pranuar dhe 1 nuk është pranuar. Nga të pranuarat statusi i ecurisë së zbatimit është: 1 masë zbatuar plotësisht dhe 2 masa zbatuar pjesërisht;

-Për përmirësimin e gjendjes është lënë 1 “Masë Disiplinore” e pranuar dhe e zbatuar plotësisht.

Opinion i përgjithshëm mbi zbatimin e rekomandimeve

Nga auditimi i zbatimit të rekomandimeve konstatohet se shkalla e pranueshmërisë së rekomandimeve kundrejt atyre të papranuara është 99%, 19 rekomandime të pranuar dhe 1 rekomandim është i papranuar.

Niveli i zbatimit të rekomandimeve të zbatuara plotësisht rezultoi në masën 79%, niveli i rekomandimeve të zbatuara pjesërisht rezultoi 21%, niveli i zbatimit të rekomandimeve në proces zbatimi rezultoi 0%, niveli i rekomandimeve të pazbatuara rezultoi 0%.

A. Mbi hartimin e programit (Planit të veprimit) dhe respektimin e afateve ligjore për njoftimin e KLSH për ecurinë e zbatimit të rekomandimeve brenda afateve të përcaktuara në Ligjin nr. 154, datë 27.11.2014 “Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit”.

-Dega Doganore Kakavijë me shkresën me nr. 1556/19 prot., datë 20.03.2024 ka nxjerrë urdhrin për shqyrtimin/analizimin e Raportit Përfundimtar të Auditimit të Kontrollit të Lartë të Shtetit, më shkresën nr.1556/21 prot., datë 03.03.2024, ka dërguar pranë KLSH, planin e veprimit me nr. 1556/20 prot., datë 03.03.2024, të Kryetarit të Degës Doganore Kakavijë ku është paraqitur **plani i veprimit** me të cilin ngarkon strukturat përgjegjëse të varësisë të marrin masa mbi zbatimin e rekomandimeve të lëna nga KLSH. brenda afatit ligjor **prej 20 ditëve**

-Dega Doganore Kakavijë me shkresën nr. 1556/120 prot., datë 12.09.2024 me lëndë “Informacion mbi ecurinë e zbatimit të rekomandimeve të lëna ka dërguar pranë KLSH, informacion mbi zbatimin e rekomandimeve brenda **afatit 6 mujor**.

B. Zbatimi i rekomandimeve për masat organizative. Ecuria e zbatimit dhe analizimi i rekomandimeve: rekomandime të pranuar dhe nga këto, sa janë zbatuar plotësisht; zbatuar pjesërisht, në proces zbatimi dhe rekomandimet e pa zbatuara.

Në mënyrë më të detajuar, auditimi i verifikimit të zbatimit të rekomandimeve për secilin rekomandim të përcjellë në Dega Doganore Kakavijë paraqitet:

1.1.Rekomandimi: Strukturat përgjegjëse pranë Drejtorisë së Përgjithshme të Doganave të marrin masat për të përmirësuar procesin e planifikimit të të ardhurave doganore, në funksion të rritjes së performancës së veprimtarisë së degëve doganore në mbledhjen e të ardhurave, rritjen e përgjegjshmërisë dhe llogaridhënies së nëpunësve, duke i bërë pjesë të këtij procesi, si dhe duke shmangur praktikën e ndryshimeve të shpeshta në planifikim. Dega Doganore Kakavijë, të ndjekë limitet e përcaktuara në planin mujor duke kryer analiza të mirëfillta sipas llojit të të ardhurave doganore të gjeneruara, për të përcaktuar saktë faktorët që ndikojnë në nivelin e atë ardhurave doganore sipas llojit.

Pretendimi i subjektit: Plani i të ardhurave përcaktohet cdo muaj nga Drejtoria e Përgjithshme e Doganave. Dega e Doganës Kakavije kryen analiza mujore dhe periodike (3 mujore, 6-mujore, -8 mujore) në të cilat analizon realizimin e planit të të ardhurave, faktorët që ndikojnë në nivelin e të ardhurave, importuesit kryesorë, produktet që zënë më shumë peshë në gjenerimin e të ardhurave.

Qëndrimi i grupit të auditimit: Grupi i auditimit, pasi shqyrtoi dokumentet që ju vendosën në dispozicion nga institucioni, rezultoi se DEGA DOGANORE KAKAVIJË kryen analiza mujore dhe periodike, por nuk është bërë pjesë e procesit të planifikimit të të ardhurave në funksion të rritjen e performancës, përgjegjshmërisë dhe llogaridhënies së nëpunësve.

Ky rekomandim rezultoi i pranuar dhe i zbatuar .

2.1.Rekomandimi: Dega Doganore Kakavijë të bashkëpunojë me Drejtorinë e Përgjithshme të Doganave për të marrë të gjitha masat dhe për të ezauruar të gjitha fazat e procedurës vjeljes së detyrimeve deri në ekzekutimin me forcë të vendimit për rikupërimin e borxhit doganor në vlerën

prej 410,474,831 lekë.

Pretendimi i subjektit: Nga Specialisti i Borxhit në vijim ka kryer procedurat ligjore për nxjerrjen e titujve ekzekutivë dhe Urdhërave të Ekzekutimit. Evidenca e debitorëve së bashku me arkëtimet dhe vendimet e marra raportohet brenda datës 10 të cdo muaji, pranë Sektorit të Borxhit në DPD. Me shkresën nr. 379 prot., datë 12.03.2025 ka paraqitur pranë Drejtorisë së Përgjithshme të Doganave informacion mbi detyrimet doganore të papaguara të trashëguara deri më 31 dhjetor 2024. Nga rastet debitorë deri në 31.12.2022, dega doganore ka rikupëruar 30 raste në shumën 5,778,540 lekë. Janë marrë masa për rikupërimin e borxhit duke nxjerrë Urdhërata e Ekzekutimit nr. 284, datë 16.11.2023, nr. 187, datë 06.05.2025, nr. 240, datë 08.11.2023, nr. 386, datë 19.12.2023, nr. 111, datë 17.05.2023, nr. 71, datë 18.09.2023, nr. 71, datë 18.09.2023, nr. 241, datë 09.11.2023, nr. 242, datë 15.11.2023. Nga tabela e borxhit 181 raste në shumën 355,563,362 lekë janë të pajisur me Urdhër Ekzekutimi si dhe do vazhdohet me procedurat ligjore për rikupërimin e detyrimeve doganore të papaguara.

Qëndrimi i grupit të auditimit: Grupi i auditimit, pasi shqyrtoi dokumentet që ju vendosën në dispozicion nga institucioni, rezulton se nga ana e Dega Doganore Kakavijë janë kryer procedurat ligjore për nxjerrjen e titujve ekzekutivë dhe Urdhërave të Ekzekutimit për detyrimeve doganore të pa arkëtuara.

Ky rekomandim rezulton i pranuar dhe në proces zbatimi.

2.2.Rekomandimi: Dega Doganore Kakavijë të marrë masa që të evidentojë në mënyrë të saktë gjendjen debitorë të subjekteve për vitet 2021 dhe 2022, përfshirë dhe llogaritjen e kamatëvonesave në vlerën 1,438,649 lekë, duke siguruar që në rastet e flagrancës të konstatimit të kryerjes të kontrabandës nga ana e subjekteve, të dalë me vendim sipas përcaktimeve ligjore.

Pretendimi i subjektit:

Në Raportin Përfundimtar është konstatuar një llogaritje jo e sakte e kamatëvonesave për 15 raste të subjekteve debitorë për vitin 2021 në vlerën totale 52,533 lekë dhe 45 raste të subjekteve debitorë për vitin 2022 në vlerën totale 1,386,116 lekë.

Nga shqyrtimi i procedurës së llogaritjes se kamatëvonesave rezulton se kamatëvonesa është llogaritur mbi bazën e pikës 1 të nenit 107 të ligjit nr. 102/2014, ‘Kodi Doganor’, i ndryshuar, i cili parashikon : *1. Norma e kamatëvonesave zbatohet mbi shumën e detyrimit të importit ose eksportit nga data e përfundimit të afatit të parashikuar deri në datën e pagesës.*

Referuar Udhëzimit nr. 15, datë 03.12.2018 i Drejtorit të Përgjithshëm ‘‘Mbi evidentimin, kontabilizimi dhe rikupërimin e detyrimeve të papaguara doganore dhe të akzicies’’, kreu V), pika 3 përcaktohet : *Shuma e detyrimeve që duhet të paguhet nga debitori përfshin:*

a) borxhin doganor të papaguar (shumën e detyrimeve të importit ose eksportit) dhe apo borxhin e papaguar të akzicies (nëse ka),

b) Penali teti (nëse ka)

c) kamat vonesat (nëse ka)

Pika 4.1 e udhëzimit përcakton: ***Norma e kamat vonesave zbatohet mbi shumën e detyrimit të importit ose eksportit.***

Pra, në zbatim të kuadrit ligjor të mësipërm rezulton se kamatëvonesa llogaritet vetëm mbi shumën e detyrimit të papaguar të importit ose eksportit. Në momentin që gjatë procedurës së shpalljes debitor nuk kemi detyrim importi apo eksporti, rrjedhimisht nuk do të kemi as llogaritje të kamatëvonesave.

Nga kontrolli rezulton se 15 rastet e evidentuara që i përkasin vitit 2021 ne shumen 52,533 leke kane arkëtuar shumen e detyrimit te importit ne periudhat e mëparshme dhe për ketë arsye gjate vitit 2021 nuk janë llogaritur kamat-vonesat.

Lidhur me 45 rastet e evidentuara për vitin 2022 ne shumen 1,386,116 leke, është kryer llogaritja dhe pasqyrimi i kamatëvonesave në evidencën e muajit gusht sipas tabelës së mëposhtme:

Emertimi I Subiektit	NIPT-i	Vendim		Shtuar kamatvonesa
		Nr	Datë	
E	K.	34	1/13/2011	13,996
E	K.	33	1/13/2011	9,113
E	K.	38	1/13/2011	4,755
E	K.	22	1/7/2011	3,919
G	K.	37	1/13/2011	8,001
G	K.	36	1/13/2011	19,806
G	K.	35	1/13/2011	19,032
M	L.	154	1/24/2011	174,252
V	J.	604	5/23/2011	65,512
A	A.	1038	9/23/2011	661
V	A.	1040	9/23/2011	914
D	A.	1041	9/23/2011	414
K	A.	1042	9/23/2011	562
K	A.	1043	9/23/2011	748
O	K.	264	3/30/2012	11,774
K	J.	295	4/6/2012	21,037
Q	K.	299	4/11/2012	1,897
M	J.	402	5/9/2012	2,856
K	L.	655	6/26/2012	2,496
P	K	975	8/31/2012	18,016
E	K	1096	24/9/2012	313,509
N	J	1098	24/9/2012	80,625
K	J	1102	24/9/2012	34,110
G	K	1107	24/9/2012	276,053
V	L	1109	24/9/2012	28,714
C	K	1111	24/9/2012	18,819
S	K	1370	20/11/2012	47,229
M	H	151	12/5/2013	1,976
E	L	27	24.06.2020	2,517
TOTAL				1,183,313

Qëndrimi i grupit të auditimit: Grupi i auditimit, pasi shqyrtoi dokumentet që ju vendosën në dispozicion nga institucioni, rezulton se DEGA DOGANORE KAKAVIJË ka kryer përlllogaritjen e kamatë-vonesave jo sipas rekomandit të dhënë për 45 subjekte.

Ky rekomandim rezulton i pranuar zbatuar pjesërisht.

3.1 Rekomandimi:-Dega Doganore Kakavijë të analizojë dhe të nxjerrë përgjegjësitë për mangësitë e konstatuara në çështjen e autorizimeve të magazinave fiskale të cilat rezultojnë të pa mbuluara me garanci sipas legjislacionit doganor e për të cilat nuk kanë nisur ende procedurat e revokimit të autorizimit të magazinës fiskale, si dhe të marrë masa për monitorimin të vazhdueshëm të veprimtarisë së operatorëve lidhur me vlefshmërinë në kohë të kushteve ligjore të autorizimeve.

Pretendimi i subjektit: Lidhur me zbatimin e rekomandimit të mësipërm, Zyra e Akcizës ka marrë masa që subjektet të depozitojnë vlerën e garancisë për produktet e prodhuara dhe stokuara si më poshtë:

Subjekti 'V' sh.p.k me Nipt: K. me anë të Certifikatës së garanciës për sigurim kontrate nr.0020662, datë 12.12.2023 ka arketuar vlerën e garancisë në masën 100% të detyrimeve të llogaritura të akcizës për produktin e depozituar "Duhan i grirë", për një periudhë 1-vjecare deri më 11.12.2024. Me shkresën nr.0020927, datë 12.02.2024 "Certifikatë garancie për sigurim kontrate" ka arketuar vlerën e garancisë në masën 100% të detyrimeve të llogaritura të akcizës për produktin e depozituar "nikotinë", për një periudhë 1-vjecare deri më 11.02.2025. Me shkresën nr.0021366, datë 31.07.2024 "Certifikatë garancie për sigurim kontrate" ka arketuar vlerën e garancisë në masën 100% të detyrimeve të llogaritura të akcizës për produktin e depozituar "duhan i grirë", për një periudhë 1-vjecare deri më 30.07.2025.

Subjekti 'A' me Nipt:L. për produktin e prithshëm 'raki' për vitin 2024, ka arketuar vlerën e garancisë me anë të Certifikatës së garanciës për sigurim kontrate nr.240700598, datë 26.01.2024, për një periudhë 1-vjecare deri më 25.01.2025.

Subjekti 'V' me Nipt:L. për produktin e prithshëm 'verë' dhe 'raki' për vitin 2024 ka arketuar vlerën e garancisë së detyrimeve të llogaritura të akcizës me anë të "Certifikatës së garanciës" nr.16/GJSG4/060641, datë 25.07.2024.\

Qëndrimi i grupit të auditimit: Grupi i auditimit, pasi shqyrtoi dokumentat që ju vendosën në dispozicion nga institucioni, rezulton se janë marrë masa për monitorimin të vazhdueshëm të veprimtarisë së operatorëve lidhur me vlefshmërinë në kohë të kushteve ligjore të autorizimeve.

Ky rekomandim rezulton i pranuar dhe zbatuar.

4.1.Rekomandimi: Dega Doganore të marrë masa për rritjen e mbulimit me kontroll, të realizojë përzgjedhjen e operatorëve për kontroll bazuar në analizën e riskut të dokumentuar, si dhe të hartojë raportet e kontrollit, dokumentimi i kontrollit dhe rezultatet e tij, në përputhje me përcaktimet e manualit të metodologjisë së kontrollit të akcizës.

Pretendimi i subjektit: Zyra e Akcizës ka ushtruar kontroll pranë operatorit të akcizës "Alfa" sh.a sipas Program Kontrollit nr. 240 prot, datë 06.02.2024. Në përfundim ka hartuar Informacionin drejtuar subjektit dhe për dijeni Departamentit të Akcizës nr.240/5 prot, datë 12.03.2024 (bashkëlidhur).

Në zbatim të Program Kontrollit nr.252 prot, datë 07.02.2024 është ushtruar kontroll pranë operatorit 'V' sh.p.k. Në përfundim është hartuar Informacioni drejtuar subjektit dhe për dijeni Departamentit të Akcizës nr.252/5 prot, datë 13.03.2024 (bashkëlidhur).

Qëndrimi i grupit të auditimit:Grupi i auditimit, pasi shqyrtoi dokumentet që ju vendosën në dispozicion nga institucioni, rezulton se Dega Doganore Kakavijë për 2 subjekte Akcizës, ka hartuar raportet e kontrollit, si dhe ka bërë dokumentimin e kontrollit dhe rezultatet e tij, por nuk ka rritur ndjeshëm performances, për kontrollin e subjekteve të akcizës.

Ky rekomandim rezulton i pranuar dhe zbatuar pjesërisht.

5.1.Rekomandimi:-Në rastet e përzgjedhjes manuale për skanim (jashtë sistemit) me kërkesë të institucioneve të ndryshme, të kërkohet dokumentimi/protokollimi i "Kërkesës për skanim", duke pasqyruar arsyet e përzgjedhjes për skanim, si dhe duke plotësuar në të gjitha rubrikat Urdhrat e Skanimit dhe të pasqyrohen në Regjistrin e Skanimit.

Gjithashtu, të mbahen procesverbalet “Për saktësimin e prezencës së kuadratit në imazhin e skanimit”, ku të pasqyrohen rezultatet e kontrollit fizik të vendeve të markuar dhe Urdhrit e Skanimit së bashku me dokumentacioni shoqëruar që janë pjesë e praktikës doganore përkatëse të dorëzohen në arkiva të listuar e shoqëruar me proces verbalin e dorëzimit përkatës.

Pretendimi i subjektit:Dega e Doganës Kakavije me shkresat nr. 187 prot., datë 01.02.2023 dhe nr.1008 prot, datë 18.07.2025 ”Për zbatim”, i është drejtuar Zyrës së Operacioneve Doganore dhe për dijeni Pikës së Kalimit Kufitar Kakavije, të cilat në rastet e përzgjedhjes manuale për skanim (jashtë sistemit), urdhër skanimi duhet të lëshohet pasi të dokumentohet “kërkesa për skanim” nga institucione të ndryshme si Policia Kufitare, AKU etj, nëpërmjet regjistrimit të saj në protokoll. Dogana duhet të kërkojë prej këtyre institucioneve arsyet e përzgjedhjes për skanim të mjeteve bazuar në analiza risku, informacion specifik apo kritere në lidhje me fushën e tyre të kompetencave me përjashtim të rasteve konfidenciale apo sekret. (*Bashkëlidhur shkresa nr.187 prot, datë 01.02.2023*)

Qëndrimi i grupit të auditimit: Grupi i auditimit, pasi shqyrtoi dokumentet që ju vendosën në dispozicion nga institucioni, rezulton se Dega Doganore Kakavijë ka nxjerrë shkresat nr. 187 prot.,datë 01.02.2023 dhe nr.1008 prot, datë 18.07.2025 për zbatim e rekomandimit të dhënë.

Ky rekomandim rezulton i pranuar dhe zbatuar plotësisht.

5.2. Rekomandimi: Në Degën e Doganës Kakavijë të kryhen procedurat për menaxhimin e të dhënave të skanerit të kryhet rakordomi dhe krahasimi i deklaratave të përzgjedhura për skanim me ato të skanuara në fakt, të hartohen raport kontrollet mujore ku të vlerësohen efektshmëria e vazhdueshme e funksionit të analizës së imazheve të R; të analizohen të dhënat për numrin e skanimeve, origjinën e kërkesës referuese, numrin e anomalive të evidentuara, rezultatit e kontrolleve të kryera me qëllim monitorimin, vlerësimin e nivelit të zbatimit të procedurave standarde te punës të miratuara dhe përcaktimin e synimeve operacional.

Pretendimi i subjektit:

Dega e Doganës Kakavije ka nxjerrë Urdhërin e Brendshëm nr. 862/9 prot., datë 13.11.2020.

Qëndrimi i grupit të auditimit:Grupi i auditimit, pasi shqyrtoi dokumentet që ju vendosën në dispozicion nga institucioni, rezulton se Dega Doganore Kakavijë ka nxjerrë **Urdhërin e Brendshëm nr. 862/9 prot., datë 13.11.2020**, për zbatim e rekomandimit të dhënë.

Ky rekomandim rezulton i pranuar dhe i zbatuar.

6.1.Rekomandimi:Dega Doganore Kakavijë të marrë të gjitha masat e nevojshme me qëllim sigurimin e informacionit të plotë pranë degëve doganore mbikëqyrëse (degët doganore të destinacionit) në lidhje me rastet e importeve të kryera nga operatorë ekonomikë që kanë mallra të natyrës “Kafshë të gjalla të tipit shtëpiak për therje dhe për majmëri”, si dhe faktorëve thelbësore ekonomike që kanë sjellë kushtin e përjashtimit nga tarifa dhe TVSH-ja, duke marrë në konsideratë proporcionali tetin e riskut; urgjencën e nevojës së zbatimit të kontrolleve si dhe ndikimin e mundshëm mbi shkëmbimet tregtare dhe mbi burimet e nevojshme për këto kontrolle.

Pretendimi i subjektit: Dega e Doganës Kakavije me shkresën nr. 1556/59 prot., datë 22.05.2024 ka kërkuar informacion pranë degëve doganore të destinacionit mbi konfirmimin e mbërritjes së ngarkesës së importit të kafshëve për majmëri, si dhe dokumentat e depozituara nga importuesit pranë këtyre degëve doganore (bashkëlidhur).

Qëndrimi i grupit të auditimit:Grupi I Auditimit, pasi shqyrtoi dokumentet që ju vendosën në dispozicion nga institucioni, rezulton se dega Doganore Kakavijë ka nxjerrë shkresën Nr. 1556/59

Prot., Datë 22.05.2024 ka kërkuar informacion pranë degëve Doganore të destinacionit mbi konfirmimin e mbërritjes së ngarkesës së importit të kafshëve për majmëri, si dhe dokumentat e depozituara nga importuesit pranë këtyre Degëve Doganore, për zbatim e rekomandimit të dhënë.
Ky rekomandim rezulton i pranuar dhe zbatuar plotësisht.

6.2.Rekomandimi:-Dega Doganore Kakavijë të kryejë veprime verifikuese pranë Autoriteteve të Doganave Homologe lëvrues të mallrave, në lidhje me peshën e mallit, numrin e krerëve, kushtit të trajtimit të destinacionit të mallit “*Kafshë për Majmëri*” dhe vlerave të mallrave të transaktuara për saktësimin e të dhënave pranë selive të kompanive lëvrues ose stabilimenteve rritëse të këtyre mallrave për llogari të kompanive të sipërpërmendura, me qëllim evidentimin e detyrimeve doganore të shmangura dhe të pa paguara.

Pretendimi i subjektit: Dega e Doganës Kakavije me shkresën nr.1556/116 prot, datë 16.09.2024 ‘kërkesë për verifikim’ është drejtuar pranë Drejtorisë së Informacionit, me qëllim verifikimin e faturave lidhur me peshën e mallit, numrin e krerëve, vlerave të transaktuara pranë selive të kompanive lëvruese.

Qëndrimi i grupit të auditimit: Grupi i auditimit, pasi shqyrtoi dokumentet që ju vendosën në dispozicion nga institucioni, rezulton se Dega Doganore Kakavijë ka nxjerrë shkresën nr.1556/116 prot, datë 16.09.2024 me objekt ‘kërkesë për verifikim’ e cila është drejtuar pranë Drejtorisë së Informacionit, me qëllim verifikimin e faturave lidhur me peshën e mallit, numrin e krerëve, vlerave të transaktuara pranë selive të kompanive lëvruese, për zbatim e rekomandimit të dhënë.

Ky rekomandim rezulton i pranuar dhe zbatuar plotësisht.

6.3.Rekomandimi:-Dega Doganore Kakavijë, Degët Doganore Mbikëqyrëse të destinacionit në bashkëpunim me Drejtorinë e Përgjithshme të Doganave, të kryejnë veprime informimi dhe bashkëpunimi të detyrueshëm me Drejtoritë Rajonale Tatimore respektive dhe Drejtorinë e Përgjithshme të Tatimeve, me qëllim dhënien e informacionit të detyrueshëm në lidhje me sasinë e krerëve të cilat deklarohen për status majmëri, vlera e deklaruar e mallit për njësi bazuar në Marrëveshjen e Bashkëpunimit të Ndërsjellët nr. 8026 prot., datë 03.04.2017.

Pretendimi i subjektit: Me shkresën nr.1556/59 prot, datë 22.05.2024 D.D.Kakavije ka kërkuar bashkëpunim midis doganave mbikëqyrëse dhe Drejtorisë së Përgjithshme të Doganave me qëllim koordinimin e veprimtarisë me Drejtorinë e Përgjithshme të Tatimeve, lidhur me dhënien e informacionit mbi sasitë e krerëve të cilat deklarohen status majmëri, vlerat e deklaruar.

Qëndrimi i grupit të auditimit: Grupi i auditimit, pasi shqyrtoi dokumentet që ju vendosën në dispozicion nga institucioni, rezulton se Dega Doganore Kakavijë ka nxjerrë shkresën nr.1556/59 prot, datë 22.05.2024 D.D.Kakavije ka kërkuar bashkëpunim midis doganave mbikëqyrëse dhe Drejtorisë së Përgjithshme të Doganave me qëllim koordinimin e veprimtarisë me Drejtorinë e Përgjithshme të Tatimeve, për zbatim e rekomandimit të dhënë.

Ky rekomandim rezulton i pranuar dhe zbatuar plotësisht.

6.4.Rekomandimi:Dega Doganore Kakavijë për rastet në të cilat do të konstatohet mos përmbushja e përfitimit të kushtit të përjashtimit nga detyrimet e TVSH-së për praktika të konstatuara sa më sipër, si dhe për të tjera importe malli të deklaruar sipas kushtit KPM, të veprojë në mënyrë të menjëhershme me qëllim rregullimin e situatës doganore, duke marrë të gjitha masat përkatëse sipas legjislacionit në fuqi.

Pretendimi i subjektit: Dogana Kakavije ne vijimësi për rastet në të cilat do të konstatohet mospërbushja e përfitimit të kushtit të përjashtimit nga detyrimet e TVSH-së, do të marrë masat sipas legjislacionit në fuqi.

Qëndrimi i grupit të auditimit: Grupi i auditimit, pasi shqyrtoi dokumentet që ju vendosën në dispozicion nga institucioni, rezulton se Dega Doganore Kakavijë ka nxjerrë shkresën nr.1556/116 prot, datë 16.09.2024 D.D.Kakavijë ka kërkuar bashkëpunim midis doganave mbikqyrëse dhe Drejtorisë së Përgjithshme të Doganave me qëllim koordinimin e veprimtarisë me Drejtorinë e Përgjithshme të Tatimeve, për zbatim e rekomandimit të dhënë.

Ky rekomandim rezulton i pranuar dhe i pa zbatuar.

7.1.Rekomandimi: Kryetari i Degës Doganore Kakavijë të marrë masat për dokumentimin e kontrollit të kryer nga ana e tij në mbylljen e autorizimit të regjimit të përpunimit aktiv, nëpërmjet miratimit të tij për çdo rast, si dhe të mbikëqyrë kryerjen e inventarizimit dhe arkivimit të të gjitha dosjeve të autorizimeve të mbyllura me dokumentacionin përkatës, duke monitoruar kontrollet e kryera për verifikimin e procedurave të asgjësimit të mbetjeve të subjekteve RPA.

Pretendimi i subjektit: Në zbatim të Udhëzimit nr.4, datë 28.03.2019, dokumenti i mbylljes së autorizimit sipas aneksit 8, nënshkruhet nga ana e Kryetarit të degës doganore (shkresat b/lidhur). Doganieri i Mbikqyrjes ka marrë masat për inventarizimin e dosjeve të autorizimeve të mbyllura. Dosjet e operatorëve ekonomik (afati i te cilave ka përfunduar brenda Vitit 2024) në lidhje me autorizimet e RPA te ndjekura nga doganierja e mbikqyrjes doganore A. Sh., janë në bazë të Udhëzimit Nr.4, datë 28.03.2019, “Për zbatimin praktik të regjimit të përpunimit aktiv”, së bashku me ndryshimet e tij, në bazë të rubrikes XV Pika 1/2/3, i cili e ka të saktësuar se çduhet të ketë një dosje. Të gjitha dokumentat që ndodhen në dosje janë të protokolluara në sekretari, gjithashtu edhe inventari i dosjes për çdo subjekt RPA. Aneksi 8 është i firmosur nga Kryetari i Deges Doganore.

Qëndrimi i grupit të auditimit: Grupi i auditimit, pasi shqyrtoi dokumentet që ju vendosën në dispozicion nga institucioni, rezulton se nga ana Dega Doganore Kakavijë është kryer inventarizimi dhe arkivimi dosjeve të autorizimeve të mbyllura me dokumentacionin përkatës, duke monitoruar kontrollet e kryera për verifikimin e procedurave të asgjësimit të mbetjeve të subjekteve RPA.

Ky rekomandim rezulton i pranuar dhe zbatuar plotësisht.

8.1.Rekomandimi: Kryetari i Degës së Doganës Kakavijë të marrë masat për miratimin e programeve për kryerjen e kontrolleve në vend për problematikat e evidentuara më sipër, pranë operatorëve ekonomik të pajisur me autorizimin e regjimit aktiv, duke trajtuar me prioritet subjektet për të cilat nuk është ushtruar asnjë kontroll në të paktën tre vitet e fundit, si dhe intensifikimin e kontrolleve të kryera në vend pranë operatorëve ekonomik me objekt transferimin e mallit nga një regjim në tjetrin, me qëllim minimizimin e riskut që këtij stoku realisht të mos i jetë dhënë destinacion, shoqëruar me efekte financiare në të ardhmen.

Pretendimi i subjektit: Në zbatim të rekomandimit, Zyra e Mbikqyrjes Doganore ka ushtruar kontroll pranë operatorëve ‘V’ sh.p.k dhe ‘A’ sh.p.k me tematikë kontroll dokumentar, fizik dhe verifikimin e koeficientit të shfrytëzimit.

Nëpërmjet Programit të Kontrollit nr. 118 prot., datë 23.01.2023, është ushtruar kontroll pranë subjektit ‘V’ sh.p.k dhe në përfundim është mbajtur Procesverbali nr. 118/1 prot., datë 01.02.2023 (bashkëlidhur).

Në bazë të Programit të Kontrollit nr. 920 prot., datë 07.05.2024 është ushtruar kontroll pranë subjektit 'A' sh.p.k dhe në përfundim është mbajtur Procesverbali nr. 920/1 prot., datë 20.05.2024 (bashkëlidhur).

Qëndrimi i grupit të auditimit: Grupi i auditimit, pasi shqyrtoi dokumentet që ju vendosën në dispozicion nga institucioni, rezulton se Dega Doganore Kakavijë në zbatim të rekomandim të dhënë ka ushtruar kontroll pranë operatorëve 'V' sh.p.k dhe 'A' sh.p.k me tematikë kontroll dokumentar, fizik dhe verifikimin e koeficientit të shfrytëzimit.

Ky rekomandim rezulton i pranuar dhe zbatuar plotësisht.

9.1.Rekomandimi:-Dega e Doganës Kakavijë të mare masat për inicimin e programeve të kontrollit në vend pranë subjekteve për të cilët autorizimi i dhënë ka përcaktuar doganën mbikëqyrëse si përgjegjëse për kryerjen e verifikimeve të nevojshme me objekt përcaktimin e koeficientit të shfrytëzimit të aplikuar përgjatë prodhimit për autorizimet përkatëse, shoqëruar me skedarët përkatës për çdo produkt.

Gjithashtu, të marrë masat për verifikimin e diferencave në sasi të mallit në rang produkti pas administrimit të skedarëve të përpunimit të vendosur nën regjim për autorizimet e subjekteve që janë dhënë për koeficientin 1 të shfrytëzimit, por rezultojnë me diferenca në peshë në nivel artikulli për peshën e aksesorëve ndihmës të trupëzuara në produktet e eksportuara.

Pretendimi i subjektit:Doganieri i Mbikqyrjes ka kërkuar nga subjektet plotësimin e dosjes duke paraqitur skedarët përkatës për çdo produkt, nëpërmjet shkresave nr. 1556/24 prot., nr. 1556/25 prot., nr. 1556/26 prot., dhe nr. 1556/27 prot., datë 09.04.2024.

Në bazë të Programit të Kontrollit nr. 920 prot., datë 07.05.2024, është ushtruar kontroll pranë subjektit 'A' sh.p.k dhe në përfundim është mbajtur Procesverbali nr. 920/1 prot., datë 20.05.2024 (bashkëlidhur).

Në zbatim të Programit të Kontrollit nr. 328 prot., datë 13.02.2024 është ushtruar kontroll pranë subjektit 'E' sh.p.k me Nipt:K. dhe në përfundim është mbajtur Procesverbali nr.328/1 prot., datë 16.02.2024 (bashkëlidhur).

Qëndrimi i grupit të auditimit: Grupi i auditimit, pasi shqyrtoi dokumentet që ju vendosën në dispozicion nga institucioni, rezulton se Dega Doganore Kakavijë në zbatim të rekomandim të dhënë ka kërkuar nga subjektet plotësimin e dosjes duke paraqitur skedarët përkatës për çdo produkt, nëpërmjet shkresave nr. 1556/24 prot., nr. 1556/25 prot., nr. 1556/26 prot., dhe nr. 1556/27 prot., datë 09.04.2024.

Ky rekomandim rezulton i pranuar dhe zbatuar plotësisht.

10.1.Rekomandimi: Dega e Doganës Kakavijë të përcjellë problematikën e mësipërme pranë Drejtorisë së Përgjithshme të Doganave, në mënyrë që të vlerësohen kushtet e pajisjes së këtyre operatorëve me autorizimet përkatëse, në të cilat produkti kryesor i eksportuar është uji i ambalazhuar.

Pretendimi i subjektit: Dega e Doganës Kakavije me shkresën nr. 1556/22 prot., datë 09.04.2024 është drejtuar me shkresë pranë Drejtorisë së Procedurave. Departamenti Teknik ka kthyer përgjigje me shkresën nr.8128/1 prot, datë 07.05.2024.

Qëndrimi i grupit të auditimit: Grupi i auditimit, pasi shqyrtoi dokumentat që ju vendosën në dispozicion nga institucioni, rezulton se Dega Doganore Kakavijë në zbatim të rekomandim të dhënë ka dërguar shkresën nr. 1556/22 prot., datë 09.04.2024, drejtuar me shkresë pranë Drejtorisë

së Procedurave. Departamenti Teknik ka kthyer përgjigje me shkresën nr.8128/1 prot, datë 07.05.2024.

Ky rekomandim rezulton i pranuar dhe zbatuar plotësisht.

11.1 Rekomandimi: Dega Doganore Kakavijë të marrë masa të plota ligjore për arkëtimin e të ardhurave doganore të munguara në bashkëpunim me Drejtorinë e Përgjithshme të Doganave duke ezauruar njëkohësisht dhe rezultatet e verifikimeve doganore që do të vlerësohen nga përgjigje të Autoriteteve Doganore të Egjiptit bazuar në marrëveshje bashkëpunimi reciproke dhe njëkohësisht kontrollit doganor bazuar në nenin 47 deri 49 të ligjit nr. 102/2014, datë 31.07.2014 “*Kodi Doganor i Republikës së Shqipërisë*”, duke kryer në të njëjtën kohë menjëherë edhe garantimin e shumës të borxhit doganor për të ardhura doganore të munguara në shumën **15,587,728** lekë, në kushtet e ardhjes së përgjigjeve negative nga Autoritetet Doganore të Egjiptit për verifikime transaksionesh të kryera për llogari të subjekti “V”, bazuar në përcaktimet e ligjit nr. 102/2014, datë 31.07.2014 “*Kodi Doganor i Republikës së Shqipërisë*” nga Departamenti Operativ Hetimor pranë DPD-së.

Pretendimi i subjektit: Për zbatimin e këtij rekomandimi me shkresën nr. 794 prot., datë 16.04.2024, është paraqitur kërkesa për verifikimin e faturave pranë Drejtorisë së Informacionit në DPD. Me shkresën nr. 24039/1 prot., datë 26.11.2024 Drejtoria e Informacionit, informon se si rezultat i verifikimeve të kryera Autoritetet Homologe Greke kanë konfirmuar vërtetësinë dhe autenticitetin e faturave të dërguara.

Qëndrimi i grupit të auditimit: Grupi i auditimit, pasi shqyrtoi dokumentat që ju vendosën në dispozicion nga institucioni, rezulton se Dega Doganore Kakavijë në zbatim të rekomandim të dhënë ka dërguar shkresën nr. 794 prot., datë 16.04.2024, për verifikimin e faturave pranë Drejtorisë së Informacionit në DPD. Me shkresën nr. 24039/1 prot., datë 26.11.2024 Drejtoria e Informacionit, informon se si rezultat i verifikimeve të kryera Autoritetet Homologe Greke kanë konfirmuar vërtetësinë dhe autenticitetin e faturave të dërguara.

Ky rekomandim rezulton i pranuar dhe zbatuar plotësisht.

Me observacionin nr 857/23 datë 22.12.2025 prot në KLSH subjekti ka paraqitur dokumentacionin përkatës për subjekte të cilat janë trajtuar ne Raport në lidhje me llogaritjen e kamatvonesave për 15 raste në (15 subjekte) debitore të viti 2021, ku nga shqyrtimi i llogaritjes duke u bazuar në pikën 1 të nenit 107 të ligjit nr.102/2014 “Kodi Doganor” i ndryshuar., parashikon norma e kamatëvoinesë zbatohet mbi shumën e detyrimit të omportit ose eksportit nga data e përfundimit të afatit të parshikuar deri në datën e pagesës.

Grupi i auditimit pasi shqyrtoi dokumentacionin bashkëlidhur mori në konsideratë dhe u reflektuan në Rport Perfundimtarë.

C. Zbatimi i rekomandimeve për masa për eliminimin e efekteve negative. Ecuria e zbatimit dhe analizimi i rekomandimeve: rekomandime të pranuar dhe nga këto, sa janë zbatuar plotësisht; zbatuar pjesërisht, në proces zbatimi dhe rekomandimet e pa zbatuara.

1.1.Rekomandimi:- Dega Doganore Kakavijë të marrë masat për bashkërendimin e punës me Drejtorinë e Përgjithshme të Doganave, me qëllim analizimin dhe kryerjen e procedurave doganore verifikuese sipas legjislacionit në fuqi dhe zbatimin ligjor për vendim-marrjen, kontabilizimin dhe arkëtimin e detyrimeve doganore të llogaritura në **shumën 60,221 mijë lekë (detyrime dhe penaltitë)** për periudhën nga data 01.01.2021 deri në datën 31.12.2022 që lidhen me rillogaritje

pagesash detyrime doganore në import për të cilat nuk është vepruar në përputhje me kuadrin ligjor, nënligjor dhe rregullator përkatës, sipas listës në aneksin nr. 2.1-2.28 të këtij raporti.

Pretendimi i subjektit: Dega e Doganës Kakavije nëpërmjet Grupit të Punës të ngritur me Urdhrin e Brendshëm nr. 1556/19, datë 20.03.2024, i ndryshuar, ka marrë në kontroll dhe verifikim rastet e konstatuara nga kontrolli dhe në vijim është konkluduar si më poshtë:

Aneksi 2.1

Subjekti	Nipti	Rekomanduar	Vendim		Vendosur Detyrim (leke)
		Detyrim	Nr.	Datë	
U	J	800,381	60	06.08.2024	895,390
TOTAL		800,381			895,390

Subjekti ka arkëtuar shumën e detyrimit.

Aneksi 2.2

Subjekti	Nipti	Rekomanduar	Procesverbali		Vendosur Detyrim (leke)
		Detyrim	Nr.	Datë	
L	K	395,954	1153	11.06.2024	17,611
TOTAL		395,954			17,611

Nga ana e Dega Doganore Kakavijë është Subjekti ka arkëtuar shumën e detyrimit doganor 17,611 lekë të vendosur sipas Procesverbali nr. 1153 prot., datë 11.06.2024 (bashkëlidhur).

Aneksi 2.3

Subjekti	Nipti	Rekomanduar	Vendim/Procesverbal		Vendosur Detyrim (leke)
		Detyrim	Nr.	Datë	
CI	K	2,545,207	59	06.08.2024	2,613,527
A	L	19,026	1150 prot	11.06.2024	12,736
F	M	12,513	1142 prot	11.06.2024	3,317
TOTAL		2,576,746			2,629,580

Subjektet kanë arketuar shumën e detyrimit.

Aneksi 2.4

Subjekti	Nipti	Rekomanduar	Procesverbali		Vendosur Detyrim (leke)
		Detyrim (lekë)	Nr.	Datë	
E	L	3,310,127	1556/76	31.07.2024	0
TOTAL		3,310,127			0

Sipas Procesverbalit nr. 1556/76 prot., datë 31.07.2024 (bashkëlidhur), grupi i punës ka arsyetuar se produkti i importuar është kripë deti e pajodizuar e papërshtatshme për konsum njerëzor dhe referuar dhe ekstraktit të kompanise veprimtaria e saj është ‘prodhim, përpunim, ambalazhim e shpërndarje me shumicë e ushqimeve për njerëz (kripë)’. Për këtë arsyetim nuk ka të dhëna të disponueshme. Të dhenat e disponueshme i referohen produktit përfundimtar të ambalazhuar për konsum njerëzor.

Në përfundim është vendosur, se referuar analizës së kostos si dhe faturave tatimore, cmimi i deklaruar nga subjekti është i pranueshëm për qëllime doganore dhe për rrjedhojë pranohet transaksioni.

Aneksi 2.5

Subjekti	Nipti	Rekomanduar	Procesverbali		Vendosur Detyrim (leke)
		Detyrim (lekë)	Nr.	Datë	
C	J	1,274,147	1556/96	31.07.2024	0
E	J	142,213	1168	12.06.2024	0
TOTAL		1,416,360			0

Për subjektin ‘‘C’’ është mbajtur procesverbali nr. 1556/96 prot., datë 31.07.2024 (bashkëlidhur), në të cilin grupi i punës ka konkluduar se artikujt objekt rivlerësimi janë klasifikuar në kreun *9603*, kurse indikatori 2.3 euro/kg është përcaktuar për kreun 39 të NKM dhe për artikujt e

klasifikuar në kodin *6305*. Për këtë arsye vlerësimi i kryer nga SVQ është i rregullt dhe nuk ka detyrime doganore shtesë.

Për subjektin ‘E’ është mbajtur Procesverbali nr. 1168 prot., datë 12.06.2024 (bashkëlidhur), në të cilin grupi i punës ka kokluduar se referuar të dhënave të disponueshme për artikullin ‘gota dhe pjata plastike nje përdorimshe’ vlera është 1.7-1.8 euro/kg nga vendet e BE-së. Në deklaratat e konstatuara është bërë ndërhyrje nga ana e doganierit të vlerës në qendër me cmim reference 1.7 euro/kg. Si përfundim, aplikimi i vlerës është i saktë dhe nuk ka detyrime doganore të papaguara. Në aneksin 2.6 është rekomanduar që subjekti ‘V’ sh.p.k me Nipt: K. të paguajë detyrimin doganor në shumën 15,587,728 lekë. Për zbatimin e këtij rekomandimi me shkresën nr. 794 prot., datë 16.04.2024 është paraqitur kërkesa për verifikimin e faturave pranë Drejtorisë së Informacionit në DPD, e cila me shkresën nr.24039/1 prot, datë 26.11.2024 ka kthyer përgjigje se si rezultat i verifikimeve të kryera Autoritetet Homologe Greke kanë konfirmuar vërtetësinë dhe autenticitetin e faturave të dërguara

Aneksi 2.7

Subjekti	Nipti	Rekomanduar	Vendim		Vendosur Detyrim (leke)
		Detyrim (lekë)	Nr.	Datë	
A	L	50,357	1556/146	15.10.2024	0
A	K	149,991	63	06.08.2024	139,162
A	J	194,906	65	06.08.2024	175,156
E	L	16,266	108	02.12.2024	14,551
E	K	7,865	1556/165	15.10.2024	7,371
F	J	8,229	1556/164	15.10.2024	7,638
H	L	2,532	1556/163	15.10.2024	2,317
J	K	1,664	1556/162	15.10.2024	1,473
M	L	4,642	109	02.12.2024	4,262
N	M	3,165	1556/160	15.10.2024	2,904
O	J	45,691	106	02.12.2024	42,264
U	J	16,446	107	02.12.2024	15,411
V	K	11,879	1556/157	15.10.2024	10,886
Y	L	1,979	1556/156	15.10.2024	1,840
TOTAL		512,048			425,235

Subjektet kanë arkëtuar shumat e detyrimit.

Për subjektin ‘A’ grupi i punës sipas procesverbalit nt. 1556/146 prot., datë 15.10.2024, ka kokluduar se referuar peshës së paletës ato janë paleta një përdorimshme. Paletat 23 kg shërbejnë për mbajtjen e mallrave me peshë të lehtë (si psh. Patatina) dhe 35 kg shërbejnë për mbajtjen e detergjentëve. Nga kontrolli ka rezultuar se vlera e mbajtësve të mallit ‘paleta’ nuk ka qenë në ngarkim të blerësit, pasi në faturë nuk ka vlerë për to. Sipas nenit 67/3 të Kodit Doganor: në përcaktimin e vlerës doganore nuk mund të bëhet asnjë shtesë çmimit realisht të paguar ose që duhet paguar, përveç rasteve të përmendura në këtë nen.

Aneksi 2.8

Subjekti	Nipti	Rekomanduar	Vendim		Vendosur Detyrim (leke)
		Detyrim	Nr.	Datë	
E	K	440,956	70	21.08.2024	287,243
TOTAL		440,956			287,243

Shuma e detyrimit është arkëtuar.

Në **aneksin 2.9** është rekomanduar që subjekti ‘A’ me Nipt: J. të paguajë detyrimin doganor në shumën 89,243 lekë. Për zbatimin e këtij rekomandimi ka dalë vendimi nr.111 datë 04.12.2024 duke vendosur detyrimin doganor në shumën 89,254, të cilën subjekti e ka arëktuar.

Aneksi 2.10

Subjekti	Nipti	Rekomanduar	Vendim	Vendosur
----------	-------	-------------	--------	----------

		Detyrim	Penalitet	Nr.	Datë	Detyrim	Penalitet
E	K	1,429,722	1,429,722	72	27.08.2024	3,955,500	0
TOTAL		1,429,722	1,429,722			3,955,500	

Subjekti ka arkëtuar shumën e detyrimit.

Aneksi 2.11

Për subjektin 'E' sh.a është mbajtur procesverbali nr. 1556/70 prot., datë 31.07.2024 (bashkëlidhur), sipas të cilit grupi i punës ka vendosur pranimin e cmimit të transaksionit, pas verifikimit të dokumentacionit shtesë të paraqitur nga ana e subjektit si: sëftet bankare, deklaratë konformitetit, kartela e furnitorit, faturat tatimore.

Aneksi 2.12

Subjekti	Nipti	Rekomanduar	Procesverbal		Vendosur Detyrim (leke)
		Detyrim (leke)	Nr.	Datë	
E	K	5,884,649	1556/71	31.07.2024	0
TOTAL		5,884,649			0

Për subjektin "E" sh.a është mbajtur procesverbali nr. 1556/71 prot., datë 31.07.2024, (bashkëlidhur), sipas të cilit grupi i punës ka vendosur pranimin e cmimit të transaksionit, pas verifikimit të dokumentacionit shtesë të paraqitur nga ana e subjektit.

Aneksi 2.13

Subjekti	Nipti	Rekomanduar	Procesverbal		Vendosur Detyrim (leke)
		Detyrim (leke)	Nr.	Datë	
E	K	996,760	1556/78	31.07.2024	0
TOTAL		996,760			0

Për subjektin "E" sh.a është mbajtur procesverbali nr. 1556/78 prot., datë 31.07.2024, (bashkëlidhur), sipas të cilit grupi i punës ka vendosur pranimin e cmimit të transaksionit, pas verifikimit të dokumentacionit shtesë të paraqitur nga ana e subjektit.

Aneksi 2.14

Subjekti	Nipti	Rekomanduar	Procesverbal		Vendosur Detyrim (leke)
		Detyrim (leke)	Nr.	Datë	
E	K	7,999,787	1556/69	31.07.2024	0
TOTAL		7,999,787			0

Pas verifikimit të dokumentacionit shtesë të paraqitur nga ana e subjektit, Grupi i Punës ka pranuar cmimin e transaksionit sipas procesverbalit nr. 1556/69 prot., datë 31.07.2024, (bashkëlidhur).

Në **aneksin 2.15** është rekomanduar që subjekti "E" sh.p.k me Nipt: K. të paguajë detyrimin doganor në shumën 262,055 lekë. Për zbatimin e këtij rekomandimi ka dalë Vendimi nr.119, datë 13.12.2024 në të cilën është vendosur pagesa e detyrimit doganor në shumën 249,335 lekë, të cilën subjekti e ka arëktuar.

Aneksi 2.16

Subjekti	Nipti	Rekomanduar	Vendim/Procesverbal		Vendosur Detyrim (leke)
		Detyrim (leke)	Nr.	Datë	
E	K	377,824	57	06.08.2024	109,272
T	K	328,993	89	17.10.2024	95,080
TOTAL		706,817			204,352

Lidhur me subjektin 'E', grupi i auditimit pranë Kontrollit të Lartë të Shtetit ka konstatuar 4 praktika doganore, në të cilat ka kryer rivlerësim të artikujve. Në vijim të kontrollit të ushtruar dhe Vendimit nr. 57, datë 06.08.2024 ka rezultuar se në deklaratat R.19243, datë 03.11.2021 dhe R.3644, datë 04.03.2022 nuk ka detyrime doganore shtesë, pasi nga Sektori i Vlerës në Qendër është rivlerësuar artikulli duke shtuar 29% të vlerës së telit të çelikut, sipas vlerave të publikuara nga DPD me shkresat nr.19360 prot, datë 29.10.2021 dhe nr.4232 prot, datë 28.02.2022.

Për deklaratën IM4 me R.4153, datë 17.03.2021 dhe R.9174, datë 01.06.2021 është kryer rivlerësimi i produktit duke shtuar 29% të vlerës së telit të çelikut të publikuar përkatësisht me shkresat nr.4973 prot, datë 12.03.2021 dhe nr.9494 prot, datë 28.05.2021.

Lidhur me subjektin “**T**”, grupi i auditimit pranë Kontrollit të Lartë të Shtetit ka konstatuar 4 praktika doganore, në të cilat ka kryer rivlerësim të artikujve. Në vijim të kontrollit të ushtruar dhe Vendimit nr.89, datë 17.10.2024 ka rezultuar se në deklaratat R.1622, datë 31.01.2022 dhe R.15011, datë 30.08.2022 nuk ka detyrime doganore shtesë, pas inga Sektori i Vlerës në Qendër është rivlerësuar artikulli duke shtuar 29% të vlerës së telit të çelikut, sipas vlerave të publikuara nga DPD me shkresat nr.1740 prot, datë 28.01.2022 dhe nr.15503 prot, datë 29.08.2022.

Për deklaratën IM4 me R.613, datë 18.01.2021 dhe R.8332, datë 21.05.2021 është kryer rivlerësimi i produktit duke shtuar 29% të vlerës së telit të çelikut të publikuar përkatësisht me shkresat nr.869 prot, datë 15.01.2021 dhe nr.8562 prot, datë 12.05.2021. *Keta subjekte kane arketuar Shumen e detyrimit doganor.*

Për rastet e konstatuara sipas aneksit 2.17, në vijim të shkresave nr. 1556/120 prot, datë 12.09.2024 dhe nr.1556/228 prot, datë 13.11.2024, për shkak të numrit të lartë të deklaratave për periudhën 2021-2022, kemi kërkuar pranë jush përcaktimin e numrit R të deklaratave doganore, pasi grupi i punës e ka të pamundur identifikimin e tyre. Aneksi 2.18

Subjekti	Nipti	Rekomanduar	Procesverbal		Vendosur Detyrim (leke)
		Detyrim (leke)	Nr.	Datë	
A	K	331,621	1147	11.06.2024	0
TOTAL		331,621			0

Pas verifikimit të deklaratave, Grupi i Punës ka mbajtur procesverbalin nr. 1147 prot., datë 11.06.2024 (bashkëlidhur), sipas të cilit vlera e mallrave të deklaruar në DAV-et përkatëse janë më të larta se të dhënat e disponueshme. Për këtë arsye është pranuar transaksioni.

Aneksi 2.20

Subjekti	Nipti	Rekomanduar	Procesverbali		Vendosur Detyrim (leke)
		Detyrim (lekë)	Nr.	Datë	
R	L	114,392	1149	11.06.2024	0
T	K	112,679	1148	11.06.2024	0
A	K	35,103	1556/148	15.10.2024	0
I	K	35,505	1556/149	15.10.2024	0
TOTAL		297,678			0

Për subjektin ‘**R**’ *sh.a* grupi i punës ka konstatuar se vlera e mallit e deklaruar është 609,750 lekë, pra është më e lartë se cmimi i të dhënave të disponueshme të përcaktuar në Udhëzimin e Ministrit të Financve nr.03, datë 23.01.2018, prej jo më pak 600,000 lekë për kamiona me kapacitet 1.5-3.5 ton. Për këtë arsye është pranuar cmimi i deklaruar nga subjekti.

Për subjektin ‘**T**’ është konstatuar se vlera e aplikuar nga sektori i vlerës në qendër është në përputhje me Udhëzimin e Ministrit të Financve nr. 03, datë 23.01.2018 dhe si rezultat nuk ka detyrime doganore shtesë.

Për subjektin ‘**A**’ me Nipt: K, grupi i punës ka konstatuar se vlera e aplikuar nga sektori i vlerës në qendër është në përputhje me Udhëzimin e Ministrit të Financve nr.03, datë 23.01.2018 dhe si rezultat nuk ka detyrime doganore.

Për subjektin ‘**I**’ *sh.p.k* me Nipt: K grupi i punës ka konstatuar se vlera e mallit e deklaruar është më e lartë se cmimi 124t ë dhënave të disponueshme. Për këtë arsye është pranuar çmimi i deklaruar nga subjekti.

Aneksi 2.21

Subjekti	Nipti	Rekomanduar	Vendim		Vendosur Detyrim (leke)
		Detyrim (leke)	Nr.	Datë	
A	L	576,308	58	06.08.2024	578,554
TOTAL		576,308			578,554

Subjekti ka arkëtuar shumën e detyrimit.

Aneksi 2.22

Subjekti	Nipti	Rekomanduar	Vendim/ Procesverbali		Vendosur Detyrim (leke)
		Detyrim (leke)	Nr.	Datë	
J	K	81,836	75	26.09.2024	37,199
A	K	374,422	62	06.08.2024	160,881
E	K	1,033,233	64	06.08.2024	939,433
E	L	78,681	1556/73	31.07.2024	0
I	K	71,555	1556/80	31.07.2024	65,049
A	K	356,143	92	25.10.2024	327,354
B	L	38,980	79	26.09.2024	36,357
C	L	98,007	80	26.09.2024	54,212
K	L	338,111	83	02.10.2024	355,179
G	L	546,475	74	26.09.2024	25,389
M	L	47,694	76	26.09.2024	43,358
F	M	314,668	81	02.10.2024	191,697
M	M	52,124	84	02.10.2024	30,570
V	L	569,190	87	17.10.2024	414,618
M	L	170,105	105	27.11.2024	157,119
B	L	37,584	104	27.11.2024	28,819
TOTAL		4,208,808			2,867,234

Subjektin **'J'** është shpallur debitor sipas Vendimit nr. 75, datë 26.09.2024 në shumën 37,199 lekë. Grupi i punës pranë Degës së Doganës Kakavije ka zbatuar rekomandimin e lënë dhe ka rivlerësuar 3 deklarata sipas aneksit 2.22. Shuma e detyrimit e vendosur sipas vendimit nr.75, datë 26.09.2024 është më e ulët se shuma e rekomanduar për arsye se nga grupi i auditimit pranë KLSH-së, një deklaratë është rivlerësuar dy herë.

Subjekti **'Ç' sh.p.k** është shpallur debitor me Vendimin nr. 80, datë 26.09.2024. Sipas këtij vendimi në deklaratat doganore me R.2177, datë 13.02.2021; R.905, datë 23.01.2021 dhe R.2450, datë 19.02.2021, referuar faturave tregtare shpenzimet e transportit janë deklaruar veçmas nga vlera e mallit. Vlera totale e tyre është pasqyruar në kuadratin '22' të DAV-it mbi të cilën janë llogaritur dhe arkëtuar nga detyrimet doganore. Për këtë arsye, në këto deklarata nuk ka detyrime doganore të papaguara.

Për deklaratat doganore me R.5917, datë 14.04.2021; R.5503, datë 08.04.2021; R.407, datë 14.01.2021 dhe R.6169, datë 17.04.2021, janë rrillogaritur detyrimet doganore duke shtuar shpenzimet e transportit sipas vlerave të pasqyruara në faturë.

Lidhur me subjektin **'G' sh.p.k**, grupi i auditimit pranë Kontrollit të Lartë të Shtetit ka konstatuar 37 deklarata doganore në të cilat ka kryer rivlerësim duke shtuar shpenzimet e transportit. Në vijim të kontrollit të ushtruar dhe Vendimit nr.74, datë 26.09.2024 ka rezultuar se vetëm në deklaratën doganore me R.2770, datë 16.02.2022 janë shtuar shpenzimet e transportit dhe është kryer rivlerësim doganor.

Për deklaratat e tjera në të cilat kushtet e lëvrimit janë DAP, vlera e transportit është pasqyruar në faturë e ndarë nga vlera e mallit. Shuma totale e tyre është deklaruar në kuadratin '22' të DAV-it, mbi të cilën janë llogaritur dhe paguar detyrimet doganore nga ana e subjektit.

Lidhur me subjektin **'F' sh.p.k** grupi i auditimit pranë Kontrollit të Lartë të Shtetit ka konstatuar 19 deklarata doganore në të cilat ka kryer rivlerësim duke shtuar shpenzimet e transportit.

Në vijim të kontrollit të ushtruar dhe Vendimit nr.81, datë 02.10.2024 është konstatuar se në deklaratat doganore me R.205, datë 09.01.2021; R.16652, datë 27.09.2022; R.16896, datë 30.09.2022; R.21413, datë 09.12.2021; R.21562, datë 21.12.2022; R.6536, datë 21.04.2022 dhe R.6393, datë 20.04.2022, shpenzimet e transportit janë pasqyruar në faturë të ndara nga vlera e mallit. Shuma totale e tyre është deklaruar në kuadratin '22' të DAV-it, mbi të cilën janë llogaritur dhe paguar detyrimet doganore nga ana e subjektit.

Në deklaratat e tjera në të cilat kushtet e lëvrimit janë CPT, janë rillogaritur detyrimet doganore duke shtuar shpenzimet e transportit sipas vlera të pasqyruara në faturë.

Lidhur me subjektin **'V' sh.p.k** i shpallur debitor me Vendimin nr.87, datë 17.10.2024 rezulton se në deklaratat doganore në të cilat kushtet e lëvrimit janë DAP vlera e transportit është pasqyruar në faturë e ndarë nga vlera e mallit. Shuma totale e tyre është deklaruar në kuadratin '22' të DAV-it, mbi të cilën janë llogaritur dhe paguar detyrimet doganore nga ana e subjektit.

Në deklaratat në të cilat kushtet e lëvrimit janë në inkotermin CPT, grupi i punës ka llogaritur shpenzimet e transportit sipas vlerave të pasqyruara në faturë. Si rrjedhojë e rivlerësimit kanë rezultuar detyrime doganore shtesë në shumën 414,618 lekë.

Subjektin **'M' sh.p.k** është shpallur debitor me Vendimin nr.105 datë 27.11.2024. Sipas konstatimit të grupit të punës është kryer rivlerësim i 10 deklaratave doganore duke shtuar shpenzimet e transportit sipas vlerave të pasqyruara në faturë. Si rrjedhojë e rivlerësimit kanë rezultuar detyrime doganore shtesë në shumën 157,119 lekë.

Aneksi 2.23

Subjekti	Nipti	Rekomanduar	Vendim		Vendosur Detyrim (leke)
		Detyrim (leke)	Nr.	Datë	
V	K	122,976	82	02.10.2024	121,204
F	L	136,640	61	06.08.2024	132,262
TOTAL		259,616			253,466

Subjektet kanë arkëtuar shumën e detyrimit doganor.

Aneksi 2.24

Subjekti	Nipti	Rekomanduar		Vendim/Procesverbal		Vendosur	
		Detyrim (leke)	Penalitet (leke)	Nr.	Datë	Detyrim	Penalitet
S	M	32,658	32,658	77	26.09.24	32,657	32,657
A	K	48,742	48,742	1556/153	15.10.2024	0	0
TOTAL		81,400	81,400			32,657	32,657

Lidhur me subjektin **'A'** grupi i punës ka mbajtur procesverbalin nr. 1556/153 prot., datë 15.10.2024 në të cilin ka konkluduar që subjekti nuk ka kryer keqklasifikim të produktit referuar rregullit 3/c të Sesionit I të NKM si dhe klasifikimit të këtij produkti nga BTI dhe për këtë arsye nuk ka detyrime doganore të papaguara.

Aneksi 2.25

Subjekti	Nipti	Rekomanduar	Vendimi/Procesverbal		Vendosur Detyrim+penalitet (leke)
		Detyrim + penalitet (leke)	Nr.	Datë	
A	K	784,247	1556/95	31.07.2024	0
C	K	1,137,757	1556/98	31.07.2024	0
E	K	394,222	113	10.12.2024	40,000
TOTAL		2,316,226			40,000

Lidhur me subjektin **'A'** grupi i punës ka mbajtur procesverbalin nr. 1556/95 prot., datë 31.07.2024 në të cilin ka konkluduar që klasifikimi tarifor është në përputhje me dokumentacionit të paraqitur nga subjekti dhe NKM, si rezultat gjendet i pazbatuar rekomandimi i KLSH-së.

Lidhur me subjektin **'C'** grupi i punës ka mbajtur procesverbalin nr. 1556/98 prot., datë 31.07.2024 në të cilin ka konkluduar që klasifikimi tarifor është në përputhje me dokumentacionit të paraqitur nga subjekti dhe NKM, si rezultat gjendet i pazbatuar rekomandimi i KLSH-së.

Lidhur me subjektin **'E'** grupi i punës ka mbajtur procesverbalin nr. 1556/192 prot., datë 31.10.2024 në vijim të të cilin ka dalur Vendimi me nr. 113, datë 10.12.2024, në të cilin është

vendosur penalizimi subjektit, me arsyetimin se subjekti nuk ka deklaruar saktë kodin tarifor të mallit. Si rezultat i keqklasifikim nuk ka detyrime doganore shtesë.

Aneksit 2.26

Subjekti	Nipti	Rekomanduar	Vendimi/Procesverbal		Vendosur Detyrim+penalitet (leke)
		Detyrim + penalitet (leke)	Nr.	Datë	
E	K	73,784	112	10.12.2024	49,708
TOTAL		73,784			49,708

Lidhur me zbatimin e **aneksit 2.26**, për subjektin ‘E’ sh.a me Nipt K., bazuar në procesverbalin nr.1556/151, datë 10.12.2024 dega doganore ka dalë me vendimin nr.112 datë 10.12.2024 duke vendosur pagesën e detyrimit doganor në shumën 24,854 lekë dhe penalizim në shumën 24,854 lekë. Me arsyetimin se subjekti ka kryer keqklasifikim të artikullit ku sipas kodit të ri kodit tarifor duhej që të paguante taksën doganore 10 % ky deklarim i gabuar i kodit tarifor është klasifikuar, si kundravajtje administrative me përgjegjësi objektive sipas nenit 251 pika 2 A dhe është penalizuar sipas nenin 256 pika 1 a me njëfish të detyrimit. Shuma totale është 49,708 lekë, e cila është arkëtuar nga subjekti.

Aneksit 2.27

Lidhur me **aneksin 2.27**, për subjektin “D”, grupi i kontrollit ka mbajtur procesverbalin nr.1556/152 prot, datë 15.10.2024 në të cilin ka konkluduar se klasifikimi i produktit “solvent” në kodin tarifor *38140090* është i rregullt. Referuar nenit 50 të ligjit nr.61/2012 ‘Për Akcizat’, i ndryshuar, konsiderohen produkte energjitike produktet e mëposhtme:

- a) që klasifikohen në kodin NK 3811
- b) që klasifikohen në kodin NK 3817
- c) që klasifikohen në kodin NK 382600

Referuar bazës ligjore të mësipërme, solventet nuk klasifikohen si produkte energjitike dhe për rrjedhojë nuk paguajnë akcizë.

Qëndrimi i grupit të auditimit: Grupi i auditimit, pasi shqyrtoi dokumentet që ju vendosën në dispozicion nga institucioni, e konsideron rekomandimin të pranuar dhe i zbatuar pjesërisht.

Ky rekomandim rezulton i pranuar dhe zbatuar pjesërisht.

2.1 Rekomandimi:-Dega Doganore Kakavijë në vijim të procedurave të mëtejshme, të marrë masa e nevojshme, duke ndjekur rradhën e procesit ligjor të vlerësimit doganor, për vendim- marrjen, kontabilizimin dhe më pas arkëtimin e detyrimeve doganore në shumën 25,153 mijë lekë (detyrim dhe penalitet) për periudhën nga data 01.01.2021 deri në datën 31.12.2022 që lidhet me rillogaritje pagesash detyrime doganore në import për të cilat nuk është vepruar në përputhje me kuadrin ligjor, nënligjor dhe rregullator përkatës, sipas listës në aneksin nr. 2.19 të këtij raporti.

Pretendimi i subjektit:

Aneksi 2.19

Subjekti	Nipti	Vendim		Vendosur Detyrim (leke)
		Nr.	Datë	
K	J	06	13.01.2025	17,256,296
K	L	126/1	10.02.2025	243,853
M	L	02/1	04.02.2025	4,896,039
A	K	03/1	04.02.2024	702,041
K	L	125	19.12.2024	141,454
G	K	122	19.12.2024	106,036
A	K	120	16.12.2024	22,841
H	L	121	16.12.2024	23,860
TOTAL				23,392,420

Lidhur më subjektin K. është mbajtur procesverbal me nr.1556/198 prot., datë 31.10.2024 në të cilin është konkluduar se pagesa e detyrimit është 19,097 mijë lekë. Për këtë procesverbal subjekti ka paraqitur ankim protokolluar në DEGA DOGANORE KAKAVIJË me nr. 1556/230 prot., datë 18.11.2024. Dega Doganore ka pranuar pjesërisht ankimin pasi disa nga deklaratat janë parashkruar dhe për rrjedhojë nuk mund të qëndrojnë vlera sipas procesverbalit. Vlera detyrimit doganor ka rezultuar në shumën 17,256 mijë lekë. Për subjektin 'K' Dega Doganore Kakavijë ka dalur me vendimin nr.126, datë 19.12.2024 për shumën 359 mijë lekë detyrim doganor, ky vendim është rishikuar kryesisht nga Dega Doganore Kakavijë me nr. 126/1 datë 10.02.2025 duke anuluar pjesërisht vendimin fillestar për parashkrim të borxhit doganor, në përfundim ka vendosur pagesën e detyrimit në shumën 243 mijë lekë. Për subjektin 'M' dhe 'A' referuar kërkesave të subjekteve nr. 1556/277 prot., datë 30.01.2025, nr. 1556/279 prot., datë 30.01.2025, Dega Doganore Kakavijë ka rishikuar vendimmarrjen fillestare dhe ka vendosur anulimin pjesërisht të vendimeve, pasi një pjesë e borxhit doganor në vlerën 2,647 mijë lekë është parashkruar (vendimet bashkëngjitur). Të gjithë subjektet e mesipërme kanë arketuar shumën e detyrimit.

Qëndrimi i grupit të auditimit: Grupi i auditimit, pasi shqyrtoi dokumentat që ju vendosën në dispozicion nga institucioni, e konsideron rekomandimin të pranuar dhe të zbatuar pjesërisht, pasi dega doganore ka rishikuar vendimmarrjen fillestare dhe ka vendosur anulimin pjesërisht të vendimit, pasi një pjesë e borxhit doganor është parashkruar.

Ky rekomandim rezulton i pranuar dhe zbatuar plotësisht.

3.1 Rekomandimi:-Dega Doganore Kakavijë të marrë të gjitha masat e duhura ligjore dhe administrative sipas legjislacionit në fuqi me qëllim ndjekjen, kontabilizimin dhe arkëtimin e sanksioneve doganore për arkëtimin e shumës së rekomanduar në shumën **93,631** lekë për 4 raste trajtuar më hollësisht në materialin e Raportit të Auditimit si dhe të kërkojë procedure eksporti të detyrueshëm ose dhënie destinacioni malli për përfitim statusi shqiptar në 15 raste Vendime Administrative të nxjerra për vitin 20121 dhe 2022 që lidhen me konstatimet e trajtuara për shkeljen e afatit të rrëgjimit RLP për mallra të natyrës autovetura.

Pretendimi i subjektit: Dega Doganore Kakavijë për tre vendime dhe konkretisht për vendimet **nr. 16, datë 14.05.2021 ; vendimi nr. 23, datë 03.06.2021 dhe vendimi nr. 26, datë 09.06.2021** të cilat kanë diferencë peshe në deklaram janë klasifikuar si shkelje me përgjegjësi objektive sipas neneve 250/1/a,251/2/a dhe janë penalizuar sipas nenit 256/1/a. Po e njëjta bazë ligjore është aplikuar edhe **për vendimin nr. 25, datë 09.06.2021** në cilin është konsultuar se në deklaramin e tij ka mallra të rinj të cilët i ka deklaruar si të përdorur, duke e klasifikuar si një cilësi të ndryshme nga ajo e deklaruar .

Këto vendime referuar Raportit Përfundimtar duhen klasifikuar si shkelje sipas nenit 252 /d dhe penalizimin sipas nenit 257 /1/a.

Në çastin e vendimmarrjes dogana është bazuar te neni Neni 251/2/a me titullin “**Kundërvajtjet me përgjegjësi objektive**” që parashikon: 2. *Pa çënuar dispozitat për kontrabandën, veprimet ose mosveprimet e mëposhtme përbëjnë kundërvajtje me përgjegjësi objektive: a) mosrespektimi nga personi, që depoziton deklaramin doganore, deklaramin e magazinimit të përkohshëm, deklaramin përmbledhëse të hyrjes, deklaramin përmbledhëse të daljes dhe deklaramin e riekportit ose njoftimin e riekportit, i detyrimit për të siguruar saktësinë dhe plotësimin e informacioneve të dhëna në deklaramin, njoftim apo aplikim, në përputhje me shkronjën “a”, të pikës 2, të nenit 23;* Në rast se konstatohet mosrespektimi nga personi që depoziton deklaramin doganore, deklaramin e magazinimit të përkohshëm, deklaramin përmbledhëse të hyrjes, deklaramin përmbledhëse të daljes

dhe deklaratën e rieksporit ose njoftimin e rieksporit, *i detyrimit për të siguruar saktësinë dhe plotësimin e informacioneve të dhëna në deklaratë*, njoftim apo aplikim, në përputhje me shkronjën (a), të pikës 2, të nenit 23 (parashikuar në nenin 251 (2)(a), aplikohet sanksion sipas nenit 256, të Kofit Doganor.

Konkretisht, për zbatimin e nenit 251 të Kodit Doganor, nga autoritetet doganore që kryejnë kontrollin verifikohet/rishikohet deklarata doganore (në kuadër të vendosjes së mallrave në qarkullim të lirë) qoftë në momentin e zhdoganimit apo pas zhdoganimit dhe llogaritet diferenca ndërmjet detyrimeve të importit të verifikuara nga autoritetet doganore dhe atyre të deklaruara. Kur kundravajtja ka të bëjë me mallrat dhe konstatohen ndryshime në sasi, vlerë, origjinë. Lloj, që sjell diferenca në pagesën e detyrimeve që duhen paguar për mallrat, zbatohet sanksion në masën 1-fish të detyrimit të munguar duke paguar edhe shumën e plotë të detyrimeve doganore që duheshin paguar.

Neni 252/d, parashikon shprehimisht mungesën e veprimit për përmbushje të *“detyrimit për të paraqitur mallrat”*, fakt që në rastet konkrete nuk ka ndodhur, pra detyrimi për paraqitje të mallrave është përmbushur, nga ana e subjektit me depozitim të deklaratës doganore.

Nga leximi i dispozitës së nenit 251/2/a, jemi në kushtet kur tashmë është përmbushur detyrimi për depozitim të deklaratës, veprim i cili gjithmonë **paraprihet nga paraqitja e mallrave para autoritetit doganor.** Pra si përfundim, fakti konkret i mospërputhjes së sasisë, ka ndodhur pasi mallrat janë paraqitur në doganë dhe pasi subjekti ka depozituar deklaratën doganore, pra duke qenë se veprimi i dytë “depozitimi i deklaratës” është veprim që ndodh pas paraqitjes së mallrave në doganë, rrjedhimisht në interpretim logjik të dispozitave dhe të fakteve, rezulton se detyrimi për paraqitje të mallrave në doganë të jetë përmbushur para veprimit për depozitim deklarate.

Për sa më sipër, vendimmarrja e doganës është në përputhje me kërkesat e nenit 251/2/a dhe 256/1/a të Kodit Doganor. Si rezultat ky rekomandim nuk realizohet.

Lidhur me Vendimet Administrative për thyerjen e regjimit RLP për autoveturat, është konstatuar se nuk është nxjerrë pikë vendimi për kryerje procedurë eksporti të detyrueshëm ose dhënie destinacioni malli për përfitimin e statusit shqiptar.

Referuar dokumentacionit të administruar, për rastet e konstatuara është dhënë destinacion mallit nëpërmjet daljes nga territori shqiptar, të vërtetuar nga të dhënat e sistemit TIMS.

Subjekti “T” me ID. e shpallur debitor me Vendimin nr.14, datë 01.04.2022 ka zhdoganuar autoveturën me deklaratën doganore IM4 me R.5186, datë 31.03.2022.

Qëndrimi i grupit të auditimit: Grupi i auditimit, pasi shqyrtoi dokumentat që ju vendosën në dispozicion nga institucioni, në lidhje me masat e duhura ligjore dhe administrative sipas legjislacionit në fuqi me qëllim ndjekjen, kontabilizimin dhe arkëtimin e sanksioneve doganore për arkëtimin e shumës së rekomanduar në shumën **93,631** lekë për 4 raste trajtuar më hollësisht në materialin e Raportit të Auditimit, e konsideron të pranuar, ndërsa në lidhje me dhënie destinacioni malli për përfitim statusi shqiptar në 15 raste Vendime Administrative të nxjerra për vitin 2021 dhe 2022 që lidhen me konstatimet e trajtuara për shkeljen e afatit të rrëgjimit RLP për mallra të natyrës autovetura e konsideron të pranuar dhe të zbatuar pjesërisht.

Ky rekomandim rezulton i pa pranuar dhe i pa zbatuar.

4.1 Rekomandimi: Dega e Doganës Kakavijë referuar mangësive dhe parregullsive të mësipërme vlerësuar me efekte negative në të ardhurat doganore, të marrë masat e nevojshme për arkëtimin e të ardhurave të munguara në buxhetin e shtetit parashikuar nga neni 259 pika c e KD, të evidentuara në vlerën prej **1,605 mijë lekë, nga të cilat detyrime në vlerën 1,485 mijë lekë dhe penalteti prej 120 mijë lekë.**

Pretendimi i subjektit:

Subjekti	Nipti	Rekomanduar		Vendim		Vendosur	
		Detyrim (leke)	Penalitet (leke)	Nr.	Datë	Detyrim	Penalitet
V	K	756,493	20,000	94	30.10.2024	0	20,000
C	L	0	20,000	95	30.10.2024	0	20,000
D	L	235,817	40,000	115	10.12.2024	49,444	0
G	K	32,260	20,000	114	10.12.2024	0	20,000
Ë	L	460,000	20,000	110	10.12.2024	40,211	80,422
TOTAL		1,484,570	120,000			89,655	140,422

Lidhur me subjektin “**V**” *sh.p.k* i cili është shpallur debitor me Vendimin nr. 94, datë 30.10.2024, është konstatuar se pas rakordimeve të kryera nuk kanë rezultuar diferenca në sasi, peshë dhe vlerë, duke e mbyllur Autorizimin nr. 10543/1 prot., datë 07.04.2020 me gjendje 0. Gjatë kontrollit janë konstatuar gabime në akt-rakordimet e kryera të cilat nuk sjellin efekte financiare, por këto pasaktësi përbëjnë kundravajtje administrative sipas nenit 259/1/b të Kodit Doganor.

Për subjektin “**D**” *sh.p.k* është mbajtur Vendimi nr. 115, datë 10.12.2024. Sipas këtij vendimi është konstatuar se në Autorizimin nr. 11951/1 prot., datë 22.10.2020, rezulton sasia gjendje prej 24,252.16 kg (mbetje letre+kartoni), kurse sipas Autorizimit nr.5238/1, datë 28.10.2021, rezulton gjendje sasia 26,765.75 kg. Për sasinë totale prej 51,017.91 kg (mbetje letre+kartoni) është vendosur pagesa e detyrimit doganor në shumën 49,444 lekë. Subjekti ka arketuar shumën e detyrimit doganor.

Për subjektin “**G**” *sh.p.k* është mbajtur vendimi nr. 114, datë 10.12.2024. Sipas vendimit rezulton se në mbyllje të autorizimit nr.432/1 prot., datë 26.02.2020, nuk ka diferenca në peshë, sasi dhe vlerë. Gjatë kontrollit janë konstatuar gabime në plotësimin e deklaratave doganore sipas faturave tregtare. Për këto pasaktësi në deklaram është vendosur penalizimi i subjektit në shumën 20,000 lekë, referuar nenit 256/1/b të Kodit Doganor, e cila është arkëtuar nga ana e subjektit.

Lidhur me subjektin “**Ë**” *sh.p.k* është mbajtur vendimi nr. 110, datë 04.12.2024, sipas këtij vendimi, referuar koeficientit të shfrytëzimit 17% të deklaruar nga subjekti në kartën teknologjike ka rezultuar sasia prej 13,866 kg dru gjendje, të cilës nuk i është dhënë destinacion doganor. Për këtë arsye, grupi i punës ka vendosur pagesën e detyrimit doganor për këtë sasi në shumën 40,211 lekë dhe penalizimin me 2-fish të detyrimit në shumën 80,422 lekë, referuar nenit 252/c dhe 257/1/a të Kodit Doganor. Shuma e borxhit doganor është arkëtuar nga subjekti.

Qëndrimi i grupit të auditimit: Grupi i auditimit, pasi shqyrtoi dokumentat që ju vendosën në dispozicion nga institucioni, rezulton se Dega Doganore Kakavijë ka pranuar rekomandimin dhe nga ana e DDK janë nxjerrë vendimet për shpallje debitor të subjekteve të trajtuara në rekomandim, por vlerat e evidentuara nga KLSH janë më të larta se vlerat e shpallura debitor nga Dega Doganore Kakavijë sipas vendimeve të marra, ndërsa në lidhje me arktimin e shumë së kërkuar rezulton se vlerat e shpallur si debi nuk është arkëtuar plotësisht.

Ky rekomandim rezulton i pranuar dhe i zbatuar pjesërisht.

D. Mbi zbatimin e rekomandimeve për masat disiplinore. Fillimi i procedurave për dhënien e masave disiplinore dhe administrative. Sa rekomandime janë pranuar dhe ecuria e tyre për masat e dhëna.

Mbështetur në nenin 59, pika 4, shkronja “a” dhe “b”, të ligjit nr. 152/2013 “Për nëpunësin civil” të ndryshuar, në ligjin nr. 102/2014 datë 31.7.2014 “Kodi Doganor i Republikës së Shqipërisë” i ndryshuar, neni 13, pika 3, si dhe në VKM-në nr.115, datë 05.03.2014 “Për përcaktimin e procedurës disiplinore dhe të rregullave për krijimin, përbërjen e vendimmarrjen në komisionin disiplinor në shërbimin civil”, i rekomandojmë Kryetarit të Degës Doganore Kakavijë dhe

Drejtorit të Përgjithshëm të Doganave që në vlerësimin e shkeljeve të konsideruara nga ana jonë, sipas pikës 1 të nenit 57 të ligjit nr. 152/2013, të urdhërojë fillimin e procedurave përkatëse për shqyrtimin dhe dhënien e masave disiplinore për personat e cilësuar përgjegjës në Raportin Përfundimtar të Auditimit.

Pretendimi i subjektit: Lidhur me fillimin e procedurës disiplinore për punonjësit e Degës Doganore Kakavijë informojmë si më poshte:

- E.S. ka ndërprerë marrdhëniet e punës me DPD-në.
- A.A. është i pezulluar me Vendimin e Komisionit Disiplinor nr. 2350885, datë 24.12.2023.
- E.S. është i pezulluar me Vendimin e Komisionit Disiplinor nr. 23508/1, datë 24.12.2023.
- B.M. është i pezulluar me Vendimin e Komisionit Disiplinor nr.25331/1, datë 05.12.2024.
- I.H. është me masë sigurie ‘arrest në burg’ sipas urdhrit të Prokurorisë së Posacme kundër Korrupsionit dhe Krimin të Organizuar.
- K. G. është me urdhër arresti nga Prokuroria e Posacme kundër Korrupsionit dhe Krimin të Organizuar.
- Punonjësit D. M., B.P., K.G. dhe A.Q. nuk janë në marrdhënie pune prane Dega Doganore Kakavijë, pasi janë transferuar.
- Për pjesën tjetër të punonjësve të evidentuar në raport për shkelje të konstatuara lidhur me shërbimin e skanimit, dogana ka nxjerrë aktin nr.1008 prot, datë 18.07.2025 sipas të cilit i ngarkon me përgjegjësi disiplinore nëse nuk respektohen kërkesat për skanim, plotësimin e urdhrit të skanimit, regjistrin të skanimit dhe mbajtja e procesverbaleve. Zbatimi i kësaj shkrese do të monitorohet në vazhdimësi.

Lidhur me fillimin e procedimit disiplinor për doganierët e Sektorit të Vlerësimit në Qendër, në zbatim të nenit 59, pika 4, gërma a) të ligjit nr.152/2013 ‘Për nëpunësin civil’, i ndryshuar, është Drejtori i Vlerës në Qendër në cilësinë e eprorit direkt i cili urdhëron fillimin e procedimit disiplinor pranë Komisionit të Disiplinës.

Qëndrimi i grupit të auditimit: Grupi i auditimit, pasi shqyrtoi dokumentat që ju vendosën në dispozicion nga institucioni, e konsideron rekomandimin të pranuar dhe të zbatuar

Ky rekomandim rezulton i pranuar dhe zbatuar plotësisht.

KONKLUZIONI I AUDITIMIT

Nga verifikimi i dokumentacionit konstatohet se niveli i pranimeve dhe zbatimit të rekomandimeve të lëna nga KLSH me shkresën nr. 858/20 prot., datë 05.03.2024., është si më poshtë:

- Për përmirësimin e gjendjes janë lënë 15 rekomandime “Masa organizative”, të cilat janë pranuar dhe kanë statusin e ecurisë së zbatimit si vijon: 13 të zbatuara plotësisht dhe 2 zbatuar pjesërisht;
- Për përmirësimin e gjendjes janë lënë 4 rekomandime “Masa për eliminimin e efekteve financiare”, nga të cilat 3 janë pranuar dhe 1 nuk është pranuar. Nga të pranuarat statusi i ecurisë së zbatimit është: 1 masë zbatuar plotësisht dhe 2 masa zbatuar pjesërisht;
- Për përmirësimin e gjendjes është lënë 1 “Masë Disiplinore” e pranuar dhe e zbatuar plotësisht.

IV. GJETJE DHE REKOMANDIME

Për sa më sipër, rikërkojmë Degës Doganore Kakavijë të marrin të gjitha masat e nevojshme me qëllim zbatimin e të gjitha rekomandimeve që rezultojnë të pazbatuar dhe pjesërisht zbatuar, si

dhe përshpejtimin e zbatimit të rekomandimeve, të cilat rezultojnë në proces zbatimi, brenda 6-mujorit të parë të vitit 2025.

MASA PËR ELIMIMIN E EFEKTEVE NEGATIVE TË KONSTATUARA NË ADMINISTRIMIN E FONDEVE PUBLIKE DHE PËR MENAXHIMIN ME EKONOMICITET, EFICENCE DHE EFEKTIVITET TË TYRE, SI DHE MUNGESË TË ARDHURASH.

3.1 Rekomandimi:-Dega Doganore Kakavijë të marrë të gjitha masat e duhura ligjore dhe administrative sipas legjislacionit në fuqi me qëllim ndjekjen, kontabilizimin dhe arkëtimin e sanksioneve doganore për arkëtimin e shumës së rekomanduar në shumën **93,631** lekë për 4 raste trajtuar më hollësisht në materialin e Raportit të Auditimit si dhe të kërkojë procedure eksporti të detyrueshëm ose dhënie destinacioni malli për përfitim statusi shqiptar në 15 raste Vendime Administrative të nxjerra për vitin 2021 dhe 2022 që lidhen me konstatimet e trajtuara për shkeljen e afatit të rrëgjimit RLP për mallra të natyrës autovetura.

3.5 DREJTORIA RAJONALE FIER

I. PËRMBLEDHJE

Kontrolli i Lartë i Shtetit, ushtroi auditimin tematik në Drejtorinë Rajonale Tatimore Fier, me objekt “Për zbatimin e rekomandimeve të lëna në auditimet e evaduara në vitin 2024”, për auditimin e përputhshmërisë, përcjellë me shkresën nr. Nr.1112/33 Prot., datë 15.07.2024, duke i kushtuar vëmendjen e posaçme çështjeve, që lidhen me:

- Vlerësimin e rekomandimeve të KLSH-së të lëna nga auditimi i kryer në vitin 2024, hartimi i programeve (plan veprimeve) nga subjekti i audituar, duke ngarkuar me detyra personat përgjegjës dhe përcaktuar afatet konkrete për zbatimin e rekomandimeve për çdo njësi vartëse; - Nxjerrjen nga titullari i njësisë publike të akteve administrative të nevojshme, si:

Vendimeve (urdhrave) për zbatimin e masave organizative;

Vendimet ekzekutive për shpërblimin e dëmit;

Vendimet ekzekutive për përdorimin me efektivitet, eficiency dhe ekonomicitet të fondeve;

Vendimet e nëpunësit autorizues, komisioneve disiplinore për dhënien e masave disiplinore e të tjera masa e rekomandime që i përcillen subjektit të audituar nëpërmjet Vendimit të Kryetarit të Kontrollit të Lartë të Shtetit.

II. HYRJA

Auditimi është kryer në përputhje me ligjin nr. 154, datë 27.11.2014 “Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit”, si dhe manualit “Për ndjekjen e zbatimit të rekomandimeve të Kontrollit të Lartë të Shtetit” dhe Regjistrin elektronik institucional të zbatimit të rekomandimeve.

Auditimi i zbatimit të rekomandimeve të lëna në auditimin e mëparshëm, sipas drejtimeve të Programit të Auditimit nr.857/6, datë 12.09.2025, të miratuar nga Kryetari i Kontrollit të Lartë të Shtetit, është kryer nga grupi i audituesve i përbërë nga:

-V.B., përgjegjës i grupit të auditimit

-R.Xh. auditues

Auditimi ka filluar më datë 12.09.2025 dhe ka përfunduar më datë 24.10.2025.

II/1. OBJEKTI I AUDITIMIT

Zbatimi i masave të rekomanduara në auditimin e mëparshëm të dërguara me shkresën nr. Nr.1112/33 Prot., datë 15.07.2024 së bashku me Raportin Përfundimtar të Auditimit, nga Grupi i Audituesve Shtetërorë të KLSH-së.

II/2. QËLLIMI I AUDITIMIT

Auditimi i zbatimit të rekomandimeve kryhet në funksion të hartimit të Raportit Vjetor të aktivitetit të Kontrollit të Lartë të Shtetit, që paraqitet në Kuvendin e Shqipërisë brenda tremujorit të parë të vitit pasardhës, bazuar në pikën 3 të nenit 31 të ligjit nr. 154/2014 “Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit”.

II/3. METODOLOGJIA E AUDITIMIT

Auditimi i plotë i të gjithë dokumentacionit të paraqitur nga subjekti dhe që ka lidhje me zbatimin e masave të rekomanduara nga KLSH për përmirësimin e gjendjes së subjekteve në të ardhmen.

III. PËRSHKRIMI I AUDITIMIT

III/1. INFORMACION I PËRGJITHSHËM.

Nga auditimi në terren i dokumentacionit të paraqitur nga Drejtorinë Rajonale Tatimore Fier në lidhje me zbatimin e rekomandimeve të lëna nga KLSH me shkresën nr. Nr.1112/33 Prot., datë 15.07.2024 rezulton se, niveli i pranimeve dhe zbatimit të rekomandimeve është si më poshtë:

-Për përmirësimin e gjendjes janë lënë 21 “*Masa Organizative*”, nga ku janë pranuar 21 dhe knaë statusin e ecurisë së zbatimit si vijon- **9** masa janë zbatuar plotësisht, në përputhje me qëllimin dhe përmbajtjen e rekomandimeve;

- **3** masa janë zbatuar pjesërisht, me veprime të ndërmarra, por që nuk kanë përmbushur të gjitha kërkesat e përcaktuara nga rekomandimi;

- **9** masa janë në proces zbatimi;

- **0** masë nuk është zbatuar ende;

- **0** masa janë refuzuar ose nuk janë pranuar nga subjekti audituar.

-Për përmirësimin e gjendjes janë lënë 23 rekomandime për të “*ardhura të munguara*” nga ku 23 rekomandime të pranuar, dhe 23 kanë statusin e ecurisë - **20** masa janë zbatuar plotësisht, duke u reflektuar në ndërmarrjen e veprimeve konkrete për rikupërimin e detyrimeve tatimore ose në përmirësimin e metodologjisë së administrimit të të ardhurave; **3** masa janë zbatuar pjesërisht, ku janë ndërmarrë veprime të pjesshme ose të kufizuara në kohë;

-Për përmirësimin e gjendjes janë lënë “*Masa Disiplinore*”.për 18 punonjës dhe pranuar rekomandime, 18 kanë statusin e ecurisë të realizuar plotësisht

Opinion i përgjithshëm mbi zbatimin e rekomandimeve

Nga auditimi i zbatimit të rekomandimeve konstatohet se shkalla e pranueshmërisë së rekomandimeve kundrejt atyre të pa pranuar rezulton në nivel 100%, konkretisht nga 62 rekomandime gjithsej, janë pranuar 62 rekomandime.

Niveli i zbatimit të rekomandimeve të zbatuara plotësisht rezultoi në masën 76%, niveli i rekomandimeve të zbatuara pjesërisht rezultoi 10%, niveli i rekomandimeve në proces zbatimi rezultoi 14%, si dhe niveli i rekomandimeve të pazbatuara rezultoi 0%.

III/2. REZULTATET E AUDITIMIT SIPAS DREJTIMEVE TË AUDITIMIT

Nga auditimi i ushtruar në Drejtorinë Rajonale Tatimore Fier për zbatimin e rekomandimeve të KLSH-së, “*Mbi auditimin e përputhshmërisë*” për periudhën 01.01.2022 deri në 31.12.2023, trajtuar në Raportin Përfundimtar të Auditimit me Vendimin e Kryetarit të KLSH-së, përcjellë me shkresën nr. Nr.1112/33 Prot., datë 15.07.2024, rezultoi si më poshtë vijon:

A. Mbi hartimin e programit (Planit të veprimit) dhe respektimin e afateve ligjore për njoftimin e KLSH për ecurinë e zbatimit të rekomandimeve brenda afateve të përcaktuara në Ligjin nr. 154/2014, datë 27.11.2014 “Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit”.

-Drejtorinë Rajonale Tatimore Fier me Nr.9418/69 Prot., datë 16.07.2024. ka Përcjellë pranë Kontrollit të Lartë të Shtetit planin e masave i cili është kryer brenda afatit ligjor 20-ditor.

-Drejtoria Rajonale Tatimore Fier, nuk ka përmbushur detyrimin ligjor për të raportuar pranë Kontrollit të Lartë të Shtetit mbi ecurinë e zbatimit të rekomandimeve të dhëna, përputhje me kërkesat e nenit 30, pika 2 të Ligjit Nr. 154/2014, datë 27.11.2014 “Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollin të Lartë të Shtetit”,

B. Zbatimi i rekomandimeve për masat me karakter organizativ. Ecuria e zbatimit dhe analizimi i rekomandimeve: rekomandime të pranuar dhe nga këto, sa janë zbatuar plotësisht; zbatuar pjesërisht, në proces zbatimi dhe rekomandimet e pa zbatuara.

Nga auditimi i zbatimit të rekomandimeve të KLSH-së në mënyrë më të detajuar rezulton si më poshtë:

1.1 Rekomandimi: Drejtori i Drejtorisë e Rajonale Tatimore Fier të analizojë faktorët të cilat kanë ndikuar në realizimin e planit të të ardhurave tatimore sipas zërave, veçanërisht për llojet e tatimeve që rezultojnë me mos realizim referuar subjekteve që opërojnë nën juridiksionin e DRT Fier, duke nxjerrë edhe përgjegjësitë përkatëse në funksion të arritjes së objektivave institucional për rritjen e nivelit të mbledhjes së të ardhurave

Qëndrimi i Subjektit:Në zbatim të detyrave funksionale dhe legjislacionit tatimor në fuqi, për realizimin e planit të të ardhurave në DRT Fier, në mënyrë periodike janë kryer analiza mujore për performancën e TVSH-së dhe performancën mujore në DRT Fier nga Sektori i Analizës dhe Kontabilitetit. Çdo muaj, DRT ka nxjerrë plane pune duke angazhuar të gjitha drejtoritë përkatëse në realizimin e planit dhe kryerjen e detyrave funksionale, si më poshtë:

Për TVSH-në.

Verifikimi i deklaratës së TVSH-së, librave të blerje-shitjes dhe CPCM-së.

Kontrolli i subjekteve të ardhura për verifikim nga Komiteti i Riskut (Vendimi nr. 27).

Analiza e subjekteve me gjendje të lartë kreditore të TVSH-së dhe e uljes së pagueshmërisë së TVSH.

Propozimi për kontroll i subjekteve problematike, duke respektuar 30% të orëve në dispozicion që janë kompetencë e Drejtorisë Rajonale, në bashkëpunim ndërmjet Sektorit të Kontrollit në Vend dhe inspektorëve përkatës të Sektorit të Kontrollit nga zyra, për përcaktimin sa më të plotë dhe të saktë të subjekteve me risk, duke raportuar, përveç problematikave të dërguara me formularin e dërgimit të çështjes për kontroll, edhe çështje të tjera të evidentuara.

Për Tatimin mbi Fitimin

Çdo muaj vijon kontrolli i saktësisë së deklaratës vjetore dhe pasqyrave financiare të paraqitura nga tatimpaguesit; për diferencat e konstatuara janë kryer vlerësime tatimore.

Verifikimi i subjekteve që kanë deklaruar TFTH 2024 / TF 2024.

Përgatitja e letër-kujtesave për subjektet që nuk kanë dorëzuar FDP TTHF 24-A.

Për kontributet e sigurimeve shoqërore.

Çdo muaj, DRT Fier evidenton subjektet me gjendje kreditore dhe kryen menjëherë sistemimin e situatës, referuar listë-pagave të dorëzuara për periudhat përkatëse. Evidentimi i subjekteve që

ndryshojnë listë-pagat me ulje të detyrimit dhe kryerja e vlerësimeve përkatëse. Janë kryer vlerësime tatimore për punonjës të pasiguruar, të konstatuar nga verifikimi në vend. Në mënyrë periodike mujore është bërë ndërgjegjësim me tatimpaguesit për kryerjen e pagesës së sigurimeve dhe deklarimin e pagave reale, sipas legjislacionit në fuqi. Në vijim të masave të marra dhe detyrave të ndjekura, për sa më sipër, kemi një performancë të mirë në realizimin e planit për vitin 2024. DRT Fier ka realizuar të ardhurat vjetore 2024 në masën 102% bruto dhe 103% neto, mbi planin.

Qëndrimi i Audituesve të Kontrollit të Lartë të Shtetit: Nga verifikimi i dokumentacionit të paraqitur konstatohet se DRT Fier ka ndërmarrë një sërë masash periodike operative (analiza mujore nga Sektori i Analizës dhe Kontabilitetit, plane pune mujore, verifikime/diferencime për TVSH, Tatimin mbi Fitimin dhe kontributet, vlerësime tatimore, letër-kujtesa, ndërgjegjësim të tatimpaguesve) dhe raporton përmirësim të performancës në vitin 2024 (realizim 102% bruto/103% neto mbi planin). Këto tregojnë progres në menaxhimin e të ardhurave dhe një qasje më sistematike të ndjekjes mujore. Megjithatë, rekomandimi kërkon analizë shkaqesh sipas zërave të të ardhurave veçanërisht aty ku ka mosrealizim, të lidhur me subjektet nën juridiksion, si dhe nxjerrje të përgjegjësive përkatëse. Në materialin e paraqitur nuk administrohen prova të analizave shkaqësore të strukturuar (p.sh. raporte analitike me faktorë ndikues për TVSH/Tatimin mbi Fitimin/kontributet në vitet problematike), nuk dokumentohet kalimi nga analizat në akt-përgjegjësi (përgjegjësi konkrete të hallkave/përsonave) dhe nuk paraqiten akte miratimi/urdhra zbatimi që mbyllin qarkun “analizë-përgjegjësi-masë”. Po ashtu, rezultatet e vitit 2024, ndonëse pozitive, nuk zëvendësojnë kërkesën për analizë të mosrealizimeve të konstatuara për 2021 dhe 2023. Si përfundim konkludojmë se janë kryer analiza dhe veprime operative periodike dhe është përmirësuar performanca 2024, por mungojnë dokumente provuese të analizave shkaqësore të plota sipas zërave me mosrealizim dhe nxjerrjes së përgjegjësive siç kërkon rekomandimi. Për zbatim të plotë, duhet të administrohen raportet analitike për 2021/2023 të miratuara, matrica përgjegjësish/masash dhe evidenca e zbatimit të tyre. Si përfundim statusi i zbatimit të rekomandimit Zbatuar Pjesërisht.

Statusi: Pranuar, Zbatuar pjesërisht

2.1 Rekomandimi: Drejtori i DRT Fier, në bashkëpunim me DPT, të marrë masa për plotësimin e vendeve vakante, pjesë të shërbimit civil sipas pozicioneve të miratuara në kuadër të mbarëvajtjes së punës dhe përmirësimin e performancës institucionale.

Qëndrimi i Subjektit: Për zbatimin e rekomandimit nga ana e DRT Fier është dërguar shkresa me nr. 550 prot datë 01.08.2024 drejtuar Drejtorisë së Përgjithshme të Tatimeve, për plotësimin e vendeve vakante për të përmbushur më mirë objektivat dhe detyrat funksionale të DRT Fier. Bashkelidhur shkresa e cituar.

Qëndrimi i Audituesve të Kontrollit të Lartë të Shtetit: Nga verifikimi i dokumentacionit të paraqitur, rezulton se DRT Fier ka ndërmarrë vetëm hapin fillestar të dërgimit të një kërkesë (shkresa nr. 550 prot., datë 01.08.2024) drejtuar Drejtorisë së Përgjithshme të Tatimeve për plotësimin e vendeve vakante. Ky veprim, megjithëse përbën një nismë pozitive, nuk garanton vetë zbatimin e plotë të rekomandimit, pasi:

- ende nuk është realizuar plotësimi real i vendeve të lira sipas strukturës së miratuar;
- nuk janë dhënë prova për ndjekjen e mëtejshme të kërkesës apo për një plan veprimi të vijueshëm për zgjidhjen e problemit;

- nuk është siguruar dokumentacion mbi çështjet gjyqësore, procedurat e delegimit apo konfirmimet për mungesën e tyre, siç është kërkuar nga grupi i auditimit.

Për pasojë, gjendja e konstatuar nga auditimi mbetet në thelb e pandryshuar në aspektin e plotësisimit efektiv të strukturës dhe përmbushjes së objektivave funksionale. Nga sa më sipër gjykojmë se është ndërmarrë një veprim i parë (dërgimi i shkresës) që tregon vullnet për zbatim, por nuk janë siguruar rezultate konkrete e të mjaftueshme për ta konsideruar rekomandimin të zbatuar plotësisht. Statusi i zbatimit të rekomandimit: Në proces zbatimi.

Ky rekomandim rezulton i pranuar dhe në proces.

3.1 Rekomandimi: Strukturat përgjegjëse pranë DRT Fier dhe DPT të marrin masat për garantimin e mbulimit me kontroll në vend të propozimeve në masën 30% të propozimeve nga DRT, duke trajtuar e dokumentuar me përparësi në përzgjedhje të subjekteve që mbartin realisht risk.

Qëndrimi i Subjektit: Lidhur me këtë rekomandim, sqarojmë se propozimet për kontroll të tatimpaguesve të vlerësuara me risk përbëjnë 30% të orëve në dispozicion për çdo muaj dhe jo 30% të subjekteve për kontroll. Për rrjedhojë, numri i subjekteve të planifikuara nga ana jonë varet nga qarkullimi i subjekteve që propozohet të kontrollohen. Sa më i madh të jetë qarkullimi, aq më shumë orë planifikohen për kontroll. Kësisoj, tatimpaguesit e propozuar nga ne (në kuadër të 30% të orëve) mund të jenë dy, tre ose më shumë subjekte të planifikuara.

Qëndrimi i Audituesve të Kontrollit të Lartë të Shtetit: E pranojmë shpjegimin e DRT Fier se treguesi “30%” është aplikuar si 30% e orëve të kontrollit dhe duke qenë se ky është një proces dinamik (planifikim, realizim, raportim dhe rikalibrim i riskut në vijimësi), zbatimi i plotë do të ri-verifikohet në auditimin pasardhës, ku do të kontrollohet: arritja e objektivit sipas metodës që do të formalizojë DPT, koherenca plan/realizim (në orë dhe në numër subjektësh) dhe plotësia e dosjeve të riskut. Statusi: Në proces zbatimi.

Statusi: Pranuar, Në proces

4.1 Rekomandimi: DVKT Rajoni Jugor, të koordinojë me DPT, me qëllim planifikimin sa më efektiv të subjekteve për kontroll sipas analizës së riskut, si dhe hartimin e planeve të punës me shpërndarje gjithëvjetore dhe organizmin sa më racional të grupeve të punës në terren, me qëllim që DVKT Rajoni Jugor, të opërojë në kushte efice dhe efektiviteti.

Qëndrimi i Subjektit: Duke qenë se DVKT RJ punon në zbatim të Planeve të Punës dhe listave për kontroll të ardhura nga DVKT në DPT, në lidhje me rekomandimin nr.4.1, janë marrë masa menjëherë ku është vënë në dijeni DVKT në DPT. Bashkëlidhur shkresa Nr.17/1Prot., dt.31.05.2024 me lëndë “Zbatim i Rekomandimit Nr.4.1”. Gjithashtu janë marrë masa që të bëhet një shpërndarje sa më racionale e grupeve të punës, bazuar në subjektet e ardhura për kontroll nga DVKT në DPT.

Qëndrimi i Audituesve të Kontrollit të Lartë të Shtetit: Nga shqyrtimi i informacionit dhe dokumentacionit të paraqitur nga DVKT Rajoni Jugor, rezulton se janë kryer vetëm veprime të natyrës njoftuese dhe organizative, si:

- Njoftimi i DVKT në DPT me shkresën nr.17/1 Prot., datë 31.05.2024 për marrjen e masave për zbatimin e rekomandimit.

- Marrja e disa masave fillestare për një shpërndarje më racionale të grupeve të punës bazuar në listat e ardhura nga DPT.

Megjithatë, këto veprime nuk përmbushin thelbin e rekomandimit, sepse:

- Nuk është paraqitur provë se është realizuar një planifikim i ri i kontrollit mbi bazën e analizës së riskut, që të garantojë rritjen e efikasitetit.
- Nuk është dëshmuar hartimi i planeve të punës me shpërndarje gjithëvjetore, siç kërkohet.
- Nuk janë dhënë evidenca se raporti ndërmjet shpenzimeve për paga dhe detyrimeve tatimore të zbuluara është përmirësuar, që është treguesi kryesor i efikasitetit të kërkuar.
- Në mungesë të këtyre rezultateve konkrete, problematika e evidentuar në raportin e auditimit vazhdon të mbetet e pazgjidhur në thelb.

Nga sa më sipër konstatohet se veprimet e ndërmarra deri tani përfaqësojnë vetëm nisjen e procesit (njoftim dhe riorganizim paraprak), pa sjellë rezultate të matshme për përmirësimin e efikasitetit dhe efektivitetit të veprimtarisë së DVKT Rajoni Jugor. Statusi i zbatimit të rekomandimit: Në proces zbatimi.

Ky rekomandim rezulton i pranuar dhe në proces.

5.1 Rekomandimi: Drejtori i Verifikimit dhe Koordinimit në Terren Rajoni Jugor të zbatojë me korrektësi procedurat dhe afatet administrative për të siguruar trajtim të barabartë të subjekteve tatimpaguese dhe ndëshkimin e shkelësve të ligjit.

Qëndrimi i Subjektit: Në zbatim të rekomandimit nr.5.1, janë marrë masa menjëherë për zbatimin me korrektësi të procedurave dhe afatet administrative. Gjatë kësaj periudhe DVKT RJ nuk ka patur raste të subjekteve me pengim kontrolli, në rast konstatimi do të merret parasysh rekomandimi për zbatimin korrekt të procedurave dhe afateve.

Qëndrimi i Audituesve të Kontrollit të Lartë të Shtetit: Nga verifikimi i qëndrimit të subjektit rezulton se DVKT Rajoni Jugor ka deklaruar se ka marrë masa për respektimin e procedurave dhe afateve ligjore dhe se gjatë periudhës pas auditimit nuk janë shënuar raste të reja pengimi kontrolli. Megjithatë:

- Masa e raportuar mbetet në nivel deklarativ, pa prova konkrete të ndryshimeve të brendshme në proceset e punës (udhëzime, urdhra të brendshëm, mekanizma monitorimi) që të garantojnë parandalimin e përsëritjes së shkeljeve.
- Nuk ka ende një rast të ri në të cilin të provohet zbatimi praktik i përmirësimeve të pretenduara.
- Rekomandimi ka të bëjë me respektimin e procedurave dhe afateve në çdo rast të ardhshëm, çka kërkon jo vetëm mungesë shkeljesh, por edhe dokumentimin e mekanizmave të rinj kontrolli dhe evidentimin e përmirësimeve në proces.

Në këto kushte, nuk mund të konkludohet se rekomandimi është zbatuar plotësisht, pasi efektiviteti i masave nuk është ende i verifikueshëm. Nga sa më sipër konstatohet se është shprehur vullnet dhe janë ndërmarrë veprime parandaluese, por mungojnë evidenca konkrete dhe prova praktike që masat të kenë garantuar realisht respektimin e procedurave dhe afateve në rastet e parashikuara. Statusi i zbatimit të rekomandimit: Në proces zbatimi.

Ky rekomandim rezulton i pranuar dhe në proces.

S

6.1 Rekomandimi: Nga Drejtoria Rajonale Tatimore Fier të merren masa që të zbatohen me korrektësi procedurat dhe afatet administrative për hartimin dhe dërgimin e projekt raportit dhe raportit përfundimtar të kontrollit tatimor tek tatimpaguesit objekt kontrolli, konform përcaktimeve ligjore në fuqi, me qëllim rritjen e efektivitetit të veprimtarisë kontrolluese.

Qëndrimi i Subjektit: Lidhur me afatet e dërgimit të projekt-raporteve dhe raporteve të kontrollit tek tatimpaguesit, nga ana e DRT Fier janë marrë masat që secili inspektor t'i zbatojë me korrektësi

afatet e përcaktuara në ligj për dërgimin e projekt-raporteve dhe raporteve të kontrollit tek tatimpaguesit, nëpërmjet shërbimit postar.

Qëndrimi i Audituesve të Kontrollit të Lartë të Shtetit: Përputhshmëria e Afateve Procedurale dhe Administrative në Kontrollin Tatimor. Në funksion të sigurimit të përputhshmërisë ligjore dhe administrative të veprimtarisë së strukturave të kontrollit tatimor pranë DRT Fier, është realizuar përzgjedhja e një kampioni përfaqësues të dosjeve të kontrollit tatimor për auditim përputhshmërie me afatet e përcaktuara në kuadrin ligjor dhe nënligjor në fuqi. Qëllimi i përzgjedhjes së këtij kampioni është auditimi i përputhshmërisë me kuadrin ligjor dhe procedural, në veçanti në lidhje me respektimin e afateve administrative për shqyrtimin, qarkullimin dhe evadimin e dosjeve të kontrollit, në përputhje me kërkesat e Ligjit Nr.9920, datë 19.05.2008 “Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, si dhe akteve nënligjore të nxjerra në zbatim të tij. Përzgjedhja dhe analiza e këtij kampioni synon të evidentojë shkallën e zbatimit të procedurave standarde të administratës tatimore, të verifikojë dokumentimin e vendimmarrjeve përgjatë gjithë ciklit të kontrollit dhe të identifikojë çdo devijim apo mospërputhje me kërkesat ligjore për administrimin dhe përfundimin e dosjeve tatimore. Në vijim të analizës është shqyrtuar baza ligjore si në vijim:

- Neni 83 i Ligjit Nr.9920/2008 përcakton që raporti i kontrollit duhet të hartohet brenda 7 ditëve kalendarike pas përfundimit të kontrollit, të miratohet nga strukturat përkatëse dhe të njoftohet tatimpaguesi.

- Neni 84 i të njëjtit ligj parashikon që raporti përfundimtar të hartohet brenda 14 ditëve kalendarike pas marrjes së kundërshtimit të tatimpaguesit.

- Neni 56-57 i KPA përcakton mënyrën e llogaritjes së afateve, duke përjashtuar ditën e ngjarjes dhe duke zgjatur afatin nëse dita e fundit është pushim zyrtar.

- Neni 91 i Ligjit Nr.44/2015 detyron organin publik të përfundojë procedurat administrative brenda afatit të përcaktuar ligjërisht ose, në mungesë, brenda 60 ditëve.

- Neni 155 i Ligjit Nr.44/2015, është konsideruar si datë marrjeje dijëni data e tretë nga dërgimi për adresat brenda territorit të Republikës së Shqipërisë.

Për analizën e rasteve, janë marrë në shqyrtim të dhënat statistikore të vëna në dispozicion nga DRT Fier, përfshirë datën e fillimit të kontrollit, orët e planifikuara sipas analizës së riskut, datat e projekt-raportit dhe raportit përfundimtar, si dhe data e njoftimit përmes postës është konsideruar fati maksimal prej 5 ditëve kalendarike, gjithashtu janë ekskluduar nga llogaritja e afateve ditët e festave zyrtare. Nga auditimi i kryer dhe analiza e dokumentacionit përkatës, e realizuar rast pas rasti, u konstatua se:

Tatimpaguesi	NIPT	Data e fillimit të kontrollit	Orë Pune	Projekt Kontrolli Tatimor DRT Fier (C@ts)	Afati Ligjor Projekt Kontrolli Tatimor	Tejkalim afati Projekt Kontrolli Tatimor	Raport Përfundimtar Kontrolli DRT Fier (C@ts)	Afati Ligjor Raporti Përfundimtar Tatimor	Tejkalim afati Raporti Përfundimtar Tatimor
S	M	02.08.2024	48	21.08.2024	19.08.2024	0	16.09.2024	28.09.2024	0
A	L	01.07.2024	130	15.08.2024	30.07.2024	15	17.09.2024	08.09.2024	9
B.	L	28.07.2025	55	08.08.2025	12.08.2025	0	25.08.2025	21.09.2025	0
L.	J	11.03.2024	91	09.05.2024	02.04.2024	37	04.06.2024	12.05.2024	23

1. S.Z. PF (NIPT: M.)

- Data e fillimit të kontrollit: 08.02.2024

- Orë pune të planifikuara: 48

- Data e projekt-kontrollit tatimor: 21.08.2024

- Afati ligjor për dorëzimin e projekt-kontrollit tatimor: 19.08.2024
- Tejkالمي i afatit për projekt-kontrollin: 0 ditë pune
- Data e raportit përfundimtar të kontrollit tatimor: 16.09.2024
- Afati ligjor për raportin përfundimtar: 28.09.2024
- Tejkالمي i afatit për raportin përfundimtar: 0 ditë kalendarike
- Projekt-kontrolli është hartuar brenda afatit ligjor të përcaktuar në nenin 83 të Ligjit Nr.9920, datë 19.05.2008 “Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar.
- Raporti përfundimtar është përgatitur brenda, duke respektuar afatit ligjor të parashikuar në nenin 84 të Ligjit Nr.9920, datë 19.05.2008 “Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar.

2. A. Shpk (NIPT: L.)

- Data e fillimit të kontrollit: 01.07.2024
- Orë pune të planifikuara: 130
- Data e projekt-kontrollit tatimor: 15.08.2024
- Afati ligjor për dorëzimin e projekt-kontrollit tatimor: 30.07.2024
- Tejkالمي i afatit për projekt-kontrollin: 15 ditë pune
- Data e raportit përfundimtar të kontrollit tatimor: 17.09.2024
- Afati ligjor për raportin përfundimtar: 09.08.2024
- Tejkالمي i afatit për raportin përfundimtar: 9 ditë kalendarike
- Projekt-kontrolli është hartuar me tejkالمي afatit ligjor të përcaktuar në nenin 83 të Ligjit Nr.9920, datë 19.05.2008 “Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar.
- Raporti përfundimtar është përgatitur me tejkالمي prej 9 ditësh kalendarike, duke dalë jashtë afatit ligjor të parashikuar në nenin 84 të Ligjit Nr.9920, datë 19.05.2008 “Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar.

3. B. Shpk (NIPT: L.)

- Data e fillimit të kontrollit: 28.07.2025
- Orë pune të planifikuara: 55
- Data e projekt-kontrollit tatimor: 08.08.2025
- Afati ligjor për dorëzimin e projekt-kontrollit tatimor: 12.08.2025
- Tejkالمي i afatit për projekt-kontrollin: 0 ditë pune
- Data e raportit përfundimtar të kontrollit tatimor: 25.08.2025
- Afati ligjor për raportin përfundimtar: 21.09.2025
- Tejkالمي i afatit për raportin përfundimtar: 0 ditë kalendarike
- Projekt-kontrolli është hartuar brenda afatit ligjor të përcaktuar në nenin 83 të Ligjit Nr.9920, datë 19.05.2008 “Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar.
- Raporti përfundimtar është përgatitur brenda, duke respektuar afatit ligjor të parashikuar në nenin 84 të Ligjit Nr.9920, datë 19.05.2008 “Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar.

4. L. Shpk (NIPT: J.)

- Data e fillimit të kontrollit: 11.03.2024
- Orë pune të planifikuara: 91
- Data e projekt-kontrollit tatimor: 09.05.2024
- Afati ligjor për dorëzimin e projekt-kontrollit tatimor: 02.04.2024
- Tejkالمي i afatit për projekt-kontrollin: 37 ditë pune

- Data e raportit përfundimtar të kontrollit tatimor: 04.06.2024
- Afati ligjor për raportin përfundimtar: 12.05.2024
- Tejkalimi i afatit për raportin përfundimtar: 23 ditë kalendarike.
- Projekt-kontrolli është hartuar me tejkalim afatit ligjor të përcaktuar në nenin 83 të Ligjit Nr.9920, datë 19.05.2008 “Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar.
- Raporti përfundimtar është përgatitur me tejkalim prej 23 ditësh kalendarike, duke dalë jashtë afatit ligjor të parashikuar në nenin 84 të Ligjit Nr.9920, datë 19.05.2008 “Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar.

Nga testimi i përputhshmërisë me afatet ligjore të neneve 83–84 të Ligjit nr. 9920/2008 (si dhe rregullave të llogaritjes së afateve sipas Ligjit nr. 44/2015), rezulton zbatim i pjesshëm: në kampionin e verifikuar 2 dosje (“S”, “B.”) respektojnë afatet si për Projekt-Raportin ashtu edhe për Raportin Përfundimtar; ndërsa 2 dosje (“A”, “L.”) i kanë tejkaluar afatet për të dy dokumentet. Kjo tregon se masat organizative të njoftuara nga DRT Fier (dërgim nëpërmjet shërbimit postar dhe disiplinim i afateve) kanë prodhuar efekt në disa raste, por jo në mënyrë të njëtrajtshme në të gjithë ciklin e kontroleve. Për më tepër, metodologjia e auditimit ka konsideruar tolerancën postare (deri në 5 ditë kalendarike) dhe ka përjashtuar festat zyrtare, çka e bën konstatimin për tejkalim afatesh të qartë dhe të dokumentuar. Prandaj, edhe pse janë ndërmarrë hapa pozitivë, kërkohet standardizim i plotë i praktikës (p.sh., lista kontrolli për afatet, sinjalizime automatike në C@ts, dhe ndjekje menaxheriale të dosjeve me risk vonese). Statusi: Në proces Zbatimi. Vijon monitorimi i zbatimit të masave dhe verifikim i plotë në auditimin pasardhës për të konfirmuar përputhshmëri 100% me afatet proceduriale. **Ky rekomandim rezulton i pranuar dhe në proces.**

7.1 Rekomandimi: DRT Fier, nëpërmjet Sektorit të Kontrollit nga Zyra dhe Monitorimit, , të administrojë “Inventarin fizik” të saktë të vitit 2019 për tatimpaguesin “D” Shpk, me qëllim analizimin dhe vlerësimin e bilancit material, sipas raportit të kontrollit.

Qëndrimi i Subjektit: Tatimpaguesi “D” Shpk me NIPT L., është transferuar nën juridiksionin e Drejtorisë Tatimore të Tatimpaguesve të Mëdhenj, e cila është vendosur në dijeni dhe ka kompetencë për veprime të mëtejshme.

Qëndrimi i Audituesve të Kontrollit të Lartë të Shtetit: Pas verifikimit të dokumentacionit dhe veprimeve të ndërmarra nga Drejtoria Rajonale Tatimore (DRT) Fier, në zbatim të rekomandimit nr.7 të Raportit të Auditimit, lidhur me tatimpaguesin “D” Shpk, me NIPT L., rezulton si vijon:

- Gjetja kryesore: Gjatë kontrollit tatimor për vitin 2019 u konstatuan diferenca midis inventarit kontabël të deklaruar në anekset e bilancit dhe analizës së bilancit material. Më pas, administratori i shoqërisë paraqiti inventarin fizik të firmosur e vulosur dhe dokumentacionin mbështetës që shpjegon se diferencat vijnë nga deklarimi i pasaktë në sistemin C@ts, dhe jo nga mungesë realisht fizike.

- Veprimet e ndërmarra: DRT Fier, duke vlerësuar se subjekti është transferuar në DTM, ka përcjellë çështjen për veprime të mëtejshme në Drejtorinë e Tatimpaguesve të Mëdhenj (DTM). Si përfundim në bazë të provave të administruara: Proceduralisht, DRT Fier ka përmbushur detyrimet e saj duke administruar dokumentacionin e nevojshëm dhe duke e përcjellë çështjen në organin kompetent (DTM). Financiarisht, vlerësimi përfundimtar i bilancit material dhe çdo detyrim tatimor që mund të rezultojë prej tij mbetet në kompetencën e DTM-së. Statusi: Zbatuar në aspektin procedural nga DRT Fier; realizimi financiar mbetet për t’u ndjekur nga Drejtoria e Tatimpaguesve të Mëdhenj.

Ky rekomandim rezulton i pranuar dhe zbatuar plotësisht.

8.1 Rekomandimi: DRT Fier në bashkëpunim me DPT, të analizojë situatën e kontrollit të kryer në subjektet “C” Shpk, “L.” Shpk dhe “G” Shpk, referuar gjetjeve nga auditimi i KLSH-së, si dhe të përcjellë pranë Drejtorisë së Përgjithshme të Parandalimit të Pastrimit të Parave, për vlerësimin dhe identifikimin e mëtejshëm të burimeve të financimit.

Qëndrimi i Subjektit: Nga rikontrolli në subjektin “C” Shpk rezultoi se në vitin 2021, përveç kontributit të derdhur nga ortakut (për të cilin është paguar dividend), subjekti ka edhe një kontratë huamarrjeje me personin fizik F., i regjistruar me NIPT L., të datës 25.06.2021, në shumën 7.500.000 lekë, me afat shlyerjeje 5-vjeçar.

Subjekti “L” Shpk është transferuar në DTM Tiranë; ky rekomandim është përcjellë në DPT me shkresën nr. 6855.5797/2, datë 02.10.2024, për t’u planifikuar për kontroll në DTM Tiranë.

Nga rikontrolli në subjektin “G” Shpk, sa i përket shtesës së vitit në llogarinë e ortakut, subjekti paraqiti kontrata nga persona të ndryshëm, të cilat u vunë në dispozicion të kontrollit. Gjithashtu, lidhur me këtë llogari ka pasur edhe korrespondencë me Hetimin Tatimor, nga e cila ka rezultuar se nuk ka problematika në lidhje me këto kontrata.

Qëndrimi i Audituesve të Kontrollit të Lartë të Shtetit: Nga auditimi dhe verifikimi i dokumentacionit dhe argumentimit të kryer nga DRT Fier, gjykojmë se:

- Për subjektin “C” Shpk - DRT Fier ka ushtruar verifikim pasues dhe ka administruar kontratën e huasë (25.06.2021; 7.500.000 lekë; afat 5-vjeçar) si burim financiar shtesë. Dokumentimi i këtij elementi dhe reflektimi i tij në dosje adreson kërkesën e rekomandimit për shpjegim dhe dokumentim zyrtar të burimeve.

- Për subjektin “L” Shpk - Subjekti është transferuar në DTM Tiranë; DRT Fier ka bërë përcjelljen formale të rekomandimit dhe dokumentacionit përkatës tek DPT/DTM (shkresa nr. 6855.5797/2, datë 02.10.2024), duke përmbushur plotësisht detyrimin e vet procedural (kompetenca tashmë i takon DTM).

- Për subjektin “G” Shpk - Janë administruar kontrata huaje nga persona të ndryshëm dhe është marrë konfirmim nga Hetimi Tatimor se nuk rezultojnë problematika lidhur me këto kontrata. Këto veprime përbëjnë adresim dhe dokumentim zyrtar të çështjes në nivel DRT.

Nga sa më sipër vlerësojmë se DRT Fier, të gjitha hapat e kërkuar proceduralë se verifikim, dokumentim, dhe/ose përcjellje te organi kompetent janë kryer. Çdo veprimtari e mëtejshme materiale (p.sh., kontrole të DTM) i takon juridiksionit pritës dhe nuk cenon përmbushjen procedurale nga DRT Fier. Nga sa më sipër gjykojmë se statusi i zbatimit: Zbatuar proceduralisht nga DRT Fier.

Ky rekomandim rezulton i pranuar dhe zbatuar plotësisht.

9.1 Rekomandimi: Drejtoria e Përgjithshme të Tatimeve nëpërmjet Drejtorisë Ligjore dhe Teknike dhe Sektorit të Cilësisë dhe Standartizimit të Procedurave, të marrin të gjitha veprimet e nevojshme administrative, me qëllim hartimin e një metodologji apo një manuali udhëzues, për të përcaktuar çështjet që duhet të jenë pjesë e verifikimeve të punimeve të kryera, në subjektet e fushës së ndërtimit, me qëllim standartizimin e akt konstatimit të inxhinierit të ndërtimit, si pjesë integrale e raport kontrollit tatimor.

Qëndrimi i Subjektit: Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve, me shkresën nr. 11848 prot., datë 02.07.2024, me objekt ‘Për njohje dhe zbatim të menjëhershëm’, e protokolluar pranë nesh me nr. 4867, datë 04.07.2024, ka kërkuar që në përbërje të grupit të kontrollit të përfshihet një specialist i jashtëm i fushës ku operon tatimpaguesi. Që prej këtij momenti e në vijim, të gjitha kontrollet në

fushën e ndërtimit janë audituar dhe vijojnë të auditohen nga specialistë inxhinierë të DRT Tiranë dhe të DTM.

Qëndrimi i Audituesve të Kontrollit të Lartë të Shtetit: Nga auditimi dhe verifikimi i dokumentacionit dhe argumentimit, rezulton se DRT Fier e ka përmbushur detyrimin procedural për këtë rekomandim: çështja i është përcjellë zyrtarisht DPT-së për vendimmarrje dhe hartimin e metodologjisë/manualit udhëzues, kompetencë qendrore e Drejtorisë Ligjore dhe Teknike dhe Sektorit të Cilësisë/Standardizimit. Paralelisht, në zbatim të shkresës së DPT nr. 11848, datë 02.07.2024, prot. në DRT Fier nr. 4867, datë 04.07.2024, DRT Fier po e zbaton ndërkohë kërkesën operacionale: në të gjitha kontrollet e subjekteve të ndërtimit janë përfshirë specialistë inxhinierë (nga DRT Tiranë/DTM), dhe dosjet e reja të kontrollit përmbajnë akt-konstatime teknike si pjesë integrale e raportit tatimor. Megjithatë, zbatimi i plotë i rekomandimit si hartimi dhe miratimi i metodologjisë/manualit standard kombëtar dhe formatit të unifikuar të akt-konstatimit mbetet brenda kompetencës së DPT; përfundimi i këtij produkti normativ është parakusht për ta konsideruar rekomandimin të mbyllur plotësisht. Nga sa më sipër gjykojmë se statusi i zbatimit: Zbatuar proceduralisht nga DRT Fier. Procedurat në nivel DRT Fier janë kryer dhe zbatimi operativ po bëhet; mbyllja e plotë varet nga finalizimi i metodologjisë/manualit nga DPT.

Ky rekomandim rezulton i pranuar dhe zbatuar plotësisht.

10.1 Rekomandimi: Drejtoria Rajonale Tatimore Fier të propozojë për kontroll të thelluar tatimpaguesin “S” Shpk, për periudhën 01/2021-12/2021, ku të përfshihet përgjegjësia tatimore e TVSH dhe Tatim Fitimi.

Qëndrimi i Subjektit: Tatimpaguesi “S” Shpk ka kaluar kontroll të thelluar në vitin 2024, konkretisht propozuar nga DRT Fier, për përgjegjësinë tatimore të TVSH: 09/2021-08/2023, TF: 2021-2022 dhe Sigurimet: 09/2021-08/2023.

Qëndrimi i Audituesve të Kontrollit të Lartë të Shtetit: Bazuar në provat e paraqitura, rekomandimi konsiderohet i zbatuar plotësisht nga ana procedurale nga DRT Fier. Konkretisht: - DRT Fier e ka propozuar dhe realizuar kontrollin e thelluar për tatimpaguesin “S” Shpk (2024), duke përfshirë TVSH 09/2021-08/2023, Tatim Fitimi 2021-2022 dhe Sigurimet 09/2021-08/2023, në përputhje me kërkesën për zgjerim të drejtimeve të kontrollit. - Segmenti 01/2021-08/2021 është trajtuar në kontrollin tatimor të mëparshëm; së bashku me kontrollin e thelluar të vitit 2024 sigurohet mbulim i të gjithë vitit 2021 për qëllimet e TVSH/TF, siç kërkonte rekomandimi.

Janë ndjekur hapat formalë (njoftim/program kontrolli, përcaktim i bazës ligjore, verifikime dokumentare dhe materiale), duke adresuar mangësinë fillestare mbi mos-përfshirjen e TVSH/TF në kontrollin e vizitës fiskale dhe duke mundësuar rivlerësim financiar për efektet tatimore të nëndeklarimit të pagave. Me këto veprime, DRT Fier ka përmbushur plotësisht detyrimin procedural për të propozuar dhe zhvilluar kontrollin e thelluar në periudhën objekt, duke garantuar mbulim dhe trajtim substancial të çështjeve të ngritura. Statusi: Zbatuar.

Ky rekomandim rezulton i pranuar dhe zbatuar plotësisht.

11.1 Rekomandimi: Drejtoria Rajonale Tatimore Fier të analizojë dhe verifikojë 33 kontratat e porosisë dhe të shitjes përfundimtare tek objekti “Godinë e kombinuar 11 kate + 1 katë nëntokë, Lagjja Apollonia, Fier”, i shoqërisë “G”, si dhe të kërkojë nga Drejtoria Teknike dhe Ligjore në DPT interpretim ligjor dhe fiskal për vlerësim tatimor në lidhje me çmimet mesatare referuese të

shitjes në kontratat e porosisë të nënshkruara përpara hyrjes në fuqi të VKM Nr168, datë 27.3.2019, kur objekti ndërtimor ka qenë në proces legalizimi për shtesat pa leje.

Qëndrimi i Subjektit: Për sa i përket analizimit të kontratave të shitjes së apartamenteve të subjektit “G” Shpk, për të cilat duhet marrë çmimi mesatar i referencës përpara hyrjes në fuqi të VKM-së për legalizimin e shtesave pa leje, sqarojmë sa vijon, subjekti i ka përpiluar kontratat në momentin e ndërtimit dhe, për atë periudhë, është përcaktuar çmimi referues përkatës. Në momentin e regjistrimit të objektit, subjekti nuk mund të rillogarisë detyrime të tjera mbi kontratat e mëparshme të nënshkruara.

Qëndrimi i Audituesve të Kontrollit të Lartë të Shtetit: Nga shqyrtimi i dokumentacioni dhe argumentimit e vënë në dispozicion, rezulton se DRT Fier e ka adresuar proceduralisht rekomandimin 11.1: (i) ka analizuar dosjen e kontratave (kontrata porosie dhe kontrata përfundimtare shitjeje) për objektin “Godinë e kombinuar 1 l kate + 1 kat nëntokë”, duke verifikuar kronologjinë e lidhjes së kontratave, skemat e pagesave me këste dhe momentin e kalimit të titullit; (ii) e ka përfshirë çështjen në Planin e Masave dhe ka vendosur në dijeni DPT-në, duke kërkuar interpretim ligjor/teknik për aplikimin e çmimeve referuese në rastet kur kontratat e porosisë janë nënshkruar përpara hyrjes në fuqi të VKM nr.168, datë 27.03.2019 dhe kur objekti ka qenë në proces legalizimi; (iii) pas analizës së kryer, ka mbajtur qëndrimin se nuk kryhet ndryshim/rillogaritje e çmimeve në momentin e kalimit të pronësisë, kur marrëdhënia kontraktore dhe çmimi janë përcaktuar paraprakisht në kontratat e porosisë, në përputhje me parimin e mos-retroaktivitetit dhe me momentin e lindjes së detyrimit tatimor sipas praktikës kontabël/fiskale. Në këtë kuptim, detyra e DRT Fier (analiza + referimi për interpretim) është përmbushur. Çdo vendimmarrje unifikuese mbi trajtimin fiskal të rasteve analoge (standardizim/udhëzim) mbetet kompetencë e DPT dhe do të ndiqet sipas përgjigjes/udhëzimit të saj. Statusi: Zbatuar proceduralisht brenda kompetencave nga DRT Fier.

Ky rekomandim rezulton i pranuar dhe zbatuar plotësisht.

12.1 Rekomandimi: Strukturat përgjegjëse pranë DRT Fier të përforcojnë procedurat aktuale të ndjekura për monitorimin e akt marrëveshjeve aktive në drejtim të vjeljes së detyrimeve të subjekteve debitorë, si dhe të marrin masat për dokumentimin e analizave përpara lidhjes së akt-marrëveshjeve, me qëllim përmbushjen e kushteve dhe minimizimin e riskut të anulimit, apo përsëritjes së tyre, si një alternativë për të mos kaluar në masa të tjera shtrënguese.

Qëndrimi i Subjektit: Sa i përket Akt-Marrëveshjeve, nga ana jonë ndiqet në mënyrë të rregullt kronologjia e pagesave të kryera nga tatimpaguesi, përkatësisht pagesat e kësteve të Akt-Marrëveshjes si edhe detyrimet korente të lindura. Për tatimpaguesit që nuk i shlyejnë në mënyrë të rregullt këstet e Akt-Marrëveshjes dhe detyrimet korente, vihet në zbatim zgjidhja e Akt-Marrëveshjes dhe përfundimi i planit të pagesës me këste. Përpara lidhjes së një Akt-Marrëveshjeje, për çdo tatimpagues që depoziton kërkesë në DRT Fier, hartohet akt-verifikimi ku analizohen pasqyrat financiare, situata e deklarimeve, kapitali i shoqërisë, qarkullueshmëria e inventarit dhe likuiditetet e tjera. Gjithashtu, për çdo kërkesë të marrë, kërkohet dokumentacioni i ekstrakteve bankare për të gjitha bankat e nivelit të dytë me të cilat operon tatimpaguesi. Për tatimpaguesit të cilëve u është zgjidhur Akt-Marrëveshja e pagesës me këste, nuk është vijuar me lidhjen e një Akt-Marrëveshjeje të re.

Qëndrimi i Audituesve të Kontrollit të Lartë të Shtetit: Evidentojmë se DRT Fier ka ndërmarrë hapa konkretë për përforcimin e praktikës së akt-marrëveshjeve: ndjekje kronologjike pagesash (këste + detyrime korente), zgjidhje të menjëhershme të akt-marrëveshjeve jo të respektuara, si

dhe vendosje të një akt-verifikimi paraprak (analizë pasqyrash financiare, kapital, qarkullueshmëri inventari, likuiditete) të shoqëruar me ekstrakte bankare. Po ashtu, deklarohet se nuk lidhen më akt-marrëveshje të reja me tatimpagues për të cilët një marrëveshje e mëparshme është zgjidhur për mosrespektim. Megjithatë, për ta konsideruar rekomandimin plotësisht të mbyllur, kërkohet provë e qëndrueshme dokumentare dhe zbatim i konsoliduar në të gjitha rastet (p.sh. dosje të plota me akt-verifikim, checklist procedural sipas pikës 5.8 të Manualit, arsyetim financiar për aftësinë shlyerse dhe gjurmë vendimmarrjeje për mos-përsëritjen e marrëveshjeve). Gjithashtu, për rastet historike të evidentuara (21 subjektet me përsëritje/prishje), kërkohet të dokumentohet korrigjimi i praktikës dhe monitorimi i mëtejshëm. Në këtë kuadër, vlerësojmë pozitivisht masat e marra dhe drejtimin e duhur të përmirësimit, por nevojitet verifikim në kampion dosjesh pas datës së masave për të konfirmuar që:

- Akt-verifikimi paraprak është i pranishëm dhe i plotë në çdo dosje;
- Argumentimi i “aftësisë për të zbatuar kushtet” është i dokumentuar me tregues financiarë;
- Mospërsëritja e marrëveshjeve pas zgjidhjes po respektohet;
- Monitorimi periodik dhe masa shtrënguese alternative aplikohen në kohë.

Duke qenë se këto elemente duhen verifikuar në një kampion dosjesh të lidhura pas periudhës së auditimit, vlerësojmë se administrata ka ndërmarrë masa pozitive dhe në linjë me rekomandimin. Statusi i zbatimit: Në proces zbatimi.

Ky rekomandim rezulton i pranuar dhe zbatuar plotësisht.

13.1 Rekomandimi: Drejtoria Rajonale Tatimore Fier të marrë masat për përcjelljen e kësaj problematike pranë DPT, ku strukturat përgjegjëse pranë DPT-në, në bashkëpunim me DPD-në dhe AKSHI-n, të ngrenë një grup pune me përfaqësues nga këto institucione, me qëllim verifikimin e shkaqeve që sjellin rezultate të ndryshme mes deklarimeve sipas DPT dhe DPD, me qëllim ndërmarrjen më pas të veprimeve rregulluese në sistemet sipas së cilave funksionojnë këto institucione, për të shmangur ekzistencën e diferencave në deklarim dhe për të fokusuar punën e inspektorëve të kontrollit të zyrës në diferenca që mund të përbëjnë realisht risk, dhe jo atyre që vijnë vetëm si shkak të raportimit të gabuar të të dhënave sipas sistemeve.

Qëndrimi i Subjektit: Në zbatim të rekomandimit 13.1 të KLSH-së, Drejtoria Rajonale Tatimore Fier, në bashkëpunim me DPT-në dhe strukturën përgjegjëse të AKSHI-t pranë DPT-së, ka mundur gjenerimin e raporteve për deklarimet analitike import–eksport dhe për diferencat në deklarime Import–Eksport (DPD–DPT). Në sistemin tatimor C@ts, në menynë “Raporte”, si edhe në sistemin Portali Qendror për Kontroll dhe Menaxhim (CPCM), shfaqen të gjitha të dhënat analitike të deklaratave doganore. Për rastet kur konstatohet problematikë në transmetimin e deklaratës, komunikohet në mënyrë shkresore me DPD-në për çdo rast të konstatuar.

Qëndrimi i Audituesve të Kontrollit të Lartë të Shtetit: Pranohet se DRT Fier ka vepruar proceduralisht: problematika është përcjellë dhe, në bashkëpunim me DPT dhe AKSHI, janë vënë në funksion raporte analitike Import–Eksport në C@ts dhe CPCM; po ashtu, për rastet me mospërputhje bëhet komunikim zyrtar me DPD rast-pas-rasti. Këto masa adresojnë kërkesën për nxitje bashkërendimi dhe përmirësim të gjenerimit/leximit të të dhënave. Megjithatë, zgjidhja e plotë sistematike (krijimi dhe funksionimi i plotë i grupit të përbashkët DPT-DPD-AKSHI, identifikimi/ndreqja e shkaqeve rrënjësore dhe eliminimi i diferencave të gjeneruara nga sistemi) mbetet në kompetencë të DPT, DPD dhe AKSHI dhe ende nuk është provuar si e finalizuar. Deri atëherë, diferencat po menaxhohen, por nuk provohet se janë eliminuar në burim. Procedurat nga DRT Fier janë kryer; përmbyllja kërkon vendimmarrje dhe ndërhyrje sistematike nga DPT/DPD/AKSHI. Statusi i zbatimit: Zbatuar proceduralisht.

Ky rekomandim rezulton i pranuar dhe zbatuar plotësisht.

14.1 Rekomandimi: Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve të marrë masa të menjëhershme për verifikimin e pasojave ekonomike administrative ligjore me efekte në të ardhurat tatimore në Buxhetin e Shtetit që kanë lindur si pasojë e veprimeve të kryera pas nxjerrjes së aktit administrativ të kundërligjshëm sipas urdhrave të mësipërm, gjatë periudhës dhe fushës materiale që ka mbuluar akti administrativ, si dhe të marrë masat për eliminimin e këtyre veprimeve.

Qëndrimi i Subjektit: Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve ka filluar ecurinë disiplinore ndaj z. A. P. me detyrë Drejtor Rajonal në Drejtorinë Rajonale Tatimore Fier me shkresën e DPT nr. 12886/2 prot datë 04.09.2024, protokolluar në DRT Fier me shkresën nr. 9418/99 prot datë 06.09.2024, në lidhje me shkeljet e konstatuara në Raportin Përfundimtar të Auditimit të ushtruar në DRT Fier nga Kontrolli i Lartë i Shtetit. Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve me Vendim Nr. 417 datë 29.10.2024, dërguar me shkresën nr. 12886/10 prot datë 29.10.2024, protokolluar në DRT Fier me nr. 9418/139 prot datë 01.11.2024, ka vendosur marrjen e masës disiplinore “Largim nga shërbimi civil” për nëpunësin civil z. A.P.

Qëndrimi i Audituesve të Kontrollit të Lartë të Shtetit: Nga shqyrtimi i veprimeve të kryera nga Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve (DPT) konstatohet se:

- Është ndërmarrë masë disiplinore ndaj ish-Drejtorit Rajonal të DRT Fier, z. A.P., me nisjen e procedurës disiplinore, shkresa nr.12886/2 prot., datë 04.09.2024 dhe vendimmarrjen përfundimtare me Vendimin nr.417, datë 29.10.2024, për “Largim nga shërbimi civil”, i dërguar e protokolluar sipas afateve.

- Këto veprime adresojnë pjesërisht kërkesën e rekomandimit, duke sanksionuar personin përgjegjës për aktet administrative të kundërligjshme.

Megjithatë, rekomandimi i KLSH-së nuk kufizohet vetëm në marrjen e masave disiplinore ndaj personave përgjegjës, por kërkon gjithashtu:

- Verifikim të pasojave ekonomike, administrative dhe ligjore që kanë ndikuar në të ardhurat tatimore në Buxhetin e Shtetit si rezultat i urdhrave të paligjshëm;

- Marrjen e masave konkrete për eliminimin e pasojave të këtyre veprimeve, për të rikthyer situatën në përputhje me kuadrin ligjor.

Nga dokumentacioni i paraqitur nuk rezulton se këto dy komponentë kryesorë (analiza e efekteve ekonomike dhe masat për eliminimin e tyre) janë realizuar apo finalizuar.

Statusi i zbatimit të rekomandimit: Zbatuar Pjesërisht.

Arsyetimi: Është përmbushur komponenti disiplinor ndaj drejtuesit përgjegjës, por mungojnë prova për verifikimin e plotë të pasojave ekonomike-administrative dhe për ndërmarrjen e masave për eliminimin e tyre, siç kërkon në mënyrë të plotë rekomandimi i KLSH-së.

Ky rekomandim rezulton i pranuar dhe zbatuar plotësisht.

15.1 Rekomandimi: DPT të marrë masat për të vlerësuar zgjidhje optimale në sistemin C@ts me qëllim zgjidhjen e problematikave të trajtuara më sipër në drejtim të aplikimit automatik të penaliteteve për tatimpaguesit që kanë likuiduar me vonesë këstet e parapagimeve të tatim fitimit apo të pagesës për këstin do të shkojë për detyrimin më të hershëm të tij, rivlerësimeve të kësteve, apo edhe proporcionalitetit të parapagimeve të kësteve të tatim fitimit krahasimisht me tatim fitimin e periudhës.

Qëndrimi i Subjektit: Në zbatim të rekomandimit 15.1 të KLSH-së, nga ana e DPT-së është aplikuar në sistemin C@ts llogaritja dhe kontabilizimi automatik i penaliteteve për tatimpaguesit

që kanë likuiduar me vonesë këstet e parapagimeve të tatimfitimit; pagesa e këstit alokohet automatikisht te detyrimi më i hershëm. Lidhur me kontabilizimin e gjobave për këstet që nuk ishin kontabilizuar në sistem, Drejtoria Rajonale Tatimore ka marrë masat për përfundimin e procedurës së kontabilizimit të tyre, si më poshtë:

Deri më datë 02.05.2024 ka përfunduar procedura e penalizimit për tatimpaguesit:

Nr	Subjekti	NIPT	Diferenca	Inspektori	Koment	Viti
1	X	L	284,678	Artan Hajdini	Penalizuuar pas Akt Konstatimit te glupit te auditimit (datë 13.05.2024)	2021
2	A	I	259,147	Zhaneta Abazi	Penalizuuar pas Akt Konstatimit te glupit te auditimit (datë 13.05.2024)	2021
3	S	L	562,623	Artan Hajdini	Penalizuuar pas Akt Konstatimit te grupit te auditimit (datë 02.05.2024)	2022
4	B	K	435,500	Artan Hajdini	Penalizuuar pas Akt Konstatimit te grupit te auditimit (datë 02.05.2024)	2022
5	S	K	168,480	Artan Hajdini	Penalizuuar pas Akt Konstatimit te grupit te auditimit (datë 02.05.2024)	2022
6	S	M	115,776	Artan Hajdini	Penalizuuar pas Akt Konstatimit te grupit te auditimit (datë 02.05.2024)	2022
7	O	M	103,101	Esat Faria	Penalizuuar pas Akt Konstatimit te grupit te auditimit (datë 16.05.2024)	2022
8	C	J	99,993	Esat Faria	Penalizuuar pas Akt Konstatimit te grupit te auditimit (datë 16.05.2024)	2022
9	S	L	312,779	Artan Hajdini	Penalizuuar pas Akt Konstatimit te grupit te auditimit (datë 02.05.2024)	2023
10	A	L	239,812	Xhensila Pone	Penalizuuar pas Akt Konstatimit te grupit te auditimit (datë 02.05.2024)	2023
11	B	K	163,158	Artan Hajdini	Penalizuuar pas Akt Konstatimit te grupit te auditimit (datë 02.05.2024)	2023
12	C	J	149,989	Artan Hajdini	Penalizuuar pas Akt Konstatimit te grupit te auditimit (datë 02.05.2024)	2023
13	S	K	149,372	Artan Hajdini	Penalizuuar pas Akt Konstatimit te grupit te auditimit (datë 02.05.2024)	2023
14	E	L	122,035	Artan Hajdini	Penalizuuar pas Akt Konstatimit te grupit te auditimit (datë 02.05.2024)	2023
			3,166,443			

- Për tatimpaguesin X, me NIPT L., me vendim të DAT nr. 3102/1, datë 06.08.2024, është shfuqizuar Njoftimi i Vlerësimit nr. 3102 prot., datë 16.05.2024, nxjerrë nga DRT Fier, për gjobën në masën 20.518 lekë për mospagim të kësteve të tatimfitimit për periudhën janar–dhjetor 2021.

- Për tatimpaguesin S., me NIPT L., me vendim të DAT nr. 3100/4, datë 06.08.2024, është shfuqizuar Njoftimi i Vlerësimit për detyrimet nr. 3100 prot., datë 16.05.2024, nxjerrë nga DRT Fier, për gjobën në masën 38.731 lekë për mospagim të kësteve të tatimfitimit për periudhën janar–dhjetor 2021.

Gjodat ndaj subjekteve, të kontabilizuara nga inspektorët e kontrollit nga zyra pas datës 11.09.2024, janë në shumën 1,604,665 lekë.

Nr	Subjekti	NIPTi	Diferenca	Inspektori	DRT FIER	Viti	Shuma e kontabilizuar
1	P	L	403,450	ZA	Kontabilizuar dt. 11.09.2024	2021	403,450
2	M	J	167,964	F.H	Kontabilizuar dt. 17.09.2024	2021	5,484
3	S	J	119,757	Z Ab	Kontabilizuar dt. 11.09.2024	2021	119,757
4	G	L	109,895	Fa H	Kontabilizuar dt. 17.09.2025	2021	2,844
5	A	M	103,573	Fa H	Kontabilizuar dt. 11.09.2024	2021	103,573
6	M	L	102,899	EN	Kontabilizuar dt. 11.09.2024	2021	102,899
7	S	J	218,739	Z A	Kontabilizuar dt. 11.09.2024	2021	218,739
8	M	L	51,740	Z SH	Kontabilizuar dt. 11.09.2024	2022	51,740
9	V	L	204,757	F H	Kontabilizuar dt. 11.09.2024	2023	204,757
10	B	L	121,891	E S	Kontabilizuar dt. 11.09.2024	2023	121,891
			1,604,665				1,335,134

Gjodat e subjekteve që janë ose kanë qenë në administrimin e Drejtorive Tatimore të tjera, janë në shumën 6,605,650 lekë.

Nr	Subjekti	NIPT	Diferenca	Viti	Drejtoria ne Administrim
1	B	K	1,068,612	2021	DTM
2	P	K	822,146	2021	DTM
3	S	L	426,494	2021	DRT Vlorë
4	A	L	202,265	2021	DTM
5	A	L	130,053	2021	DRT Elbasan
6	B	K	1,989,454	2022	DTM
7	A	L	661,186	2022	DTM
8	G	L	114,222	2022	DRT Vlorë
9	P	L	91,600	2022	DTM
10	A	L	85,838	2022	DRT Elbasan
11	T	L	60,547	2022	DTM
12	P	K	50,887	2022	DTM
13	B	K	382,410	2023	DTM
14	I	K	285,529	2023	DTM
15	B	K	234,407	2023	DTM
			6,605,650		

Për këto gjopa do t'u dërgohet për veprime të mëtejshme drejtorive përkatëse. Nga ana jonë i jemi drejtuar me shkresë drejtorive përkatëse si më poshtë:

- Shkresa nr. 6344, datë 26.08.2024 - drejtuar DTM, për 11 raste, në vlerën 5,849,403 lekë.
- Shkresa nr. 6343, datë 26.08.2024 - drejtuar DRT Elbasan, për 3 raste, në vlerën 642,386 lekë.
- Shkresa nr. 6342, datë 26.08.2024 - drejtuar DRT Vlorë, për 1 rast, në vlerën 114,386 lekë.

Është kthyer përgjigje:

- Nga DRT Vlorë, me shkresën nr. 5801/1, datë 03.09.2024, protokolluar në DRT Fier me nr. 6342/1, datë 06.09.2024. Në këtë shkresë konfirmohet se dokumentet ndodhen në dosjen fizike të tatimpaguesit. Në vijim të kësaj përgjigjeje, nga verifikimi në sistemin C@ts i kryer nga ana jonë, rezultoi se subjekti, më 17.01.2023, është penalizuar me gjobë këstesh për periudhën 22-A, në shumën 126,608 lekë. Gjopa është kontabilizuar në C@ts me çështjen nr. Serial C0001356606, hapur më 13.01.2023 dhe mbyllur më 17.01.2023, sipas aktit nr. 199 prot., datë 12.01.2023.

- Nga DRT Elbasan, me shkresën nr. 6829/1, datë 04.09.2024, protokolluar në DRT Fier me nr. 6343/1, datë 06.09.2024, ku është konfirmuar kontabilizimi i penaliteteve për mospagim të kësteve të tatimit për tatimpaguesin A. për të dy periudhat 2021-2022, në vlerën totale 215.893 lekë. Pas marrjes së përgjigjes nga DRT Elbasan për tatimpaguesin S., nga verifikimi i dokumentacionit në sistemin tatimor C@ts rezultoi se, për periudhën për të cilën referohet KLSH, subjekti ka qenë në administrimin e DRT Vlorë; për këtë arsye i jemi drejtuar me shkresë nr. 6543, datë 12.09.2024, për sqarim të situatës.

- Nga DTM, është kthyer përgjigje me shkresën nr. 6344/1, datë 13.09.2024, për 11 tatimpagues, duke sqaruar me dokumentacion shoqërues kontabilizimet në sistemin C@ts për periudhën 2022–2023.”

Qëndrimi i Audituesve të Kontrollit të Lartë të Shtetit: Në vlerësim të rekomandimit 15.1 dhe dokumentacionit shoqërues, konstatojmë se DRT Fier e ka përmbushur plotësisht, proceduralisht dhe brenda kompetencave të saj, detyrimin për adresimin e penaliteteve të kësteve të Tatimit dhe pasqyrimin e tyre në sistem: Zbatim operativ i penaliteteve/akt-vlerësimeve: janë llogaritur dhe kontabilizuar penalitete për këstet e paguara me vonesë (p.sh. totali i kontabilizuar nga inspektorët pas akt-konstatimit, si dhe seritë e çështjeve në C@ts). Janë reflektuar gjithashtu vendimet e ankimit ku është urdhëruar shfuqizim (p.sh. “X” dhe “S”), duke korrigjuar pozicionet në sistem. Trajtimi i rasteve jashtë juridiksionit: rastet që u përkasin DTM/DRT të tjera janë përcjellë zyrtarisht me shkresa referuese (DTM, DRT Elbasan, DRT Vlorë), dhe DRT Fier ka ndjekur përgjigjet dhe ka bërë rakordimet në C@ts kur provat e kontabilizimit janë konfirmuar (p.sh. përgjigjet konfirmuese nga DRT Vlorë dhe DRT Elbasan; përgjigja e DTM me listimin shoqërues të kontabilizimeve). Evidencë/arkivim dhe transparencë procedurale: praktikat e rivlerësimit dhe penalizimit janë mbajtur me akte, njoftime vlerësimi dhe gjurmë në C@ts; komunikimi ndër-institucional është dokumentuar. Nga ana tjetër, elementët e mbetur janë të natyrës sistematike dhe kompetencë e DPT si logjika e alokimit automatik të detyrimit më i hershëm, standardizimi/moduli i rivlerësimeve në C@ts. Mosplotësimi përfundimtar i këtyre komponentëve nuk i ngarkohet DRT Fier, e cila e ka përmbushur rolin e vet ekzekutiv. Statusi i zbatimit: Zbatuar në nivel DRT Fier, proceduralisht brenda kompetencave të saj, kurse komponentët sistematikë të C@ts dhe rregullat e përgjithshme të alokimit/rivlerësimit vijnë si proces në nivel DPT.

Ky rekomandim rezultoi i pranuar dhe zbatuar plotësisht.

16.1 Rekomandimi: Drejtoria Rajonale Tatimore Fier të marrë masat e duhura administrative konform legjislacionit tatimor për të shqyrtuar diferencat e mësipërme midis qarkullimit të deklaruar në formularin e deklarimit të pagesës të TVSH-së (FDP) dhe deklaratën e Tatimit mbi

Fitimit, duke intensifikuar vlerësimet dhe rivlerësimet përkatëse si dhe propozimeve pranë Sektorit të Kontrollit në Vend në DRT Fier për kontrollet e thelluara në vend ose vizitave fiskale për tatimpaguesit me risk të lartë apo pamundësi vlerësimi nga zyra.

Qëndrimi i Subjektit: Në lidhje me rekomandimin e mësipërm nga DRT Fier janë vendosur në dispozicion sqarimet për secilin rast, konkretisht si në tabelat në vijim:

Nr.	Nipt	TVSH	TF	DIF 2021	Inspektori	Shënime
1	K	62,687,089	9,495,000	53,192,089	A.D.	Arkëtim 2021 nga shitje 2020; referencë shkresa 3498 (06.03.2020)
2	K	33,499,820	-	33,499,820	A.D.	Nuk ka dorëzuar PF/TF; procedurë bashkimi
3	L	68,469,340	63,142,042	5,327,298	A.D.	Të ardhura të shtyra; kontroll i plotë
4	L	213,346,985	209,602,930	3,744,055	A.D.	Autogarkesë në shitje/blerje; verifikim sistemi
5	K	105,903,516	120,955,190	-15,051,674	A.D.	Prodhim në proces + kurs këmbimi; verifikuar me akt kontrolli
6	K	55,762,972	70,883,052	-15,120,080	A.D.	Subvencione + të ardhura të shtyra; sqaruar në shënime/raport ekspërit
7	K	49,215,998	64,431,055	-15,215,057	A.D.	Të ardhura të shtyra në pasiv; detajuar në PASH
8	K	252,187,208	267,608,436	-15,421,228	A.D.	Rimarrje të ardhurash të shtyra (15,421,230)
9	K	219,052,858	239,185,293	-20,132,435	A.D.	Rimarrje nga grant; kontroll i plotë për TF
10	K	776,961,366	860,063,637	-83,102,271	A.D.	Të ardhura të shtyra (79,956,980) + diferencë kursi (3,145,946) në PASH
11	K	868,391,735	-	868,391,735	A.D.	Nuk ka dorëzuar PF/TF; bashkim; propozuar kontroll i plotë
12	K	872,961,089	58,395,686	814,565,403	A.D.	Transferim asetë + të ardhura të tjera; bashkim; kontroll i plotë
13	L	559,384,864	31,785,043	527,599,821	A.D.	Transferim asetë + të ardhura të tjera; bashkim; kontroll i plotë
14	J	255,490,108	75,034,477	180,455,631	A.D.	Transferim asetë + të ardhura të tjera; njoftuar fillim kontrolli i plotë
15	K	318,828,083	312,591,154	6,236,929	A.D.	Arkëtime në avancë (6,218,374) + të tjera; pasiv bilanci
16	L	-	13,343,325	-13,343,325	A.D.	Pa përgjegjësi TVSH në periudhë
17	K	307,112,059	332,433,890	-25,321,831	A.D.	Ndryshim gjendje produkt i gatshëm + të ardhura të tjera; kontroll i plotë
18	K	3,238,998,621	195,258,263	3,043,740,358	A.D.	(2022) Transferim asetë + të ardhura/interesa; bashkim; kontroll i plotë
19	J	429,267,061	569,786,797	-140,519,736	A.D.	(2022) Të ardhura të tjera (puna KAP, interesa); njoftuar fillim kontrolli i plotë
20	M	66,305,382	41,356,505	24,948,877	A.M.	Diferenca = arkëtime nga paradhënie; sqaruar me çështjen E0001081522; reflektuar në PF
21	L	12,579,333	6,533,333	6,046,000	A.M.	Parapagime të arkëtuara; në kontroll të plotë (Njoftim 12395/1, 13.02.2023)
22	L	5,522,754	17,176,358	-11,653,604	A.M.	I regjistruar me TVSH nga 23.09.2021 (prandaj diferencë 21-A)
23	L	-	12,171,574	-12,171,574	A.M.	Pa përgjegjësi TVSH (21-A)
24	M	-	13,018,401	-13,018,401	A.M.	Pa përgjegjësi TVSH (21-A)
25	M	99,874,700	5,111,700	94,763,000	A.M.	Diferenca = parapagime të marra
26	M	138,567,205	151,346,595	-12,779,390	A.M.	Diferenca = paradhënie të faturuara më herët; në pasiv "parapagime të arkëtuara"
27	L	163,124,021	112,102,109	51,021,912	A.H.	Parapagime në pasqyrë pozicioni financiar + të ardhura nga kursi
28	K	319,152,057	287,678,390	31,473,667	A.H.	Diferenca nga parapagime (pa TVSH) sipas shënimeve 2021
29	L	69,072,716	51,161,732	17,910,984	A.H.	Rritje "të ardhura të shtyra + parapagime"; pjesa tjetër detyrime ndaj ortakëve (jo deklaruar si "të tjera")
30	K	129,846,355	119,012,959	10,833,396	A.H.	Parapagime të arkëtuara (10,833,396) në pasiv
31	K	727,000	12,185,942	-11,458,942	A.H.	Kaluar në TVSH më 24.12.2021; deklarim vetëm dhjetor 2021
32	L	176,686	11,665,525	-11,488,839	A.H.	Kaluar në TF/TVSH më 11.11.2021
33	K	54,959,953	81,566,229	-26,606,276	A.H.	Ulje e "të ardhurave të shtyra" (-26,606,097)
34	K	201,604,728	263,953,783	-62,349,055	Aha	Të ardhura nga kamatëvonesa, subvencione, këmbim valutor, grante, të tjera (shuma në shënim)
35	J	288,399,235	177,653,250	110,745,985	A.H.	Dërguar për kontroll të plotë (shkresa 391, 19.01.2024)
36	L	401,476,069	323,319,304	78,156,765	AH	Rritje parapagimesh (78,156,765)
37	L	134,298,169	103,853,566	30,444,603	AH	Rritje "të ardhura të shtyra + parapagime të arkëtuara" (30,444,603)
38	L	64,122,923	43,815,078	20,307,845	AH	Të ardhura të shtyra/parapagime (20,307,845)
39	J	135,043,385	126,148,444	8,894,941	AH	Diferenca nga parapagime për prenotim apartamenti + efekt kursi
40	L	10,868,290	4,633,602	6,234,688	A.H.	Rivlerësim tatimpaguesi
41	K	52,873,739	49,487,948	3,385,791	AH	Arkëtime në avancë të deklaruar
42	K	286,861,724	299,144,597	-12,282,873	A.H.	Të ardhura kursi këmbimi + të tjera financiare (nota kredi)
43	K	305,201,636	330,035,475	-24,833,839	AH	Ulje e të ardhurave në avancë (2022)
44	K	239,170,461	317,498,598	-78,328,137	A.H.	Ndryshim inventar/prodhim proces + të ardhura/interes + parapagime (-) + të tjera
45	L	192,491,363	109,374,838	83,116,525	D.D.	Regjim fason: në situatë shfaq totalin (hak pune + material); në TF vetëm haku i punës
46	L	51,778,612	20,471,461	31,307,151	D.D.	"Borgji i keq" deklaruar me minus në të ardhura; saktësuar me akt në vend
47	L	55,827,407	40,827,407	15,000,000	D.D.	Llogaria "parapagime" në bilanc
48	J	288,658,991	280,511,465	8,147,526	D.D.	Arkëtime në avancë; saktësuar në shënim PF 2021
49	L	16,403,960	8,522,735	7,881,225	D.D.	Shitje aktivi; deklaruar si diferencë me vlerën neto në PF/TF
50	L	-	10,889,953	-10,889,953	DD	Pa përgjegjësi TVSH në 2021 (kaluar 04.04.2022)
51	K	-	10,925,118	-10,925,118	D.D.	Pa përgjegjësi TVSH në periudhë
52	L	-	11,000,000	-11,000,000	D.D.	OJF; pa përgjegjësi TVSH (neni 3 Ligji TVSH)
53	K	-	11,306,871	-11,306,871	D.D.	Pa përgjegjësi TVSH në periudhë
54	L	-	11,777,961	-11,777,961	D.D.	Kaluar në TVSH më 11.03.2022; 2021 pa TVSH
55	K	-	13,740,975	-13,740,975	D.D.	OJF; pa përgjegjësi TVSH (neni 3)
56	M	29,453,158	48,951,198	-19,498,040	D.D.	Kaluar me përgjegjësi TVSH (ndryshim regjimi)
57	J	848,619,011	873,663,887	-25,044,876	D.D.	Grante AZHBR (linjë prodhimi turshi) + të ardhura financiare; saktësuar me akt në vend
58	L	-	26,381,127	-26,381,127	D.D.	Pa të ardhura aktiviteti; të ardhura në PF = subvencione bashkie (PASH)
59	L	518,335	31,076,945	-30,558,610	D.D.	Grante nga Bashkia Lushnjë; të ardhurat e deklaruar
60	J	53,636,568	95,267,405	-41,630,837	D.D.	Subvencione; propozuar kontrolli i thelluar; njoftuar fillim kontrolli i plotë
61	J	406,667,280	519,291,726	-112,624,446	D.D.	Subvencione; propozuar kontrolli i thelluar; njoftuar fillim kontrolli i plotë
62	L	-	175,278,149	-175,278,149	D.D.	Aktivitet i përjashtuar nga TVSH (neni 53/b — garantim kredie)
63	J	735,563,582	583,563,773	151,999,809	D.D.	Arkëtime në avancë (-152 mln) në pasiv
64	K	45,241,306	13,998,136	31,243,170	D.D.	Vetëkorrigjim deklarate TF 2022
65	M	26,381,700	3,477,700	22,904,000	D.D.	Diferenca = parapagime të arkëtuara (PF 2022)
66	K	582,411,649	594,633,842	-12,222,193	D.D.	Arkëtime në avancë (7,991,668) + rivlerësim shitjesh TF; saktësuar me akt
67	K	10,332,204	23,459,442	-13,127,238	D.D.	Pa përgjegjësi TVSH; kalim 29.08.2022
68	L	-	13,150,000	-13,150,000	D.D.	OJF; pa përgjegjësi TVSH (neni 3)
69	J	107,399,926	126,452,939	-19,053,013	D.D.	Pa PF 2022; dërguar në kontroll; diferenca nga deklarim total me TVSH; vetësisht; TF=107,399,926
70	L	-	20,233,946	-20,233,946	D.D.	Kaluar TF 18.10.2022 dhe TVSH 18.01.2023; dublim të ardhurash në TF
71	K	-	21,116,600	-21,116,600	D.D.	OJF; pa përgjegjësi TVSH (neni 3)
72	L	-	31,193,794	-31,193,794	D.D.	Si nr. 58: subvencione bashkie (jo të ardhura aktiviteti)
73	L	-	156,632,069	-156,632,069	D.D.	Si nr. 62: aktiviteti i përjashtuar (neni 53/b)
74	L	186,238,892	68,944,201	117,294,691	E.M.	Arkëtime në avancë (ndërtim); saktësuar me akt 13695/1 (13.02.2023)

75	L	180,128,392	67,934,793	112,193,599	EM	Arkëtime në avancë (ndërtim); akt 9287/1 (17.01.2024)
76	L	200,865,350	164,565,350	36,300,000	EM	Arkëtime në avancë (pallate në ndërtim)
77	L	242,711,585	230,205,358	12,506,227	EM	Arkëtime në avancë (fatura spec. 2021)
78	K	672,302,355	666,273,104	6,029,251	EM	Arkëtime në avancë për porosi
79	L	13,828,615	8,664,517	5,164,098	EM	Kontrolluar me akt 14796/1 (24.03.2023)
80	L	272,126,976	268,592,865	3,534,111	EM	Arkëtime në avancë
81	L	33,614,330	30,670,661	2,943,669	EM	Të ardhura grant AZHBR; akt 14793/1 (04.04.2023)
82	L	279,449,680	301,253,619	-21,803,939	EM	Të ardhura të tjera (grant AZHBR)
83	L	356,553,887	176,629,429	179,924,458	EM	Arkëtime në avancë (ndërtim); akt 9287/1 (17.01.2024)
84	L	153,511,118	62,805,121	90,705,997	EM	Arkëtime në avancë (ndërtim); akt 13695/1 (13.02.2023)
85	L	55,373,921	7,976,421	47,397,500	EM	Arkëtime në avancë (ndërtim)
86	K	326,930,751	320,354,565	6,576,186	EM	Pakesim "të ardhura të shtyra" (tollona 2020 tërhequr 2021)
87	K	71,399,993	66,978,492	4,421,501	EM	Të ardhura të shtyra; fatura parapagimi furnizimesh
88	L	293,396,993	289,202,754	4,194,239	EM	Vetëfaturim fidanësh (prodhim në sera)
89	K	-	19,691,042	-19,691,042	EM	Pa diferencë; TVSH nga 2023
90	J	-	20,964,217	-20,964,217	EM	Pa diferencë; TVSH nga 2023
91	K	71,399,993	66,978,492	4,421,501	EM	Dublim (nr. 144/195)
92	M	113,469,646	82,919,567	30,550,079	E S	Arkëtime në avancë; pasqyruar në PF
93	L	32,737,164	28,557,109	4,180,055	E S	Deklarata ndryshuar; pa diferencë
94	M	30,110,004	26,379,713	3,730,291	E S	Vlerësuar me akt-vlerësim
95	L	394,600	11,015,085	-10,620,485	E S	Kaluar TVSH 29.12.2021; diferenca shitje pa TVSH
96	L	-	11,233,876	-11,233,876	E S	Pa përgjegjësi TVSH
97	M	18,529,595	-	18,529,595	E S	Në procedurë rivlerësimi nga zyra
98	K	-	11,805,060	-11,805,060	E S	Pa përgjegjësi TVSH
99	K	-	11,951,677	-11,951,677	E S	Pa përgjegjësi TVSH; shtuar janar 2023
100	L	-	8,558,850	-17,117,100	E S	Pa përgjegjësi TVSH
101	M	-	9,081,273	-18,262,546	E S	Pa përgjegjësi TVSH
102	L	95,238,604	119,101,353	-23,862,749	E S	Kaluar TVSH 13.10.2022; diferenca shitje pa TVSH
103	L	29,288,300	13,972,550	15,315,750	FH	Arkëtime në avancë (13,197,417) + ...
104	K	1,302,748	12,358,726	-11,055,978	FH	Pa përgjegjësi TVSH
105	L	265,600	13,211,163	-12,945,563	FH	Dy përgjegjësi: TFTH/TF dhe TVSH në dhjetor 2021
106	L	38,893,229	54,812,127	-15,918,898	FH	Subvencion/grant AZHBR, penalitete/gjoha; në shënime shpjeguese
107	L	2,659,483	18,702,371	-16,042,888	FH	Pa përgjegjësi TVSH; nuk shfaqet në situata
108	L	1,302,259	18,580,276	-17,278,017	FH	Propozuar kontrolli i thelluar
109	L	3,268,251	-	3,268,251	FD	Pa përgjegjësi TVSH/TF; më pas kaluar me përgjegjësi
110	K	10,227,854	27,055,922	-16,828,068	FD	Pa përgjegjësi; më pas kalim në TVSH/TF
111	L	2,555,045	19,526,500	-16,971,455	FD	Pa përgjegjësi TVSH; më pas kalim në TVSH
112	L	27,278,344	13,906,020	13,372,324	J V	Subjekt pasiv që prej 2021; diferenca = paradhënie (pasiv)
113	K	9,880,367	-	9,880,367	J V	Transferim veprimtarie (faturë shitje 25.05.2021)
114	M	23,322,542	18,204,322	5,118,220	J V	Deklarata ndryshuar; pa diferencë
115	L	-	10,436,080	-10,436,080	J V	2021 pa TVSH
116	L	-	10,470,827	-10,470,827	J V	2021 pa TVSH
117	K	-	10,987,663	-10,987,663	J V	2021 pa TVSH
118	K	-	11,148,651	-11,148,651	J V	2021 pa TVSH
119	J	56,986,028	47,239,261	9,746,767	J V	Shitje aktivi (tokë) - neto + grante; diferenca e saktësuar në shënime
120	K	143,878,157	138,919,218	4,958,939	J V	Të ardhura të shtyra (pasiv)
121	K	1,780,380	13,009,135	-11,228,755	J V	Kaluar TVSH tetor 2022
122	L	87,208,084	100,207,257	-12,999,173	J V	Të ardhura të tjera
123	K	-	9,280,270	-13,961,931	J V	Subjekt pa TVSH; ndryshuar në 2023
124	J	160,378,577	178,088,883	-17,710,306	J V	Kompensim nafte + rimbursim TVSH jashtë (SI/DE)
125	M	48,444,800	44,515,065	3,929,735	K K	Arkëtime në avancë; vlera saktësuar në PF 2022
126	K	132,043,933	36,301,208	95,742,725	L F	Arkëtime në avancë (53.8 mln) + proces (32.1 mln)
127	K	337,888,687	303,488,686	34,400,001	L F	Arkëtime në avancë për porosi (34.4 mln)
128	L	74,937,492	53,950,002	20,987,490	L F	Lëndë e parë/materiale të konsumuar
129	J	71,904,542	65,287,787	6,616,755	L F	Arkëtime në avancë (deklaruar)
130	L	147,613,192	143,319,969	4,293,223	L F	Rritje arkëtime në avancë + të ardhura nga kursi
131	L	91,295,049	50,636,080	40,658,969	L F	Kredit-note (36 mln) + parapagime (4.658.969)
132	K	88,532,758	51,417,789	37,114,969	L F	Arkëtime në avancë (30.591.969) + lëndë e parë (6.523.000)
133	L	27,408,750	5,301,206	22,107,544	L F	Grante + të ardhura të shtyra
134	M	19,690,000	-	19,690,000	L F	Parapagime për kontrata të lidhura
135	L	158,285,612	154,204,291	4,081,321	L F	Të tjera të shfrytëzimit (1.25 mln) + amortizim fondi AZHBR
136	M	23,533,224	35,531,765	-11,998,541	L F	Kaluar TVSH më 23.05.2022 (në mes të vitit)
137	K	2,751,515	19,829,453	-17,077,938	L F	Të tjera të shfrytëzimit; kalim TVSH më 22.11.2022
138	L	258,728,111	243,912,447	14,815,664	L R	Diferencë e papërfillshme (3.224 lekë) sipas raport-kontrollit
139	L	132,092,186	123,962,186	8,130,000	L R	Arkëtime në avancë (8,130,000) në pasiv
140	L	163,792,949	159,813,710	3,979,239	L R	Korrigjim TF 2021 (të ardhurat 163,792,949)
141	L	-	11,217,472	-11,217,472	L R	TF 2021 korrigjuar (të ardhura 1,622,262); TVSH nga 26.01.2023
142	L	100,096,472	83,779,209	16,317,263	L R	PF 2022: "Aktetive në avancë" -16,536,884 + "kursi" 219,621; pa diferenca reale
143	L	8,494,775	1,435,464	7,059,311	L R	"Parapagime të arkëtuara" 5,001,000 + "Parapagesa për inventare" -4,329,102 (3,439,775 në 2022)
144	K	5,384,072	-	5,384,072	L R	Tatimpaguesi ka ndërruar jetë
145	L	10,086,480	21,943,418	-11,856,938	L R	Kaluar TVSH më 01.07.2022; diferenca para TVSH-së
146	J	95,091,426	107,968,530	-12,877,104	L R	Të ardhura të tjera (PASH 2022)
147	K	39,557,000	55,684,250	-16,127,250	L R	PF 2022: Shitje punime/shërbime + qira; diferenca nga këto zëra
148	L	-	10,695,051	-10,695,051	OD	Pa përgjegjësi TVSH 2021
149	L	-	11,322,789	-11,322,789	O D	Pa përgjegjësi TVSH; kërkesë cregjistrim 08.09.2021; përsëri ka ndërruar jetë
150	L	29,115,670	-	29,115,670	O A	Pa diferenca; vetëkorrigjim TF
151	L	671,228,235	530,479,001	140,749,234	RV	Ndërtim; parapagime, rimarrje të ardhurash, kosto prodhimi; sqaruar në PASH 2022 dhe çështje E0001094664
152	L	68,520,198	50,678,044	17,842,154	R V	Sqaruar në PF 2022; "deftesa të pagueshme" (pasiv)
153	L	541,724,199	505,106,992	36,617,207	X P	Kaluar kontrolli i plotë (nr.11956, 16.01.2023)
154	L	43,209,409	18,357,756	24,851,653	X P	Arkëtime në avancë për porosi
155	L	213,495,419	207,052,422	6,442,997	X P	Arkëtime në avancë; sqaruar me raport kontrolli (17.10.2022)
156	L	83,732,470	94,131,636	-10,399,166	X P	Të ardhura të tjera shfrytëzimi; lëvizje "të ardhura të shtyra" 2020/2021
157	L	-	10,469,395	-10,469,395	X P	Pa përgjegjësi TVSH; më pas kalim me TVSH
158	L	57,333	12,994,369	-12,937,036	X P	Pa përgjegjësi TVSH; kalim 29.12.2021
159	L	50,081,005	76,575,754	-26,494,749	X P	Në kontroll të plotë (Njofim 15617, 22.12.2022)
160	L	53,485,770	65,030,557	-11,544,787	X P	Kaluar TF 25.05.2022 dhe TVSH 06.06.2022

161	M	1,152,000	12,903,787	-11,751,787	X P	Kaluar TF 20.10.2022; TVSH 02.12.2022
162	M	-	12,362,680	-12,362,680	X P	Pa përgjegjësi TVSH; më pas kalim me TVSH
163	M	5,445,845	18,678,585	-13,232,740	X P	Kaluar TF 20.10.2022; TVSH 02.12.2022
164	L	-	13,530,420	-13,530,420	X P	Pa përgjegjësi TVSH; më pas kalim me TVSH
165	L	53,485,770	65,030,557	-11,544,787	X P	Dublím (nr. 153/198)
166	M	1,152,000	12,903,787	-11,751,787	X P	Dublím (si nr. 161)
167	L	-	13,856,879	-13,856,879	XX	Pa përgjegjësi TVSH; më pas kalim me TVSH
168	L	344,794,101	170,947,847	173,846,254	X B	Arkëtime në avancë + të tjera të ardhura shfrytëzimi
169	J	125,245,265	106,898,171	18,347,094	X B	Të ardhura nga ndryshim gjendje
170	K	44,095,953	30,014,242	14,081,711	X B	Arkëtime në avancë për porosi
171	K	9,641,014	-	9,641,014	X B	Arkëtime në avancë për porosi
172	K	30,648,636	24,093,519	6,555,117	X B	Parapagime të arkëtuara
173	M	34,537,479	30,658,173	3,879,306	X B	Të ardhura të shtyra
174	K	10,488,857	23,870,056	-13,381,199	X B	Të ardhura të tjera të shfrytëzimit
175	L	480,121,542	235,941,097	244,180,445	X B	Arkëtime në avancë
176	L	140,552,816	98,797,984	41,754,832	X B	Parapagime të arkëtuara
177	K	42,800,900	8,593,424	34,207,476	X B	Arkëtime në avancë
178	K	43,932,541	33,443,361	10,489,180	X B	Të ardhura nga ndryshimi i gjendjes së produktit të gatshëm
179	K	108,294,031	101,155,898	7,138,133	X B	Penalitet për rritje të ardhurash në TVSH (Jan-Qer 2022); miratuar kontroll për pjesën tjetër
180	L	170,991,798	165,677,831	5,313,967	X B	Arkëtime në avancë
181	L	-	11,285,760	-11,285,760	X B	Kaluar TVSH 24.11.2022
182	M	-	12,787,691	-12,787,691	X B	Regjistruar me TVSH 18.01.2023
183	L	63,875,522	78,081,652	-14,206,130	X B	Të ardhura të tjera; grant AZHBR
184	L	320,329,933	337,940,837	-17,610,904	X B	Të ardhura nga puna e kryer për qëllime vetjake e kapitalizuar
185	L	2,508,384	20,934,127	-18,425,743	X B	TVSH nga 14.07.2022; shitje C/PCM (20,934,127)
186	L	-	11,285,760	-11,285,760	X B	(Si 181) TVSH 24.11.2022
187	K	53,078,275	28,903,489	24,174,786	Z S	Parapagime + të ardhura të tjera; sqaruar në PF
188	M	10,000,000	-	10,000,000	Z S	Të ardhura të shtyra; sqaruar në PF
189	L	-	13,491,239	-13,491,239	Z S	TVSH nga 2023
190	L	112,568,222	52,699,234	59,868,988	Z S	Skemë përpunim aktiv; diferenca = kosto lënde së parë (e ardhura reale = shitesa vlere)
191	K	50,298,230	31,954,681	18,343,549	Z S	Parapagime + të ardhura të tjera; sqaruar në PF
192	K	7,726,663	-	7,726,663	Z S	Vlerësim me akt; zbulim 0 (të ardhura <14 mln)
193	K	66,207,184	60,370,334	5,836,850	Z S	Arkëtime në avancë; sqaruar në PF
194	M	18,162,020	13,940,368	4,221,652	Z S	Arkëtime në avancë; sqaruar në PF
195	J	-	11,289,600	-11,289,600	Z S	Pa vlerësim (TVSH nga 11.05.2023)
196	M	11,980,051	23,635,221	-11,655,170	Z S	TVSH nga 14.07.2022 (diferencë para TVSH)
197	L	3,168,058	16,482,731	-13,314,673	Z S	TVSH nga 19.10.2022 (diferencë para TVSH)
198	J	498,488,898	516,380,515	-17,891,617	Z S	Të ardhura nga AZHBR (diferenca e sqaruar)
199	J	-	11,289,600	-11,289,600	Z S	Dublím (si nr. 195)
200	M	11,980,051	23,635,221	-11,655,170	Z S	Dublím (si nr. 196)

Niçpt	TVSH	TF	DIF 2022	Inspektori	Komente
K	3,238,998,621	195,258,263	3,043,740,358	A D	Transferim asete; të ardhura të tjera/interesa; procedurë bashkimi – kontroll i plotë
K	868,391,735	-	868,391,735	A D	S'ka dorëzuar PF dhe deklaraten e TF; procedurë bashkimi – propozim për kontroll të plotë
K	872,961,089	58,395,686	814,565,403	A D	Transferim asete; të ardhura të tjera; procedurë bashkimi – kontroll i plotë
L	559,384,864	31,785,043	527,599,821	A D	Transferim asete; të ardhura të tjera; procedurë bashkimi – kontroll i plotë
J	255,490,108	75,034,477	180,455,631	A D	Transferim asete; të ardhura të tjera; procedurë bashkimi – kontroll i plotë
K	318,828,083	312,591,154	6,236,929	A D	Arkëtime në avans për porosi (pasiv bilanci) dhe çështje të tjera
K	307,112,059	332,433,890	-25,321,831	A D	Gjendje produkt i gatshëm dhe të ardhura të tjera; ka kaluar në kontroll të plotë
J	429,267,061	569,786,797	-140,519,736	A D	Të ardhura të tjera (punë KAP, interesa); propozim për kontroll të plotë
M	99,874,700	5,111,700	94,763,000	A M	Diferenca = 'Parapagime të marra' (sipas PF 22-A)
M	138,567,205	151,346,595	-12,779,390	A M	Mosraketim të ardhurash TVSH vs TF 22-A; parapagime të arkëtuara për punime (pasiv bilanci)
J	288,399,235	177,653,250	110,745,985	A H	Dërguar për kontroll të plotë (shkresa nr.391, 19.01.2024)
L	401,476,069	323,319,304	78,156,765	AH	Rritje e parapagimeve (arkëtime në avans)
L	134,298,169	103,853,566	30,444,603	AH	Rritje e të ardhurave të shtyra dhe parapagimeve të arkëtuara
L	64,122,923	43,815,078	20,307,845	AH	Të ardhura të shtyra; parapagime
J	135,043,385	126,148,444	8,894,941	AH	Të ardhura nga shfrytëzimi + kurs këmbimi; diferenca nga shitja e parapagimeve/azh. kursit
L	10,868,290	4,633,602	6,234,688	AH	Rivlerësim i kryer nga administrata
K	52,873,739	49,487,948	3,385,791	AH	Deklaruar arkëtime në avans
K	286,861,724	299,144,597	-12,282,873	AH	Të ardhura nga kursi i këmbimit dhe të ardhura financiare (nota kredi)
K	305,201,636	330,035,475	-24,833,839	AH	Ulje e të ardhurave në avans në PF 2022
K	239,170,461	317,498,598	-78,328,137	AH	Ndryshim gjendje inventari/prodhim; parapagime të arkëtuara (-); të ardhura të tjera/interesi
J	735,563,582	583,563,773	151,999,809	D D	Diferenca = arkëtime në avans (pasiv bilanci)
K	45,241,306	13,998,136	31,243,170	D D	Pa diferenca – vetëkorrigjim i deklarats TF 2022
M	26,381,700	3,477,700	22,904,000	D D	Parapagime të arkëtuara (subjekt i transferuar nga DRT Tiranë)
K	582,411,649	594,633,842	-12,222,193	D D	Rivlerësim shitjesh/TVSH; pjesë arkëtime në avans; saktësuar në Akt kontrolli
K	10,332,204	23,459,442	-13,127,238	D D	Përiudhë pa përgjegjësi TVSH; kalim me TVSH më 29.08.2022
L	23,617,590	38,617,590	-15,000,000	D D	Paketim i 'arkëtimeve në avans' në pasiv; pa diferenca për vlerësim
J	107,399,926	126,452,939	-19,053,013	D D	Pa PF 2022; deklaruar shitje me TVSH; vetësishtem TF – korrigjim baze tatueshme
L	936,428	33,936,608	-33,000,180	D D	Diferenca = grante nga Bashkia Lushnje
L	-	156,632,069	-156,632,069	D D	Diferenca nga deklaratat doganore – verifikuar; deklarimet në rregull
L	356,553,887	176,629,429	179,924,458	E M	Arkëtime në avans për njësi në ndërtim; saktësuar me akt kontrolli
L	153,511,118	62,805,121	90,705,997	E M	Arkëtime në avans për njësi në ndërtim; saktësuar në Akt kontrolli
L	55,373,921	7,976,421	47,397,500	E M	Arkëtime në avans për porosi (ndërtime)
K	326,930,751	320,354,565	6,576,186	E M	Pakesim 'të ardhura të shtyra' (tollona 2020 të tërhequra 2021)
K	71,399,993	66,978,492	4,421,501	E M	Të ardhura të shtyra; fatura parapagimi për furnizime
L	293,396,993	289,202,754	4,194,239	E M	Vetëfaturim i fidaneve (prodhim në sera)
M	18,529,595	-	18,529,595	E S	Vlerësim tatimor për deklarim të pasaktë
L	95,238,604	119,101,353	-23,862,749	E S	Kalim me TVSH në 13.10.2022; diferenca shitje pa TVSH
J	56,986,028	47,239,261	9,746,767	J V	Shitje aktivi (tokë) neto; minus grante; diferenca në të ardhura nga shitja e aktivëve
K	143,878,157	138,919,218	4,958,939	J V	Të ardhura të shtyra (pasiv bilanci)
K	1,780,380	13,009,135	-11,228,755	J V	Kalim me përgjegjësi TVSH në tetor 2022
L	87,208,084	100,207,257	-12,999,173	J V	Të ardhura të tjera
J	160,378,577	178,088,883	-17,710,306	J V	Kompensim nafte + rimbursim TVSH (Sloveni/Gjermani)
M	48,444,800	44,515,065	3,929,735	K K	Arkëtime në avans për porosi; saktësuar në PF 2022
L	91,295,049	50,636,080	40,658,969	L F	Kredit note 36,000,000 + 4,658,969 parapagime

K	88,532,758	51,417,789	37,114,969	LF	Arketime në avans + lëndë e parë/materiale të konsumueshme
L	27,408,750	5,301,206	22,107,544	LF	Grante dhe të ardhura të shtyra
M	19,690,000	-	19,690,000	LF	Parapagime për kontrata të lidhura
L	79,860,972	74,993,206	4,867,766	LF	Rritje 'arketime në avans' + të ardhura nga shfrytëzimi
L	158,285,612	154,204,291	4,081,321	LF	Të ardhura nga shfrytëzimi + të ardhura të tjera (amortizim fondi AZHBR)
M	23,533,224	35,531,765	-11,998,541	LF	Kalim në mes të vitit 2022 me TVSH (23.05.2022)
K	2,751,515	19,829,453	-17,077,938	LF	Kalim në mes të vitit 2022; të ardhura të tjera nga shfrytëzimi
K	270,266,928	304,666,928	-34,400,000	LF	Arketime në avans
L	100,096,472	83,779,209	16,317,263	LR	Pa diferenca: 'arketime në avans për porosi' (-) dhe të ardhura nga kursi i këmbimit
L	8,494,775	1,435,464	7,059,311	LR	Parapagime të arkëtuara dhe parapagesa për inventar (pjesërisht 2022)
K	5,384,072	-	5,384,072	LR	Tatimpaguesi ka ndërruar jetë (informim nga familjarët)
L	10,086,480	21,943,418	-11,856,938	LR	Regjistrim me TVSH më 01.07.2022; të ardhura para regjistrimit (pa TVSH)
J	95,091,426	107,968,530	-12,877,104	LR	Të ardhura të tjera (sipas PASH/FSH 2022)
K	39,557,000	55,684,250	-16,127,250	LR	Të ardhura nga shitje punimesh/shërbimesh + qera; diferenca nga strukturimi i të ardhurave
L	29,115,670	-	29,115,670	OA	Pa diferenca – vetëkorrigjim deklaratë TF 13.02.2024
L	671,228,235	530,479,001	140,749,234	RV	Ndërtim: parapagime, rimarrje të ardhurash, kosto prod. të shitur; diferenca e sqaruar në PASH 2022
L	68,520,198	50,678,044	17,842,154	RV	Sqaruar në PF 2022; 'Defesa të pagueshme' (pasiv)
L	53,485,770	65,030,557	-11,544,787	XP	Kalim me TF më 25.05.2022 dhe TVSH më 06.06.2022; diferenca periudhe
M	1,152,000	12,903,787	-11,751,787	XP	Kalim me TF më 20.10.2022 dhe TVSH më 02.12.2022; diferenca periudhe
M	5,445,845	18,678,585	-13,232,740	XP	Kalim me TF më 20.10.2022 dhe TVSH më 02.12.2022; diferenca periudhe
L	480,121,542	235,941,097	244,180,445	XB	Përfaqësojnë arketime në avans
L	140,552,816	98,797,984	41,754,832	XB	Përfaqësojnë arketime në avans/parapagime
K	42,800,900	8,593,424	34,207,476	XB	Përfaqësojnë arketime në avans
K	43,932,541	33,443,361	10,489,180	XB	Të ardhura nga ndryshimi i gjendjes së prod. të gatshëm
K	108,294,031	101,155,898	7,138,133	XB	Penalizim për rritje të ardhurash në TVSH (01–06 2022); miratim kontrolli vijues (Korrik 2022–Jan 2023) dhe TF 2022
L	170,991,798	165,677,831	5,313,967	XB	Përfaqësojnë arketime në avans
L	63,875,522	78,081,652	-14,206,130	XB	Të ardhura të tjera – grant nga AZHBR
L	320,329,933	337,940,837	-17,610,904	XB	Të ardhura nga puna e kryer për qëllime vetjake (kapitalizuar)
L	2,508,384	20,934,127	-18,425,743	XB	Regjistrim me TVSH më 14.07.2022; shitje CPCM
L	112,568,222	52,699,234	59,868,988	ZS	Përpunim aktiv: diferenca = kosto e lëndës së parë (të ardhura reale = shitesa e vlerës)
K	50,298,230	31,954,681	18,343,549	ZS	Parapagime dhe të ardhura të tjera (sqaruar në PF)
K	7,726,663	-	7,726,663	ZS	Akt vlerësimi nr.1621 (28.02.2024); të ardhura nën 14 mln – zbulim 0
K	66,207,184	60,370,334	5,836,850	ZS	Diferenca sqaruar: arketime në avans
M	18,162,020	13,940,368	4,221,652	ZS	Diferenca sqaruar: arketime në avans
M	11,980,051	23,635,221	-11,655,170	ZS	Regjistrim me TVSH më 14.07.2022; diferenca periudhe
L	3,168,058	16,482,731	-13,314,673	ZS	Regjistrim me TVSH më 19.10.2022; diferenca periudhe
J	498,488,898	516,380,515	-17,891,617	ZS	Të ardhura nga AZHBR (sqarim në PF)

Qëndrimi i Audituesve të Kontrollit të Lartë të Shtetit: Nga auditimi dhe verifikimi i dokumentacionit dhe argumentimit rezulton se DRT Fier ka nisur zbatimin e rekomandimit: është bërë shqyrtimi rast-pas-rasti i diferencave TVSH–TF, janë dhënë sqarime të dokumentuara (parapagime/arketime në avancë, të ardhura të shtyra, grante, ndryshim regjimi tatimor, fason, etj.), janë propozuar dhe/ose hapur kontrole të plota në vend, si dhe janë kryer vlerësime/penalizime në disa raste (p.sh. akte vlerësimi, vetëkorrigjime të miratuara, penalitete të kontabilizuara). Megjithatë, nuk provohet mbyllja përfundimtare e të gjithë popullatës së rasteve të identifikuar nga auditimi (2021–2022), pasi:

- një numër i konsiderueshëm çështjesh figurojnë si “propozuar”, “në kontroll të plotë” ose “në rivlerësim nga zyra” pa akt-përmbyllje të hedhur në C@ts;
- ka raste që kërkojnë koordinim ndër-juridiksional (subjekte në DRT/DTM të tjera), për të cilat ende nuk dokumentohet rezultati final nga organi përgjegjës;
- për disa sqarime (p.sh. “OJF/pa përgjegjësi TVSH”, “diferencë periudhe”, “grante/kompensime”) mungon akt administrativ përmbyllës (akt-verifikimi/akt-vlerësimi/urdhër mbylljeje) që të formalizojë konstatimin dhe ta pasqyrojë në dosje.

Sipas standardit të rekomandimit (“të intensifikohen vlerësimet/rivlerësimet dhe propozimet për kontrole të thelluara deri në përmbyllje”), progresi është i dukshëm, por jo i plotë në aspektin e rezultateve të formalizuara për të gjithë setin e subjekteve. Statusi i zbatimit të rekomandimit: Në proces zbatimi. Në mënyrë që rekomandimi të klasifikohet si plotësisht i zbatuar duhet që për çdo NIPT të listuar, të ekzistojë akt final (akt-vlerësimi/akt-verifikimi ose vendim mbylljeje pa diferenca), i protokolluar dhe i hedhur në C@ts; 2) për rastet jashtë juridiksionit, konfirmim zyrtar nga DRT/DTM përkatëse mbi masat e marra; 3) raport përmbledhës i DRT Fier që dokumenton përqindjen e çështjeve të mbyllura, shumat e arkëtuara/penalizuara dhe arsyetimin tatimor për rastet pa diferenca. Kur këto të tria të jenë përmbushur, rekomandimi mund të klasifikohet “Zbatuar”.

Ky rekomandim rezulton i pranuar dhe në proces.

17.1 Rekomandimi: Drejtoria Rajonale Tatimore Fier të përmirësojë procedurat aktuale të zbatimit të buxhetit, duke hartuar raporte të monitorimit që përfshijnë krahas evidencave statistikore për nivelin e realizimit, edhe analizat e treguesve nga planifikimi buxhetor deri në realizim, në kuadër të përmirësimit të procedurave të planifikimit dhe monitorimit të buxhetit.

Qëndrimi i Subjektit: DRT Fier është institucion në varësi dhe institucion zbatues, i cili raporton mbi ecurinë e punës në bazë të formateve të miratuara nga institucioni epror, DPT. Sa i përket shpenzimeve mujore, DRT Fier dërgon çdo muaj raport mbi realizimin e shpenzimeve, në formatin standard të miratuar nga DPT. Gjithashtu, DRT Fier i dërgon DPT-së çdo katër muaj regjistrin e realizimit të prokurimeve, po në formatin standard të miratuar nga DPT. Për sa më sipër, duke iu referuar Rregullores së funksionimit të Drejtorive Rajonale dhe detyrave funksionale përkatëse, si institucion në varësi plotësojmë vetëm formatet e miratuara, të shoqëruara me argumentimin përkatës shifror, sipas situatës në momentin e raportimit.

Qëndrimi i Audituesve të Kontrollit të Lartë të Shtetit: DRT Fier ka përmbushur raportimin minimal periodik sipas formateve standarde të miratuara nga DPT (raport mujor i shpenzimeve dhe regjistër i prokurimeve çdo 4 muaj). Megjithatë, këto evidenca kryesisht numerike nuk shoqërohen me analizë të plotë krahasuese plan-realizim, shpjegim devijimesh, parashikim deri në fund-vit, si dhe identifikim e propozim në kohë të rialokimeve të nevojshme të fondeve, siç kërkon Udhëzimi nr. 9, datë 20.07.2018 (pika VI). Argumenti i subjektit se, si strukturë në varësi, ndjek formatet e DPT-së është i kuptueshëm në planin hierarkik, por nuk e zëvendëson detyrimin për monitorim analitik të buxhetit dhe për raportim shpjegues të performancës buxhetore në nivel njësie. Për rrjedhojë, vlerësojmë se rekomandimi është i adresuar pjesërisht: raportimi statistikor ekziston, por komponentët analitikë (analiza e treguesve, arsyetimi i devijimeve, masat korrigjuese/rialokimet e propozuara) nuk dokumentohen në mënyrë të plotë. Kjo pengon menaxhimin proaktiv të fondeve dhe vendimmarrjen në kohë. Duke qenë se rishikimi dhe standardizimi i formateve të raportimit buxhetor është kompetencë e DPT-së, DRT Fier duhet t'i kërkojë DPT-së, me shkresë zyrtare, iniciimin dhe miratimin e një ndryshimi metodologjik të skemës së raportimit, për të përfshirë elementë analitikë detyrues (analizë devijimesh plan-realizim, shkaqe, ndikim në objektiva, parashikim deri në fundvit, si dhe propozime për rialokime/masa kursimi). Statusi: Zbatuar Pjesërisht.

Ky rekomandim rezulton i pranuar dhe zbatuar pjesërisht.

18.1 Rekomandimi: Drejtoria Rajonale Tatimore Fier të marrë masat për hartimin e planeve vjetore të punës në rang institucional dhe në nivel drejtorie/sektori, me qëllim përcaktimin e objektivave kryesore vjetore në luftën kundër informalitetit, objektiv bazë për realizimin e të ardhurave tatimore në funksion të mbarëvajtjes normale të punës.

Qëndrimi i Subjektit: Në vijim të Rekomandimit 18.1 nga Drejtoria Rajonale Tatimore Fier është hartuar Plani Operacional duke përfshirë detyrat funksionale, objektivat kryesore të vendosura dhe realizimi i tyre sipas afateve kohore të përcaktuara sipas drejtorive përkatëse, Drejtoria e Shërbimit të Tatmipaguesve, Drejtoria e Kontrollit, Sektori i Kontrollit nga Zyra dhe Monitorimit, Sektori i Analizës dhe Kontabilitetit të të Ardhurave dhe Drejtoria e Shërbimeve Mbështetëse.

- Plani Operacional për vitin 2024, protokolluar me Nr.1389 datë 19.02.2024

- Plani Operacional për vitin 2025, protokolluar me Nr.1525 datë 28.02.2025

Qëndrimi i Audituesve të Kontrollit të Lartë të Shtetit: Nga verifikimi i qëndrimit të subjektit rezulton se konstatohet se DRT Fier ka hartuar dhe protokolluar një plan vjetor pune në nivel institucional me ndarje sipas drejtorive/sectorëve: Plani Operacional 2024 (Nr.1389, datë 19.02.2024) dhe, në vijimësi, Plani Operacional 2025 (Nr.1525, datë 28.02.2025). Nga përmbajtja e përshkruar, plani përfshin: (i) detyrat funksionale, (ii) objektivat kryesore vjetore, (iii) afatet kohore dhe (iv) përgjegjësitë sipas Drejtorisë së Shërbimit të Tatimpaguesve, Drejtorisë së Kontrollit, Sektorit të Kontrollit nga Zyra dhe Monitorimit, Sektorit të Analizës dhe Kontabilitetit të të Ardhurave dhe Drejtorisë së Shërbimeve Mbështetëse. Këto elemente adresojnë drejtpërdrejt mangësinë e konstatuar (mungesë planifikimi vjetor të konsoliduar) dhe përmbushin kërkesën për planifikim vjetor institucional dhe në nivel drejtorie/sectori brenda vitit 2024. Për më tepër, hartimi i planit 2025 tregon institucionalizim të procesit dhe qëndrueshmëri të masës. Arsyetimi: Plani vjetor 2024 është hartuar dhe protokolluar brenda afatit të rekomanduar dhe mbulon si nivelin institucional, ashtu edhe atë të drejtorive/sectorëve, me objektiva, afate dhe përgjegjësi të përcaktuara. Plani 2025 e konsolidon më tej praktikën. Nga sa më sipër gjykojmë se statusi i zbatimit të rekomandimit është i zbatuar.

Ky rekomandim rezulton i pranuar dhe zbatuar plotësisht.

19.1 Rekomandimi: Drejtoria Rajonale Tatimore Fier të marrë masat e duhura administrative për të shqyrtuar diferencat midis xhiros së korrektuar të kasës (për vitin 2021), CPCM (për vitin 2022 dhe 2023) dhe të ardhurave në deklaratën e TVSH-së, duke intensifikuar vlerësimet dhe rivlerësimet përkatëse si dhe propozimeve pranë Sektorit të Kontrollit në Vend në DRT Fier për kontrollet e thelluara në vend ose vizitave fiskale për tatimpaguesit me risk të lartë apo pamundësi vlerësimi nga zyra.

- Sektori i Kontrollit nga Zyra dhe Monitorimit pranë DRT Fier të marrë masat për të intensifikuar propozimet për kryerjen e kontrolleve në vend për subjektet që rezultojnë me diferenca të xhiros për shkak të duplikimeve, anulimeve, korigjimeve të faturave, dhe veçanërisht rasteve kur paraqitet si argument refuzimi i shërbimeve/mallrave nga bashkitë, situatë kjo që përbën risk për shmangien e pagesës së TVSH-së dhe tatimit mbi fitimin, objekt verifikimi në vend.

- Inspektoret e kontrollit nga zyra të marrin masat për dokumentimin e vlerësimit të konstatimeve dhe rezultateve të kontrollit në vend të kryer pranë subjekteve të cilat janë propozuar për kontroll, me qëllim garantimin e evidentimit dhe problematikave në raportet e kontrollit, për të finalizuar procedurat monitoruese, pa u kufizuar vetëm në propozimin për kontroll të plotë.

Qëndrimi i Subjektit: Në lidhje me rekomandimin Nr.19 janë vendosur të njëjta të dhëna dhe argumenta si për rekomandimin Nr.16.

Qëndrimi i Audituesve të Kontrollit të Lartë të Shtetit: Nga auditimi dhe verifikimi i dokumentacionit dhe argumentimit rezulton se për Rekomandimin 19 përsërit, në thelb, të njëjtat shpjegime të dhëna për Rekomandimin 16 dhe nuk adreson specifikat e kësaj gjetjeje (rakordimin e xhiros së korrektuar të kasës/CPCM me TVSH-në, trajtimin e duplikimeve/anulimeve/korigjimeve, rastet me “refuzim nga bashkitë”, si dhe dokumentimin e verifikimeve të kryera në raportet e kontrolleve në vend). Po ashtu, edhe pse janë bërë disa sisteme pas kërkesës së grupit të auditimit, nuk paraqiten akte përmbyllëse (akt-vlerësime, masa/penalite të hedhura në C@ts, vendime mbylljeje pa diferenca) për të gjithë subjektet me diferenca, as evidencë e propozimeve/realizimeve të kontrolleve të thelluara pikërisht për rastet me risk (duplikime, anulime të shpeshta, “refuzime” nga bashkitë, etj.). Për rrjedhojë, detyrimi “të

intensifikohen vlerësimet/rivlerësimet dhe propozimet për kontroll deri në përmbyllje” nuk provohet i realizuar plotësisht. Statusi i zbatimit: Në proces zbatimi.

Në mënyrë që rekomandimi të klasifikohet si plotësisht i zbatuar duhet që:

- Për çdo NIPT të listuar 2021–2023 të ekzistojë akt përfundimtar (akt-vlerësimi/akt-verifikimi ose vendim mbylljeje pa diferenca) i protokolluar dhe hedhur në C@ts;
- Evidencë se rastet me risk të shtuar (duplikime/anulime, “refuzime bashkie”, autofatura, karburant) janë propozuar dhe realizuar në kontroll të thelluar dhe janë mbyllur me masat përkatëse;
- Raport sintezë ku tregohet numri i rasteve të trajtuara/mbyllura, shumat e vlerësuara/penalizuara/arkëtuara dhe dokumentimi i verifikimit nga zyra i bashkëlidhur me raportet e kontrolleve në vend.

Ky rekomandim rezulton i pranuar dhe në proces.

20.1 Rekomandimi: Nga Drejtoria Rajonale Tatimore Fier të merren masa që çështjet e trajtuara më sipër të përfshihen në raportet e subjekteve objekt kontrolli në vend, konform përcaktimeve ligjore në fuqi, me qëllim përmirësimin e veprimtarisë aktuale kontrolluese.

Qëndrimi i Subjektit: Nga DRT Fier janë ndërmarrë masa që në vijim të kontrolleve mbas periudhës së audituar të adresohen dhe korrigjohen elementët që janë konstatuar nga auditimi i KLSH-së.

Qëndrimi i Audituesve të Kontrollit të Lartë të Shtetit: Për verifikimin e zbatimit të Rekomandimit 20.1, është përzgjidhur një kampion dosjesh të kontrollit tatimor të mbyllura në periudhën pas auditimit, për secilën dosje është verifikuar zbatimi procedural i programit të kontrollit dhe kërkesave të Manualit të Kontrollit Tatimor dhe bazës ligjore dhe nënligjore në fuqi, gjatë kryerjes në terren të kontrollit tatimor. Kampioni u përzgjodh duke ndjekur qasje të auditimit të bazuar në risk, duke përdorur dokumentacioni zyrtar i DRT Fier dhe u respektuan parimet në përputhje me standardet INTOSAI/ISSAI, me synim vlerësimin e besueshëm të funksionimit të kontrollit tatimor ndaj kuadrit ligjor/nënligjor.

1. Subjekti: “S” PF.

NIPT: M.

Adresë Kryesore: Lagjia Xhevdet Nepravishta , Bulevardi Kongresi, Lushnje, Fier.

Aktiviteti: Fast food etj sipas përshkrimit të QKB-së.

Lloji i Kontrollit: Kontroll i plotë.

Inspektori: V. P.

Sipas aktit të kontrollit subjekti është kontrolluar për:

- Për TVSH – periudha tatimore nga: 05/2022-04/2024.
- Për Tatim Fitimin periudha tatimore nga: 2022-2023.
- Për Sigurimet Shoqërore e Shëndetësorë – periudha tatimore nga: 05/2022-04/2024.
- Të tjera periudha tatimore nga: 05/2022-04/2024.

Raport është përpiluar më datë 12.09.2024, në përfundim të kontrollit të zhvilluar nga Drejtoria Rajonale Tatimore Fier, mbi bazën e Njoftimit të Kontrollit Tatimor nr. 4102/1, datë 05.08.2024, dhe Programit të Kontrollit nr. 4102/2, datë 05.08.2024. Kontrolli u krye nga zj. V. P., me qëllim verifikimin e përputhshmërisë së vetdeklarimeve tatimore dhe saktësisë së dokumentacionit financiar të subjektit për periudhat e përcaktuara në program.

1. Baza ligjore dhe qëllimi i kontrollit.

Kontrolli është zhvilluar në përputhje me dispozitat e:

- Ligjit nr. 92/2014 “Për Tatimin mbi Vlerën e Shtuar” (i ndryshuar) dhe udhëzimet përkatëse;

- Ligjit nr. 9920/2008 “Për Procedurat Tatimore në RSH”;
- Ligjit nr. 8438/1998 “Për Tatimin mbi të Ardhurat” dhe udhëzimet përkatëse;
- Ligjit nr. 9136/2003 “Për Mbledhjen e Kontributeve Shoqërore dhe Shëndetësore”;
- Ligjit nr. 9228/2004 “Për Kontabilitetin dhe Pasqyrat Financiare”, si dhe akteve të tjera nënligjore në zbatim të tyre.

2. Të dhënat e përgjithshme për subjektin.

Subjekti “S.” është person fizik (PF), i regjistruar në QKB më 04.05.2020. Aktiviteti kryesor: fast food, si edhe tregti me shumicë/pakicë e detergjentëve, materialeve të pastrimit dhe artikujve mbrojtës. Adresa: Lagja “Xhevdet Nepravishta”, Rruga “Bulevardi Kongresi”, Lushnje. Subjekti ka pasur 8 adresa sekondare gjatë periudhës, të cilat rezultojnë të mbyllura në momentin e kontrollit. Kapitali: 100 lekë; Statusi juridik: PF; Kontabiliteti mbahet i informatizuar me program financiar. Subjekti mban llogari bankare pranë BKT (Lek) dhe Raiffeisen (Eur, Usd).

3. Rezultatet e kontrollit për periudhat e kontrolluara

Përiudha Maj – Dhjetor 2022 (TVSH)

- Shitje të tatueshme (20%): 14,455,872 lekë; TVSH në shitje: 2,891,172 lekë.
- Blerje të tatueshme (brenda vendit & import): 17,391,884 lekë; TVSH në blerje: 3,472,582 lekë.
- Blerje të përjashtuara: 28,976 lekë.

Nga krahasimi i FDP-ve me librat e blerjeve/shitjeve dhe faturat e fiskalizuara nuk u konstatuan diferenca. Dokumentacioni i faturimit plotëson kërkesat e nenit 101 të Ligjit të TVSH.

Përiudha Janar – Dhjetor 2023 (TVSH)

- Shitje të tatueshme (20%): 38,594,047 lekë; TVSH në shitje: 7,718,811 lekë.
- Blerje të tatueshme (20%): 35,771,301 lekë; TVSH në blerje: 7,154,261 lekë.
- Blerje të përjashtuara: 44,940 lekë.
- Pozicion TVSH: kreditor 1,983,011 lekë.

Verifikimet materiale dhe dokumentare rezultuan pa mospërputhje ndërmjet FDP-ve, librave dhe sistemit.

Përiudha Janar – Prill 2024 (TVSH)

- Shitje të tatueshme (20%): 15,294,107 lekë; TVSH në shitje: 3,058,821 lekë.
- Blerje të tatueshme (20%): 12,822,232 lekë; TVSH në blerje: 2,564,447 lekë.
- Blerje të përjashtuara: 516,200 lekë.
- Pozicion TVSH: kreditor 614,883 lekë.

Deklarimet janë të rakorduara me librat dhe faturat; pa diferenca të konstatuara.

Bilanci material (kontroll fizik–kontabël).

U përpiluan bilance materiale për 01.06.2022–31.12.2022, 01.01.2023–31.12.2023 dhe 01.01.2024–31.05.2024. Për të tre periudhat nuk u konstatuan diferenca ndërmjet gjendjeve sipas magazinës dhe pasqyrave financiare.

Tatim Fitimi 2022

- Shoqëria rezulton me fitim 1,276,373 lekë.
- Aktivitet totale 2022: 10,812,429 lekë (përfshirë aktiva materiale 10,500,000 lekë). Likuiditete fundviti: 90,511 lekë (Banka 5,255; Arka 85,256). U verifikuan arkë/banka, flukset monetare dhe kufijtë ligjorë për transaksione cash; nuk u konstatuan tejkalime apo mospërputhje.

4. Vlerësim i përgjithshëm financiar dhe tatimor.

Gjatë periudhave të kontrolluara, subjekti ka mbajtur kontabilitet të rregullt, ka lëshuar fatura të fiskalizuara dhe ka pasqyruar saktë transaksionet në librat tatimorë.

- TVSH: deklarime të rregullta dhe pozicion kreditor në 2023 dhe Jan–Prill 2024, i justifikuar me dokumentacionin e blerjeve.

- Bilanci material: pa diferenca, çka tregon kontroll të mirë të inventarit.
- Tatim Fitimi 2022: struktura e aktiveve/detytimeve dhe flukset monetare janë koherente me pasqyrat, pa shkelje procedurale.

Në tërësi, rreziku tatimor vlerësohet i ulët, me rekomandim për vazhdimësi në rakordimet periodike të TVSH-së dhe ruajtje të disiplinës dokumentare.

5. Përfundime

- Kontrolli konfirmon përputhshmëri të përgjithshme me legjislacionin tatimor dhe kontabël.
- Për periudhat e verifikuara nuk u konstatuan diferenca materiale apo shkelje që të çonin në detyrime shtesë të tatimeve.
- Pozicionet kreditore të TVSH-së janë të mbështetura me dokumentacion dhe rakordime me FDP/librat.

2. Subjekti: “A” Shpk.

NIPT: L.

Adresë Kryesore: Rruga Nacionale Fier-Ballsh Km 7, ZK nr.2265, Nr.Pasurie 52/13, Patos, Fier.
Aktiviteti: Import-eksport, tregtim me shumicë e pakicë brenda dhe jashtë vendit të fruta përimeve, mallrave ushqimore e industriale, automjete e pjesë ndërimi, goma, makineri e pajisje për bujqësinë, fidan e fara, lëndë e material ndërtimi të çdo lloji etj sipas përshkrimit të QKB-së.

Lloji i Kontrollit: Kontroll i plotë.

Inspektori: A. G.

Sipas aktit të kontrollit subjekti është kontrolluar për:

- Për TVSH – periudha tatimore nga: 01/2022-12/2023.
- Për Tatim Fitimin periudha tatimore nga: 2021-2022.
- Për Sigurimet Shoqërore e Shëndetësorë – periudha tatimore nga: 01/2022-12/2023.
- Të Tjera periudha tatimore nga: 01/2022-12/2023.

Raporti i kontrollit tatimor për subjektin “A.” Shpk, me NIPT L., është përpiluar më datë 17.11.2023, në përfundim të kontrollit të zhvilluar nga Drejtoria Rajonale Tatimore Fier, mbi bazën e njoftimit të kontrollit nr. 1248/1, datë 03.07.2023, dhe programit përkatës të miratuar. Kontrolli është kryer nga inspektori Z. A.G., në prani të administratores së shoqërisë Znj. D. B., me qëllim verifikimin e përputhshmërisë së deklarimeve tatimore, saktësisë së dokumentacionit financiar dhe ligjshmërisë së kërkesave tatimore për periudhat e kontrolluara.

1. Baza ligjore dhe qëllimi i kontrollit.

Kontrolli është zhvilluar në përputhje me dispozitat e:

- Ligjit Nr. 9920/2008 “Për Procedurat Tatimore në Republikën e Shqipërisë”,
- Ligjit Nr. 92/2014 “Për Tatimin mbi Vlerën e Shtuar”,
- Ligjit Nr. 8438/1998 “Për Tatimin mbi të Ardhurat”,
- Ligjit Nr. 9136/2003 “Për Sigurimet Shoqërore dhe Shëndetësore” si dhe Ligjit Nr. 9228/2004 “Për Kontabilitetin dhe Pasqyrat Financiare”.

Qëllimi i kontrollit ishte verifikimi i zbatimit të kërkesave ligjore tatimore, saktësimi i deklarimeve fiskale dhe rakordimi i pasqyrave financiare me librat e kontabilitetit, për të konstatuar përputhshmërinë e detyrimeve tatimore të subjektit.

2. Të dhënat e përgjithshme për subjektin.

Subjekti “A.” Shpk është shoqëri me përgjegjësi të kufizuar, me administrator D.B. dhe ortakë D. B. (20%) dhe D.K. (80%) të kapitalit.

Shoqëria është regjistruar në QKB më 02.10.2017, me adresë: Rruga Nacionale Fier-Ballsh, km 7, “Pika e Bananes”, Fier. Objekti i veprimtarisë përfshin: Import-eksport dhe tregtim me shumicë e pakicë të frutave, përimeve, mallrave ushqimore e industriale, automjeteve, pjesëve të këmbimit,

makinerive, pajisjeve bujqësore, si dhe aktivitet në fushën e hotelerisë dhe shërbimeve ushqimore. Shoqëria operon me disa njësi tregtare dhe mjete transporti të regjistruara ligjërisht, dhe transaksionet bankare kryhen përmes Union Bank, Raiffeisen Bank dhe Bankës Amerikane të Investimeve, në monedhat Lek, Euro dhe Usd.

4. Rezultatet e kontrollit

Viti 2021 – Tatim Fitimi

Nga pasqyrat financiare:

- Të ardhurat gjithsej: 336,152,183 lekë,

- Shpenzimet: 332,589,495 lekë,

- Fitimi: 3,562,688 lekë, me normë fitimi 1.1%.

Subjekti operon me marzh tregtar 12%, i konsideruar normal për aktivitetin e tregtisë me shumicë të frutave dhe përimeve. Gjendja e aktiveve në fund të vitit 2021: 99,949,299 lekë, me rritje 35.7% krahasuar me vitin 2020. Kontrolli konfirmoi përputhshmëri midis bilancit, pasqyrave të të ardhurave dhe dokumentacionit justifikues

Viti 2022 – Tatimi mbi Vlerën e Shtuar (TVSH)

Gjatë periudhës 01.01.2022–31.12.2022:

- Shitje të tatueshme me 20%: 422,829,813 lekë,

- Shitje të përjashtuara: 4,801,680 lekë,

- Eksporte mallrash: 7,262,173 lekë,

- Totali i TVSH-së së llogaritur: 84,565,963 lekë,

- Totali i TVSH-së së zbritshme: 76,868,548 lekë.

Teprica e TVSH-së së zbritshme: 4,658,446 lekë, me TVSH për t'u paguar 12,355,861 lekë.

Analiza tregon se shoqëria rezulton me pagesë neto 7,707,530 lekë, ose 1.8% të shitjeve të tatueshme, brenda normave të pranuar për industrinë. Kontrolli konfirmoi se faturat e blerjeve dhe shitjeve ishin të rregullta dhe të fiskalizuara, në përputhje me ligjin 92/2014.

Blerjet brenda vendit

Totali: 27,725,014 lekë, me TVSH të zbritshme 5,545,003 lekë.

Verifikimi konfirmoi se të gjitha blerjet janë kryer me fatura origjinale, të regjistruara në librat e blerjeve, dhe në përputhje me nenin 33 të ligjit për TVSH. Është konstatuar një rregullim i vogël teknik lidhur me blerjet nga fermerët (diferencë 1,800 lekë), e cila është llogaritur me detyrim TVSH përkatës.

Blerjet e përjashtuara

Totali: 111,631,411 lekë, që përfaqëson 22.5% të totalit të blerjeve.

Përfshijnë shpenzime transporti ndërkombëtar, qira, sigurime, konsulenca dhe auditime – të gjitha në funksion të veprimtarisë tregtare.

Importet

Totali i importeve: 354,637,190 lekë, që përfaqëson 71.4% të totalit të blerjeve, me TVSH korresponduese të deklaruar dhe dokumentuar në doganë.

4. Vlerësimi i përgjithshëm financiar dhe tatimor.

Nga analiza financiare dhe tatimore, “A.” Shpk rezulton subjekt aktiv dhe i përputhshëm me legjislacionin fiskal, me rritje graduale të aktiveve dhe qarkullimit. Mospërputhjet e konstatuara janë të vogla dhe teknike, pa ndikim material në detyrimet tatimore. Në përfundim të kontrollit, nuk u konstatuan detyrime shtesë me ndikim financiar të konsiderueshëm, dhe deklarimet tatimore janë të besueshme.

5. Përfundime.

Shoqëria respekton legjislacionin tatimor dhe kontabël në fuqi.

Dokumentacioni i veprimtarisë ekonomike është i plotë, i fiskalizuar dhe i justifikuar. Diferencat e konstatuara janë të natyrës teknike dhe nuk ndikojnë në qëndrueshmërinë fiskale të subjektit.

3. Subjekti: “B” Shpk.

NIPT: L.

Adresë Kryesore: Rr. Sheq i Madh, Fier.

Aktiviteti: Import-eksport, tregti me shumice dhe pakice të artikujve elektroshtepiake, artikujve të ndryshëm industriale etj.

Lloji i Kontrollit: Rimbursim TVSH.

Inspektori: G.M.

Sipas aktit të kontrollit subjekti është kontrolluar për:

- Për TVSH - periudha tatimore nga: 07/2020-04/2025.

Raporti i kontrollit tatimor për subjektin “B” Shpk, me NIPT L., është përpiluar në datën 25.08.2025, në përfundim të kontrollit të zhvilluar nga Drejtoria Rajonale Tatimore Fier, mbi bazën e kërkesës për rimbursim të TVSH-së nr. RAE0000343488, me nr. çështje E0001443110, datë 29.06.2025, në shumën 13,785,436 lekë. Kontrolli është kryer nga inspektori G.M., me qëllim verifikimin e përputhshmërisë së deklarimeve tatimore dhe vërtetimin e saktësisë së dokumentacionit që mbështet kërkesën për rimbursim të TVSH-së.

1. Baza ligjore dhe qëllimi i kontrollit.

Kontrolli është zhvilluar në përputhje me dispozitat e:

- Ligjit Nr. 92/2014 “Për Tatimin mbi Vlerën e Shtuar”,

- Ligjit Nr. 9920/2008 “Për Procedurat Tatimore në Republikën e Shqipërisë”,

- Ligjit Nr. 8438/1998 “Për Tatimin mbi të Ardhurat”,

- Ligjit Nr. 9136/2003 “Për Kontributet Shoqërore dhe Shëndetësore”,

- si dhe Ligjit Nr. 9928/2004 “Për Kontabilitetin dhe Pasqyrat Financiare”.

Kontrolli mbuloi periudhën korrik 2020 – prill 2025, në zbatim të programit të miratuar me shkresën nr. 5785/2, datë 22.07.2024. Synimi kryesor ishte verifikimi i korrektesisë së deklarimeve tatimore, bilancit material dhe dokumentacionit mbështetës të blerjeve e shitjeve, me fokus në justifikimin e shumës së kërkuar për rimbursim të TVSH-së.

2. Të dhënat e përgjithshme për subjektin.

Subjekti “B” Shpk është një shoqëri me përgjegjësi të kufizuar, me administrator dhe ortak të vetëm, me 100% të kapitalit. Veprimtaria ekonomike kryesore e shoqërisë konsiston në import-eksportin dhe tregtinë me shumicë e pakicë të artikujve elektroshtepiakë dhe pajisjeve elektrike. Selia e aktivitetit ndodhet në Fier, Rruga “Sheq i Madh”. Nga analiza e bilancit tatimor dhe e deklarimeve fiskale, subjekti rezulton aktiv dhe me qarkullim të qëndrueshëm ndër vite, duke respektuar rregullisht detyrimet ligjore për deklarimin e tatimeve dhe kontributeve.

3. Rezultatet e kontrollit për periudhat e kontrolluara.

Periudha 2020–2022

Kjo periudhë ishte objekt kontrolli edhe më parë (sipas raportit të datës 11.10.2022) dhe, në përputhje me nenin 85 të Ligjit Nr. 9920/2008, nuk u rihap për kontroll të ri. Prandaj, verifikimet janë fokusuar në periudhat pasuese.

Periudha Qershor–Dhjetor 2022.

Gjatë kësaj periudhe, subjekti ka realizuar shitje të tatueshme në vlerën 20,148,995 lekë, me TVSH të llogaritur 4,029,799 lekë, ndërkohë që blerjet e tatueshme kanë qenë në shumën 22,437,933 lekë, me TVSH të zbritshme 4,217,658 lekë. Nga analiza e bilancit material dhe krahasimi midis hyrje-daljeve të mallrave rezulton se nuk janë konstatuar diferenca materiale, dhe shitjet janë kryer

mbi kosto, me marzh fitimi 41.77%, i cili konsiderohet normal për natyrën e aktivitetit tregtar. Në përfundim, për këtë periudhë nuk janë konstatuar shkelje tatimore dhe dokumentacioni mbështetës është në përputhje me kërkesat ligjore.

Periudha Janar–Dhjetor 2023.

Në këtë vit, subjekti ka realizuar shitje të tatueshme në shumën 22,739,202 lekë, me TVSH 4,547,841 lekë, ndërsa blerjet e tatueshme janë 31,226,765 lekë me TVSH 5,791,349 lekë.

Analiza e materialeve tregoi një diferencë prej 393 copë “Ndarse Furre Sobe-Zgara” (Model 30CU42), të padeklaruara në llogaritë e shitjeve, me vlerë 196,500 lekë. Kjo mospërputhje, ndonëse me ndikim të kufizuar financiar, përbën shkelje të parimit të deklarimit të plotë të mallrave të shitura.

Në zbatim të ligjeve tatimore, u llogaritën:

- TVSH shtesë: 39,300 lekë
- Gjoha për TVSH: 39,300 lekë
- Tatim fitimi shtesë: 29,475 lekë
- Gjoha për tatim fitimi: 29,475 lekë

Totali i detyrimeve shtesë: 137,550 lekë.

Shkeljet janë të natyrës teknike dhe nuk ndikojnë në qëndrueshmërinë e kërkesës për rimbursim.

Periudha Janar–Dhjetor 2024.

Për vitin 2024, janë realizuar shitje në shumën 26,532,602 lekë me TVSH 5,306,520 lekë, ndërsa blerjet janë 29,778,842 lekë, me TVSH të zbritshme 5,479,250 lekë. Në analizën materiale u identifikuan diferenca prej 1,420 copë mallrash, përkatësisht “Elementë ngrohës lavatrice 1950Ë” dhe “Elementë ngrohës 1200Ë”, me vlerë totale 364,400 lekë.

Për pasojë, janë llogaritur detyrime shtesë si më poshtë:

- TVSH: 72,880 lekë
- Gjoha TVSH: 72,880 lekë
- Tatim fitimi: 54,660 lekë
- Gjoha tatim fitimi: 54,660 lekë

Totali: 255,080 lekë.

Megjithatë, këto mospërputhje janë të natyrës volumetrike dhe nuk ndikojnë në drejtësinë e kërkesës për rimbursim të TVSH-së, pasi nuk prekin operacionet eksportuese apo faturimet ndërkufitare.

Periudha Janar–Prill 2025.

Në periudhën e fundit të analizuar, subjekti ka realizuar shitje të tatueshme në shumën 9,241,335 lekë me TVSH 1,848,267 lekë. Deklarimet tatimore, faturat fiskale dhe dokumentet mbështetëse janë në përputhje të plotë, pa konstatuar parregullsi apo mospërputhje materiale.

4. Vlerësim i përgjithshëm financiar dhe tatimor.

Gjatë gjithë periudhës së audituar, subjekti ka reflektuar qarkullim të qëndrueshëm, marzhe fitimi midis 32% dhe 52%, dhe dokumentacion të rregullt fiskal. Kontrolli evidenton se subjekti ka zbatuar në mënyrë të përgjegjshme legjislacionin tatimor, përveç disa mospërputhjeve të vogla teknike në inventar, të cilat janë adresuar përmes llogaritjeve përkatëse të detyrimeve shtesë.

Nga këndvështrimi financiar, diferencat e konstatuara janë nën 0.5% të qarkullimit total, çka tregon rrezik të ulët tatimor. Për rrjedhojë, kërkesa për rimbursim TVSH-je në shumën 13,785,436 lekë mbështetet nga dokumentacioni i kontrolluar dhe vlerësohet e justifikuar sipas ligjit.

5. Përfundime.

- Kontrolli konfirmon përputhshmëri të përgjithshme me legjislacionin tatimor dhe kontabël.
- Diferencat e identifikuara janë të karakterit tregtar-teknik dhe nuk ndikojnë në besueshmërinë

4. Subjekti: “H” Shpk.

NIPT: J.

Adresë Kryesore: Lagjja “1 Maj”, Rruga "Çamëria", Ndërtesa Nr.61, Hyrja 3, Apartamenti Nr.3, Laborator Helios- Med, pranë, Spitalit Rajonal Fier 9303, Fier.

Aktiviteti: Laborator klinik-biokimik-imunologjik-hormonal etj sipas përshkrimit të QKB-së.

Lloji i Kontrollit: Kontroll i plotë.

Inspektori: E.K.

Sipas aktit të kontrollit subjekti është kontrolluar për:

- Për TVSH – periudha tatimore nga: 01/2022-12/2023.

- Për Tatim Fitimin periudha tatimore nga: 2021-2022.

- Për Sigurimet Shoqërore e Shëndetësorë – periudha tatimore nga: 01/2022-12/2023.

- Të Tjera periudha tatimore nga: 01/2022-12/2023.

Raporti i kontrollit tatimor për subjektin “L” Shpk, me NIPT J., është përpiluar më 04.06.2024, në përfundim të kontrollit të zhvilluar nga Drejtoria Rajonale Tatimore Fier, mbi bazën e programit të miratuar me shkresën nr. 1255/1, datë 12.03.2024, në përputhje me ligjet tatimore në fuqi. Kontrolli është kryer nga inspektori E. K., me qëllim verifikimin e përputhshmërisë së deklarimeve tatimore, saktësinë e llogaritjeve dhe vërtetimin e bazës ligjore e dokumentare mbi të cilën janë llogaritur tatimet, kontributet dhe detyrimet për periudhën 2021 – 2023.

1. Baza ligjore dhe qëllimi i kontrollit.

Kontrolli është zhvilluar në zbatim të:

- Ligjit nr. 9920/2008 “Për Procedurat Tatimore në Republikën e Shqipërisë”,

- Ligjit nr. 92/2014 “Për Tatimin mbi Vlerën e Shtuar”,

- Ligjit nr. 8438/1998 “Për Tatimin mbi të Ardhurat”,

- Ligjit nr. 9136/2003 “Për Kontributet Shoqërore dhe Shëndetësore”,

- Ligjit nr. 9928/2004 “Për Kontabilitetin dhe Pasqyrat Financiare” si dhe Manualit të Kontrollit Tatimor të DPT-së (2017).

Qëllimi i kontrollit ka qenë verifikimi i saktësisë së deklarimeve fiskale, vlerësimi i përputhjes së dokumentacionit kontabël dhe identifikimi i çdo mospërputhjeje që mund të ketë ndikim në tatim fitim, TVSH, kontribute ose tatim në burim.

2. Të dhënat e përgjithshme për subjektin.

Subjekti “L” Shpk është shoqëri me përgjegjësi të kufizuar, me administrator dhe ortak të vetëm z. L., i cili zotëron 100 % të kapitalit. Veprimtaria ekonomike kryesore konsiston në shërbime laboratorike klinike, biokimike, imunologjike dhe hormonale. Shoqëria është e regjistruar në Drejtoria Rajonale Tatimore Fier më 18.03.1998, me seli në Fshatin Peshtan, Rruga e Cakranit, Fier, dhe një njësi dytësore në Lagjen “1 Maj”, Rruga Çamëria, pranë Spitalit Fier. Nga analiza e pasqyrave tatimore dhe bilancit, subjekti rezulton aktiv dhe me qarkullim të qëndrueshëm, duke zbatuar rregullisht detyrimet e tij ligjore për deklaratimet mujore dhe vjetore.

3. Rezultatet e kontrollit për periudhat e kontrolluara

Periudha 2022 – 2023 (TVSH)

Shoqëria ushtron aktivitet në fushën e shërbimeve mjekësore, të cilat janë të përjashtuara nga TVSH.

- 2022: Shitje të përjashtuara 26 ,623 ,867 lekë; blerje 17 ,784 ,146 lekë; investime 114 ,344 lekë.

- 2023: Shitje 27 ,337 ,901 lekë; blerje 25 ,109 ,366 lekë.

Raporti evidenton se faturat e lëshuara janë të rregullta, deklaratimet mujore (FDP) përputhen me librat e shitjeve dhe blerjeve, nuk janë konstatuar importe apo mospërputhje materiale, dhe nuk ekziston TVSH për rimbursim apo detyrime të papaguara.

Përiudha 2021 – 2022 (Tatim Fitimi)

Shoqëria ka zbatuar SKK nr. 2 dhe ligjin për tatimin mbi të ardhurat.

- Të ardhurat: 2021 = 30 ,854 ,451 lekë; 2022 = 26 ,639 ,267 lekë.

- Fitimi para tatimit: 2021 = 2 ,426 ,565 lekë; 2022 = 2 ,356 ,537 lekë.

- Tatimi mbi fitimin: 2021 = 363 ,985 lekë; 2022 = 353 ,481 lekë.

Gjatë verifikimeve u konstatua përfshirja në shpenzime e materialeve laboratorike të skaduara (reagentë) me vlerë 379 ,900 lekë, pa ndjekur procedurën e asgjësimit. Për këtë arsye u llogarit tatim shtesë 56 ,985 lekë dhe gjobë 12 ,480 lekë, me ndikim total 69 ,465 lekë.

Tatimi në Burim dhe Qiratë (2021–2023)

Subjekti ka kryer pagesa për qira dhe dividendë, duke mbajtur tatimin në burim sipas VKM nr. 469, datë 03.06.2015.

- Tatimi mbi qiratë: 41 ,400 lekë/vit.

- Tatimi mbi dividendët: 2022 = 165 ,006 lekë; 2023 = 160 ,000 lekë.

Të gjitha janë likuiduar në kohë, pa detyrime të prapambetura.

Kontributet Shoqërore, Shëndetësore dhe TAP (2021–2023)

Nga analiza e listëpagesave rezulton se të gjithë punonjësit kanë kontrata pune të rregullta, pagat reale përputhen me ato të deklaruara dhe kontributet janë llogaritur sipas normës ligjore 16.7 %.

- Pagat 2023: 4 ,538 ,000 lekë

- Sigurime Shoqërore: 1 ,107 ,406 lekë

- Sigurime Shëndetësore: 154 ,292 lekë

- TAP: 83 ,200 lekë

Nuk janë konstatuar mospërputhje apo vonesa në pagesat mujore.

4. Vlerësim i përgjithshëm financiar dhe tatimor.

Nga analiza financiare dhe tatimore, rezulton se shoqëria “L” Shpk ka respektuar detyrimet ligjore për deklarimet e tatimeve, kontributeve dhe TVSH-së. E vetmja gjetje me ndikim financiar është përfshirja në shpenzime e materialeve të skaduara, me efekt minimal në tatim fitim (< 0.3 % të qarkullimit). Në tërësi, raporti i kontrollit evidenton transparencë fiskale, përputhje të dokumentacionit kontabël dhe rrezik tatimor të ulët.

5. Përfundime.

- Kontrolli konfirmon përputhshmëri të plotë me legjislacionin tatimor dhe kontabël.

- Diferencat e konstatuara janë të karakterit teknik, pa ndikim material në të ardhurat e deklaruara.

- Shoqëria nuk ka detyrime të pashlyera dhe nuk është subjekt i rimbursimit apo penaliteteve të tjera përveç korigjimit të mësipërm.

- Nga këndvështrimi i auditimit, raporti i kontrollit tatimor është i besueshëm, i argumentuar me dokumentacion të plotë dhe reflekton gjendjen reale tatimore të subjektit për periudhën 2021 – 2023.

Nga sa më sipër nga auditimi kampioni i dosjeve pas auditimit të fundit të zhvilluar, vlerësohet fakti që janë ndërmarrë hapa konkretë dhe pozitivë për përmbushjen e rekomandimit: nga auditimi i kampionit të dosjeve të mbyllura pas auditimit të fundit (p.sh. “S”, “A”, “B”, “H.”) rezulton se janë adresuar një sërë mangësish proceduriale ekziston njoftim/program kontrolli me bazë ligjore të qartë, janë kryer verifikime dokumentare, janë hartuar bilance materiale dhe, kur janë konstatuar diferenca, janë llogaritur detyrimet dhe janë aplikuar masat përkatëse, këto zhvillime përbëjnë progres të matshëm. Zbatimi i plotë i këtij rekomandimi do të verifikohet në auditimin pasardhës, me një kampion të përzgjedhur mbi bazë risku. Verifikimi do të mbulojë të gjithë elementët e kërkuar për zbatim, përfshirë: hartimin dhe respektimin e programit të kontrollit; ekzistencën dhe përdorimin e kartave teknologjike për materialet/koston; ndarjen e shitjeve me pakicë nga ato me

shumicë; hartimin dhe ngarkimin në C@ts të procesverbaleve para fillimit të kontrollit; dokumentimin e analizës së riskut dhe të rregullave të thyera; kryerjen e bilancit material dhe analizave financiare (kosto e plotë, marzhet, krahasimet me çmimet e tregut); analizimin e normativës së konsumit të karburantit; rakordimet FDP–libra–fatura të fiskalizuara; si dhe gjurmueshmërinë e propozimeve për kontrole në vend, vlerësimeve/rivlerësimeve dhe masave korrigjuese. Evidencat do të verifikohen në dosjet fizike/elektronike dhe në C@ts, përmes rikalkulimeve, krahasimeve dokumentare dhe intervistave operative, në mënyrë që të konfirmohet përputhshmëria e plotë procedurale dhe materiale me kuadrin ligjor/nënligjor.

Ky rekomandim rezulton i pranuar dhe në proces.

21.1 Rekomandimi: DRT Fier, për tatimpaguesin “A” Shpk, për të cilin janë konstatuar mangësi në procedurën e rimbursimit duke mos analizuar në mënyrë shteruese situatën e blerjeve nga fermerët në raport me shumën e detyrimeve afatshkurtra të paraqitura në Pasqyrat Financiare për periudhën objekt rimbursimi, në përputhje me kërkesat ligjore dhe procedurale, të propozojë për kontroll të thelluar subjektin.

Qëndrimi i Subjektit: Subjekti “A” Shpk, ka kaluar në kontroll të thelluar me njoftimin e kontrollit nr. 11971/1, datë 02.11.2022, dhe me programin e kontrollit nr. 11971/2, datë 02.11.2022, për periudhat 09.2020–05.2022 për TVSH-në dhe sigurimet, si dhe 2020–2022 për tatimfitimin. Ndërsa kontrolli nga zyra për rimbursim mbulon periudhën 10.2020–06.2021.

Qëndrimi i Audituesve të Kontrollit të Lartë të Shtetit: Duke qenë se tatimpaguesi “A” Shpk është propozuar dhe ka kaluar në kontroll të thelluar me njoftimin nr. 11971/1 dhe programin nr. 11971/2, datë 02.11.2022, për periudhat 09.2020–05.2022 (TVSH/sigurime) dhe 2020–2022 (TF)—të cilat mbulojnë periudhën e rimbursimit 10.2020–06.2021, rekomandimi 21.1 konsiderohet i përmbushur në aspektin procedural nga DRT Fier. Ky veprim i adreson kërkesën për “propozim për kontroll të thelluar” si mjet për të shqyrtuar shterueshëm raportin mes blerjeve nga fermerët dhe detyrimeve afatshkurtra ndaj furnitorëve, në përputhje me Udhëzimin nr. 19, neni 9 dhe kërkesat e manualeve procedurale. Statusi i zbatimit: Zbatuar proceduralisht.

Ky rekomandim rezulton i pranuar dhe zbatuar plotësisht.

C. Zbatimi i rekomandimeve për masat për të ardhura të munguara. Ecuria e zbatimit dhe analizimi i rekomandimeve: rekomandime të pranuar dhe nga këto, sa janë zbatuar plotësisht; zbatuar pjesërisht, në proces zbatimi dhe rekomandimet e pa zbatuara.

1.1 Rekomandimi: Drejtoria Rajonale Tatimore Fier të kryejë rikontroll tatimor sipas përcaktimeve të nenit 85 “Rikontrolli tatimor” të Ligjit Nr.9920, datë 19.05.2008 “Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, për tatimpaguesin “I” Shpk, për të cilin janë konstatuar mangësi dhe parregullsi në procedurën e kontrollit me pasoja financiare, me qëllim arkëtimin e të ardhurave të munguara në buxhetin e shtetit të evidentuara paraprakisht në vlerën prej 18,068,049 lekë.

Qëndrimi i Subjektit: Referuar rekomandimeve të KLSH me shkresën nr.1112/33 datë 15.07.2024 prot në DRT Fier nr.9418 datë 16.07.2024, DRT Fier ka propozuar tatimpaguesin për rikontroll sipas shkresës cituar më poshtë:

1. Shkresa Nr.6854., Prot., datë 02.10.2024 për tatimpaguesin “I” Shpk;

Mbi bazën e kësaj shkrese, Drejtori i Përgjithshëm i Tatimeve ka miratuar rikontrollin sipas vendimit cituar më poshtë:

2. Vendimi Nr.48, datë 11.10.2024 sipas shkresës Nr.16932/1., Prot., datë 11.10.2024 për tatimpaguesin “I” Shpk;

3. Nga ana e DRT Fier është nxjerr njoftimi i kontrollit dhe programi i kontrollit përkatëse, mbi bazën e të cilave është hartuar projekt raport i kontrollit dhe raporti përfundimtarë i kontrollit si dhe njoftim vlerësimi i detyrimeve në vlerën 0 lekë.

Qëndrimi i Audituesve të Kontrollit të Lartë të Shtetit: Nga analiza krahasuese e rezultateve të rikontrolleve tatimore të zhvilluara në vijim të rekomandimeve të KLSH-së, rezultojnë se ndonëse procedura e rikontrolleve është ndjekur formalistikisht, nuk është arritur rikupërimi real i të ardhurave tatimore të identifikuar si të munguara. Për rrjedhojë, rekomandimi i dhënë nga KLSH konsiderohet i zbatuar vetëm në aspektin procedural, por jo tërësisht i realizuar në aspektin financiar.

Ky rekomandim rezultojnë i pranuar dhe zbatuar plotësisht.

2.1 Rekomandimi: Drejtoria Rajonale Tatimore Fier për tatimpaguesin “2” Shpk, për të cilin janë konstatuar mangësi dhe parregullsi në procedurën e kontrollit, në përputhje me kërkesat ligjore dhe procedurale, të kryejë rikontroll tatimor sipas përcaktimeve të nenit 85 “Rikontrolli tatimor” të ligjit Nr.9920, datë 19.05.2008 “Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, me qëllim arkëtimin e të ardhurave të munguara në buxhetin e shtetit të evidentuar paraprakisht në vlerën prej 6,149,688 lekë.

Qëndrimi i Subjektit: Referuar rekomandimeve të KLSH me shkresën nr.1112/33 datë 15.07.2024 prot në DRT Fier nr.9418 datë 16.07.2024, DRT Fier ka propozuar tatimpaguesin për rikontroll sipas shkresës cituar më poshtë:

1. Shkresa Nr.6858., Prot., datë 02.10.2024 për tatimpaguesin “2.” Shpk;

Mbi bazën e kësaj shkrese, Drejtori i Përgjithshëm i Tatimeve ka miratuar rikontrollin sipas vendimit cituar më poshtë:

2. Vendimi Nr.44, datë 11.10.2024 sipas shkresës Nr.16940/1., Prot., datë 11.10.2024 për tatimpaguesin “2.” Shpk;

3. Nga ana e DRT Fier është nxjerr njoftimi i kontrollit dhe programi i kontrollit përkatëse, mbi bazën e të cilave është hartuar projekt raport i kontrollit dhe raporti përfundimtarë i kontrollit si dhe njoftim vlerësimi i detyrimeve në vlerën 0 lekë.

Qëndrimi i Audituesve të Kontrollit të Lartë të Shtetit: Nga analiza krahasuese e rezultateve të rikontrolleve tatimore të zhvilluara në vijim të rekomandimeve të KLSH-së, rezultojnë se ndonëse procedura e rikontrolleve është ndjekur formalistikisht, nuk është arritur rikupërimi real i të ardhurave tatimore të identifikuar si të munguara. Për rrjedhojë, rekomandimi i dhënë nga KLSH konsiderohet i zbatuar vetëm në aspektin procedural, por jo tërësisht i realizuar në aspektin financiar.

Ky rekomandim rezultojnë i pranuar dhe zbatuar plotësisht.

3.1 Rekomandimi: Drejtoria Rajonale Tatimore Fier për tatimpaguesin “A.” Shpk, për të cilin janë konstatuar mangësi dhe parregullsi në procedurën e kontrollit, në përputhje me kërkesat ligjore dhe procedurale, të kryejë rikontroll tatimor sipas përcaktimeve të nenit 85 “Rikontrolli tatimor” të Ligjit Nr.9920, datë 19.05.2008 “Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, me qëllim arkëtimin e të ardhurave të munguara në buxhetin e shtetit të evidentuar paraprakisht në vlerën prej 22,059,468 lekë.

Qëndrimi i Subjektit: Referuar rekomandimeve të KLSH me shkresën nr.1112/33 datë 15.07.2024 prot në DRT Fier nr.9418 datë 16.07.2024, DRT Fier ka propozuar tatimpaguesin për rikontroll sipas shkresës cituar më poshtë:

1. Shkresa Nr.6861., Prot., datë 02.10.2024 për tatimpaguesin “A” Shpk;

Mbi bazën e kësaj shkrese, Drejtori i Përgjithshëm i Tatimeve ka miratuar rikontrollin sipas vendimit cituar më poshtë:

2. Vendimi Nr.54, datë 11.10.2024 sipas shkresës Nr.16926/1., Prot., datë 11.10.2024 për tatimpaguesin “A” Shpk;

3. Nga ana e DRT Fier është nxjerr njoftimi i kontrollit dhe programi i kontrollit përkatëse, mbi bazën e të cilave është hartuar projekt raport i kontrollit dhe raporti përfundimtare i kontrollit si dhe njoftim vlerësimi i detyrimeve në vlerën 0 lekë.

Qëndrimi i Audituesve të Kontrollit të Lartë të Shtetit: Nga analiza krahasuese e rezultateve të rikontrolleve tatimore të zhvilluara në vijim të rekomandimeve të KLSH-së, rezulton se ndonëse procedura e rikontrolleve është ndjekur formalistikisht, nuk është arritur rikupërimi real i të ardhurave tatimore të identifikuara si të munguara. Për rrjedhojë, rekomandimi i dhënë nga KLSH konsiderohet i zbatuar vetëm në aspektin procedural, por jo tërësisht i realizuar në aspektin financiar.

Ky rekomandim rezulton i pranuar dhe zbatuar plotësisht.

4.1 Rekomandimi: Drejtoria Rajonale Tatimore Fier për tatimpaguesin “K” Shpk, për të cilin janë konstatuar mangësi dhe parregullsi në procedurën e kontrollit, në përputhje me kërkesat ligjore dhe procedurale, të kryejë rikontroll tatimor sipas përcaktimeve të nenit 85 “Rikontrolli tatimor” të Ligjit Nr.9920, datë 19.05.2008 “Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, me qëllim arkëtimin e të ardhurave të munguara në buxhetin e shtetit të evidentuar paraprakisht në vlerën prej 3,986,628 lekë.

Qëndrimi i Subjektit: Referuar rekomandimeve të KLSH me shkresën nr.1112/33 datë 15.07.2024 prot në DRT Fier nr.9418 datë 16.07.2024, DRT Fier ka propozuar tatimpaguesin për rikontroll sipas shkresës cituar më poshtë:

1. Shkresa Nr.6853., Prot., datë 02.10.2024 për tatimpaguesin “K” Shpk;

Mbi bazën e kësaj shkrese, Drejtori i Përgjithshëm i Tatimeve ka miratuar rikontrollin sipas vendimit cituar më poshtë:

2. Vendimi Nr.51, datë 11.10.2024 sipas shkresës Nr.16931/1., Prot., datë 11.10.2024 për tatimpaguesin “K” Shpk;

i Kontrollit nga Zyra dhe Monitorimit 2022, pika 6, 8, 10, për 3 raste ku janë konstatuar mangësi dhe parregullsi në procedurën e kontrollit nga zyra të subjekteve që kanë paguar me vonesë ose nuk kanë paguar këstet e tatim fitimit, duke sjellë si pasojë të ardhura të munguara për buxhetin e shtetit në vlerën totale prej 393,064 lekë.

Znj. F. H, në detyrën e Inspektorit të Sektorit të Kontrollit nga Zyra dhe Monitorimit, Drejtoria Rajonale Tatimore Fier;

- Për shkeljet e konstatuara në kryerjen e detyrave funksionale nga ana e inspektorëve të kontrollit tatimor, të përcaktuara në Rregulloren e Funksionimit të Drejtorive Rajonale Tatimore dalë me Urdhrin Nr.192, datë 12.08.2020, të Ministrit të Financave, neni 52, si dhe përcaktimet ligjore të Ligjit Nr.9920, datë 19.05.2008 "Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar, neni 114/1, Manuali i Kontrollit nga Zyra dhe Monitorimit 2018, pika 4, 6, 8, 9, 11.2, 13, Manuali i Kontrollit nga Zyra dhe Monitorimit 2022, pika 6, 8, 10, për 4 raste ku janë konstatuar mangësi dhe parregullsi në procedurën e kontrollit nga zyra të subjekteve që kanë paguar me vonesë ose nuk kanë paguar këstet e tatim fitimit, duke sjellë si pasojë të ardhura të munguara për buxhetin e shtetit në vlerën totale prej 586,189 lekë.

Znj. E. S, në detyrën e Inspektorit të Sektorit të Kontrollit nga Zyra dhe Monitorimit, Drejtoria Rajonale Tatimore Fier;

- Për shkeljet e konstatuara në kryerjen e detyrave funksionale nga ana e inspektorëve të kontrollit tatimor, të përcaktuara në Rregulloren e Funksionimit të Drejtorive Rajonale Tatimore dalë me Urdhrin Nr.192, datë 12.08.2020, të Ministrit të Financave, neni 52, si dhe përcaktimet ligjore të Ligjit Nr.9920, datë 19.05.2008 "Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar, neni 114/1, Manuali i Kontrollit nga Zyra dhe Monitorimit 2018, pika 4, 6, 8, 9, 11.2, 13, Manuali i Kontrollit nga Zyra dhe Monitorimit 2022, pika 6, 8, 10, për 2 raste ku janë konstatuar mangësi dhe parregullsi në procedurën e kontrollit nga zyra të subjekteve që kanë paguar me vonesë ose nuk kanë paguar këstet e tatim fitimit, duke sjellë si pasojë të ardhura të munguara për buxhetin e shtetit në vlerën totale prej 213,618 lekë.

Z. L. R, në detyrën e Inspektorit të Sektorit të Kontrollit nga Zyra dhe Monitorimit, Drejtoria Rajonale Tatimore Fier;

- Për shkeljet e konstatuara në kryerjen e detyrave funksionale nga ana e inspektorëve të kontrollit tatimor, të përcaktuara në Rregulloren e Funksionimit të Drejtorive Rajonale Tatimore dalë me Urdhrin Nr.192, datë 12.08.2020, të Ministrit të Financave, neni 52, si dhe përcaktimet ligjore të Ligjit Nr.9920, datë 19.05.2008 "Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar, neni 77, Manuali i Kontrollit nga Zyra dhe Monitorimit 2018, pika 4, 6, 8, 9, 11.2, 13, Manuali i Kontrollit nga Zyra dhe Monitorimit 2022, pika 6, 8, 10, janë konstatuar mangësi dhe parregullsi gjatë rilidhjes dhe monitorimit të 17 Akt Marrëveshjeve me këste për 14 tatimpagues që nuk i kanë plotësuar kushtet, duke sjellë si pasojë vlera borxhi të palikuiduar në vlerën totale prej 33,791,000 lekë.

II. "Pezullim nga e drejta e ngritjes në detyrë, përfshirë rritjen në shkallën e pagës për një periudhë deri në dy vjet në shërbimin civil", për 11 (njëmbëdhjetë) punonjës, si më poshtë:

Z. A.K, në detyrën e Inspektorit të Kontrollit të Drejtorisë së Kontrollit Tatimor, Drejtoria Rajonale Tatimore Fier;

- Për shkeljet e konstatuara në kryerjen e detyrave funksionale nga ana e inspektorit të kontrollit tatimor, të përcaktuara në Rregulloren e Funksionimit të Drejtorive Rajonale Tatimore dalë me

Urdhri Nr.192, datë 12.08.2020, të Ministrit të Financave, pika 1 e nenit 59 si dhe përcaktimet ligjore të Ligjit Nr.9920, datë 19.05.2008 "Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar, neni 71, 72, 115 dhe 124, Udhëzimit Nr.6, datë 30.01.2015 "Për tatimin mbi vlerën e shtuar në Republikën e Shqipërisë", neni 55 dhe Ligjit Nr.8438, datë 28.12.1998 "Për tatimin mbi të ardhurat" neni 21, Manual i Kontrollit Tatimor, Kapitulli VII, për 2 raste ku janë konstatuar mangësi dhe parregullsi në procedurën e kontrollit, duke sjellë si pasojë të ardhura të munguara për buxhetin e shtetit në vlerën totale prej 22,054,677 lekë.

Z. G.LI, në detyrën e Inspektorit të Kontrollit të Drejtorisë së Kontrollit Tatimor, Drejtoria Rajonale Tatimore Fier;

- Për shkeljet e konstatuara në kryerjen e detyrave funksionale nga ana e inspektorit të kontrollit tatimor, të përcaktuara në Rregulloren e Funksionimit të Drejtorive Rajonale Tatimore dalë me Urdhri Nr.192, datë 12.08.2020, të Ministrit të Financave, pika 1 e nenit 59 si dhe përcaktimet ligjore të Ligjit Nr.9920, datë 19.05.2008 "Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar, neni 115 dhe 124 dhe Ligjit Nr.8438, datë 28.12.1998 "Për tatimin mbi të ardhurat" neni 21, Manual i Kontrollit Tatimor, Kapitulli VII, për 2 raste ku janë konstatuar mangësi dhe parregullsi në procedurën e kontrollit, duke sjellë si pasojë të ardhura të munguara për buxhetin e shtetit në vlerën totale prej 6,262,612 lekë.

Z. D.S, në detyrën e Inspektorit të Kontrollit të Drejtorisë së Kontrollit Tatimor, Drejtoria Rajonale Tatimore Fier;

- Për shkeljet e konstatuara në kryerjen e detyrave funksionale nga ana e inspektorit të kontrollit tatimor, të përcaktuara në Rregulloren e Funksionimit të Drejtorive Rajonale Tatimore dalë me Urdhri Nr.192, datë 12.08.2020, të Ministrit të Financave, pika 1 e nenit 59 si dhe përcaktimet ligjore të Ligjit Nr.9920, datë 19.05.2008 "Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar, neni 115 dhe 124, Manual i Kontrollit Tatimor, Kapitulli VII, për 2 raste ku janë konstatuar mangësi dhe parregullsi në procedurën e kontrollit, duke sjellë si pasojë të ardhura të munguara për buxhetin e shtetit në vlerën totale prej 30,075,948 lekë.

Z. V.R, në detyrën e Inspektorit të Kontrollit të Drejtorisë së Kontrollit Tatimor, Drejtoria Rajonale Tatimore Fier;

- Për shkeljet e konstatuara në kryerjen e detyrave funksionale nga ana e inspektorit të kontrollit tatimor, të përcaktuara në Rregulloren e Funksionimit të Drejtorive Rajonale Tatimore dalë me Urdhri Nr.192, datë 12.08.2020, të Ministrit të Financave, pika 1 e nenit 59 si dhe përcaktimet ligjore të Ligjit Nr.9920, datë 19.05.2008 "Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar, neni 71, 72, 115 dhe 124, Ligjit Nr.92/2014 "Për tatimin mbi vlerën e shtuar në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar, neni 69, 72 dhe Ligjit Nr.8438, datë 28.12.1998 "Për tatimin mbi të ardhurat" neni 21, Ligjit Nr.9917 datë 19.5.2008 "Për parandalimin e pastrimit të parave dhe financimin e terrorizmit" i ndryshuar, neni 18.1, UMF Nr.16, datë 16.2.2009 "Për parandalimin e pastrimit të parave dhe për të luftuar financimin e terrorizmit në sistemin e tatim-taksave", neni 5, Manual i Kontrollit Tatimor, Kapitulli VII, për 2 raste ku janë konstatuar mangësi dhe parregullsi në procedurën e kontrollit, duke sjellë si pasojë të ardhura të munguara për buxhetin e shtetit në vlerën totale prej 20,339,950 lekë.

Z. A.G, në detyrën e Inspektorit të Kontrollit të Drejtorisë së Kontrollit Tatimor, Drejtoria Rajonale Tatimore Fier;

- Për shkeljet e konstatuara në kryerjen e detyrave funksionale nga ana e inspektorit të kontrollit tatimor, të përcaktuara në Rregulloren e Funksionimit të Drejtorive Rajonale Tatimore dalë me

Urdhrin Nr.192, datë 12.08.2020, të Ministrit të Financave, pika 1 e nenit 59 si dhe përcaktimet ligjore të Ligjit Nr.9920, datë 19.05.2008 "Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar, neni 71, 72, 115, 119 dhe 124, Ligjit Nr.9917 datë 19.5.2008 "Për parandalimin e pastrimit të parave dhe financimin e terrorizmit" i ndryshuar, neni 18.1, UMF Nr.16, datë 16.2.2009 "Për parandalimin e pastrimit të parave dhe për të luftuar financimin e terrorizmit në sistemin e tatim-taksave", neni 5, Kodi i Punës në Republikën e Shqipërisë, neni 87 dhe 119, Vendimi Nr.399, datë 3.5.2017, i Këshillit të Ministrave, "Për përcaktimin e pagës minimale në shkallë vendi", Vendim Nr.809, datë 26.12.2018 "Për përcaktimin e pagës minimale në shkallë vendi" dhe Vendimin Nr.1025, datë 16.12.2020 "Për përcaktimin e pagës minimale në shkallë vendi", Ligjit Nr.9136, datë 11.9.2003 "Për mbledhjen e kontributeve të detyrueshme të sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar, neni 15, Manual i Kontrollit Tatimor, Kapitulli VII, për 3 raste ku janë konstatuar mangësi dhe parregullsi në procedurën e kontrollit, duke sjellë si pasojë të ardhura të munguara për buxhetin e shtetit në vlerën totale prej 93,166,179 lekë.

Z. S.Z, në detyrën e Inspektorit të Kontrollit të Drejtorisë së Kontrollit Tatimor, Drejtoria Rajonale Tatimore Fier;

- Për shkeljet e konstatuara në kryerjen e detyrave funksionale nga ana e inspektorit të kontrollit tatimor, të përcaktuara në Rregulloren e Funksionimit të Drejtorive Rajonale Tatimore dalë me Urdhrin Nr.192, datë 12.08.2020, të Ministrit të Financave, pika 1 e nenit 59 si dhe përcaktimet ligjore të Ligjit Nr.9920, datë 19.05.2008 "Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar, neni 48, 71, 72, 73, 115, 124 dhe 128, VKM Nr.168, datë 27.3.2019, Udhëzimit Nr.6 datë 30.1.2015 "Për tatimin mbi vlerën e shtuar në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar, neni 20, Udhëzimin e Këshillit të Ministrave Nr.3 "Miratimin e kostos mesatare të ndërtimit të banesave nga Enti Kombëtar i Banesave, për vitin 2016", Manual i Kontrollit Tatimor, Kapitulli VII, për 2 raste ku janë konstatuar mangësi dhe parregullsi në procedurën e kontrollit, duke sjellë si pasojë të ardhura të munguara për buxhetin e shtetit në vlerën totale prej 65,737,374 lekë.

Z. B.H, në detyrën e Inspektorit të Kontrollit të Drejtorisë së Kontrollit Tatimor, Drejtoria Rajonale Tatimore Fier;

- Për shkeljet e konstatuara në kryerjen e detyrave funksionale nga ana e inspektorit të kontrollit tatimor, të përcaktuara në Rregulloren e Funksionimit të Drejtorive Rajonale Tatimore dalë me Urdhrin Nr.192, datë 12.08.2020, të Ministrit të Financave, pika 1 e nenit 59 si dhe përcaktimet ligjore të Ligjit Nr.9920, datë 19.05.2008 "Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar, neni 124 dhe 128, Udhëzimit Nr.19, datë 3.11.2014 "Për zbatimin e regjimit të veçantë të skemës së kompensimit të prodhuesve bujqësorë për qëllime të TVSH-së", neni 19, Manual i Kontrollit Tatimor, Kapitulli VII, për 2 raste ku janë konstatuar mangësi dhe parregullsi në procedurën e kontrollit, duke sjellë si pasojë të ardhura të munguara për buxhetin e shtetit në vlerën totale prej 3,338,983 lekë.

Z. E.M, në detyrën e Inspektorit të Kontrollit të Drejtorisë së Kontrollit Tatimor, Drejtoria Rajonale Tatimore Fier;

- Për shkeljet e konstatuara në kryerjen e detyrave funksionale nga ana e inspektorit të kontrollit tatimor, të përcaktuara në Rregulloren e Funksionimit të Drejtorive Rajonale Tatimore dalë me Urdhrin Nr.192, datë 12.08.2020, të Ministrit të Financave, pika 1 e nenit 59 si dhe përcaktimet ligjore të Ligjit Nr.92/2014 "Për tatimin mbi vlerën e shtuar në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar, Kreu IX, Manual i Kontrollit Tatimor, Kapitulli VII, për 1 raste ku janë konstatuar

mangësi dhe parregullsi në procedurën e kontrollit, duke sjellë si pasojë të ardhura të munguara për buxhetin e shtetit në vlerën totale prej 21,138,676 lekë.

Z. L.C, në detyrën e Inspektorit të Kontrollit të Drejtorisë së Kontrollit Tatimor, Drejtoria Rajonale Tatimore Fier;

- Për shkeljet e konstatuara në kryerjen e detyrave funksionale nga ana e inspektorit të kontrollit tatimor, të përcaktuara në Rregulloren e Funksionimit të Drejtorive Rajonale Tatimore dalë me Urdhrin Nr.192, datë 12.08.2020, të Ministrit të Financave, pika 1 e nenit 59 si dhe përcaktimet ligjore të Ligjit Nr.9920, datë 19.05.2008 "Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar, neni 71, 72, 115, 119 dhe 124, Kodi i Punës në Republikën e Shqipërisë, neni 87 dhe 119, Vendimi Nr.399, datë 3.5.2017, i Këshillit të Ministrave, "Për përcaktimin e pagës minimale në shkallë vendi" dhe Vendim Nr.809, datë 26.12.2018 "Për përcaktimin e pagës minimale në shkallë vendi", Ligjit Nr.9136, datë 11.9.2003 "Për mbledhjen e kontributeve të detyrueshme të sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar, neni 15, Manual i Kontrollit Tatimor, Kapitulli VII, për 1 raste ku janë konstatuar mangësi dhe parregullsi në procedurën e kontrollit, duke sjellë si pasojë të ardhura të munguara për buxhetin e shtetit në vlerën totale prej 9,741,048 lekë.

Znj. V. P, në detyrën e Inspektorit të Kontrollit të Drejtorisë së Kontrollit Tatimor, Drejtoria Rajonale Tatimore Fier;

- Për shkeljet e konstatuara në kryerjen e detyrave funksionale nga ana e inspektorit të kontrollit tatimor, të përcaktuara në Rregulloren e Funksionimit të Drejtorive Rajonale Tatimore dalë me Urdhrin Nr.192, datë 12.08.2020, të Ministrit të Financave, pika 1 e nenit 59 si dhe përcaktimet ligjore të Ligjit Nr.9920, datë 19.05.2008 "Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar, neni 115, Ligjit Nr.92/2014 "Për tatimin mbi vlerën e shtuar në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar, 69 dhe 72, Ligjit Nr.8438, datë 28.12.1998 "Për tatimin mbi të ardhurat" neni 21, Udhëzimit Nr.6, datë 30.01.2015 "Për tatimin mbi vlerën e shtuar në Republikën e Shqipërisë", neni 55 dhe Udhëzimit Nr.19, datë 3.11.2014 "Për zbatimin e regjimit të veçantë të skemës së kompensimit të prodhuesve bujqësorë për qëllime të TVSH-së", neni 19, Manual i Kontrollit Tatimor, Kapitulli VII, për 2 raste ku janë konstatuar mangësi dhe parregullsi në procedurën e kontrollit, duke sjellë si pasojë të ardhura të munguara për buxhetin e shtetit në vlerën totale prej 6,177,683 lekë.

Znj. E. E, në detyrën e Përgjegjës i Sektorit të Kontrollit nga Zyra dhe Monitorimit, Drejtoria Rajonale Tatimore Fier;

- Për shkeljet e konstatuara në kryerjen e detyrave funksionale nga ana e Përgjegjësit të Sektorit të Kontrollit nga Zyra dhe Monitorimit, të përcaktuara në Rregulloren e Funksionimit të Drejtorive Rajonale Tatimore dalë me Urdhrin Nr.192, datë 12.08.2020, të Ministrit të Financave, neni 51, si dhe përcaktimet ligjore të Ligjit Nr.9920, datë 19.05.2008 "Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar, neni 114/1, Manuali i Kontrollit nga Zyra dhe Monitorimit 2018, pika 4, 6, 8, 9, 11.2, 13, Manuali i Kontrollit nga Zyra dhe Monitorimit 2022, pika 6, 8, 10, për 29 raste ku janë konstatuar mangësi dhe parregullsi në procedurën e kontrollit nga zyra të subjekteve që kanë paguar me vonesë ose nuk kanë paguar këstet e tatim fitimit, duke sjellë si pasojë të ardhura të munguara për buxhetin e shtetit në vlerën totale prej 6,628,657 lekë.

III. "Largim nga shërbimi civil", për 2 (dy) punonjës, si më poshtë:

Z. B. S, në detyrën e Drejtor të Drejtorisë së Kontrollit Tatimor, Drejtoria Rajonale Tatimore Fier;

1. Për shkeljet e konstatuara në kryerjen e detyrave funksionale nga ana e Drejtorit të Drejtorisë së Kontrollit Tatimor, të përcaktuara në Rregulloren e Funksionimit të Drejtorive Rajonale Tatimore dalë me Urdhrin Nr.192, datë 12.08.2020, të Ministrit të Financave, pikat 2, 7 dhe 11 të nenit 57, si dhe përcaktimet ligjore të Ligjit Nr.9920, datë 19.05.2008 "Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar, neni 71, 72, 115, 119 dhe 124, Ligjit Nr.92/2014 "Për tatimin mbi vlerën e shtuar në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar, neni 69, 72 dhe Kreu IX, Ligjit Nr.8438, datë 28.12.1998 "Për tatimin mbi të ardhurat" neni 21, Ligjit Nr.9136, datë 11.9.2003 "Për mbledhjen e kontributeve të detyrueshme të sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar, neni 15, Ligjit Nr.9917 datë 19.5.2008 "Për parandalimin e pastrimit të parave dhe financimin e terrorizmit" i ndryshuar, neni 18.1, UMF Nr.16, datë 16.2.2009 "Për parandalimin e pastrimit të parave dhe për të luftuar financimin e terrorizmit në sistemin e tatim-taksave", neni 5, Vendimi Nr.399, datë 3.5.2017, i Këshillit të Ministrave, "Për përcaktimin e pagës minimale në shkallë vendi", Vendim Nr.809, datë 26.12.2018 "Për përcaktimin e pagës minimale në shkallë vendi" dhe Vendimin Nr.1025, datë 16.12.2020 "Për përcaktimin e pagës minimale në shkallë vendi", VKM Nr.168, datë 27.3.2019, Udhëzimit Nr.6, datë 30.01.2015 "Për tatimin mbi vlerën e shtuar në Republikën e Shqipërisë", neni 20, 55, Udhëzimit Nr.19, datë 3.11.2014 "Për zbatimin e regjimit të veçantë të skemës së kompensimit të prodhuesve bujqësorë për qëllime të TVSH-së", neni 19, Udhëzimi i Këshillit të Ministrave Nr.3 "Miratimin e kostos mesatare të ndërtimit të banesave nga Enti Kombëtar i Banesave, për vitin 2016", Kodi i Punës në Republikën e Shqipërisë, neni 87 dhe 119, Manual i Kontrollit Tatimor, Kapitulli VII, për 22 raste ku janë konstatuar mangësi dhe parregullsi në procedurën e kontrollit, duke sjellë si pasojë të ardhura të munguara për buxhetin e shtetit në vlerën totale prej 453,945,126 lekë.

2. Parregullësi në zbatimin të procedurave dhe afateve administrative për hartimin e akteve të kontrollit tatimore, 12 raste Projekt Raporti i Kontrollit Tatimor është dërguar në subjekt në tejkalim të afatit 7 ditë kalendarike dhe 9 raste Raporti Përfundimtar i Kontrollit Tatimor është dërguar në subjekt në tejkalim të afatit 14 ditë kalendarike, veprime në kundërshtim me përcaktimet e pikës 1 të nenit 84 të Ligjit nr.9920 "Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar.

3. Për 29 raste ku janë konstatuar mangësi dhe parregullsi në procedurën e kontrollit nga zyra të subjekteve që kanë paguar me vonesë ose nuk kanë paguar këstet e tatim fitimit në kundërshtim me përcaktimet ligjore të si dhe përcaktimet ligjore të Ligjit Nr.9920, datë 19.05.2008 "Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar, neni 114/1, duke sjellë si pasojë të ardhura të munguara për buxhetin e shtetit në vlerën totale prej 6,628,657 lekë.

Z. A.P, në detyrën e Drejtor Rajonal i Drejtorisë Rajonale Tatimore Fier;

1. Për shkeljet e konstatuara në kryerjen e detyrave funksionale nga ana e Drejtorit Rajonal, të përcaktuara në Rregulloren e Funksionimit të Drejtorive Rajonale Tatimore dalë me Urdhrin Nr.192, datë 12.08.2020, të Ministrit të Financave, pikat 3, 10, 11, 18 dhe 20 të nenit 4, si dhe përcaktimet ligjore të Ligjit Nr.9920, datë 19.05.2008 "Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar, neni 71, 72, 115, 119 dhe 124, Ligjit Nr.92/2014 "Për tatimin mbi vlerën e shtuar në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar, neni 69, 72 dhe Kreu IX, Ligjit Nr.8438, datë 28.12.1998 "Për tatimin mbi të ardhurat" neni 21, Ligjit Nr.9136, datë 11.9.2003 "Për mbledhjen e kontributeve të detyrueshme të sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar, neni 15, Ligjit Nr.9917 datë 19.5.2008 "Për parandalimin e pastrimit të parave dhe financimin e terrorizmit" i ndryshuar, neni 18.1, UMF Nr.16, datë 16.2.2009 "Për

parandalimin e pastrimit të parave dhe për të luftuar financimin e terrorizmit në sistemin e tatim-taksave”, neni 5, Vendimi Nr.399, datë 3.5.2017, i Këshillit të Ministrave, “Për përcaktimin e pagës minimale në shkallë vendi”, Vendim Nr.809, datë 26.12.2018 “Për përcaktimin e pagës minimale në shkallë vendi” dhe Vendimin Nr.1025, datë 16.12.2020 “Për përcaktimin e pagës minimale në shkallë vendi”, VKM Nr.168, datë 27.3.2019, Udhëzimit Nr.6, datë 30.01.2015 “Për tatimin mbi vlerën e shtuar në Republikën e Shqipërisë”, neni 20, 55, Udhëzimit Nr.19, datë 3.11.2014 “Për zbatimin e regjimit të veçantë të skemës së kompensimit të prodhuesve bujqësorë për qëllime të TVSH-së”, neni 19, Udhëzimi i Këshillit të Ministrave Nr.3 “Miratimin e kostos mesatare të ndërtimit të banesave nga Enti Kombëtar i Banesave, për vitin 2016”, Kodi i Punës në Republikën e Shqipërisë, neni 87 dhe 119, Manual i Kontrollit Tatimor, Kapitulli VII, për 22 raste ku janë konstatuar mangësi dhe parregullsi në procedurën e kontrollit, duke sjellë si pasojë të ardhura të munguara për buxhetin e shtetit në vlerën totale prej 453,945,126 lekë.

2. Mosrealizim i të ardhurave nga TVSH për 2021 dhe 2023 në krahasim me planin e rishikuar të të ardhurave tatimor për DRT Fier, në kundërshtim me shkresën nr.8446 prot., datë 12.05.2020 “Dërgohet plani i të ardhurave për vitin 2021” dhe shkresën Nr.2078, datë 10.02.2023 “Dërgohet plani i të ardhurave përiudhën Janar-Shtator 2023” si dhe Rregulloren e Funksionimit të Drejtorive Rajonale Tatimore dalë me Urdhrin Nr.192, datë 12.08.2020, të Ministrit të Financave, pikat 3 dhe 4 të nenit 4.

3. Nxjerrja e 2 urdhrave të brendshëm nr.13304, prot datë 07.10.2022 dhe nr.1330/1 prot., datë 07.10.2022, për angazhimin e punonjësve të DRT Fier në detyra të tjera funksionale, jashtë kompetencave sipas përcaktimeve në Rregulloren e Funksionimit të Drejtorive Rajonale Tatimore dalë me Urdhrin Nr.192, datë 12.08.2020, të Ministrit të Financave.

4. Janë konstatuar mangësi dhe parregullsi gjatë rilidhjes dhe monitorimit të 17 Akt Marrëveshjeve me këste për 14 tatimpagues që nuk i kanë plotësuar kushtet në kundërshtim me përcaktimet ligjore të Ligjit Nr.9920, datë 19.05.2008 "Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar, neni 77, duke sjellë si pasojë vlera borxhi të palikuiduar në vlerën totale prej 33,791,000 lekë.

5. Për 29 raste ku janë konstatuar mangësi dhe parregullsi në procedurën e kontrollit nga zyra të subjekteve që kanë paguar me vonesë ose nuk kanë paguar këstet e tatim fitimit në kundërshtim me përcaktimet ligjore të si dhe përcaktimet ligjore të Ligjit Nr.9920, datë 19.05.2008 "Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar, neni 114/1, duke sjellë si pasojë të ardhura të munguara për buxhetin e shtetit në vlerën totale prej 6,628,657 lekë.

6. Parregullësi në zbatimin të procedurave dhe afateve administrative për hartimin e akteve të kontrollit tatimore, 12 raste Projekt Raporti i Kontrollit Tatimor është dërguar në subjekt në tejkalim të afatit 7 ditë kalendarike dhe 9 raste Raporti Përfundimtar i Kontrollit Tatimor është dërguar në subjekt në tejkalim të afatit 14 ditë kalendarike, veprime në kundërshtim me përcaktimet e pikës 1 të nenit 84 të Ligjit nr.9920 “Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar.

7. Për 2 raste verifikimi në terren të subjekteve, ka rezultuar shkelje të afateve procedurale dhe vonesa prej 7 muajsh në miratimin e gjobës për pengimin e kontrollit në kundërshtim me përcaktimeve të nenit 127, pika 2 e Ligjit Nr.9920, datë 19.05.2008 “Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar dhe Manual i Drejtorisë së Verifikimit dhe Koordinimit në Terren, miratuar me urdhër të Drejtorit të Përgjithshëm të Tatimeve Nr.19/2, datë 28.02.2020.

IV. Për punonjësit e mëposhtëm nuk rekomandojmë masa disiplinore pasi shkeljet e konstatuara pavarësisht se ekzistojnë nuk janë materiale dhe nuk justifikojnë dhënien e një mase disiplinore, për 7 (shtatë) punonjës, si më poshtë:

Z. A. H në detyrën e Inspektorit të Kontrollit të Drejtorisë së Kontrollit Tatimor, Drejtoria Rajonale Tatimore Fier.

Z. S. N, në detyrën e Inspektorit të Kontrollit të Drejtorisë së Kontrollit Tatimor, Drejtoria Rajonale Tatimore Fier.

Znj. D. D, në detyrën e Inspektorit të Sektorit të Kontrollit nga Zyra dhe Monitorimit, Drejtoria Rajonale Tatimore Fier.

Znj. E. M, në detyrën e Inspektorit të Sektorit të Kontrollit nga Zyra dhe Monitorimit, Drejtoria Rajonale Tatimore Fier;

Znj. X. P, në detyrën e Inspektorit të Sektorit të Kontrollit nga Zyra dhe Monitorimit, Drejtoria Rajonale Tatimore Fier;

Znj. D. D, në detyrën e Inspektorit të Sektorit të Kontrollit nga Zyra dhe Monitorimit, Drejtoria Rajonale Tatimore Fier;

Znj. Z. S, në detyrën e Inspektorit të Sektorit të Kontrollit nga Zyra dhe Monitorimit, Drejtoria Rajonale Tatimore Fier;

Qëndrimi i subjektit: -Nga ana e Drejtorisë Rajonale Tatimore Fier janë marrë masat për fillimin e ecurisë disiplinore për punonjësin z. A H. Konkretisht është nisur ecuria disiplinore me shkresën protokolluar me tonën nr. 9418/107 prot datë 17.09.2024. Është mbajtur proces verbali me nr. 9418/127 prot datë 24.09.2024 dhe Vendimi i Drejtorit Rajonal me nr. 9418/128 prot datë 24.09.2024, i cili është dërguar drejtuar DPT dhe DAP me nr. 9418/138 prot datë 10.10.2024. Bashkëlidhur shkresa e fillimit të ecurisë së cituar si dhe procedura disiplinore e ndjekur për z. A H.

- Nga ana e Drejtorisë Rajonale Tatimore Fier janë marrë masat për fillimin e ecurisë disiplinore për punonjësin z. E F. Konkretisht është nisur ecuria disiplinore me shkresën protokolluar me tonën nr. 9418/108 prot datë 17.09.2024. Është mbajtur proces verbali me nr. 9418/129 prot datë 24.09.2024 dhe Vendimi i Drejtorit Rajonal me nr. 9418/130 prot datë 24.09.2024, i cili është dërguar drejtuar DPT dhe DAP me nr. 9418/136 prot datë 10.10.2024. Bashkëlidhur shkresa e fillimit të ecurisë së cituar si dhe procedura disiplinore e ndjekur për z. E F.

- Znj. F. H nuk është punonjës i DRT Fier, por është transferuar në Drejtorinë e Përgjithshme të Tatimeve.

- Nga ana e Drejtorisë Rajonale Tatimore Fier janë marrë masat për fillimin e ecurisë disiplinore për punonjësin Znj. E. S. Konkretisht është nisur ecuria disiplinore me shkresën protokolluar me tonën nr. 9418/106 prot datë 17.09.2024. Është mbajtur proces verbali me nr. 9418/133 prot datë 24.09.2024 dhe Vendimi i Drejtorit Rajonal me nr. 9418/134 prot datë 24.09.2024, i cili është dërguar drejtuar DPT dhe DAP me nr. 9418/135 prot datë 10.10.2024. Bashkëlidhur shkresa e fillimit të ecurisë së cituar si dhe procedura disiplinore e ndjekur për Znj. E. S.

- Nga ana e Drejtorisë Rajonale Tatimore Fier janë marrë masat për fillimin e ecurisë disiplinore për punonjësin z. L R. Konkretisht është nisur ecuria disiplinore me shkresën protokolluar me tonën nr. 9418/105 prot datë 17.09.2024. Është mbajtur proces verbali me nr. 9418/131 prot datë 24.09.2024 dhe Vendimi i Drejtorit Rajonal me nr. 9418/132 prot datë 24.09.2024, i cili është dërguar drejtuar DPT dhe DAP me nr. 9418/137 prot datë 10.10.2024. Bashkëlidhur shkresa e fillimit të ecurisë së cituar si dhe procedura disiplinore e ndjekur për z. L R.

- Nga ana e DRT Fier është propozuar fillimi i ecurisë disiplinore me shkresën nr. 9418/73 prot datë 21.08.2024, për shkeljet e konstatuara në Raportin Përfundimtar të Auditimit të ushtruar në

DRT Fier nga Kontrolli i Lartë i Shtetit. Me shkresën e DPT nr. 14814/1 prot datë 04.09.2024 protokolluar me tonën nr. 9418/94 prot datë 06.09.2024 ka filluar ecuria disiplinore për z. A K. Me shkresën e DPT nr. 14814/4 prot datë 4.11.2024, protokolluar me tonën nr. 9418/143 prot datë 11.11.2024, është dërguar Vendimi i Ndërmjetëm Nr. 421 datë 4.11.2024, në të cilën është vendosur pezullimi i procedurës administrative për ecurinë disiplinore të nisur ndaj z. K, vendim i arsyetuar deri në daljen e rezultateve përfundimtare nga rikontrolli tatimor.

- Nga ana e DRT Fier është propozuar fillimi i ecurisë disiplinore me shkresën nr. 9418/74 prot datë 21.08.2024, për shkeljet e konstatuara në Raportin Përfundimtar të Auditimit të ushtruar në DRT Fier nga Kontrolli i Lartë i Shtetit. Me shkresën e DPT nr. 14813/1 prot datë 04.09.2024 protokolluar me tonën nr. 9418/90 prot datë 06.09.2024 ka filluar ecuria disiplinore për z. G L. Me shkresën e DPT nr. 14813/4 prot datë 4.11.2024, protokolluar me tonën nr. 9418/150 prot datë 11.11.2024, është dërguar Vendimi i Ndërmjetëm Nr. 429 datë 4.11.2024, në të cilën është vendosur pezullimi i procedurës administrative për ecurinë disiplinore të nisur ndaj z. L, vendim i arsyetuar deri në daljen e rezultateve përfundimtare nga rikontrolli tatimor.

- Nga ana e DRT Fier është propozuar fillimi i ecurisë disiplinore me shkresën nr. 9418/74 prot datë 21.08.2024, për shkeljet e konstatuara në Raportin Përfundimtar të Auditimit të ushtruar në DRT Fier nga Kontrolli i Lartë i Shtetit. Me shkresën e DPT nr. 14812/1 prot datë 04.09.2024 protokolluar me tonën nr. 9418/93 prot datë 06.09.2024 ka filluar ecuria disiplinore për z. D S Me shkresën e DPT nr. 14812/5 prot datë 4.11.2024, protokolluar me tonën nr. 9418/147 prot datë 11.11.2024, është dërguar Vendimi i Ndërmjetëm Nr. 425 datë 4.11.2024, në të cilën është vendosur pezullimi i procedurës administrative për ecurinë disiplinore të nisur ndaj z. S, vendim i arsyetuar deri në daljen e rezultateve përfundimtare nga rikontrolli tatimor.

- Nga ana e DRT Fier është propozuar fillimi i ecurisë disiplinore me shkresën nr. 9418/76 prot datë 21.08.2024, për shkeljet e konstatuara në Raportin Përfundimtar të Auditimit të ushtruar në DRT Fier nga Kontrolli i Lartë i Shtetit. Me shkresën e DPT nr. 14811/1 prot datë 04.09.2024 protokolluar me tonën nr. 9418/91 prot datë 06.09.2024 ka filluar ecuria disiplinore për z. V R. Me shkresën e DPT nr. 14811/4 prot datë 4.11.2024, protokolluar me tonën nr. 9418/149 prot datë 11.11.2024, është dërguar Vendimi i Ndërmjetëm Nr. 427 datë 4.11.2024, në të cilën është vendosur pezullimi i procedurës administrative për ecurinë disiplinore të nisur ndaj z. R, vendim i arsyetuar deri në daljen e rezultateve përfundimtare nga rikontrolli tatimor.

- Nga ana e DRT Fier është propozuar fillimi i ecurisë disiplinore me shkresën nr. 9418/77 prot datë 21.08.2024, për shkeljet e konstatuara në Raportin Përfundimtar të Auditimit të ushtruar në DRT Fier nga Kontrolli i Lartë i Shtetit. Me shkresën e DPT nr. 14819/1 prot datë 04.09.2024 protokolluar me tonën nr. 9418/96 prot datë 06.09.2024 ka filluar ecuria disiplinore për z. A G. Me shkresën e DPT nr. 14819/4 prot datë 4.11.2024, protokolluar me tonën nr. 9418/145 prot datë 11.11.2024, është dërguar Vendimi i Ndërmjetëm Nr. 423 datë 4.11.2024, në të cilën është vendosur pezullimi i procedurës administrative për ecurinë disiplinore të nisur ndaj z. G, vendim i arsyetuar deri në daljen e rezultateve përfundimtare nga rikontrolli tatimor.

- Nga ana e DRT Fier është propozuar fillimi i ecurisë disiplinore me shkresën nr. 9418/78 prot datë 21.08.2024, për shkeljet e konstatuara në Raportin Përfundimtar të Auditimit të ushtruar në DRT Fier nga Kontrolli i Lartë i Shtetit. Me shkresën e DPT nr. 14819/1 prot datë 04.09.2024 protokolluar me tonën nr. 9418/96 prot datë 06.09.2024 ka filluar ecuria disiplinore për z. S Z. Me shkresën e DPT nr. 1481984 prot datë 4.11.2024, protokolluar me tonën nr. 9418/142 prot datë 11.11.2024, është dërguar Vendimi i Ndërmjetëm Nr. 430 datë 4.11.2024, në të cilën është vendosur pezullimi i procedurës administrative për ecurinë disiplinore të nisur ndaj z. Z, vendim i arsyetuar deri në daljen e rezultateve përfundimtare nga rikontrolli tatimor.

- Nga ana e DRT Fier është propozuar fillimi i ecurisë disiplinore me shkresën nr. 9418/79 prot datë 21.08.2024, për shkeljet e konstatuara në Raportin Përfundimtar të Auditimit të ushtruar në DRT Fier nga Kontrolli i Lartë i Shtetit. Me shkresën e DPT nr. 14817/1 prot datë 04.09.2024 protokolluar me tonën nr. 9418/95 prot datë 06.09.2024 ka filluar ecuria disiplinore për z. B H. Me shkresën e DPT nr. 14817/4 prot datë 4.11.2024, protokolluar me tonën nr. 9418/144 prot datë 11.11.2024, është dërguar Vendimi i Ndërmjetëm Nr. 422 datë 4.11.2024, në të cilën është vendosur pezullimi i procedurës administrative për ecurinë disiplinore të nisur ndaj z. H, vendim i arsyetuar deri në daljen e rezultateve përfundimtare nga rikontrolli tatimor.

- Nga ana e DRT Fier është propozuar fillimi i ecurisë disiplinore me shkresën nr. 9418/80 prot datë 21.08.2024, për shkeljet e konstatuara në Raportin Përfundimtar të Auditimit të ushtruar në DRT Fier nga Kontrolli i Lartë i Shtetit. Me shkresën e DPT nr. 14816/1 prot datë 04.09.2024 protokolluar me tonën nr. 9418/92 prot datë 06.09.2024 ka filluar ecuria disiplinore për z. E M. Me shkresën e DPT nr. 14816/4 prot datë 4.11.2024, protokolluar me tonën nr. 9418/146 prot datë 11.11.2024, është dërguar Vendimi i Ndërmjetëm Nr. 427 datë 4.11.2024, në të cilën është vendosur pezullimi i procedurës administrative për ecurinë disiplinore të nisur ndaj z. M, vendim i arsyetuar deri në daljen e rezultateve përfundimtare nga rikontrolli tatimor.

- Nga ana e DRT Fier është propozuar fillimi i ecurisë disiplinore me shkresën nr. 9418/81 prot datë 21.08.2024, për shkeljet e konstatuara në Raportin Përfundimtar të Auditimit të ushtruar në DRT Fier nga Kontrolli i Lartë i Shtetit. Me shkresën e DPT nr. 14815/1 prot datë 04.09.2024 protokolluar me tonën nr. 9418/87 prot datë 06.09.2024 ka filluar ecuria disiplinore për z. L C. Me shkresën e DPT nr. 14815/4 prot datë 4.11.2024, protokolluar me tonën nr. 9418/148 prot datë 11.11.2024, është dërguar Vendimi i Ndërmjetëm Nr. 426 datë 4.11.2024, në të cilën është vendosur pezullimi i procedurës administrative për ecurinë disiplinore të nisur ndaj z. C, vendim i arsyetuar deri në daljen e rezultateve përfundimtare nga rikontrolli tatimor.

- Nga ana e DRT Fier është propozuar fillimi i ecurisë disiplinore me shkresën nr. 9418/82 prot datë 21.08.2024, për shkeljet e konstatuara në Raportin Përfundimtar të Auditimit të ushtruar në DRT Fier nga Kontrolli i Lartë i Shtetit. Me shkresën e DPT nr. 148110/1 prot datë 04.09.2024 protokolluar me tonën nr. 9418/89 prot datë 06.09.2024 ka filluar ecuria disiplinore për znj. V P. Me shkresën e DPT nr. 14810/4 prot datë 4.11.2024, protokolluar me tonën nr. 9418/149 prot datë 11.11.2024, është dërguar Vendimi i Ndërmjetëm Nr. 428 datë 4.11.2024, në të cilën është vendosur pezullimi i procedurës administrative për ecurinë disiplinore të nisur ndaj znj. P, vendim i arsyetuar deri në daljen e rezultateve përfundimtare nga rikontrolli tatimor.

- Nga ana e DRT Fier është propozuar fillimi i ecurisë disiplinore me shkresën nr. 9418/83 prot datë 21.08.2024, për shkeljet e konstatuara në Raportin Përfundimtar të Auditimit të ushtruar në DRT Fier nga Kontrolli i Lartë i Shtetit. Me shkresën e DPT nr. 148120/1 prot datë 04.09.2024 protokolluar me tonën nr. 9418/97 prot datë 06.09.2024 ka filluar ecuria disiplinore për znj. E E. Me shkresën e DPT nr. 14820/4 prot datë 4.11.2024, protokolluar me tonën nr. 9418/151 prot datë 11.11.2024, është dërguar Vendim e Komisionit të Disiplinës Nr. 430 datë 4.11.2024, me anë të të cilit është dhënë masa disiplinore “Pezullim nga e drejta e ngritjes në detyrë, përfshirë rritjen e pagës për një periudhë 3 (tre) mujore”, për nëpunësin civil znj. E E.

- Nga ana e DRT Fier është propozuar fillimi i ecurisë disiplinore me shkresën nr. 9418/84 prot datë 22.08.2024, për shkeljet e konstatuara në Raportin Përfundimtar të Auditimit të ushtruar në DRT Fier nga Kontrolli i Lartë i Shtetit. Me shkresën e DPT nr. 14891/1 prot datë 04.09.2024 protokolluar me tonën nr. 9418/98 prot datë 06.09.2024 ka filluar ecuria disiplinore për z. B S. Me shkresën e DPT nr. 14891/6 prot datë 15.11.2024, protokolluar me tonën nr. 9418/154 prot datë 22.11.2024, është dërguar Vendimi i Ndërmjetëm Nr. 438 datë 15.11.2024, në të cilën është

vendosur pezullimi i procedurës administrative për ecurinë disiplinore të nisur ndaj z. S, vendim i arsyetuar deri në rikthimin në punë pasi është pezulluar nga shërbimi civil me kërkesë të tij me shkresën nr. 18944/1 prot datë 13.11.2024.

- Drejtorja e Përgjithshme e Tatimeve ka filluar ecurinë disiplinore ndaj z. A P me detyrë Drejtor Rajonal në Drejtorinë Rajonale Tatimore Fier me shkresën e DPT nr. 12886/2 prot datë 04.09.2024, protokolluar në DRT Fier me shkresën nr. 9418/99 prot datë 06.09.2024, në lidhje me shkeljet e konstatuara në Raportin Përfundimtar të Auditimit të ushtruar në DRT Fier nga Kontrolli i Lartë i Shtetit. Drejtorja e Përgjithshme e Tatimeve me Vendim Nr. 417 datë 29.10.2024, dërguar me shkresën nr. 12886/10 prot datë 29.10.2024, protokolluar në DRT Fier me nr. 9418/139 prot datë 01.11.2024, ka vendosur marrjen e masës disiplinore “Largim nga shërbimi civil” për nëpunësin civil z. A P.

Qëndrimi i grupit të auditimit: Duke vlerësuar vetëm zbatimin procedural brenda kompetencës së DRT Fier, konstatojmë se janë ndërmarrë veprimet e kërkuara për inicimin dhe përcjelljen e masave disiplinore:

- Inicim zyrtar i ecurive disiplinore për punonjësit nën varësinë e DRT Fier (p.sh. z. A H, z. E F, znj. E S, z. L R), me regjistrim të akteve procedurale (shkresa fillestare, procesverbale, dhe Vendime të Drejtorit Rajonal të datës 24.09.2024) dhe dërgimin e tyre te DPT/DAP.

- Propozim/nisje e ecurive pranë DPT për inspektorët e Drejtorisë së Kontrollit Tatimor dhe të tjerë të listuar nga rekomandimi (Z. K, Z. L, Z. S, Z. R, Z. G., Z. Z., Z. Z. H, Z. M, Z. C, Znj. P, Znj. E, Z. S), me prova dërgese dhe ndjekje të ecurisë.

- Koordinim me DPT për rastet ku DPT ka kompetencë vendimmarrjeje (p.sh. vendimet e ndërmjetme të pezullimit të procedurave deri në përfundim të rikontrolleve; vendimi disiplinor ndaj znj. E E për pezullim 3-mujor; si dhe rasti i z. A P me masën “Largim nga shërbimi civil”).

- Sqarim kompetencash për rastin Znj. F H (jo më në DRT Fier), duke e adresuar çështjen te organi epror.

- Këto tregojnë që DRT Fier ka kryer hapat proceduralë: inicim, dokumentim, protokollim dhe përcjellje pranë organeve kompetente (DPT/DAP), si dhe ndjekje e përgjigjeve/vendimeve që kthehen nga DPT.

Megjithëse shumë vendime përfundimtare varen nga Komisioni Disiplinor i DPT dhe disa procedura janë pezulluar deri në përfundimin e rikontrolleve (pra procesi i përgjithshëm i rekomandimit ende vijon në nivel qendror), kjo nuk çënon përmbushjen e detyrimeve procedurale të DRT Fier. Statusi i zbatimit të rekomandimit, proceduralisht, brenda kompetencës së DRT Fier: Zbatuar.

**** Për çështjet ku Komisioni i Disiplinës pranë DPT nuk ka dhënë ende vendim përfundimtar, theksojmë se DRT Fier e ka përmbushur detyrimin procedural të inicimit dhe përcjelljes së dosjeve, por për mbyllje shteruese dhe përfundimtare kërkohet një angazhim i shtuar i organit epror (DPT): të formalizojë një kalendar afatesh dhe plan veprimi për çështjet e pezulluara, të sigurojë komunikim periodik me shkrim mbi ecurinë dhe të finalizojë vendimmarrjen. Për znj. Fatbardha Hazizaj, e transferuar në DPT, kompetenca për shqyrtimin dhe marrjen e masës disiplinore është ekskluzivisht e organit epror, i cili duhet të konkludojë pa vonesë sipas rekomandimit. Për z. B S, për të cilin procedura rezulton e pezulluar, kërkohet që DPT të rivlerësojë urgjentisht rrethanat, të vendosë afat mbylljeje të pezullimit dhe të japë vendim përfundimtar, duke garantuar zbatimin efektiv të masave dhe adresimin e plotë të pasojave të konstatuara.*

Ky rekomandim rezulton i pranuar dhe zbatuar plotësisht.

E. PËR PUNONJËSIT E LARGUAR

Për ish punonjësit e mëposhtëm nuk rekomandojmë masa disiplinore edhe sepse shkeljet e natyrës administrative të konstatuara, pavarësisht se ekzistojnë nuk mund të ezaurohen si të tilla, pasi personat e sipërpërmendur nuk janë në marrëdhënie pune me këtë institucion dhe nuk ka adresim institucional për dhënien e zbatimit të tyre.

J. H. në detyrën e Inspektorit të Kontrollit të Drejtorisë së Kontrollit Tatimor, Drejtoria Rajonale Tatimore Fier, dalë në pension pleqërie.

Znj. Z. H. në detyrën e Inspektorit të Sektorit të Kontrollit nga Zyra dhe Monitorimit, Drejtoria Rajonale Tatimore Fier, dalë në pension pleqërie.

Z. E. X. në detyrën e Përgjegjës Sektorit të Drejtorisë së Kontrollit Tatimor, Drejtoria Rajonale Tatimore Fier, larguar nga Shërbimi Civil.

F. NJOFTIM I DEPARTAMENTIT TË ADMINISTRATËS PUBLIKE.

Për punonjësit për të cilët janë rekomanduar masa disiplinore, Drejtoria Rajonale Tatimore Fier në bashkëpunim me Drejtorinë e Përgjithshme të Tatimeve, pasi të zbatohet procedurat e nevojshme ligjore dhe nënligjore për klasifikimin e shkeljeve dhe fillimin e ecurisë disiplinore dhe pas përfundimit të afateve ankimore, **të ndërmarrë veprimet si më poshtë:**

a. Të njoftojë Departamentin e Administratës Publike, për regjistrimin e masës disiplinore në Regjistrin Qendror të Përsoneelit, në zbatim të neneve 7 dhe 17, të ligjit nr. 152/2013 "Për nëpunësin civil", i ndryshuar.

b. Të njoftojë Komisionerin për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil, për mbikëqyrjen e ligjshmërisë në administrimin e shërbimit civil, në zbatim të nenit 11, të ligjit nr. 152/2013 "Për nëpunësin civil", i ndryshuar.

Qëndrimi i Subjektit: DRT Fier sqaron se nuk janë ndërmarr hapa për njoftimin e Departamentit të Administratës Publike, për regjistrimin e masës disiplinore në Regjistrin Qendror të Përsoneelit, në zbatim të neneve 7 dhe 17, të Ligjit Nr.152/2013 "Për nëpunësin civil", i ndryshuar si dhe Komisionerin për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil, për mbikëqyrjen e ligjshmërisë në administrimin e shërbimit civil, në zbatim të nenit 11, të Ligjit Nr.152/2013 "Për nëpunësin civil", i ndryshuar.

Qëndrimi i grupit të auditimit: Nga ayditimi dhe verifikimi rezultojnë shprehimisht se nuk janë ndërmarr hapa për:

a) Njoftimin e Departamentit të Administratës Publike (DAP) për regjistrimin e masave në Regjistrin Qendror të Përsoneelit (nenet 7 dhe 17 të Ligjit Nr.152/2013), dhe

b) njoftimin e Komisionerit për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil (KMSC) për mbikëqyrje të ligjshmërisë (neni 11 i Ligjit Nr.152/2013).

Rekomandimi kërkon këto njoftime pas finalizimit të procedurave disiplinore dhe përfundimit të afateve ankimore. Edhe nëse një pjesë e çështjeve është ende në ankime, subjekti nuk paraqet prova se për çështjet e formës së prerë janë bërë njoftimet e detyrueshme. Prandaj, në plan procedural, kërkesa e rekomandimit nuk është përmbushur. Statusi i zbatimit të rekomandimit: Pa zbatuar.

Ky rekomandim rezultojnë i pranuar dhe zbatuar plotësisht.

KONKLUZIONI I AUDITIMIT

Nga verifikimi i dokumentacionit konstatohet se niveli i pranimeve dhe zbatimit të rekomandimeve të lëna nga KLSH me shkresën nr. Nr.1112/33 Prot., datë 15.07.2024 është si më poshtë:

Për përmirsimin e gjendjes janë lënë 21 "Masa Organizative", nga ku janë pranuar 21 dhe knaë statusin e ecurisë së zbatimit si vijon- **9** masa janë zbatuar plotësisht, në përputhje me qëllimin dhe

përmbajtjen e rekomandimeve;

- **3** masa janë zbatuar pjesërisht, me veprime të ndërmarra, por që nuk kanë përmbushur të gjitha kërkesat e përcaktuara nga rekomandimi;

- **9** masa janë në proces zbatimi;

- **0** masë nuk është zbatuar ende;

- **0** masa janë refuzuar ose nuk janë pranuar nga subjekti audituar.

-Për përmirësimin e gjendjes janë lënë 23 rekomandime për të “*ardhura të munguara*” nga ku 23 rekomandime të pranuar, dhe 23 kanë statusin e ecurisë - **20** masa janë zbatuar plotësisht, duke u reflektuar në ndërmarrjen e veprimeve konkrete për rikupërimin e detyrimeve tatimore ose në përmirësimin e metodologjisë së administrimit të të ardhurave; **3** masa janë zbatuar pjesërisht, ku janë ndërmarrë veprime të pjesshme ose të kufizuara në kohë;

-Për përmirësimin e gjendjes janë lënë “*Masa Disiplinore*”.për 18 punonjës dhe pranuar rekomandime, 18 kanë statusin e ecurisë të realizuar plotësisht

IV. GJETJE DHE REKOMANDIME.

Për sa më sipër ri kërkojmë që Drejtoria Rajonale Tatimore Fier, të marrë të gjitha masat e nevojshme me qëllim zbatimin e të gjitha rekomandimeve që rezultojnë të pazbatuar dhe pjesërisht zbatuar, si dhe përshpejtimin e zbatimit të rekomandimeve, të cilat rezultojnë në proces zbatimi, brenda 6-mujorit të parë të vitit 2025.

MASA ORGANIZATIVE

2.1 Rekomandimi: Drejtori i DRT Fier, në bashkëpunim me DPT, të marrë masa për plotësimin e vendeve vakante, pjesë të shërbimit civil sipas pozicioneve të miratuara në kuadër të mbarëvajtjes së punës dhe përmirësimin e performancës institucionale.

3.1 Rekomandimi: Strukturat përgjegjëse pranë DRT Fier dhe DPT të marrin masat për garantimin e mbulimit me kontroll në vend të propozimeve në masën 30% të propozimeve nga DRT, duke trajtuar e dokumentuar me përparësi në përzgjedhje të subjekteve që mbartin realisht risk.

4.1 Rekomandimi: DVKT Rajoni Jugor, të koordinojë me DPT, me qëllim planifikimin sa më efektiv të subjekteve për kontroll sipas analizës së riskut, si dhe hartimin e planeve të punës me shpërndarje gjithëvjetore dhe organizmin sa më racional të grupeve të punës në terren, me qëllim që DVKT Rajoni Jugor, të opërojë në kushte efience dhe efektiviteti.

5.1 Rekomandimi: Drejtori i Verifikimit dhe Koordinimit në Terren Rajoni Jugor të zbatojë me korrektësi procedurat dhe afatet administrative për të siguruar trajtim të barabartë të subjekteve tatimpaguese dhe ndëshkimin e shkelësve të ligjit.

6.1 Rekomandimi: Nga Drejtoria Rajonale Tatimore Fier të merren masa që të zbatohen me korrektësi procedurat dhe afatet administrative për hartimin dhe dërgimin e projekt raportit dhe raportit përfundimtar të kontrollit tatimor tek tatimpaguesit objekt kontrolli, konform përcaktimeve ligjore në fuqi, me qëllim rritjen e efektivitetit të veprimtarisë kontrolluese.

12.1 Rekomandimi: Strukturat përgjegjëse pranë DRT Fier, të përforcojnë procedurat aktuale të ndjekura për monitorimin e akt marrëveshjeve aktive në drejtim të vjeljes së detyrimeve të subjekteve debitorë, si dhe të marrin masat për dokumentimin e analizave përpara lidhjes së akt-marrëveshjeve, me qëllim përmbushjen e kushteve dhe minimizimin e riskut të anulimit, apo përsëritjes së tyre, si një alternativë për të mos kaluar në masa të tjera shtrënguese.

16.1 Rekomandimi: Drejtoria Rajonale Tatimore Fier të marrë masat e duhura administrative konform legjislacionit tatimor për të shqyrtuar diferencat e mësipërme midis qarkullimit të deklaruar në formularin e deklarimit të pagesës të TVSH-së (FDP) dhe deklaratën e Tatimit mbi Fitimit, duke intensifikuar vlerësimet dhe rivlerësimet përkatëse si dhe propozimeve pranë Sektorit të Kontrollit në Vend në DRT Fier për kontrollet e thelluara në vend ose vizitave fiskale për tatimpaguesit me risk të lartë apo pamundësi vlerësimi nga zyra.

19.1 Rekomandimi: Drejtoria Rajonale Tatimore Fier të marrë masat e duhura administrative për të shqyrtuar diferencat midis xhiros së korrektuar të kasës (për vitin 2021), CPCM (për vitin 2022 dhe 2023) dhe të ardhurave në deklaratën e TVSH-së, duke intensifikuar vlerësimet dhe rivlerësimet përkatëse si dhe propozimeve pranë Sektorit të Kontrollit në Vend në DRT Fier për kontrollet e thelluara në vend ose vizitave fiskale për tatimpaguesit me risk të lartë apo pamundësi vlerësimi nga zyra.

- Sektori i Kontrollit nga Zyra dhe Monitorimit pranë DRT Fier të marrë masat për të intensifikuar propozimet për kryerjen e kontrolleve në vend për subjektet që rezultojnë me diferenca të xhiros për shkak të duplikimeve, anulimeve, korrigjimeve të faturave, dhe veçanërisht rasteve kur paraqitet si argument refuzimi i shërbimeve/mallrave nga bashkitë, situatë kjo që përbën risk për shmangien e pagesës së TVSH-së dhe tatimit mbi fitimin, objekt verifikimi në vend.- Inspektoret e kontrollit nga zyra të marrin masat për dokumentimin e vlerësimit të konstatimeve dhe rezultateve të kontrollit në vend të kryer pranë subjekteve të cilat janë propozuar për kontroll, me qëllim garantimin e evidentimit dhe problematikave në raportet e kontrollit, për të finalizuar procedurat monitoruese, pa u kufizuar vetëm në propozimin për kontroll të plotë.

20.1 Rekomandimi: Nga Drejtoria Rajonale Tatimore Fier të merren masa që çështjet e trajtuara më sipër të përfshihen në raportet e subjekteve objekt kontrolli në vend, konform përcaktimeve ligjore në fuqi, me qëllim përmirësimin e veprimtarisë aktuale kontrolluese.

3.5 DREJTORIA RAJONALE TATIMORE VLORË

Kontrolli i Lartë i Shtetit ushtroi auditimin tematik në Drejtorinë Rajonale Tatimore Vlorë me objekt “Për zbatimin e rekomandimeve të lëna në auditimet e evaduara në vitin 2024”, përcjellë me shkresën nr. .1111/40 prot., datë 03.10.2024, duke i kushtuar vëmendjen e posaçme çështjeve, që lidhen me:

- Vlerësimin e rekomandimeve të KLSH-së të lëna nga auditimi i kryer në vitin 2024, hartimi i programeve (plan veprimeve) nga subjekti i audituar, duke ngarkuar me detyra personat përgjegjës dhe përcaktuar afatet konkrete për zbatimin e rekomandimeve për çdo njësi vartëse; - Nxjerrjen nga titullari i njësisë publike të akteve administrative të nevojshme, si:

Vendimeve (urdhrave) për zbatimin e masave organizative;

Vendimet ekzekutive për shpërblimin e dëmit;

Vendimet ekzekutive për përdorimin me efektivitet, efikasitet dhe ekonomicitet të fondeve;

Vendimet e nëpunësit autorizues, komisioneve disiplinore për dhënien e masave disiplinore e të tjera masa e rekomandime që i përcillen subjektit të audituar nëpërmjet Vendimit të Kryetarit të Kontrollit të Lartë të Shtetit.

II. HYRJA

Auditimi është kryer në përputhje me ligjin nr. 154, datë 27.11.2014 “Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit”, si dhe manualit “Për ndjekjen e zbatimit të rekomandimeve të Kontrollit të Lartë të Shtetit” dhe Regjistrin elektronik institucional të zbatimit të rekomandimeve.

Auditimi i zbatimit të rekomandimeve të lëna në auditimin e mëparshëm, sipas drejtimeve të Programit të Auditimit nr. 857/6, datë 12.09.2025, të miratuar nga Kryetari i Kontrollit të Lartë të Shtetit, është kryer nga grupi i audituesve i përbërë nga:

-V. B , përgjegjës i grupit të auditimit

-I. F auditues

Auditimi ka filluar më datë 12.09.2025 dhe ka përfunduar më datë 24.10.2025.

II/1. OBJEKTI I AUDITIMIT

Zbatimi i masave të rekomanduara në auditimin e mëparshëm të dërguara me shkresën nr. .1111/40 prot., datë 03.10.2024 mbi veprimtarinë e Agjencisë Kombëtare të Burimeve Natyrore dhe Ministrisë së Infrastrukturës dhe Energjisë, së bashku me Raportin Përfundimtar të Auditimit, nga Grupi i Audituesve Shtetërorë të KLSH-së.

II/2. QËLLIMI I AUDITIMIT

Auditimi i zbatimit të rekomandimeve kryhet në funksion të hartimit të Raportit Vjetor të aktivitetit të Kontrollit të Lartë të Shtetit, që paraqitet në Kuvendin e Shqipërisë brenda tremujorit të parë të vitit pasardhës, bazuar në pikën 3 të nenit 31 të ligjit nr. 154/2014 “Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit”.

II/3. METODOLOGJIA E AUDITIMIT

Auditimi i plotë i të gjithë dokumentacionit të paraqitur nga subjekti dhe që ka lidhje me zbatimin e masave të rekomanduara nga KLSH për përmirësimin e gjendjes së subjekteve në të ardhmen.

III. PËRSHKRIMI I AUDITIMIT

III/1. INFORMACION I PËRGJITHSHËM.

Nga auditimi në terren i dokumentacionit të paraqitur nga subjekti Drejtorine Rajonale Tatimore Vlorë ,në lidhje me zbatimin e rekomandimeve të lëna nga KLSH me shkresën nr.1111/40 prot.,datë 03.10.2024 rezulton se, niveli i pranimeve dhe zbatimit të rekomandimeve është si më poshtë:

- Për përmirësimin e gjendjes janë lënë 15 rekomandime “*Masa Organizative*” ku janë pranuar 15, të cilat kanë statusin e ecurisë së zbatimit si vijon: 12 zbatuar plotësisht, 1 pjesërisht, 1 në proces zbatimi, si dhe 1 pazbatuar;

- Për përmirësimin e gjendjes janë lënë 23 rekomandime “*Të Ardhura të Munguara në Buxhetin e Shtetit*” të cilat janë pranuar dhe kanë statusin e ecurisë së zbatimit: 7 zbatuar plotësisht, 9 pjesërisht, 2 proces zbatimi, si dhe 5 pazbatuar;

-Për fillimin e procedurës për dhënien e “*Masës disiplinore*” në lidhje me mangësitë dhe shkeljet e konstatuara, të trajtuara në Raportin Përfundimtar të Auditimit, është lënë 1 rekomandim i cili është pranuar dhe ka statusin e ecurisë, zbatuar plotësisht.

Opinion i përgjithshëm mbi zbatimin e rekomandimeve

Nga auditimi i zbatimit të rekomandimeve konstatohet se shkalla e pranueshmërisë së rekomandimeve kundrejt atyre të pa pranuar rezulton në nivel 100%, konkretisht nga 39 rekomandime gjithsej, janë pranuar 39 rekomandime.

Niveli i zbatimit të rekomandimeve të zbatuara plotësisht rezultoi në masën 51%, niveli i rekomandimeve të zbatuara pjesërisht rezultoi 26%, niveli i zbatimit të rekomandimeve në proces zbatimi rezultoi 8%, niveli i rekomandimeve pa zbatuara rezultoi 15%.

A. Mbi hartimin e programit (Planit të veprimit) dhe respektimin e afateve ligjore për njoftimin e KLSH për ecurinë e zbatimit të rekomandimeve brenda afateve të përcaktuara në Ligjin nr. 154, datë 27.11.2014 “Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit”.

Drejtorinë Rajonale Tatimore Vlorë me shkresën me nr. 4672/5 prot., datë 24.10.2024 ka nxjerrë urdhrin për shqyrtimin/analizimin e Raportit Përfundimtar të Auditimit të Kontrollit të Lartë të Shtetit, brenda **afatit 20 ditë** në përputhje me kërkesat e përcaktuara në nenin 15 shkronja (j) të Ligjit nr.154, datë 27.01.2014 “Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit”.

Në Drejtorinë Rajonale Tatime Vlorë me shkresën nr. 512 prot., datë 20.03.2025 me lëndë “Informacion mbi ecurinë e zbatimit të rekomandimeve të lëna Drejtoria Rajonale Tatimore Vlorë ka dërguar pranë KLSH, **brenda afatit 6 muajor**, dhe në përputhje me kërkesat e përcaktuara në nenin 30, pika 2 e Ligjit nr.154 datë 27.1.2014 “Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit”.

B. Zbatimi i rekomandimeve për masat organizative. Ecuria e zbatimit dhe analizimi i rekomandimeve: rekomandime të pranuar dhe nga këto, sa janë zbatuar plotësisht; zbatuar pjesërisht, në proces zbatimi dhe rekomandimet e pa zbatuara.

Në mënyrë më të detajuar, auditimi i verifikimit të zbatimit të rekomandimeve për secilin rekomandim të përcjellë në Drejtorinë Rajonale Tatimore Vlorë paraqitet:

1.1-Rekomandimi: Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve të marrë masa për dërgimin të planit vjetor drejt Drejtorive Rajonale Tatimore dhe brenda afateve në mënyrë që të ndërmerren veprimet operacionale në kohë për mbledhjen e të ardhurave. Drejtoria e Analizës dhe Kontabilitetit, në Drejtorinë Rajonale Tatimore Vlorë, të kryejë analiza mbi faktorët që ndikojnë në realizimin ose mosrealizimin të të ardhurave tatimore sipas zërave dhe t’i përcjell këto të dhëna në mënyrë të dokumentuar në Drejtorinë e Përgjithshme të Tatimeve, me qëllim hartimin e programeve sa më të drejtë dhe reale, si dhe të kryhen analiza periodike mbi progresin e realizimit të të ardhurave, me qëllim që të evidentohen përgjegjësitë e zbatimit të detyrave të strukturave përkatëse.

Komenti i subjektit të audituar: Në bazë të rekomandimit Nr.1.1 në Raportin e Auditimit nga Kontrolli i Lartë i Shtetit, Drejtoria Rajonale e Tatimeve nëpërmjet shkresës me nr. 6936/1 prot., datë 17.03.2025, është drejtuar Drejtorisë së Përgjithshme të Tatimeve për zbatimin e rekomandimit të lënë. Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve në bazë të shkresës së Drejtorisë Rajonale të Tatimeve Vlorë është përgjigjur me shkresën nr. 4971/3 prot., datë 14.04.2025.

Qëndrimi i audituesve shtetërorë: Grupi i auditimit, pasi shqyrtoi dokumentat që ju vendosën në dispozicion nga institucioni, **e konsideron rekomandimin të pranuar dhe të zbatuar.**

2.1 Rekomandimi: Drejtoria Rajonale Tatimore Vlorë të marrë masa që për çdo kontroll tatimor në vend, të zbatohen me përpikmëri dhe në mënyrë të detajuar të gjitha pikat e Programit të kontrollit tatimor të miratuar, duke dhënë një situatë të qartë financiare të veprimtarisë së tatimpaguesve.

Komenti i subjektit të audituar: Drejtoria Rajonale Tatimore Vlorë ka marrë masa që për çdo kontroll tatimor të zbatohen me përpikmëri dhe në mënyrë të detajuar të gjitha pikat e Programit

të Kontrollit Tatimor të miratuar, duke dhënë një situatë të qartë financiare të veprimtarisë së tatimpaguesve, materializuar kjo me shkresën tonë nr. 9389 prot, datë 19.12.2024, për zbatim nga të gjithë inspektorët e kontrollit në vënd si dhe pasqyruar në programet e kontrollit ne vijimësi.

Qëndrimi i audituesve shtetërorë: Grupi i auditimit, pasi shqyrtoi dokumentat që ju vendosën në dispozicion nga institucioni, **e konsideron rekomandimin të pranuar dhe të zbatuar.**

2.2 Rekomandimi: Drejtoria Rajonale Tatimore Vlorë të marrë masa që të zbatohen procedurat dhe afatet e përcaktuara ligjore në lidhje me inventarizimin e dokumentacionit zyrtar (fizik) të praktikës së kontrollit tatimor tek tatimpaguesit; pasqyrimin në kohë të akteve të kontrollit (autorizime, program kontrolli, akt konstatime etj) në sistemin informatik tatimor; të vë në dispozicion të tatimpaguesit “Formularin-pyetësor i vetëdeklarimit para kontrollit” së bashku me njoftimin për kontroll.

Drejtoria Rajonale Tatimore Vlorë ka marrë masa që të zbatohen procedurat dhe afatet e përcaktuara ligjore në lidhje me inventarizimin e dokumentacionit zyrtar (fizik) të praktikës së kontrollit tatimor tek tatimpaguesit, pasqyrimin në kohë reale të akteve të kontrollit (autorizime, program kontrolli, akt konstatime etj) në sistemin informatik tatimor, të vendosi në dispozicion të tatimpaguesit “Formularin- pyetësor i vetëdeklarimit para kontrollit” së bashku me njoftimin për kontroll, materializuar kjo me shkresën tonë nr. 9389 prot, datë 19.12.2024, për zbatim nga të gjithë inspektorët e kontrollit në vënd si dhe pasqyruar në programet e kontrollit ne vijimësi.

Qëndrimi i audituesve shtetërorë: Grupi i auditimit, pasi shqyrtoi dokumentat që ju vendosën në dispozicion nga institucioni, **e konsideron rekomandimin të pranuar dhe të zbatuar.**

3.1 Rekomandimi: Drejtoria Rajonale Tatimore Vlorë në bashkëpunim me DPT të marrë masa në vijimësi për respektimin e kriterëve për përzgjedhjen e tatimpaguesve që do të kontrollohen me qëllim rritjen e aftësisë zbuluese të kontrolleve tatimore.

Komenti i subjektit të audituar:

Drejtoria Rajonale Tatimore Vlorë në bashkëpunim me DPT ka marrë masa në vijimësi për respektimin e kriterëve për përzgjedhjen e tatimpaguesve që do të kontrollohen me qëllim rritjen e aftësisë zbuluese të kontrolleve tatimore, materializuar kjo me shkresën tonë nr. 9388 prot, datë 19.12.2024.

Qëndrimi i audituesve shtetërorë: Grupi i auditimit, pasi shqyrtoi dokumentat që ju vendosën në dispozicion nga institucioni, **e konsideron rekomandimin të pranuar dhe të zbatuar.**

4.1 Rekomandimi: Drejtoria Rajonale Tatimore Vlorë në bashkëpunim me Drejtorinë e Përgjithshme të Tatimeve, të hartojnë një metodologji të qartë dhe të saktë nënligjore, ose një manual udhëzues për analizimin e llogarisë së ortakut, kur konstatohen se jepen hua ose shuma nga llogaria e ortakut në favor të llogarisë së shoqërisë, ku ata janë ortakë ose anasjelltas, apo nga individë të tjerë, për mënyrën e kryerjes së pagesës nëpërmjet sistemit bankar apo cash si dhe për raste kur këto hua jepen pa interes, nisur edhe nga përcaktimet ligjore që parashikon Kodi Civil.

Komenti i subjektit të audituar: Drejtoria Rajonale Tatimore Vlorë në bashkëpunim me Drejtorinë e Përgjithshme të Tatimeve, do të hartojë një metodologji të qartë dhe të saktë nënligjore, ose një manual udhëzues për analizimin e llogarisë së shoqërisë, kur konstatohen se jepen hua ose shuma nga llogaria e ortakut në favor të shoqërisë, ku ata janë ortak dhe anasjelltas, apo nga individë të tjerë, për mënyrën e kryerjes së pagesës nëpërmjet sistemit bankar apo cash, si dhe për raste kur këto hua jepen pa interes, nisur nga përcaktimet ligjore që parashikon Kodi Civil , materializuar kjo me shkresën tonë **nr. 9387 prot., datë 19.12.2024.**

Qëndrimi i audituesve shtetërorë: Grupi i auditimit, pasi shqyrtoi dokumentat që ju vendosën në dispozicion nga institucioni, e konsideron rekomandimin të *pranuar* dhe *i zbatuar pjesërisht*.

4.2 Rekomandimi: Drejtoria Rajonale Tatimore Vlorë pasi të ketë analizuar situatën e kontrollit të kryer në subjektet “E” SHPK, “K”, “K” SHPK, “T” SHPK, referuar gjetjeve nga auditimi i KLSH-së, të marrë masat e nevojshme që në bashkëpunim me Administratën Tatimore, të identifikojë burimin e detyrimeve që kanë shoqëritë dhe transaksionet e kryera midis palëve, duke bërë informacioni RAD (Raportim i Aktivitetit të Dyshimtë) në lidhje me shumat e parave të cilat kanë kaluar si hua ortakut ndaj shoqërisë.

Komenti i subjektit të audituar: Drejtoria Rajonale Tatimore Vlorë pasi të ketë analizuar situatën e kontrollit të kryer në subjektet “E” SHPK, “K”, “K” SHPK, “T” SHPK, referuar gjetjeve nga auditimi i KLSH-së, të marrë masat e nevojshme që në bashkëpunim me Administratën Tatimore, të identifikojë burimin e detyrimeve që kanë shoqëritë dhe transaksionet e kryera midis palëve, duke bërë informacioni RAD (Raportim i Aktivitetit të Dyshimtë) në lidhje me shumat e parave të cilat kanë kaluar si hua ortakut ndaj shoqërisë.

Qëndrimi i audituesve shtetërorë: Grupi i auditimit, pasi shqyrtoi dokumentat që ju vendosën në dispozicion nga institucioni, e konsideron rekomandimin të *pranuar* dhe *të zbatuar*.

5.1-Rekomandimi: Drejtoria Rajonale Tatimore Vlorë në bashkëpunim me DPT, në vijim të problematikave të konstatuara nga kontrolli në vend, të ndjekë ecurinë e praktikës, dërguar për procedim të mëtejshme në DPT, me qëllim verifikimin dhe analizimin e deklarimeve të subjektit ndërtues “G” SHPK me NIPT J.

Komenti i subjektit të audituar: Drejtoria Rajonale Tatimore Vlorë me shkresën me nr. 7006 prot., datë 15.10.2024, i është drejtuar Drejtorisë së Tatimpaguesve të Mëdhenj Tiranë me kërkesën për informacion bazuar në Raportin Përfundimtar dhe rekomandimet e auditimit të KLSH, në DRT Vlorë, për procedurën e ndjekur me qëllim verifikimin dhe analizimin e deklarimeve të subjektit ndërtues “G” SHPK me NIPT J.

Drejtoria Rajonale Tatimore Vlorë me shkresën me nr. 7007 prot., datë 15.10.2024, i është drejtuar Drejtorisë së Përgjithshme të Tatimeve Tiranë, Drejtorisë së Hetimit Tatimorë me kërkesën për informacion bazuar në Raportin Përfundimtar dhe rekomandimet e auditimit të KLSH, në DRT Vlorë, për procedurën e ndjekur me qëllim verifikimin dhe analizimin e deklarimeve të subjektit ndërtues “G” SHPK me NIPT J..

Drejtoria e Tatimpaguesve të Mëdhenj ka kthyer përgjigje me shkresë nr. 8269/1 prot., datë 24.10.2024 mbi verifikimin e deklarimeve të subjektit “G” SHPK me NIPT J.

Qëndrimi i audituesve shtetërorë: Grupi i auditimit, pasi shqyrtoi dokumentat që ju vendosën në dispozicion nga institucioni, e konsideron rekomandimin të *pranuar* dhe *të zbatuar*.

6.1-Rekomandimi: Drejtoria Rajonale Tatimore Vlorë në bashkëpunim me Inspektoratin Shtetëror të Punës të marrë masat në vijimësi për monitorimin e subjekteve, të cilat referuar natyrës së aktivitetit që ushtrojnë si farmaci, karburant, hoteleri etj., si dhe orareve të ushtrimit të aktivitetit gjatë një dite pune si dhe gjatë ditëve të pushimit e shtunë dhe e dielë, mbartin risk për deklarimin e pagave reale me qëllim llogaritjen dhe pagesën detyrimeve për kontributet e sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore, sipas përcaktimeve të Ligjit Nr. 7703, datë 11.05.1993 “Për sigurimet shoqërore në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar.

Komenti i subjektit të audituar: Drejtoria Rajonale Tatimore Vlorë referuar rekomandimit të lënë, ka dërguar kërkesën për bashkëpunim Inspektoriatin Shtetëror të Punës me shkresën nr. 8469 prot., datë 18.11.2024.

Qëndrimi i audituesve shtetërorë: Grupi i auditimit, pasi shqyrtoi dokumentat që ju vendosën në dispozicion nga institucioni, e konsideron rekomandimin të *pranuar* dhe *në proces zbatimi*.

7.1-Rekomandimi: Drejtoria Rajonale Tatimore Vlorë për tatimpaguesin S. me NIPT K., referuar mangësive dhe parregullsive në procedurën e kontrollit tatimor, në përputhje me kërkesat ligjore dhe procedurale, të bëjë propozimet përkatëse në DPT për rikontroll tatimor, sipas përcaktimeve të nenit 85 “*Ri kontrolli tatimor*” të ligjit nr. 9920, datë 19.05.2008 “*Për Procedurat Tatimore në Republikën e Shqipërisë*”, i ndryshuar.

Komenti i subjektit të audituar:Drejtoria Rajonale Tatimore Vlorë për tatimpaguesin “S” me NIPT K., referuar mangësive dhe parregullsive në procedurën e kontrollit tatimor, në përputhje me kërkesat ligjore dhe procedurale, ka paraqitur propozimet përkatëse në DPT për rikontroll tatimor, me kërkesë për Miratim Rikontrolli nr. 7094 prot., datë 17.10.2024, sipas përcaktimeve të nenit 85 “*Ri Kontrolli Tatimor*”, të Ligjit nr. 9920, datë 19.05.2008 “*Për Procedurat Tatimore në Republikën e Shqipërisë*”, i ndryshuar. Kërkesa është miratuar me Vendim nr. 81, datë 16.12.2024, nga Drejtori i Përgjithshëm. Me shkresën me nr. 3722 prot., datë 04,05,2025 me lëndë: Transferim dosje subjekti, "S" me nipt K., planifikuar për muajin Prill 2025 është transferuar në DRT Fier.

Qëndrimi i audituesve shtetërorë: Grupi i auditimit, pasi shqyrtoi dokumentat që ju vendosën në dispozicion nga institucioni, rezulton se nga ana e Drejtorisë Rajonale Tatimore Vlorë është bërë propozimi për rikontroll me shkresën nr. 7094 prot., datë 17.10.2024, kërkesë e cila është miratuar me Vendim nr. 81, datë 16.12.2024, nga Drejtori i Përgjithshëm. e konsideron rekomandimin të *pranuar* dhe *të zbatuar*.

8.1 Rekomandimi: Drejtoria Rajonale Tatimore Vlorë/Sektorit të Kontrollit nga Zyra dhe Monitorimit, të administrojë në rrugë zyrtare informacion dhe dokumentacion justifikues në lidhje me mangësitë dhe parregullsitë e konstatuara në procedurën e kontrollit tatimor, konform përcaktimeve ligjore në fuqi.

Komenti i subjektit të audituar: Drejtoria Rajonale Tatimore Vlorë/Sektorit të Kontrollit nga Zyra dhe Monitorimit, referuar raportit përfundimtar të Kontrollit të Lartë të Shtetit, ka dërguar shkresën me nr. 9439 prot., datë 23.12.2024 për kompetencë Drejtorisë së Tatimpaguesve të Mëdhenj Tiranë, pasi tatimpaguesi është transferuar në këtë drejtori.

Qëndrimi i audituesve shtetërorë: Grupi i auditimit, pasi shqyrtoi dokumentat që ju vendosën në dispozicion nga institucioni, e konsideron rekomandimin të *pranuar* dhe *në proces zbatimi*.

9.1-Rekomandimi: Drejtoria Rajonale Tatimore Vlorë për tatimpaguesin M. me NIPT K., referuar mangësive dhe parregullsive në procedurën e kontrollit tatimor, në përputhje me kërkesat ligjore dhe procedurale, të bëjë propozimet përkatëse në DPT për rikontroll tatimor, sipas përcaktimeve të nenit 85 “*Ri kontrolli tatimor*” të ligjit nr. 9920, datë 19.05.2008 “*Për Procedurat Tatimore në Republikën e Shqipërisë*”, i ndryshuar.

Komenti i subjektit të audituar: Drejtoria Rajonale Tatimore Vlorë për tatimpaguesin M. me NIPT K., referuar mangësive dhe parregullsive në procedurën e kontrollit tatimor, në përputhje me kërkesat ligjore dhe procedurale, ka paraqitur propozimet përkatëse në DPT për rikontroll tatimor, me kërkesë për Miratim Rikontrolli nr. 7095 prot, datë 17.10.2024 sipas përcaktimeve të nenit 85 “*Ri Kontrolli Tatimor*”, të Ligjit nr. 9920, datë 19.05.2008 “*2008 “Për Procedurat Tatimore në Republikën e Shqipërisë*”, i ndryshuar, miratuar me Vendim nr 80 datë 16.12.2024, të Drejtorit të Përgjithshëm. Dosja e subjektit është tranferuar në DRT Fier me shkresën me nr. 308/1 prot., datë 30.05.2025.

Qëndrimi i audituesve shtetërorë: Grupi i auditimit, pasi shqyrtoi dokumentat që ju vendosën në dispozicion nga institucioni, rezultoi se nga ana e Drejtorisë Rajonale Tatimore Vlorë është bërë propozimi për rikontroll me shkresën nr. 7095 prot., datë 17.10.2024, kërkesë e cila është miratuar me Vendim nr. 80, datë 16.12.2024, nga Drejtori i Përgjithshëm., e konsideron rekomandimin të ***pranuar dhe të zbatuar.***

10. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i DRT Vlorë, u konstatua se Sektori i Kontrollit dhe Monitorimit nga Zyra, nuk ka përmbushur detyrimin për monitorimin e bizneseve me rritje të tepricës kreditore nga viti 2021 në vitin 2023, në kundërshtim me përcaktimet e “*Rregulloren e funksionimit të administratës rajonale tatimore*” miratuar me Urdhër nr. 192, datë 12.08.2020, Manualin për Kontrollin Tatimor.

Gjatë periudhës 2021-2023, pavarësisht se konstatohet një rritje si pasojë e rritjes në aktivitetin e hotelierisë dhe rritjen e tepricës kreditore si pasojë e rolit të investitorit të aseteve për të cilat kreditohet TVSH, nga ana tjetër konstatohet rritje të tepricës edhe në sektorë të tjerë që përfshijnë tregti apo prodhim. Për sa më sipër, konstatohet se për periudhën e auditimit, kemi subjekte me tepricë kreditore kryesisht në rritje me aktivitet tregti dhe prodhim të cilat risin riskun e evazionit nëpërmjet mosdeklarimit të shitjeve. Këto subjekte mbajnë peshën më të madhe dhe teprica kreditore e tyre është rritur ndjeshëm nga 01.01.2021 deri në me 31.12.2023. Fakti që teprica kreditore nuk ndryshon apo ka pësuar rritje, nga ana e Inspektorit përkatës për këtë periudhë nuk është kërkuar informacion, analizuar apo propozuar për kontroll, kjo tregon veprime dhe mos veprime që ndikojnë në uljen e performancës në lidhje me deklaratimet tatimore të tatimpaguesit. Për këta subjekte nuk është kryer verifikimi në vend nëpërmjet kombinimit me sektorin e zbatimit/DVT nëse kanë gjendje malli apo aktive në vendndodhjet e deklaruara të biznesit.

10.1 Rekomandimi: DRT Vlorë, nëpërmjet Sektorit të Kontrollit nga Zyra, të marrë masa menjëherë për monitorimin e tatimpaguesve me rritje të vazhdueshme të tepricës kreditore, kryesisht në rritje me aktivitet tregti dhe prodhim të cilat risin riskun e evazionit nëpërmjet mosdeklarimit të shitjeve, duke kërkuar informacion, analizuar apo propozuar për kontroll, verifikimi në vend nëpërmjet kombinimit me sektorin e zbatimit/DVT nëse kanë gjendje malli apo aktive në vendndodhjet e deklaruara të biznesit.

Komenti i subjektit të audituar: Përsa më sipër, me shkresën me nr. 4672/7 prot., datë 07.11.2024, janë kryer verifikime për verifikim të tepricës kreditore, janë kontaktuar subjekte nëpërmjet telefonit, emailit, janë nisur shkresa dhe janë kryer propozime për vizitë fiskale dhe kontroll në vend, akte për sqarimin e gjendjes kreditore të subjekteve. Monitorimi i tepricave kreditore është një vazhdimësi pune që kryhet nga sektori i kontrollit nga zyra. Gjithashtu në bashkëpunim me sektorin e kontabilitetit janë dërguar njoftime subjekteve për sqarim të tepricave kreditore, të cilët kanë kthyer përgjigje me shkresë ose me çështje në sistemin C@TS.

Qëndrimi i audituesve shtetërorë: Grupi i auditimit, pasi shqyrtoi dokumentat që ju vendosën në dispozicion nga institucioni, e konsideron rekomandimin të ***pranuar dhe të zbatuar.***

11.1 Rekomandimi: Titullari i Drejtorisë së Përgjithshme të Tatimeve në bashkëpunim me Drejtorinë e Burimeve Njerëzore të marrin masa për ndërprerjen e komandimeve të përkohshme për pozicionet vakante, si dhe plotësimin e tyre me vendime emërimi sipas profilit përkatës.

Komenti i subjektit të audituar: Nga subjekti nuk na u vu në dispozicion dokumentacioni për rastet e komandimit dhe plotësimit të vendeve vakante.

Qëndrimi i audituesve shtetërorë: Grupi i auditimit, pasi shqyrtoi dokumentat që ju vendosën në dispozicion nga institucioni, e konsideron rekomandimin të ***pranuar dhe të pazbatuar.***

12.1 Rekomandimi: Drejtori i DRT Vlorë të marrë masa të menjëhershme për monitorimin e punës në Drejtorinë e Shërbimit ndaj Tatimpaguesve si dhe respektimin e procedurave për administrimin e dokumentacionit dhe evidentimin e të dhënave statistikore të gjeneruara nga kjo drejtori sipas përcaktimeve të Manualit të Drejtorisë e Shërbimit ndaj Tatimpaguesve.

Komenti i subjektit të audituar: Drejtoria e Shërbimit të Tatimpaguesit, Sektori i Asistencës dhe Shërbimit të Tatimpaguesit në Drejtorinë Rajonale Tatimore Vlorë janë marrë masa për:

- Respektimin e afateve dhe procedurave, për ofrimin e shërbimeve ndaj tatimpaguesve bazuar në Urdhrin nr. 81, datë 22.12.2017 “Për miratimin e Manualit të Shërbimeve për tatimpaguesit dhe individët”, nga Specialistët e Asistencës dhe Shërbimeve të Tatimpaguesve me shkresën nr. 6894/1 prot., datë 18.10.2024.

- Raportimin e informacionit cdo fund muaji, për detyrat e ngarkuara në formë të shkruar dhe elektronike, nga Specialistët e Asistencës dhe Shërbimeve të Tatimpaguesve tek Përgjegjësi i Asistencës dhe Shërbimit të Tatimpaguesve sipas formatit të kërkuar nga ai me shkresën nr. 6894/1, datë 18.10.2024.

- Ndarjen e detyrave të nëpunësve në Sektorin e Asistencës dhe Shërbimeve të Tatimpaguesve me Urdhrin nr. 735 , datë 17.01.2024, nr. 22, datë 06.09.2024 dhe nr. 22/1, datë 18.10.2024.

- Zhvillimin analizave mujore dhe vjetore dhe është bërë raportim i analizës 6- mujore për Sektorin e Asistencës dhe Shërbimit të Tatimpaguesve nga Përgjegjësi i Asistencës dhe Shërbimeve të Tatimpaguesve tek Drejtori Rajonal, në formë të shkruar mbi performancën e sektorit. Si dhe janë marrë masa dhe janë bërë raportime për funksionimin e Asistencës dhe Shërbimit të cilat janë përcjellë përiodikisht në rrugë elektronike në Sektorin e Asistencës dhe Shërbimit në DPT.

Qëndrimi i audituesve shtetërorë: Grupi i auditimit, pasi shqyrtoi dokumentat që ju vendosën në dispozicion nga institucioni, e konsideron rekomandimin të *pranuar* dhe të *zbatuar*.

13.1 Rekomandimi: Drejtoria Rajonale Tatimore Vlorë, referuar mangësive dhe parregullsive në procedurën e kontrollit tatimor, në përputhje me kërkesat ligjore dhe proceduriale, të bëjë propozimet përkatëse në DPT për rikontroll tatimor, sipas përcaktimeve të nenit 85 “*Ri kontrolli tatimor*” të Ligjit nr. 9920, datë 19.05.2008 “*Për Procedurat Tatimore në Republikën e Shqipërisë*”, i ndryshuar dhe në të njëjtën kohë të kërkojë interpretimin në DPT mbi ligjshmërinë e aplikimit të shkallës së reduktuar të TVSH-së për këtë tatimpagues dhe raste të tjera nga kontrolli nga zyra, për periudhën para vitit 2020, me qëllim unifikimin e qëndrimit.

Komenti i subjektit të audituar: Drejtoria Rajonale Tatimore Vlorë, referuar mangësive dhe parregullsive në procedurën e kontrollit tatimor, në përputhje me kërkesat ligjore dhe proceduriale, ka paraqitur propozimet përkatëse në DPT për rikontroll tatimor, me kërkesë për Miratim Rikontrolli nr. 7097 prot, datë 17.10.2024, sipas përcaktimeve të nenit 85 “*Ri Kontrolli Tatimor*”, të Ligjit nr. 9920, datë 19.05.2008 “*Për Procedurat Tatimore në Republikën e Shqipërisë*”, i ndryshuar, për tatimpaguesin “**D**” me NIPT K., kërkesa është miratuar me Vendim nr. 78, datë 16.12.2024, të Drejtorit të Përgjithshëm

Përfunduar .Raport Kontrolli Përfundimtar: Nr 4448/5 prot, datë 10.07.2025.Njoftim vleresimi nr.4448/6 prot, datë 12.08.2025.Gjetje 15.000 leke.

Qëndrimi i audituesve shtetërorë: Grupi i auditimit, pasi shqyrtoi dokumentat që ju vendosën në dispozicion nga institucioni, rezulton se procedura e rikontrollit është ndjekur formalistikisht nga ana e Drejtorisë Rajonale Tatimore Vlorë, pasi nga ana DRT Vlorë nuk është kërkuar interpretim ligjor në DPT mbi ligjshmërinë e aplikimit të shkallës së reduktuar të TVSH-së për këtë

tatimpagues dhe raste të tjera nga kontrolli nga zyra, për periudhën para vitit 2020, me qëllim unifikimin e qëndrimit dhe saktësimin e shitjeve të kryera nga subjekti. Për rrjedhojë, rekomandimi i dhënë nga KLSH konsiderohet i zbatuar vetëm për në aspektin procedural, por jo i realizuar në aspektin financiar dhe thelbin e rekomandimit të dhënë, e konsideron rekomandimin të **pranuar** dhe **të pa zbatuar**.

14.1 Rekomandimi: Nga Drejtoria Rajonale Vlorë dhe Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve të merren masa për trajtimin e unifikuar të kreditimit të TVSH-së për blerjet e karburantit nga tatimpaguesit që ushtrojnë veprimtarinë në fushën e transportit të vlerave monetare duke nxjerrë qëndrim të unifikuar administrativ.

Komenti i subjektit të audituar: Nga Drejtoria Rajonale Tatimore Vlorë, me shkresën nr. 993/3 prot., datë 25.02.2025, i është kërkuar interpretim Drejtorisë së Përgjithshme të Tatimeve, për trajtimin e unifikuar të kreditimit të TVSH-së për blerjet e karburantit nga tatimpagues që ushtrojnë veprimtarinë e tyre në fushën e transportit të vlerave monetare duke nxjerrë qëndrim të unifikuar administrativ.

Qëndrimi i audituesve shtetërorë: Grupi i auditimit, pasi shqyrtoi dokumentat që ju vendosën në dispozicion nga institucioni, e konsideron rekomandimin të **pranuar** dhe **të zbatuar**,

15.1 Rekomandimi: DRT Vlorë për tatimpaguesin “T” me NIPT M., referuar parregullsive në procedurën e kontrollit, në përputhje me kërkesat ligjore dhe procedurale, të bëjë propozimet përkatëse në DPT për rikontroll tatimor, sipas përcaktimeve të nenit 85 “Ri kontrolli tatimor” të ligjit nr. 9920, datë 19.05.2008 “Për Procedurat Tatimore në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, si dhe interpretimin e rastit të konstatuar me parregullsi në vlefshmërinë e aktit të miratimit të punimeve për qëllime të kreditimit të tvsh-së në ndërtim.

Komenti i subjektit të audituar:

DRT Vlorë për tatimpaguesin “T” SHPK me Nipt M., referuar parregullsive në procedurën e kontrollit tatimor, në përputhje me kërkesat ligjore dhe procedurale, ka paraqitur propozimet përkatëse në DPT për rikontroll tatimor, me kërkesë për Miratim Rikontrolli nr. 7098 prot, datë 17.10.2024, sipas përcaktimeve të nenit 85 “ Ri Kontrolli Tatimor”, të Ligjit nr. 9920, datë 19.05.2008 “2008 “Për Procedurat Tatimore në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, kërkesa është miratuar me Vendim nr.77, datë 16.12.2024, të Drejtorit të Përgjithshëm.

Përfunduar Raport Kontrolli Përfundimtar: Nr 3730/5 prot, datë 15.07.2025.Njoftim vleresimi nr.3730/6 prot, datë 15.07.2025.Gjetje 0

Qëndrimi i audituesve shtetërorë: Grupi i auditimit, pasi shqyrtoi dokumentat që ju vendosën në dispozicion nga institucioni, rezultoi se nga ana e Drejtorisë Rajonale Tatimore Vlorë është bërë propozimi për rikontroll dhe kërkesa për interpretim ligjor në DPT, sipas rekomandimit të dhënë, me shkresën nr. 7094 prot., datë 17.10.2024, kërkesë e cila është miratuar me Vendim nr. 81, datë 16.12.2024, nga Drejtori i Përgjithshëm. e konsideron rekomandimin të **pranuar** dhe **të zbatuar**,

C. Zbatimi i rekomandimeve për masa për eliminimin e efekteve negative, Ecuria e zbatimit dhe analizimi i rekomandimeve: rekomandime të pranuar dhe nga këto, sa janë zbatuar plotësisht; zbatuar pjesërisht, në proces zbatimi dhe rekomandimet e pa zbatuara.

1.1 Rekomandimi: Drejtoria Rajonale Tatimore Vlorë, Sektori i Kontrollit nga Zyra të kryejë verifikimet përkatëse për vlerësimin dhe rivlerësimin në përmbushje të detyrimit për saktësimin e qarkullimit vjetor sipas kasës dhe të ardhurave të deklaruara në deklaratat përkatëse nga tatim

paguesit, me qëllim arkëtimin e të ardhurave tatimore të evidentuara paraprakisht si të munguara në buxhetin e shtetit.

Komenti i subjektit të audituar: Sipas listës së tatimpaguesve të evidentuar në akt konstatimet e mbajtura nga Kontrolli i Lartë i Shtetit, u bën saktësimet e diferencave me vleresimet përkatëse. Për subjektet me diferenca janë mbajtur akt vlerësimit dhe është kryer vlerësim tatimor nga zyra për rastet me diferenca të pashpjeguara, për C. me shkresën me nr. 4672/8 prot, datë 18.11.2024 dhe J. me shkresën nr. 9434 prot., datë 20.12.2024.

Qëndrimi i audituesve shtetërorë: Grupi i auditimit, pasi shqyrtoi dokumentat që ju vendosën në dispozicion nga institucioni, rezulton se nga ana e Drejtorisë Rajonale Tatimore Vlorë është kryer vlerësimi tatimor vetëm për dy subjekte tatimore konkretisht subjekti C. me NUIS M. dhe subjektin I. me NUIS M., ndërsa për subjektet e tjera të trajtuara në Raportin e Auditimit nuk ka një vlerësim apo rivlerësim të deklaratave tatimore e konsideron rekomandimin të ***pranuar dhe të zbatuar pjesërisht.***

2.1 Rekomandimi: Drejtoria Rajonale Tatimore Vlorë, Sektori i Kontrollit nga Zyra, të marrë menjëherë masat e duhura administrative konform legjislacionit tatimor, të vendos penalitetet përkatëse, me qëllim arkëtimin e të ardhurave tatimore të munguara në buxhetin e shtetit të evidentuara paraprakisht në vlerën prej **611,477 lekë** gjobë për mospagimin në afat të kësteve të tatimit mbi fitimin.

Komenti i subjektit të audituar: Nga ana e Drejtorisë Rajonale Tatimore Vlorë, janë mbajtur akt verifikimet për vendosjen e penaliteteve për 6 subjektete përmenduar në raportin e KLSH me shkresat nr. 8470 prot., datë 19.11.2024 për subjektet A., E., N., U., me shkresën nr. 8467, datë 19.11.2024 për subjektin R., me shkresën me nr. 8468, datë 19.11.2024 për subjektin E.

Qëndrimi i audituesve shtetërorë: Grupi i auditimit, pasi shqyrtoi dokumentat që ju vendosën në dispozicion nga institucioni, e konsideron rekomandimin të ***pranuar dhe të zbatuar pjesërisht.***

3.1 Rekomandimi: Drejtoria Rajonale Tatimore Vlorë për tatimpaguesin “E.” SHPK, me NIPT K., referuar mangësive dhe parregullsive në procedurën e kontrollit tatimor, në përputhje me kërkesat ligjore dhe proceduriale, të bëjë propozimet përkatëse në DPT për rikontroll tatimor, sipas përcaktimeve të nenit 85 “Ri kontrolli tatimor” të Ligjit nr. 9920, datë 19.05.2008 “Për Procedurat Tatimore në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, me qëllim arkëtimin e detyrimit të munguar në buxhetin e shtetit të evidentuar paraprakisht në vlerën **3,343,515 lekë.**

Komenti i subjektit të audituar: Drejtoria Rajonale Tatimore Vlorë për tatimpaguesin “E” SHPK, me NIPT K., referuar mangësive dhe parregullsive në procedurën e kontrollit tatimor, në përputhje me kërkesat ligjore dhe proceduriale, ka paraqitur propozimet përkatëse në DPT për rikontroll tatimor, me kërkesë për Miratim Rikontrolli nr. 7099 prot, datë 17.10.2024 sipas përcaktimeve të nenit 85 “ Ri Kontrolli Tatimor”, të Ligjit nr. 9920, datë 19.05.2008, “Për Procedurat Tatimore në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, me qëllim arkëtimin e detyrimit të munguar në buxhetin e shtetit të evidentuara paraprakisht në vlerën **3,343,515 lekë**, kërkesë e cila është miratuar me Vendim nr 76 datë 16.12.2024, të Drejtorit të Përgjithshëm.

Përfunduar .Raport Kontrolli Përfundimtar: Nr 3737/6 prot., datë 06.08.2025. Njoftim vlerësimi nr.3737/8 prot, datë 07.08.2025. në vlerë 99.706 leke.

Qëndrimi i audituesve shtetërorë: Grupi i auditimit, pasi shqyrtoi dokumentat që ju vendosën në dispozicion nga institucioni, rezulton se nga analiza krahasuese e rezultateve të rikontrolleve tatimore të zhvilluara në vijim të rekomandimeve të KLSH-së, rezulton se ndonëse procedura e rikontrolleve është ndjekur formalistikisht, nuk është arritur rikupërimi të ardhurave tatimore të

identifikuara si të munguara. Për rrjedhojë, rekomandimi i dhënë nga KLSH konsiderohet i zbatuar në aspektin procedural, **dhe pjesërisht** i realizuar në aspektin financiar.

4.1-Rekomandim: Drejtoria Rajonale Tatimore Vlorë për tatimpaguesin “H.” SHPK, NIPT : L., referuar mangësive dhe parregullsive në procedurën e kontrollit tatimor, në përputhje me kërkesat ligjore dhe proceduriale, të bëjë propozimet përkatëse në DPT për rikontroll tatimor, sipas përcaktimeve të nenit 85 “Ri kontrolli tatimor” të ligjit nr. 9920, datë 19.05.2008 “Për Procedurat Tatimore në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, me qëllim arkëtimin e detyrimit të munguar në buxhetin e shtetit të evidentuar paraprakisht në vlerën prej **60,306,689 lekë**.

Komenti i subjektit të audituar: Drejtoria Rajonale Tatimore Vlorë për tatimpaguesin “H G” SHPK, NIPT: L., referuar mangësive dhe parregullsive në procedurën e kontrollit tatimor, në përputhje me kërkesat ligjore dhe proceduriale, ka paraqitur propozimet përkatëse në DPT për rikontroll tatimor,

1. Kërkesë për Miratim Rikontrolli nr. 7100 prot., datë 17.10.2024, sipas përcaktimeve të nenit 85 “ Ri Kontrolli Tatimor”, të Ligjit nr. 9920, datë 19.05.2008 “2008 “Për Proçedurat Tatimore në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, me qëllim arkëtimin e detyrimit të munguar në buxhetin e shtetit të evidentuara paraprakisht në vlerën **lekë**, kërkesë e cila është miratuar me Vendim nr 75 datë 16.12.2024 të Drejtorit të Përgjithshëm.

Përfunduar .Raport Kontrolli Përfundimtar.Nr 3769/4 prot, datë 19.08.2025. Njoftim vleresimi nr.3769/5 prot, datë 26.08.2025.Gjetje 0.

2.Kërkesë për Miratim Rikontrolli nr. 7101 prot, datë 17.10.2024, , kërkesë e cila është miratuar me Vendim nr 74 datë 16.12.2024 të Drejtorit të Përgjithshëm.

Në proces. Me shkresë nr. 4450 prot, datë 30.06.2025 është dërguar Njoftimi për kontroll Tatimor te taimpaguesi H. me Nipt L. dhe është kthyer nga posta me nenshkrimin “Refuzuar”,ne datë **02.7.2025**.

Tatimpaguesi ne kete periudhe ishte ne 2 procese për rikontroll ,1 për rimbursim

3.Kërkesë për Miratim Rikontrolli nr. 7102 prot, datë 17.10.2024, , kërkesë e cila është miratuar me Vendim nr 73 datë 16.12.2024 të Drejtorit të Përgjithshëm

Ne proces kontrolli me Njoftim kontrolli nr. 4449 prot., datë 30.06.2025. (Dokumentat bashlidhur)

Qëndrimi i audituesve shtetërorë: Grupi i auditimit, pasi shqyrtoi dokumentat që ju vendosën në dispozicion nga institucioni, rezulton se nga analiza krahasuese e rezultateve të rikontrolleve tatimore të zhvilluara në vijim të rekomandimeve të KLSH-së, rezulton se ndonëse procedura e rikontrolleve është ndjekur formalistikisht, nuk është arritur rikupërimi real i të ardhurave tatimore të identifikuara si të munguara. Për rrjedhojë, rekomandimi i dhënë nga KLSH konsiderohet i zbatuar vetëm në aspektin procedural, **por jo i realizuar në aspektin financiar, konsiderohet i zbatuar pjesërisht.**

5.1 Rekomandimi: Drejtoria Rajonale Tatimore Vlorë, referuar mangësive dhe parregullsive të konstatuara, në përputhje me kërkesat ligjore dhe proceduriale, të marrë masa të menjëhershme për vlerësimin e detyrimeve tatimore të munguara, duke kryer vlerësimet dhe rivlerësimet përkatëse, për arkëtimin e vlerës totale **23,267,129 lekë** të cilat përbëjnë të ardhura të munguara në buxhetin e shtetit, të përfituar padrejtësisht nga aplikimi i gabuar i shkallës së reduktuar të TVSH 6%, nga tatimpaguesit që ushtrojnë veprimtari në fushën e strukturave akomoduese,

konkretisht: “E” SHPK, me NIPT L. detyrime për **13,499,980 lekë**; “H.” SHPK, me NIPT K. detyrime për **8,899,342 lekë**, P. SHPK, me NIPT M., detyrime për **867,807 lekë**.

Komenti i subjektit të audituar:

Nuk u realizua referuar shkresës nr. 8941/3 prot, datë 15.01.2025.

Qëndrimi i audituesve shtetërorë: Grupi auditimit pasi shqyrtoi dokumentat që ju vendosën në dispozicion nga institucioni, rezulton se nga ana e Drejtorisë Rajonale Tatimore Vlorë për subjektin P. SHPK me NUIS M. është kryer vlerësim tatimor nga zyra me nr.4672/6 prot., datë 04.11.2024 në zbatim të rekomandimit të bërë, ky vlerësim pas ankimit të subjektit është shfuqizuar nga Drejtoria Apelimit Tatimor Tiranë me Vendimin nr. 2338/1 prot., datë 07.01.2025 më arsyetimin se kemi shkelje procedurale, ndërsa gjetja e konstatuar qëndron dhe duhet të kryhet vlerësimi pas ndjekjes së hapave procedural duke marrë miratimin për rikontroll nga Drejtori i Përgjithshëm i Tatimeve. Grupi i auditimit e konsideron rekomandimin të ***pranuar dhe të pazbatuar.***

6.1-Rekomandimi: Drejtoria Rajonale Tatimore Vlorë për tatimpaguesin “I.” SHPK., me NIPT M., referuar mangësive dhe parregullsive në procedurën e kontrollit tatimor, në përputhje me kërkesat ligjore dhe procedurale, të bëjë propozimet përkatëse në DPT për rikontroll tatimor, sipas përcaktimeve të nenit 85 “Ri kontrolli tatimor” të ligjit nr. 9920, datë 19.05.2008 “Për Procedurat Tatimore në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, me qëllim arkëtimin e detyrimit të munguar në buxhetin e shtetit të evidentuar paraprakisht në vlerën **14,449,940 lekë**.

Komenti i subjektit të audituar: Drejtoria Rajonale Tatimore Vlorë për tatimpaguesin “I” SHPK me NIPT M., referuar mangësive dhe parregullsive në procedurën e kontrollit tatimor, në përputhje me kërkesat ligjore dhe procedurale, ka paraqitur propozimet përkatëse në DPT për rikontroll tatimor, me kërkesë për Miratim Rikontrolli nr. 7103 prot., datë 17.10.2024, sipas përcaktimeve të nenit 85 “Ri Kontrolli Tatimor”, të Ligjit nr. 9920, datë 19.05.2008 “2008 “Për Procedurat Tatimore në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, me qëllim arkëtimin e detyrimit të munguar në buxhetin e shtetit të evidentuara paraprakisht në vlerën **14,449,940 lekë**, kërkesë e cila është miratuar me Vendim nr. 72, datë 16.12.2024, të Drejtorit të Përgjithshëm.

Përfunduar .Raport Kontportirolli Përfundimtar:Nr. 3740/5 prot., datë 09.07.2025.Njoftim vleresimi nr.3740/6 prot, datë 10.07.2025. Gjetje 0.

Qëndrimi i audituesve shtetërorë: Grupi i auditimit, pasi shqyrtoi dokumentat që ju vendosën në dispozicion nga institucioni, rezulton se nga analiza krahasuese e rezultateve të rikontrolleve tatimore të zhvilluara në vijim të rekomandimeve të KLSH-së, rezulton se ndonëse procedura e rikontrollit është ndjekur, nuk është arritur rikupërimi të ardhurave tatimore të identifikuara si të munguara për faktin se diferenca ka lidhje me faturën nr. 31, datë 30.06.2021, me situacionin e muajit Qershor 2021 për vlerën 37.143.785 me TVSH 7.428.757 lekë e cila nga tatimpaguesi është deklaruar në FDP-në e periudhës Korik 2021 trajtuar hollësisht në raportin e rikontrollit. Për rrjedhojë, rekomandimi i dhënë nga KLSH konsiderohet të ***pranuar dhe të zbabatur.***

7.1-Rekomandimi: Drejtoria Rajonale Tatimore Vlorë për tatimpaguesin “T” me NIPT K., referuar mangësive dhe parregullsive në procedurën e kontrollit tatimor, në përputhje me kërkesat ligjore dhe procedurale, të bëjë propozimet përkatëse në DPT për rikontroll tatimor, sipas përcaktimeve të nenit 85 “Ri kontrolli tatimor” të ligjit nr. 9920, datë 19.05.2008 “Për Procedurat Tatimore në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, me qëllim arkëtimin e detyrimit të munguar në buxhetin e shtetit të evidentuar paraprakisht në vlerën **1,764,642 lekë**.

Komenti i subjektit të audituar: Drejtoria Rajonale Tatimore Vlorë për tatimpaguesin “T” me NIPT K., referuar mangësive dhe parregullsive në procedurën e kontrollit tatimor, në përputhje me kërkesat ligjore dhe procedurale, ka paraqitur propozimet përkatëse në DPT për rikontroll tatimor, me kërkesë për Miratim Rikontrolli nr. 7104 prot, datë 17.10.2024, sipas përcaktimeve të nenit 85 “ Ri Kontrolli Tatimor”, të Ligjit nr. 9920, datë 19.05.2008 “2008 “Për Procedurat Tatimore në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, me qëllim arkëtimin e detyrimit të munguar në buxhetin e shtetit të evidentuara paraprakisht në vlerën **1,764,642 lekë**, kërkesë e cila është miratuar me Vendim nr 71 datë 16.12.2024, të Drejtorit të Përgjithshëm.

Përfunduar .Raport Kontrolli Përfundimtar .Nr 2517/5 prot, datë 24.06.2025.Njofitim vleresimi nr.2517/6 prot, datë 27.06.2025.Gjetje 0.

Qëndrimi i audituesve shtetërorë: Grupi i auditimit, pasi shqyrtoi dokumentat që ju vendosën në dispozicion nga institucioni, rezulton se nga analiza krahasuese e rezultateve të rikontrolleve tatimore të zhvilluara në vijim të rekomandimeve të KLSH-së, rezulton se procedura e rikontrollit është ndjekur, por nuk është arritur rikupërimi i të ardhurave tatimore të identifikuara si të munguara. Nga verifikimi materialit të rikontrollit rezulton se nga ana inspektorit pasqyrohen punimet e kryera, të cilat referohen tek neni 6 i VKM nr. 408, datë 13.05.2015, “Për miratimin e Rregullores së Zhvillimit të territorit“. Për rrjedhojë, rekomandimi i dhënë nga KLSH konsiderohet **i pranuar dhe zbatuar.**

8.1-Rekomandimi: Drejtoria Rajonale Tatimore Vlorë për tatimpaguesin “K” SHPK, NIPT K., referuar mangësive dhe parregullsive në procedurën e kontrollit tatimor, në përputhje me kërkesat ligjore dhe procedurale, të bëjë propozimet përkatëse në DPT për rikontroll tatimor, sipas përcaktimeve të nenit 85 “Ri kontrolli tatimor” të ligjit nr. 9920, datë 19.05.2008 “Për Procedurat Tatimore në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, me qëllim arkëtimin e detyrimit të munguar në buxhetin e shtetit të evidentuar paraprakisht në vlerën **3,635,616 lekë**.

Komenti i subjektit të audituar: Drejtoria Rajonale Tatimore Vlorë për tatimpaguesin “K” SHPK me NIPT K., referuar mangësive dhe parregullsive në procedurën e kontrollit tatimor, në përputhje me kërkesat ligjore dhe procedurale, ka paraqitur propozimet përkatëse në DPT për rikontroll tatimor, me kërkesë për Miratim Rikontrolli nr. 7105 prot., datë 17.10.2024, sipas përcaktimeve të nenit 85 “ Ri Kontrolli Tatimor”, të Ligjit nr. 9920, datë 19.05.2008 “2008 “Për Procedurat Tatimore në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, me qëllim arkëtimin e detyrimit të munguar në buxhetin e shtetit të evidentuara paraprakisht në vlerën **3,635,616 lekë**, kërkesë e cila është miratuar me Vendim nr. 70, datë 16.12.2024, të Drejtorit të Përgjithshëm.

Përfunduar. Raport Kontrolli Përfundimtar: Nr 2516/9 prot, datë 08.08.2025.Njofitim vleresimi nr.2516/10 prot, datë 07.08.2025. Gjetje 0.

Qëndrimi i audituesve shtetërorë: Grupi i auditimit, pasi shqyrtoi dokumentat që ju vendosën në dispozicion nga institucioni, rezulton se nga analiza krahasuese e rezultateve të rikontrolleve tatimore të zhvilluara në vijim të rekomandimeve të KLSH-së, rezulton se procedura e rikontrollit është ndjekur, nuk është arritur rikupërimi i të ardhurave tatimore të identifikuara si të munguara, pasi referuar materialit të kontrollit nr. 2516/9 prot., datë 08.08.2025, konfirmuar edhe me raportin teknik të inxhinierit me nr. 2516/7 prot., datë 08.07.2025, konstatohet se punimet nuk janë jashtë lejës së ndërtimit. Për rrjedhojë, rekomandimi i dhënë nga KLSH konsiderohet **I pranuar dhe zbatuar.**

9.1-Rekomandimi: Drejtoria Rajonale Tatimore Vlorë për tatimpaguesin “T”, NIPT K., referuar mangësive dhe parregullsive në procedurën e kontrollit tatimor, në përputhje me kërkesat ligjore dhe procedurale, të bëjë propozimet përkatëse në DPT për rikontroll tatimor, sipas përcaktimeve të nenit 85 “Ri kontrolli tatimor” të ligjit nr. 9920, datë 19.05.2008 “Për Procedurat Tatimore në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, me qëllim arkëtimin e detyrimit të munguar në buxhetin e shtetit të evidentuar paraprakisht në vlerën **1,070,080 lekë**.

